PETRO MARKO

Intervistë me vetveten

(RETË DHE GURËT)

SHTËPIA BOTUESE **"OMSCA"**
Tiranë, 2000

Botues: LUAN PENGILI

Redaktor : **Loredan BUBANI**

Redaktor teknik : **Skënder BEGU**
Kopertina : **Safo MARKO**
Arianita MARKO

ISBN 99927-40-33-7

Copyright Shtëpia botuese **"OMSCA"**, 2000
Rruga "Frederik Shiroka", Tiranë
Tel. Fax: + 42 355 336 48

PARATHËNIE

Po të mos ishte këmbëngulja e Safos, ndoshta nuk do të kishim sot në dorë këtë vëllim, ku dynden kujtimet, i cili, sido që të jetë, bën të mundur që diçka të mbetet; them diçka, se sigurisht nuk mund të pretendohet që të jetë paraqitur e plotë tërë odiseja e jetës së tij në këtë numër faqesh të shkruara me nxitim, por, të paktën, të qartësojë gjurmët e lëna në një rrugë të mundimshme, ku era e harresës, e mosnjohjes do të bënte me kohë, qoftë edhe pa dashje, deformimin e tyre.

Duke i shfletuar këto kujtime unë vetë, padashur, figura e njeriut që jetoi kalvarin e tij, siç e quan ai vetë, nuk mund të mos njësohet me figurën e njeriut shumë të dashur, të babait tim, me përkëdheljet, kujdesin, ngrohtësinë, mbrojtjen që ai rrezatonte për mua, për familjen.

Plane e plane për të shkruar e për të shkruar. Jehona e tiktakut të tasteve të makinës së shkrimit ende dëgjohet nëpër shtëpi. Shfletimi i dorëshkrimeve, i blloqeve të shënimeve, i fletëve të shkëputura, i letrave, bën të mundur frymëmarrjen që nuk mund të ndalojë; fjalët që mbetën të shkruara në letër, dhe ato që do të kishte dashur të thoshte akoma për të komunikuar me njerëzit, me ditët, me kohën që ecën, me jetën, tingëllojnë e nuk shuhen. E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja janë të pandashme, sepse ai jo vetëm që ishte, por është dhe do të jetë. Më kujtohet në periudhën e njërit prej dënimeve të tij, kur ai na thoshte: mund të ketë një ish-ministër, një ish-president, një

ish-udhëheqës, por kurrë nuk mund të ketë një ish-shkrimtar. Dhe unë tani, plotësisht e bindur, them: po, ai është përherë shkrimtar, poet, gazetar, por edhe burrë e prind i mrekullueshëm për familjen e tij.

Safoja, mamaja ime, u bë shkas që ai të ulej e të shkruante për kalvarin e tij, duke e bindur me faktin se do të ishte e pamundur që tërë atë jetë të mundte dikush tjetër ta tregonte e ta ndërtonte, se tërë ato ngjarje, data, njerëz, histori, përveç atij vetë, kurrkush tjetër nuk do të mund t'i rendiste vërtetësisht. Dhe ai u ul e hodhi në letër "shkurt", aq shkurt sa mund të tregohet shkurt një jetë e cila është sa për disa jetë të jetuara gjallërisht dhe jo një shtyrje jete, ashtu siç ndodh rëndom, qetësisht e kotësisht, në amullinë dhe apatinë e njerëzve që shtyjnë ditët brenda atij pellgu të cilin e kanë sajuar vetë ose ua kanë servirur.

Nuk pati mendimin e botimit, nuk bëri përpjekje për t'i ngjyrosur e për t'i bërë tërheqëse, vetëm se, për fat të keq, pati kujdesin e një vetëkontrolli, për të mos krijuar me duart e tij atë që mund të kthehej pas një kontrolli (të provuar, të pësuar) në një shkak për një dënim të ri për të dhe për familjen e tij. Ai tregoi, duke nxituar të rindërtonte armaturën e një ndërtese gjigante, sepse jeta e tij nuk u jetua vetëm, por, siç thotë ai, paralel me historinë dhe njerëzit.

Pjesa e parë, kur Petro Marko plak (sa e pagoditur kjo fjalë për ta cilësuar atë) interviston Petro Markon e ri, sido që të jetë, për fat të mirë, është më e plotë. Ajo u shkrua në kohën kur vuante një burg të ri, të cilin e quan burgim me heshtje, izolim, dhe kur i biri vuante burgimin, kur veç ëndrrave si krijues, iu ekzekutuan edhe ëndrrat si prind e familjar. Si do ta ketë ndier veten, i rrethuar ndërkohë nga helmi, kur tregon për fillimet e jetës, për luftën për një botë të ndryshme nga ajo që njohu, për idealin, për guximin e të shpresuarit dhe sakrificën, për humbjen në rrugën e kërkimit dhe për kthimin plot shpresë NË ATDHEUN E TIJ? I mbeturi jetim në vogëli, i përplasur nga tallazet e një deti të stuhishëm, kërkoi e kërkoi të gjente e të ndërtonte hapësirën e një bote pa gjerdhe, pa errësirë, e cila të jetohej nga njerëz të mirë, këtu, në atdheun e tij, ku duhej të fillonte kjo botë.

E kujtoj në ballkonin e shtëpisë, në çastet e trishtimit ngarkuar me kujtime, kur këndonte nën zë këngët atdhetare, luftarake dhe vajtimtare, në gjuhën e dashur shqipe dhe në gjuhët e vendeve në të cilat kishte luftuar, vuajtur, ëndërruar, i lidhur përsëri me zinxhirë, kësaj radhe të padukshëm, zinxhirë që nuk iu ndanë atij, njeriut që ishte nisur për t'i luftuar e zhdukur ata, në rrugët kaotike të një lufte e cila nuk po mbaronte.

Pjesa e dytë, aq pak fletë të një letre të zverdhur, u shkruajt mbas 13 vjetësh, në kohën kur Petro Marko i kishte shpëtuar përkohësisht pushtetit të vdekjes. Por ajo pas pak do ta mbyllte përsëri në një burg, në atë të përjetshmin e qenies fizike, në largimin e përhershëm nga njerëzit e dashur dhe nga kjo botë ende në furtunë. Çuditërisht vdekja e largoi vërtet prej nesh, pa asnjë mundësi për ta parë e për ta takuar më, por kudo nëpër shtëpi, në raftet, sirtarët, dosjet, ngado, mund të ndiesh praninë e tij, jetën e tij dhe kurrë mungesën.

Kjo pjesë e cila vazhdon nga viti 1944, viti i çlirimit, pas kthimit në Shqipërinë e tij, dhe që duhet të përmblidhte kujtimet, mendimet, zhgënjimet, humbjet, njohjen, regëtimin e rrezes së shpresës për rreth 47 vjet të një jete të ngjeshur me ngjarje, punë, krijimtari, do të mund të shkruhej kësaj radhe pa frikën e një kontrolli, pa kufirin e mureve mbrojtëse të të mos thënit të së vërtetës, por për fat të keq u shkruajt nën pushtetin e sëmundjes, e cila mezi e lejonte të merrte frymë. Përsëri një diktat kundër të cilit ai kësaj radhe ishte i pafuqishëm të luftonte, i cili po e prangoste sërish drejt dënimit të fundit, por tani e më tej ky dënim nuk do ta burgoste dot më me pamundësinë e fjalës. Fjala e tij jeton dhe ky botim, si dhe të tjerët që do ta pasojnë atë, nuk do të pengohet më, nuk do ta shpien më në brumatriçe e ta kthejnë në karton, nuk do ta burgosin dot e, sido që të jepen vendimet e rastësishme, nuk do të mundet kurrë më t'ia vrasin të drejtën më të thjeshtë të një krijuesi: atë të komunikimit me njerëzit.

Në kohën kur vendosëm të japim për botim këtë jetëshkrim, duke e zgjedhur të parin ndërmjet veprave të pabotuara a të botuara të cunguara, e rilexova me zë për mamanë time. U rijetua një jetë, sepse qemë pranë tij që kur ai ishte fëmijë, pastaj i ri, burrë dhe, së fundi,

nuk do të thosha i plakur, por i lodhur nga përvoja e një jete nëpër tallazet e pambarimta të kohës. Leximi im shumëfishohej nga kujtimet e pafundme të Safos dhe nga ato të miat. Atëherë vërtet vumë re se sa e pamundur ishte që ai të mund të përmblidhte jetën e tij, të mund ta tregonte atë për të tjerët. Por mua, ndërkohë që kaloja nëpër rrugën e mundimshme të një njeriu i cili përplasej në shkrepat e thepisura të brigjeve të ëndërruara, duke marrë goditje të njëpasnjëshme të realitetit të pamëshirshëm, të tjera gjëra më vinin ndër mend. E si është e mundur që një njeri me një peshë të tillë vuajtjesh të mund të krijonte ndër vite atmosferën e shumëdashur të një BABAI, duke dhuruar vetëm mirësi, dashuri, ngrohtësi, kujdes, duke mos lejuar që pesha e halleve të tij të rëndonte edhe mbi shpirtrat tona. Kujtoj babin te dera e gjimnazit me bukën time me vete, se unë kisha ikur pa ngrënë mëngjes. Kujtoj ushqimet që përgatiteshin për t'i shpënë në burg tek im vëlla, kur ai thoshte: edhe këtë, edhe atë, duke mbledhur me aq kujdes, e sigurisht me shumë vështirësi, ato që mundeshim. Kujtoj ëmbëlsirat që sillte sa herë që merreshin rrogat ose ndonjë honorar; e kujtoj të sëmurë, kur, sa herë i bëhej ndonjë shërbim ose i kalonim pranë, na puthte përherë, sikur të kishte çdo çast frikën e largimit prej nesh. Nuk e shpërndante hidhërimin te fëmijët, duke na ruajtur në çdo çast, me aq sa mundej, nga helmimi prej tij. Nëse e pyesja e më tregonte për rrugën e tij, të kësaj jete përherë të vështirë, e bënte në mënyrë të tillë që paraqiste anën e bukur, njerëzit e mirë, besimin për të ardhmen dhe besimin se e bardha është më e fuqishme se e zeza, drita se errësira, dashuria se urrejtja, e ardhmja se e tashmja. Një nga gjërat që më bën kurdoherë përshtypje, janë miqësitë e tij. Në një miqësi nuk mjafton të dish të zgjedhësh, por edhe të dish të zgjidhesh. Miqësitë e tij i kanë rezistuar kohës, largësisë, kufijve. Ende sot, kur ai nuk është më midis nesh, miqësia e miqve vazhdon duke e bërë ende më të pranishëm. I përmend këto pak gjëra, sepse nuk mund të ndash njeriun-baba nga njeriu-artist. Për mua ai është BABI im, por edhe shkrimtari e poeti i dashur të cilin mund ta lexoj e ta rilexoj, duke i dashur veprat e tij dhe personazhet, të cilat më duken përherë të njohura e të afërta. Në rrugë, studentët, njerëz të panjohur e përshëndetnin: Hasta la vista, Petro Marko!

Një nga dëshirat e tij ishte që ai të mbetej edhe si poet. Sepse në shpirt në fund të fundit ai mbeti POET. Në tragjikën e jetës së tij ai ishte poeti, midis mureve i mbyllur, nëpër humbjet i plagosur, ndër dënimet i izoluar, ai mundte të shikonte përtej mundësisë së lejuar të qiellin qiell, të dashuruarën të bukur, të palëvizshmin mal, të lirin njeri, të shtrenjtën shpresë. Poezinë e kishte në tërë qenien dhe në ngjizjen e tij, aq sa edhe në çastet kurajëvrasëse shpirti i tij krijonte bukurinë dhe muzikalitetin, të cilin nuk mundej dot dreqësia ta shprishte, ta shkelte, ta shndërronte.

Kjo parathënie është një porosi e tij. Ndoshta nga bisedat tona dhe nga ato me njerëzit e dashur, ai e mendoi se dikur do të botohej e do të bëhej i njohur edhe ky dorëshkrim për lexuesit e tij. Dhe midis shumë porosive ishte edhe kjo: jetëshkrimi i tij të shoqërohej me një shpjegim të thjeshtë për kohën, mundësinë, pamundësinë e të shkruarit të jetës. Do të ishte ndryshe, por kaq qe e mundur të thuhej. Sa shumë mbeti pa u thënë. Për njerëzit që ai deshi, që i njohu, që vuajtën dhe bashkëvuajtën me të, që mbetën të vlerësuar ose "të panjohur", në rrugën e përhershme drejt një ideali të një bote të denjë të jetuar nga njerëz të denjë, për të cilët gjithnjë i dukej se kishte një borxh për t'u dhënë mundësinë e njohjes dhe të rijetimit. Atëherë unë mund të them se në këtë bisedë të gjatë të shkurtuar nga pamundësia Petro Markos i mbeti ende shumë për të thënë. Si të gjithë njerëzit.

Në bisedat dhe në shënimet e tij flitet për romanin që ai e quan më të rëndësishmin e krijimtarisë së tij, për romanin "Retë dhe gurët". Janë shënimet, projekti, hartat. Ndër vite. Në një fletë shkruhet: "Dëshira e fundit: Të shkruaj romanin "Retë dhe gurët". Më poshtë:

Regjimet	Deti Toka Malet Koha	**Njerëzit Zogjtë**

Në fund të leximit të këtij jetëshkrimi, ne, pa pasur as më të voglin dyshim, menduam: Ky jetëshkrim duhet të mbajë titullin "Retë dhe gurët", sepse, ndoshta pa e ditur, Petro Marko e ka shkruar

edhe atë. Romani i dëshiruar, dëshira e tij e fundit, në të vërtetë është realizuar. Kjo përkon me dëshirën dhe planet e tij. Unë besoj se ai këtë gjë me siguri do ta pranojë. Është titulli që ai e kishte zgjedhur vetë.

Ai zgjodhi të kthehej në një gur në vendin e tij. Tashti ai qëndron në atë vend nga i cili dikur, ende fëmijë, shikonte botën përtej horizontit e detit, duke ëndërruar njohjen të veshur me mantelin e shpresës, sepse bota ishte aq e madhe, e parë nga larg, sa do të ishte e pamundur që të mos kishte vend për njerëzit që do të jetonin në të. Ai e kaloi detin dhe tentoi të prekte horizontin. Por nuk mund të zgjidhte që të kthehej në re. Zgjodhi gurin. Si emri i tij. Si një paracaktim i fatit. Dhe, meqë ka edhe re, ka edhe gurë, si mundet që Petroja të mos zgjidhte gurin?! Ai tani është një gur në vendin e tij. U kthye. Për ta parë tanimë të njohurin horizont nga fshati i vet.

ARIANITA PETRO MARKO

Pjesa e parë

Petro Marko plak interviston Petro Markon e ri

Shkruar në vitin 1977

Ç'janë kujtimet? - Jeta e jetuar me emocione, me të gjitha armët që e mbajnë të gjallë, me të gjitha normat dhe kanunet që ka krijuar kuvendi i shekujve.

Dikur kam shkruar tetë vargje për KUJTIMET. Dhe, me sa mbaj mend, thosha: *"O kujtime, o jeta ime! Dilni andej nga jeni hedhur të grumbulluara me vullnetin tuaj, pa asnjë shtypje a kanosje, dilni ashtu siç u regjistruat në shiritin e pafund të magnetotrurit tim. Tani ju dua!"*

Pse kërkoja të dilnin kujtimet e mia, të dilnin ashtu siç u grumbulluan nga emocionet, vizionet, imazhet, skenat, dramat, tragjeditë, tragjikomeditë e jetës sime? Sepse atëherë kur shkrova këto vargje, isha i internuar në ishullin e shkretë të Ustikës, atje në atë nisi të vetmuar, larg Sicilisë, larg Palermos. Dhe njeriu i veçuar nga jeta, ose më mirë i vdekur, se i vdekur është ai që jeton me kujtimet, kurdis magnetotrurin e tij dhe kalon kohën i qetë, duke numëruar hapat e këmbëve dhe të mendimit, të zemrës dhe të përvojës së tij.

Ç'mbetet në kujtesë, ka kaluar nëpër shoshën e viteve, të shqetësimeve dhe të ëndrrave, të realitetit lakuriq dhe të gjurmëve të thella të emocioneve, imazheve, vizioneve, peizazheve, duarve, syve, zemrave, zërave, kujave, këngëve, valleve, intrigave, pasioneve, shqetësimeve, dashurive, flirteve, gjuhëve, tingujve, shfaqjeve të përditshme në ekranin e pafund të jetës...

Unë nuk kam mbajtur kurrë shënime, ku të shkruaja ç'kisha parë e ç'kisha dëgjuar, ç'kisha qarë e ç'kisha kënduar, ç'kisha thënë e ç'më kishin zënë veshët, prandaj këto që tani nisa t'i nxjerr nga pellgu i paanë i mbresave të jetës sime shumë, shumë të gjatë, po i nxjerr nga kujtesa që ende nuk më ka lënë.

Nuk po shfletoj as dokumente, as shkresa, as shkrime, por i çel rrugë detit të pafund të mbushur për shtatëdhjetë vjet me radhë. Jetë e gjatë! Ngjarje të shtrira në kohë! Shekull i lëkundjeve të mëdha shoqërore, i përmbysjeve, i shembjeve, i katastrofave, i humbjeve dhe i fitoreve.

Shumë vjet më parë shkrova:

Ditën që linda unë,
planeti ish në furtunë!

Ditën që rrojta unë,
planeti ish në furtunë!

Ditën që vdiqa unë,
planetin e lashë në furtunë!

Edhe milingona ka jetën e saj. Çdo gjë e gjallë ka jetën e vet: lind, jeton dhe vdes. Çdo njeri ka jetën e vet. Ka gëzimet dhe dhembjet e veta. Këto gëzime dhe këto dhembje kanë përmasat e horizonteve dhe të mjediseve ku ai lind, jeton dhe vdes. Stinët e moshës, stinët e pasioneve, ëndrrave, dëshirave përcaktojnë krijimin e kushteve të jetës me anën e armëve që përdor njeriu. Cilat janë armët që përdor ai për të jetuar? Puna! Puna është jeta! Puna! Krijimi është motori që vë në lëvizje këmbët e jetës, që hap shtigje të reja, horizonte të reja, burime të reja, kanune të reja, që sjell përparimin... Anekset: intriga dhe frika, smira dhe dhuna, tradhtia dhe pabesia, posh-

tërsia dhe krimi... ngjyrat e zeza (në dëlirësinë e jetës, nën diellin e betejave për të jetuar) kanë qenë, janë dhe do të jenë kurdoherë turpi i jetës. Kontradiktat do të jetojnë bashkë me jetën, por duhet të pakësohen dhe të zhduken ato antagoniste dhe të ecet me joantagonistet. Jeta një herë jetohet!

LE TA ÇELIM RUBINETIN E DETIT TË KUJTESËS

Këtë intervistë, unë, plaku Petro Marko, e marr nga i riu Petro Marko. Fillojmë:

- Petro, *tani kam nevojë të bisedojmë bashkë dhe të çmallemi duke rijetuar jetën.* Le ta fillojmë këtë punë të gjatë me pyetje:

Pyetja e parë: - Ç'mund të thuash për origjinën tënde dhe fëmijërinë?

Përgjigje: - Me sa kam dëgjuar, me sa di, unë rrjedh nga një familje që në fshatin Dhërmi quhet Bua. Shekuj më parë, në fshatin tonë erdhi për t'u strehuar Gjin Bue Shpata, nipi i luftëtarit Gjin Bue Shpata. Ai, nipi, siç thonë pleqtë, banoi në një vend midis Shënapremtes dhe Shën Theodhorit, aty ku kishte nomenë Zhupa dhe që quhet Paloshpita... Pastaj erdhi dhe ndërtoi një konak, nën Qendushën, aty ku ende i themi Konaku i Gjinit. Aty atij i lindën dy djem: Markoja dhe Gjoni. Pak metra më poshtë ngriti një kishë të vogël: Shën Janin, që është ende. Djemtë e tij u rritën dhe ndërtuan shtëpi të tjera të vogla, nën shpellën e Pano Gjinit. Markoja dhe Gjoni shtëpitë i bënë pranë e pranë. Aty, në atë vend, Markajt dhe Gjonët bënë shtëpi të tjera, se u shtuan. Edhe Buajt bënë shtëpi pranë Konakut të Gjinit. Kështu që, shekuj me radhë, Markajt, Gjonët, Buajt ishin një bark, një fis dhe gjer vonë, sa isha unë i ri, nuk martoheshin me njëri-tjetrin. Kishin të drejtën e gjakut për njëri-tjetrin,

quheshin një familje. Mbaj mend se gjatë viteve '30, një nga Gjonët, Kosta, dashuroi kushërirën time të parë, Eftalinë, por prifti i fshatit nuk u vinte kurorë, se ishin të një gjaku. Prandaj ata shkuan në Korfuz dhe paguan dhespotin për t'i kurorëzuar...

Pra, siç e shihni, familja jonë është një familje e lashtë.

Pyetje: - Më fal që po të ndërpres, po... si të them, këto që po dëgjoj nga ti, mos janë pjellë e fantazisë? Se, më fal, më fal, ti njihesh sikur ke shumë fantazi të shfrenuar dhe aty për aty trillon gjëra, episode ose ngjarje të paqena.

Përgjigje: - Ashtu është! Shokë të mi të ngushtë, si Zenel Hekali, Minella Koleka, për të cilët do të flas kur të hapet kapitulli i të njohurve të mi, kur u kallëzoja ndonjë episod të jetës sime, shkuleshin së qeshuri duke thënë: "Ja, ja, tani e trilloi! Ç'fantazi që ka shejtani!" Dhe unë qeshja bashkë me ta dhe u thosha: "Edhe Don Kishoti i shkretë, kur ishte në pragun e vdekjes, thirri të afërmit e tij, i vështroi dhe u tha: "Unë ju kam gënjyer. Nuk kam lexuar libra kalorësie dhe as që jam kalorës i fytyrës së vrerosur. Unë quhem Antonio Kishiena dhe jo Don Kishot!" Ata, që e dëgjuan të fliste kështu, panë njëri-tjetrin në sy dhe thanë me vete (disa dhe me zë) :" I ziu, tani që është duke vdekur, shkalloi, rrodhi, nuk di se ç'thotë!"

Pra, Don Kishotin, kur trillonte bëma fantastike, e besonin. Kur tha të vërtetën, nuk e besuan.

Për origjinën tonë si Bua, kam të dhëna që kur rronin ende dy pleq nga fshati ynë: Mantho Bua dhe Petro Gjoni. Këta hera-herës shkonin në Patras e në More për t'u takuar me xhinsin tonë, se edhe atje ka Buaj. Thoshin se ata kishin shkuar atje shumë shekuj më parë, ndoshta me Gjin Bue Shpatën. Po lidhjet familjare nuk i kishin shkëputur. Xha Manthoja tregonte se edhe ata mbu-

rreshin me Merkur Buan, një kapedan stratiot, që shkoi në Spanjë dhe arriti gradën e gjeneralit. Thonë se ishte shumë i zoti dhe mbreti i Spanjës e kishte krah të djathtë. Thonë se në një luftë me francezët kishte zënë rob djalin e mbretit të Francës, Fransua i parë... Për këtë mund të marrim vesh më shumë nga një poemë që është shkruar për të: "MERKURIADA". Grekët thonë se ishte grek, por ai vetë ka thënë se ka lindur në Malin e Vetëtimës, "Akroqeravnie Ori", që janë malet tona të Bregdetit.

Kur rronte xha Mantho Bua, meqë ishte më i moçmi, ne, si Markaj, Buaj e Gjonë, nuk mund të bënim asnjë veprim (martesë, krushqi, shitblerje tokash e të tjera) pa qenë ai në krye të kuvendit familjar. Kur vdiq ai, vendin e tij e zuri Petro Gjoni.

Im atë quhej Marko. Nëna ime quhej Zoicë. Im atë ishte i biri i Jani Markos. Unë di të flas për kohën që nga Jani Marko i vjetri, se shumë gjëra i kam dëgjuar nga gjyshja ime, e cila na rriti dhe që unë e doja shumë, ndaj dhe me mua bisedonte gjatë. Jani Markoja kishte dy vëllezër: Pano Markon dhe Kiço Markon. Shtëpitë kolibe që kishin trashëguar, i kishin shtuar dhe zgjatur aty ku kishin qenë të parat. Rronin duke punuar tokat, duke rritur bagëtitë dhe duke shitur valanidhe. Jani Markoja, që ishte më i vogli, u martua me një vajzë shumë të bukur, që ishte nga familja Mëhilli ose Maruli. Ajo ishte e gjatë, leshverdhë, e hollë dhe fisnike. Ne i thoshim mama Mille. Shumë vonë, kur u bëra burrë, mësova se ajo emrin e kishte Fotina. Ajo ishte burim i pashterur i rrëfimeve, i legjendave, i vajtimit dhe i ligjërimit me vargje. Ajo, gjersa vdiq, qante dy orë ditën me ligje në dhomën e saj, që ne e quanim *kamarullë*. Dhe ja pse qante ditë për ditë, vite me radhë, gjersa vdiq aty nga fundi i viteve '30.

Burri i saj, Jani, kur kthehej nga Janina ose Delvina, ku shkonte me mushkat e ngarkuara për të shitur vajin, pinte shumë rum Xhamajke në kafenenë e Domo Dabos,

aty pranë Shëmitrit. Një mbrëmje, me një shok të tij të ngushtë, pasi piu shumë, i tha: "More vëlla, pse nuk martohesh edhe ti si ne?" Dhe ai, i bërë tapë, u përgjigj: "Me kë të martohem? Atë që desha unë, e more ti!" Paguan dhe u ndanë pa i thënë njëri-tjetrit as natën e mirë. Jani vajti në shtëpi. Gruan e gjeti që e priste me mësallë shtruar për të ngrënë darkën. Ai nuk vuri gjë në gojë. Shkoi dhe u shtri pranë vatrës. Gjyshja, kur e pa që e kishte zënë gjumi, e mbuloi dhe vajti te fëmijët e saj që flinin: Markoja pesëvjeçar, Andrea trevjeçar dhe Evanthia njëvjeçare; pra, mama Millja kishte tre fëmijë. Gjyshi, në mëngjes, pa gdhirë mirë, u ngrit, ngarkoi mushkat me vaj dhe iku për në Janinë, pasi puthi në ballë të tre fëmijët, që ende flinin. Iku dhe nuk u kthye më. Prit një vit e dy vjet, e pesë dhe dhjetë vjet, asnjë lajm nga gjyshi. Im atë, kur u rrit dhe u bë shumë i pasur, ç'nuk bëri për të gjetur babanë e tij! Kudo ku kishte fshatarë nga tanët, në Greqi e në Rusi, e pastaj në Francë e në Amerikë, në Turqi e në Egjipt e kudo... kërkoi e kërkoi po asnjë gjurmë. Thanë pas viteve '20 se ishte martuar në Izmir e kishte bërë dy djem: Markon dhe Andrean. Im atë nuk la njeri pa pyetur. Por në Izmir ndodhi katastrofa, kur grekët u hodhën në det nga tërbimi turk.

Nuk ishte rasti i vetëm zhdukja e gjyshit tim. Për burrat që nuk shkonin mirë me gratë e tyre, ose kur ato kishin ndonjë cen të rëndë fizik a moral, rrugë tjetër nuk kishte veç largimit përgjithnjë nga familja, nga fshati, kështu që gratë vdisnin të plakura te pragu, duke pritur burrin të kthehej nga kurbeti.

Mama Millja i rriti mirë fëmijët e saj, Markon, Andrean dhe Evanthinë, të cilën e martoi pesëmbëdhjetëvjeçare, por kjo ra në gëlqere të pashuar dhe vdiq nuse e re, pa lënë asnjë fëmijë. Markoja dhe Andrea punuan tokat, sidomos Rahinë, aty ku kultivohej qitroja e çifutëve. Tabori, ku ishte toka jonë, ka qenë karakoll turk që

ruante bregdetin. Pranë asaj ndërtese, që i mbeti emri Tabori, ishin tokat tona të pasura, me qitro nga më të mirat.

Pyetje: - Nuk është më mirë të na thuash disa fjalë për ato qitro? Se fshati me ato qitro jetonte mirë dhe pasurohej shumë.

Përgjigje: - Ashtu është. Edhe shtëpia e re ku linda unë, nga shitja e qitrove u bë. Qitrot janë një familje me agrumet. Ato, siç kam dëgjuar nga pleqtë, fshati ynë i njohu në kohën e Venedikut. Thoshin se më parë u kultivuan në Pargë e pastaj në Borsh e në Dhërmi. Toka dhe uji i Dhërmiut janë më të përshtatshme për kultivimin e tyre. Qitrot ebraike janë një kulturë e jashtëzakonshme. Atë kulturë fshatarët e mi e zhvilluan shumë, brez pas brezi, sa u bë Dhërmiu monopoli i qitrove ebraike në botë. Me ato qitro çifutët bëjnë pashkët. Një qitro, bashkë me një degë palme, është emblema e pritjes së Moisiut, ashtu siç e kishin ortodoksët, që bënin pashkë me vezë të kuqe. Dhërmiu kishte si qendër të shitjes së qitrove Triesten. Aty mblidheshin blerësit nga Varshava dhe Vjena, nga Budapesti dhe Peterburgu, nga Praga e Bratislava, pra andej nga kishte më shumë çifutë. Takonte të vinin dhe në Dhërmi priftërinj çifutë, që kishin lidhje me prodhuesit e mëdhenj.

Im atë, meqë prodhonte qitro të cilësisë së parë (perfekte u thoshin) nisi të shkonte vetë në Trieste. Komisionerët e tij ishin të shumtë, se "marka" e qitrove "Marko" kërkohej dhe blihej shumë dhe mirë.

Ndërsa im atë merrej me tregtinë e qitrove, vëllai i tij, Andrea, merrej me tregtinë e kafshëve. Blinte lopë, qe, dhen e dhi dhe i shiste në Korfuz. Në fillim të dhjetëvjetëshit të dytë të këtij shekulli, ata u bënë nga më të pasurit e gjithë Bregut. Kishin dyqane dhe mendonin të blinin hotel "Kostandinopolin" në Korfuz. Aq të pasur u bënë, sa, kur ndanin paratë, mbushnin një qyp me flori

pa i numëruar se sa copë ishin, dhe thoshin: "Një unë, një ti, një unë, një ti!." Për këtë ata kishin lënë nam, saqë edhe sot e kësaj dite, po të flasësh me ndonjë plak që i ka jetuar ato kohë, thotë: "Ama, ata ishin vëllezër!... Kishin besim dhe dashuri te njëri-tjetri, sa ishin bërë shembull për të gjithë! Sidomos e ëma, mama Millja, zemërmirë e shpirtmadhe, që nuk la familje pa i shpënë dhurata e bukë e ç'të kishin nevojë. Në vitin 1910 im atë fitoi shumë nga qitrot, se bëri një marifet: shkoi në Pargë, i bleu ato pak qitro që prodhoheshin aty, dhe i hodhi në det. Shkoi në Jafa të Palestinës, ku gjithashtu prodhoheshin pak qitro, i bleu edhe ato dhe i hodhi në det. U tha fshatarëve që e prodhonin qitron: "A s'mi shitni mua me çmimin që dëshironi, se dua që t'i kem unë në dorë një herë çifutët që na e hedhin! Se në Trieste venë edhe fshatarë analfabetë dhe kërkojnë të maten me aftësitë e mëdha të tregtarëve çifutë"... U foli shumë. Fshati e deshi shumë babanë tim. Edhe ata që nuk e deshën, bënë, ç'bënë dhe qitrot nuk i shpunë vetë në Trieste, si çdo vit, por ia shitën tim eti. Kështu im atë shkoi në Trieste me gjithë qitrot e atij viti. Komisionerët, tregtarët çifutë, prisnin prodhuesit e tjerë, por e panë që asnjë nuk dukej. Po afronte pashka. Duhej medoemos të ktheheshin në Poloni e në Rusi, në Gjermani e në Austri e Rumani me qitrot, se pa ato çifutët nuk do të bënin pashkë. Im atë u tha: "Dua gjysmë napoloni flori për çdo kokërr! Në daçi i blini, në daçi mos i blini!" Ata dhanë e dhanë që ky ta ulte çmimin, por im atë nuk tundej. I kishte në dorë. Më në fund, ata deshën, s'deshën, i blenë me gjysmë napoloni flori kokrrën. Ai vit qe shumë i mbarë për bashkëfshatarët e tij. Krisi kënga, dasmat e vallja; vera dhe rakia derdheshin lumë. Atë vit im atë dhe xhaxhai im vajtën e gjetën ustallarë nga Janina e Konica dhe ndërtuan shtëpinë ku linda edhe unë. Qerestenë e prunë nga Triestja, të porositur në Suedi. Të dy vëllezërit kishin servise për

200 veta dhe shtrojë e mbulesa për pesëdhjetë veta, të gjitha të blera në Evropën Qendrore, në Budapest, në Vjenë e Pragë. Këto i mbaj mend edhe unë. Fshati ende flet. Vazhdojnë të jenë në komo shumë fletë llamarine me markën e qitrove "Marko" me shkronja ebraike, që viheshin në arkat e ambalazhit të qitrove dhe që, kur përshkoheshin me një furçë me bojë të zezë, dilnin shkronjat. Kaq për qitrot. Tani, si thua, ç'kërkon prej meje?

Pyetje: - Nuk na fole për mama Millen. Si e kujton?

Përgjigje: - Është figura më e dashur, më e shtrenjtë e jetës sime. E kam respektuar shumë. Ajo "më ka dhënë uratën", se unë, qysh i vogël, kurdoherë i shpija diçka, kur kthehesha nga bahçet ose nga bregu i detit: i çoja fiqtë më të pjekur (ne u thoshim glluparia). I çoja manaferra, i çoja nespullat më të ëmbla, pjeshkët më të pjekura dhe rrushin e parë të bardhë, që piqej shpejt. Dhe ajo lëmonte flokët e saj të bardhë dhe më thoshte: "Paç uratën, o bir!". Mama Millja rridhte nga një familje detarësh. Dy vëllezërit e saj u mbytën në kanalin e Torontos. I rrëmbeu rryma bashkë me gjeminë dhe i vërviti në ujëvarën e Niagarës. Edhe djemtë e saj e deshën shumë dhe bënin çmos që ta gëzonin, se vajzën e vetme e humbi fare të re, dy vëllezërit i humbi, burrin e humbi. Ajo krenohej me dy djemtë e saj. Kishte pak fjalë, por shumë ligjërime të prekshme. Familja e saj shkonte me pëlhurat e fryra, siç thonë detarët, kur gjeminë ua shtyn era e mistralit. Po...

Pyetje: - Pse heshte? Ç'doje të thoshe?

Përgjigje: - Do të të them një gjë që duhet ta mbash mend përjetë.. Dije se i huaji na ka sjellë kurdoherë gjëmë, kujë, vdekje. Afro pesëqind vjet me Turqinë vit për vit bënim dava... Po ja që më 1914 erdhën andartët e Greqisë. Dhe shkuan në Karaburun me disa nga Palasa. Aty, në Karaburun, dukatasit mbajnë nometë e tyre

denbabaden. Andartët rrëmbyen, plaçkitën dhe vranë dy të rinj. Dukati u ngrit më këmbë dhe u zemërua shumë me banorët e Himarës. "Si, - thanë ata, - po ne jemi vëllezër, megjithëse i huaji na ndau në dy fe. Ne jemi vëllezër e gjak... dhe tani ju po lejoni andartët kriminelë të na vrasin e të na plaçkitin?!" U betuan se do ta merrnin hakun. Disa thanë që të shkulej gjithë krahina e Dukatit dhe t'i sulej Himarës. Po patriotët e asaj krahine, njërin prej të cilëve, Pilo Andonin, e kishte dërguar Ismail Qemali në Himarë te Spiro Miloja, që ishte i pari i greko-manëve, për t'i kujtuar fjalën dhe besën që kishin dhënë që të mos vriteshin djemtë tanë për qejfin e turkut a të grekut, qetësuan gjakrat dhe vendosën që gjaku të merrej duke i prerë kokën njërit nga paria e krahinës së Himarës. Paria e krahinës së Dukatit caktoi disa emra nga të parisë së Himarës dhe, me llotari, ra që të vritej Andrea Marko, vëllai i tim eti, që ishte një kapedan që i dëgjohej fjala në krahinë, trim e i urtë dhe shumë i pasur. Thirrën xhaxhanë tim, gjoja për kuvend në Dukat, pasi ai kishte qinasur dhe shumë bagëti me dukatasit, dhe në Llogara i bënë pritë 12 veta. Xhaxhai ishte mbi mushkë dhe trimi i shkonte pas. Nga prita qëlluan dhe ai ra nga mushka i bërë shoshë nga plumbat. Shkuan vrasësit t'i prisnin kokën dhe ta shpinin në Dukat, se kështu ishte vendosur. Kur u afruan, Andrea ishte ende gjallë. I njihte, i kishte miq. Mezi u tha: "Kush më qëlloi?" Njëri prej tyre, babai i dy djemve që u vranë nga andartët në Karaburun, i tha: "Ne të vramë për hakmarrje!" Andrea mezi tha: "Ju më vratë? Ju do të më qani!"

Këtë vrasje, që bëri bujë në gjithë krahinën, grekomanët me në krye Spiro Milon dhe arhondët e tjerë, e kthyen në një fushatë kundër shqiptarëve. Po kishte krahina njerëz me kokë, kishte patriotë që dinin t'u bënin ballë dallgëve të andartëve grekë. Njëri prej tyre ishte dhe Thanas Beni nga Vunoi, i cili, nga minareja e xhamisë

së Kallaratit qëlloi dhe vrau kapedan Çullaqin, komandantin e andartëve kriminelë që digjnin fshatrat e Jugut...

Im atë u pikëllua shumë, këtë vrasje nuk e kuptonte dot. "Po ne i kemi miq e vëllezër. Me ta kemi ngrënë bukë dhe kemi zgjidhur problemet tona. Pse? Pse të ma vrasin vëllanë, i cili me Dukatin kishte të bënte sikur të ishte vetë nga Dukati? Me dukatasit hante e pinte dhe bagëtinë bashkë e kishin qinasur. Pse? Pse të na e bëjnë neve këtë? Sidomos Hamit Selmani, që e kishim dhe mik. Sidomos Bezhani, që hynim e dilnim në shtëpitë e njëritjetrit si vëllezër. Pse? Do t'ia marr hakun vëllait !" Dhe paguante pilurjotë për të shkuar e për të djegur shtëpitë e Hamit Selmanit dhe të Bezhanit, të vrisnin djem e fëmijë. Po pilurjotët nu kishin budallenj. Pse të armiqësoheshin me dukatasit? Pastaj barinj të tjerë, miq e vëllezër me dukatasit, lajmëronin familjet e Hamit Selmanit dhe të Bezhanit se po vinin pilurjotët. Dhe ata largoheshin. Madje disa nga krahina thanë që të organizohej një ekspeditë me andartë e me himarjotë që të shkonin e të digjnin Dukatin. Dhe im atë, siç thonë ata që e kanë dëgjuar, kishte thënë: "Mos ngatërroni hasmërinë e një familjeje me të një familjeje tjetër. Ç'ka këtu Dukati dhe Himara?... Nuk u çmendëm të dëgjojmë mendimet e liga të disa të shiturve..." Këto që tha im atë, duke kaluar gojë më gojë, ndryshuan kuptimin dhe ata arhondë që trembeshin nga im atë, se u kishte dhënë para borxh, prisnin orën të bënin të tyren. Dhe ora erdhi. Andartët ikën dhe erdhi Italia.

Të parën gjë që italianët kërkonin nga fshatarët, ishin armët.

Kuvendi i pleqësisë u mblodh lart, në Shën Mëri. Vendosën që të mos i dorëzonin armët. U betuan: "Armët nuk ia japim kurrë të huajve, që na dogjën, por ato do t'i mbajmë siç i kemi mbajtur në shekuj, për të mbrojtur jetën tonë, nderin tonë!"

Erdhi çasti i disa arhondëve grekomanë që ta zhduknin Marko Janin, i cili u kishte dhënë dhe shumë para borxh. Ata u munduan ta zhduknin edhe pse nuk e deshën, edhe pse kështu nuk do t'i kthenin më qindra e mijëra napolona flori që ai u kishte dhënë borxh. Vajtën te komanda italiane dhe thanë se fshati kishte armë, por nuk i lejonte Marko Jani t'i dorëzonin. Thanë se ai është marrë vesh me një fuqi të huaj, me Austrinë; se vinte një nëndetëse në Spile të Shën Theodhorit dhe se aty ky merrte direktiva dhe jepte informacion kundër italianëve...

Pyetje: - Atëherë, sa vjeç ishe ti?

Përgjigje: - Isha çilimi, por e mbaj mend këtë vizion që më ka ndjekur gjithë jetën: Ishim rreth vatrës. Ishte dimër. Unë isha në prehrin e tim eti dhe recitoja një vjershë libertine që kishte bërë gjyshi, babai i nënës, Jani Kuçuli, se ishte poet, dhe qeshnim. Mbaj mend se nëna kishte gatuar supë pule me limon e vezë dhe po e ndante në pjata, kur befas na hynë në dhomë tre karabinierë të mëdhenj sa tre qiparisa. Shumë të mëdhenj. Shumë të zinj. Në kokë mbanin disa kapela si varka. Ne u trembëm. Unë pashë babanë të ngrihej. Pashë të zgjaste duart. Ata i folën, ai ua dinte gjuhën. Pashë t'i hidhnin prangat. Ne të gjithë, gjashtë vëllezër dhe një motër, u grumbu-lluam rreth nënës. Ata e shtynë. Fotoja, vëllai i madh, u hodh, por ata e shtynë. Dëgjova zërin e babait; "Zoicë, edhe në mos u kthefsha, djemtë kanë toka, të punojnë dhe të vdesin mbi to. Kurrë të mos i lënë tokat!" Iku! Ne qanim. E shpunë në Vlorë. Pas pak ditësh e prunë përsëri në fshat. Përkundruall shtëpisë sonë, italianët kishin përzënë familjen e dajës Foto Kuçuli dhe kishin vendosur zyrat e karabinierisë. Shumë karabinierë dhe oficerë ishin grumbulluar përpara një togu armësh të vjetra: dogra, maliherë, çifte... Nxorën babanë nga biruca dhe e çuan përpara armëve. Një kolonel i tha:

- Ti ngulje këmbë dhe thoshe se fshati nuk ka asnjë armë! Po këto ç'janë?

- Armë! - tha im atë dhe shikonte nga shtëpia jonë. Ne kishim dalë të gjithë në tarracë dhe sytë tek ai i mbanim. Shpresonim mos e lironin.

- Po të kujt janë këto armë? - e pyeti përsëri koloneli.

- Ju e dini, - u përgjigj thatë im atë.

- Janë të fshatarëve tuaj, dhe ti këmbëngulje e thoshe se nuk kemi asnjë armë. Armik i shitur, i rrezikshëm! Kërkoje të bëje luftë kundër nesh...

Im atë, i qetë, ia preu:

- Unë them se këto armë nuk janë të fshatarëve të mi.

Atëherë koloneli thirri disa fshatarë, midis të cilëve dhe kryeplakun dhe dy arhondë, të cilët thanë njëzëri:

- Armët janë tonat!

Im atë i pështyu dhe i shau keq:

- Haleja e fshatit jeni ju dhe jo arma e fshatit. Tradhtarë të ndyrë!

Koloneli e shtyu. Karabinierët e hoqën zvarrë, e shpunë brenda. Andej, me këmbë të lidhura, e shpunë në Vlorë, pastaj e dërguan në burgun e Brindizit, në atë të Leçes, në të Palermos, më vonë në ishullin e Fabianës e pastaj në ishullin e Ustikës. Andej na shkruante një letër në muaj. Letrat i kemi mbajtur shumë kohë në komo. I lexonim dhe qanim: *"Jam në një kafaz hekuri të një kështjelle të errët. Ju mos mendoni më për mua, po për veten tuaj. Punoni tokat dhe vdisni mbi to!"*

Pas dy vjetësh na vdiq vëllai i vogël, Jaku. Nëna gjithnjë qante, kurse mama Millja i thoshte: "Mua më la me dy djem të vegjël, pa asgjë, dhe i mbajta sa i bëra burra të dëgjuar me nder e me nam. Ti ke pesë djem. Ata do të rriten dhe do të bëhen si etërit e tyre."

Pas 1919-s, shumë fshatarë nga Dhërmiu, nga gjithë krahina e Vlorës dhe e Himarës, që ishin në burgje dhe

të internuar nga italianët, u kthyen. Vetëm babai nuk u kthye. Në shtëpinë tonë ishte komanda e ushtrisë. Erdhi gjeneral Piaçentini dhe daja i vogël, barba Leka, që dinte edhe ai italisht, na mblodhi dhe na shpuri lart, në zyrat e gjeneral Piaçentinit. I tha: "Ja familja e Marko Janit. Të gjithë u liruan. Ai pse nuk lirohet? Është njeriu më i dashur i fshatit. Nuk ju flas vetëm në emrin e familjes së Marko Janit, po ju them në emrin e gjithë fshatit, për të mirën tuaj, lirojeni edhe Marko Janin!"

Siç morëm vesh më vonë, gjeneral Piaçentini i kishte bërë një telegram mbretit të Italisë pak a shumë me këto fjalë: *"Mendojmë që për oportunitet politik dhe në interes të sigurisë sonë, duhet të lirohet patjetër Marko Jani, që gjendet i* internuar *në Ustikë."* Nuk e mbaj mend ç'muaj ishte: ja shkurti, ja marsi i vitit 1920. Erdhi poshtë në Jaliskari një vapor luftarak, i cili nxori në stere babanë! Të gjithë vrapuan poshtë dhe, pas disa orësh, babai, mbi një mushkë, erdhi si i thonë: i vdekur, por i pa kallur. Mezi fliste. Ishte bërë kockë e lëkurë, vuante nga tuberkulozi dhe pas dy javësh vdiq! E varrosi me kujë gjithë fshati, gjithë krahina. Gratë e qanin me ligje, kurse burrat u binin gjokseve. Njëri i ra me grusht xhamit - se arkivolin e kishin mbuluar me xham, pasi ai ishte tuberkuloz - duke vajtuar: *Ngrihu, o Marko, ngrihu, o Andrea. Ngrihuni, se burrat ju kërkojnë për kuvend! Ku na latë, o burra të kësaj toke! Ngrihuni!"* - E mbaj mend atë burrë që ishte nga Martinajt e Gjilekut!

Pas disa muajsh italianët u shporrën. Dëgjohej lufta që bëhej në Llogara. Dy mësuese italiane, që banonin pranë nesh, kërkuan që Mimi, vëllai pas Fotos, t'i shpinte me mushkat e mëdha gjer në Porto Palermo. Kur u kthye Mimi me të dyja mushkat ushtarake trupmëdha, një kushëri yni, edhe ai mësues, i mori mushkat dhe e rrahu Mimin. Atëherë ngjau kjo: Fotoja, që ishte i madh, Jani, një kushëri që ishte i rritur, Llambro Gjoni, Vasil Markoja

dhe Spiro e Kiço Bua, të rritur edhe këta, nxorën nga vendi i fshehtë maliherët dhe zunë pritë në shtigjet nga do të kalonte Thoma Konomi (ai që rrahu Mimin dhe mori mushkat). U mblodh menjëherë fshati, shkoi te Thoma Konomi dhe i mori mushkat e na i ktheu. Ne i shitëm. (Pra, Bua Marko dhe Gjoni u bashkuan menjëherë si një familje e vetme).

Nëna u sëmur rëndë, me peritonit. Vinte mjeku Milo, e shihte, tundte kokën dhe ikte i mërzitur. E kuptuam se nëna do të vdiste. Motra Lilo na mblidhte, na gjunjëzonte nën kandilin dhe ikonat e Shën Mërisë, aty përballë shtratit ku lëngonte nëna, dhe na thoshte të përsëritnim me zë: "O Shën Mëri e çudive, shpëtona nënën!" Këto i thoshim si në kor. Nëna dëgjonte dhe lotët i rridhnin çurg në faqe. Kështu nëna, gjashtë muaj pas vdekjes së tatës, na la. E vajtuam, e vajtoi fshati dhe nuk e varrosëm aty ku ishin varrosur Andrea dhe Markoja (se ishte femër), por rrëzë kambanerisë së madhe. Aty shkonim shpesh dhe qanim mbi varrin e saj, sidomos unë, kur dilja me lopët dhe kaloja nga varrezat e Shën Mërisë.

Pyetje: - Mund të më flasësh pakëz më shumë për mama Millen?

Përgjigje: - Për mama Millen... Ka kohë që mendoj të bëj një roman për fatin e gruas sonë para Çlirimit, sidomos të gruas himarjote, duke e pasur atë si protagoniste, se ka një jetë furtunë, një jetë gjithë brenga, po kurdoherë kolonë, vitore e shtëpisë dhe e rezistencës ndaj dallgëve të ashpra të jetës sonë.

Që më 1914, kur u vra Andrea, dhe gjersa vdiq, ajo nuk doli për vizitë në asnjë familje, as për lindje, as për martesa, as për vdekje. Shkonte çdo të diel në kishë.

Gabim të madh kam bërë që nuk kam mbajtur shënime nga ligjërimet e saj të përditshme. Ajo çdo pasdreke mbyllej në kamarullën e saj dhe vajtonte me radhë të vdekurit. Mbaj mend, kur isha në klasën e tretë, kisha

bërë një vjershë për fshatin. E mori mësuesi im Naqe Konomi dhe ua lexoi shokëve të mi të klasës. Mbaj mend vetëm një strofë:

Dora jonë punëtore,
që lind çdo pasuri,
si një fole qiellore
të bëri, o Dhërmi...

Duke dëgjuar përditë ligjërimet poetike të mama Milles, m'u bë edhe mua shprehi të thurja vargje. Kishte vdekur duke lindur një kushërirë e parë, Lena, me të cilën banonim bashkë në shtëpinë e madhe që kishin ndërtuar prindërit tanë. Mama Millja e vajtonte bukur. Vetëm një strofë mbaj mend:

O Lenë, o bijë e zërë,
që do veç ku vanë të tërë,
thuaju si na ke lënë,
jo si njerëz, po si qënë...

Ashtu mbetëm ne, jetimë. Të gjitha na i rrëmbyen njerëzit tanë, sidomos dajallarët. Liloja ishte shumë dorëlëshuar dhe gratë e fshatit e zhvatnin. Nuk lanë mbulesë e shtresë, nuk lanë servis, nuk lanë gjë prej gjëje. Komoja ku ishin defterët e babait, ishte e hapur, dhe burrat e fshatit tonë vinin e rrëmbenin kambialet, çeqet, çirrnin faqet e librit tregtar që mbante babai, ku çdo faqe kishte edhe një emër, si edhe shumat që u kishte dhënë borxh. I çirrnin, i digjnin. Mbeti shtëpia si kishë. Musëndra u boshatis. Qilari u boshatis. Dhe sënduku i bukur i mama Milles, i blerë në Trieste, me gjithë pajën e saj, me gjëra shumë të vlefshme, u boshatis. Lart në dhomën e madhe të pritjes kishin mbetur vetëm disa frona dhe tryeza e bukur, e cila është edhe sot e kësaj

dite. Kishin mbetur dhe portretet e gjithë monarkëve të Evropës, që mbulonin faqet e mureve. Ende më kujtohen ata monarkë e sidomos Katerina e Rusisë si edhe Elisabeta e Anglisë...

Mama Millja herë rrinte me ne dhe herë-herë, për të na lehtësuar nga ana ekonomike, rrinte me familjen e xhaxhait, që ishte më në gjendje, sepse e shoqja ishte e zonja, kishte bagëti dhe gjashtë vajza e dy djem. Ajo, mama Millja, ngandonjëherë fuste ndonjë copë bukë në prehër dhe vinte te ne fshehurazi për të na e dhënë, se zihej me mama Tullën. Ashtu quhej gruaja e xhaxhait. Mama Tulla kishte disa vëllezër tahmaqarë, që deshën të futnin hundët në pasurinë e saj, po im atë, gjersa jetoi, nuk i lejoi. Ata ziheshin me të. Madje thonë se ata, sidomos i madhi, Mimi, trilloi atë nëndetëse që vinte nën Shën Theodhor, në Spile, që i sillte gjoja tim eti armë e udhëzime. Dhe, për ta vërtetuar këtë, ata sajuan edhe dëshminë e mama Tullës, motrës së tyre, e cila gjoja e kishte parë vetë me sy nëndetësen. Kjo e rëndoi shumë babanë, prandaj, kur erdhi gjysmë i vdekur nga burgjet e Italisë, nuk e pranoi në shtëpi. Edhe kur vdiq ai, mama Tulla nuk e qau, po, siç thonë, thurte tërkuzë me gjineshtër prapa derës. Megjithatë ne e deshëm, po mama Millja gjithnjë grindej me të.

Ngado që veja, edhe kur isha nxënës në Shkollën Tregtare, kur kthehesha, diçka do t'i sillja mama Milles: ndonjë shami të zezë, ndonjë palë çorape të zeza, ndonjë shishe konjak "Metaksa", që ajo e përdorte si ilaç. Dhe, kur erdhi koha që unë do të largohesha nga atdheu, kalova nga fshati. Kur më përcollën, asnjeriu nuk i thashë se isha nisur për në Spanjë. Mama Millja më pyeti:

- E ku do të shkosh, more bir?

- Shumë larg, mama.

Ajo nuk ma lëshonte dorën:

- Mos ndiq rrugën e tët gjyshi, o bir! Megjithatë, ngado që të shkosh, do të kesh me vete uratën time. Por po të

jap dy këshilla. E para: bëhu i ndershëm si yt atë! E dyta: mos ki kurrë besim tek asnjë femër!

Kur u ktheva më 1940, ajo nuk rronte më. Më shumë qava për të, se për çdo gjëmë tjetër që kishte rënë mbi familjen time. Mama Millja, vitorja e shtëpisë, gjyshja shtyllë e shtëpisë nuk ishte më!

Pyetje: - Po për nënën tënde ç'kujton?

Përgjigje: - Për nënën time nuk kujtoj shumë gjëra. Ajo ishte një grua zemërmirë. Ishte e heshtur, e kundërta e vëllezërve të saj. Babai i saj, Jani Kuçuli, kishte tre djem dhe tri vajza. Ai ishte i famshëm si poet. Edhe xhinsi i tij ishin detarë. Ky çalonte. Ishte i shkurtër, po shakatar. Kur Turqia mori burrat e Bregut dhe i internoi në Zallahonë, midis Janinës dhe Prevezës, në një vend të shkretë me baltë dhe moçale, që t'i mundonte gjer në vdekje, i kishte vënë në një punë të rëndë, për të hapur kanale, ku do të kalonin ujërat e mbledhura në moçal. Gjyshi ishte i paktë dhe, kur karvani i burrave, i shoqëruar nga spahinjtë, shkonte nga barakat për në punë, ky mbetej prapa, se ishte i çalë dhe i dobët. Një spahi ngriti kamxhikun për ta goditur:

- Ec, kaur i qenit, se të vrava!

Gjyshi ngriti kokën, i buzëqeshi dhe i tha:

Më avash, o djalë,
se ti je mbi kalë
sa një mal,
unë jam i çalë...

Spahiu buzëqeshi:

- Jemi të një gjaku, a derëbardhë! - i tha dhe e mori në vithet e kalit. Arriti të tjerët dhe u bërtiti:

- Dëgjoni, ju, o bregas! Këtë , - dhe tregoi gjyshin, - do ta merrni me radhë kaç, që nga konakët e deri te kanalet, se do t'ju shqep në hu!

Pastaj nisi komedia. Të gjithë i luteshin: "Aman, o Jani, mos ma hip mua, se jam i këputur! Mezi hedh këmbët!" - dhe gjyshi ia hipte atij që e kishte më shumë inat. Kam dëgjuar se patrioti Hasan Sulo, nga Radhima, ka mbledhur bejtet e gjyshit dhe ia ka dorëzuar Institutit të Folklorit.

Dy motrat e nënës vdiqën. Të tre vëllezërit morën rrugën e mërgimit. I madhi, Foti, ndenji afro dyzet vjet në pellgun e Karaibeve. Mori pjesë në luftën për çlirimin e Kubës nga spanjollët, madje edhe ishte dekoruar dhe dekoratën e ruante me shumë dashuri. Tregonte se si kishte hyrë i pari në një ishull të vogël, ku kishte ngritur flamurin e Kubës. Fliste me shumë dashuri për Hoze Martinin dhe Simon Bolivaresin, dy heronj të Amerikës Latine - Qendrore dhe Jugore. Dhe shumë herë më thoshte: "Kemi nevojë të na dalë ndonjë Simon Bolivares, ose ndonjë Hoze Martin, për të na shpëtuar nga anadollakët, që na morën shpirtin." Ai u kthye plak nga Karaibet.Mbante me vete edhe një libër me kapakë të kuq: ishte libri i Kanalit të Panamasë. Në një nga faqet e atij libri, ku bëhej historiku i çeljes së atij kanali të famshëm dhe ku flitej për kryeinxhinierët, inxhinierët dhe teknikët që morën pjesë në ndërtimin e tij, ishte dhe fotografia dhe biografia e tij. Mburrej dhe tregonte se si ishte ndërtuar ai kanal. Ai punonte me një vapor të vogël, si rimorkio për qindra maune që sillnin materialet. Ai në fshat nuk solli asgjë, por një humor të hidhur, që mbante gjallë burrat e uritur... (Për këtë kam shkruar në romanin: "Një emër në katër rrugë!")

Vëllai i dytë i nënës quhej Simo. Ai ishte tip i qetë. Emigroi në Amerikë, ku mori dhe dy djemtë e tij, Panon dhe Thomanë. Më pas u kthye e vdiq në fshat.

Vëllai i tretë quhej Lekë. Ky ishte shumë i zgjuar dhe aventurier i madh. Fillimisht u mor me tregtinë e

qitrove ebraike, po kurrë nuk solli një metelik në fshat. Hante e pinte borxh. Mbaj mend se, në kohën kur në Tiranë kishte nisur puna për ndërtimin e ministrive që janë edhe sot, aty nga viti 1931-1932, dhe unë vërtitesha rrugëve për punë, pasi kisha mbaruar Shkollën Tregtare në Vlorë; ai kishte hapur pijetoren, "Roma" në Rrugën e Dibrës. Aty pinin raki pak burra, po punën ai e bënte me punëtorët dhe teknikët italianë që ndërtonin ministritë. Ata pinin verë gjithë ditën. Daja verën e bënte ujë e, pasi dinte italisht, i gënjente. Ata zbaviteshin më shumë me qyfyret e tij, sesa me verën-ujë që pinin. Unë i shërbeja duke shkuar ku më dërgonte: në furrë me tavat (furra e Dingut), për të blerë shishqebapë për ata që pinin raki, ose për të marrë ujë në pus me teneqe. Një ditë, kur më dërgoi të blija pesë shishqebapë, u ktheva dhe ua shtrova në tryezë atyre që pinin raki. Kur hapa gazetën që mbështillte shishqebapët e ngrohtë, pashë me çudi: "Shenjtorja e vogël", novelë nga Petro Marko. Shtanga dhe prita sa të mbaronin ata që pinin, që ta merrja gazetën e të lexoja novelën time të parë, të botuar në gazetën "Ora" të Çekrezit. Kur mbaruan pijanecët, gazetën e kishin bërë copa-copa. I kërkova dajës një çerek leku për të blerë gazetën, por ai më bërtiti:

"Mos i lexo gazetat, se gënjejnë!" - Atëherë shkova vetë në zyrat e gazetës "Ora", në Rrugën Mbretërore (sot Rruga e Barrikadave), ku ishte shtypshkronja "Dielli". Kur hyra në një zyrë, nga e djathta, më pyeti një burrë, me syze:

- Ç'dëshironi?

- Ka mundësi të më jepni një gazetë?

Ai më tregoi me dorë:

- Ja, atje shitet!

Më erdhi turp, por i thashë:

- Nuk kam lekë... Po unë jam Petro Marko, që... që më keni botuar novelën "Shenjtorja e vogël".

Ai ndërroi fytyrë, më buzëqeshi dhe më mori për dore. Trokiti në një derë tjetër dhe më futi brenda. Aty ishte një burrë që shkruante në tryezë.

- Kostë! Ky është Petro Marko.

Ai hoqi syzet, më pa i vrenjtur dhe më pyeti:

- Ku e ke marrë ti atë novelë? Nga ç'gjuhë e ke përkthyer?

Mbeta. Pastaj mora guximin:

- E kam shkruar vetë, atje në Ujë të Ftohtë, kur isha student.

- Ulu, more djalë! Ulu, - dhe më vështronte si për të depërtuar në thellësitë e syve të mi.

Më pyeti nga isha, ku isha, ku shkoja. Dhe unë i thashë me pak fjalë jetën time, gjendjen time. Ai tundte kokën.

- Mos u mërzit! Kështu e kemi filluar të gjithë! Por a ke novela të tjera?

- Kam.

- Sa ke?

- Mund të kem nja dhjetë!

- M'i sill mua, - tha. Futi dorën në xhep, nxori kuletën dhe më dha 25 lekë. Ngurrova t'i merrja, se unë e dija që atëherë njerëzit paguanin që t'u botoheshin shkrimet, dhe askush nuk merrte asgjë nga shkrimet.

- Ti, kur të jesh i lirë, eja këtu dhe rri me këtë zotërinë këtu. Shkruaj, se do të bëhesh një gazetar i mirë. Ky është zoti Vasil Xhaçka, kurse i nënshkruari, - dhe qeshi, - jam endacaku, filozofi pa prokopi Kostë Çekrezi.

Për këta dhe për fillimin e punës sime si gazetar do të flas kur të vijë radha. Po, pasi e kishim fjalën për dajë Lekën, vazhdojmë të themi ende diçka për të. Dua të them se ç'fund pati ky. Kur unë isha në Spanjë, ky, bashkë me një grek na paskëshin blerë një vapor të vogël. Udhëtimin e parë e kishin bërë me armë kontrabandë,

që i kishin blerë në Palestinë dhe do t'i shpinin në Spanjën Republikane, që kërkonte armë. I shkruante djalit të tij, Vangjelit: *"Vaporin e blemë me kredi. Udhëtimi i parë na shkoi mbarë: blemë armë në Palestinë dhe ia shitëm vendit ku lufton dhe nipi im, djali i Zoicës. Gjysmën e çmimit të vaporit e nxorëm. Tani do të bëjmë edhe udhëtimin e dytë. Në na shkoftë mbarë, ia lajmë fare borxhin atij që na e shiti vaporin."*

Vangjeli, pas disa muajsh, mori vesh se vapori ishte torpiluar nga luftanijet e Musolinit, që kishin bllokuar bregun e Spanjës...

Pyetje: - Tani dëshiroj të më kallëzosh disa nga mbresat më të pashlyeshme të fëmijërisë sate. A ka mundësi?

Përgjigje: - Nga ç'kanë mbetur në shoshën e viteve, do të mundohem të të rrëfej ato që nuk i harroj kurrë.

DITA E PARË E SHKOLLËS

Vëllai, Mimi, siç dukej, nuk shkonte në shkollë. Mama Millja më tha që të shkoja edhe unë me të, që të sigurohej në vente apo nuk vente në shkollë. Iu drejtua Mimit dhe i tha që të më merrte edhe mua me vete.

Dhe Mimi më mori për dore. Ecnim të dy ashtu dorë për dore. Ai mbante të varur në shpinë çantën me libra dhe me pllakën e rëndë. Më shpuri në një vend, nga dukej gjithë fshati. Më futi brenda në shpellë dhe nisi të më thoshte:

- E sheh atë? - Më tregonte një shkëmb të rrumbullakët.

- E sheh?

- E shoh.

- Ai quhet mësues! Quhet mësues! Thuaje edhe ti tani! Si quhet ai?

- Ai quhet mësues!

- Përsërite mësimin... Si quhet ai?

- Ai quhet mësues.

- Mirë, e mësove mësimin. Tani, i shikon këta që tunden? - Më tregonte me radhë qiparisët që ishin në hyrjen e shpellës.

- I shikoj.

- Këta janë nxënësit. Këta janë nxënësit. Tani thuama edhe ti: Si quhen ata që tunden?

- Ata që tunden, janë, janë...

- Nxënësit! - plotësonte Mimi dhe unë përsëritja:

- Ata që tunden, janë nxënësit... nxënësit... nxënësit...

- Shumë mirë, e mësove mësimin. Tani eja këtu dhe shikomë.

- Ai u ul në shesh dhe me një cipal vizatonte në tokën e njomë një *O* të madhe. E shikon këtë? Kjo është *O O O*. Thuaje edhe ti: kjo është *O*! - dhe unë përsëritja:

- Kjo është *O O O*.

- Shkruaje ti tani këtë *O O O*. - dhe unë nisa të bëja një rreth mbi tokën e njomë duke përsëritur:

- Kjo është një *O O O*.

Ai më la aty duke bërë *O*-në dhe vetë nuk e di ku vajti. Kur pa nxënësit që dolën nga shkolla, erdhi dhe më mori dhe vajtëm në shtëpi.

Mama Millja më pyeti:

- Ishit në shkollë?

- Posi! Ishim.

- Po ç'patë atje?

- Atje pamë mësuesin me një kokë shumë të madhe...

- Ai do të ketë qenë, Kosta, - tha mama Millja. - Pastaj ç'bëtë?

- Pamë dhe nxënësit me radhë që tundnin kokat...

- Mirë, a të keqen, po ju a e tundët kokën?

- Mësova të shkruaja dhe *O O O*.

Gjyshja u bind. Na shtroi për të ngrënë. Me ne hante dhe një druvar me emrin Thanas Zoto. Ai kishte çarë trungjet e ullirit të rrëzuar nga cikloni. Fasule me vaj e limon, ullinj, qepë dhe tepse-misri të ngrohtë: u shqepëm së ngrëni dhe dolëm që të luanim aty te lëmenjtë, që ishin pranë shtëpisë sonë. Luanim stapin dhe kalanë. Ra kambana e shkollës. Ora dy. U kthyem në shtëpi. Mimi mori librat, po Thanas Zotoja ende po hante. Dhe gjyshja i tha:

- Ç'bën kështu, more Thanas, ende po ha?

- Ç'bëre mirë që më kujtove, se kisha harruar që po haja! - tha druvari dhe bëri kryqin e mbarimit të drekës, që vazhdoi më shumë se dy orë.

Dhe unë me Mimin, përsëri te shpella e Pano Gjinit. Ai kishte një llastik për zogj. Më la aty duke shkruar *O O O-të* dhe iku. Kur u zgjova, u llahtarisa. Errësirë. Zura të qaja me të madhe. Markajt e tjerë, që banonin aty pranë, më dëgjuan dhe vrapuan. Më morën dhe më shpunë në shtëpi. Të gjithë ishin mbledhur të shqetësuar. Kush më kishte shpënë atje atë natë? "Djajtë! - tha dikush! - Djajtë!... Shpejtoni dhe thirrni priftërinjtë." Dhe erdhën dy priftërinj në mes të natës. Më kënduan fqelon për të shpëtuar nga shkelja e djajve. Kur më pyeti Fotoja se kush më shpuri atje, unë i thashë:

- Mimi.

- A, Mimi të paska shpënë atje?

- Po, në shkollë, atje ishte shkolla, mësuesi me kokë të madhe, nxënësit që tundnin kokët dhe unë që shkruaja *O O O-të*.

- Mirë, mirë, - tha Fotoja. - Jua ndreq unë samarin. - Dhe, në mëngjes, kur ra kambana e shkollës, Fotoja na lidhi që të dy me një tërkuzë dhe na vuri përpara. Kur hymë në derën e oborrit të shkollës, nxënësit luanin e thërrisnin. Me të na parë ne të dy të lidhur me tërkuzë, u mblodhën duke bërtitur e duke u shkulur së qeshuri.

Na shpuri brenda në drejtori dhe drejtori na foli me të mirë, sidomos mua. Pastaj iu kthye Mimit:

- Si, more, e le vëllanë e vogël vetëm te shpella e Pano Gjinit!

Ja kjo ishte dita e parë e shkollës për mua.

PËRSËRI ME DJAJTË DHE PRIFTËRINJTË

Ne kishim një lopë që e quanin Kuqinë. Ajo na mbante shpirtin. Pillte çdo vit nga një viç të mirë. Ne ushqeheshim me qumështin e saj dhe e deshëm si gjënë më të shtrenjtë që kishim. Ishte e sertë dhe i shponte me brirë lopët dhe mushkat në bark. Kishte shpuar dhe Grivën e mama Tullës dhe ia kishte nxjerrë zorrët përjashta. Ia premë brirët me sharrë, por brirët e prerë i zinin krimba. Ne kërkonim t'ia pastronim. Mua më donte se i hidhja qitro, që i hante shumë. Po një ditë, para se ta nxirrja te lëmenjtë, ku mblidheshin lopët e tjera, desha t'ia hipja si Grivës. Ajo u shkund dhe më vërviti në mur. U vrava shumë, sa edhe sot e kam plagën në vetull. Te lëmenjtë pranë shtëpisë sonë gjithë ata që kishin lopë, i binin aty dhe atij që i vinte radha, dilte me to brinjave për t'i kullotur. Ne një lopë kishim, prandaj vetëm një ditë na binte t'i nxirrnim lopët për t'i kullotur. Atyre që kishin dy, u binin dy ditë me radhë dhe atyre që kishin tri, tri ditë me radhë. Radha ishte caktuar dhe cilido e dinte se kur do t'i nxirrte lopët për kullotë lart në Karava...

Kur erdhi radha jonë, Mimi nuk shkonte më. As Andoni. Atëherë duhej të shkoja unë. Më dhanë torbën me bukë, ullinj, një qepë dhe kungullin e mbushur me ujë. Dhe më thanë:

"Ato dinë vetë se ku venë. Mos i lër të futen në vreshtat e Karavait. Kur të perëndojë dielli, do t'i numërosh dhe do të vish bashkë me to në fshat. Janë shtatëdhjetë e dy."

Lopët e dinin rrugën e tyre. Unë u shkoja prapa. Disa kishin dhe këmborë dhe tingujt e tyre ishin të ndryshëm. Unë shikoja gjithnjë Kuqinën time. Hipëm në Shën Mëri. Prapa mureve të lashta, të ngritura me gurë ciklopikë, aty nën kambaneri, ishte varri i mëmës sime. Unë qava për nënën. "Si rri e vetme! Si fle e vetme! Si nuk ka frikë nga të vdekurit, sidomos nga shejtanët që mblidhen në atë grykë, ku qëmoti kapedan Gjika u bë vëllam me djallin." Quhej trim ai që dilte në atë grykë në mes të natës lakuriq, brenda një trekëndëshi të vizatuar në zall me llambadhe të ndezura në tri këndet e thërriste me zë të lartë: "Ku je, o djall! Eja, se të kam vëlla!" Thonë se kapedan Gjika, që kishte marrë për nuse Marcellanen, zërën kapedane, pasi kishte ndezur të tria llambadhet në tri këndet, pasi ishte zhveshur, kishte thirrur me zë të lartë: "Ku je, o djall! Eja, se të kam vëlla!" Ai thërriste dhe zëri i tij përsëritej nga oshëtima, se vendi ku ai bërtiste, ishte në mes dy bregoreve shkëmb si thikë. Thonë se djalli nuk kishte dalë, se kishte pasur frikë nga kapedan Gjika. Po zëra kapedane, Marcellania, pse vdiq? Thoshin plakat dhe vajzat i këndonin këngë:

"Vdiq Marcellania, që ish kapedania, Marcellane me tri fustane, ishte zëra kapedane", se kapedan Gjika u martua me të...

...Zërat këndonin e kërcenin livadheve e burimeve. I shihnin vetëm ata që ishin trima dhe zemërmirë. Kapedan Gjika ishte trim dhe zemërmirë. I pa që kërcenin në lëmin e papa Trekos, i dëgjonte dhe u vërsul t'i merrte një shenjë së parës që hiqte vallen. Ajo ishte Marcellania. I rrëmbeu shaminë. Po t'u merrje një shenjë zërave, ato nuk zhdukeshin, qëndronin dhe bëheshin njerëzore. Të tjerat u zhdukën, kurse zëra kapedane, Marcellania, u ndal dhe i tha kapedan Gjikës:

- Ç'kërkon prej meje?

- Dua të bëhesh gruaja ime! - i tha kapedani. - Ajo

pranoi me këtë kusht: për tre vjet, tre muaj, tri javë e tri ditë nuk duhet t'i thoshte njeriu se ai ishte martuar me Marcellanen. U martuan. Bënë një fëmijë. Fshatarët habiteshin kur shihnin që tokat e kapedan Gjikës punoheshin prej njerëzve të padukshëm. Marcellania lindi një fëmijë që qante dhe shihej nga të gjithë, kurse ajo vetë ishte e padukshme për të tjerët; veç kapedan Gjika e shihte siç shihte njerëzit e tjerë. Fëmija qante dhe dukej, punët e shtëpisë dhe të arave kryheshin natën: fshatarët dyshuan. E kujt është fëmija? Kush ia bën punët kapedanit? Fshati ziente. Njerëzit e kapedanit e shtrëngonin këtë t'u hapej. Po ky e bënte veshin shurdh. Kishin kaluar tre vjet, tre muaj, tri javë e dy ditë dhe nga presionet e njerëzve kapedan Gjika më në fund u tha se kishte marrë për grua zërën kapedane, Marcellanen. Kur u kthye në shtëpi, fëmija qante. Natën nuk u duk Marcellania. Ditën tjetër ky doli ta kërkonte e, kur shkoi te lëndina e njohur, aty, i habitur dhe i tronditur, pa zërat që varrosnin Marcellanen duke ligjëruar:

Vdiq Marcellania,
që ish kapedania!
Marcellane me tri fustane,
ishe zëra kapedane...

Këtë ligjërim dëgjoja unë nga disa vajza që bënin dru, aty, mbi Shën Mëri, në të tatëpjetën e Karavait. Lopët ngjiteshin duke kërkuar ndonjë gjethe xineje ose sfake, mertoje ose trumbe për të ngrënë. Këmborët binin me tinguj të ndryshëm. Unë hëngra bukën me ullinj e qepë, piva dhe ujin, pastaj kungullin e vogël e vura si shenjë për ta goditur me gurë, gjersa e bëra copë. Lopët ngjiteshin. Këmborët binin. Vajzat që bënin dru, këndonin këngën e Marcellanes. Ç'melodi e trishtuar! Unë mendoja për Marcellanen, për kapedan Gjikën, që ishte trim dhe

nuk trembej nga djalli. Lopët, duke kullotur, arritën te Karavai dhe u shpërndanë në pllajat e Pandelemonit, kurse unë kërkoja ndonjë vend të butë ku të shtrihesha. Ngrihesha dhe shihja qiellin me re. Dielli përtej reve ecte me të shpejtë. Dhe unë mendoja se, pasi dielli ecte kaq shpejt, shpejt do të perëndonte. Ishte tramundana që i bënte retë të fluturonin, kurse dielli vazhdonte rrugën e tij të zakonshme. Mendoja. Shumë gjëra mendon çobani i vogël, i vetmuar, brinjave, me lopët që nuk flasin. "Mësuesi na tha se toka është e rrumbullakët, se rrotullohet rreth vetes dhe ecën." Unë shkova në majë të një shkëmbi dhe lashë një kuti mishi bosh (nga ato të italianëve). Të nesërmen shkova për ta gjetur kutinë e mishit të përmbysur, se toka natën do të rrotullohej dhe kutia do të përmbysej. Për çudinë time, kutia aty ishte dhe unë vrisja mendjen pse nuk ishte përmbysur, pasi natën çatia do të bëhej dysheme dhe dyshemeja çati. Pastaj edhe unë, si gratë, qaja për babanë, për nënën. Lopët ecnin në punën e tyre. Unë harrova dhe eca e eca, gjersa arrita përtej përroit të Stavridhit. Aty, i lodhur, u futa në një gëmushë mareje dhe u shtriva që të flija. Lopët, sipas zakonit të tyre, kur po mbaronte dita, u kthyen në fshat. Kur të mitë panë që unë nuk u ktheva, u alarmuan. U mblodhën burra e gra dhe me fenerë e me të thirrura: "O Petrooo, more, ku je?", u shpërndanë në pllajat e Karavait. Dy qentë e dashur, Kavdheli dhe Bustiana, më kërkonin. (Do të flas më poshtë për këta dy qen të dashur). Unë ndjeva gjuhën e Kavdhelit që më lëpinte dhe lehte me gëzim. U zgjova. Kur hodha sytë nga malet e ashpra dhe nga vendi i tmerrshëm ku isha, zura të qaja. Dëgjoja që larg zëra: "O Petrooo, ku je!". Kavdheli lehte me të madhe, e unë qaja me të madhe. Ata dëgjuan, erdhën dhe më morën kaç. Mbaj mend që në shtëpi, në mes të natës, përsëri erdhën të dy priftërinjtë, që të më bënin fqelo, se, aty ku më gjetën, te përroi i Stavridhit, patjetër djajtë do të na kishin shpënë...

Pyetje: - Ç'do të na thuash për Kuqinën, Kavdhelin dhe Bustianën?

Përgjigje: - Kuqina e dashur! Sa herë më ka lodhur, sa herë më ka bërë të qaja. Ishte radha jonë që t'i nxirrnim lopët, ishte koha që ato duhej të kullotnin në Rovole. Edhe vendi i kullotave ishte sipas stinëve. Në Rovole kishte dhe ujë, deti ishte afër. Kuqina u shkëput dhe kërkonte të futej te vreshtat e Kocanajve. E ndoqa duke e qëlluar me gurë. Ajo zbriti në zallin e detit. Dukej se iu fut zekthi në vesh dhe zuri të vraponte bregut të zallit të bardhë e të gjatë drejt Jaliskarit. Lopa vraponte e vraponte, dhe unë pas saj, se mos futej në bahçet dhe pastaj do të duhej të paguanim gjobë. Ajo arrinte në Jaliskar dhe kthehej përsëri në Rovole e në Alevra dhe unë pas saj, në piskun e vapës, duke qarë. Sa herë e bëri këtë vrapim gjatë bregut, nuk e mbaj mend, se, aq u lodha, sa rashë buzë detit. Ajo kishte shkuar tek tufa e lopëve. Kur u ktheva dhe e pashë atje, iu afrova dhe e putha. Kuqina më lëpinte duart.

Nuk do ta harroj kurrë Kuqinën plakë e të sëmurë. Nuk shihte më. Ishte bërë si e zgjebosur. Ne përpiqeshim ta mbanim mirë. Nuk na shihte më. Përpiqej të dilte nga katoi në oborr e nga oborri te Lëmenjtë, por i merreshin këmbët. Ne qanim për të. Nuk kishte mjek për Kuqinën.

Po flinim, kur dëgjuam kujën e Lilos në katua. Ajo ulëriti sikur të kishte vdekur ndonjë nga ne. Dhe nisi ligjërimin për Kuqinën. Ne u zgjuam dhe vrapuam në katua. Kuqina kishte mbaruar. Me sytë e hapur na shikonte. Ne rreth saj filluam ta përkëdhelnim dhe të qanim me zë. U mblodhëm të gjithë, edhe mama Tulla me fëmijët e saj, dhe mama Millja. Edhe ato qanin, sikur të kishin përpara një kufomë të dashuri. Pa erdhi dhe barba Leka, daja, dhe na bërtiti:

- Për lopën qani?! Ne kujtuam se kishte vdekur ndonjë nga ju! Tani t'i heqim lëkurën e ta shesim!

- Jo! - bërtitëm të gjithë! - Jo! Kurrë, kurrë!

Nuk e lamë. Ne, duke e vendosur në një qilim të fortë, e morëm të gjithë dhe e shpumë tek ullinjtë tanë, aty pranë, te Kolgjoni. I bëmë një varr dhe e kallëm me të qara. E mbuluam dhe ndenjëm shumë kohë mbi varrin e saj duke qarë. Unë veja shpesh te varri i Kuqinës dhe qaja.

BUSTIANA

Bustiana dhe Kavdheli ishin dy zagarë gjahu që na i lanë italianët, kur ikën. Bustiana pillte shumë këlyshë, që ua ndanim tanëve, se i kërkonin. Bustiana na ra neve, kurse Kavdheli i ra familjes së mama Tullës. Por ishim në një oborr dhe të dy qentë rrinin të pandarë. Të mëdhenjtë, kur dilnin për gjah, i merrnin dhe kurrë nuk ktheheshin pa gjë. Bustianën e merrja edhe unë dhe, meqë kisha bërë një pushkë prej kallami, dilja për gjah. Një herë zbuloi një dhelpër, që e ndoqi gjer në folenë e saj. Thirra disa burra, që erdhën dhe e zunë dhelprën.

Një ditë, kur shkoja në Rahi nga Hiellardha, Bustiana ecte përpara meje, mes monopateve të ngushta nën ullinjtë. Ajo zuri të lehte duke shikuar një ulli. Ktheva kokën dhe aty pashë një maçok të egër. I rashë shumë herë me gurë, gjersa ai ra dhe m'u vërsul e mi futi dhëmbët në thundrën e zbathur të këmbës së djathtë. Kur e pa Bustiana gjakun që po më rridhte, iu vërsul, e gllabëroi gjysmën e trupit të tij dhe e përplaste herë andej e herë këndej, gjersa e ngordhi fare. Kur e pa që ngordhi, erdhi më lëpinte këmbën duke qarë bashkë me mua. Maçokut të egër i kishin dalë zorrët nga goja dhe nga prapa. Dergjej.

Bustiana pati një fund tragjik. Shkaktar jam unë, prandaj gjithë jetën e kam kujtuar me trishtim, i penduar. Ja se si ndodhi: Një mëngjes mora kallamin-çifte dhe

dola për gjah me Bustianën. Arritëm në Merto, hipëm në Shëndëlli e zbritëm te një breg i pjerrët, mbi një shpellë, që përdorej si nome në dimër. Atje ku hidhja unë gurin, Bustiana vraponte se mos nxirrte ndonjë lepur. Gurin e hodha mbi shkëmbin e pjerrët dhe Bustiana vrapoi. Shkau dhe u rrëzua kokëposhtë nga shpella, nga njëqind metra lartësi. Ajo ishte me barrë. Kur shkova poshtë dhe e pashë të shtrirë pa shpirt, qava me dhembje. Nxitova që t'u tregoja edhe atyre të shtëpisë për të keqen që na kishte gjetur. U thashë edhe se këlyshët i kishin zënë frymën. Të gjithë u nisëm për te shpella, nën Shëndëlli. Në mes të rrugës, në monopat, tek ullinjtë e Shkurtajve, e gjetëm Bustianën të shtrirë, të ngordhur. Ajo ishte nisur që të vinte e të jepte frymën e fundit në shtëpi. Të gjithë e qamë me lot. I bëmë një varr dhe e varrosëm me ngashërime. Ky qe fundi tragjik i Bustianës.

Pyetje: - Po fundi i Kavdhelit?

Përgjigje: - Fundi i Kavdhelit qe më tragjik. Ai u plak. Nuk shihte më. Mezi ecte. Ishte bërë kockë e lëkurë. I zgjebosur. Qanim kur e shihnim. Ç't'i bënim? Jani vendosi që ta vriste, për ta shpëtuar. E lidhi me tërkuzë në trungun e një ulliri dhe me çifte (me plumb për derra) e qëlloi me lot në sy. Plumbi e mori në tërkuzë, që ia këputi. Ai, duke tundur bishtin, shkoi drejt Janit dhe i lëpiu këpucët. Jani qau, hodhi tutje çiften dhe erdhi në shtëpi sikur të kishte bërë krimin më të rëndë në jetën e tij. Kavdheli e ndoqi pas dhe erdhi përsëri në shtëpi. I bëmë një kafaz me shufra shqope dhe e mbyllëm brenda. Aty i shpinim për të ngrënë. Ai qante me ulërima therëse. Nuk e duronim dot. Erdhi Neçoja, ai që ishte martuar me Amalinë, vajzën më të madhe të mama Tullës. (E kam paraqitur në romanin "Një emër në katër rrugë", vëllai i Gjikë karrieristit.) Neçoja, një burrë i fortë, i zakonit, ndenji për darkë te ne. Ndenji vonë. Ne shkuam për të fjetur. Natën dëgjuam një krismë. Në mëngjes mësuam se Neçoja e kishte qëlluar me revole mu në ballë. Pastaj

e kishte marrë dhe e kishte hedhur në det me një gur të rëndë të varur në qafë me një tel. Ne qamë shumë për Kavdhelin, sikur të na kishte vdekur njeriu më i dashur i familjes...

Pyetje: - Më fal, por dua të të pyes se si ishte situata politike në fshatin tuaj, kur ti ishe i vogël. Patjetër atëherë ti nuk kuptoje gjë, po si e gjykove, kur u rrite dhe kur nise rrugën e gjatë të jetës?

Përgjigje: - Është një pyetje me vend. Do të përpiqem të kujtoj gjithçka që mund të ketë rëndësi politike.

Himara ishte një krahinë që jetoi për shekuj si autonome. Kishte fituar disa privilegje nga Turqia; nuk paguante xhelepe, nuk shkonin nizamë bijtë e saj. Për të thyer monotoninë e rrëfimit, dua të përmend atë që ka të bëjë me këtë çështje e që më ka ndodhur para njëzet vjetësh në Vranisht të Vlorës. Kisha shkuar edhe unë si gazetar për të marrë pjesë në kremtimin e njëzetë të krijimit të Brigadës së Pestë Sulmuese partizane. Pasi mbaroi festa aty në Tërbaç, Hysni Kapoja më tha: "Eja të vemi në Vranisht, se na kanë thirrur për darkë!" Vajtëm te shtëpia e babait të Mersin Jonuzit. Na pritën mirë. Mua, me zor, më vunë në krye të njërës qoshe të vatrës. Në qoshen tjetër ishte Hysniu. Dhoma ishte plot dhe zjarri brambullinte. Fshatarët përqafoheshin me Hysniun. Një plak foli:

- Hysniun e njoh, po atë shokun tjetër nga e kemi?

- Nga Bregu! - u përgjigj Hysniu.

Plaku na drodhi nga një cigare dhe ma hodhi duke thënë:

- Qaj, o Breg, për Turqinë!

Të gjithë u habitën dhe heshtën, se e dinin se ai plak nuk fliste kurrë kuturu. Mendimi i tij ishte shprehje e shpirtit të fshatit dhe të Lumit të Vlorës. Hysniu ndërhyri dhe i tha:

- Jo bregasit, po ne të qajmë për Turqinë!

Plaku qeshi dhe tha:

- Jo, jo! Këta të qajnë për Turqinë, se, sa qe Turqia, këta këmbë mbi këmbë thoshin rroftë sulltani, dhe nuk paguanin as xhelepe dhe as që shkonin nizamë. Ne na rropi sulltani. Na dërgonte të linim kockat në shkretëtirat e Jemenit! Tani, - dhe më shikonte mua në sy, - tani, s'ka më... - Të gjithë njësoj, të gjithë njësoj na bëri Partia.

Të gjithë qeshën.

Pra himarjotët nuk paguanin taksa, nuk shkonin ushtarë. Ishin si autonomë. Kur u shporr Italia nga vendi - dhe dua të shtoj edhe këtë, po me keqardhje: himarjotët nuk morën pjesë siç duhej në Luftën e Njëzetës, përveç disa patriotëve si Nase Beni, që ishte kapedan - unë isha i vogël, por e mbaj mend shumë mirë kur erdhën në bregun e fshatit luftanije greke. Shumë fshatarë u ranë kambanave dhe thirrën: "Zito i Ellas! - Rroftë Greqia!" "Zito i aneksartisia, zito i aftonomia! - Rroftë pavarësia, rroftë autonomia!" Madje u shpall nga paria njëfarë autonomie dhe burrat shkonin e bënin rojë në Llogara. Pas pak ditësh erdhi ushtria shqiptare dhe populli doli në xhade me raki, me petulla, me flamuj. Therën mishra dhe hodhën valle. Po disa arhondë nuk dolën nga shtëpitë. Në krye të ushtrisë ishin Riza Cerova, Azis Çami e të tjerë... Ishte hera e parë që Himara inkuadrohej në pushtetin shqiptar dhe letrat që vinin nga mërgimtarët, nuk vinin me adresën Drimades-Himara- Epir, po Dhërmi-Himarë-Albania...

Shkollat ishin greke. Disa mësues patriotë, si Naqe Konomi, Foto Vitoja, Gaqo Kaporra, Ibrahim Kushta e të tjerë, u mblodhën në shtëpinë e mësuesit tim të parë Pavllo Vretos dhe, me kështillat, udhëzimet e ndihmat që u dha Halim Xheloja, shkolla u bë shqipe. Bënim edhe greqisht, po vetëm shkrim e lexim me tekste greke. Halimi u dha mësuesve librat "Bagëti e bujqësia" të Naimit, që

ishin leximet e para të shqipes në shkollën time. Pasi ra fjala për shkollat, këtu dua të zgjatem ca. Në shekullin XVII, më 1630, në Dhërmi priftërinjtë bazilianë që i kishte dërguar papa në Himarë, hapën të parën shkollë shqipe - seminar për priftërinj në gjuhën shqipe; kjo sipas raporteve që i dërgonin priftërinjtë bazilianë papës, një pjesë e të cilave janë botuar (doemos ato që u interesonin atyre) te Nilo Borgias, i cili përmbledh një pjesë të veprimtarisë së priftërinjve unitë (bazilianë) që ndenjën në Himarë për rreth tre shekuj.

Pyetje: - A mund të na flasësh pakëz më gjatë për këtë çështje, se pak gjëra dihen për misionin e priftërinjve bazilianë?

Përgjigje: - Misionarët bazilianë në Himarë ndenjën tre shekuj. Pas vdekjes së Skënderbeut, Himara - atëherë Himara përfshinte gjithë Labërinë, që nga Radhima, Lekli, Nivica e Bubari - ishte e pavarur. Gjon Kastrioti u thye nga Napoli, që e quajti atë krahinë mbretëri të vetën. Shumë banorë të Veriut, nga terrori i madh turk, shpërnguleshin për në Himarë, të gjenin shpëtim. Po Himara ishte e varfër, vend malor dhe nuk mundi t'i mbante qindra mijëra shqiptarë të Veriut. Atëherë u morën vesh me mbretin e Napolit, i cili tha se mund të venin të banonin në mbretërinë e tij. Filloi eksodi i madh i arbëreshëve: me varka, me anije të sajuara. Shumë u mbytën në Kanalin e Otrantos. Ata që arrinin gjallë, nuk priteshin mirë nga banorët e Kalabrisë. Shqiptarët kishin 25 vjet në luftë, kishin pësuar në fund edhe terrorin e egër turk që kalonte në satër popullatën, prandaj këta arbëreshë që arrinin të gjallë në Kalabri, ishin egërsuar dhe nuk dinin ç'të bënin. Mbetën pa strehë e pa bukë brigjeve të Kalabrisë. Atëherë Kuvendi i Himarës mblodhi nja dhjetë mijë të armatosur dhe i nisi që të merreshin me shpëtimin e popullatës shqiptare që endej pa bukë e pa strehë në brigjet e Kalabrisë. Me të arritur atje këta ushtarë,

shpërngulnin me forcë banorët e atjeshëm dhe vendosnin tanët. Kështu që kapedan Kumi, nga Dhërmiu, që ishte dërguar atje për të sistemuar me çdo kusht arbëreshët, e kreu misionin e tij. Mbreti i Napolit, duke dëgjuar për kapedan Kumin, e thirri në Napoli dhe e mbajti pranë vetes duke e bërë gjeneral, adjutant të tij. Thonë se gjeneral Kumi bëri shumë heroizma, madje shpëtoi edhe mbretin në një betejë. Më vonë, në shekullin XIX, do të shkonte atje edhe një gjeneral tjetër nga Dhërmiu: gjeneral Dhimitër Leka. Ky, pasi u shqua në Luftën e Mesolongjit kundër turqve, më 1820/21, u thirr nga mbreti i Napolit, që t'i shërbente atij. Dhe ky shkoi në Napoli dhe u ngarkua të shfaroste karbunarët e Kalabrisë. Me të shkuar në Kalabri, pa atje se banorët ishin arbëreshë. I njohu dhe, në vend që t'i luftonte, i përkrahu shumë. Poeti i madh De Rada, si mirënjohje për këtë arbëresh, botimin e parë të "Milosaos" ia kushtoi Dhimitër Lekës. Më vonë do të flas dhe për këta arbë-reshë. Po tani le të kthehem te priftërinjtë bazilianë që erdhën te ne.

Papa, për interesat e tij, që të kishte një prapavijë këtej bregut Jon, se kishte frikë nga turqit, dërgoi misionarët bazilianë. Shumica e tyre ishin arbëreshë, të ardhur nga Morea. Mësonin në Loreto, në seminaret e papës dhe bëheshin misionarë të tij. Ishin ortodoksë, po nuk e njihnin patrikun e Stambollit. Dhe papa, që t'i bënte edhe ortodoksët e Himarës unitë, domethënë kristianë ortodoksë, por me papën, dërgoi shumë misionarë të aftë, me shkollë, me përgatitje të mirë politike dhe fetare. Ata qendrën e tyre e vendosën në Dhërmi, ku kishin mitropolinë e tyre për gjithë Shqipërinë, gjer në Strugë e Ohër. Ngritën më parë kishën e Shën Mitrit, që e kishin si katedrale. Filluan nga puna. U lidhën me parinë e të gjitha fshatrave dhe u premtonin ndihma materiale. Prandaj shumë herë Himara, me anën e kuvendeve, i

bënte thirrje papës për armë e për ndihma të tjera. Papa u premtonte. Këta himarjotë, gjer te mbreti i Polonisë i zgjatën lutjet e tyre për ndihma, me shkresa të nënshkruara nga të gjithë fshatrat, që nga Radhima, Lekli, Nivica e Bubari. (Këto dokumente gjenden në arkivat e Vatikanit.) Po, siç e thashë, para se Italia ta pushtonte Shqipërinë më 1939, papa botonte në revistat e tij *"Studi orientali"*, aty nga vitet '30, një pjesë të raporteve të bazilianëve, që ia dërgonin Vatikanit gjatë tre shekujve nga Himara. Një pjesë të këtyre raporteve që u botuan në revistën *"Studi orientali"*, u përmblodh në një vëllim nga Nilo Borgia, me titullin *"I missionari, basiliani in Albania"*.

Në këto raporte gjejmë shumë gjëra interesante: jetën reale të himarjotëve, interesimin e madh të tyre për armë, për kulturë, për ndihma nga Evropa e krishterë. Në Dhërmi u hap një seminar për priftërinj, në gjuhën shqipe. Edhe në fshatra të tjera u hapën kurse të gjuhës shqipe. "Katekizmi"në meshë këndohej shqip. Papa Dhimitri nga Dhërmiu, Gjileku, e përktheu "Katekizmin" në gjuhën shqipe, po, sipas raporteve të bazilianëve, nuk u botua, se ishte botuar ai i Budit. Nilo Katalani botoi dhe një gramatikë shqip-italisht. Ai ishte mitropoliti, ndaj ndërtoi dhe kishën e Shën Thanasit, për ta shpëtuar fshatin nga kolera që kishte rënë në fshatin tjetër, Pangalladhë, ku popullsia u shua fare. Nilo Katalani u varros në kishën e Shën Thanasit.

Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, erdhën përsëri priftërinj unitë në Himarë dhe filluan propagandën e Vatikanit, që banorët e Himarës të bëheshin unitë, domethënë të vareshin nga papa. I paguanin shumë ata që bëheshin unitë, ndaj disa zuzarë u bënë unitë për para. Ata i kishin të gjitha dokumentet, prandaj edhe varrin e Nilo Katalanit në Shën Thanas e hapën dhe morën gjërat me vlerë: veshje të ergjendta dhe kryqin e florinjtë.

Pyetje: - Pasi fole për shkollat shqipe, pa më thuaj pse fshati juaj e humbi gjuhën, pse flet greqisht?

Përgjigje: - Këtë do ta zgjidhin mirë kompetentët: historianët, gjuhëtarët. Unë jam interesuar dhe kam qenë shumë kureshtar. Shumë shokë më kanë pyetur: Po ju, jeni shqiptarë apo jeni grekë? Të jesh i çdo kombësie, nuk është turp, por unë, para disa vjetësh, kur isha në fshat, dhe pasi kampistët (punëtorët që shkonin në kampin e Dhërmiut për të pushuar) më pyetën nëse ishim shqiptarë apo grekë, u përgjigja me siguri: "Ne jemi shqiptarë!" Më pyetën pastaj pse flisnim greqisht. Me sa munda, u thashë arsyet. Të nesërmen provokova një mbledhje të gjerë në fshat. U mbush oborri i shkollës me burra dhe me gra. Mënjanë ishin nxënësit dhe gjithë të rinjtë, se e kishin marrë vesh që unë do të flisja rreth temës: "Jemi shqiptarë apo jemi grekë?"

Bisedën e nisa pak a shumë kështu:

- Duhet ta dimë mirë se ç'jemi, ç'kombësi kemi, se dëgjohen poshtë e lart fjalë se këta janë grekë, këta nuk dinë se ç'janë! Pra, fillojmë: Ti, shoku Pavllo Beja, nga e ke origjinën?...

- Familja jonë, si gjithë Gjileku, jemi krutanë. Erdhëm këtu pas vdekjes së Skënderbeut.

- Po ti, Vangjel Liza, si e di origjinën e familjes sate?

- Ne vijmë nga Tërbaçi. Këtu erdhën tre vëllezër nga Tërbaçi. Dhe nga të tre vëllezërit u shtuan lagjet Lizaj, Çaçëdhimitrët dhe Trekot.

- Po ju, o Kostë, nga vini?

- Ne vijmë nga Velça! Jemi Tavajt, - dhe qeshi. - Ju e keni dëgjuar atë breg-shkëmb atje lart, që quhet Trapeza ose Kont-Tava. Rrjedhim nga Kontët, si ju nga Buajt. Aty tek Trapeza paguanin venecianët, prandaj quhet dhe sot e kësaj dite Kont-Tava ose Trapeza...

Kështu me radhë të gjitha familjet thanë se nga rridhnin. Na doli se vetëm një ishte i huaj: Josif Averbahu, me origjinë çifute, nga Austria. Kjo e tij është një histori

e çuditshme: Një konsull i Austro-Hungarisë, që ishte në Vlorë, dashuroi një fshatare tonën që mblidhte myshnje në Llogara me shoqet e saj. Ky konsull shkonte në Llogara për gjah. E pa këtë vashëz dhe u çmend pas saj. Erdhi në Dhërmi dhe e kërkoi për grua. I thanë të ndërronte fenë. U bë ortodoks dhe banor i fshatit...

Pra, ç'jemi ne? Shqiptarë! Po pse e humbëm gjuhën?

Unë do të them ato që di: Pse nënat plaka, gjyshet dhe gjyshët dinë më mirë shqipen se greqishten? Pse qajmë dhe këndojmë shqip? Pse fjalët e urta i themi shqip? Siç duket, që nga viti 1820 e tëhu, greqizimi u bë me qëllim politik nga vetë Greqia, që fitoi lirinë me gjakun e shqiptarëve, qoftë në Mesolongji, qoftë në revolucionin grek. Suli dhe Himara ishin shqiptare, po dy krahina autonome që nuk njihnin as Greqinë e as Shqipërinë, së cilës i kishte humbur edhe emri. Suli dhe Himara ishin kurdoherë në luftë me turkun. Erdhi koha që Himara u nda: Himara bregdetare mbeti e lirë dhe e krishterë, kurse Himara e brendshme, Labëria, Kurveleshi, Lumi i Vlorës e Dukati u myslimanizuan dhe u ndanë. Megjithëse u ndanë në dy fe, nuk e humbën kurrë lidhjen e gjakut dhe të fisit. Çdo fshatar kishte të tijtë në një fshat të myslimanizuar që në kohën e Ali pashë Tepelenës. Kur bëheshin operacione ndëshkimore nga turqit, bregasit nuk shkonin më përtej maleve, në Mesaplik e në Kurvelesh, për t'u mbrojtur, siç bënin gjer në atë kohë, por iknin me varka për në Korfuz ose për në Gjirit, nën mbrojtjen e venecianëve. Aty shkonin pleq e plaka dhe fëmijë. Burrat luftonin. Aty rrinin shumë vjet, gjersa mbaronin operacionet ndëshkimore. Thonë se banorët e Dhërmiut shkonin në ishullin grek, kurse ata të Himarës në Gjirit. Prandaj dhe, kur flasin greqisht, dhërmijasit flasin si korfjatët, kurse himarjotët, si gjiritlinjtë.

Pastaj shkollat ishin greke. Mesha këndohej greqisht. Tregtinë e bënin me Korfuzin, Janinën. Pak nga pak u

shkëputën lidhjet me Labërinë, me Dukatin. Greqia, që u çlirua e para, thoshte se kudo ku janë ortodoksë janë grekë; myslimanët janë turq. Nisi antagonizmi turq e kaurë! Propaganda bënte punën e saj. Kjo u thellua në kohën e Ali pashë Tepelenës, i cili dërgoi një delegacion në Himarë, që dhe Himara të myslimanizohej. Paria e Himarës delegacionin e priti në Qeparo, se kishte më shumë kapedanë.

Delegatët e Ali pashë Tepelenës e thanë mendimin dhe qëllimin e vizitës. Më plaku i kuvendit himarjot u tha delegatëve:

- E falënderojmë pashanë, që mendon për të mirën tonë. Po i thoni pashait se këtu poshtë, në fshat, kemi një fushë që s'ka ujë. Thahet në verë dhe nuk na jep asgjë. I jemi lutur Krishtit dhe Shën Mërisë, Shën Kozmait dhe Shën Spiridhonit, po s'na dhanë ujë. Në na dhëntë Muhameti ujë, menjëherë bëhemi myslimanë. Kështu i thoni pashait.

Kur vajtën e ia thanë pashait përgjigjen e bregasve, ai qeshi me zemërim dhe tha:

- Eh, kaurët e dreqit, do të ma paguajnë! - Pastaj, duke qeshur: - Pizevengët, janë të zgjuar, s'ke ç'thua, janë rrufjanë të mëdhenj!

Pak nga pak propaganda greke bëhej më e madhe, duke pretenduar se Himara ishte krahina më heroike e Greqisë. Shumë kapedanë, sidomos paria, kishin privilegje. Dhe paratë e mirëbërësve himarjotë, që i kishin lënë në bankën greke për shkollat e Himarës, ishin një shkak shumë serioz për propagandën greke. Gjikë Bixhili nga Dhërmiu kishte fituar shumë para në Rusi, ku e kishte marrë Pano Bixhili, përfaqësues i himarjotëve pranë Carit, në Peterburg. Mësuesit dhe shpenzimet për shkollën merreshin nga fondi i Gjikë Bixhilit. Gjikë Bixhili ndërtoi dhe një shkollë, që është edhe sot e kësaj dite. Ne, kur ishim të vegjël, në shkollën e fshatit shihnim

portretin e tij, të varur në klasë. Siç i la Gjikë Bixhili paratë në bankën greke, ashtu i lanë dhe shumë mirëbërës të tjerë nga Jugu, si Zhapa me shokë. Ishin miliona, të cilat u bënë burim për të ushqyer propagandën greke në vendin tonë, sa u krijua miti i Vorio Epirit dhe sillogu vorioepirot, që merrej "me çlirimin" e Vorio Epirit, domethënë të Shqipërisë së Jugut. Paratë u vunë në dispozicion të parisë, e cila merrte një mijë dhe shpenzonte për shkolla një... Paria merrte pará nga banka greke, e cila qe e autorizuar nga qeveritë reaksionare nacionaliste të Megali Idhesë (Megali Idheja: që Greqia të bëhej e madhe duke përfshirë në kufijtë e saj jugun e Shqipërisë dhe vende të Ballkanit ku janë ortodoksë).

Himarjotët që emigronin në Greqi, kishin privilegje: përkraheshin si bij të një "krahine heroike greke" me histori trimërie dhe burrërie. Fatkeqësia ishte se Shqipëria u çlirua e fundit në Ballkan. Himara kishte ushqyer shpirtin e aneksartisë, autonomisë, si Suli, i cili pak nga pak u greqizua. Dhe, pasi u çlirua Shqipëria, me kufijt të cunguar shumë, propaganda greke e ushqeu shumë idenë e autonomisë së Himarës: as shqiptare, as greke! Kishte hedhur rrënjë të thella kjo propagandë në shpirtin e himarjotëve, të cilët sytë i mbanin nga Greqia. Krerë himarjotë, si Spiro Miloja, një luftëtar që e ndihmoi shumë Greqinë, ishte në krye të kësaj propagande, me gjithë farefisin dhe sojin e tij të përndarë në Dhërmi, Vuno e gjetkë. Spiro Miloja ishte nga Progonati. Në fshatin tonë ai kishte farefis Llukë Zh. e të tjerë, që propagandonin ndarjen e Himarës nga Shqipëria. Si bazë kryesore të propagandës përdornin dhe këtë: Pse labëria u bë turke? E pse të mos bëhemi edhe ne me Greqinë, që është armike e betuar e Turqisë, siç jemi edhe ne armiq të betuar të turkut?

Shumë fanatikë ishin fshatarët e mi! Njëzet e gjashtë kisha kishte. Mbaj mend unë se kishim tetë priftërinj.

Lidhjet ekonomike, privilegjet në Greqi, interesimi i Greqisë për himarjotët, sillogu vorioepirot ndikuan shumë për t'i bërë himarjotët t'i kthenin sytë nga Greqia dhe të ëndërronin për një autonomi. Pastaj, edhe në kohën e pavarësisë himarjotët panë se asnjë qeveri e Tiranës nuk u kujdesua asnjëherë për ta. Nuk shkonin as xhandarë dhe nuk merreshin në asnjë punë. Ata pëlqyen të mërgonin: herën e parë në Llavrion, ku kishte miniera; në Korint, për të hapur kanalin; në Vllahi, në Rusi, pastaj në Amerikë, në Francë, në Meksikë, në Argjentinë, në Australi, Kanada e gjetkë. Kështu që ne dinim më mirë se ku binte Buenos Ajresi sesa Kukësi, që nuk ia kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim se ku binte Australia dhe jo Kosova, që nuk ia kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim ku binte Athina dhe Korfuzi ose Tirana e Shkodra. Ishim pa asnjë lidhje me atdheun tonë. Disa përçarës, vetë regjimi i Zogut, sidomos Musa Juka, na përçau. U ndamë në fshat në dy parti: pendëkuqtë, që deshën Shqipërinë dhe shkollat shqipe; dhe pendë-bardhët, që deshën Greqinë e shkollat greke në fshat. Këtë përçarje e ushqeu shumë Musa Juka, duke na armiqësuar vëlla me vëlla. Familja jonë bënte pjesë në partinë e pendëkuqve dhe mbanim në ballkon kurdoherë flamurin e Shqipërisë. Kapedanët e Spiro Milos na kishin ardhur disa herë në shtëpi, duke na thënë se Andrea Markoja ishte vrarë për Greqinë, Marko Jani ishte inter-nuar nga italianët për Greqinë e të tjera. Deshën që ne të linim shtëpinë e të shkonim në Korfuz, ku do të na mbante me shkolla e me pensione Athina. Qoftë im vëlla, Fotoja, qoftë kushëriri im, Jani, i sikterisnin duke u thënë: "Andrea Markoja u vra për Himarën dhe Marko Jani vdiq i veremosur nga internimet dhe vuajtjet e shumta për Himarën dhe jo për Greqinë. Himara sot është dhe mbetet shqiptare. Prandaj mbajmë dhe flamurin ditë e natë të ngritur në ballkon. Ne e dimë gjakun tonë se nga buron."

Pyetje: - Ç'mban mend për vitet e para të shkollës në fshat?

Përgjigje: - E thashë më parë që dita e parë e shkollës sime ka qenë një ditë e çuditshme, e jashtëzakonshme: shkova në shkollë i lidhur me tërkuzë. Kur u ula në bankën e parë, me Vangjel Neçon, me të cilin më vonë u bëmë dhe vëllezër, më bëhej ujët e vogël dhe nuk dija se mund të merrja leje, prandaj e lëshova aty. Vangjeli e pa dhe qeshi me të madhe. Mësuesi, Pavllo Vreto, që mbante në dorë një purtekë, erdhi dhe më goditi në pëllëmbët e hapura. Ulërita, se më dhembën shumë. "Frikacak! Nuk mjafton që të prunë të lidhur, po edhe shurrën na e lëshove sapo u ule!" Më nxori jashtë dhe më dërgoi në shtëpi të ndërroja pantallonat. Ika duke qarë. Mama Milles i thashë se ç'më kishte ngjarë. Ajo më hoqi pantallonat e vjetra prej ndrilloje, shkoi i lau dhe i vari në tel të thaheshin. Unë u shtriva pranë vatrës. Mama Millja më mbuloi pa zë. E dëgjova që fliste me vete. Qava shumë, gjersa më zuri gjumi. Në drekë Mimi dhe Andoni erdhën nga shkolla, më zgjuan dhe më shanë shumë. U ula edhe unë për të ngrënë. Mama Millja kishte bërë një kulaç me krundet që kishte fshirë në hambar. Ishin krunde të përziera me majat e fshesës prej xineje. Andoni, kur e mori kulaçin e ngrohtë për ta çarë më dysh, e pa që nuk hahej dot, se ishte bërë si betonarme. E vërtiti tutje në dysheme, duke bërtitur: "A hahet ky gur?..." Mama Millja, me duart në gji, iu përgjigj: "Mos e hidh, se do ta hash si frëngu pulën!" Andoni dhe Mimi u ngritën dhe ikën. Ata, kur nuk gjenin gjë në shtëpi për të ngrënë, shkonin tek ndonjë fis yni: ja te mama Tulla, ja te Malia e xha Fotit, ja te Markajt e tjerë. Unë nuk e kam bërë kurrë këtë marifet. Po të gjeja për të ngrënë, haja; kur nuk gjeja gjë, qaja dhe bija për të fjetur.

Në shkollë nuk mungoja kurrë. Mësoja mirë dhe merrja nota të mira. Mësuesit më donin. U vinte keq për

mua. Jetim. Nga figurat më të dashura për mua mbetet mësuesi Naqe Konomi, nga Vunoi. Ishte drejtor i shkollës dhe ai na bënte mësim shtetëror. Ishte i dashur edhe për fshatarët. Nga ai dëgjova për herë të parë emrin e Leninit. Në një mësim na foli për profetët e gjallë: "Sot janë bërë profetë: Lenini dhe Gandi. Lenini mendon që edhe ju të keni këpucë e bukë e gëzim, kurse Gandi profetizon çlirimin e Indisë së madhe nga sunduesit kolonizatorë anglezë." Ne ishim të gjithë të zbathur, dhe ishte janar i 1924-ës. Pamë këmbët tona të zbathura dhe u gëzuam që qenkësh një njeri që do të na blinte këpucë. Dhe ai njeri quhej Lenin. Pastaj Naqe Konomi tha: "Mjerisht ai njeri që mendon edhe për ju, Lenini, vdiq!" Ne shikuam me trishtim njëri-tjetrin, se e humbëm shpresën për këpucët. Por ai vazhdoi: "Ai vdiq, po idetë e tij do të triumfojnë edhe këtu dhe ju do të bëheni me këpucë e me të gjitha të mirat!"

Naqe Konomi u interesua shumë për mua. Në Ujë të Ftohtë ishte hapur Shkolla Tregtare dhe kërkoheshin nxënës nga të gjitha fshatrat. Megjithëse isha në klasën e katërt, ai i përgatiti vetë dokumentet dhe më dërgoi në shkollë. Bashkë me mua ishte dhe Nonda Strakosha, që e kisha në klasë, si dhe Vangjel Marko, kushëriri im i parë. Nga mësuesi e kam rrugën që mora. Do të kisha mbaruar si vërsnikët e mi, në fshat, duke më rënë bretku, ose në mërgim. Do të flas më poshtë për Naqe Konomin, kur unë më 1932 u emërova mësues në Dhërmi nga Hilë Mosi.

Në janarin e vitit 1924 isha në Ujë të Ftohtë.

Pyetje: - Ç'do të thuash për jetën tënde në Shkollën Tregtare të Vlorës?

Përgjigje: - Është një kapitull me shumë rëndësi në jetën time. Mendoj se më 1924 m'u hap pakëz perdja për rrugët që do të ndiqja. Mendoj gjithashtu se viti 1924 është një vit historik për Shqipërinë dhe për jetën time.

Njëzetvjetëshi, 1924-1944, përcaktoi dhe konsolidoi karakterin tim, moralin tim, ndërgjegjen time. Dëshiroj të shprehem kështu për këtë njëzetvjetësh shumë të rëndësishëm për atdheun, për shqiptarët dhe për mua:

Pas dështimit të qeverisë demokratiko-borgjeze të Fan Nolit (për epokën e shkurtër 1920-1924 do të them ç'kam parë e ç'kam dëgjuar në fshat dhe në Vlorë), dhe deri në triumfin e Luftës Antifashiste të popullit, kanë ngjarë aq turbullira, shtypje, kthesa, peripeci në Shqipëri, sa përcaktojnë mirë karakterin e cilitdo që mendonte për popullin e për lirinë e Shqipërisë. Këta njëzet vjet e ndanë shapin nga sheqeri. U duk haptazi se cili ishte patriot, cili dallkauk, cili revolucionar, cili tradhtar, cili servil, cili antishqiptar, cili me karakter e cili palaço.Janë disa që gjer më 1924 e quanin veten patriotë e revolucionarë, por gjatë njëzet vjetëve, 1924-1944, treguan fytyrën e tyre të vërtetë. Dhe, pas triumfit të revolucionit, këta myteberë e derbederë kërkuan t'i harronin këta njëzet vjet, kur disa u bënë agjentë e servilë të Zogut, disa pritën me lule pushtimin italian të prillit 1939 dhe bashkëpunuan me pushtuesit, dhe përmendin vetëm vitet para 1924-ës, kur kishin qenë "patriotë" dhe "shqiptarë të mirë." Ka shumë nga ata që veprimtarinë në këtë periudhë kaq vitale mundohen ta mbulojnë fare dhe të mos e përmendin në biografinë e tyre. Ata vënë maskën e thonë: "Kam qenë në "Bashkimi" me Avni Rustemin", "Kam marrë pjesë në Kongresin e Lushnjës", "Kam qenë me Ismail Qemalin, me Bajram Currin, me Luigj Gurakuqin, me Halim Xhelon..." Po pastaj? Pastaj u bëre me Zogun, pastaj me Duçen, pastaj me Hitlerin... dhe pastaj u hodhe në prehrin tonë! Dhe pretendon privilegje patriotike!

Kur vajtëm ne në Shkollën Tregtare, ishim djem të varfër, nga Himara, nga Dukati, nga Mesapliku, nga Kudhësi dhe nga Kurveleshi. Atë shkollë, në kohën e Nolit,

patriotë si Halim Xheloja, Murat Tërbaçi e të tjerë deshën ta hapnin për jetimët e Luftës së Vlorës. Dhe kishin menduar ta hapnin në Borsh. Mirëpo nuk arritën, se qeveria e Nolit iku. Patriotët dhe arsimdashësit e Vlorës ngulën këmbë që shkolla të hapej me shpenzimet e bashkisë. Dhe me shumë luftë e hapën. Ne, kur vajtëm në Ujë të Ftohtë, në mjediset e konviktit dhe të klasave (në kohën e pushtimit italian ato ndërtesa përdoreshin për spitale të ushtrisë italiane) filluam nga pastrimi, se aty kishin ndenjur bashibozukët e Ahmet Zogut, me Taf Kazinë në krye, që kishin ardhur në Jug për të terrorizuar popullin me hu e me plaçkitje.

Përtej këtyre ndërtesave, në drejtim të Kalasë, ishin dy vila të mëdha dhe të bukura: Vila e Qazim Koculit dhe vila e Qazim Kokoshit. Mësuam se fill pas fitores së madhe të epopesë së njëzetës, "krerët" e Luftës së Vlorës ndanë në mes tyre vilat që lanë italianët, dhe luftëtarët, pasi mbaruan punë, u nisën për në vatrat e tyre të varfra. U dhanë nga një qylaf të bardhë dhe nga një okë rrush...! (Ironi therëse historike!)

Drejtor i shkollës ishte Loni Naçi. Mësues kishim Jusuf Pukën, Kel Vilën dhe italianin, agjentin e vjetër të italisë në Vlorë, Saporetin. Na veshën me uniformë. Hanim e pinim mirë. Flinim në shtretër të butë. Dhe mësonim mirë. Çdo mëngjes, para se të shkonim në mensë për të ngrënë, rreshtoheshim para shtizës së flamurit dhe njëri nga ne qëndronte nën të dhe fillonte:

Sa jemi shqiptarë,
kemi gjithë një farë,
s'kemi kurrë të ndarë...

Kjo ishte lutja e mëngjesit. Këto i përsëritnim me zë të lartë, dhe, pasi ngrihej flamuri, shkonim në mensë për të ngrënë mëngjesin. Të gjithë ishim shokë e vëllezër, sikur të na kishte lindur një nënë. Në klasën e parë ishin

pak, midis të cilëve dhe Shevqet Musaraj. Në klasën time shokë kisha Ymer Alikon, Mehmet Shehun, Bari Balën, Sulejman Kalajn, Nonda Strakoshën, Laze Ajazin, Qazim Sherifin, Qazim Çakërrin, Mersin Fiqiriun, Xhevat Fishtën, Reshat Aganë, Bajramin, Isuf Glinën, Pandeli Panganikun. U vëllazëruam shumë. Ishim të virgjër nga çdo ligësi. Nuk dinim të gënjenim dhe ta kishim smirë njëri-tjetrin. Vinim nga fshatra të varfra, nga familje të varfra. Dhe ramë në një jetë "përrallore". Hanim shumë mirë: në mëngjes - qumësht, djathë dhe marmelatë; në drekë - mish, ëmbëlsira e pemë; në darkë - supë, makarona, pilaf dhe mish. Teshat i mbanim të pastra. Dhomat e fjetjes ishin me shtretër me susta, shtresa e mbulesa të ngrohta dhe të buta. Për çdo konviktor shpenzoheshin dy napolona flori në muaj. Për atë kohë, me dy napolona rronte me bollëk një familje e tërë.

Mësuam këngët patriotike të asaj kohe: "Jam vlonjat, o jam vlonjat", "Për mëmëdhenë", "Eja, mblidhuni këtu", "Ç'merr prej kreshte t'Veleçikut", "Bini, toskë, e bini, gegë", "Porsi fleta ëngjelli i Zotit", "Edhe flamuri kuq e zi/ do të valojë përsëri/ në Kosovë e Çamëri", "M'kambë, ju nipat e Gjergj Kastriotit", "Edhe hana do ta dijë, edhe dielli do t'ketë pa/ se përqark kësaj rrokullie/ si Shqipnia vend nuk ka!", "Që më një të kollozhegut u formua shoqëria, u formua brenda mu në Sofje, për skoli të Shqipërisë", si edhe këngë labe, këngë patriotike, këngë të Luftës së Vlorës.

Jusuf Puka, mësuesi patriot kosovar, disa herë na këndonte vetë një këngë melankolike:

Që në kohë të djelmënisë,
porsa i mbusha njëzet vjet,
qe premtue prej Perëndisë
me marrë rrugët e m'u tret!

Drejtori Loni Naçi, ishte i mirë, po neve na dukej si afarist, si një njeri që atë detyrë e kishte pranuar për të marrë një rrogë të mirë. Me ne sillej korrekt dhe na këshillonte që të bëheshim patriotë të mirë. Saporeti na mësonte italisht dhe frëngjisht. Kishte një metodë të mirë. Sajonte vargje dhe na detyronte t'i mësonim përmendsh. Për shembull: *"La laine de la brebis est tres utile! - Le soleil est l'oeil du monde"*.[1] Saporeti ishte plak, por pedagog i mirë. Kishte ardhur në Vlorë në fillim të shekullit, si mësues për fëmijët e italianëve që punonin në SIMSA (serat e Selenicës), për fëmijët e personelit të madh të konsullatës italiane në Vlorë dhe për fëmijët e agallarëve të Vlorës. Siç mësuam më vonë, ai ishte agjent i vjetër i Italisë në Vlorë.

Pas Loni Naçit, drejtor na erdhi Kolë Kamsi nga Shkodra. Ishte i heshtur, por punëtor i madh. Ai na bënte gjuhësi, gramatikë, lexim, hartim. E them me plot gojën se na e mësoi shqipen mirë: gramatikën, poetët tanë, historinë e shkrimit të shqipes dhe kulturën tonë. Ishte kërkues dhe gëzonte respekt për punën e mirë që bënte me ne. Fliste pak; shikonte shumë, kujdesej shumë për çdo problem tonin. Në kohën e tij profesorët i kishim italianë. Vetëm katër orë në javë kishim shqip, mësimet e tjera i bënim italisht. Tekstet vinin nga Italia. Profesorët italianë ishin të zotë, të zgjedhur, punëtorë e seriozë; kurrë nuk na zunë në gojë as Musolinin, as fashizmin. Ata na ndihmuan shumë, por edhe ne mësonim, sa ata habiteshin me përgatitjen tonë këmbëngulëse që bënim për të marrë kurdoherë nota të mira. Midis profesorëve italianë që mbaj mend, ishin: profesor Çezare Kuki, Pentasulia, Lorencoja, Antoniani etj. Për Pentasulian do të flas më poshtë, se ai na dha të lexonim për herë të parë "Manifestin komunist". Edhe për Kukin do të flas, se njoha vajzën e tij Ana Maria.

---

1) Leshi i deles është shumë i dobishëm. - Dielli është syri i botës.

Kolë Kamsin nuk e harroj edhe për këtë episod: Isha në mësim. Erdhi shërbyesi dhe më tha se më kërkonte drejtori. Shkova në drejtori, nderova ashtu siç nderonim atëherë, me dorë në zemër, allazogistshe, dhe nuk vura re se nga e djathta ishte ulur një burrë. Drejtori më tha: "Petro, është vëllai yt, Fotoja." Ktheva kokën nga ai. Fotoja ishte veshur me pallto të zezë dhe në kokë mbante një republikë të zezë. Dukej si i huaj. U trondita. Ai u ngrit dhe më dha dorën. Desha ta puthja, po Fotoja mënjanoi kryet e më tha: "Nuk duhet të të puth, se..." U ngrit dhe, pasi u përshëndet me drejtorin, dolëm nga drejtoria. Te shkallët dëgjova Kolë Kamsin të më thërriste. U ktheva dhe ai zgjati dorën e më dha disa lekë (nuk e mbaj mend sa), duke më thënë: "Paguaje ti karrocën." Në oborr priste karroca. Hipëm dhe u nisëm për në Vlorë. Gjatë rrugës Fotoja foli pak. Ishte i verdhë. Zërin e kishte të ngjirur. Më tha: "Ne mbaruam... në minierat e Francës. Mimi punon si bojaxhi në Greqi. Vetëm ti pate fatin që erdhe këtu, në shkollë, të bëhesh njeri, të jetosh mirë, se ne mbaruam, ashtu qe shkruar. Unë tani jam keq dhe më duhet të dal në Llogara për ajër të pastër. Jam keq..." Unë lotoja në heshtje. (Më poshtë do të flas për fatin e vëllezërve të mi.)

Pas Kolë Kamsit, drejtor na erdhi Zihni Hamzaraj nga Vlora. Ai na mësonte frëngjisht. Mua më donte dhe më thoshte: *"Bouche d'or et bouche d'argent!*[1]" Thoshin se ai kishte propozuar që në shkollën tonë të vinin edhe nxënëse italiane nga Italia, të mësonin me ne si konviktore, të njiheshim me to dhe të martoheshim me to. Thoshin. Sa është e vërtetë, nuk dihet. Thonë se vlonjatët, kur e dëgjuan këtë mendim të Hamzarajit, u alarmuan dhe nuk e pranuan kurrë një gjë të tillë. Thonë se zëri i protestës së tyre arriti gjer në Tiranë, kështu që nuk na

1) Gojartë e gojargjend.

erdhën vajzat italiane. Shumica e shokëve tanë, sidomos Qazim Çakërri, Qazim Sherifi, Apostol Malo e të tjerë u dëshpëruan shumë, se prisnin vajzat nga Italia të eglendiseshin...

Mësuesi i historisë ka qenë Safet Butka nga Erseka. E deshëm, se ishte i biri i Sali Butkës. Ai kishte mësuar në Vjenë dhe na vinte në klasë me libra të trashë, enciklopedi e të tjera. Ishte i shkurtër, nuk para shoqërohej me profesorët italianë, madje i përbuzte ata. Gjeografi na bënte Llazaraq Eftimiadhi nga Vlora, një burrë i urtë si fëmijë, i përkëdhelur, se ishte djalë i vetëm, mes shumë motrave të mira. I shkonim në shtëpi për pashkë dhe e ëma na priste mirë. Ai shkruante dhe novela dhe i shtypte në shtypshkronjën "Vlora", pronë e një italiani, që ishte në Skelë të Vlorës. Kur i lexonim novelat e tij romantike dhe pesimiste, shkuleshim së qeshuri. Në klasat e ulëta bënte mësim dhe Llukë Karafili. Ai krijonte fjalë të reja shqipe, po qesharake, si bie fjala: "Sot erdha me vetëtundësen, po avullrrumbullaku ishte i ftohtë". *(Vetëtundësja - automobili; avullrumbullaku - atmosfera).* Kishte bërë dhe një libër "Tempulli i Dodonës" dhe ne talleshim me të. Rebi Alikaj, që ishte nga Kuçi dhe merrej me mbledhjen e folklorit, në një hartim që Llukë Karafili u kërkoi të bënin me temë "Shkruani se cili libër ju ka pëlqyer më shumë" (bënte aluzion për librin e tij "Tempulli i Dodonës", shkroi një hartim që mbeti i famshëm: "Letër gjyshit në *Terra del fuoco* - Argjentinë". I shkruante gjyshit të vdekur dhe i thoshte se kishte dalë një libër i famshëm të cilin të gjithë ata që ishin në *Terra del fuoco* (bota e të vdekurve) duhej ta lexonin, pasi për ata ishte.

Me profesorët italianë kurrë nuk u tallëm.

Matura e parë mbaroi me pesë vjet shkollë, kurse, kur klasa jonë, që vinte pas saj e që e mbaroi po me pesë vjet, ishte në maturë, shkolla u quajt Instituti Tregtar.

Në vitin e fundit na erdhi si drejtor Xheladin Nushi, nga Gjakova, zogist. Kishte mbaruar në Vjenë. Ishte mendjemadh dhe arrogant. Na jepte matematikë. Erdhi profesor i shqipes Ernest Koliqi. Ai sillej mirë me ne dhe na rrëmbeu zemrat me mënyrën si e organizonte mësimin. Shumë herë bënte aludime për Avni Rustemin, për Ismail Qemalin. Shumë herë na shpinte te varri i Ismail Qemalit në Kaninë, na thoshte të gjunjëzoheshim para atij varri të braktisur, të rrethuar me tela me gjemba dhe plot hithra e shpendra. Pasi gjunjëzoheshim, ai mbante ligjërata të zjarrta për Plakun e Madh, që ngriti flamurin në Vlorën kreshnike dhe tash dergjej i harruar, i lënë midis telave me gjemba, sikur ta kishte dënuar historia. Ironi! Ironi historike! Dhe kthehej nga ne e na thoshte: "Po ju do ta lulëzoni këtë varr dhe do t'i ngrini monumentin më të madh në këtë tokë arbnore." Ishte koha kur Ernest Koliqi ende nanurisej nga valët e patriotizmit. Adhuronte Karduçin dhe D'Anuncion. Dihet se, më vonë, aty nga vitet 1935-1936 përktheu shqip "Poetët e mëdhenj të Italisë". Ishte i penës, po retorik. Unë hartimet i bëja në vargje. Kur bëmë hartimin e maturës, na la të lirë të zgjidhnim një temë patriotike. Unë bëra një hartim me këtë titull: "Agimi i lirisë" dhe në parantezë (Fyelli i shejtanit). Përmbajtja ishte kjo: Shqipëria, e braktisur, e rreckosur, e rrezikuar nga shtazët, mes një pylli, i binte kambanës duke kërkuar ndihmë nga bijtë e saj. Po një shejtan, me një fyell të madh, ishte jashtë pyllit dhe, duke i rënë fyellit natë e ditë, bënte që të humbiste zëri dhe thirrja e Shqipërisë, që kërkonte ndihmë nga bijtë e saj. Prandaj, që të dëgjohej mirë zëri i mëmëdheut dhe të dinim se ku ishte ajo, duhej më parë të thyenim fyellin e shejtanit. E kisha shkruar në vargje gjashtëmbëdhjetërrokëshe. Ai këtë hartim e lexoi në klasë. Pastaj më thirri në dhomën e tij dhe më pyeti se nga e kisha marrë këtë motiv. I thashë se nuk e kisha

marrë nga asnjë shkrimtar, por ishte pjellë e fantazisë sime. Ai më përgëzoi dhe hartimin e mbajti si kujtim. Në vitin 1932, kur kishim mbaruar shkollën dhe endeshim për punë, ai ishte larguar nga Vlora dhe në revistën "Leka" kishte botuar një vjershë: "Uji i Ftohtë - miqve të mi vlonjatë". Unë bëra një vjershë po me atë rimë, po me ato strofa, me titull: "Nga Uji i Ftohtë - Ernest Koliqit", ia dërgova revistës "Leka" dhe ajo e botoi.

Në kohën kur ne ishim në maturë dhe drejtor ishte Xheladin Nushi, ishte edhe Koliqi profesor. Me Xheladin Nushin klasa jonë u zu keq. Talleshim me të. Ai e kishte kuptuar, prandaj një ditë, para se të shkonim të hanim drekën në mensë, mblodhi gjithë klasat para shkollës dhe mbajti një fjalim. Aty ishin dhe profesorët italianë, dhe Ernest Koliqi. Klasën tonë e shau shumë para të gjithëve, arriti të na quante rebelë, që hanim kot bukën e popullit dhe të tjera sharje të rënda. Ne menjëherë u larguam nga rreshtat, shkuam në klasë të zemëruar dhe vendosëm të mos shkonim më në mësim. U betuam: "Ja ne këtu, ja Xheladin Nushi!"

Dua të them dhe arsyen kryesore të zemërimit të tij:

Unë isha caktuar si kujdestar i bibliotekës, e cila ishte në mes të klasave, aty ku profesorët linin çantat në minutat e pushimeve. Librat që vinin nga Italia, ishin falas, por ai më kishte porositur që nxënësit e jashtëm, të cilët vinin me tram nga Vlora, duhej t'i paguanin. Paratë që mblidhja unë nga shitja e librave, i ruaja mirë, po vinte drejtori dhe i merrte të gjitha, pa i numëruar dhe pa më pyetur fare... Këtë e dinin shokët e mi, prandaj e quanin "kusar". Një ditë Pentasulia, profesori ynë i dashur, mori çantën, më pa në sy dhe më hodhi një libër të vogël duke më thënë italisht: "Fute shpejt në xhep, lexojeni fshehurazi, pa ju diktuar drejtori ose... Kini mendjen!" E mora librin e vogël, e futa në xhep dhe shkova menjëherë në mësim. U bëra mjaft kureshtar, e nxora

ngadalë librin nga xhepi dhe lexova në kapak: "IL MANIFESTO DEI COMUNISTI". E futa në xhep dhe në darkë, kur po bënim studim në ndërtesën e veçantë ku ne si klasë mature edhe flinim, e nxora këtë libër dhe u thashë shokëve ta lexonim. Ia dhamë ta lexonte Reshat Agait, se kishte diksion të mirë: "Proletari di tutti i paesi, unitevi..." E dëgjuam me vëmendje gjithë manifestin, po nuk na bëri ndonjë përshtypje të madhe. Kur bënim ekonomi politike, aty kishte dhe një kapitull për marksizmin. Profesori na e shpjegoi mirë, dhe përfundoi; *"Marksizmi konsiston në këtë, që njeriu me sforcimin më të vogël të marrë rendimentin më të madh..."* Laze Ajazi, një nxënës me të cilin konkurroja në mësime, u ngrit dhe i tha italisht: "Zoti profesor, ne këtu të gjithë jemi marksistë dhe ultramarksistë!" - Profesori nuk qeshi, por u vrenjt dhe i tha Lazes: "Nuk ju kuptoj!" - Dhe Lazja duke qeshur i tha: "Jo me sforcimin më të vogël të marrim rendimentin më të madh, po ne shqiptarët duam që pa asnjë sforcim të marrim rendimente më të mëdha."

Pas dy ditësh drejtori na shau në klasë, por ne nuk e kuptuam. Kur e morëm vesh, u betuam që njëri nga ne duhej të qëndronte aty në shkollë: ja ne, ja ai. Të dyja palët kurrën e kurrës! Ndërkohë filluam të dyshonim se njëri nga ne duhej të kishte spiunuar. Ra zilja për mësim, por ne nuk shkuam. Kishim stenografi me Antonion. Në darkë, u mblodhëm në klasë dhe dikush nxori një thikë të gjatë: "Të betohemi përsëri..." Zgjatëm duart drejt thikës së gjatë, ashtu siç bënin të parët tanë duke zgjatur duart mbi një shpatë, dhe thamë: "Na u bëftë haram qumështi i nënës, nëse tradhtojmë shokët!" Pastaj vendosëm t'i bënim një telegram Ministrisë së Arsimit në Tiranë. Tekstin e hartuam kështu: "Ne maturantët e Institutit Tregtar kërkojmë nga ajo Ministri që të largohet këtej Xheladin Nushi, se na ka poshtëruar. Nuk vemi në mësim, po nuk erdhët ju!" E hodhëm në llotari se kush

do të shkonte në Skelë për ta nisur telegramin. Na ra mua, Qazim Çakërrit dhe Apostol Panganikës. Shkuam në Skelë, të veshur me xhaketat së prapthi dhe me kasketat të futura thellë në kokë, sa na mbulonin edhe veshët, edhe vetullat. Postieri na hodhi një shikim të dyshimtë dhe, pasi e lexoi disa herë telegramin, na tha me të butë: "More djema, këtë telegram unë nuk e heq." Ngul këmbë ne për ta nisur e ngul këmbë ai për të kundërtën, asgjë s'bëmë. Me një karrocë shkuam në postën e Vlorës. Ishte natë. Asnjë nuk dukej në Sheshin e Flamurit, pranë të cilit ishin dhe zyrat e postës. Ai burri që ishte rojë, na vështroi një herë dhe na tha: "Unë atë punë kam, të heq telegramet, po ju mendohuni dhe një herë... se nuk do t'ju dalë për mirë." Ne këmbëngulëm dhe ai e nisi. Paguam dhe me një taksi u nisëm për te Uji i Ftohtë, për në shkollën tonë. Paguam pesë lekë. Kur shkuam në shkollë, iu lutëm shoferit t'i binte disa herë rrotull konviktit duke i rënë borisë. Dolën të gjithë nxënësit në dritare dhe habiteshin. Ç'ka ngjarë, thoshin. Zbritëm dhe u futëm në sallën tonë, ku na prisnin të tjerët, shokët tanë.

Të nesërmen në mëngjes erdhi në shkollë kapiteni i xhandarmërisë Zef Prenushi me tetë xhandarë. Ra zilja që të futeshim në mësim. Drejtori na dërgoi një profesor dhe na tha të shkonim te përroi, nga ana e shtëpisë së Qamil Agait, për të rrëzuar disa mure të vjetra. Kur u kthyem në drekë, vumë re se klasa jonë ishte bërë çorbë: libra dhe fletore të hedhura sheshit. Edhe dhoma e fjetjes gjithashtu: dyshekë dhe batanije përtokë... Kishin kontrolluar xhandarët kudo për të gjetur "Manifestin komunist". Nuk kishin gjetur gjë, se atë libër unë e kisha fshehur midis librave të bibliotekës, në një vend ku vetëm unë mund ta gjeja.

Pasdreke na thirri drejtori, i cili ishte njoftuar nga prefekti për telegramin që ne i kishim drejtuar Ministrisë

së Arsimit, dhe me të butë (na thërriste një nga një) na pyeste se ç'libër kishim lexuar në klasë para disa ditësh. Asnjë nga ne nuk tregoi. Atëherë ai, i zemëruar, na kërcënoi me burg, nëse nuk do të tregonim se kush e kishte sjellë dhe ku gjendej libri. Ne heshtnim. Ishim egërsuar dhe na dukej sikur po bënim ndonjë revolucion të madh. Pas dy ditësh erdhi në shkollë ministri i Arsimit, Abdurrahman Dibra, mik i ngushtë i Xheladin Nushit, erdhi prefekti, kapiteni i xhandarmërisë Zef Prenushi me shumë xhandarë. Të gjithë nxënësit, të të gjitha klasave, u tmerruan: Ç'do të ndodhte tani?!

Ra zilja: të gjithë nëpër klasa. Edhe ne shkuam në klasën tonë. Vinte një xhandar dhe thërriste një e nga një shokët e klasës. I pari shkoi Bari Bala. E mbajtën shumë minuta. Shikonim nga dritarja, kur do të dilte. Ai doli dhe xhandarët nuk e lanë të vinte nga ne, por i thanë të shkonte nga ana tjetër. Bariu, me zë, këndonte labçe: *"Më shtrënguanë të flas, po nuk thashë asgjë! Mbahi, shokë, të vendosur, se s'na bëjnë gjë..."* Ashtu, me radhë, na morën një e nga një. Kur erdhi radha ime, më rrihte zemra fort. Kur hyra në drejtori dhe pashë gjithë ata burra që më shikonin, e humba. Mbaj mend që drejtori tha: "Këtë e kemi nxënësin më të urtë, më të mirë. E kam pasur dhe si sekretar për të mbushur amzat, regjistrat, dëftesat. I kam lënë në besim dhe bibliotekën... (Nuk i përmendi librat që shiteshin, se paratë i merrte ai.) Por as ky nuk flet!"

Dëgjova ministrin e Arsimit që fliste dhe më shikonte në sy:

- Ashtu janë xhithë gjemtë tanë... po allahile, more gjalë, ç'boni çashtu... Nuk e shifni ç'ktu janë italianë...!" - fliste me dialekt, si disa shokë të klasës nga Dibra (Mersin Fiqiriu, Xhevat Pustina, Irfan Majuni e të tjerë), me të cilët talleshim, siç talleshin dhe ata me dialektin tonë.

Më bënë pyetje djallëzore, por unë mohoja çdo gjë. Nuk pranova asgjë, si gjithë shokët e mi. Ashtu mbaroi ajo ditë. Disa nga shokët tanë të rritur nga mosha, si Irfan Majuni, Isuf Glina, i paskësh thirrur drejtori natën (këtë e mësuam pas shumë ditësh). Këta të dy filluan të na thoshin: "More, s'kemi ç'të bëjmë! Drejtorin e do mbreti, e do ministri i Arsimit... ai qau para ministrit dhe i tha se ne na do shumë... por e pranoi që është gjaknxehtë, siç janë gjaknxehtë gjithë shqiptarët... Ne mendojmë të hakmerremi kështu: ta detyrojmë Xheladin Nushin që të na kërkojë ndjesë para gjithë shkollës..." Këto dhe mendime të tjera kompromisi ata na i thanë njëqind herë gjithë ditën dhe gjithë natën, sa ne gjetëm të udhës këtë zgjidhje: të na kërkonte ndjesë para gjithë nxënësve dhe profesorëve. Dhe kështu u bë: pas pesë ditësh grevë, u mblodhëm të gjithë para ndërtesës së konvikteve, aty ku na kishte sharë. Ishin të gjithë profesorët, ministri i Arsimit, prefekti me xhandarët e me kapiten Zef Prenushin...

I pari e mori fjalën ministri i Arsimit, i cili na mburri si djem të mirë e pastaj lavdëroi edhe Xheladin Nushin si person me vlera të mëdha dhe besnik i mbretit. "Ashtu, o djema. Xheladini do t'ju kërkojë ndjesë dhe ne do t'ju falim." Foli dhe drejtori: "Unë jam si ju, jam me ju, punoj për ju dhe ju kam miq e shokë... U nxeha shumë dhe më shpëtuan disa fjalë që nuk duhej t'i thosha. Tani ju kërkoj ndjesë" (dhe erdhi dhe na dha dorën të gjithëve me radhë).

Të nesërmen, u futëm në klasë. Këtë ngjarje unë e shkrova në "Kryengritja e studentit", po humbi bashkë me dorëshkrimet e tjera, në kohën kur vinin në shtëpi xhandarë e karabinierë për të më arrestuar. M'i morën të gjitha shkrimet.

Pyetje: - Po ai profesori italian që quhej Pentasulia, nuk të tha gjë?

Përgjigje: - Harrova! Pasi u mbyll kjo çështje, një të

diel, se të dielave ne dilnim në Vlorë, ai më pa te Sheshi i Flamurit dhe më thirri. Më pyeti për shëndetin dhe më ftoi në dhomën e tij, në hotel "Gambino", që ishte aty pranë. Më qerasi me disa çokollata "Peruxhina" dhe, duke më shikuar me një shprehje dashurie, më tha: "Kalova ditë shumë të shqetësuara. Mjaftonte një fjalë nga ju për atë libër dhe unë... dhjetë vjet në burg... dhjetë vjet! Po jeni djem të mrekullueshëm... të mrekullueshëm..." Pastaj më porositi që atë broshurë ta përkthenim, po duhej të lidheshim me shokë më të rritur, besnikë dhe të ndershëm. Bënte aluzion për komunistët, që ne nuk i njihnim fare. Kur u ndamë, më tha: "Kur të keni probleme të vështira në punën dhe rrugën tuaj, këshillohuni dhe me mua" - dhe më puthi në faqe.

Më vonë mora vesh se ai nuk ishte komunist, por antifashist.

Pyetje: - Pastaj ç'rrugë more?

Përgjigje: - Para se ta mbyll këtë kapitull, dua të theksoj burimin e madh të patriotizmit të mjedisit ku unë ndenja gati shtatë vjet. Uji i Ftohtë është një vend piktoresk. Më nxiste për të shkruar vargje dhe tregime. Vjershën e parë e botova më 1929, te "Shqipëria e re", që botohej në Konstancë të Rumanisë. Ishte sonet (tingëllim) kushtuar Ismail Qemalit. Kur erdhi gazeta dhe e pashë vjershën me autor "Vlonjati", se ashtu e vura pseudonimin, u gëzova pa masë. E futa midis librave gazetën me vjershën time dhe, kur shkova te familja e profesor Kukit, që banonte në një vilë, nën shkollën tonë, ia tregova Ana Marisë, me të cilën bënim mësimet. Edhe ajo studionte në liceun e San Remos, nga ishte. I ati dhe e ëma më zgjodhën mua si nxënës të urtë për të mësuar bashkë historinë, gjuhën, gjeografinë, algjebrën, fizikën e të tjera, që i kishim lëndë të përbashkëta. Ana Maria ishte e para vajzë që më shikonte në sy e me të cilën bisedoja shumë. Kishte një gërshet të gjatë. Fliste pak. Dy vëllezërit e saj

talleshin me të. Kur dilnim në pllajat e Ujit të Ftohtë për shëtitje, unë mblidhja manushaqe dhe ia lidhja në gërshetin e gjatë. Ajo më falënderonte. Kur kthehesha në konvikt dhe kur binim për të fjetur, shokët më pyesnin për Ana Marinë: si flet, si i ka sytë, si e ka trupin e të tjera. Dhe më luteshin që ta sillja një herë në klasë në kohën e studimit, pasdreke, kur gjithë profesorët mungonin. Një ditë iu luta shumë dhe ajo, duke qeshur, më tha: "Kam turp, ç'do të bëj unë në klasën tuaj?" E binda. Dhe, kur e shpura në klasë, ra një heshtje e madhe. Shumica ulën kokën për të fshehur gajasjen, të tjerë, si Apostol Malo, Qazim Çakërri, Nonda Strakosha, iu afruan, i dhanë dorën dhe nisën t'i recitonin tingëllimin e Dantes për Beatriçen. Ajo u skuq dhe më tha: "Andiamo!" Kur e recitoi tingëllimin Qazim Sherifi, që ishte më i moshuari i klasës, harroi ca vargje dhe nisi të qeshte vetë. Plasi një e qeshur në gjithë klasën. Ana Maria më mori nga dora dhe më tërhoqi që të dilnim. Qe vajza e parë dhe e fundit që hyri në klasën tonë.

Në sallën e fjetjes atë mbrëmje u bë debat i madh për bukurinë e Ana Marisë, për vajzat tona, që ishin pa shkollë, për dashurinë... Më vonë mora vesh se Ana Maria kishte vajtur si infermiere (vullnetare), bashkë me ushtarët e Musolinit, në Abisini...

Tani dua të theksoj mendimin që nisa për burimin e patriotizmit të mjedisit historik dhe topografik të Vlorës. Vlora, me historinë e saj, me shtypjen që i bënte Zogu, me lëvizjet patriotike, me varrin e Avni Rustemit të lënë dhe të bërë një me baltën e madhe të rrugës Vlorë-Skelë, me varrin e Ismail Qemalit, të lënë atje në Kaninë, midis telave me gjemba, me Sazanin atje në krye të limanit, ku valonte flamuri i Italisë, me bregoret mbi Qafë të Koçiut, ku ishin të shpërndara varret e luftëtarëve tanë pa asnjë shenjë, me varret e italianëve të vrarë më 1920, aty kundruall çmendinës, varreza me kryqe, me lule, aty

përmbi shkollën tonë, na shtynin të bënim krahasime: luftëtarët shqiptarë, bijtë e këtij vendi, dergjen të harruar midis ferrave, kurse varret e shkelësve të tokës sonë, me kryqe mermeri dhe me trëndafila! O ironi e historisë! Të gjitha këto na nanurisnin ditë e natë, sikur të na thoshin: "Ku jeni, o djema!".

Letrat ilegale të Halim Xhelos, bisedat me patriotët që ishin aty në Ujë të Ftohtë, të cilët i vizitonim shpesh e që na flisnin për historinë tonë, për luftën që duhej vazhduar kundër Zogut, si Murat Tërbaçi, Gani Aliko, Dhimitër Konomi e të tjerë, na edukonin me ndjenja të thella patriotike dhe revolucionare. Ishim të rritur dhe e kuptonim situatën. Një ditë, në çmendinën e Vlorës, ku shkonim shpesh, një shok i tha Sulejman Delvinës, kryeministrit të parë pas Kongresit të Lushnjës, që Zogu e kishte futur në çmendinë: "Zoti Sulejman, pse nuk dilni përjashta, pse qëndroni këtu?". Dhe ai, duke qeshur dhe duke na shikuar me ata sytë e tij që kurrë nuk i harroj, u përgjigj: "E ku të vete, o bijtë e mi! Gjithë Shqipëria çmendinë është katandisur nga... nga ai", - dhe tregoi me gisht nga veriu, duke aluduar për Ahmet Zogun.

Dhe ne, të ndërgjegjshëm për mundimet që do të hiqnim, e lamë Shkollën Tregtare. U ndamë me shokët dhe morëm rrugët e mundimit e jo të realizimit të ëndrrave tona që trillonim aty, në atë vend të bukur, aty, në vatrën e dashur, ku jetuam për shtatë vjet, pa asnjë hall, pa asnjë privim. U ndamë me premtimin se do ta nderonim shkollën që na edukoi, do ta nderonim Vlorën që na nanurisi me shpirtin e saj patriotik.

KALVARI... (1931-1937)

NË TIRANË

Pyetje: - Për herë të parë shkove në Tiranë?

Përgjigje: - Jo! Para një viti kisha qenë në Tiranë për këtë çështje:

Kostë Goreci, më i pasuri i fshatit, njëri nga paria më reaksionare dhe më intrigante (ishte me grekun, ishte me Italinë e parë, ishte me Nolin, ishte me Zogun... i lidhur me agallarët e krahinës së Vlorës dhe me arhondët e Himarës), më kishte hedhur në gjyq, se kërkonte një mijë lireta që gjoja ia kishte dhënë tim eti në burgun e Leçes, më 1917... Im atë u jepte të tjerëve dhe jo të kërkonte nga Goreci para hua. Goreci ia kishte vënë syrin një bahçes sonë me ullinj, në Angra, aty në kufi me ullinjtë e tij, në xhadenë që kishin hapur italianët për Jaliskarin. Nënprefektin e Himarës dhe gjykatësin i kishte miq, ashtu siç kishte miq kurdoherë gjithë autoritetet që shkonin e vinin. Shtëpia e tij kurdoherë vizitohej dhe strehonte autoritetet, me të cilat bënte dallavere. Ky Kostë Goreci më paskësh hedhur në gjyq dhe gjyqin e kisha humbur në mungesë. As unë e asnjë nga familja ime

nuk dinte gjë. Më erdhi vendimi në Shkollën Tregtare. U habita. U habitën dhe shokët e mi. Ai, me një të shtënë, mendonte të vriste dy zogj: të na merrte bahçen dhe unë të humbisja shkollën. Vëllai im, Fotoja, kishte vdekur nga veremi. Vëllai tjetër, Mimi, që vinte pas Fotos, kishte marrë rrugët e kurbetit. Andoni, që ishte më i madh se unë, punonte si ndihmësshofer në linjën Sarandë-Vlorë.

Më thirri drejtori, Kolë Kamsi. Më pyeti gjatë dhe unë i tregova synimet e Kostë Gorecit. Ai më dha një napolon dhe më tha: "Shko në Tiranë, në Diktim!" Shkova në Tiranë dhe iu drejtova fshatarit tim Kolë Dhimitri, që ishte anëtar i Diktimit. Ai më shpuri në një ëmbëltore në rrugën e Durrësit. U ulëm. Pasticieri solli një pjatancë me nja dhjetë pasta. "Ha, - më tha Kolë Dhimitri. Mora një dhe e gëlltita, se isha pa ngrënë. - Ha," - më tha prapë Kolë Dhimitri. Dhe unë, duke kujtuar se të gjitha pastat i kishte prurë për mua (ishte zakon atëherë që të vinin përpara pjatancën me pasta dhe ti zgjidhje cilën të doje; këtë zakon më vonë e mësova nga shokët, të cilëve u tregova ngjarjen dhe ata shkuleshin së qeshuri), i hëngra të tëra. "Të bëfshin mirë!" - më tha Kolë Dhimitri, që më shikonte me vëmendje. Pastaj më mori dhe shkuam në Ministrinë e Drejtësisë, ku ishte dhe Diktimi (Gjykata e Lartë). Më shpuri te ministri, Milto Tutulani, pastaj te Thoma Orollogai. Foli me ta. Ç'është e vërteta, ata më pritën mirë dhe u erdhi keq për mua. Kolë Dhimitri më shpuri pastaj në zyrën e tij, shkroi një ankesë, e nënshkrova dhe më tha: "Tani ikë e mos ki frikë. Gjyqi u prish... dhe ai gjykatës i keq do të transferohet nga Himara!" Më përcolli gjer te dera pastaj më pyeti nëse kisha të holla me vete. Unë ula kokën. Ai nxori portofolin dhe më dha njëzet franga duke më thënë: "Kur të zësh punë, m'i kthe!"

U ktheva në shkollë i gëzuar. Vendimi i padrejtë ishte prishur dhe gjykatësi i keq nga Leskoviku ishte tran-

sferuar. Ishte hera e parë kjo që shkoja në Tiranë, po nuk mbaj mend asgjë tjetër.

Në Tiranë, shokët tanë, që e kishin mbaruar shkollën, si Shevqet Musaraj, Adem Kondi e të tjerë, kishin zënë punë. Ata na përkrahnin dhe na gjenin ndonjë vend ku të flinim. Ishim shumë nga klasa jonë: unë, Sulejman Kalaj, Nonda Strakosha, Bari Bala, Qazim Sherifi, Laze Ajazi... që silleshim vërdallë ditë për ditë nëpër zyra të ndryshme për ndonjë punë. Arsimtarë nuk mund të pranoheshim. Kur isha në shkollë, lexova në gazetë se ishte hapur konkursi për një gjeografi për shkollat e mesme. Në gjeografi unë isha i pari, më pëlqente shumë. Fola me profesorin e gjeografisë, Antonianin, që na bënte edhe stenografi. Ai më nxiti të merrja edhe unë pjesë në këtë konkurs. Mora programin e Ministrisë së Arsimit, punova natë e ditë, me shumë tekste që më jepte Antoniani, dhe me tekstet e tjera dhe e mbarova: 400 faqe të daktilografuara. Shokët e mi ishin entuziastë dhe më thanë: "Kur të marrësh të pesëdhjetë napolonat, do të na japësh edhe neve ndonjë napolon". Ia dërgova rekomande, në Tiranë, Ministrisë së Arsimit. Kaluan muaj e muaj dhe asnjë përgjigje, asnjë shpallje për fituesin e kon-kursit.

Një ditë, Bari Bala erdhi në lulishten mbretërore, ku mërzenim, dhe me gazetën në dorë më thirri si i çmendur: "Fitove! Fitove!" - dhe më përqafoi. Kisha fituar konkursin. Të gjithë së bashku u nisëm për në Ministrinë e Arsimit. Të gjithë hipëm lart dhe pyeta se ku duhej të veja.

Hyra në një zyrë. Nderova allazogistshe. "Jam Petro Marko, ai që kam fituar konkursin për gjeografinë!" Nëpunësi më pa nga këmba e gjer te koka, përdrodhi buzët dhe më tha: "Ku e ke kopjuar ti? Kush ta ka bërë?" Unë, i dehur nga emocioni, i thashë se e kisha bërë vetë. Ai u zemërua: "Me kë tallesh ti? Kërkon të na e hedhësh, ë? Hajt, ikë që këtej!" Dola me lot në sy nga zemërimi.

Shokëve nuk u fola fare, por ata e kuptuan mirë që puna ime kishte shkuar dëm.

Unë kisha bërë edhe lutje për bursë, për jashtë shtetit, për studimet e larta. Flitej se atë vjeshtë do të jepnin shumë bursa, pasi SVEA (Societa Sviluppo Economico Albania) kishte caktuar shumë bursa nga huaja që do t'i jepte shtetit tonë Italia e Musolinit. Lutje kishin bërë shumë liceistë e gjimnazistë që endeshin bashkë me ne rrugëve të Tiranës. Andoni, vëllai, kishte shkuar ushtar dhe i shërbente një koloneli italian si ordinancë. Ai kolonel më thirri në shtëpi dhe më pyeti se ç'kërkoja. Ishte me gruan dhe me vajzën e tij të rritur. Ato të dyja iu lutën shumë kolonelit që të interesohej për mua, dhe ai më dha fjalën se do të interesohej shumë. Më dërgoi me një kartëvizitë në legatën italiane te një shqiptar që punonte atje me emrin Daniska. Ai përdrodhi buzët dhe më tha se do të interesohej. Dua të shënoj këtu se ende nuk isha futur në shpirtin e kohës, në dallaveret, në intrigat, në imoralitetet, që ishin arma për të jetuar...

Kalonin ditë, javë e muaj. Vera po shkonte. Afrohej vjeshta. Ne vinim vërdallë zyrë më zyrë. Ishim shumë. Unë ngandonjëherë vidhja bukë te daja, për Sulejman Kalajn, Bari Balën e të tjerë, që rrinin ditë të tëra pa vënë gjë në gojë. Për këta dy shokë më vonë do të botoja dy novela; "Vdekja e shokut", kushtuar Sulejman Kalajt, që vdiq pa zënë ende punë, dhe "Shpresa", kushtuar Bari Balës, që edhe ai vdiq pa zënë punë. Gjatë kësaj kohe botoja në "Ora" tregime dhe aty-këtu ndonjë vjershë. Namik Delvina me Loni Naçin, nxorën gazetën "Miku i popullit". Namiku më mori edhe mua të punoja në gazetë, por kjo nuk pati jetë të gjatë. E them tani, se Loni Naçi, që më njihte, se kishte qenë drejtori i parë i Shkollës Tregtare, jo vetëm që nuk më dha asnjë lek për punën që bëra aty, po një ditë më tha: "More djalë, a ke ndonjë lek

në xhep?" Kisha pesë lekë, që m'i kishte dhënë vëllai im, Andoni, dhe ia tregova duke i thënë se vetëm ato kisha. Ai m'i mori edhe ato!

Pyetje: - Ç'të ka mbetur në kujtesë nga ato ditë?

Përgjigje: - Episode komike dhe tragjike. Një ditë vëllai im, Andoni, ishte veshur me uniformën e kolonelit italian - ky dhe familja e tij kishin shkuar për pushime në Itali - pasi do të takohej me një vajzë pasanike, që shoqërohej kurdoherë nga një trim. Vajza u fut në bane-sën e kolonelit dhe i tha trimit shoqërues se njihte vajzën e kolonelit. Por, kur vonoi vajza të dilte, trimi hyri brenda. Kur pa Andonin të veshur si kolonel, që bënte dashuri me vajzën, ai nxori revolen dhe e qëlloi. E plagosi në dorë. Çështja u mbyll, që të mos dilte emri i vajzës...

Lexuam në gazetë se zyrat ose drejtoria e Reformës Agrare kërkonte topografë. Shkuam: unë, Laze Ajazi, Bari Bala, Sulejman Kalaj, Nonda Strakosha dhe disa të tjerë. Drejtori, Sali Vuçiterni, një njeri i zymtë, me qylaf të zi, me syze të zeza, na bëri shenjë të uleshim. Ishte hera e parë që një zyrtar na priste qetë, duke na bërë shenjë të uleshim. Morëm zemër dhe shpresat na u ngjallën: "Do të zinim punë si topografë!" Fronat ishin të gjatë, të thurur me fije indiane. U ulëm dhe shtynim njëri-tjetrin me bërryl nga gëzimi. Fjalën e mori drejtori, Sali Vuçiterni.

- Keni mbarue shkollën?

- Po! - iu përgjigjëm njëzëri.

- Të mesmen? - pyeti përsëri drejtori.

- Si urdhëron! - u përgjigjëm njëzëri.

- Mirë, pra, po pa më thoni, nga jeni?

- Ne heshtëm, se e dinim që, sapo t'i thoshim nga ishim, do të na përzinte nga zyra me shkelma. Kudo ku shkonim, na pyesnin se nga ishim. Porsa u thoshim se ishim nga Vlora, na sikterisnin.

- E, o djema, nga jeni? - përsëriti drejtori. Ne heshtëm. Po Laze Ajazi tha me zë të ulët:

- Jemi nga... Vlora!

Ai, sapo dëgjoi se nga ishim, u ngrit më këmbë dhe na bërtiti:

- Hajt, shporruni përjashta!

Laze Ajazi tha:

- Ah, në na ardhtë dita!

Vendi ku mblidheshim më shpesh, ishte kopshti pranë pallatit të mbretit, aty në rrugën e Elbasanit. Ishte i vetmi kopsht. Muret e oborrit të pallatit ishin shumë të larta. Këtej, në anën tjetër, ishin ndërtesat ku banonte familja e mbretit: nëna dhe motrat. Kalonte nga kopshti shpeshherë princ Tati, djali i motrës së Zogut, e cila kishte për burrë Cen Kryeziun. Në kopshtin ku rrinim ne, edhe kur pemëve u binin gjethet dhe bënte ftohtë, kalonte princ Tati i vogël, nja dymbëdhjetë vjeç, si vajzë e bukur, me flokë të gjatë kaçurrelë. Ai vraponte dhe pas e ndiqte një adjutant i vrenjtur, i cili shpesh na kërcënohej dhe nuk na linte të rrinim në kopsht. Na shante keq. Ai ishte Ethem Bajrami, nga Mati, besnik i familjes së Zogut, toger atëherë. Për të pirë ujë e për të bërë nevojën shko-nim në Ministrinë e Arsimit, gjoja për të pritur në sallon. Salloni ishte i madh, me një tryezë të madhe ovale në mes dhe me kolltukë. E mbaj mend mirë mbulesën e trashë jeshile të tryezës. Aty pranë, në banjë ishte nevojtorja dhe një depo me ujë të ftohtë. Aty nga vjeshta, mbaj mend se erdhi një djalë i ri, i zbathur, që kërkonte të futej te ministri. Bërtiste: "Dua bursë, kam mbaruar shkollën plotore, dua bursë!" Ishte nga Tragjasi. E pashë që nuk shkulej, megjithëse dita po mbaronte, prandaj u mendova dhe i thashë: "Ti hiqe atë mbulesën e tryezës, mbështillu mirë me të dhe shtrihu në këtë kolltuk këtu duke thirrur: "S'kam se ku të vete! Jam i varfër! Dua bursë!" Ai nisi të vepronte ashtu siç e porosita. Pra, pasi u mbështoll mirë e u shtri në kolltuk, nisi të bërtiste. Erdhën shërbyesit, rojat, i kanoseshin ta ngrinin, por ai nuk shkulej. U bë një shamatë e madhe, sa dolën dhe

shumë nëpunës nga zyrat e tyre. Doli dhe Aleksandër Xhuvani. Pyeti se ç'po ndodhte, dhe, pasi e mori vesh, e mori me të mirë atë djalë të zbathur e i tha: "Eja me mua, se do të të japim bursë që tani!" Djali u ngrit dhe, pa e hequr nga trupi mbulesën jeshile të tryezës, i shkoi pas Xhuvanit, i cili e futi në zyrë të tij. Kur doli jashtë, ai mbante në dorë një shkresë për te konvikti "Vaso Pasha". E kishte fituar bursën. Unë, i vetmi që kisha bërë lutje për bursë jashtë shtetit, ende shpresoja. Po ja që bursat u shpallën. Ishin shumë. Unë nuk isha në listë. U dëshpërova pa masë. Shokët e mi më ngushëllonin dhe më thoshin: "Mos u mërzit, se u pa kjo punë. Mor po, të zëmë nga një copë punë, pa pastaj rregullohemi". Punë pranonim kudo që të na jepnin, përveç xhandar, polic ose prift.

Dëgjoja dajën tim, barba Lekën, t'i thoshte shpeshherë Namik Delvinës, që pinte raki dhe fërkonte hundën e madhe (ashtu e kishte zakon, kur pinte raki fërkonte hundën):

- More zoti Namik, thuaji atij Hiqmet bej Delvinës se mos i gjen ndonjë punë këtij nipit tim që mbeti rrugëve.

Namiku thoshte:

- Kur të botojmë ndonjë gazetë, do ta marr unë. I kam bërë rixha edhe Kostë Çekrezit, por ai nuk ka vend. Të durojë. Mbaje ti, se e ke djalë.

Barba Leka mendonte që unë të emigroja jashtë shtetit. Po ku të veja? "Në djall të vesh - më thoshte, - këtu s'ka bukë! Shko në Francë, në Australi, në Argjentinë, në djall, se këtu s'ka bukë, s'ka punë".

Por unë gjithnjë kisha ëndërruar që të zija ndonjë punë të mirë, në ndonjë zyrë, se shumica e zyrtarëve ishin analfabetë. Kishte nëpunës me dy klasë fillore, kishte sekretar komune ose kryetar komune me dy klasë fillore. Pse të mos na jepnin punë neve, që kishim mbaruar shkollën e mesme?

Kishte nisur në ndërgjegjen time të buiste revolta, pakënaqësia, dëshpërimi, urrejtja. Po ç'të bëja? Po shokët e mi ç'të bënin? Ngado që të hidhnim sytë: padrejtësi, poshtërsi.

Pyetje: - Po nuk kishit rënë ende në kontakt me ndonjë shok komunist?

Përgjigje: - Jo! Unë dhe shokët e mi ndiqnim rrugën e të gjithëve: ku të gjenim ndonjë mik, të na ndihmonte, të na gjente ndonjë nëpunësi. As që mendonim se kishte shokë që luftonin regjimin. Unë, si gjithë himarjotët shqiptarë, e deshëm Zogun, pa ditur se ç'ishte ai. Ai për ne ishte Shqipëria. Madje unë kisha bërë edhe një tingëllimë për Zogun, botuar në gazetën "Besa" në faqen e parë, me rastin e ditëlindjes së tij ose të 28 Nëntorit, nuk e mbaj mend.

Tani, as që mund ta kujtoj se cili qe i pari që më lidhi me Demir Godellin. Ndoshta Minella Koleka, ndoshta Thoma Varfi ose Mahmut Bedalli, që punonte në noterinë e Kokalarit, bashkë me Shevqet Musarajin. Nuk më kujtohet mirë, Por patjetër që Mahmuti më ka njohur me Demirin, që ishte kthyer nga Moska. Ky më tha (e mbaj mend mirë këtë): "Erdha nga Moska dhe i prura të fala nga Halim Xheloja Shevqet Musarajit. Po Shevqeti më tha: "Nuk e njoh!" Si nuk e njeh Shevqeti Halimin? - mendova. - Ai i ka dhënë motrën për grua!"

Më kujtohej shumë mirë kjo ngjarje: "Te Uji i Ftohtë, në Vlorë, Shevqeti na lexonte letrat që merrte nga Halimi. Dikush e spiunoi dhe u thirr shumë herë në xhandarmëri, në prefekturë, dhe, me presione e frikësime për masa të rrepta, e shtrëngonin të pohonte se kishte marrë letra nga Halimi. Po Shevqeti, Gani Tafilaj (edhe ai në klasën e Shevqetit, që ishte nga Smokthina dhe mik i Halimit), me gjithë procesverbalet që u mbajtën, nuk thanë gjë. Unë e lidha këtë mohim të Shevqetit me atë ngjarje. Pra nuk pranoi që e njihte Halimin, para një njeriu të panjohur.

Kur u shpallën bursat dhe unë u dëshpërova shumë, Sulejman Kalaj më tha: "Do dhe Muçoja kafe! (Ti kërkon bursë! Këtu nuk na qasin në fshat, ti kërkon vajzën e priftit për grua! Na ka marrë lumi ne, që s'kemi as para, as mbështetje, as shpresa. Ne do të vdesim nga uria! Më vjen keq për motrat e mia, se më kanë vëlla të vetëm! Më thoshte mirë nëna: "E ku shkon, more djalë! Rri këtu, me bagëtinë tonë. Sos ke vëllezër të tjerë, të na lësh vetëm mua dhe motrat e tua!" I gjori Sulejman, vdiq nga një plevit dhe nga uria!

Vjeshta po ikte. Vinte dimri. Unë - pa tesha, me këpucë të copëtuara. Mërdhija. Kurdoherë shkoja në Ministrinë e Arsimit, jo më për bursë, po për ndonjë punë. Më 28 Nëntor bëhej festë e madhe. Populli do të kalonte para mbretit.U futa edhe unë në turmën e madhe që bërtiste "Rroftë mbreti!" U afrova te ballkoni i ulët i pallatit, ku mbreti, i veshur me uniformën ushtarake, nderonte popullin; e pashë. Qe hera e parë dhe e fundit që pashë mbretin e famshëm, që ne e deshëm dhe mburreshim me të. Në ditët e ardhshme do të mësoja se ç'gjëmë të madhe i kishte prurë ai vendit. Demir Godelli më jepte edhe disa broshura që botoheshin nga Komiteti i Çlirimit Nacional, në Paris.

Atë dimër të vitit 1932 njoha dhe Asim Vokshin. Nuk e di se si u njoha dhe me Vasil Shanton, që ishte student, por që punonte edhe në furrë, me babanë e tij. Mbaj mend se ai na sillte nga një franxhollë të ngrohtë. Pastaj nuk e di se si Vasili na shpuri në një restorant që kishte hapur një maqedonas ose bullgar, aty në Rrugën e Dibrës, karshi shtëpisë ku ishte shtypshkronja "Tirana". Vasili na tha të shkonim të hanim te Restoranti Ekonomik (ashtu e kishte tabelën ai restorant). Shkonim disa, si unë, Sulejmani, Bariu, Lazja. E vërteta është se ne ishim shumë. Vidhnim bukë dhe ua shpinim atyre që nuk vinin me ne. Pas një muaji e ca, ai restorant u mbyll: i zoti ishte arratisur.

Unë dhe Nonda Strakosha, i shkonim përditë në derë të oborrit deputetit të krahinës sonë. Ai ishte pasuruar shumë, se Zogu i kishte besuar planimetrinë e Tiranës. Kur Zogu u plagos në parlament nga Beqir Valteri, ky, si mjek që ishte, i shëroi plagën. Si fitonte mijëra napolona doktori? Pasi kishte në dorë planimetrinë e Tiranës, ky lajmëronte ata që kishin para: "Shikoni se andej do të hapet bulevardi ose filan rrugë e re!" Dhe këta shkonin e blinin tokat me 10 franga një metër katror e pastaj, kur hapej bulevardi ose rruga e re, po ai vend kushtonte 20 ose 30 franga ar metri katror.

Pak më lart se shtëpia e deputetit banonte Hilë Mosi, pranë furrës së Dingut. E shihnim edhe atë çdo mëngjes, që ia hipte veturës për të shkuar në zyrë. Shoferi na shihte me dyshim. Ishte një tullac nga Korça. Por ne, unë dhe Nonda, njëri nga e djathta e derës se oborrit dhe tjetri nga e majta, prisnim të dilte doktori, me një çantë të madhe në dorë. Ai hapte derën e madhe, as na i hidhte sytë, se e dinte që ne ishim aty. E vinim në mes dhe e shoqëronim pa thënë asnjë fjalë, gjersa futej në derën e parlamentit, ku ne shkonim shumë herë (lart në galeri) për të dëgjuar diskutimet e deputetëve tanë.

Një ditë, doktori, i mërzitur, ose ngaqë kishte frikë nga ne, na foli me të mirë dhe na çoi drejt e në Ministrinë e Arsimit. Ne u gëzuam pa masë. I pari u fut ai në zyrën e Aleksandër Xhuvanit, pastaj na ftoi edhe ne të futeshim. Pasi u përshëndet me Xhuvanin, hapi çantën dhe nxori një letër të gjatë, nga ato të korrekturave të gazetës, dhe filloi:

- Zoti Xhuvani! Kam këtë për transferim, këtë për shtim rroge, këtë për gradim, këtë për emërim... - vazhdoi nja njëqind emra e, në fund të listës, - kam Petro Markon dhe Nonda Strakoshën për emërim...!

Xhuvani, duke qeshur, i tha:

- Këto punë duan shumë kohë që të kryhen. Durim!

Durim! (Këto fjalët e fundit na i drejtoi neve të dyve, që prisnim shpëtim!) - Pastaj deputeti ynë u kthye nga ne dhe tha:

- Ë, a e patë se sa interesohem unë për ju, për popullin?! S'ka punë tani! Durim! Durim!

Përsëri rrugëve. Nonda kishte dhe një të keqe të madhe: hapte sytë dhe për femra. Aty ku ishte parlamenti, karshi ministrive, ishin zyrat e furnizimit me graso dhe benzinë. Nonda merrte pak graso dhe lyente flokët si me brilantinë. Qelbej erë dhe, kur grasoja shkrinte, i kullonte faqeve...

Pyetje: - Po ti a kishe njohur ndonjë vajzë?

Përgjigje: - Aso kohe mund të njihje vajzën që do të bëhej gruaja jote. Nuk guxonim t'i hidhnim sytë ndonjë femre. Nuk e mohoj: më pëlqenin disa gra ose vasha që shikoja - sidomos ato që shkonin në Institutin Femëror - po si të ta shpjegoj? E shihnim hënën, na pëlqente, por a mund ta zinim me dorë? Aq larg ishim aso kohe me femrat. Ne shikonim nëpunësit kur dilnin nga zyrat: asnjë femër. Vetëm një ishte në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kishte dhe ca mësuese. Kishte dhe shtëpi publike, por unë i urreja ato, nuk i shihja dot me sy. Kjo më mbeti që kur isha në Vlorë. Me të mbaruar shkollën, shokët e mëdhenj të klasës na thanë se tani ishim bërë burra dhe duhej të shkonim në shtëpinë publike. Vajtëm një pasdreke të gjithë së bashku. Shtëpia publike ishte pranë spitalit. Aty ishin nja tri gra të thata, të shëmtuara. Shkuan disa shokë, po, kur më tha njëra mua: "Eja, mor çapkën", - unë ika me vrap. Qysh atëherë kam një neveri të madhe për ato të mjera.

Dua të hap një kapitull të veçantë për femrat që kam njohur, sidomos jashtë shtetit. Më poshtë, kur të vijë radha...

Pyetje: - Folna për vitin 1932. A është e vërtetë që ky vit ka qenë vit me ngjarje të mëdha për jetën tënde?

Përgjigje: - Ashtu është! Viti 1932 ka qenë plot ngjarje.

Merre me mend, kaluam gjithë ata muaj rrugëve, duke trokitur dyerve për punë. Në fshat më vinte turp të kthehesha. Të gjithë mendonin se unë kisha shpëtuar. Kisha mbaruar shkollën e mesme dhe patjetër do të futesha në radhët e të privilegjuarve, do të isha me rrogë.

Atëherë, ai që kishte një rrogë, sado e vogël që të ishte, rronte mirë. Rroga më e vogël ishte e shërbyesve të zyrave dhe e xhandarëve: dy napolona në muaj. Ëndrra ime kishte qenë të vazhdoja shkollën e lartë, por ajo ëndërr mori fund. Tani luftoja të sistemohesha në punë, kudo, në çdo skaj të atdheut, si nëpunës. Shikonim ku kishte kërkesa, por pa miq nuk bënim gjë. Thuhej se, kur një qeveritar emëronte një nëpunës, gjashtë muaj të rrogës i merrte ai. Edhe atë kusht e pranoja. Kisha një kushëri që ishte ordinancë te një major i marinës sonë, zyrat i kishte në Ministri të Brendshme. Ai merrte racionin e tij si ushtar dhe e ndante me mua. Flija me të në një depo vozash të zbrazura. Ma qante hallin dhe më thoshte shumë gjëra të neveritshme për moralin e nëpunësve të lartë. Për herë të parë i dëgjoja këto mynxyra... Dhe e provova vetë:

Deputeti ynë, të cilit kurrë nuk iu ndamë, por e shoqëronim kot, që të na shihnin spiunët se kishim edhe ne një njeri të regjimit, një ditë më tha: "A di të shkruash me makinë?" "Si nuk di! Kemi bërë mësim daktilografi dhe kam dalë më i miri!" Më mori dhe më shpuri në parlament. Më çoi në një zyrë, nga ana e majtë e hyrjes, dhe i tha një zotërie: "Ky e kopjon rregulloren e bashkive." Ai zotëri më dha një deng me shkresa, të cilat unë duhet t'i bëja në njëzet kopje. Do të më paguanin 100 franga. Për mua qe një gëzim i madh. Iu përvesha punës dhe për dhjetë ditë e mbarova atë punë. Më dhanë një shkresë, të shkoja në Ilogarinë e Ministrisë së Punëve të

Brendshme, për të marrë të hollat. Po afronte Viti i Ri. Unë dhe shokët e mi do të bënim një Vit të Ri me para... Shkova në llogarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Llogaritar ishte një qeros nga Dibra. I tregova dëftesën. "Eja nesër!" - më tha. Shkova të nesërmen. "Eja nesër!" Kaluan shumë ditë. "Eja nesër!" - më thoshte qerosi dhe as që ma varte fare. Shokët e gjorë, të cilët prisnin përjashta që unë të dilja me të pesë napolonat e të shkonim edhe ne të shqepeshim së ngrëni, kur më shihnin të mërzitur, e kuptonin. Njëri prej tyre më tha që të shkoja drejt e te ministri e të ankohesha. U ktheva përsëri në Ministri, i thashë rojës se doja të takohesha me ministrin. Ai më udhëzoi që herën e parë duhej të takohesha me një sekretar të ministrisë e pastaj me ministrin. Trokita në derë dhe hyra brenda. Nderova allazogistshe dhe i thashë ç'kërkoja. Ai, duke buzëqeshur, ma bëri me dorë që të ulesha përballë tij. U habita me këtë sjellje të jashtëzakonshme. Më buzëqeshi dhe më zgjati kutinë e cigareve. E falënderova, nuk e pija. Më pyeti se nga isha e nga s'isha, pse doja të takohesha me të e të tjera. Më fliste sikur të më njihte mirë. Dhe unë i tregova gjithë odisenë time. Ai më tha pse nuk kisha vajtur tek ai. Më premtoi se, meqë kishte simpati për rininë, e cila, sipas fjalëve të tij ishte e ardhmja e atdheut, për çdo hall që të kisha, do të më mbaronte punë. Më premtoi se do të më sistemonte mirë. Më tha: "Ma jep mua atë dëftesë dhe në darkë, kur të erret, aty para "Kursalit" do të vijë të të marrë një karrocë. Do të të sjellë... do të të jap edhe paratë!" U gëzova pa masë dhe e falënderova me zemër këtë njeri kaq zemërmirë dhe bujar. Kur dola në korridorin e ministrisë, më priste kushëriri im, ushtar-marinar, që ishte ordinancë i majorit të marinës sonë. Më pyeti ç'kisha bërë. I thashë se në darkë paratë do të m'i jepte sekretari i përgjithshëm. Ai u nxeh, u tërbua dhe më tha: "Eja me mua!" I shkova pas. Ai u fut në

zyrën e majorit të marinës dhe pas pak më thirri brenda. Majori italian, i shkurtër, me një monokël në sy, më pyeti italisht se ç'hall kisha, dhe më dëgjoi mirë. U ngrit dhe më tha ta ndiqja pas. Shkuam te dera e sekretarit. Majori trokiti dhe hyri. Pas tij edhe unë. I tha atij që t'i jepte dëftesën time. Ai nuk dinte italisht, por ia përktheja unë me një përçmim dhe neveri për atë sekretar shkurtabiq. Ai ia dha dëftesën. Unë i hodha ca shikime të egra. Ndoqa majorin, i cili u drejtua për te llogaria, tek ai qerosi që më thoshte "Eja nesër!". Porsa e pa, ai llogaritar mistrec u ngrit më këmbë. Mori dëftesën, nxori nga arka një pesënapolonëshe, por ia dha majorit dhe jo mua. Dolëm në korridor. Ai major i mirë më hodhi krahun dhe më tha: "Attenzione figlio mio, perche questi sono lupi... Qui é un bordello!"[1] Më dha dorën dhe u ndamë. Unë e falënderova shumë. Kushëriri im, marinari Petro Nino, duke qeshur, më tha: "Shpëtove mirë nga bishat. Takohemi në drekë!" Të them të drejtën, që atë çast unë u bëra armik i betuar dhe i vendosur gjer në vdekje kundër atij regjimi imoral, kundër atij regjimi që shokët e mi më të pjekur e kishin cilësuar regjimi i hurit dhe i litarit...

Me ato para lamë ca borxhe dhe bëmë një Vit të Ri të mirë. Pastaj përsëri avazi. Unë mërdhija, se isha i zhveshur fare. Kur binte shi, shkoja në bibliotekë. Drejtori i saj, një burrë i mirë, Sotir Kolea, kur pa emrin tim, më buzëqeshi dhe më tha: "Ti shkruan mirë!". Siç dukej, ai e lexonte gjithë shtypin. Më jepte për të lexuar botime të vjetra, shtypin e vjetër, kalendarë kombëtarë të vjetër. Kohën e kaloja jo keq.. Shkoja me shokët edhe në parlament, për t'u eglendisur me "Baballarët e kombit," që më dukeshin të gjithë njësoj, përveç Abdurrahman Krosit, Lalës, siç i thoshin njeriut më potent të kohës së Zogut. (Do të tregoj më poshtë.)

---

1) Kujdes biri im, sepse këta janë ujq... këtu është një shtëpi publike!

Mësuam se Ministria e Drejtësisë kishte caktuar një ditë konkursi për një sekretar të një prokurorie. Vajta dhe unë. Në sallën e poshtme të ministrisë u grumbulluam nja pesëdhjetë veta: liceistë, gjimnazistë dhe shokë nga shkolla ime. Ishte në komision Thoma Orollogai... Para se të na jepnin pyetjet, pasi na shpërndanë disa letra të bardha, u fut një shërbyes i ministrisë dhe i dorëzoi Orollogait një pusullë. Ai e lexoi dhe me keqardhje na tha: "Vendin e caktuar e fitoi një njeri që nuk mori pjesë në këtë konkurs". Dolëm jashtë të mërzitur dhe të revoltuar. Më vonë mësuam se ai njeri që u caktua, ishte një matjan me katër klasë fillore. Lalë Krosi i kishte dhënë një kartëvizitë për ministrin e Drejtësisë, Milto Tutulanin, me dy fjalë: "Fëjte çëkët!"

Urrejtja më shtohej. Revolta më shtohej. Po ç'të bënim. Një fjalë, dhe të priste burgu. Mora pjesë si dëgjues edhe në gjyqin e vlonjatëve. Bëhej aty në Rrugën e Kavajës, në kinema "Gloria". Na pëlqeu shumë qëndrimi burrëror i doktor Tare Libohovës dhe i doktor Bilalit. Prokuror ishte Kiço Bisha dhe kryetar gjyqi politik Bilal Nivica. Urryem Idriz Jazon, që i tha të tëra (ai e kishte denoncuar organizatën ilegale të Vlorës). Ne dëgjonim dhe na shtohej revolta dhe urrejtja. Dënimet qenë shumë të rënda. Shumë me vdekje.

Pyetje: - A pate kontakte me shokë revolucionarë?

Përgjigje:- Me sa më kujtohet, takimet me Demir Godellin bëheshin të shpeshta. Por dua të theksoj këtë: në ato kohë më pëlqenin më shumë ata shokë që shkruanin vjersha ose tregime. Më pëlqente shumë Lasgushi, Asdreni, Fishta, Koliqi, Fan Noli, Konica, Mjeda... Nga moshatarët e mi ose pakëz më të mëdhenj ishin Nologus, Vedat Kokona, Mitrush Kuteli, Helenau e të tjerë. Nga gazetarët më pëlqenin shumë Kostë Çekrezi, Nebil Çika, sidomos Brumbulli (Gjergj Bubani), Vangjel Koça, Ismet

Toto... Nga shokët revolucionarë takohesha me Demir Godellin, me Vasil Shanton. Demiri më njohu me shumë të tjerë, si me Asim Vokshin, Mane Nishovën, Zef Malën e të tjerë. Dy pra ishin kategoritë e njerëzve që më pëlqenin, ata që shkruanin dhe ata që ishin revolucionarë.

Më poshtë do të flas gjatë për këta.

Pyetje: - Po si e përballoje jetën?

Përgjigje: - Keq e mos më keq. Daja e mbylli kafenenë, se falimentoi. Kushëriri-marinar që më jepte nga gaveta e tij, ishte liruar. E shtyja si të tjerët, herë me bukë e herë pa bukë, por e keqja më e madhe ishte se mërdhija shumë: isha fare lakuriq, me tesha të lehta e të vjetëruara, me këpucë të grisura. Mbaj mend se Demiri më dha një këmishë të përdorur: ishte e Asimit, i cili më kishte ftuar edhe në familjen e tij. Ishte i mirë Asimi, toger i xhandarmërisë, simpatik dhe me fjalë pak. Ai rrallë shihej në Tiranë.

Pyetje: - Kur u emërove mësues dhe si?

Përgjigje: - Kjo është ngjarja më e madhe e jetës sime e vitit 1932. E mbaj mend si sot dhe, kur kaloj andej nga pallatet e ministrive, u them të njohurve e sidomos familjarëve të mi: Ja, këtu, në këtë vend, qëndroja unë më 20 shkurt të vitit 1932. Ngrohesha në diell, në muret e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ishte ora dymbëdhjetë. Ora e Tiranës tingëlloi dymbëdhjetë herë.

Dhe menjëherë turma e nëpunësve doli nga zyrat dhe u drejtua për të ngrënë drekën. Unë i shikoja si dilnin dy e nga dy e tufa-tufa. Ishte ora 12 e njëzet shkurtit të vitit 1932. Vazhdoja të rrija në diell dhe të shihja turmën e nëpunësve që dilnin nga zyrat. Ministrat ua hipnin veturave të zeza. Herën e parë doli ministri i Financës, që e kishte zyrën karshi Ministrisë së Arsimit dhe të Drejtësisë. Pastaj doli ministri i Drejtësisë. Pastaj doli ministri i Botores, që i kishte zyrat karshi Ministrisë së Brendshme, kryeministri, ministri i Brendshëm, ministri

i Luftës e me radhë. Unë i urituri, i mbetur rrugëve, mendoja shumë gjëra të çuditshme, kur shihja këta ministra! Kur ja, doli dhe ministri i Arsimit. Vetura e tij kaloi pranë meje. Pastaj u ndal. Ministri çeli dritaren e veturës dhe ma bëri me dorë t'i afrohesha. Ai më tha: "Djalosh, pse nuk shkon të hash?" U ndodha fare bosh dhe nuk e di si më dolën nga goja këto fjalë: "Hani ju për ne, ekselencë!" - dhe më dolën lot e ika me vrap...

Disa herë i kisha shkuar në zyrë ministrit të Arsimit, Hilë Mosit, për bursë, për ndonjë punë. Muaj të tërë...

Pasdreke shumë shokë mblidheshim te kopshti mbretëror. Uleshim të lodhur në bankat e ftohta, nën pemët e zhveshura. Bënim dhe qyfyre. Nonda na kallëzonte se si kishte njohur një jevgë të trashë andej nga Brraka, ku ai shkonte shpeshherë. Dhe na tregonte se si i kishte dhënë të pinte një gotë raki. Ndërkohë na doli përpara shoferi tullac i Hilë Mosit.

- Ti, ti atje, me flokë kaçurrelë, eja, se të kërkon urgjent ministri i Arsimit!

Shtanga. Të gjithë shtangën.

- Eja shpejt, shpejt, - përsëriste shoferi.

U ngrita. Kur ai më tha të futesha në veturë, u habita. Ishte hera e dytë që hipja në një veturë. Dëgjova shokët të bërtitnin pas veturës: "Aman, thuaji dhe për mua! Mos harro! Thuaji edhe për ne! More vesh? Mos harro!" Mendime të mira, po dhe mendime të nxira: "Po sikur të më burgosë për fjalët që i thashë." "Hani ju edhe për ne, ekselencë"? Mendimet më turbullonin kokën. "Punë e madhe! Le të më burgosin! Thonë se në burg të japin bukë!"

Vetura u ndal përpara derës së Ministrisë. "Zbrit, - më tha shoferi - dhe eja pas meje!" E ndoqa pas duke hipur shkallët. Iu afruam derës së ministrit. Trokiti. I pari hyri ai. Pas tij, unë. "Ja, jua solla!" - i tha dhe u largua. Hilë Mosi u ngrit në këmbë dhe më pa nga këmbët deri te koka:

- Ti je ai Petro Marko që shkruan vjersha dhe novela?

- Po, - i thashë.

- Po ç'kërkon nga unë? - Nisi të shëtiste. - Unë, - dhe më shikonte në sy, - nuk hëngra drekë sot!

Unë mendoja: "Si nuk e di se ç'kërkoj unë nga ai? Sa herë ia kam thënë e stërthënë!"

- Unë më parë kërkoj nga ju ndonjë bursë! - i thashë. - Po bursat i marrin ata që kanë miq. Pastaj ju kërkoj ndonjë punë! Unë nuk kam miq...

Ai më tha të ulesha. Më shikonte me sy të mallëngjyer. Binte dhe erë raki!

- Dëgjo këtu, o Petro Marko! - dhe u ngrit më këmbë. M'u afrua dhe më vuri dorën në kokë: - Unë nuk kam djem. Kam vetëm vajza. Që sot e tutje ti je djali im! - dhe nisi të shëtiste në dhomën e madhe. - Po, unë do të të dërgoj ty në vjeshtë ku të duash, në Vjenë, në Paris, në Romë për studime, po. Po tani ç'duhet bërë me ty?

Më dukej sikur isha në ëndërr. A ishte në vete ai njeri, vjershat e të cilit i kisha lexuar, madje me zë, sipas muzikës së Shubertit? Më kujtoheshin vargje si: *Atje n'at vend të lamun/ me gjak t'arbnorit lirë,/atje një djalë asht vramun,/ atje mbet një ilir!*", ose: *Nëpër terr që lshonte nata, / ngarkue teshat kaliboç!/Nëpër pyll që s'ra kurr' sëpata,/ ndiqte rrugën një djaloç...*

- Po, - dhe më përkëdhelte flokët, - ka për të të çue lala ku të duesh ti! Por tani, tani ç'duhet ba?. - I ra ziles. Hyri roja. I tha:

- Thueji Luigjit të vijë këtu!

Isha si mbi re. Nuk besoja asgjë. "Do të ketë pirë shumë, i ziu, dhe s'di se ç'thotë. Shyqyr që nuk ma mori për keq atë që i thashë..."

Hyri Luigj Shala, i gjatë dhe impozant, ai që nuk më besoi për gjeografinë. Më hodhi një shikim të shpejtë. Hilë Mosi i foli gjermanisht dhe kështu vazhdoi biseda midis tyre. Unë nuk kuptoja gjë. Hilë Mosi m'u drejtua:

- Gjer në vjeshtë do të shkosh si arsimtar në shkollën industriale të Korçës. Do të marrësh një rrogë të mirë.

Luigj Shala i foli gjermanisht.

Hilë Mosi foli shqip:

- Në Korçë jo! Se ajo shkollë është italiane dhe profesorët janë veshur mirë. Kurse ti...

"Filloi i dehuri me përrallat," - mendoja unë. Nuk besoja për ato që më thoshin.

- Më mirë është që ti të shkosh mësues në fshatin tënd gjer në vjeshtë. Aty rrogën e ha me familjen tënde! Si thua? Mirë?

Nuk flisja fare. Ata bisedonin gjermanisht.

M'u drejtua Luigj Shala:

- Më mirë është kështu. Shko në fshatin tënd, se në Korçë, me atë shoqëri, me ata kolegë... Si thua, pranon?

- Ku të doni më çoni, - u thashë, - vetëm të filloj nga puna!

Hilë Mosi u ngrit. Erdhi dhe më përkëdheli faqet. Më puthi në ballë dhe më tha:

- Tani ikë shpejt e na sill dy fotografi për dekretin!

Dola jashtë. Ishte errur. Shokët më prisnin.

As unë nuk e di pse vrapoja. Shokët më vinin pas duke më pyetur: "Ç'ka ngjarë?" Kur arritëm te sheshi para Bashkisë, u ndala. Ishte errur mirë. Atje m'u kujtua se në atë kohë fotografët nuk punonin (ata që rrinin aty, nga e majta e Bashkisë, me ato aparate të mëdha në krahë). Mora frymë dhe u ktheva nga shokët. Nonda, Sulejmani, Bariu e ca të tjerë gjimnazistë më bënin një mijë pyetje dhe, kur u tregoja se ç'më kishte ndodhur me Hilë Mosin, nuk më besonin. Bariu i gjorë tha:

- Tallen me ty!

Duke ecur, bisedonim rreth kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme.

- Hilë Mosi është poet, - u thosha, - dhe nuk tallet!

- Do të ketë qenë tapë. Se ai pi shumë! Kur të shkosh nesër, s'ka për të të njohur. Ke për ta parë.

- Ndodhin dhe çudira!

- Mos është edhe Hilë Mosi...?

- Jo! Jo! - bërtita unë. - Ai është poet. M'u soll sikur të isha djali i tij!

- Po pse? Ç'i hipi atij të të bëjë djalë ty, u çmend? Një ministër të bëjë djalë një varfanjak, një të mjerë si ne?!

- Po ai është patriot!

- Ku ka patriotë në ministri!

- Patriotët janë... në burgje!

Biseduam gjer vonë, edhe kur shkuam në një barakë ku flinim, gjersa na zuri gjumi. Unë isha si mbi re. Bisedat me shokët e mi ma prishën ëndrrën! "Patjetër nesër s'ka për të më njohur! Sidomos ai Luigj Shala, që më mohoi fitoren e konkursit për gjeografinë!"

Shumë vonë më zuri gjumi. Nuk kisha parë asnjë ëndërr, që të gjykoja për sa më prisnin. Se unë shihja ëndrra profetizuese. U ngrita dhe u thashë se do të shkoja te një fshatar imi që shiste verë e raki, të më jepte pesë lekë borxh për fotografitë. Shokët qeshnin me mua. Nuk besonin asgjë.

Me fotografi ende të lagura, shkova në ministri. Më pa shoferi tullac, m'u afrua, më buzëqeshi dhe më tha:

- Të do shumë ministri, të do sikur të të kishte djalë. I bëre fotografitë? Eja të shkojmë lart. - I pari hyri ai në zyrën e ministrit. Pas tij edhe unë. Hilë Mosi diçka lexonte. Sapo më pa, u ngrit më këmbë dhe m'u afrua. Më hodhi dorën në sup. I dhashë fotografitë.

- Eja këtu për... për tri ditë, se do ta dërgojmë emërimin në Kryeministri.. Pas tri ditësh eja këtu, more bir!

"Domethënë nuk është tallur me mua! Domethënë unë po emërohem mësues! Pra, mbaroi kalvari im! Domethënë do të jem edhe unë me rrogë!"

Ato tri ditë qenë shumë të gjata për mua, siç qenë të gjata dhe planet që bëja. Takova Demirin, i thashë se

ç'më kishte ngjarë, dhe ai, i gëzuar, më tha:

- Hilë Mosi është patriot, është idealist, është shumë i ndershëm!

Ditën e tretë u gjenda para ministrisë në kohën kur futeshin nëpunësit. Ishte shpejt. Dhe ja, erdhi dhe vetura e ministrit. Doli dhe, sapo më pa - se i dola përpara - më tha;

- Eja me mua! - Asnjë fjalë tjetër. U ngjitëm shkallëve. Me të hyrë në zyrën e tij foli: - Dekretin e morëm qysh dje! - U ul dhe nxori nga sirtari dekretin e emërimit tim si mësues në shkollën e Dhërmiut, të nënprefekturës së Himarës.

- Ulu, - më tha pasi më dha dekretin. E shikoja! Ai thirri llogaritarin, njëfarë Berberolli. Një burrë i gjatë. I tha:

- Të bësh një dëftesë për shpenzime udhëtimi Tiranë--Himarë, njëqind franga!

Berberolli iu përgjigj:

- Shkëlqesi, shpenzimet e udhëtimit Tiranë-Himarë nuk janë 100 franga, por njëzet e pesë.

Dhe Hilë Mosi:

- Si po të urdhëroj unë, ashtu të bësh ti! Njëqind franga, dhe silli këtu! - Doli Berberolli dhe ministri më fliste me zë të ulët. Më dukej i mërzitur, i lodhur. Mbaj mend se më dha disa porosi për punën time të përkohshme, se do të më dërgonte me bursë jashtë shtetit. Veçanërisht, më porositi:

- Të shkruesh vjersha. Vjersha asht shprehja ma njerëzore e mendimit dhe e zemrës.

Erdhi Berberolli me të njëqind frangat, të cilat i mora pasi nënshkrova. Ai u largua. Hilë Mosi u ngrit në këmbë.

- Tash, more djalë, të kjoftë udha mbarë! Me këto pare vishu mirë, me kostum, me këpucë, dhe shko në fshatin tand! Më shkruej! - Dhe më përqafoi.

Kur shkova në fshat, i veshur dhe i mbathur, u

paraqita në shkollë.

Drejtori im, Naqe Konomi, më priti mirë. Ai më deshi shumë, ai më pati çuar në Shkollën Tregtare me bursë. Më tha se ishte në dijeni, pasi vetë Hilë Mosi kishte telegrafuar pak a shumë me këto fjalë: *Ju vjen aty si arsimtar djaloçi vendas Petro Marko. E ngarkoni me punë që mund t'i bajë, si gjimnastikë, kangë ose dhe lexime, se ai ka me shkue me bursë jashtë shtetit në vjeshtë.*

Pyetje: - Si i gjete në shtëpi njerëzit e tu?

Përgjigje: - Gjeta mama Millen, së cilës i kisha blerë një palë çorape të zeza, një shami të zezë dhe pesë metra cohë për fustan e pollkë të madhe, si dhe një shishe konjak "Metaksa." Më puthi me lot në sy. Gjeta motrën Lilo, së cilës gjithashtu i kisha blerë stof për fustan dhe një shami të zezë. Kisha dhe dhurata të tjera për kushërirat, për plakat. Dy vëllezërit, Andoni dhe ai pas meje, Agjisilla, punonin si ndihmësshoferë. Gjithë farefisi im u gëzua pa masë: xha Foti, xha Petro Gjoni, xha Mantho Bua e të tjerë mburreshin që unë vajta në fshat si mësues.

Për ne nisi një erë e re: në dyqan tani na jepnin borxh, sa të merrja rrogën, prandaj, sipas zakonit, hynin e dilnin thuajse gjithë fshatarët. Liloja, dorëlëshuar siç ishte, blinte ditë për ditë raki, verë, mish, cigare dhe piqte byrekë në furrë. Shtëpia nisi të gjallërohej dhe të vdekurit nuk përmendeshin më.

Me këtë rast dua të bëj një parantezë për karakterin e fshatarëve të mi: para një viti kishte rënë tërmet. Shkaktoi dëme të mëdha, madje edhe të vdekur. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe shtetet fqinje dërguan ndihma të mëdha. Vodhi qeveria, vodhën autoritetet e Vlorës, vodhën autoritetet e Himarës, vodhën autoritetet e fshatit, po mbeti dhe për fshatarët. U nda miell e sheqer, makarona e kuti mishi, voza me sardele, tesha, mbulesa dhe para. Neve, për një të çarë të murit, na dhanë dyzet

napolona. Kështu që fshati i madh, pasi ra në bollëk, harroi të vdekurit dhe me atë bollëk kërciste vera e rakia, byrekët, shqerrat e kecërit e pjekur! Hanin, pinin e këndonin si në dasma. Mirëpo për pak muaj i mbaruan dhe nisën të qanin të vdekurit... Dhe ngjau shakaja më e madhe e atyre viteve: Prifti Parthemo, që ishte dhe shakaxhi, pasi bënte meshën një të diel në kishën e madhe të shën Spiridonit, doli me kryqin e madh aty në mes të dyerve të ajodhimës dhe bërtiti:

- Gjunjëzohuni!

Të gjithë u llahtarisën dhe u gjunjëzuan.

- Tani, - thirri ai, - lutuni të na vijë tërmeti tjetër, se i mbaruam!

Po tërmeti tjetër nuk erdhi. Erdhi përsëri lufta për bukën e gojës.

Unë ia çoja mirë. Mësuesit e mi, Naqe Konomi, Gaqe Kaporra, Pavllo Vretoja e të tjerë, më deshën. Edhe nxënësit më deshën shumë. Por ky gëzim nuk zgjati. Ato ditë të marsit të vitit 1932, në Dhërmi, fshatarët këndonin, pinin dhe thërrisnin: "Nuk paguajmë xhelepe!". Gjurulldi: Njëfarë demonstrate masive kundër qeverisë, që kishte urdhëruar të paguheshin të dhjetat. Mirëpo historia e venomeve ishte shekullore. Himara i kishte fituar këto venome qysh nga shekulli XVII, nga sulltani, dhe as venome paguante, as nizam nuk shkonte. Në kohën e Fan Nolit shkuan forca ushtarake për t'i detyruar himarjotët të paguanin. Komandoheshin nga Azis Çami. Ishte koha kur vilej rrushi. Himarjotët nxorën gratë për të vjelë rrushin. Ushtarët dhe xhandarët i ndaluan; këto u përleshën me ta dhe u vranë nga të dyja palët. Për këtë ngjarje u ngrit dhe kënga: *Seneja njëzet e katër/ në Himarë u bë hata,/ doli populli të vjelë,/ qeveria nuk e la/. Qeveria s'bëri mirë/ që ndezi luftë me gra... Pesëqind vjet me Turqinë/ mot për mot bëjmë dava,/ po Himara, sa të rrojë,/ xhelep e të dhjeta s'ka...*

Këtë këngë e këngë të tjera i këndonin burrat, që gjithë ditën pinin verë e raki. Edhe shkolla u mbyll. U hap fjala se do të vinte vetë kryeministri. Naqe Konomi më tha:

- Do të flasësh ti, se ti je brezi i ri me kulturë. Prandaj merr letër dhe shkruaj. - Ai më diktonte dhe unë shkruaja historikun e Himarës, luftërat kundër Turqisë, fitoren e venomeve dhe... ardhjen e mbretit Zog, i cili i kishte premtuar Himarës se, sa të ishte ai monark i Shqipërisë, Himara nuk do të paguante xhelepe. Pasi i shkrova ato që më diktoi Naqe Konomi, dëgjova të më thoshte:

- Janë disa ngatërrestarë që duan të na përçajnë, po ne e kemi me të drejtë. Mbreti një fjalë ka. Kur të vijë kryeministri Koço Kota, ti fol në emër të fshatit, se të përket.

U përhap lajmi se vinte kryeministri me shumë personalitete nga Tirana dhe nga Vlora. Burrat kërcenin në xhade valle burrërie. Në vend të shamisë, ai që hiqte vallen, kishte flamurin e Shqipërisë.

U dëgjuan makinat që vinin. Vallet u ndezën në mes të xhadesë.

Makinat u binin borive, që të largoheshin njerëzit nga mesi i xhadesë. Po një prift, më duket Parthenoja, bërtiti:

- Dale të mbarohet vallja!

Pasi mbaroi vallja, dolën nga makinat: kryeministri Koço Kota, ministri i Punëve të Brendshme Musa Juka, prefekti i Vlorës dhe autoritete të tjera. Kishte ardhur nga Përmeti dhe një kompani xhandarësh, që kishte rrethuar fshatin. Dhe burrat e pirë vinin shishen e rakisë në kokë dhe u bërtisnin xhandarëve:

- Shko njëqind metra dhe merr shenjë shishen mbi kokën time! E godet? Provoje...

Ra një heshtje e madhe. Koço Kota foli i pari:

- Ç'keni, more të uruar? Ç'bëni kështu? Kush ju nxit

të silleni kështu? Jemi një shtet dhe nuk jemi pazar. Pse nuk shkoni në punë?

Naqe Konomi ma bëri me shenjë që të dilja dhe të flisja. Dola pakëz përpara, nxora nga xhepi ligjëratën dhe nisa:

- Shkëlqesë!

Mbaj mend se Marko Kuçuli, një kushëri imi, i dehur, thirri me të madhe: "E ç'do me thënë çkëlqesë?" Zëra të tjerë u dëgjuan: "Njerëz që shkëlqejnë!" Pasi thirra disa herë që të pushonin, vazhdova të lexoja ato që më kishte diktuar Naqe Konomi...

Në ato që lexoja unë, përmendej shpeshherë mbreti si njeri që e donte Himarën, që kishte premtuar se, gjersa të ishte ai në fuqi, Himara nuk do t'i paguante të dhjetat, prandaj hera-herës masa shpërthente me "Rroftë Mbreti!"

Koço Kota, kryeministri, tha se mbreti na kishte në zemër, prandaj edhe ne duhej ta kishim në zemër, duhej të venim në punë, të mos bënim "potere", "gjullurdira", "anarshira" e të prishnim rendin dhe unitetin e regjimit. "Dërgoni një delegacion te mbreti dhe, pasi ju keni besim të madh tek ai, merruni vesh me të. Ai do t'ju këshillojë dhe udhëzojë se si duhet të silleni!" Kështu u la që të shkonte te mbreti një delegacion. Vajti, më duket, ja Jorgo Bollani, ja Naqe Leka. Më vonë u përhap në Himarë se ç'kishte ndodhur:

Delegatin e Himarës nuk e shoqëroi te mbreti deputeti ynë, se kishte frikë. Ishte një punë me spec. Ai e shpuri gjer te dera e pallatit. E kishte pritur një adjutant i mbretit dhe e kishte futur në pallat, në sallën e pritjes. Kishte dalë një njeri i veshur pastër, civil, dhe kishte pyetur delegatin e Himarës ç'e donte mbretin. Ky i kishte thënë se kishte punë dhe se e kishte dërguar krahina. Ai i ishte përgjigjur me fjalët:

- Ju jeni rebelë, ngatërrestarë, kërkoni turbullira, të shkelni statutin e mbretnisë.

- Unë nuk kam punë me ju, more zotni, unë kam fjalë me mbretin.

- Ju nuk e kuptoni damin e madh që po i sillni mbretnisë!

- Më falni, unë fjalë nuk kam me ju (megjithëse e njohu që ai ishte vetë mbreti), po me atë mbretin tonë të shtrenjtë dhe të madh!

Dhe Zogu i tha:

- Unë jam vetë mbreti!

Atëherë delegati i Himarës foli:

- Ju nuk mund të jeni mbreti, se, siç folët ju, nuk mund të flasë kurrë një mbret!

Ndërkaq mbreti thirri:

- Ç'do të thuash me këtë? Nuk beson se unë jam mbreti?

- Jo! Nuk ka mbret në botë që të marrë mbrapsh vendimet e tij. Mbreti një fjalë ka: po, jo! Ju, nëse pretendoni se jeni vetë Zogu i Parë, mbreti i shqiptarëve, më falni, po... unë them se nuk jeni për mbret, pasi e ktheni një herë ashtu e një herë kështu!

Mbreti u zemërua pa masë dhe i bërtiti:

- Ju jeni njerëz të rrezikshëm! I keni sjellë telashe edhe sulltanit, edhe çdo qeverie, po me mua s'ka tërc-mërc!

- E morëm vesh! Ju nuk mund të jeni monark, ashtu siç u kemi përfytyruar...

Dy njerëz që ishin prapa delegatit të Himarës, i kishin hedhur duart në sup dhe i kishin thënë me inat:

- Çën! Eja me ne! - E kishin mbërthyer mirë dhe e kishin zvarritur! Delegati kishte psherëtirë: "A ç'mbret paskemi ne të mjerët!"

Zogu kishte urdhëruar dy oficerët ta linin të lirë. I ishte afruar dhe i kishte shtrënguar dorën duke i thënë:

- Bëra një provë! Kisha dëgjuar që jeni kryelartë, që jeni burra. Dhe ja, ashtu më doli! Gëzohem, more burrë, me karakterin arbnor të himarjotëve! - Eja me mua! - E

kishte mbajtur për drekë dhe e kishte dërguar me veturë në Himarë, duke i thënë:

- Gjersa të jem unë, Himara do t'i gëzojë venomet si kurdoherë. E meriton!

Himara ato ditë ishte në festë: këngë, valle, verë, raki dhe thirrjet "Rroftë Mbreti!".

Pas dy javësh vjen një thirrje në shkollë: *Naqe Konomi dhe Petro Marko të paraqiten te nënprefekti për një çështje shumë të rëndësishme!* Naqe Konomi mbi mushkë, unë pas tij, iu drejtuam Himarës. Kur hymë te zyra e nënprefektit, u tmerrova, se ai u ngrit më këmbë dhe me zë të çjerrë thërriste:

- Mirë ky, - dhe më tregonte mua, - që është një subversiv, po ti, ti, goxha plak, si u bëre edhe ti subversiv?! Naqe Konomi ishte një burrë i mençur, i pjekur, i qetë, po, kur zemërohej në klasë, bëhej bishë kundër atyre që nuk i bindeshin ose që ishin të pandreqshëm, tërbohej dhe i rrihte me shufër sa mundej. Po atje? Atje u bë një mijë herë më bishë. Bërtiti:

- Kujt, more, i thërret ti kështu! Mor jevg i Leskovikut! Mor servil dhe xhandar i bejlerëve dhe i agallarëve! Ku je këtu, more edepsëz?! Këtu je në Himarë, ku njerëzit nuk kanë pjerdhur për sulltanë e vezirë e monarkë dhe jo për ty, mor jevg servil e dallkauk...! Papaliloja - ashtu quhej nënprefekti nga Leskoviku - ai që bashkë me gjykatësin nga Leskoviku kishte marrë vendim në favor të Gorecit që të merrnin edhe bahçen tonë, u struk dhe nuk nxori fjalë nga goja. Naqe Konomi më kapi për krahu dhe dolëm jashtë.

Nuk ndenjëm fare në Himarë. Ai ia hipi mushkës, dhe unë pas tij, arritëm në Vuno, në shtëpinë e tij. Aty hëngrëm dhe fjetëm. Më fliste për padrejtësitë e mëdha, për dallkaukët, për spiunët, për regjimin e hurit dhe të litarit dhe përfundonte:

- Ka Shqipëria, ka djem të zotë dhe të ndershëm, ka

patriotë dhe idealistë, prandaj mos u dëshpëro. - Ai fliste dhe mua më kujtoheshin Demir Godelli, Asim Vokshi, Vasil Shanto e të tjerë shokë që kisha lënë në Tiranë.

Pas një jave erdhi mandata: Unë transferohesha për në Dhuvjan të Dropullit, dhe plaku Naqe Konomi, që gjithë jetën kishte qenë mësues në Dhërmi dhe Himarë, transferohej në Dhrovjan të Delvinës. Këto ishin masa administrative të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me paralajmërimin: po të vazhdonim të ishim subversivë, do të merreshin jo masa pushimi, por të tjera, më të rënda...

Pyetje: - Menjëherë shkove në Dhuvjan?

Përgjigje: - Jo! Naqe Konomi shkoi në Vlorë. Kur u kthye, më tha se, meqë për një muaj mbaronte viti shkollor, duhej të qëndronim në Dhërmi gjer në fillimin e vitit të ri shkollor, domethënë gjer në fund të gushtit...

Familjes sime i erdhi keq që unë do të ikja nga fshati. Fjala u përhap kudo se transferimi ynë ishte një masë dënimi, një masë administrative për ligjëratën që mbajta kur erdhi Koço Kota në Dhërmi, dhe për nxitjen që u bënim fshatarëve të ngriheshin kundër regjimit. Ishim shënuar me bojë të kuqe në zyrat sekrete si subversivë...

Plaku Naqe Konomi përpiqej të më qetësonte:

- Ti je i ri! Tani e ke nisur rrugën tënde. Ke pengesa përpara, ke mundime përpara, ke masa administrative përpara, por ec përpara me shokët për të cilët më ke folur: ua kam dëgjuar emrin. Mos u ndaj nga ata. E mban mend kur unë ju thashë në klasë se sot ka dy profetë: Lenini dhe Gandi? Po! Mbaje mend, Lenini vdiq, po fryma e tij, ideja e tij, rruga që ai çau, nuk vdes kurrë. Kemi edhe ne njerëz jashtë. Kemi Fan Nolin, kemi Halim Xhelon... kemi patriotë dhe kryengritës sa të duash. - Më fliste i urti, i mençuri, i patremburi, mësuesi im Naqe Konomi. Mbaj mend edhe këtë:

Ishte dita e fundit për ne si arsimtarë në shkollën tonë.

- Dëgjo, more Petro, të them Petro tani, se je burrë. Dëgjo! A e ke vënë re se ç'bëjnë zotërit (zot i thoshim gjyshit) te djepi i një mashkulli, kur pagëzohet dhe i vënë emrin? Shkojnë pranë djepit dhe me një shpatë ose hanxhar i bien tri herë kreut të djepit duke thënë: "T'u ndiftë emri, more bir!" Këtë e thonë me kuptim të mirë, domethënë t'u dëgjoftë emri për mirë dhe jo për të keq. Domethënë u bëfsh i gjallë, i zoti, aktiv, kapedan! More vesh? Prandaj mos u mërzit kur të hasësh në pengesa dhe masa administrative. Qëndro besnik i shokëve, i idealit, i popullit, i Shqipërisë! - Këto porosi të mësuesit të dashur Naqe Konomi jam munduar t'i zbatoj gjatë gjithë jetës sime.

Pyetje: - Vajte në Dhuvjan?

Përgjigje: - Vajta. U nisa nga fshati me makinën që shërbente si korrierë Vlorë-Sarandë, ku ngarkova dengun e madh me shtresa e mbulesa, ashtu siç bënin nëpunësit e shkretë, që shpeshherë transferoheshin nga një qark në tjetrin. Nga Saranda, me korrierën Sarandë-Gjirokastër, udhëtova gjer në Sofratikë. Më poshtë, nja pesëqind metra, ishte një dyqan si han, ku ndaleshin Dhuvjanitët, se fshati ishte lart, në grykë, anës një përroi të gjerë e të thatë. Disa fshatarë e kuptuan që unë isha mësuesi. Më folën greqisht dhe dërguan në fshat për ndonjë kafshë, që të merrte dengun e shtresëmbulesave. Ishte pasdreke. Më shpunë në oborrin e shkollës. Pas pak erdhi edhe kryeplaku, një burrë i mirë, Kostë Lanidhi. Më përshëndeti dhe më tha se do të shkonim shumë mirë, pasi fshati e donte shkollën dhe i nderonte shumë mësuesit. Më tha se isha mësues pa mustaqe dhe qeshi.

Ishte pasdreke vjeshte. Ndenja pakëz në derën e shkollës dhe kundrova fshatin. Shumë gra, vasha e plaka, kishin dalë për të më parë! Ishte hera e parë që vinte këtu një mësues pa mustaqe, i ri, nëntëmbëdhjetëvjeçar. Në mes ishte përroi, kurse në pllajën kundruall shkollës,

kishës dhe varrezave, shtrihej fshati Dhuvjan. Më parë se të vija këtu, kisha dëgjuar se ishte një fshat i bukur, i pastër, si të gjitha fshatrat e Dropullit dhe të Himarës. Shumica ishin shtëpi dykatëshe, pa pemë. Erdhën disa pleq dhe më flisnin greqisht. U gëzuan pa masë që isha nga Himara dhe që e dija greqishten. Më pyeti kryeplaku nëse dëshiroja të shkoja për darkë tek ai, por unë isha i lodhur dhe mjaft i emocionuar. Hipa lart, në katin e dytë të shkollës. Nga e djathta ishte dhoma e fjetjes së mësuesve dhe një sallë e madhe për mësim, që kishte në krye dërrasën e zezë. Kryeplaku më tregoi edhe llambën e vajgurit dhe e kontrolloi nëse kishte vajguri. U larguan dhe unë ndenja ca në dritare, për të kundruar fshatin. Dritaret zunë të ndritnin nga llambat e ndezura. Zhurma po fashitej, gjersa ra qetësi e plotë. Shtrova për të fjetur dhe rashë. Gjumi më zuri shpejt.

Natën u zgjova se më grinë çimkat. Ndeza llambën dhe pashë se çarçafët nxinin prej tyre. I shkunda, i shkunda, po ku mbaronin! Të tjera dilnin si milingona. Rrëmbeva dyshekun dhe velenxën dhe dola jashtë. Pashë aty nga e djathta një varr si shtrat, shtrova dhe rashë për të fjetur. Në mëngjes, plakat kishin zakon që vinin e ndiznin kandila në krye të varreve. Më panë dhe u llahtarisën. Shkuan dhe lajmëruan kryeplakun dhe dhimojerondinin: "Është bërë lugat papa Vlashi". - Kishin ardhur të gjithë dhe ishin rreth varrit mbi të cilin unë flija me kokë të mbuluar, për t'u mbrojtur nga vesa e mëngjesit. Pastaj, gjumi më kishte zënë shumë vonë. Kur zbulova kokën dhe pashë njerëz rreth meje, u çudita. Dëgjova kryeplakun të më thoshte:

- Na llahtarise, more dhaskal! Kujtuam se na ishte bërë lugat papa Vlashi.

Pashë plakat të bënin kryqin dhe kalamajtë të shkuleshin së qeshuri.

Pas disa ditësh erdhën edhe dy kolegët e mi:

Muharrem Ahmati, nga Sasaj i Sarandës, dhe një nga Gorica e Dropullit. I pari - kryemësues, i dyti - mësues i greqishtes. Ishte viti i parë i punës aty. Me Muharremin menjëherë u miqësuam. Ai u gëzua pa masë, kishte lexuar tregimet dhe vjershat e mia. Ai kishte mbaruar normalen e Elbasanit. Tjetri na shikonte me dyshim. Ai kishte mbaruar shkollën fetare në Vella, ku përgatiteshin "ushtarë" të *megali idhesë*, një shkollë fetare propagandistike, mu në kufirin tonë. Muharremi qysh ditët e para nuk e honepste atë dhaskal. Unë hoqa nga klasat ikonat e shenjtorëve dhe vizatova vetë (më jepej për të vizatuar) Ismail Qemalin, Skënderbeun dhe Zogun e Parë. I zmadhoja nga fotografitë, me katrorë, bardhezi, me laps. Fshati u zemërua shumë. Erdhi kryeplaku, dhimojerondini, dhe më thanë:

- Po ti je i krishterë, nga Himara, si e bëre këtë punë? - U thashë se në Himarë nuk mbanin ikona shenjtorësh në klasa, po Gjikë Bixhilin dhe portretet e Skënderbeut, Ismail Qemalit dhe të Zogut të Parë. U thashë se i kisha shpënë në kishë, se aty e kishin vendin. Me të mirë, i binda se shkolla nuk ishte private, por e shtetit shqiptar. Ata mblidhnin buzët.

Me Muharremin shkonim bashkë në Gjirokastër, ku njoha Zenel Hekalin, Jorgji Meksin, Vangjel Koçën, Ramiz Harxhin, Xhevat Kallajxhiun e të tjerë... Fillova të shkruaja në gazetën "Demokracia". Vangjel Koça më njihte nga shkrimet që kisha botuar tek "Ora", "Leka" e gjetkë.

Në gjithë fshatrat e Dropullit kishin ardhur mësues të rinj, shumica nga normalja e Elbasanit. Në Derviçan ishte dhe Sterjo Spasse, i cili gëzua pa masë kur më pa, se më njihte nga shkrimet. Edhe ai shkruante. Në postëkomandën e xhandarmërisë ishte një kapter nga Kuçi, Bejkush Gjoleka, me të cilin u bëmë vëllamë. Aty më erdhi dhe Asim Vokshi, i cili ishte toger i xhandarmërisë së qarkut, po me shërbim në Sarandë e Delvinë. Asimi u gëzua pa masë; edhe unë gjithashtu. Kur u

ndamë, më tha të takohesha shpesh me Zenel Hekalin, më dha dhe disa libra greqisht. Kur i hapa, pashë: "Protopori", organ i rinisë komuniste greke. "Mos ia trego njeriu," - më porositi. Siç më tha, do të më sillte shumë literaturë. Ai ishte në Sarandë, ku censura nuk lejonte literaturë revolucionare, dhe, ato që ndalonte dogana, i merrte Asimi. U gëzova shumë.

Pyetje: - Më parë na fol për jetën në shkollë, në fshat! Cilat qenë përshtypjet e para? Si punoje? Si shkoje me kolegët, me nxënësit, me fshatarët? Po me autoritetet?

Përgjigje: - Unë jepja gjeografi, gjuhësi në klasat e katërta dhe të pesta, bëja gjimnastikë, këngë dhe mësim shtetëror. Në dhomën e sipërme, ngjitur me atë ku flinim, bëhej mësim për klasën e pestë, të katërtën dhe të tretën. Dhoma poshtë ishte për nxënësit e shumtë të klasës së parë dhe të klasës së dytë. Kur bënim këngë, të gjithë nxënësit i mblidhja në dhomën e madhe të katit të parë. Kisha blerë dhe një mandolinë. Kisha blerë në fshat dhe një revolver "Golt". Meqë përmenda revolverin, dua t'u rikthehem disa kujtimeve nga Shkolla Tregtare.

...Kur ishim në maturë, na shpunë në Bari të Italisë, për të vizituar "Fiera del Levante", një ekspozitë që hapej për orientin. Ishte përurimi i asaj ekspozite që vazhdon të bëhet edhe sot çdo shtator. Kishte ardhur aty dhe mbreti i Italisë. Ne na shoqëronte Ernest Koliqi. Ishte hera e parë që dilja jashtë shtetit. Në Bari vizituam edhe universitetin dhe rektori na shtroi një koktej. Më kujtohet se, kur na dhanë panën, një gjë e re për ne, Koliqi na thoshte që ta hanim, se ishte e mirë. E afruam dhe filluam t'i frynim. Kujtonim se ishte e ngrohtë. Por, kur e vumë në gojë, pamë se ishte akull. Ne mbanim në kokë qeleshe të bardha. Një mbrëmje u kthyem vonë, se kishim shkuar në një shfaqje. U futëm në dhomë - banonim në një konvikt të vajzave - por dhoma qe e errët. Kërkuam shërbyesen, që të na ndizte dritën. Ajo erdhi dhe ç'të shihte? Llamba e elektrikut qe mbështjellë me qeleshen e bardhë

dhe me pantallonat e Bari Balës, i cili flinte... Ai u zgjua dhe na tha: "Aman, mos e ndizni, se mezi e zura atë dritë! Nuk më zë gjumi me dritë!" - Shërbyesja u shkul së qeshuri. Dua të shënoj këtu se ne s'dinim gjë prej gjëje nga jeta moderne. Ç'ngjau me Laze Ajazin? Doli nga banja duke thirrur: "Po mbytemi!" - Vrapuam të gjithë... dhe pamë se, kur ai kryente nevojën, ishte kapur nga teli që zbraz ujin për të larë nevojtoren. Uji kishte rrjedhur me forcë dhe ai kishte kujtuar se kishte plasur uji dhe po mbyteshim!

Gjithë ditën bënim vizita. Në panair merrte pjesë dhe Shqipëria. Vizituam pavijonin tonë: dy njerëz të veshur me kostume kombëtare, njëri me fustanellë e tjetri me brekushe, bënin rojë. Pavijoni ynë qe shumë i varfër: disa rrota sere të Selenicës, disa lëkurë, duhan dhe asgjë tjetër.

Hynim e dilnim te dyqanet e mëdha, por nuk kishm para. Me ata pak lekë që kisha unë, bleva një revolver, një "beretë" të vogël, dy metra cohë për gjyshen dhe një palë çorape për motrën. Revolverin e mbaja në xhepin e brendshëm të xhaketës. Kur u ktheva në fshat, u mblodhëm dhe e shikonim. Unë e mbaja në dorë. Andoni mbante në dorë karikatorin, Vangjeli shikonte tytën. Kur, nuk e di se kush e tërhoqi gishtëzën, plasi fisheku që mbante brenda. Shyqyr që plumbi i vogël goditi dorën e Andonit, që mbante karikatorin, i shpoi dy gishtërinjtë dhe pastaj i shkoi Vangjelit mu në vetull, rrëshqiti dhe i gjakosi lëkurën e kokës. Plasi gjaku. Gratë vunë ulërimat, se fytyra e Vangjelit u mbyt në gjak...

Pyetje: - Pse i kapërcen në kohë pa i renditur ngjarjet? Na fol për punën tënde në Dhuvjan! Si shkoje me nxënësit, me fshatarët,me autoritetet?

Përgjigje: - Me Muharremin shkoja shumë mirë. Por mësuesi i greqishtes na mërziste, se ishte dinak, frikacak,

mendjemadh. Më vonë u bë edhe psallt. Kur veja në kishë dhe dëgjoja atë që psallte, ia bëja me shenjë Muharremit, duke i treguar njëzet franga, pastaj ato njëzet franga ia tregoja mësuesit të greqishtes duke ia tundur. Muharremi shkulej së qeshuri... Po si t'ia bënim? E kishim koleg. Me ne hante, me ne flinte në një dhomë... Ç'bënte ai? Kishte një enciklopedi greke sa një ungjill. Kur na vinte ndonjë fshatar për vizitë, ai e hapte atë enciklopedi dhe dukej sikur kridhej në studime të thella. Dhe pse e bënte këtë? Se aty vajzat martoheshin me prikë të madhe, me para. Kështu që përhapej fjala se ai mësonte në libra të trashë, dhe kështu prika ngrihej. I thashë Muharremit:

- Dëshiron që ta bëj atë të ikë me vrap prej nesh?

- Aman, mos na bëj ndonjë skandal! - më tha i miri Muharrem!

Një pasdreke, po rrinim të tre para derës. I thashë mësuesit të greqishtes të shkonte e të shihte fasulet, se mos mbeteshin pa ujë. (Gatuanim lart, në dhomën ku flinim.) Ai nuk shkonte, se kishte frikë nga shejtanët dhe lugetërit, siç kishin frikë gjithë fanatikët e fshatit. Shkova unë, dhe ç'bëra? Këmishën e natës që më kishte qepur motra, të gjatë si raso, prej basme japoneze, e mbusha me tesha. E vendosa mbi një fron, të cilin e vura përballë derës. I bëra dhe një kokë me peshqirët, i vura mbi kokë borsalinën e Muharremit dhe në dorë, fshesën me bisht të gjatë. Dukej si dordolec. Zbrita poshtë. Vazhduam të bisedonim, pastaj i thashë mësuesit të shkonte lart e të shihte fasulet.

- E ku vete ai lart? - tha Muharremi.

- Jo, more, - i thashë unë, - Ai është intelektual dhe nuk ka frikë nga hijet...

Jo ka frikë, jo s'ka frikë, vumë bast me pesë lekë. Mësuesi i greqishtes dëgjonte dhe lëvizte me nervozizëm shufrën që mbante kurdoherë në dorë. Pas shumë hezitimesh ai vendosi të shkonte lart. Na pa një herë me

kokën lart, sikur do të bënte ndonjë heroizëm, dhe nisi t'u ngjitej shkallëve duke fishkëllyer një këngë dropullite. Muharremi nuk dinte gjë se ç'kisha punuar unë, prandaj qeshte. Veç kur u dëgjua një ulërimë në kupë të qiellit, therëse.

- Do t'i jenë derdhur fasulet në këmbë! - tha Muharremi dhe vrapuam lart.Mësuesi qe shtrirë pa frymë në dysheme. Unë e hoqa dordolecin me vrap. Muharremi u çorodit, kishte marrë shtambën me ujë dhe ia hidhte në kokë. Ai erdhi në vete. U ngrit dhe, duke vrapuar, thërriste:

- Papa Vlashi! Ishte këtu lugat papa Vlashi!

Iku drejt e te kryeplaku, i cili pas pak na erdhi në shkollë e na e pyeti nëse e kishim parë edhe ne lugatin. Ne rrinim seriozë dhe i treguam ngjarjen...

Kryeplaku iku duke tundur kokën. Ai tha se do t'i gjente një vend tjetër, pasi ai nuk pranonte të vinte më te ne. Atë natë do ta mbante në shtëpinë e tij.

Kështu na u hoq qafe ai që na bezdiste dhe na e bënte jetën shumë të mërzitshme me sjelljet e tij prej frikacaku, megallomani, servili, dallkauku. Muharremi qeshte dhe më thoshte:

- Je i madh! Kurrë nuk e mendoja se do të na e shporrje që këtej!

Do të tregoj shkurtimisht se si e kaloja në Dhuvjan:

Nxënësit më deshën shumë, se me ta sillesha si shok. Kisha krijuar një skuadër futbolli. Unë nganjëherë thirresha edhe në skuadrën e Gjirokastrës, ku luaja si mbrojtës. Bëmë një ndeshje me Delvinën dhe e mundëm. Terreni në Delvinë ishte shumë i keq, një lëndinë plot gurë dhe e pjerrët. Me nxënëset - ishin të rritura, shumë prej tyre përsëritnin klasën e pestë, se s'kishin ç'të bënin - shkoja shumë mirë; ishin të dashura, të sjellshme, visheshin bukur, si gjithë nxënësit, që qenë të pastër, të edukuar mirë. Bisedoja me ta. U mësoja dhe këngë himarjote si "Vajzë e valave" dhe këngë trimërie labe. E

kishin zakon të sillnin një dru në javë për mësuesit, por unë ua preva këtë zakon, se ata s'kishin dru për vete, ndaj shkulnin hunjtë e gardheve dhe na i binin neve për zjarr. Bëra kështu: një herë në javë me klasën e pestë shkonim në pyll dhe prisnim dru për shkollën. Krijuam dhe një kopsht dhe mbillnim zarzavate. Kur bëheshin shumë, ua ndaja nxënësve të varfër, që nuk kishin prindër në mërgim, se shumica e meshkujve të fshatit ishin në mërgim, në Amerikë.

Shumë propozime më kishin bërë që të fejohesha me ndonjë vajzë që kishte prikë të madhe. Por unë nuk e mendoja kurrë një gjë të tillë, kisha shqetësime të tjera...

Veja në dasma, që bëheshin të bukura, shikoja sa bukur kërcenin gratë e veshura me kostume fantastike e me florinj në ballë. Edhe në festat fetare, si për pashkë, gratë kërcenin, atje lart, në lëndinat e manastirit. Nuk harrohen ato kostume, ato valle, ato gra të bukura që kishin mbetur vetëm.

Unë, Bejkush Gjoleka e disa të tjerë, ngandonjëherë, kur vinte dhe Xhevdet Gjoleka, këndonim gjithë natën. Dhe gjithë natën gratë nuk flinin, po rrinin në dritare për të na dëgjuar. Këngët tona i mësuan edhe nxënësit, edhe fshatarët, dhe i këndonin. Gjersa isha unë aty, nuk u dëgjua asnjë fjalë për asnjë mësues e për asnjë femër. Ditët e para fshatarët nuk na deshën, se ndryshuan mësimet, bëheshin në gjuhën shqipe. Në orën e mësimit shtetëror i kështilloja nxënësit e rritur që ta mësonin mirë gjuhën shqipe, se me atë do të rronin. U thosha se ishin minoritet, por atdhe kishin Shqipërinë. Aty do të jetonin, aty do të shkonin ushtarë, aty do të punonin. Pra, pa gjuhën nuk do të bënin dot. U thosha se prindërit e tyre shkonin në Amerikë për të fituar bukën e gojës. Atje e mësonin gjuhën e atij vendi, se u duhej për të punuar e jetuar. Kurse këta që ishin këtu, nënshtetas shqiptarë,

s'kishin si të jetonin pa ditur gjuhën shqipe. U flisja dhe për padrejtësitë. Madje, kur bëheshin zgjedhjet për kryeplakun, u thosha: "Çdo vit bëhen zgjedhje për kryeplakun e fshatit, kurse për monarkët nuk ka kurrë zgjedhje. Ai që është në fron, dhe që fronin ndoshta e ka marrë me gjak, qëndron aty gjersa të vdesë, qoftë i mirë, qoftë i lig..." Ata më dëgjonin. Ngandonjëherë u lexoja edhe ndonjë shkrim greqisht të organit të rinisë komuniste greke "I protopori" dhe ata heshtnin e më dëgjonin me shumë vëmendje. Më donin shumë.

Kishte nëpunës, xhandarë ose nga ata të komunës, që u thoshin: "Pse nuk na thoni mirëmëngjes shqip, po na thoni kalimera? Është e ndaluar të na flisni greqisht." Unë isha kundër atyre "fanatikëve" të këqij, që prishnin punë. Një ditë, kryetari i komunës, që e dinte mirë greqishten, i tha priftit: "Fol shqip mirëmëngjes dhe mos më thuaj mua kalimera, se nuk jam Venizellosi!" Që atë ditë e mora inat atë kryetar komune kapadai. Pastaj mora vesh se ai gjithë muajin shëtiste fshat më fshat, mbante në xhep vulën e komunës dhe celebrimet, regjistrimet, lindjet, vdekjet i bënte fshatrave, duke marrë për çdo vulosje një napolon. Hante e pinte qyl në familjet më të pasura dhe mora vesh se ishte edhe i pamoralshëm. Për të gjitha këto, nuk e shihja dot me sy. Inat e kishte marrë edhe Bejkush Gjoleka, postëkomandanti i xhandarmërisë së Sofratikës, me të cilin ishim bërë vëllamë. Më 28 Nëntor, festonim Ditën e Flamurit në Sofratikë. Ishin mbledhur të gjitha shkollat, që nga Derviçani e gjer në Frashtan-Lugar, ishin kryepleqtë, paria e vendit. U poqën mishra. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i komunës. I thashë Bejkushit: "Po sikur t'u them edhe unë nja dy fjalë greqisht, për këtë ditë?" Ai e pranoi mendimin tim. Kur mbaroi "ligjëratën shabllon" kryetari i komunës - kudo ajo ligjëratë mbahej: Plaku i thinjun Ismail Qemali, tuj kalue mes për mes Myzeqesë, me baltë gjer në gjoks,

arriti në Vlonën kreshnike dhe aty ngriti flamurin kuqezi, flamurin e Skanderbegut, pesëqind vjet në robni, - dhe fshatarët e dëgjuan, por nuk duartrokitën, Bejkushi ma bëri me sy që të flisja.

Kur fillova greqisht: "Të dashur fshatarë... - ata u habitën. Dhe vazhdova kështu: - Unë e di që ju keni ardhur të merrni pjesë në këtë festim jo me vullnet, po nga frika. Po, nga frika, se ju, të dashur fshatarë, nuk e kuptoni dot rëndësinë e kësaj dite të madhe. Ju keni frikë, se jeni si të huaj në vendin tuaj. Ju jeni banorë të kësaj toke shqiptare. Shekuj më parë, stërgjyshërit tuaj u sollën këtu nga feudalët për të punuar këtë fushë të paanë të Dropullit. Ishin skllevër prindërit dhe gjyshërit tuaj, dhe ju, mjerisht, ende vazhdoni ta quani veten tuaj skllevër. Po pse? Se koha jonë ende nuk ka ardhur. Por, kur të vijë koha që ju të bëheni zotërit e tokës suaj, atëherë ju, në këtë ditë të madhe, do të vini me këngë e me hare për ta kremtuar këtë liri". Në fund thashë: "Zito i Alvania! Zito i Elefteria!" - Asnjë nuk duartrokiti. Në këtë kohë kryetari i komunës, që dinte greqisht, bënte me shenjë që unë të pushoja, po Bejkushi i bënte shenjë të mos ndërhynte. Atë ditë aty ishte dhe një vëlla i Vasil Xhait, tregtar nga Sofratika, që kishte ardhur nga Amerika për pak kohë. Ai m'u afrua dhe më tha greqisht: "Gëzohem që edhe këtu, në vendin tonë, ka komunistë!" Dhe, kur shkoi në Amerikë, më dërgoi disa gazeta "Empros", që ishte organi i punëtorëve grekë në Amerikë.

Pasi hëngrëm, pimë dhe kënduam, kryetari i komunës i tha diçka Bejkushit. Dhe Bejkushi iu përgjigj: "As ke parë dhe as ke dëgjuar gjë, se, po mora vesh që ti e ke raportuar, ke të bësh me mua!" - Megjithatë ai më raportoi te prefekti, i cili më thirri në zyrën e tij dhe, pasi më foli për agjentë grekë që ka në Dropull dhe për komunistët që "helmojnë" atmosferën, më propozoi që të bëhesha informator... "se ty të duan fshatarët dhe me ty

shprehen lirisht." Unë i thashë: "Jam arsimtar dhe jo xhandar. Po të vija edhe unë në gushë atë copëzën e kuqe, do të isha gjysmëxhandar e gjysmarsimtar!" - Ai buzëqeshi, por më vështroi me dyshim.

Dëshiroj të zgjatem pakëz për kryetarin e komunës. Aty nga shkurti, më erdhi në shkollë. Ishte errur. U ngroh në zjarr dhe m'u lut t'i jepja makinën e rrojës. Do të shkonte për darkë te kryeplaku, që kishte dy vajza të reja. Ia dhashë makinën me një brisk me të cilin mprihja majat e lapsit. U gri, u copëtua, u gjakos dhe, duke më mallkuar, iku për te kryeplaku. Ai ishte një njeri i varfër dhe tani, natën, do të shkonte të lypte raki, meze, për të pritur kryetarin. Pas pak shkova dhe unë te kryeplaku. E pashë kryetarin që kishte hequr këpucë e çorape dhe ato këmbë, si të të vdekurit, ia lante vajza e kryeplakut. Më hipi gjaku në kokë. I thashë: "Zoti kryetar, na ka thirrur poshtë Bejkushi, prandaj, - iu drejtova kryeplakut, - mos gatuaj gjë, se do të hamë poshtë te postëkomanda."

Kryetari u zemërua pa masë, kurse kryeplaku u gëzua tej mase. Mezi e binda, se nuk tundej. Dolëm. Fryn-te një erë e ftohtë. Ai më hodhi krahun. Po zbrisnim zallit. Më fliste për punët e mëdha që kishte, dhe pastaj për femrat e Dropullit. "Lum ti, që je i ri! Kushedi se ç'kërdi bën ti këtu! Pse s'më le? Nuk e pe atë vashën që më lante këmbët? Ia pe sytë, ia pe gjoksin?" Mua më ziente gjaku dhe nuk flisja. Kur arritëm në postëkomandë, Bejkushi ishte te dyqani i Vasil Xhait. Shkova dhe e mora. Duke u kthyer për në postëkomandë, i tregova arsyet: "Nuk durohet qeni! Shfrytëzon postin dhe bën ç'i teket me vajza, nuse... Nuk durohet!" Edhe Bejkushi u nxeh shumë. Nuk fliste. E gjetëm kryetarin që fliste me xhandarët. Bejkushi ruajti gjakftohtësinë. I tha se kishte disa punë me të. Xhandarët përgatitën darkën: vezë të fërguara, ullinj, sardele, qepë dhe raki. Kryetari piu dhe, kur erdhi në qejf, thoshte: "Me kë do të fle unë sonte?"

Kur shkova në Gjirokastër për të marrë rrogën dhe

për të shpënë një vjershë te "Demokratia", e pashë kryetarin të zbriste mu te Sheshi i Çerçizit, me bastun në dorë, kryelartë. Desha të ndërroja rrugë, se kushedi ç'do të më thoshte, por ai më kaloi pranë kryelartë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, dhe më përshëndeti me përulje duke më buzëqeshur si mik!

Me Bejkushin, flisnim hapur kundër regjimit. Këtë e dinte edhe Asimi.

Një mbrëmje, kur Asimi fjeti në postëkomandë bashkë me mua, folëm gjatë. Bejkushi tha:

- Nuk e di nëse keni ndonjë organizatë serioze; po qe se keni gjëra serioze, edhe unë jam gati!

Asimi i hodhi duart në qafë dhe i tha:

- Këto punë duhet të bëhen me mend, me organizim. Tani për tani ne po njihemi njëri me tjetrin!

Bejkushin e transferuan. Në vend të tij erdhi Zylyftar Veleshnja, nga Skrapari. Ishte tetar, dukej i rreptë dhe tahmaqar. Zihej me xhandarët për një kokërr vezë. Vëllai i tij vinte nga Skrapari, me mushka të ngarkuara me raki, që ia blinte tregtari Vasil Xhai. Kalonte Asimi andej dhe ndalej. I thashë përshtypjet e mia të këqija për tetarin. Isha mësuar me Bejkushin. Asimi më pororsiti: "Fol me të. Është nga Skrapari, ku ka shokë dhe burra të mirë. Shaje regjimin dhe foli për komunizmin!" Veprova ashtu siç më porositi Asimi, po Zylyftari zemërohej dhe thoshte: "More, ti ke rrogë shumë të mirë, kurse unë, katër napolona në muaj. Të rrimë rehat, se do të na pushojnë!"

Asimi, kur kalonte, ndalej dhe interesohej shumë për Zylyftarin. Më dha një fotografi me dy burra: njëri ishte Riza Cerova dhe tjetri një shok i tij. Më tha që t'ia tregoja fotografinë Zylyftarit dhe ta pyesja se me kë ishte ai, me Rizanë apo me Musa Jukën. Kur ia tregova këtë Zylyftarit, u shqetësua e më tha: "Aman, more, se na more në qafë!" Herën tjetër Asimi i kishte thënë Zylyftarit: "Po ç'kemi këtej? Më kanë raportuar se një mësues në Dhuvjan, që quhet Petro Marko, është subversiv. Heto

dhe, kur të kthehem, më njofto!" Nga ana tjetër, mua më porositte: "Foli Zylyftarit më shumë kundër regjimit!" Kur Asimi shkoi përsëri te Zylyftari dhe e pyeti për mua, Zylyftari i kishte thënë:

- Është djalë i,mirë, patriot!

- Kur qenka kështu, - i kishte thënë Asimi, - eja të vemi për darkë tek ai.

Më erdhën vonë. I prita mirë. U gëzova shumë, se Asimi do të qëndronte gjithë natën me ne. Kur mbaruam së ngrëni, u zhvillua kjo bisedë ndërmjet Asimit dhe Zylyftarit:

Asimi: - Zoti Zylyftar Veleshnja, ti je armik i regjimit!

Zylyftari: - (I trembur, duke më shikuar mua.) Unë jam besnik dhe prandaj jam dhe postëkomandant.

Asimi: - Lëri ato! Ti je armik i betuar!

Zylyftari: - Unë? Gaboheni shumë, zoti Asim! (Dhe më shikonte mua.)

Asimi: - Ti je shok i Riza Cerovës, ti e urren mbretin...

Zylyftari: - (M'u kthye mua.) More i pabesë! Ti qenke i pabesë!

Asimi: - (Duke qeshur.) Zylyftar, ne të kemi thirrur sonte këtu që të të bëjmë "myhib", të të bëjmë shokun tonë. (Dhe i hodhi duart në qafë. Zylyftari u qetësua.)

Pastaj Asimi nisi të fliste për punën që duhej të bënim. I tha: "Ti do të kesh lidhje me Petron dhe me Zenel Hekalin. Ju të tre këtu do të formoni një treshe". Zylyftari u gëzua pa masë dhe e përqafoi. Më përqafoi edhe mua. Që atë ditë Zylyftari ndërroi dhe sjelljen arrogante që kishte ndaj fshatarëve të gjorë...

Pyetje: - Aty, në Dhuvjan, shkruaje?

Përgjigje: - Bashkëpunoja me revistën "Vatra e rinisë" të Vasil Xhaçkës, i cili ma kishte kërkuar me letër bashkëpunimin. Pothuaj se në çdo numër kisha nga një shkrim: vjersha satirike me pseudonimin "Cfurkthi" dhe skeçe ose shkrime me emrin tim ose me Petro Marko Jani.

Bashkëpunoja dhe me gazetën "Demokratia". Vangjel Koça më kërkonte kurdoherë shkrime. Bëja vargje. Ai më dha për të përkthyer dhe një novelë të Kristalistit (poet i mirë nga Pindi, por që shkruante greqisht). Novela e kishte titullin "Ikona", po Vangjeli ia vuri "Kuadhrua" - një novelë interesante me subjekt nga Suli, ku një plak u tregonte atyre që ishin në kafene, për një ikonë të Skënderbeut (u fliste shqip plaku). Dhe me gazetën e Barit, "Gazeta shqiptare", bashkëpunoja. Kam botuar një novelë: "Vrasja e shokut". Temën e mora nga një ngjarje tragjike që më ndodhi mua me Muharremin: Ky kishte shkuar në Gjirokastër të merrte rrogën. U err dhe koha ishte e keqe. E prita gjer vonë, por ai nuk erdhi. "Do të ketë fjetur në Gjirokastër", - mendova. Rashë të flija dhe më zuri një gjumë i thellë. Më bëhej sikur dëgjoja trokitje të forta te dera e poshtme. Pastaj m'u bë sikur dëgjoja trokitje në dritaren e katit lart, pastaj një xham u thye dhe dëgjova këmbë të lehta në dhomën pranë. "Janë kusarë nga Lazarati, - mendova, - kanë marrë vesh se kam marrë rrogën, dhe kanë ardhur të ma përlajnë!" Revolen "Golt" e mbaja nën jastëk. E mora dhe prita që të hapej dera. Dera u hap... pranë vatrës u ndez një shkrepëse... As që e zgjata më, mendova se kusarët do të më merrnin rrogën dhe unë do të turpërohesha në gjithë fshatin e në Dropull si mësues frikacak, prandaj tërhoqa këmbëzën duke shënuar drejt shkrepëses së ndezur. "Më vrave, more Petro!" - Ishte zëri i Muharremit. Brofa më këmbë. Ndezëm llambën dhe me kujdes pamë se ku e kisha qëlluar. Për fat plumbi kishte goditur xhaketën atje ku mbërthehen kopsat, dhe ishte futur në murin e vatrës. Morëm frymë lirisht dhe gjithë natën nuk fjetëm. Unë i tregoja arsyet e mia, ai të vetat... Me këtë subjekt shkrova një novelë që u botua në "Gazetën shqiptare".

Edhe në "Illyria" dërgoja vjersha. Dërgova dhe një vjershë kushtuar Jorgji Meksit, me titull: "Nën hijen e

pemës blerimtare". Një ditë, erdhën nxënësit dhe më thanë se më kërkonte një plak. Dola jashtë dhe pashë xha Jorgon, të lodhur. E futa në dhomë, i bëra një kafe, i dhashë ujë e një konjak dhe e pyeta pse kishte ardhur gjer aty. Ai më puthi në ballë dhe më tha:

"Të falënderoj shumë për vjershën që botove për mua në "Illyria"! Unë erdha gjer këtu të të puth në ballë, jo për nderimin që tregon për mua, po se ti je poet. Ti do të bëhesh Pallamai i Shqipërisë."

Me Sterjo Spassen takohesha shpesh. Aty e shkroi romanin "Pse", të cilin ma dha për ta lexuar.

Më vonë do të shkruaja (më duket se në revistën "ABC") se romani "Pse" shprehte gjendjen kaotike të shpirtit të rinisë sonë.

Pyetje: - Kur u largove nga Dhuvjani?

Përgjigje: - Nga Dhuvjani u largova më 1934. Unë vija në Tiranë dhe takohesha me Demirin, Vasilin e me të tjerë; Demirin e ndihmoja, se isha me rrogë. Takohesha dhe me Mane Nishovën, me shokët e mi të Shkollës Tregtare, Shevqet Musarajin, që ishte ende te noteria "Kokalari" dhe që më lexonte vargjet e tij erotike, vargje pesimiste. Demiri më udhëzonte. Na kishte sjellë dhe "Internacionalen" të shqipëruar nga Lame Kodra, po disa vargje i përmirësuam me sugjerimin e Demirit. "Internacionalen" e mësova përmendsh dhe ngado që shkoja dhe ku kisha shokë, ua mësoja.

Para se të mbaroj me Dhuvjanin, do të përmend dhe një ngjarje:

Na erdhi një ditë për inspektim Jani Minga nga Vlora. Kur i thashë se nga isha dhe i kujt isha, na doli se ai ishte mik i babait tim, se kishte qenë mësues dhe në Dhërmi. I bleva një shishe konjak "Metaksa". Pinte shumë. E mbajta për drekë. "Dy gjëra u mëso këtyre nxënësve, - më tha, - të duan Shqipërinë dhe të mësojnë gjuhën shqipe!" I kishte pëlqyer një artikull që kisha

shkruar, i cili bënte fjalë për tekstet shkollore të përkthyera nga gjuhët e huaja. Aty theksoja: *"Bëjnë nxënësit tanë zoologji dhe mësojnë se ç'majmunë ka Afrika e Australia dhe nuk dinë ç'kafshë ka në malet tona e në fushat tona".*

Erdhën pleqësitë e fshatrave Terihat e Sofratikë dhe iu lutën që të urdhëronte për të parë vendin ku ata kishin menduar të ngrinin një shkollë të re, plotore, për greqishten, midis Sofratikës dhe Terihatit. Minga qeshte dhe më shkelte syrin. E piu gjithë shishen e konjakut. Ai, para se shkollat e Dropullit dhe të minoritetit të kthenheshin në shkolla shqipe, dy vjet më parë, i kishte inspektuar këto shkolla dhe i kishte raportuar Ministrisë së Arsimit me një telegram: "Inspektova 44 shkolla të minoritetit grek, ose më mirë 44 kazerma, ku përgatiten ushtarë grekë!" Muharremi kishte dijeni për këtë telegram, prandaj shkulej së qeshuri.

Pleqësia e fshatrave Sofratikë dhe Terihat e pritën dhe u nisëm bashkë për të parë vendin ku mendonin të ngrinin një shkollë plotore "Skolarhion". Unë e mbaja për krahu Mingën, i cili më tregonte episode të shumta antishqiptare. Më kujtohej një episod i Vlorës, para Luftës së Vlorës, kur pushtuesit italianë e kishin detyruar të mbante një ligjëratë në Sheshin e Flamurit, para popullit, për lidhjet ndërmjet italianëve dhe shqiptarëve. Dhe Jani Minga kishte pranuar. Gjithë populli i Vlorës u habit se si ky Jani Minga, ky antiitalian, do të mbante një ligjëratë në Sheshin e Flamurit, me urdhër të Piaçentinit, komandantit të forcave pushtuese italiane.. Gjithë populli u mblodh te Sheshi i Flamurit. Minga, nga ballkoni, filloi: "Popull div i Vlorës! Siç më njihni, unë jam mësues. Dhe sot dua t'ju jap një mësim të hapur. Na ishte njëherë një shkrimtar i vjetër grek që quhej Ezop. Ky Ezopi ka shkruar fabula për kafshët. Një nga ato fabula është edhe kjo: *Na ishte njëherë një qen dhe një lepur. Qeni lepurin herë e*

ndukte dhe herë e puthte. Dhe lepuri i gjorë i tha një ditë qenit: "O qen, nëse të kam mik, pse më nduk? Nëse të kam armik, pse më puth? Edhe ne me Italinë...si jemi, i themi: "O qen i biri i qenit, nëse të kemi mik, pse na shtyp? Nëse të kemi armik, pse na përkëdhel?" Turma bërtiti me të madhe "Rroftë Jani Minga! Rroftë flamuri!" Jani Mingën e morën dhe e internuan në Sazan. Këtë dhe episode të tjera si ky kujtoja dhe shtrëngoja më fort krahun e Jani Mingës.

Arritëm në vendin midis Sofratikës dhe Terihatit.

- Këtu, zoti epithioriti... këtu mendojmë ta ndërtojmë skolarhion..., - i thanë.

Jani Minga foli: "More, jeni a s'jeni në vete?! Ku jemi këtu, në Greqi?! Po të doni që fëmijët tuaj të shkojnë në skolarhion, le të venë në Greqi! Po nuk e kuptoni që ju jeni bijtë e këtij vendi, sigurisht që minoritet, minoritet grek?! Këtë nuk jua mohon njeri. Ju duhet t'i vini gishtin kokës dhe të thoni: Ku jetojmë ne? Në Shqipëri... Këtu, në Shqipëri, e keni jetën tuaj. Këtu do të rriten, do të punojnë dhe do të jetojnë bijtë tuaj. Pra, kuptojeni se Shqipëria është atdheu juaj. Sa për gjuhën e nënës, ne kemi menduar që fëmijët tuaj ta mësojnë, të dinë të shkruajnë dhe të lexojnë greqisht. Morët vesh?"

Muharremin e transferuan dhe në vend të tij erdhi një djalosh gjirokastrit. Edhe ai kishte mbaruar Normalen, po ndryshonte si nata me ditën me Muharremin. Ishte një tip që nuk fliste shumë dhe që nuk i pëlqente shoqëria me asnjë. Shpeshherë vinte një toger i rekrutimit a i paraushtarakëve nga Sofratika, ku kishte zyrat; ishte nga Mati. Me të rrinte mësuesi i ri dhe bisedonin gjatë në dhomën tonë. Po ja që me të ngjau diçka e papëlqyer:

Isha në sallën e katit të parë duke zhvilluar mësimin e këngës me të gjitha klasat. Ai, mësuesi i ri, ishte lart, në dhomën tonë, me togerin. Kur unë isha në mësim, ai,

me shufër në dorë, zbriti nga shkallët dhe thirri me emër dy vajza, që të shkonin lart, se kishte punë me to. Pashë vajzat që ulën kokën në bankë dhe nuk lëvizën nga vendi. Ai u thirri: "Dëgjuat apo nuk dëgjuat?" - dhe erdhi te bankat e fundit, aty ku ishin ulur ato. Përsëri u dëgjua zëri kërcënues i mësuesit të ri: "Hajt, shpejt, ejani lart ju të dyja aty!" Ato ishin vashat më të rritura, për martesë. Filluan të qanin dhe nuk lëviznin nga vendi. Atëherë më hipi gjaku në kokë. Nxora revolen nga xhepi dhe e kapa nga kravata duke i thënë (frëngjisht, që të mos kuptonin nxënësit): "Shporru që këtej, se unë jam në mësim!" - Ai për një çast më pa me inat dhe nuk lëvizi. Por, kur e kuptoi se unë isha nxehur dhe mund të bëja ndonjë hata, iku.

I pashë ata të dy, mësuesin dhe togerin, të zbrisnin me nxitim shkallët. Hapën derën dhe ikën. Në klasë ra një qetësi varri. Nxënësit u llahtarisën. Skena ishte e jashtëzakonshme: Me revole! Kërcënim!

- Mësimi mbaroi! - u thashë. - Shkoni në shtëpi. Ju të dyja atje, - u fola dy nxënëseve që ai kërkonte lart, - qëndroni, mos ikni!

Kur salla u boshatis, iu afrova dy vashave që kishin fshehur fytyrat mbi bankë, u vura duart në kokë dhe u thashë:

- Ç'keni? Pse qani? Ma thoni mua, se unë ju dua si motrat e mia. Ç'ka ngjarë?

- Nuk e themi dot! - tha njëra, pa e ngritur fare kokën.

- Janë fjalë turpi! - tha tjetra, gjithashtu pa e ngritur kokën.

E kuptova dhe më hipën xhindet!

- Mirë, tani shkoni në shtëpi, shkoni dhe mos kini frikë, se jam unë këtu! - Ato ikën.

Në fshat u përhap lajmi i skenës dramatike ndërmjet meje dhe kryemësuesit, por arsyet nuk i dinin mirë.

Pas pak ditësh më erdhi një ftesë, që të paraqitesha

te prefekti në Gjirokastër. Fola me Zylyftarin. Zylyftari, që ishte postëkomandant, më tha të mos shkoja; do të shkonte vetë ai të merrte vesh se ç'më donte prefekti. Zylyftarit i fola hapur për çka kishte ndodhur.

Erdhi Emin Çomoja, inspektor, dhe më mori në pyetje. Të dy zbritëm në postëkomandë dhe biseduam edhe me Zylyftarin.

- E di? - tha Emini, patriot dhe mësues me dinjitet. - Ata të dy ta kanë skuqur mirë: kanë raportuar se të kanë kapur duke u bërë nxënësve propagandë greke! (Zylyftari qeshi me inat.) Po ti mos shko te prefekti, se do ta sqaroj unë këtë punë!

Pastaj foli Zylyftari:

- Shyqyr që nuk kanë raportuar ndryshe: e kapëm që po u fliste nxënësve për komunizmin!

I thashë Eminit se punët ishin ngatërruar dhe se ishte e pamundur të qëndroja në Dhuvjan bashkë me atë mësuesin e ri, me të cilin nuk merresha dot vesh. Edhe ai i po këtij mendimi ishte dhe, kur shkoi në Gjirokastër, pasi dëgjoi fjalë të mira për mua nga postëkomanda e xhandarmërisë, e sqaroi mirë prefektin dhe u vendos që mësuesi të transferohej në Lugar.

Pyetje: - Po si u arratise për në Greqi?

Përgjigje: - Më 1934 erdha në Tiranë. Për fat, përveç Demirit, që më njohu me Ali Kelmendin, me Bedri Pejanin etj., takova dhe Asimin. Ai më mori në shtëpi, ku më njohu me Bijën, hallën e tij, me nënën dhe me dy vëllezërit: Durgutin, që ishte nënoficer i xhandarmërisë, dhe Myftarin. Më foli gjatë dhe më këshilloi që të arratisesha, se në Gjirokastër kishte fakte që unë kisha shpërndarë literaturë komuniste (shtypin grek, që ma jepte Asimi. Ai ma jepte me porosi që të mos ua jepja njerëzve të dyshimtë dhe të lëkundur, mirëpo unë, pa përvojë, ua lexoja edhe nxënësve të rritur, ua komentoja disa fshatarëve nga Dhuvjani, Sofratika, Terihati etj.).

Erdhi shtatori dhe unë u nisa për në Dhuvjan. Po në Gjirokastër më thanë se isha transferuar për në Hllomo të Pogonit.

U takova me Asimin. Ai ma tha troç: "Do të të arrestojnë, se ka fakte. Ka pesë dëshmitarë që ti ke përhapur shtypin komunist grek. Përgatitet arrestimi yt. Shko në Hllomo, te njëfarë Gjini dhe thuaj se të dërgoj unë..." Në Gjirokastër unë shita shtatë rroga. Ia shita njëfarë Shtinoje: për 74 napolona, që bënin rrogat e mia, ai më dha 50 napolona në dorë. Dhjetë napolona ia lashë Vangjel Koçës me këtë porosi: në vafsha në Athinë, do të të shkruaj që të m'i dërgosh të dhjetë napolonat.

Shkova në Libohovë, pajtova një qiraxhi me kuaj, ngarkova plaçkat, ia hipa një kali dhe u nisa për në Hllomo. Kaluam Stegopolin, Suhën dhe arritëm në Hllomo. Në shkollë gjeta Qamil Guranjakun. Asimi më kishte porositur që të mos i hapesha Qamilit.

Qamil Guranjaku u gëzua pa masë që do të ishim bashkë, se dhe ai shkruante vjersha. Të nesërmen kërkova Gjinin, për të cilin më kishte folur Asimi. Erdhi, më ftoi për drekë në shtëpi dhe, kur i thashë se më duhej të hidhesha në Greqi, ai më qetësoi dhe më premtoi se dëshirën do të ma plotësonte patjetër, sa më shpejt. Pas dy ditësh, më thirri për darkë. Qamilit nuk i erdhi mirë që nuk e thirri dhe atë. Në mes të natës, Gjini më mori dhe, duke ecur nja katër orë më këmbë nëpër monopate të shkreta, më tha: "Ec drejt, se për pesë minuta je në Greqi." - Më puthi dhe më pyeti në kisha të holla. Eca drejt dhe arrita në një fshat. Pyeta se ku kishte makinë për në Janinë. Disa gra më treguan vendin nga duhej të shkoja.

JASHTË SHQIPËRISË

NË GREQI

Pyetje: - Ç'mban mend nga ai udhëtim?

Përgjigje: - Të them të drejtën, asnjë imazh, asnjë vizion, asnjë skenë. Gjersa arrita në Prevezë, mendja ime ishte në Shqipëri: te familja, te shokët, te Qamil Guranjaku, i cili kushedi ç'mendonte për mua, e sidomos tek Asimi. I bëja vetes një mijë pyetje: pse Asimi më porositi: "Më mirë ikë sa më parë. Ti vëllanë e ke punëtor në Athinë, pesëdhjetë napolona i ke. Shko dhe vazhdo studimet. Po më shkrove ndonjë letër, shkruaja Demirit në Tiranë."

Unë, ç'është e vërteta, ëndërroja të shkoja për studime. Thosha me vete: "Ca para i kam, aty kam Mimin, do të më ndihmojë. Po gjeta punë në ndonjë gazetë... Po pse Asimi më tha që kam gabuar? Ku kam gabuar? Kam gabuar në qarkullimin e gazetave komuniste greke?... Pse?... Mos vallë midis atyre që e merrnin këtë shtyp, kishte edhe njerëz të zyrave sekrete dhe ata e kishin bërë punën e tyre, kishin raportuar atje ku duhej dhe, po të kapej filli, do të arrinin gjer tek unë... dhe unë patjetër do të arrestohesha, do të torturohesha për të treguar se kush m'i kishte dhënë, dhe kështu mund të rrezikohej

edhe Asimi... Prandaj Asimi mendoi që më mirë të largohesha pa zhurmë dhe se, po ta pyesnin, do të thoshte se kisha shkuar për studime..."

Këto mendime që bluaja, nuk më lanë të shihja as Janinë e as Prevezë. Haja në restorante të vogla, flija në hotele të vogla, gjoja si student në Athinë, dhe jepja adresën e vëllait tim, Mimit, që e dija përmendsh "Odhos Posidhonos, nr. 74 - Falero, Athinë". Asimi, herën e fundit që u takuam, më tha: "Mos ki frikë, nuk do të kesh asnjë andrallë... Dhe kalo nga Korfuzi, takohu atje me Dr. Omer Nishanin e bisedo me të..."

Në Korfuz u takova me Dr. Omer Nishanin, me Minella Kolekën e me të arratisur politikë, antizogistë si Dhimitër Bala, Shyqyri Peza, Gjoleka, Tatzoti e të tjerë. Ata rrinin gjithë ditën në Spianadhë, luanin tavëll. Aty Dr. Nishani më informoi shkurtimisht, siç e informova edhe unë për situatën në Shqipëri. Më tha se ata emigrantë politikë që rrinin në Korfuz, merrnin para nga Beogradi, siç merrnin nga Beogradi edhe shumica e emigrantëve politikë që ishin në Paris. Disa merrnin para nga Musolini, me Mustafa Krujën në krye; disa të tjerë nga Greqia, me Koço Tasen në krye. "Kurse, - më tha Nishani, - Halim Xheloja dhe ca të tjerë që do t'i njohësh më vonë, marrin ndihma nga Ndihma e Kuqe Internacionale."

Të gjithë më pyesnin për situatën në Shqipëri. Një ditë na erdhi aty në Spianadhë njëfarë Xhemil, që e njihja që në Shkollën Tregtare. U gëzova kur e pashë. Më tha se studionte në shkollën tregtare italiane të Korfuzit. Kur u largua ai, Nishani më porositi: "Kujdes me të, se është spiun i konsullatës italiane. E ka dërguar Meloni, konsulli italian në Vlorë!" Edhe Minella po këtë më tha. Ai, Xhemili, m'u ngjit pas dhe më bënte një mijë pyetje, por unë tashmë i besoja Dr. Nishanit, prandaj mundohesha ta shmangia.

Me Dr. Nishanin biseduam shumë. Më pyeste për çdo gjë, më këshilloi se si të sillesha dhe me kë të kisha lidhje, më njohu me Llano Borshin dhe më porositi që të kisha besim tek ai.

I shikoja me dashuri ata "patriotë" - kështu i quanim ne ata që ishin me Fan Nolin dhe që kishin braktisur vendin. Por habitesha me qëndrimin e tyre. Minella Koleka për çdo person më foli me ironi. Vetëm për Dr. Nishanin kishte mendim shumë të mirë. Më tha se ai e drejtonte "Lirinë kombëtare" bashkë me Halim Xhelon, me të cilin kishte lidhje të ngushta dhe të cilin e ndihmoi shumë kur erdhi ilegal në Shqipëri nga Korfuzi. Minella e përcolli, ai e priti...

Pyetje: - Ç'përshtypje të bëri takimi i parë me të arratisurit politikë?

Përgjigje: - E vërteta është se unë mendoja se kisha bërë ndonjë heroizëm që isha larguar ilegalisht nga Shqipëria. E ndieja veten më të pjekur tani dhe kërkoja shokë më të rritur, që të më udhëzonin. Dr. Nishani m'u duk njeri i madh, i pjekur, fliste me mend dhe ishte shumë ironik me të arratisurit që ndodheshin në Korfuz.

Isha bashkë me Minella Kolekën, në dhomën e Nishanit, dhe kuptova që ai jetonte në varfëri. Minella edhe më keq, se nuk ndihmohej nga askush. Spiro Koleka, që gjithashtu ishte i arratisur politik dhe njeri i mprehtë dhe patriot, nuk para përzihej me të tjerët. Rronte më mirë dhe lexonte shtypin. Nuk fliste. Më pyeti dhe ai për Himarën, për disa njerëz të tij dhe unë i përgjigjesha me respekt. Një ditë, pasi më vështroi gjatë, më tha: "Nëse ke zënë edhe ti rrugën e Minellës, mos prit të të japë bukë as Niko Zahariadhi dhe as Stalini!"

"E, more, si t'u dukën "heronjtë e patriotizmit"? - më pyeti një herë tjetër. - Po krerët i kemi në Paris. Aty, të gjorët, vuajnë shumë. Kanë dhjetë vjet që luajnë kumar. Sa për ne këtu, - u mendua ca, - po ta them me fjalët e

një shokut tonë që quhet Koço Boshnjaku. E ke dëgjuar? Ai, që thua ti, e përcaktoi mirë veprimtarinë tonë. Një ditë, kamerieri i kafenesë së Spianadhës mori guxim dhe na pyeti: "Ç'punë bëni zotëria juaj?" - se ai na ka parë për ditë të tëra duke luajtur tavëll e duke bërë lloqe në Spianadhë. Asnjë nuk foli. U përgjigj Koço Boshnjaku: "E ç'punë ka puna me ne, more bir?!" - E more vesh? Ne kemi mbaruar! Jemi ndryshkur fare. Prandaj ju takon juve të rinjve të mendoni për të gjorën Shqipëri!"

Edhe Spiro Koleka më pëlqeu, siç më pëlqeu edhe Dhimitër Bala, i cili më dukej më serioz edhe më me karakter. Ai e kishte njohur edhe babanë tim e më tregonte për vrasjen e xhaxhait Andrea Marko. "Fajin e kishte Spiro Miloja, që i la andartët të bënin krime. Ne luftonim që andartët të mos kapërcenin Llogaranë e të mos trazonin krahinën. Por ata, së bashku me rrufjanët e tjerë, grekomanët, vajtën në Karaburun dhe vranë..."

Minella i foli shumë për mua. Dhe ai më vështroi në sy, u ngrit dhe më përqafoi:

- Ashtu,•o djalë! Ju duhet t'i tregoni botës se Himara është zemra e lirisë, është besnike e Skënderbeut, është gjaku i Arbrit. Ti e di mirë historinë tonë. Por ata të megali idhesë janë ende bizantinë dhe i përkrah e i ndërsen tjetërkush, Janë fuqitë e tjera imperialiste që ushqejnë përçarjen, grindjen, armiqësitë. - Më fliste bukur. - Por a ke shokë të tjerë si veten në Himarë, more bir?

U përgjigj Minella:

- Ashtu janë të gjithë, sidomos ata që kanë mësuar në shkollat e mesme.

Pra, me Dr. Nishanin, me Spiro Kolekën, me Dhimitër Balën, unë u njoha shumë dhe ika nga Korfuzi duke marrë me vete edhe dashurinë e tyre. Minellës i dhashë ca të holla, se ishte i zhveshur fare.

Pyetje: - Ç'të kujtohet nga udhëtimi Korfuz-Athinë?

Përgjigje: - Përshtypje të madhe më ka bërë Itaka.

Vapori kaloi nga kanali që ndan Itakën nga Qefalonia. Nga e majta Itaka, nga e djathta Qefalonia shumë e madhe. Itaka e vogël. M'u duk më e vogël se Sazani dhe mendova (atëherë) sa nisi e vogël dhe ç'emër të madh ka në botë! (Ashtu siç mendoj sot për Shqipërinë: sa e vogël dhe ç'emër të madh ka sot në botë!)

Përshtypje të madhe më bëri edhe Kanali i Korintit. M'u kujtuan historitë që tregonin pleqtë që kishin punuar atje për çeljen e atij kanali. Njëri prej tyre kishte sjellë dhe një varé. Dhe kishte ardhur më këmbë që nga Korinti në fshat, për të mos shpenzuar për navllot. Varenë e përdori në fshat për të thyer gurë. Ishte mjeti i punës me të cilin rronte.

Harrova të shpreh dhe mendimet e mia të asaj kohe për Patrasin. Patrasi i madh, me shtëpi të bardha, ishte nga e djathta. Nga kuverta e vaporit shikoja dhe mendoja se aty kishte dhe nga fisi ynë Bua. Aty shkonte shpeshherë plaku i fisit tonë Mantho Bua, për t'u takuar me më pleqtë e fisit. Grekët, duke shkruar "Merkuriadën" për Merkur Buan, që ishte gjeneral në Spanjë, e bënin të tyrin, ndërsa ai vetë ka shkruar se ka lindur në Akroqeravnia Ori (Malet e Vetëtimës).

Sapo arritëm në Pire, liman i madh me mijëra anije të çdo lloji, m'u kujtua ngjarja tragjike e Dhimo Rucit:

Dhimo Ruci rrinte gjithnjë me papa Andonin, i cili na paskësh qenë një herë në Athinë. Dhe i tregonte të ziut Dhimo se si ishte Athina: "Bukuria e botës, mençuria e botës, pasuria e botës, parajsa e botës, drita e botës... Ta shohësh një herë Athinën dhe të vdesësh." Ia kishte prishur mendjen të ziut Dhimo. Po ja që i doli asi. Një nip i Dhimos, emigruar në Amerikë, dërgoi para që vajza e tij e vogël, e lindur me një këmbë të shtrembër, të dërgohej në Athinë për t'u shëruar. Gruan e tij, Fotinën, bashkë me vajzën e sëmurë duhej t'i shoqëronte xha Dhimoja. Dhimoja u çmend nga gëzimi. Dhe ja, u nisën për në Athinë. Vapori arriti në Pire, iu afrua bankinës

dhe u hodh shkalla për të zbritur udhëtarët. Zbriti edhe xha Dhimoja e pas tij Fotina, me vajzën në krahë. Xha Dhimoja me bërruc të zi, me qylaf të zi, me poture, me tirqe dhe caruqe me hundë, porsa hodhi këmbën në stere, u gjunjëzua, bëri kryqin dhe tha: "Ku je, o tokë e shenjtë!" Mirëpo bërruci u hap dhe u zu rruga. Njerëzit s'kishin si të kalonin, mbetën në shkallë. Një polic shkoi aty dhe i këputi një shkelm të fortë në kurriz xha Dhimos, i cili u përmbys, sa theu hundën dhe i doli gjak. U ngrit, përdrodhi mustaqet dhe i tha policit:

- Kë godet ti more, kështu? Nuk e di që unë jam himarjot?! - Polici i këputi dhe një pëllëmbë të fortë, duke i thënë:

- Ikë, more kacikokleftis (kusar kecërish)!

Fotina dhe vajza zunë të qanin. As ato nuk e kuptuan se si arritën në Athinë, në një hotel të vogël. Një tjetër himarjot i kishte njohur nga veshja dhe i kishte shoqëruar gjer në hotel. Erdhën në hotel edhe himarjotë të njohur, që e ndihmuan Fotinën ta çonte vajzën në një klinikë. Xha Dhimoja nuk doli fare nga hoteli. As që pa gjë prej gjëje.

Pas dy muajsh, u kthyen përsëri në fshat. Fshati e kishte marrë vesh këtë ngjarje dhe, me të ardhur xha Dhimoja, në shtëpinë e tij venin e vinin dhe me ironi i thoshin:

- Na thanë se të pritën me muzikë, helbete, ti e meritoje... - dhe ai, i ndezur, u përgjigjej:

- I thoni atij mjekërcjapit të mos më dalë përpara, se do ta vras, do ta vras! (Fjalën e kishte për papa Andonin, që i kishte prishur mendtë e kokës!)

Pyetje: - Në Athinë, me kë u takove së pari?

Përgjigje: - Patjetër që të parin që do të takoja, ishte vëllai im, Mimi (Dhimitri). Me trenin e vogël arrita në Athinë, kërkova një hotel të mirë dhe më thanë se një nga hotelet më të mira ishte hotel "Parnasosi". Shkova: hotel i madh, i pastër. Më shërbyen sikur të isha autoritet.

Më treguan dhomën. Parapagova për një javë. Treqind dhrami dita, me të ngrënë, me të fjetur, me shërbim pastrimi... U vesha mirë, dhe pyeta se si shkohet në Paleo Falero. Më treguan vendin e autobusëve. Asgjë nuk shihja dhe asgjë nuk mendoja. Kisha vetëm një ankth: si do të takohesha me vëllanë tim, pas trembëdhjetë vjetësh. Kur iku, qe trembëdhjetë - katërmbëdhjetë vjeç, kurse unë isha shtatë vjeç. Madje mbaj mend sa shumë vuajti nga një dhëmballë: iu fry faqja, i kishte mbledhur. Dhe gratë ia shpuan me gjembin e një dege të thatë qitroje. I doli shumë qelb. Faqja iu infektua edhe nga jashtë dhe i mbeti një plagë e madhe mu në mes, por pas ca kohësh, kur na dërgonte fotografi, nuk i dukej shenja në faqe.

Kur arrita në Falero, dielli ishte gati në të perënduar. Shkova drejt në Kafenion Avlonitu, se ajo ishte adresa ku ia dërgonim letrat. Kur hyra në kafene, pashë shumë të rinj që luanin bilardo. Pyeta të zotin e kafenesë se ku mund ta gjeja Dhimitër Markon. Ai më tha se nuk e njihte. I thashë se ne aty i dërgonim letrat. Më pyeti se ç'punë bënte. "Bojaxhi", - i thashë. Atëherë ai buzëqeshi dhe më tha: "A... po, po! Miçoja, se ne Miço i themi!" Doli jashtë dhe më tregoi një rrugicë nga e majta. "Aty, nga e djathta, është taverna e parë! Aty mblidhen çdo mbrëmje gjithë bojaxhinjtë... Aty do ta gjeni." E falënderova. Kalova përpara derës së tavernës. Asnjë. Ishte ende shpejt! U ktheva dhe zura të shëtitja anës detit. Shëtitore e gjerë. Vila të shumta dhe lokale mbi det. Njerëz të pasur shëtitnin. Një qetësi dhe një bukuri e rrallë. Shëtita gjer poshtë në Eliniko, gjersa u err mirë. U ktheva i emocionuar, se po afronte ora që do të takohesha me vëllanë tim, me Mimin e shkretë, që, kur iku nga fshati, ishte i zbathur. Iku me një varkë që do të nisej për në Korfuz... Shumë djem, vërsnikë të Mimit, do të shkonin në kurbet. Përpara ecte motra, Liloja, dhe pas saj Mimi. Nxitonin, se varka do të nisej. Mimit ia shponin këmbët

gjembat, çalonte dhe ndalej. Atëherë Liloja e mori kaç, gjersa arritën nën Shën Theodhorin, se do të iknin ilegalisht. Ishte viti 1920, pas Luftës së Vlorës...

Arrita te rrugica dhe u futa në tavernë. Zhurmë e madhe. Tym, gajasje, verë, këngë. Ku të ulesha? Gjeta në një qoshe një tryezë të lirë. U ula. Erdhi kamerieri dhe më pyeti ç'do të haja. I thashë se dëshiroja të flisja pakëz me Mimin, me Miçon. Më pa me kujdes dhe pas pak vura re se ai zuri të fliste me njërin prej atyre që ishin grumbulluar në një tryezë të gjatë, duke pirë me potere dhe duke bërtitur. Ishin të gjithë gati të zbathur, të veshur keq, me tesha gjithë bojëra. Vura re se ai me të cilin fliste kamerieri, kishte në kokë një republikë të vjetër. Kur u ngrit, pashë se në xhepin e kominoshes mbante një furçë të madhe. Ishte i gjatë dhe u drejtua për tek unë. Kur m'u afrua, u ngrita më këmbë.

- Kishit ndonjë punë me mua, zotni? - ai kujtoi se unë isha ndonjë që kërkoja të lyeja shtëpinë, pasi Mimi ishte si kapoja i bojaxhinjve. Ai u gjente punë, ai merrte paratë, ai i paguante.

- Jo, jam Petroja! - i thashë.

- Cili Petro? - dhe m'i nguli sytë e shqetësuar.

- Vëllai yt.

Ai më kapi dorën e djathtë, ma shtrëngoi shumë dhe më tërhoqi jashtë. Dorën vazhdonte të ma shtrëngonte. Ecnim pa thënë asnjë fjalë. Ecnim me një komb në fyt. Ecnim me vizionet e jetës sonë të mjerë. Ecnim...

Pasi u kthyem, më pyeti:

- Kur erdhe?

- Sot në mëngjes!

- Si është Liloja? - vetëm për Lilon më pyeti.

- Mirë!

- Po pse erdhe?

- Të studioj në universitet...

Dorën nuk ma lëshonte. Hymë përsëri në tavernë.

Zhurma ishte shtuar, po ai, me të hyrë brenda, thirri me një zë që më trembi dhe bëri që të heshtnin të gjithë:

- Anastas! Mbylle derën! Mbylle derën e tavernës! Ju, - iu drejtua bojaxhinjve, - sonte hani, pini dhe këndoni gjithë natën, se paguan Miçoja...

Heshtjen, që zgjati ca, e prishi një zë:

- More Miço, ç'ka ngjarë, u fejove me Helenën e Trojës?

- Jo, - tha Mimi, - më erdhi vëllai, ja ky këtu, i cili do të ndjekë studimet në universitet. Ja, pra, njëri nga ne do të mësojë që të na nderojë, që të na ndihmojë. Pini dhe këndoni!

Atë natë nuk e harroj kurrë. Ata kishin kitara, mandolina. Këndonin bukur. Edhe Mimi i binte mirë kitarës. Aty për aty kurdisnin bejte, duke qarë hallin e tyre dhe duke më uruar mua që të mësoja se edhe nga ne dikush duhej të mësonte e të bëhej njeri!

Pyetje: - A u pranove në universitet?

Përgjigje: - U interesuan disa fshatarë të mi, si Vasil Muçoja e të tjerë, dhe u regjistrova në degën e letërsisë. Vazhdova disa ditë, mora dokumentin e regjistrimit dhe ia paraqita policisë "allodhapon", se pa regjistrim nuk mund të qëndroja në Greqi. Ndoqa disa leksione, por papritur më thirri rektori i Universitetit të Athinës. I shkova në zyrë.

- Më keni thirrur? - e pyeta atë burrë të moshuar, me mjekër të gjatë e të dendur.

- Kush jeni ju?

I thashë emrin dhe degën ku isha regjistruar.

U ngrit në këmbë:

- A! Ju! Ju himarjot dhe mësues i shqipes, ë? Turp, tradhti! Ti, ti të jesh mësues i shqipes,ë? Sikter që këtej! I shitur! Turp! Turp!

Unë ia ktheva me gjakftohtësi:

- Turp për ju, që ende jetoni në kohën e Bizantit...

Kështu, ai rektor me emrin Dhiovunjotis, nga Pogoni i tejkufirit, më përjashtoi nga fakulteti. Dikush nga vorioepirotët e Himarës kishte raportuar. Po tani ç'do të bëja? Shkova në Falero. U takova me vëllanë tim. Ia thashë të gjitha. Ai nuk u trondit aspak:

- Mos u mërzit fare. Ka maskarenj kudo, sidomos ata të sillogut vorioepirot, fanatikë, regresivë, spiunë, të poshtër. Por mos u mërzit.

Më mbajti aty gjer vonë. Më tha se do të fliste me padronin e tij, njëfarë Nikoludhisi, që ishte manjat, kishte vaporë, ndërtesa të mëdha, të cilat Mimi i mirëmbante. Nikoludhisi kishte një grua nga Malta, e cila koleksiononte kuadro piktorësh të dëgjuar. Ishte e apasionuar pas piktorëve të famshëm. Mimi i rregullonte pinakotekën, ishte në punë tek ata prej pesë vjetësh, ndaj kishin besim tek ai. Ishte i ndershëm, prandaj dhe e donin. Ata vetëm tre muaj rrinin aty në vilën e tyre, në Falero, në shëtitoren e "Posidonos", pastaj shëtitnin nëpër Evropë. Mimi aty banonte, në një dhomë të asaj vile. Mua më la në një kafene luksoze, që ishte përmbi det dhe që quhej "Trokadero", ku kërcenin dhe eglendiseshin pasanikët, turistët e huaj. Pas një ore erdhi dhe më mori. Më tha:

- Fola me padronin. Zonja e tij, e cila kujdeset shumë për mua, më tha se dëshirojnë të të njohin. Vemi?

Hymë në kopshtin e vilës, ku ata kishin shtruar darkën, nën një tendë shumëngjyrëshe. I përshëndeta. Më thanë të ulesha. Zonja, një zeshkane nga Malta, më foli italisht. I thashë se çfarë më kishte ndodhur me rektorin. Ajo buzëqeshte dhe më qetësoi:

- Të gjitha rregullohen. Unë e kam shumë mik rektorin e Shkollës Ekonomiko-politike. A dëshironi t'ju regjistrojmë në atë shkollë? Ajo nuk është shtetërore.

Pranova me gëzim, se më duhej patjetër një regjistrim, që të rregullohesha me policinë, përndryshe do të më dëbonin nga Greqia si të huaj.

E lamë që të nesërmen më nëntë të prisja përjashta derës së vilës.

Të nesërmen në ora nëntë, prisja aty jashtë derës së vilës. Doli vetura nga garazhi. E ngiste vetë Nikoludhisi, i cili më hapi derën e veturës. Brenda ishte dhe zonja e tij malteze. Shkuam në Shkollën Ekonomiko-politike. Ai me zonjën e tij u futën në zyrën e rektorit. Pas pak minutash më thirrën. Rektori u ngrit, më dha dorën:

- E kemi për nder të kemi një student poet nga Shqipëria mike! - më tha. Menjëherë thirri sekretarin, që të më bënte një dëshmi regjistrimi (pa i dhënë ende unë asnjë dokument, as dëftesën, se e kisha në universitet). Në dëshminë që më dhanë, thuhej se isha student i vitit të parë të asaj shkolle. Kur u ktheva për në Falero, zonja e Nikoludhisit i tha të shoqit të shkonim në "Trokadero" të pinim diçka. Ajo më shikonte dhe më thoshte:

- Ju keni pamje artisti! Edhe vëllai juaj, Dhimitri, është artist dhe njeri shumë i ndershëm. E kemi si njeri të familjes.

Shpëtova! Dorëzova në polici regjistrimin dhe vazhdoja vitin e parë në *Pandios Skoli*. Profesorët ishin ata të degës së drejtësisë: Svolos, Papandreu, Kanelopulos e të tjerë. Çdo të shtunë vinte një personalitet i lartë dhe na mbante nga një leksion. Mbaj mend se një të shtunë na erdhi kryeministri, Kondilis, dhe na foli për marrëdhëniet shqiptaro-greke. Brendia e leksionit të tij ishte kjo: Ai që do Greqinë, duhet të dojë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Ishte nga arbëreshët (barbaçët) e Greqisë, por grek fanatik. Foli për arsyet pse grekët duhej të donin që Shqipëria të ishte e pavarur. Ai theksoi se jo vetëm për lidhjet e lashta të gjakut e të historisë, por se asnjë e keqe nuk i vinte Greqisë nga pavarësia e Shqipërisë, përkundrazi, po të ishte Shqipëria nën sundimin e Italisë ose të Jugosllavisë, atëherë kërcënohej edhe pavarësia e Greqisë. Më pëlqeu shumë leksioni i tij.

Kur erdhi koha për provimet e para, rastisi që unë të jepja provim në sociologji me profesor Kanelopulosin.

Ishte njeri në zë, siç ishte i njohur dhe socialisti Svolos. Më pyeti se ku banoja. I tregova rrugën. Ai nxori një kuti me fotografi dhe gjeti një fotografi të rrugës ku banoja unë.

- Në këtë rrugë? - më pyeti.
- Si urdhëron!
- Shikoje mirë...

E pashë mirë dhe ia ktheva. Ai më pyeti:

- Kur është bërë kjo fotografi, në dimër apo në verë?

Nuk iu përgjigja.

- Në mëngjes apo në darkë?

Nuk iu përgjigja...

Atëherë ai më tha:

- Nuk je vrojtues i mirë. Më kanë thënë se ti je edhe gazetar. Je shumë i sipërfaqshëm. Pa shikoje përsëri fotografinë! Kur është bërë? Në dimër apo në verë, në mëngjes apo në mbrëmje?...

I thashë që fotografia ishte bërë në dimër, se njerëzit ishin me pallto. Ishte bërë në mëngjes, se në një kioskë dukej gazeta "Proia". (Mëngjesi)

Ai qeshi dhe më porositi të isha më i thellë, më vrojtues. Pastaj nisi nga pyetjet e lëndës për të cilën do të jepja provim. (Kanelopulosi, atëherë hiqej si socialist, po më vonë mora vesh se gjatë okupacionit u bë me gjermanët.)

Pyetje: - A ke ndonjë kujtim nga Athina?

Përgjigje:- Nga Athina?...

NJË NGJARJE QË NUK DO TA HARROJ KURRË:

Disa fshatarë të mi, vërsnikë, punonin atje. Herë gjenin punë, herë bridhnin duke kërkuar punë. Minella Koleka më kishte lidhur me disa shokë komunistë, rrobaqepës. Ata më shpinin në format e edukimit, në Odhos Eollu! Dëgjoja propagandistët e Partisë Komuniste Greke: kurdoherë me ligjërata abstrakte, me luftë kundër

fesë dhe peshkaqenëve... Disa herë mora me vete dhe shokët e mi nga fshati: Vasil Dedenë, Vangjel Neçon, Gogo Dunin etj. Ata dëgjonin. Pas ca ditësh vajtëm te një fshatar yni që i ecte fjala: ishte drejtor i Shoqërisë së Sigurimeve të Triestes dhe një nga krerët e sillogut vorioepirot. Quhej Vasil Dhimitër Muço. I ati, Dhimitri, grekoman, i cili më vonë u bë nënshtetas grek, ishte mësues, po grek më shumë se vetë grekët. Vasili ishte potent, prandaj vajtëm tek ai. Na priti mirë dhe menjëherë mori në telefon pronarin e fabrikës së gomisterisë. Quhej Qesari dhe ishte nga Lukova. I tha që të na sistemonte që të tre në fabrikën e tij, pasi që të tre ishim djem të mirë. Pastaj na u drejtua neve dhe na tha të shkonim menjëherë te Qesari. Shkuam. Na priti mirë, na dha edhe nga një mijë dhrahmi si parapagim. Na caktoi në sektorë të ndryshëm. Unë, meqë isha student, do të shkoja katër orë pasdreke, do të punoja në magazinë dhe llogari për t'i bërë pronarit një relacion të ditës për hyrjet dhe daljet. Nuk kaluan as pesë ditë dhe, kur një pasdreke shkova në punë, më thanë të largohesha menjëherë, se do të arrestohesha. Ç'kishte ngjarë? Atë mëngjes, kur punëtorët dolën për pushim, Vasil Dedeja, shoku im, kishte hipur mbi një kamion që ishte në oborr, dhe mbante ligjëratë, po ato që dëgjonte përditë në Odhos Eollu, në sallat ku bëheshin format e propagandistëve të Partisë Komuniste: "Shokë! T'i marrim fabrikat, - ligjëronte Vasili me zë të lartë, - se janë tonat. Ç'ka qenë Shën Mëria? E pamoralshme! Ç'ka qenë Krishti? Mashtrues! Ç'ka qenë Shën Pjetri? Peshkatar!" - e të tjera e të tjera. Menjëherë ra sirena. Erdhi policia, arrestoi Vasilin, Gogon dhe Vangjelin. Më kërkonin edhe mua. Unë ndenja në Falero, te vëllai. I gjori vëlla, qeshte dhe më thoshte:

- Vasili do ta bëjë revolucionin? Nuk e di ai se sa komunistë ka që punojnë në atë gomisteri? Erdhi Vasili të ndezë shkëndijat e revolucionit! - Dhe qeshte. Kurse

Vasil Muçoja erdhi në Falero, takoi vëllanë tim, Mimin, dhe i tha:

- Petroja dhe shokët e tij kërkonin punë në gomisterinë e Qesarit. Ai mezi e ka bërë, dhe këta kërkojnë t'ia marrin!

NJË NGJARJE TJETËR:

Shkova në ambasadën sovjetike. Më priti një shok e më shpuri në dhomën e pritjes. Aty pashë për herë të parë Leninin në një portret të madh. Kishte një dorë në xhepin e jelekut, ku i varej zinxhiri i sahatit. Sa mendime më lindën kur pashë Leninin! Më çuan te një shoqe, e cila më pyeti ç'kërkoja.

- Dëshiroj të shkoj në Bashkimin Sovjetik për studime!

I thashë me pak fjalë gjendjen time. Ajo i ra ziles dhe thirri një shok. Ai erdhi, më dha dorën. Ata flisnin rusisht, por gruaja dinte greqisht.

- Të na shkruash me pak fjalë biografinë tënde dhe të na thuash se kush të dërgoi këtu! Cilin nga shqiptarët që janë në Bashkimin Sovjetik njeh ti, dhe cilin nga shokët komunistë grekë njeh? Pastaj do t'ju përgjigjemi.

Të nesërmen unë çova biografinë dhe kërkesën. Nga shokët shqiptarë përmenda: Sejfulla Malëshovën, Llazar Fundon, jo se i njihja personalisht, por se kisha dëgjuar nga shokët që ata ishin në Moskë. Nga shokët shqiptarë në Shqipëri përmenda Demir Godellin, Asim Vokshin, Bedri Pejanin, Ali Kelmendin e të tjerë. Nga shokët grekë nuk njihja ndonjë me rëndësi, po përmenda vëllanë tim, Dhimitrin.

- Eja pas një jave, - më tha shoqja që dinte greqisht.

Kur shkova pas një jave në ambasadën sovjetike, në zyrën e shoqes, erdhi edhe një ushtarak, me pantallona blu me vijë të kuqe anash. Më dha dorën dhe më tha:

- Dy rrugë janë për të shkuar në Bashkimin Sovjetik:

1) me pasaportë, duke u nisur si turist, - dhe më treguan se në Platia Sintagmotes ishte zyra e turizmit, - dhe 2) ilegalisht...

- Por ilegalisht, - më tha shoqja, - është shumë e vështirë. Duhet të presim ndonjë anije sovjetike në limanin e Pireut dhe aty ju do të hyni me një shënim që do t'jua japim ne. Mirëpo ka raste që vaporët sovjetikë kontrollohen, ndaj ju duhet të qëndroni në cisternë, brenda në ujë, për shumë kohë. Tani zgjidhni rrugën që parapëlqeni!

Unë nuk u përgjigja. Ajo e kuptoi dhe më tha:

- Mendohuni mirë dhe, po vendosët, ejani të na thoni.

U largova pa shpresë për të shkuar në Bashkimin Sovjetik. Kaluan ditë. Mendova e mendova dhe nuk vendosja. Edhe vëllai im ma bëri shumë të vështirë vajtjen në Bashkimin Sovjetik. "Atje venë shokë përgjegjës, që persekutohen, ose me shërbime të veçanta nga Partia. Ti nuk je as anëtar i Partisë!"

Kështu që shpresa për të shkuar në Bashkimin Sovjetik u shua.

Pyetje: - Kur u ktheve në atdhe?

Përgjigje: - U ktheva në verën e vitit 1935, me këtë qëllim: të përpiqesha se mos merrja në Tiranë ndonjë rekomandim për ambasadorin tonë në Athinë, që ishte nga Leskoviku; dhe mbiemrin Leskoviku e kishte. E dija se në ambasadë kishte nevojë për një ndihmëssekretar, ndaj do të përpiqesha me anën e shokëve dhe miqve, që Ministria e Jashtme të më jepte një shkresë për ambasadorin.

Unë ndërkohë kisha botuar shumë vjersha në revista të ndryshme: "Ylliria", "Rilindja" e të tjera. Në Athinë, në kopshtin e madh të Zhapios, kisha shkruar dhe "100 lot mërgimtari", vjersha tetërrokëshe, tetëvargëshe, pjesën më të madhe të të cilave e kisha dërguar për botim.

Në Tiranë u takova me shokët: Demir Godelli, Ali Kelmendi, Bedri Pejani, Mane Nishova, Vasil Shanto e të

tjerë, të cilët ishin gjallëruar shumë. U njoha me Hasan Reçin, me Mustafa Gjinishin, shtova shoqërinë me Tajar Zavalanin, me Branko Merxhanin, i cili më premtoi se do të shkonte vetë te ministri i Punëve të Jashtme që të më siguronte një shkresë për ambasadorin në Athinë.

Pyetje: - Domethënë në Tiranë shokët i gjete më të përgatitur?

Përgjigje: - Në Tiranë kazani ziente...

VITI 1935 - NË TIRANË
KRYENGRITJA E FIERIT

Siç e thashë më lart, në Tiranë kazani ziente. Pashë se shokët ishin shumë të gjallëruar. Takova dhe Zenel Hekalin, i cili më tha:

- Bëre mirë që erdhe, se kemi shumë punë...
- Ç'punë kemi?
- U njohe me Riza Cerovën?
- Jo! Pse, ka ardhur?
- Ka ardhur, po do të flasim.

Edhe Demiri më tha:

- Kemi ngjarje me rëndësi! E takove Riza Cerovën?
- Jo!

Më caktoi një takim në hotel "Evropa", që ishte në zemër të Pazarit të Vjetër. Aty takova dhe Mane Nishovën dhe shumë shokë të tjerë. Ata më thanë se Riza Cerovën e kishte thirrur ministri i Punëve të Brendshme, Musa Juka. Nuk më erdhi mirë. Për Rizanë kisha dëgjuar të më flisnin edhe Esat Dishnica e të tjerë dhe e desha siç duan tërë të rinjtë heronjtë. U mërzita që e kishte thirrur Musa Juka, mendova që ai do t'i ofronte ndonjë ofiq dhe "heroi" im do të bëhej edhe ai si të tjerët... Prandaj m'u prish gjaku.

Ai erdhi afër drekës. Ishte një burrë i madh, me pamje

impozante, me një veshje të varfër (që më bëri përshtypje): pantallona sportive me arna te gjunjët...

Ai u përshëndet me të gjithë. I thashë se kush isha. Më dha dorën. Ma shtrëngoi. U ul dhe tha pak a shumë këto:

- Lartmadhëria paska menduar për mua. Musa Juka më tha se mbreti kishte urdhëruar që unë t'i merrja të gjitha rrogat, qysh më 1924, kur ika, si edhe gradën e majorit!

Mua nuk më erdhi mirë. "Vate dhe ky!" - thashë me vete, por sa u gëzova, kur e dëgjova të thoshte:

- I thashë se gradat i kam lënë në Shkallën e Tujanit. Sa për rrogat, nuk kam bërë ndonjë punë që të kem të drejtën e rrogave. Nuk jam për sadaka. Kam ardhur të çmallem me njerëzit e mi.

Ashtu si unë, edhe të tjerët u gëzuan pa masë. Desha të ngrihesha e ta puthja. Ai, pasi foli me të tjerët, m'u kthye:

- Po ti, ç'punë bën?

- E kemi poet! - tha Mane Nishova.

Ai buzëqeshi dhe më tha:

- Poet i kujt je ti?

- Poeti ynë! - tha Demir Godelli dhe më hodhi krahun në qafë.

Rizai buzëqeshi:

- Poetët tanë duhet të jenë trumbetë alarmi! - dhe më shikonte në sy me mirësi. - Dhe jo si disa kalemxhinj. Poet është Noli. Po! Ai është trumbetë alarmi. Mësoni nga poezia e tij!

Më pëlqeu shumë njëri nga "heronjtë" e mi. Atë kohë ne kishim nevojë për "heronj", domethënë për shokë të ndershëm, patriotë, revolucionarë me karakter, me dinjitet, me personalitet, që nuk përkuleshin, që qëndronin të fortë. Dhe kishim shumë të tillë, sidomos ata që ishin në mërgim e në burgje. Ne krenoheshim me

emrat e Avni Rustemit, Luigj Gurakuqit, Bajram Currit. Shpresonim te Fan Noli, Qazim Koculi, Sejfulla Malëshova, Llazar Fundoja, Halim Xheloja, Omer Nishani e të tjerë, që, në mërgim, luftonin kundër regjimit të Zogut. Midis tyre ishte dhe Riza Cerova. Kishin ardhur nga Bashkimi Sovjetik shokë si Tajar Zavalani, Demir Godelli, Ali Kelmendi, Selim Shpuza, Reshat Këlliçi e të tjerë, por nga këta, përveç Demirit dhe Tajarit, nuk kishim parë gjë deri atëherë. Demiri ishte më aktivi, më i ndershmi, më proletari, më bolsheviku. Bedri Pejani tregonte se si kishte njohur Dimitrovin. Ai kishte shumë njohuri dhe fliste hapur për komunizmin. (Për këta do të flas më poshtë, më gjerë, sepse ne i kishim si mësues.)

Pra, kur Rizai na tha se nuk kishte pranuar asnjë post, ne u gëzuam pa masë. Kishte një fytyrë të çiltër dhe portreti i tij më ka mbetur i skalitur në kujtesë si një nga figurat e pastra revolucionare. Kjo, ndoshta, për fundin e tij tragjik. Ai më mori shumë herë mënjanë dhe qe i pari që më foli për revolucionin që po përgatitej. Një mbrëmje, në dhomën e tij ishin dhe Demiri, dhe Asim Vokshi. Ai më fliste: "Do të shkosh menjëherë në Himarë. Aty ke shokët e tu dhe unë kam miqtë e mi, si Thoma Varfin, Simo Zoton. Me ta do të bisedosh, që të jeni të gatshëm. Ti me djemurinë tënde, sidomos me arsimtarët dhe me Gjolekët, që i ke miq, të jeni të mobilizuar, pa marrë vesh tabori i hafijeve, se kudo ka taborë spiunësh. Përpiqu me anën e Simo Zotos a të Neço Mukës, që ta bëni për vete përgjegjësin e postës së Himarës. Sapo të jepet shenja, menjëherë ju do të zini Llogaranë dhe Grykën e Kuçit. Me të marrë urdhër, me ata shokë që të keni mobilizuar, të çarmatosni xhandarët dhe të niseni përsëri për atje ku do t'ju urdhërojnë të shkoni. (Pak a shumë këto ishin udhëzimet e Rizait.) Nëse nuk ke të holla, do të të rregullojmë, prandaj nisu sa më parë!"

Që aty shkova në shtëpinë e Asimit. Ai më foli më

gjatë për organizatën dhe më tha; "Sipas urdhrit të Kominternit, ne, si komunistë, duhet të jemi në ballë të çdo lëvizjeje popullore kundërfeudale. Në këtë organizatë ka edhe elementë heterogjenë, po ne duhet të jemi në krye për të forcuar lëvizjen tonë revolucionare.

U nisa për në fshat. Shkova në Vuno, fola me Thoma Varfin; në Himarë bisedova me Simo Zoton e me disa miq të mi. U përpoqa të takohesha me Xhevdet e Bejkush Gjolekën; shkova në Kuç, por më thanë se mund t'i gjeja në Delvinë ose në Sarandë. I shkrova letër Bejkushit që duhej ta takoja patjetër. Aty nga fundi i korrikut më shkroi një letër dhe më tha se do të shkonte në shtëpi javën e parë të gushtit. Vajta dhe e gjeta. Më priti mirë, me zemër e me gjithë të mirat. Gjithnjë qeshte dhe kishte qejf të këndonim si në Dhuvjan. Kur i fola për qëllimin e takimit, ai u vrenjt dhe më pyeti: "Po me kë kemi të bëj-më?" I fola për Riza Cerovën e për shokët e mi që njihja. I përmenda dhe Asimin. Dhe ai, pa u menduar fare, më tha: "Po qenë ata në krye, mirë do të dalë puna. Po këtej ka shumë halera. Sa për veten time, unë, si postëkomandant i një poste të xhandarmërisë, ja ku po ta them troç: menjëherë i bëj xhandarët e mi që të bashkohen me kryengritësit..."

Atë kohë Jugu ishte më antizogist, sidomos Vlora dhe Labëria, se dyshohej që Zogu kishte lidhje me Romën, kështu që ato krahina që kishin vuajtur e luftuar kundër Italisë, patjetër që do të luftonin edhe kundër Zogut, megjithëse ai kishte aty shumë krerë dhe oficerë të tij.

U ktheva në fshat dhe, duke biseduar me njerëzit e mi, u jepja të kuptonin se për së shpejti do të shpërthente kryengritja; puna qe se me kë do të ishim ne, me Zogun apo me kryengritësit. Një kushëriri im, Spiro Bua, më pyeti: "A do të jenë edhe ata me programin e Nolit, i cili kërkoi që edhe ne të paguanim xhelepet?" (Ai aludonte

për vitin 1924, kur populli ishte mjaft i lodhur e i robtuar nga pagesa e xhelepit dhe u ndez lufta me gra e u vranë disa prej tyre.) I thashë se kryengritja ishte për shpëtimin e popullit nga tirania dhe nga rreziku i pushtimit italian. Ai u bind. Ishte njeri i thjeshtë, i ndershëm. "Ne me ty jemi, more vëlla. Puna është që të mos vuajmë pastaj në litar e në burgje."

Aty nga fundi i gushtit erdhi lajmi se kryengritja dështoi! Si!? Po kur nisi kryengritja? Pse nisi shpejt, pa lajmëruar? Shumë pikëpyetje...Shumë shqetësime! Prisnim lajme. Nga Himara më lajmëruan se nuk ishte bërë gjë. Të gjithë u shpartalluan. Edhe Riza Cerova u vra. Kishin filluar arrestimet në masë. Ç'duhej të bëja? Erdhi në Dhërmi Thoma Varfi dhe më porositi që të ikja sa më parë, sa më parë të zhdukesha. Dërgova në Vlorë vëllanë me pasaportën te Gogo Ruci, që ishte kafaz në konsullatën greke të Vlorës, që t'i vinte një vulë pasaportës. Vëllai shkoi dhe ai i kërkoi një napolon për një vulë. "Do të ta japim napolonin, - i tha vëllai, - por tani Petroja është në rrezik! Ndihmona, se napolonin nuk e humbet nga ne!" Gogo Ruci, njeri i zakonit, e vulosi pasaportën, pra u mor viza. Vëllai më dërgoi lajm të veja menjëherë në Vlorë. Mora pasaportën dhe shkova në skelë, tek Ibrahim Shyti. Aty fjeta. Ibrahimi ishte dëshpëruar shumë për dështimin e kryengritjes. Me të fola gjer në mëngjes, gjersa më përcolli për te vapori jugosllav që bënte rrugën për në Korfuz. Më dha një napolon. Hipa në vapor dhe mora rrugën e mërgimit. Në Sarandë nuk dola fare në kuvertë të vaporit, i cili qëndroi atje disa orë e pastaj u nis për në Korfuz.

Pyetje: - Si munde të shpëtoje?

Përgjigje: Rastësia. Po, rastësia, se unë vendosa menjëherë të ikja dhe pasaportën e kisha. Kushëriri im Jani, që ishte i shkathët, më urdhëroi: "Ikë sa më parë!

Po të duash, paguajmë ndonjë të të hedhë përtej me varkë!" - Sapo kishin filluar arrestimet dhe emrat e shokëve ende nuk kishin dalë. Unë, të them të drejtën, u dëshpërova pa masë për këtë dështim, sidomos kur dëgjova se u vra Riza Cerova. Asgjë nuk mendoja. Çudi: i vetmi shqetësim ishte që të arratisesha e të mos më arrestonin. Ende nuk ishin vënë në veprim masat ndjekëse ashtu siç duhej. Ishin ditë rrëmuje dhe pasigurie. Nuk isha ndonjë personalitet i njohur dhe mundësitë e arratisjes ishin të shumta. Veç të isha budalla që të bija në duart e xhandarëve. Edhe një gjë: te ne nuk kishte shumë spiunë. Edhe ata që ishin, shikonin punën e tyre, nuk donin të armiqësoheshin me familjet e fshatit dhe të krahinës. Mua më donte fshati, prandaj besoja se nga asnjë prej fshatarëve të mi nuk do të tradhtohesha, as prej parisë, që ishte shumë e matur dhe nuk deshi të kishte pasoja për denoncimet, se e dinin që do të hakmerreshim.

Pyetje: - Kur arrite në Korfuz, si e gjete kolovinë e të arratisurve politikë?

Përgjigje: - Menjëherë shkova dhe takova Dr. Omer Nishanin, i cili u çudit kur më pa. Ai ishte në dijeni të situatës dhe më foli gjatë për arrestimet e shumta që po bëheshin. Më foli me shumë pikëllim për humbjen e njërit nga shokët më të mirë, Riza Cerovës. "Gjysma e Shqipërisë është në burg. Ka filluar kërbaçi në Fier." Dhe më tregonte ato që dinte: Se si u bë gabim qysh në fillim, se në këtë organizatë bënin pjesë edhe bejlerë, oficerë të lëkundshëm, agallarë frikacakë. Pastaj gabimi i dytë i madh qe se kryengritja filloi para kohës së caktuar.

Unë e ndieja veten si të humbur, të dëshpëruar. Ç'do të bëja tani? Atje vinte shtypi i Tiranës dhe ne lexonim vargun pa mbarim të të arrestuarve. Shikoja emra të dashur, si Asim Vokshi, Demir Godelli, Hasan Reçi,

Mustafa Gjinishi e të tjerë. Edhe shtypi grek shkruante për Kryengritjen e Fierit. Tregonte se si ishte vrarë gjeneral Gjilardi, se si krerë të kryengritjes, Zenel Hekali, Kostë Çekrezi, Musa Krantja e të tjerë, kishin shpëtuar duke u larguar me një benzinatë dhe kishin arritur në Itali.

Por me hollësi u njoftova nga Vasil Konomi, që erdhi në Athinë. Edhe Vasili qe pjesëmarrës i Kryengritjes. Nga ai mësova këto:

"Më 25 gusht u mblodhëm në sheshin e vogël para zyrave të nënprefekturës së Fierit. Në ato çaste u duk gjeneral Gjilardi, i cili shkonte shpesh në Myzeqe edhe për gjah, edhe për gra. Ishte gjeneral i huaj, më duket austriak, që i shërbente Zogut në çështje intime... Kur e panë gjeneralin, iu vërsulën dhe e vranë. I morën napolonat e shumtë që mbante në qemer, dhe me ato napolona paguan një benzinatë italiane që peshkonte në ujërat tona, për të shpënë në Itali krerët e kryengritjes.

Pas vrasjes së gjeneralit ra një heshtje e madhe në popull. Atëherë nga ballkoni i ndërtesës dykatëshe Zenel Hekali mbajti ligjëratën e famshme: "Nuk jam as Demosten e as Ciceron, po një mësues i thjeshtë. Katili Ahmet Zogolli, i vetëkurorëzuar si monark august, u vra. Bërtitni poshtë mbreti!" Po shumica heshti, ndërsa një pjesë thirrën: "Rroftë Mbreti!" Zeneli u nxeh dhe thirri më fort: "Mos thoni më rroftë, por poshtë mbreti!" Përsëri u dëgjuan zëra të mekur: "Rroftë mbreti!" Zeneli u ndez nga zemërimi: "Jo, mre, rroftë, por poshtë, poshtë, poshtë mbreti!" U dëgjua një zë nga mesi i turmës: "Ne, more vëlla, rroftë jemi mësuar të themi gjithë jetën." - Vasili vazhdonte të më tregonte: U mblodhëm dhe u nisëm për në Lushnjë. Ashtu ishte caktuar misioni ynë. Aty do të takoheshim me luftëtarët që do të udhëhiqte Riza Cerova - luftëtarë nga Skrapari dhe Berati. Por, në vend të

luftëtarëve, çuditërisht, aty gjetëm ushtrinë dhe xhandarmërinë e Zogut".

Shkaqet e dështimit përsëriteshin: 1. Filloi para afatit të caktuar. 2. Brenda në lëvizje kishte njerëz të mbretit. Por tani e keqja ishte se gjysma e Shqipërisë lëngonte në burgje. Njëmbëdhjetë xhandarë u pushkatuan. Dhjetëra të dënuar me vdekje prisnin ekzekutimin...

Kurse ana e Koço Tasit dhe e shokëve të tij thoshte: "Më mirë që dështoi, se do të kishte ndërhyrë ushtarakisht Musolini, sipas traktatit që kishte lidhur me Zogun: "Po të jetë Shqipëria në rrezik, qoftë nga brenda, qoftë nga jashtë, Italia fashiste duhet të ndërhyjë menjëherë".

Morëm letër nga Zylyftar Veleshnja, që ishte arratisur dhe nga Janina kishte shkuar në Selanik.

Vasili vazhdonte të më tregonte odisenë e tij: "Sapo u shpërndamë, unë nuk i arrita dot shokët që u nisën për në Itali me një benzinatë peshkatarësh. Arrita në Ujë të Ftohtë, u fsheha dhe, kur pashë në det një karav që ishte në liman, mora një varkë, hodha teshat në breg, që të kujtonin se isha mbytur, dhe arrita karavin italian. Iu luta kapitenit dhe ekuipazhit të më fshihnin. Më mbështollën me pëlhurën e madhe, se mos vinte policia dhe xhandarmëria për të kontrolluar, pasi të gjenin teshat e mia në breg të detit. Ndenja i mbështjellë ashtu gjithë ditën. Kur karavi u nis dhe doli nga Sazani, atëherë më liruan. Gati po vdisja nga asfiksia. Arrita në Bari, ku më burgosën. Gjeta aty dhe shokë të tjerë, Zenelin, Kostë Çekrezin e të tjerë. Na vunë kusht: ose menjëherë të linim tokën italiane, ose, përndryshe, do të qëndronim në burg. Unë dhe Zeneli shprehëm dëshirën të shkonim në Jugosllavi. Shkuam në Zagreb. Unë para ca kohësh kisha qenë në Zagreb, në një olimpiadë ballkanike dhe si shtytës i gjyles isha i njohur. Kisha njohur dhe një vajzë të bukur. I shkova nën dritare në mbrëmje, por nuk i fishkëlleva, se isha katandisur si Zhan Valzhani."

I gjori Vasil, gjithnjë me sport dhe dashuri!

Shtypi përparimtar botëror, sidomos ai francez, botonte artikuj e lajme për terrorin e madh që kishte pllakosur në Shqipëri, për burgimet, për ekzekutimet. Ahmet Zogu me propagandën e tij përgjigjej se Lëvizja e Fierit ishte lëvizje komuniste e përgatitur nga Moska, prandaj kërkonte ndihmën e Evropës kundër komunizmit. Emra të shquar të asaj kohe, si Ainshtaini, Barbysi, Romen Rolani e të tjerë protestonin dhe kërkonin shpëtimin nga ekzekutimi i dhjetëra shqiptarëve të dënuar me vdekje. Ndihma e Kuqe Internacionale kishte botuar edhe një kartolinë me Riza Cerovën të vrarë dhe mblidhte ndihma për të burgosurit e të persekutuarit nga mbreti Zog. Emigracioni politk shqiptar, kudo ku ishte, shqetësohej për fatin e të burgosurve, që ishin me qindra. Thoshin se një komision nga Evropa shkoi atë kohë në Tiranë për të parë me sy gjendjen e të burgosurve. Dhe atje panë një farsë të kurdisur mirë nga Musa Juka, ministër i Punëve të Brendshme: Në hotel "Internacional" kishte shumë spiunë të rafinuar, të veshur si të burgosur, që kishin marrë emrat e shumë të burgosurve të shquar të Lëvizjes së Fierit. Komisioni e vizitoi këtë burg-hotel mise en sc□ne"[1] dhe foli me "të burgosurit politikë" (spiunët e Musa Jukës). Ata luanin me letra, luanin shah, këndonin libra e gazeta, hanin mirë, pinin mirë, vizitoheshin përditë nga familjarët. Komisioni u habit me këtë "trajtim shumë njerëzor të të burgosurve nga ana e regjimit të Zogut" dhe u largua nga Shqipëria me përshtypjet më të mira. Por shtypi ynë i jashtëm dhe ai përparimtar e demaskuan këtë farsë, ndaj fushata kundër regjimit të Zogut u shtua. Atëherë Zogu, menjë-herë e rrëzoi qeverinë despotike dhe solli në pushtet një

1) - inskenim

qeveri liberale, me në krye Mehdi Frashërin, i cili, sapo erdhi në fuqi, mbajti një ligjëratë në kinema "Nacional" ku, midis të tjerash, tha: "Do ta bëj unë gjendjen, që Zogu, mbreti ynë august, të shëtitë lirisht në bulevard me bastun në dorë. Do ta bëj unë Shqipërinë e varfër të pasur, sa të eksportojë karafila!"

Filloi "liria e shtypit", pra gazetat e reja, tani shkruanin më lirisht. Pena e Tajar Zavalanit dhe e Branko Merxhanit, ajo e Vangjel Koçës dhe e Ismet Totos, ajo e Nebil Çikës dhe e Gjergj Bubanit nisën të shkruanin artikuj që zbulonin gjendjen e keqe të vendit dhe polemizonin me kontradiktat e thella historike. Në atë kohë, aty nga tetori i vitit 1935, më shkruan një letër Vangjel Koça dhe Branko Merxhani, që të kthehesha menjëherë në atdhe, se do të botonim një gazetë të re. U ktheva në nëntor të atij viti.

PËRSËRI NË TIRANË
1935-1936-1937

VITE ME DENSITET NGJARJESH

Pyetje: - Si e gjete Tiranën dhe shokët në vjeshtën e vitit 1935?

Përgjigje: - Ishte një kohë kur unë nuk besoja të kthehesha më në Shqipëri, se shokët dhe shtypi e kishin përshkruar qartë gjendjen e rëndë, me terrorin e madh që kishte pllakosur vendin. Mua më dukej se Zogu me spiunët e tij nuk do të linin gjallë asnjë shok, se ai kishte mbështetjen e plotë të Musolinit, i cili ishte xhelati i antifashistëve. Por ja që letra e Brankos dhe e Vangjelit më siguronte për çdo gjë dhe më duhej të kthehesha patjetër. Të dyja ato firma, Branko Merxhani (me pseudonim: br. Tri yje) dhe Vangjel Koça (me pseudonim: Nirvana) ishin nga më të njohurit e asaj kohe, bashkë me Tajar Zavalanin (me pseudonim: Zaks, Tarzani).

U nisa dhe kalova nga Korfuzi. U takova me Dr. Nishanin, i cili më priti mirë dhe më dha shumë porosi e udhëzime për Demirin dhe Tajarin. Ai më tha pak a shumë këto: "Të kemi mendjen se kjo lojë e Zogut është kalimtare, por ju mundohuni të përfitoni sa më shumë, veç me një kusht: shokët me përgjegjësi të mos ekspozohen shumë dhe sa të jetë e mundur të shtohen

radhët me shokë të rinj, sidomos me arsimtarë, oficerë, studentë dhe specialistë. Demaskoni sa të jetë e mundur sistemin dhe botoni sa të jetë e mundur letërsi përparimtare e revolucionare. Por koha do të jetë e shkurtër. Kini mendjen!"

Nuk e përshkruaj dot tronditjen që më ngjallën malet e Shqipërisë, kur i pashë, ndërsa kthehesha në atdhe. Nuk dola në Sarandë. Udhëtova me vaporin "Barleta" gjer në Durrës. Shikoja bregdetin tonë të mrekullueshëm dhe përfytyroja njerëzit e varfër, por të lirë dhe kryelartë që banonin atje. Pak a shumë ndjenjat e mia i kisha shprehur në vargje, në "100 lot mërgimtari", që i kisha shkruar në kopshtin e madh të Zhapios, kur rrija i vetmuar e trishtohesha për fatin tim dhe për fatin e njerëzve të mi që lëngonin në Atdhe...

Nga Durrësi menjëherë u ktheva në Tiranë. Ishte ditë me shi dhe nuk munda të takoja asnjeri. Nuk kisha as çadër. Shkova në hotel "Evropa" dhe mezi gjeta një shtrat, në një dhomë ku flinin tetë veta. Lekë nuk kisha fare. Kujt t'i drejtohesha? M'u kujtua se aty pranë hotel "Evropës", nga Pazari i Vjetër, afër pusit, kishte dyqanin një bashkëfshatar imi bashkë me një Toto, nga Borshi; ata shisnin verëra, raki e të tjera. Ishte mbrëmje kur shkova tek ai dyqan. Nuk gjeta fshatarin tim, që quhej Gjikuria, por Totón, i cili më njohu dhe më përqafoi. Më qerasi me një gotë verë. Më pyeti për shumë gjëra dhe unë i thashë se si kisha ardhur. Ai kujtonte se edhe unë kisha qenë në burg dhe isha falur bashkë me shumë të tjerë. Më tha se ishte falur edhe Asimi. Më foli edhe për Brankon. Ai më dha një napolon dhe më porositi që, kur të kisha nevojë, t'i drejtohesha pa druajtje. Kalova dhe nga hotel "Berlini", ku shpesh mblidheshin shokët si Demiri, po nuk gjeta njeri. Kur u zgjova në mëngjes, vura re se isha mbushur me morra.

Të parin që takova, qe Bedri Pejani, në kafe "Kursal".

Ai rrinte vetëm në një tryezë. Në fillim nuk më njohu:" Të mora për ndonjë spiun, - më tha, - se spiunët edhe tani që erdhi qeveria e re, liberale, nuk më ndahen. Të njëjtët janë..." U përqafuam. Nga ai mësova të rejat, ose më mirë krejt situatën si në pëllëmbë të dorës. Pak a shumë edhe ai më foli si Dr. Omer Nishani: "Të kemi mendjen, se kjo lojë e Zogut është e rrezikshme, por ne duhet ta shfrytëzojmë në maksimum, po me kujdes!..."

U takova me Asimin. Në familjen e tij si babë e nënë ishte Bija, halla e Asimit, një grua e mprehtë, e dashur. Asimin dhe shokët e tij i donte dhe i ruante si sytë e ballit. Ai më foli gjatë për situatën dhe për shokët në burg. Duheshin mbledhur ndihma për shokët që ishin në Kalanë e Gjirokastrës dhe në burgun e Durrësit. Aty fjeta. Të nesërmen më shpuri te Demiri, i cili u gëzua pa masë kur më pa. Ishte i mirë Demiri, shoku më i mirë nga ata që u kthyen nga Bashkimi Sovjetik. Tajari kishte përkthyer romanin "Nëna" të Gorkit dhe, sipas thënieve të Demirit, shokët, e sidomos ata të Korçës, kishin mbledhur ndihma për ta botuar këtë roman, për të paguar shtypshkronjën. "Tani, - më tha Demiri, - pena jote duhet të tregojë se edhe ne dimë të shkruajmë e të qajmë hallet e popullit."

U takova me Tajarin dhe me Brankon, që bënte jetën e asketit. Brankoja u tregua më i dashur me mua, më i kujdesshëm dhe më ftoi të hanim bashkë në restorant "Adriatiku", ku hahej shumë mirë. Ai nuk pagoi, sepse ishte i abonuar aty: i shkruante në një defter ato që porosiste, dhe, kur kishte para, paguante. "Ha, - më thoshte, - ha, të paktën të ngopemi me bukë në këtë limer ujqish dhe injorantësh!" Ai më tha se do të botohej një gazetë që do të ishte organi i qeverisë liberale. " E kemi quajtur "Koha e re". Dhe ti do të jesh një nga redaktorët me përgjegjësi. Këto ditë do të fillojmë nga puna. Mos u nxito kur të shkruash, dhe ki kujdes që çdo shkrim të

ngrejë një problem të kohës. Ti e di vetë, po ne duam që gazeta jonë të jetë... si të ta them, të informojë dhe të formojë."

Në dhjetor të vitit 1935 filluam botimin e "Kohës së re." Zyrat i kishim pas ndërtesës së Ministrisë së Botores, aty ku sot është klubi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në katin e dytë. Suat Asllani ishte drejtori politik, një avokat i mirë, demokrat dhe patriot. Ai më porositi që të mos nxitoheshim në shtrimin e problemeve si në shtetet demokratike. U bë lista e organikës. Mua më ishin caktuar të merrja 200 franga në muaj! Rrogë e madhe. Rrogë do të merrte dhe Brankoja, 200 franga në muaj. Të tjerët: Suat Asllani, Tajar Zavalani, Vangjel Koça e të tjerë nuk do të merrnin rrogë. Më thanë: "50 franga në muaj do t'i prishësh ti, 50 franga do t'ia dërgosh motrës sate, Lilos, kurse 100 franga do t'i ruash për çdo eventualitet, ndoshta edhe për të vazhduar studimet më vonë, se nuk dihet se si do të na vejë kjo punë..."

Mora listën e personelit me rroga dhe shkova në Ministrinë e Brendshme, për ta nënshkruar vetë ministri, Ethem Totoja. Kur hyra në zyrën e tij, më bëri përshtypje pamja e egër dhe imponuese. Kishte sy paksa të mëdhenj dhe fytyrë të gjerë të kuqërremtë. Më buzëqeshi dhe më shtrëngoi dorën." Është koha që djemuria të tregojë aftësitë e saj, të tregojë se Shqipëria e Zogut kërkon njerëz me energji të reja dhe me vitalitet. Po kini mendjen nga korrentet e dëmshme, se mbretëria nuk lejon anarkizma." Fliste dhe shikonte listën. Buzëqeshi dhe tha greqisht:" Jese mesa! (Dhit në të!)" Ishte më këmbë. Më shikoi në sy:

- Pa shih, pa shih! Idealistët! Ç'rroga të majme duan!

Aty për aty iu përgjigja:

- Besoj se edhe ju keni një rrogë të mirë! - Heshta, se ai më shikoi vëngër. - Ku ta gjejmë që të vijë ajo kohë kur do të jetojmë pa rroga.

Ethem Totoja u bë serioz. U ul në tryezë, po në atë tryezë që rrinte para disa muajsh Musa Juka. Unë, duke njohur vëllanë e tij, Ismetin, kisha njëfarë guximi dhe sinqeriteti, prandaj qëndroja qetë, sikur të flisja me një njeri të njohur, që më donte të mirën.

E nënshkroi dhe ma dha duke më thënë:

- Kini mendjen e mos na e bëni gazetën si ato të Greqisë, nga ke ardhur ti. Atje është anarki dhe shtypi mbahet me sensacione dhe shkrime turli-turli. Këtu kemi një mendim: si ta bëjmë Shqipërinë të përparuar. Si ta mbajmë popullin me informata të sakta dhe artikuj e shkrime që i përshtaten karakterit të tij nacional e patriotik.

Kur u takova me Demirin, i shpreha përshtypjet e mia për Ethem Toton.

- Ai është një funksionar i lartë i mbretit. Po ne duhet të përfitojmë shumë me këtë qeveri liberale.

Në gazetë njoha dhe Isuf Kambën, që ishte administrator. E kishte marrë Suat Asllani, drejtori i gazetës, se e kishte nga Libohova. Si redaktor kisha për detyrë të mblidhja lëndën, të interesohesha për kryeartikullin ose për artikullin redaktorial. Unë shkruaja ndonjë skicë me pseudonimin DEMO-KOTI (Demokrat Komunisti). Këtë lloj bashkimi rrokjesh e mësova nga shtypi grek.

Përpiqesha të zgjidhja lëndë problematike, sidomos të nxjerrë nga letrat dhe telegramet e shumta që na vinin nga rrethet. Harrova të përmend më të rëndësishmen: "Koha e re" ishte organ i qeverisë së re. Vetë Ethem Totoja më porositi: "Kijeni në mend: është organ i qeverisë, prandaj sakën se bëni budallallëqe! Këtë e di mirë Suati dhe gjithë ata që janë rreth tij."

Vija re se më të shumtën e kohës qëndroja vetëm në gazetë. Të tjerët vinin rrallë. Suati vinte shpesh dhe më pyeste se si ishte lënda. E merrte lëndën, i hidhte një sy,

buzëqeshte dhe më porosiste: "Ta marrim punën me ngadalë, jo me vrap."

Afrohej dita e triumfit të Legalitetit (24 dhjetor, dita kur hyri në Tiranë Zogu, i ndihmuar nga forcat reaksionare fqinje, sidomos nga qeveria e Beogradit, më 1924), dhe patjetër duhej një kryeartikull për atë ditë të shënuar të mbretërisë. E pashë se që të gjithë largoheshin. Erdhi dita e 23 dhjetorit. Lënda duhej bërë gati për ditën e nesërme. Asnjë nuk dukej. Më duhej ta bëja vetë. Dhe në vend të kryeartikullit vura një telegram që vinte nga Tepelena: *"Populli i Tepelenës, pa bukë! Ç'bën qeveria? Ku i ka premtimet?"* E shpura lëndën në shtyp, në shtypshkronjën "Nikaj." Aty punonte dhe e vetmja femër, Luçia e heshtur, që radhiste me shpejtësi dhe saktësi! Një grua e imët, kokulur, punëtore.

Kur bëhej gati gazeta, para se të shumëfishohej, duhej që kopja e parë të kalonte nga Zyra e Shtypit, në Ministrinë e Brendshme. Po të miratohej, firmosej dhe atëherë fillonte shtypja. Kur e shpura kopjen në ministri, më thirri Ethem Toto dhe më bërtiti: "Ku jemi këtu, në Greqi? Ç'është ky artikull alarmant? Ky është artikulli për ditën e sotme, që është festë kombëtare?" Ai thërriste, fliste, shante, pastaj e bëri copë-copë gazetën duke më bërtitur: "Të vijë këtu sa më parë ai tutkuni, avokat Suat Asllani, që e ka lënë gazetën në duart e anarkistëve!"

Gazeta, pas nja trembëdhjetë numrash, u mbyll. Mua ma hodhën fajin. Tek unë u shkarkua gjithë zemërimi i ministrisë. Mbeta pa punë. Më kërkonin disa gazeta si korrespondent, të bëja reportazhe. Me shumë lutje të Brankos dhe të Vangjel Koçës më mori Asim Jakova tek "Ylliria". Asimi ishte një deputet mendjemadh, që e deshi shumë mbreti dhe që kishte si grua motrën e Cilkës, një grua fisnike dhe shumë simpatike. Edhe ajo ndërhyri që unë të punoja tek "Illyria".

Pyetje: - Nuk u mor asnjë masë kundër trupit redaktorial të "Kohës së re"?

Përgjigje: - Me sa mbaj mend, nuk u mor asnjë masë administrative. Nga ato që dëgjoja prej Brankos, puna qëndronte këtu: Ethem Totoja, i vënë nga Zogu, kërkonte që këto firma: Vangjel Koça, Branko Merxhani, Ismet Totoja e të tjerë, të shkruanin për mbretin, për reformat, duke e cilësuar si monarkun më përparimtar të Evropës. Por as Brankoja e asnjë tjetër nuk e bënin këtë. Brankoja u angazhua te revista "Ylliria" me 80 franga në muaj dhe unë me 40 franga në muaj. Të tjerët ishin me punë.

Pyetje: - Sa kohë punove tek "Illyria?"

Përgjigje: - Jo shumë. Dhe ja pse: në zyrat e redaksisë qëndronte kurdoherë njëfarë K.G. Ky kishte një fytyrë kuqalashe. Karakteret tona nuk pajtoheshin. Me këtë rast duhet të shënoj këtu se si e përcaktoi karakterin e tij Krist Maloku (më vonë, pas një viti, kur punoja në revistën "Përpjekja shqiptare", shkruante artikuj dhe Krist Maloku nga Austria, me pseudonimin Krisma.) Na shkroi një letër të gjatë, ku midis të tjerash na thoshte: *"Ju lutem, ta takoni zotin K.G.dhe t'i thoni nga ana ime këto: edhe ti, zoti K., ke krijuar fjalë të reja shqipe, edhe unë kam krijuar fjalë të reja shqipe. Ti ke krijuar fjalën e re "nevojtore", kurse unë kam krijuar fjalën "botëkuptim." Këtë ndryshim kemi unë dhe ti."*

K.G. kurdoherë më provokonte lidhur me shkrimet, duke përgojuar gjithë ata shokë të mi që ishin kthyer nga Bashkimi Sovjetik. Ai shante Fan Nolin dhe lavdëronte mbretin. Nuk e duroja dot. Brankoja, me të cilin banoja në një dhomë, më porosiste të duroja dhe të mos i përgjigjesha. Nuk na e paguante rrogën si gjithë të tjerëve, por sot na jepte pesë lekë, nesër katër lekë e, kur vinte fundi i muajit, na thoshte se rrogën e kishim marrë. Brankoja ishte një tip interesant: qëndronte edhe ditë të tëra pa ngrënë, vetëm cigare donte.

Kishim mbetur prej ditësh pa asnjë lek. Asim Jakova më tha: "Tani s'kam! Nesër! Nesër!" Vinte e nesërmja

dhe përsëri nesër! Një ditë e prita gjer vonë. Nuk dola nga zyra. Ai erdhi shumë vonë dhe më tha:

- Shumë mirë që të gjeta këtu!

- Po ju prisja se s'kemi asnjë lek! Jemi pa ngrënë që pardje! Ju lutem, na jepni rrogat!...

- Patjetër do t'jua jap, po shyqyr që të gjeta. Tash ulu e shkruej një reportazh, qaje, shkrueje sa ma mirë, si një poemë, shkruej për drekën madhështore që shtroi naltmadhnia e tij për princ Abibin, që u fejue me naltësinë e saj, princeshën Sanije. Ja, këtu kam dhe fotografitë. Të zgjedhim ma të mirat. Ulu pra! Pse më shikon kështu?

Ai ishte veshur me granduniformë: bombe, frak... dhe nisi të më bërtiste:

- Pse nuk e merr penën? Apo të dridhet kur zen në gojë emnin e naltmadhnisë së tij?

Nuk u përmbajta:

- Si, more zotni Asim, të shkruaj unë një reportazh për një drekë mbretërore, madhështore, me gjithë të mirat e botës, kur unë jam i uritur, kur kam tri ditë që nuk vë gjë në gojë?

- Don me thanë se nuk pranon, ë? Atëherë sikter këndej e mos të pafsha ma këtu! Dil që këtej!

Unë ika, kurse K.G., që u ul të shkruante reportazhin e drekës mbretërore, qeshte me ironi.

Kur ia thashë Brankos ngjarjen ai u mendua dhe më tha:

- Nuk fole gjë tjetër, ndonjë insinuatë kundër mbretit?

- Jo, - iu përgjigja.

Po K. G. dhe Asim Jakova kishin përhapur fjalë se unë kisha sharë princ Abibin, djalin e sulltan Hamitit, dhe princeshën Sanije. Më thirri ministri i Punëve të Brendshme dhe më qortoi, megjithëse unë i thashë si qëndronte e vërteta.

Përsëri pa punë. Pa bukë. Demir Godelli pa punë,

Asim Vokshi pa punë. Aty nga janari i vitit 1936 na lindi ideja të botonim një revistë.

Pyetje: - Si u botua revista "ABC"?

Përgjigje: - Ideja ishte e Asimit dhe e Demirit. "Të botojmë një revistë". Këtë ide e pranuan edhe shumë shokë të tjerë, sidomos Skënder Rusi, Zef Mala, Vasil Shanto, Vasil Kushi, Reshat Këlliçi, të cilët më vonë u bënë edhe si kolegjium i redaksisë. Të tjerët, që pretendojnë të kenë qenë në këtë nismë dhe në këtë kolegjium (këtu nuk po përmend emra), as që e dinin se ku qe redaksia e "ABC"-së dhe as që i pamë ndonjëherë. E vërteta është se unë u kërkova të gjithëve bashkëpunim, por thirrjes sonë iu përgjigjën menjëherë vetëm Dhimitër Shuteriqi dhe Shevqet Musaraj. Të tjerët nuk na dërguan asnjë shkrim për numrin e parë.

Kryeartikulli u shkrua nga të gjithë (Asim Vokshi, Vasil Shanto, Reshat Këlliçi, Vasil Kushi, Skënder Rusi), por më në fund u vendos që ta kopjonte në gjuhën e mesme Reshat Këlliçi. Artikullin programatik e shkroi Tajar Zavalani, me pseudonimin ZAKS. Artikullin për rininë e shkroi Branko Merxhani. Një artikull problematik ekonomiko-shoqëror e shkroi Bedri Pejani, me pseudonimin "Sos".

Të hollat i mblodhi Asimi, nga grupi i oficerëve që kishin rroga të mira dhe ndihmonin kurdoherë. Shtypshkronjën e gjeti Asimi. Ishte shtypshkronja e vogël "Ora", ku botohej dhe organi i Komunitetit Mysliman. Numri i parë doli në shkurt më tirazh 10000 copë. Ishte tirazhi më i madh që ishte parë gjer atëherë. Revista u shit menjëherë. Në Kuçovë dërguam 3000 copë, dhe Rexhep Luga, që punonte aty në postë, na dërgoi të hollat dhe kërkesa për të shkruar artikuj për punëtorët e Kuçovës, që ishte qendra më e madhe e punëtorëve...

Migjeni na shkroi një letër të gjatë, ku na këshillonte që të mos nxitoheshim e të mos i binim murit me kokë.

Ai do të bashkëpunonte me revistën, por ne duhej të kishim shumë kujdes e të mos linim rast për masa administrative nga ana e qeverisë. Ne ishim për zhurmën, alarmin, paçka se revista mund të mbyllej. Na kishin thënë disa herë shokët se duhej ta shfrytëzonim këtë rast të "shtypit të lirë" që la përkohësisht qeveria liberale e Mehdi Frashërit. Mua më caktuan si drejtor politik dhe unë iu drejtova qeverisë për lejen e botimit të një reviste artistiko-kulturore...

Përveç Migjenit, edhe Branko Merxhani, me të cilin bashkëjetoja në një dhomë, nuk e pëlqeu vrullin tonë. Ai ishte i mendimit që ne të merreshim më shumë me art e kulturë për popullin, sesa me ngritje problemesh themelore për jetën dhe shoqërinë tonë. Prandaj nuk na dha ndonjë shkrim tjetër për numrin e dytë të revistës. Më kujtohen fjalët e tij: "Keni një revistë në dorë. Mbajeni që të hani bukë ti, Asimi, Demiri e të tjerë. Po me një kusht: mos shkaktoni zemërimin e qeverisë. Ju kërkuat leje për një revistë artistiko-kulturore dhe e kthyet në manifest politik revolucionar! Kush t'i lejon këto, more Petro! Ju ende nuk e keni kuptuar mirë politikën e Zogut! Ai është i mprehtë dhe kërkon të mbretërojë i qetë dhe jo me andralla. Edhe ju e pësuat si Fan Noli! Dale, more djema! Mos u nxitoni, se Zogu nuk lejon propagandimin e hapur të komunizmit dhe të revolucionit."

Megjithatë, numri i dytë qe edhe më revolucionar. E dërguam në shtyp. Unë shkrova kryeartikullin "Urra, mbi Tiranë!", ku thosha se të gjithë duhej të vinin në Tiranë, se vetëm në Tiranë kishte bukë, kishte jetë. Kisha shkruar dhe një artikull për punëtorët e Kuçovës: "Bajrami në Kuçovë", ku tregoja jetën e mjerë të punëtorëve të Kuçovës, që banonin në kasolle të bëra me karton dhe thasë çimentoje.

Numri dy mbaroi së shtypuri dhe unë me Asimin po e paketonim në shtypshkronjën e vogël "Ora", kur na

erdhën dhjetë xhandarë, me në krye kapitenin Zef Prenushi, të cilin e njihte mirë Asimi. Ai na tregoi shkresën: *"Drejtori i revistës, Petro Marko, të arrestohet dhe revista të digjet!"* Ai qeshte dhe, kur hapi revistën e nisi ta shfetonte, theksonte me zë: "Bobo, ç'paska këtu! More Asim (i tha me zë të ulët), merr ca kopje dhe nxirri shpejt, se do ta djegim këtu në oborr."

I ndihmuar nga një radhitës, Asimi nxori nja pesëqind kopje që qarkulluan më vonë ilegalisht. Mua më lidhën dhe më shpunë drejt e te ministri i Punëve të Brendshme, zoti Ethem Toto. Sapo hyra i lidhur në zyrën e tij, ai u ngrit më këmbë dhe i egërsuar më thirri:

- Jo ti, po 3000 Leninë të jenë në Shqipëri, nuk e bëjnë dot komunizmin! Aq sa bëhet limoni në Peshkopi, aq bëhet dhe komunizmi në Shqipëri. Unë e kam lexuar dhe e lexoj "Kapitalin" e Marksit, por komunizmi është për vendet e zhvilluara, me industri të madhe, ku ka miliona punëtorë dhe jo këtu, ku populli jeton në mizerie.
- Pastaj e uli zërin dhe, duke më shikuar në sy, më tha:
- Agjent i Moskës! Na gënjeve, prandaj ta dhamë edhe lejen e revistës. Ç't'i bëj tim vëllai, që ka besim te ju!

Unë iu afrova dhe e vendosa këmbën mbi tryezë. Këpuca ishte e grisur, dukeshin gishtërinjtë e këmbës...

- Po të isha agjent, si thoni ju, do të kisha edhe këpucë! Unë jam agjent i atyre që janë si unë, këmbëzbathur, kurse ti, që je këtu, në këtë kolltuk, je agjent i Romës. Moska nuk ka nevojë për agjentë!."

- Hiqe këmbën! - më thirri.

Unë nuk e hiqja. Atëherë ai më shtyu dhe rashë në dysheme i lidhur. Në atë çast hyri brenda Ismeti, vëllai i tij dhe i bërtiti:

- Ç'bën kështu, more i marrë! - dhe m'u afrua e më ngriti. - Hiqja zinxhirin nga duart! - bërtiste Ismeti, dhe më mbante pranë. Erdhi xhandari dhe më hoqi prangat...

Atëherë ministri iu kthye të vëllait, Ismetit:

- Pa shiko se çfarë reviste kanë nxjerrë! Revistë

bolshevike! - dhe tundte numrin e dytë të "ABC"-së, që mbante në duar. - Këta na kërkuan leje për një revistë kulturore, ashtu siç më the dhe ti, por përfituan, ia bënë fora. Po lejohet kjo? I lejon lartmadhëria e tij këto botime bolshevike?

Më shpunë në zyrat e policisë, andej nga Rruga e Dibrës. Më mbajtën gjithë natën. Të nesërmen në orën 10, më çuan në Kryeministri. Më futën në sallën e pritjes. Qëndroja më këmbë. Hyri Mehdi Frashëri, kryeministri, i cili, sapo më pa të lidhur, urdhëroi menjëherë të më hiqeshin prangat. Më tha të ulesha në një kolltuk shumë të rehatshëm. Edhe ai u ul pranë meje. Më hodhi dorën në qafë dhe pak a shumë më tha këto:

- Edhe unë jam persekutuar për tridhjetë vjet e ca, por nuk jam mërzitur!

- Po ju, nga kush jeni persekutuar? - i thashë.

Ai qeshi me të madhe:

- Nga kush persekutohet njeriu i ndershëm, ë? Ti je i ri. Mos u mërzit, dhe pa dëgjomë pakëz! - e më shikonte në sy. Ishte një burrë simpatik, që, sipas meje, nuk i bënte keq as mizës. - Ne e dimë që jemi populli më i varfër i Evropës. Por pa më thuaj pakëz, si rrojmë? Kemi një dhi, kemi një dele, një lopë, një pulë, një copë arë, hamë ndonjë kukurec, ndonjë kokë të pjekur, bëjmë përshesh me dhallë e me kos. Diçka hamë, prandaj dhe jemi gjallë, apo jo? Po ju, me shkrimet që bëni, na nxitë fare! S'kemi e s'kemi. Po, s'kemi mend në kokë! Nuk punojmë, nuk dimë të punojmë, jemi dembelë, presim nga Perëndia. Nuk dimë, jemi një popull injorant. S'themi të mos shkruani, por shkruani që jemi dembelë, që duhet të punojmë, të shtojmë bagëtinë, të shtojmë ugaret, të shtojmë pemët, të lëvizim, ta bëjmë tokën pjellore. Kemi një tokë të mirë. Apo jo? Ja, këto shkruani, more bir! Të zgjohet fshatari! Por fshatari nuk di të lexojë fare! Ç'të shkruani! Mos e bëni edhe ju si një katundar që qahej e

thoshte: "S'kam gjë prej gjëje, po më vdes fëmija për bukë!" Por ai kishte një lopë, kishte dhjetë dhi, kishte pula, kishte me se të rronte, po ama përditë avazin e Mukës: s'kam asgjë, po vdes nga uria. Ndillte të keqen. I ngordhi lopa. I ngordhën dhitë, i ngordhën dhe pulat. Aman more djalë, mos na ndillni zinë, se diçka kemi. Duhet të lëvizim e të punojmë, të çalltisim, të jemi më të gjallë dhe jo të ndjellim babëzinë. Ju, si të rinj me kulturë, që e doni popullin, mësojeni popullin të jetë më i gjallë.

Ai fliste shumë dhe mendimet i ilustronte me fjalë të urta të popullit. Pastaj më mori për krahu dhe më futi në kabinetin e tij, ku ishin mbledhur gjithë ministrat, këshilli ministror. Me dorën e tij në qafën time, ai, sapo u fut, tha:

- Ja ku e kemi! Shiheni! Ç"ti bëjmë, ta varim? - dhe buzëqeshi.

Nuk i vura re fytyrat e të tjerëve. Shikoja fytyrën e Ethem Totos. Ai u ngrit e tha:

- Do ta gjykojë gjyqi politik! Ka shkelur ligjet tona. Kemi ligje në fuqi. Tani jemi mbledhur këtu t'i heqim lejen e revistës. Unë ju propozoj që lejen t'ia heqim, se ka shkelur ligjet. Ka botuar një revistë revolucionare. Ja se ku është lutja që ka bërë për lejen. (E lexoi lutjen ku kërkoja leje për një revistë artistiko-kulturore.) Pra, revista që nxori ky, nuk është artistiko-kulturore, po revolucionare. Kërkoj nga ju të gjithë që t'i hiqet leja.

U pranua unanimisht heqja e lejes.

- Tani ne s'kemi punë më me të. Punë ka gjykata politike! - përfundoi Ethem Totoja, që ishte më këmbë.

Pas një ore më çuan në gjyqin politik. Aty gjeta dhe Asimin, në bankën e të akuzuarit. Më buzëqeshi dhe me këtë deshi të thoshte: "mos çaj kokën."

Prokurori: Kiço Bisha.

Kryetari i gjyqit: Bilal Nivica...

Pyetjet që më bënin, ishin që të dinin se cilët fshiheshin pas pseudonimeve. U përgjigjesha se,

përderisa isha përgjegjës politik i revistës, pranoja se të gjitha shkrimet ishin të miat. Më pyetën nëse kishte shkruar Asimi. Ua përsërita:

- E marr unë përgjegjësinë për të gjitha shkrimet që janë botuar pa emër ose me pseudonime!

Gjyqi nuk zgjati shumë.

Vendimi: Internim në Porto Palermo, gjashtë muaj.

Asimi: Internim në Peqin, gjashtë muaj.

Kështu u mbyll historia e revistës sonë "ABC".

Pas Çlirimit, numrin 2, që u ndalua, ma dha Ali Bakiu, që e kishte fshehur, ose, më saktë, ma dha kur i shkova në shtëpi, ku gjeta dhe Gogo Nushin. Aliu aso kohe ishte kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. E njihja nga Demiri dhe Asimi. Ai na ruante shumë shkresa dhe shtypin ilegal që vinte nga jashtë. Atij i dhashë dhe disa fotografi që i bëra në Korçë, gra që demonstronin para prefekturës dhe xhandarë që i shtynin me bajoneta. Ishin të mira dhe u botuan disa herë me raste përkujtimesh të demonstratave. Aliu doli në kopsht, gërmoi me kazmë dhe nxori një tub të vogël prej llamarine. E hapi dhe nxori numrin 2 të "ABC"-së. "E kam ruajtur", - më tha.

E mbaja në zyrat e gazetës "Bashkimi", ku punoja. Vura Rebi Alikajn ta kopjonte dhe i shfaqa një mendim Nako Spirut ta ribotonim dhe të vazhdonim botimin e saj. Ai nuk pranoi. Nuk e di pse!

Pyetje: - Si ia kalove në internim?

Përgjigje: - Në kohën e internimit jetova më mirë se kurdoherë...

Në Porto Palermo nuk më mbajtën shumë kohë, vetëm dy javë. Më hoqën që andej dhe më shpunë në Llogara. Këtë e bënë se mos arratisesha nga Porto Palermoja, pasi njihja shumë fshatarë dhe detarë. Në Llogara, më dhanë një barakë dërrasash. Shtrova një shtrat të gjerë me degë dhe gjethe shqope dhe pishe.

Erdhi nga fshati dhe motra ime për të më shërbyer. Dhe çdo ditë, kur kalonte makina e linjës Vlorë-Sarandë e Sarandë-Vlorë, dëgjohej fatorinoja që thoshte: "Petro Marko ka një shportë... Petro Marko ka një trastë". Përditë më dërgonin bukë e peshk e mish e fruta e makarona e oriz e vaj e mjaltë. Kush m'i dërgonte? Nuk kishte emrin e dërguesit... Paraqitesha dy herë në ditë te postëkomandanti i xhandarmërisë, që ishte një burrë i mirë.

Gjatë verës, aty në Llogara vinin shumë familje për të veruar, sidomos ata që vuanin nga mushkëritë. Pranë barakës sime ishte dhe banesa e Asllanit, Ali Asllanit. Ai më thërriste dhe më lexonte vjersha. Më pyeste nëse kisha nevojë për ndonjë ndihmë. Ishte dhe familja e mikut tim Ibrahim Shyti, aty në një kodër, në të hyrë, nga ana e Dukatit. Ai vend ende quhet kodra e Ibrahim Shytit. Më thërriste shpesh mbrëmjeve dhe bisedonim lirisht për situatën dhe për shokët në Tiranë e në burgje...

Rastisi të kalonte andej një gazetar amerikan. E shoqëronte një shok që e kisha njohur në Tiranë. Ai kishte mbaruar Tekniken, ndaj e dinte mirë anglishten. Siç u duk, i paskësh thënë atij gazetarit që unë atje isha i internuar. Gazetari u interesua për mua dhe m'u afrua. Dinte frëngjisht. Ishte korrespodent i "Nju-Jork Tajmsit". Kishte vizituar Finlandën e Poloninë, kishte ardhur edhe në Shqipëri për t'u takuar me mbretin, i cili e kishte pritur. Folëm gjatë. Ishte i zgjuar dhe menjëherë u bëmë miq. Quhej Bill Uaters,[1] më duket... Po, Bill e kishte emrin e parë. I fola për situatën në Shqipëri. Ai fjeti në barakën time dhe të nesërmen u nis për në Sarandë e së andejmi për në Korfuz. Për këtë gazetar po shënoj disa gjëra: Kur vajta në Spanjë, i shkrova një letër nga Albacete. Pas dy muajsh ai më shkroi një letër, brenda së cilës kishte dhe një çek 1000-dollarësh, si ndihmë

1) Pak kohë pas vdekjes së Petros, Bill Uatersi erdhi në Shqipëri dhe kontaktoi me familjen e tij. (Shën. i red.)

personale e tij për popullin spanjoll. Pas Çlirimit, kur punoja në gazetën "Bashkimi", më erdhi një zarf nga misioni ynë ushtarak në Bari, brenda së cilës ishte dhe një letër e Billit. Ishte i gëzuar që unë kisha dalë gjallë nga furtunat, dhe më ftonte në Hollivud, ku ai punonte në një shoqëri prodhuese filmash. Më kërkonte që unë të bashkëpunoja me të duke shkruar skenarë.

Unë nuk iu përgjigja kurrë, për të mos krijuar probleme.

... Nga Llogaraja u largova shpejt. Ismet Toto, Brankoja dhe të tjerë u interesuan dhe unë u lirova. Brankoja do të botonte revistën "Përpjekja shqiptare", ndaj kishte shumë nevojë për mua. Ai nuk e shkruante shqipen. Më diktonte mua shqip-greqisht-frëngjisht dhe i shkruaja unë artikujt e tij. Asimi ende ishte në Peqin. Me Demirin takoheshim shpesh dhe bisedonim. Me Tajarin më rrallë.

Pyetje: - Pa kujtohu, mos ke harruar ndonjë episod interesant të kësaj kohe, domethënë pas kthimit nga Athina?

Përgjigje: - Episodet janë të shumta dhe shumë interesante, bie fjala: Kur shkonim në parlament, për të dëgjuar pallavrat e "baballarëve të kombit", ne qëndronim në galeri dhe shikonim e dëgjonim seancat. Një ditë ngjau një incident. Njëri nga deputetët mbështeti propozimin e një tjetër deputeti. Ky i fundit, një ditë më parë i kishte bërë këtë pyetje kryetarit të qeverisë liberale: "Pse kjo qeveri na u quajtka qeveri liberale dhe qeveria e parë na paska qenë qeveri despotike? Kush i ka emëruar këto qeveri? Nënkuptohet që vetëm naltmadhnia. Pra, na shpjego zoti Mehdi Frashëri, këtë dallim që ju po i bëni qeverisë suaj!" Të nesërmen, pra, një deputet tjetër e përsëriti këtë pyetje. Në këtë kohë, deputeti i Shkodrës, u ngrit, vuri dorën në brez për të hequr revolen, dhe iu drejtua këtij deputeti që e kishte përpara: "Ti je dallkauk, pa vlerë, je një hiç, je një servil, një karrierist, një hajvan".

Dhe mundohej ta shkrepte revolen, kurse të tjerët thërrisnin: "Hiqja", "Mbajeni!", "Shkrepja!", "Mos kësh-tu!", "Qëlloje, dreqin!", "Mbajeni! Mbajeni!" - Një gjullurdi. Të gjithë ishin më këmbë dhe prisnin krismën e revoles. Po revolja nuk krisi, se ra zilja, që e tundte me furi Mehdi beu, i cili thërriste; "Mbledhja u mbyll!"

Ne dolëm të gëzuar nga kjo farsë, dhe Brankoja na propozoi që t'i shkonim në shtëpi deputetit të Shkodrës për ta përgëzuar.

U bëmë një grup shokësh dhe shkuam. Ai na priti mirë dhe na fliste shumë kundër deputetit në fjalë dhe disa të tjerëve, që kishin qenë rreckamanë aventurierë, që erdhën nga Stambolli me opinga dhe u bënë vegla të verbra të Zogut e të ambasadës italiane (dua të shënoj se flitej që shumica e deputetëve tanë merrnin rroga nga Jugosllavia, Greqia, Italia, disa dhe nga Anglia e Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Deputeti i Shkodrës na thoshte se disa nga deputetët... (Nuk e përmendi dot emrin e Lalë Krosit, që ishte zot i parlamentit), nuk votuan për "Moratoriumin", se ata qenkeshin fajdexhinjtë më të pasur të Shqipërisë. ("Moratoriumi" u propozua nga qeveria për të shtyrë borxhet, pasi gjithë populli ishte mbytur në borxhe. Ne shkruam një artikull të fortë demaskues në numrin e parë të "ABC"-së, ku thoshim se parlamenti kishte shënuar njollën më të zezë të historisë së tij, pasi aty ishte shtabi i fajdexhinjve.)

Pas dy ditësh Brankoja na tha:

- Me nder hëngrëm m.. që vajtëm te deputeti i Shkodrës, se vetë mbreti e kishte porositur ta bënte këtë lojë, për të mos hapur debate rreth qeverisë liberale dhe asaj despotike...

Pyetje: - Po nga i merrte vesh Brankoja këto?

Përgjigje: - Brankoja shoqërohej me shumë personalitete e sidomos me Mehmet Konicën, që ishte një nga këshilltarët e mbretit për çështjet ballkanike. Me të mbreti

luante brixh. Për Mehmet Konicën do të flas më poshtë, sidomos kur e takova në Romë, më 1944. Brankoja kishte një karakter të fortë, ishte i ndershëm, patriot, idealist dhe gjykonte thellë për çdo çështje kombëtare. Ai me Tajarin takohej rrallë, por me Bedri Pejanin, me Ali Kelmendin, me Demir Godellin e shokë të tjerë takohej në "Kursal", që ishte kafeneja qendrore, ku venin personalitete të kulturës e të administratës: deputetë, funksionarë të lartë. Atëherë, kafenetë i kisha ndarë në këto kategori: në "Kursal" - ata që përmenda më lart, në "Llondon" - funksionarë më të vegjël, sidomos ata që vinin nga krahinat; në "Berlin" - njerëz të papunë, të dyshimtë për qeverinë; në "Ballkan" - xhandarë, ushtarë, lebër, matrapazë (i kam përshkruar te gazeta "Koha e re" me pseudonimin Demo-Koti).

Dua të shënoj edhe këtë episod:

Aty nga shkurti i vitit 1936, kur ishim gati për të botuar "ABC"-në, Tajari e Demiri më ngarkuan me mision të veja në Kuçovë, të takoja njëfarë Birçe dhe t'i thosha se: "Ajo plaçka kushton 11 franga". Dua të shënoj se statutin e shoqërisë "Puna" të Kuçovës e kishin hartuar Tajari dhe Demiri, ia kishin shpënë edhe avokat Suat Asllanit për ta parë nga ana ligjore. Ai i kishte bërë disa ndryshime. Kam qenë edhe unë i pranishëm, kur Suat Asllani dorëzoi statutin e shoqërisë "Puna" të Kuçovës. Më thanë se duhej të veja në Berat, të takoja një shok me emrin Gaqo Vruho ose Bojaxhi, që punonte në shoqërinë "SESA". Ai kishte makinë dhe do të më çonte në Kuçovë. Kështu veprova. Gaqoja më çoi në Kuçovë një pasdreke të ftohtë. Në postë gjeta shokun tonë Rexhep Luga, i cili na shpuri në kafene, ku u takova dhe me një shok tjetër, Kokoshi, nga Vlora, të cilin e njihja. Ai punonte aty si llogaritar dhe rrinte me inxhinierët italianë. I thashë se më duhej të takoja një shok, Birçen, nga Kuçi më duket, dhe ai dërgoi një njeri që ta gjente. Pas

pak ai erdhi. Për herë të parë e shihja. U përqafuam dhe i thashë ngadalë. "Ajo plaçka kushton 11 franga, më tha Tajari dhe Demiri." Ai më pyeti përsëri se sa ishte çmimi i saktë, dhe unë ia përsërita: "11 franga!"[1] U ndamë me të gjithë. Rexhep Luga na rrinte pranë. U ndamë edhe me të.

Ishte errur shumë dhe bënte ftohtë. Tek Ura e Hasan beut (Ura Vajgurore), na pritën dy xhandarë dhe na thanë të ndaleshim. Gaqoja e ktheu veturën nga rruga e Roskovecit dhe, megjithëse xhandarët na qëlluan, ai nuk u ndal. Arritëm shumë vonë në Fier. Ku të shkonim? Gaqoja u mendua dhe më tha: "Di unë një vend të sigurt!" Më shpuri në një shtëpi publike, një barakë buzë lumit. Aty ishin tri femra të thata, të mjera, kishin ndezur një mangall dhe ngroheshin. Gaqoja u foli troç dhe u tha; "Jemi jabanxhinj, do të qëndrojmë këtu dhe do t'ju paguajmë të triave nga pesë franga." Ato qeshën dhe na ofruan gështenja të pjekura. Kur zbardhi dita, dolëm andej. Gaqoja ndenji me mua, sa më siguroi makinë për në Tiranë.

Lëndën e numrit 2 të revistës "ABC" e kishim bërë gati. Demiri dhe Tajari më thanë të veja në Korçë, të takohesha me Dhimitër Fallon, me Koçi Xoxen, me Stefo Grabockën, me Mihal Lakon e të tjerë dhe t'u thosha nga ana e tyre që aty nga gushti të shkonin në Pogradec, gjoja për verim, të takoheshin me shokët e Tiranës për të bashkërenduar punën revolucionare dhe mundësisht të bënin njëfarë komiteti të përbashkët. Shkova në Korçë. Mbledhjen e bëmë në shtëpinë e Esat Dishnicës, në Dishnicë. Aty kaluam një mbrëmje të mrekullueshme dhe të paharruar, hëngrëm e pimë dhe kënduam "Internacionalen". Mbaj mend plakun e Esatit që thërriste:

1) Ishte parulla që caktonte datën (11 shkurt) e grevës dhe demonstratës më të madhe të organizuar në Shqipëri, ku punëtorë, të organizuar, lanë punën dhe kërkonin të drejtat e tyre. Për ta shtypur shkoi vetë Ethem Toto.

"Rrofshin djemtë e Elinit! (Leninit) E shoqja e Esatit dhe sidomos motra e tij, Meli, fluturonin nga gëzimi që shihnin në vatrën e tyre shokë të Esatit, komunistë.

Pas pak ditësh mësuam se konsullata e Jugosllavisë në Korçë i kishte raportuar qeverisë sonë qëllimin e takimit që bëmë në Dishnicë. Ne menjëherë dyshuam te njëri nga shokët që kishin dijeni. (Ashtu u mendua atëherë. Sa është e vërtetë, nuk dihet.)

Aty, në shtëpinë e Esatit, u diskutua edhe për revistën tonë "ABC" dhe u tha se, pasi u mblodhën gjithë ato të holla për botimin e romanit "Nëna" të Gorkit, përkthyer nga Tajar Zavalani, duhej kërkuar ndonjë tjetër roman revolucionar për t'u përkthyer. Falloja kishte përkthyer "Jeta në varr", të Mirivilisit dhe e kishte botuar. Kishte përkthyer dhe "Feja dhe shkenca".

Kur u ktheva në Tiranë, Brankoja më tha: "Ti shkove në Korçë dhe qëllimin e vajtjes sate atje e di edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Prandaj sakën se bëni mbledhje në Pogradec, se të gjithë do të arrestoheni. Kini mendjen, se midis jush ka edhe spiunë."

Po atë ditë Tajari dhe Demiri më dhanë një tufë trakte të Komitetit të Çlirimit Nacional, që ishte në Paris. Më thanë të shkoja dhe t'i vendosja në kamaren e nevojtores së "Kursalit." Unë e bëra atë "heroizëm" se "heroizëm" më dukej, por më vonë mendova dhe thashë me vete se ato trakte aty mund t'i merrte vetëm ndonjë deputet ose spiun, që shkonte në atë kafene, prandaj m'u duk punë pa mend, ose e bërë me qëllim që të alarmohej Ministria e Punëve të Brendshme. Ne shkonim si çjapi te kasapi!

Pyetje: - Si i shihje ti shokët: Tajar Zavalani, Demir Godelli, Ali Kelmendi, Selim Shpuza e të tjerë, që ishin kthyer nga Bashkimi Sovjetik?

Përgjigje: - Unë dhe shokët e mi tek ata shihnim mësuesit tanë, udhëheqësit tanë. Ishin të ndershëm, antifashistë, kishin mësuar në shkollat e Moskës dhe

tek ata ne gjenim komunistët. Po midis tyre kishte dallime. Do të flas më poshtë e më gjatë për secilin nga këta shokë. Nuk mund të bënim asgjë pa pyetur ata. Një ditë Ismet Toto më tha:

- Dëshiroj të botoj vjershat e tua dhe të Migjenit bashkë! Dua që, në parathënie, të bëj një studim për poezinë tonë të re. - (Mua më erdhi mirë.) Vajta dhe ia thashë Tajarit. Ai, i zemëruar, m'u përgjigj:

- Jo! Ai është fashist! Nuk duhet që me vjershat e tua dhe të Migjenit të spekulojë një megalloman që i di të gjitha dhe që s'di asgjë. Ai kërkon t'ju bëjë për vete! - kështu që unë nuk e pranova kërkesën e Ismet Totos.

Filozofinë e politikës së kohës Branko Merxhani e analizonte sipas prizmit të pikëpamjeve të tij idealiste. Me mua fliste hapur dhe e dinte që unë drejtohesha nga Demiri e Tajari. Ai nxirrte këto konkluzione:

1. Zogu nuk kishte fare frikë nga komunistët. Përkundrazi, sipas tij, komunistët e përforconin regjimin e Zogut. Thoshte: "Nuk është budalla Zogu që lejon të vijnë nga Moska agjentët e saj. Ai jo vetëm i lejon, por u jep edhe punë speciale, me rroga të majme. Lejon romanin "Nëna" jo tani, që është qeveria e Mehdi beut, por që në kohën e Musa Jukës. Lejon të shkruani vjersha dhe shkrime revolucionare, si ti, që i kushtove një ligjërimë Leninit, me rastin e përvjetorit të vdekjes. I lejon, por jo pa qëllim; i thotë Musolinit: Pa shiko se ç'agjentë na dërgon këtu Moska! Kemi nevojë për ndihma materiale, që t'i luftojmë. Dhe merr nga Roma miliona e i fut në xhep."

2. Sipas Brankos, gjer atëherë në Shqipëri nuk kishte asnjë marksist-leninist kompetent. Të gjithë ne e deshëm komunizmin pa e njohur se ç'ishte komunizmi.

3. Sipas tij, ne në shumë raste luanim rolin e disgregatorit, dhe jo të unitetit të të gjitha forcave përparimtare. Thoshte: "Unë jam demokrat, idealist, dhe Tajari më

lufton! Unë dua një Shqipëri demokratike, si atë të Nolit, si atë të Turqisë së Mustafa Qemalit, por Tajari dhe shokët e tij më quajnë "armik"! Pse? Unë, sipas mendimit tim, kërkoj një zhvillim të shoqërisë ku të kenë vend komunistët dhe gjithë patriotët e antifashistët. Nuk më pëlqejnë polemikat që shpien ujë te mulliri i përçarjes, ashtu siç i pëlqen Zogut. Atij i pëlqen që ne të përçahemi dhe të mos bashkohemi kurrë."

Mendimet e Brankos ua transmetoja Tajarit dhe Demirit. Dhe ata më thoshin: "Ai është metafizik, është një filozof që rron në stratosferë!"

Brankoja kishte arritur të thoshte: "Ne jemi vagabondët e historisë!" (Jo për ne komunistët, po për ata që luftonin për pushtet.)

Pyetje: - Cilin kishit si përgjegjës ose sekretar?

Përgjigje: - Nuk e dija se cili ishte sekretari ose përgjegjësi ynë. Unë, personalisht, lidhesha ngushtë me Demirin, Asimin, Vasilin. Me të tjerët: Bedri Pejanin, Ali Kelmendin, Zef Malën, Mustafa Gjinishin, Hasan Reçin - ky i fundit kishte marrë famë se u kishte qëndruar stoikisht torturave në Fier - Mane Nishovën e të tjerë, isha shok dhe flisja lirisht për çdo gjë. E dija që ishin komunistë, por organizimin nuk e njihja. Kisha dëgjuar Demirin të thoshte "Ne, grupi i Tiranës, jemi shumë dhe duhet të kemi kujdes!"

Më hapur fliste Bedri Pejani, kurse më pak, ose hiç fare, Ali Kelmendi dhe Asim Vokshi. Vasili ishte më i gjallë, po, siç e shihja unë, vetëm me Asimin kishte më shumë lidhje, kurse me të tjerët nuk takohej fare. Të gjithë i njihte.

Atëherë të gjithë shokët, ngado që ishin, duheshin njëri me tjetrin, takoheshin si vëllezër dhe ishin shumë të lidhur, nga çdo anë. Nuk na linin pa bukë ata që ishin në punë, sidomos oficerët, shokët e Asimit, si Emrush Myftari, Xhemal Kada, Bedri Spahiu, Abaz Shehu,

Shaban Basha e të tjerë që unë nuk i njihja. Edhe arsimtarët na ndihmonin shumë. Unë, që merresha me gazetari dhe me poezi, njihja më mirë poetët si Migjeni, Dhimitër Shuteriqi, që më kushtoi botimin e parë të vargjeve të tij, Shevqet Musaraj, Aleks Çaçi, Andrea Varfi, Sotir Caci, Nexhat Hakiu, Andon Logoreci (Nologus), Helenau, Platonikus (Veli Stafa, vëllai i Qemal Stafës). Veliu më njohu me Qemalin në një kafe të shëtitores së madhe. Qemali mbante disa libra në sqetull. Më poshtë do të flas për shkrimet e tij të para, që ia botova në gazetën "Shtypi", me pseudonimin BRUTUS. Kështu që kishte një grup shokësh që lidheshin njëri me tjetrin: shpërndanin trakte dhe letërsi revolucionare që na vinte nga jashtë, sidomos nga Halim Xhelo.

Pyetje: - Ç'mendon për shokët e atëhershëm, sidomos për ata që erdhën nga Bashkimi Sovjetik?

Përgjigje: - Kishim për ata respekt dhe adhurim, se kishin qenë në Moskë, në Kremlin. Ata kurrë nuk tregonin për jetën e atjeshme. Vetëm Demiri, megjithëse tregonte anët pozitive, shpesh na kallëzonte edhe realitetin e hidhur: vështirësitë ekonomike, varfërinë, imoralitetin, papunësinë. "Janë vitet e para të socializmit në një vend të paanë, ku ka zotëruar mizerie e madhe!" Na tregonte dhe qyfyre, si bie fjala:

"Për Një Maj ne të huajt na ndanin nëpër qendra të ndryshme për të folur. Mua më dërguan në një fabrikë afër Moskës. I thashë shokut përgjegjës se në ç'gjuhë do të flisja kur të më vinte radha. Ai më tha të flisja në gjuhën time. "Po kush do të ma përkthejë?" - i thashë. "E përkthej unë," - më tha ai, që nuk dinte asnjë fjalë shqip. Më erdhi radha. Ai që drejtonte mitingun, tha: "Kemi këtu një përfaqësues të klasës punëtore të Evropës." - Turma më duartrokiti dhe më përshëndeti me grushtin përpjetë. Fillova: "Shokë punëtorë! Vendi im, Shqipëria, është një vend shumë i varfër, por liri-

dashës." Dëgjova përkthyesin: "Shokë! Ju sjell përshëndetjet nga klasa punëtore e Evropës së shtypur. Ata sytë i kanë te ju, se ju jeni pararoja e revolucionit botëror!" Flisja kot dhe ai përkthente si t'i vinte për mbarë: "Me të vërtetë ju keni akoma vështirësi, por proletariati i Evropës është me ju dhe do të ngrihet i tëri, po qe se ju kërcënoheni nga brenda ose nga jashtë. Ju jeni shpresa e botës, ju jeni heronjtë e shekullit!" Atëherë unë e mbajta veten dhe vazhdova: "Më ka marrë malli për një shishqebap e për një pilaf të vendit tim!" Ai përktheu: "Shoku thotë se, që kur ka ardhur këtu, e ndien veten të lirë, se në vendin e tij persekutohet dhe keqtrajtohet siç rrihen përditë me kërbaç gjithë punëtorët që punojnë pa asnjë shpërblim, por angari".

Shpeshherë pyesja Tajarin se si ishte organizuar rinia, komsomoli, si ishte organizuar shtypi, po Tajari më premtonte se për këto do të flisnim më vonë. Tajari nuk fliste kurrë për jetën në Bashkimin Sovjetik. Reshat Këlliçi më thoshte se atje ende ishte rrëmujë. Ali Kelmendi, që disa herë e kisha pyetur për jetën e rinisë dhe për organizmin e shtypit, vetëm këto më thoshte: "I drejton Partia Bolshevike!"

Po.. këta shokë shqiptarë, që më parë kishin qenë të KONARE-së dhe që shkuan në Bashkimin Sovjetik, qëlluan që të ishin aty kur ende BS ishte shumë i varfër, ishte koha kur ende kishte korrente të ndryshme, kur aty ishte ende Trocki. Stalini ende nuk e kishte konsoliduar mirë pushtetin dhe trazirat ishin të shumta. Reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm punonte. Kishte sabotime. Bashkimi Sovjetik ishte i izoluar nga bota. Shokët e huaj, që ishin të shumtë në Moskë, trajtoheshin mirë. Por ata shikonin varfërinë e masës. Kjo zgjati gjer në fillim të viteve '30, kohë kur shumica e shqiptarëve që ishin aty, u larguan dhe erdhën këtu me përshtypjet e atmosferës që lanë atje. Nuk ishin entuziastë, ishin të

lumtur që kishin lënë atë vend dhe kishin ardhur këtu, ku e ndienin veten më të gëzuar e më të sigurt. Ishin këto arsye që shumica e shokëve tanë që u kthyen nga Bashkimi Sovjetik, dështuan, me gjithë përkrahjen e besimin e madh që kishim ne ndaj tyre. Ata, duke na parë ne plot entuziazëm dhe besim ndaj komunizmit, nuk mund të shpreheshin kundër, se do të quheshin tradhtarë dhe renegatë.

Pyetje: - Ç'mund të na thuash për botimin e revistës "Përpjekja shqiptare"?

Përgjigje: - Branko Merxhani, njëri nga publicistët më seriozë të asaj kohe, mendoi të botonte një revistë si antipod të "Yllit të dritës", një "Revistë laike dhe universitet për të rinjtë tanë," - kështu thoshte Brankoja. Kërkoi leje dhe ia dhanë. Mua më kishte pranë. Përgatitëm numrin e parë. Ai më diktonte, unë shkruaja. Gjithë lëndën e zgjodhëm mirë. Ai shqipen e lexonte shumë mirë, po për ta shkruar nuk e shkruante dot. Qysh në numrin e parë, botuam një artikull kundër Hitlerit. Ma dha Brankoja dhe e përktheva nga revista *"Le monde"* e shkruante njëfarë Aron... Në faqen e dytë të kopertinës shkruhej: drejtor Branko Merxhani, administrator: Petro Marko. Pra, kishte firma të shquara për atë kohë. Numri i parë u prit mirë dhe pajtimtarët po shtoheshin. E dinin që ne ishim keq, nuk merrnim asnjë subvencion nga qeveria (aso kohe të gjitha gazetat dhe revistat merrnin subvencion nga qeveria, përveç "ABC"-së dhe "Përpjekjes shqiptare" deri atëherë).

Dërgonin shkrime shumica e intelektualëve laikë dhe përparimtarë. Dërgonin shkrime letrare gjithë ata të rinj të atyre viteve. Edhe Migjeni dërgoi. Brankoja ushqente një simpati të veçantë për të dhe thoshte se ai ishte talent dhe gjenial. Më dërgoi në Pukë për ta takuar. Më dha dhe tre napolona, që t'ia jepja, pasi ai ishte shëndetlig. Kur vajta në Pukë, e njoha. Më bëri përshtypje portreti i

tij i skalitur nga dora e mendimit dhe e dinjitetit. Fliste pak. I thashë se kush isha, dhe u gëzua kur më pa. Ai flinte në një dhomë përdhese dhe të gjatë, aty nën xhade, nën shkollë. Pranë tij banonte dhe infermier Filipeu, i cili më pëlqeu; ai më uroi për revistën dhe më premtoi se do të bashkëpunonte me ne. Me Milloshin ndenja dy ditë. Gjithë bisedat tona silleshin rreth stilit, rreth formës, rreth problemeve që duheshin ngritur në art e në publicistikë. Nuk i pëlqente zhurma. Në bisedë e sipër i thashë:

- Millosh, ti shkruan errët, ndaj duhet të shkruash më hapur, që të kuptohesh nga shumica e lexuesve tanë. Ne duhet të shkruajmë më thjeshtë, më hapur dhe jo me aludime.

- Që ta pësojmë si me "ABC"-në, a? Jo, vëlla! Ne duhet të shkruajmë mirë, me zemër e me mend, por me mjeshtëri artistike. Paçka se nuk na kuptojnë dot. Arti asht art dhe publicistika asht publicistikë. Ja, bie fjala, shumë nga poezitë e tua nuk më pëlqejnë se... - u mendua ca. - A të vjen keq, a, që po të flas si vëlla?

- Jo, Millosh, nuk më vjen keq aspak, por, si të ta them unë, ti je shumë hermetik dhe koha e hermetizmit ka kaluar. Duhet të jemi realistë dhe çdo shkrim yni duhet të ngrejë një problem.

Ai shikonte larg. Ishim në pragun e barakës ku flinte; po niseshim për të ngrënë në një restorant të vogël e të vetëm të Pukës.

- Dëgjo, Petro! Nëse nuk më kuptojnë, unë shkruej për vedi! - dhe më shikoi në sy. - S'ka ma lumtuni sesa kur ndjenjat e tua i shpreh me sinqeritet dhe dashuni për njeriun. - Më hodhi krahun. - Njeriu, kur shkruen, nuk merr leje nga askush, përveç ndërgjegjes së vet. - Më vështroi në sy! - Asht kështu apo jo?

Zërin e kishte të qetë dhe të ngarkuar me sinqeritet e pasion!

- Le të shkruejmë, se do të na kuptojnë, more Petro!

Tani shkojmë të hamë. Më duen fort dhe aty në restorant më shërbejnë sikur t'i kisha të familjes.

Ky qe takimi i parë me Migjenin. Për takimin e dytë dhe të fundit do të flas më poshtë.

Të kthehemi te revista "Përpjekja shqiptare". Brankoja, ç'është e vërteta, studionte. Ishte konfuz, por i kishte vënë vetes një qëllim: t'i shërbente kulturës sonë, historisë sonë. Këtë e kishte me sinqeritet, pa asnjë pretendim. Ai pranonte bashkëpunime nga njerëz kompetentë për problemet që shtronte. Bashkëpunonte me revistën edhe Mustafa Kruja, që ishte emigrant politik antizogist, por simpatizant i Musolinit. Ai artikujt albanalogjikë i nënshkruante me pseudonimin Shpend Bardhi. Bashkëpunonin Krist Maloku, me pseudonimin Krisma, Eqrem Çabej, Tajar Zavalani, Perikli Mborja, Vangjel Koça, dhe shumë të tjerë, të gjithë ata që dikur bashkëpunonin me "Illyrian".

Ra qeveria e Mehdi beut dhe erdhi përsëri Musa Juka, i cili na thirri në zyrë. Ai nisi të na fliste turqisht, por Brankoja i tha se unë nuk e dija turqishten, prandaj të flisnim shqip.

Pasi na dha cigare (unë nuk e pija), porositi dhe kafet. Pastaj na tha:

- Ju kam thirrë me ju thanë se naltmadhnia e tij më porositi t'ju them se, nëse vazhdoni botimin e revistës, duhet me ba nji deklaratë në faqen e parë që nuk jeni komunistë!

Unë iu përgjigja menjëherë:

- Nuk kam bërë gjer më sot ndonjë deklaratë ku të them se jam komunist!

Fytyra e Musa Jukës u nxi dhe më hodhi një shikim të egër.

- Asht urdhni i naltmadhnisë së tij. Tanë bota ju njef si komunistë.

Brankoja, i qetë, foli:

- Musa efendi, kjo punë duhet menduar mirë, prandaj na jep një javë afat, sa të vendosim.

Musa Juka ndërroi fytyrë duke dëgjuar Brankon:

- Mirë pra! Mbas nji jave due përgjigje!

U ndamë. Brankoja nuk fliste fare. Shkuam drejt e te dyqani i pijeve të Totos dhe Gjikurias, aty në hyrjen e Pazarit të Vjetër, ku shkonim e hanim me kredi. U futëm në dhomën e fundit, ku ishin vozat dhe damixhanat. Totoja na solli meze; për Brankon uzo dhe mua verë, si gjithnjë. Brankoja, pasi piu gotën e parë, më tha:

- Dy janë rrugët: ose t'ia heq vetes, ose të bëjmë njëfarë kompromisi... - Ai fliste me dashuri për revistën. Thoshte se ishte revista e parë ku mund të rrihej mendimi filozofik, ku mund të shtroheshin problemet e kohës. Ishte mjeti më i ndershëm për të nxjerrë kafshatën e gojës. - Nuk mund të jetojmë me sadakara. Jemi njerëz apo jo? - gati po përlotej. - E kam menduar mirë. Unë do të shkruaj artikullin "Pse nuk jam marksist" Me të do të tregoj një të vërtetë, se unë nuk jam marksist, po nuk e luftoj marksizmin, siç luftoj fashizmin dhe nazizmin. Ta kam thënë se te ne gjer më sot nuk ka asnjë marksist, - dhe nisi nga filozofia e Platonit, e Hegelit, e Durkhaimit e të tjerë, e të tjerë. - Jam një demokrat liberal, antifashist, - dhe pinte me ngadalë uzon "Omega."

I thashë:

- Po qe se ti boton një artikull të tillë, unë e heq emrin nga revista. Ti do të fitosh antipatinë e rinisë dhe të të gjithë intelektualëve të Shqipërisë. Punë e madhe se do të na e mbyllin revistën. Do të jetojmë duke bashkëpunuar me shtypin...

- Nuk e kam fjalën se do të vdesim nga uria, por më vjen shumë keq ta mbyllim këtë revistë që po bëhet "universiteti popullor".

Pastaj ai u këshillua dhe me shokët e tij, si me Vangjel Koçën e të tjerë, dhe shkoi e i tha Musa Jukës se do të

botonte një kryeartikull ku të tregonte se nuk ishte marksist. Ishte numri i tretë i revistës, kur unë e hoqa emrin tim nga ajo.

U punësova si redaktor në gazetën "Vatra" të Timo Dilos, ku shkruaja reportazhe dhe skica letrare, punova disa kohë dhe tek "Arbëria" e Nebil Çikës, i cili kishte hapur një fushatë të madhe kundër fajdexhinjve. Shkova në Korçë, i dërguar nga Timo Dilo, për disa reportazhe, sidomos për një anketë se ku duhej ngritur ndërtesa e re e prefekturës: në lagjen myslimane apo në shëtitoren "Shën Gjergj." Bëhej luftë e madhe për këtë problem.

Në "Arbëria", përveç "simiteve të ngrohta" e të tjera, botova dhe dy parodi: "Lufta" me emrin Patër Fishta dhe "Bagëti e bujqësia" me emrin Naim Frashëri: në të dyja paroditë demaskoja personalitete si Musa Juka, Koço Kota e të tjerë.

Pyetje: - Kujton ndonjë episod tipik për atë kohë?

Përgjigje: - Gjithë ajo periudhë ka qenë plot me episode, por do të përmend disa nga "Vatra" e Timo Dilos.

Timo Dilo ishte mik i Musa Jukës. Njeri i qetë, i ndershëm, por jo gazetar si Nebili e të tjerë. Siç e kam thënë, çdo gazetë merrte një subvencion nga qeveria. "Vatra" merrte 200 franga në muaj. Por Mihal Sherko, që ishte drejtor i shtypit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, një muaj nuk ia dha subvencionin Timos. Prandaj Timoja, duke e ditur se Musa Juka nuk e honepste Sherkon, shkoi te Musa Juka dhe u ankua me zemërim kundër Sherkos.

Musa Juka i tha:

- A e vret, po të kishe revole?

- E vras që ç'ke me të! - i tha Timoja.

Atëherë Musa efendiu nxori nga sirtari një nagant. I hoqi fishekët dhe i tha Timos:

- Tani do ta thërres! Ti kërcënoje me revole. - Dhe ia dha Timos revolen. Timoja e mori revolen me dorën që i

dridhej, dhe e fshehu nën xhaketë. Musa efendiu i tha rojës të thërriste Sherkon, dhe Sherkoja pas pak erdhi. Mori drejtqëndrim, nderoi allazogistshe dhe tha:

- Ekselencë, më thirrët?

Ministri bënte sikur lexonte disa shkresa. Atëherë Timoja i bërtiti:

- Paratë! Paratë, se...!

- Nuk kam punë me ju! Ekselencë, më thirrët?

- Paratë, paratë, se të vrava, të vrava, - bërtiti Timoja dhe i drejtoi revolen pa fishekë.

Sherkoja, porsa pa revolen, u shtri duke thirrur:

- Ekselencë, më vrau, më vrau, ekselencë!

Musa Juka u ngrit më këmbë, zuri mesin me të dyja duart dhe qeshte me të madhe. U hap dera dhe roja, porsa pa Timon me revole në dorë, nxori revolen nga brezi dhe ia drejtoi Timos. Ky u shtri përdhe dhe thërriste:

- Nxirre jashtë, se më vrau!

Të dy qenë shtrirë në dysheme, kurse ministri shëtiste me duar në mes duke u gajasur.

Kur shkova në Korçë, i dërguar nga "Vatra" për anketën se ku duhej bërë prefektura, mendova që për herë të parë duhej të pyesja autoritetet e vendit. Shkova te prefekti, Ismet Kryeziu, një burrë i thatë, që e mbante kokën lart. Ishte aty edhe kapiteni i xhandarmërisë, njëfarë Kulla nga Libohova, që u vra gjatë Luftës.

Pyeta prefektin se ç'mendonte ai për vendin se ku duhej ngritur prefektura e re. Ai u ngrit më këmbë dhe më tha:

- Në lagjen e myslimanëve dhe jo në atë të kaurëve.

Unë shënoja në bllok ato që më thoshte. Ai fliste me pasion kundër kaurëve. E pyeta:

- Po nëse përsëritet ndonjë manifestim më i madh se ai që u bë këtu për bukën?

- Ne, me Faslli beun e të tjerë, e kemi organizuar popullin mysliman të fshatrave të bëjnë një kundër-demonstratë më të madhe.

Pasi mbarova, u largova. Kur po hanim drekë në "Pallas" me shokët e Korçës, Stefo Grabockën, Dhimitër Fallon e të tjerë, na u afrua një oficer i ri, zeshkan, na nderoi dhe m'u drejtua mua duke më thënë se më kërkonte babai i tij, prefekti. I thashë se po haja bukë dhe nuk mund të ngrihesha. Shokët e miratuan vendimin tim, se e dinin ç'mendime kishte prefekti për kaurët. Edhe në darkë, kur po hanim, erdhi përsëri djali i prefektit, oficeri, dhe m'u lut të shkoja në shtëpi, se më kërkonte prefekti. Ai ngulte këmbë. Shokët më thanë të veja. Dhe shkova. Ai më priti mirë. Pasi më gostitën me gjithë të mirat, më tha:

- Due me pa se çfarë keni shkrue për gazetën, se sot kam kenë i nxeftë...

Iu përgjigja me gjakftohtësi:

- Zoti prefekt, kam zakon që shkrimet e mia nuk ia tregoj njeriu. Pastaj, shkrimin nuk e kam, ia dërgova Timo Dilos.

Ai nuk foli më. U largova. Pas dy ditësh, ishim me shokët në shëtitore, shkonim për te pijetorja e Bopit për të pirë birrë. Aliu, shitësi i gazetës, thërriste:

- Gazeta "Vatra", merrni gazetën "Vatra", që shkruan mendimet e prefektit tonë!

Pas nesh vinin prefekti, kryetari i bashkisë, Faslli Frashëri, e të tjerë. Rrëmbyen gazetën dhe nisën ta lexonin. U futëm te Bopi. Pas pak u futën brenda dhe prefekti me suitën e tij. Zunë vend përballë nesh. Ne pinim. Prefekti i tha kamerierit:

- Të tana ato që pinë ata djemtë atje, i paguej unë!

Unë iu përgjigja:

- Ju falënderojmë! I kemi paguar!

Prefekti ishte në qejf dhe deshi të na i paguante kafet, se unë në anketën time nuk kisha shkruar ato mendime armiqësore të prefektit që nxitnin përçarjen ndërmjet myslimanëve e kaurëve, por shkrova ato që mendoja unë:

"Unë jam i huaj këtu; korçarët patriotë e përparimtarë e dinë vetë se ku duhet ngritur ndërtesa e re. Ata janë përparimtarë dhe Korçën duan ta zbukurojnë." (Është botuar në gazetën "Vatra").

Pyetje: - Ke ndonjë kujtim nga koha e qëndrimit në Korçë?

Përgjigje: - Kam shumë kujtime: Vizitoja shpesh zyrat e shoqërisë "Puna". Mora pjesë në botimin e "Botës së re", ku shkrova një artikull "Mbi drejtimet e reja letrare" dhe një vjershë. Falloja ishte në krye të punës. Shfaqa edhe unë mendimet e mia për programin dhe shkrimet.

Stefo Grabocka kishte librarinë "Vatra" dhe i vinin revista përparimtare franceze si *"Vu"*, *"Lu"*, *"Venderdi"*, *"Canar Enchene"* e të tjera. Kishte dhe revistën *"La Russie d'Aujour d'hui"*, si dhe gazetën *"Le populaire"*, ngandonjëherë dhe *"Humanitee."*

Aty, Viti Shahini, që vinte nga Parisi, më solli disa trakte që ia kishte dhënë Halim Xhelo për mua. Traktet ishin në kutitë e aspirinave dhe në një pasqyrë, prapa, brenda kapakut. Më kishte dërguar dhe një letër, ku më porosiste: *"I dashur Arap, ti duhet të bësh ç'është e mundur që të sistemohesh në Himarë. Aty ka nevojë vendi për një shok. Duhet të bësh ç'është e mundur. Korça nuk ka nevojë për ty, se aty ka shumë shokë."*

Edhe një episod për të qeshur: Një mbrëmje Esat Dishnica dhe Teli Samsuri më thanë se duhej shkuar në një shtëpi ku ishin mbledhur disa shoqe arsimtare, që dëshironin të më njihnin dhe t'u flisja. Shkuam nëpër disa rrugica. Ishte errur. Teli trokiti në derën e oborrit. Pas pak dera u hap dhe një grua më ftoi të futesha brenda. Teli dhe Esati ishin larguar. E pyeta gruan:

- Ku janë shoqet?

Ajo më tha:

- Brenda janë! Sa dëshiron ti?

Pasi pashë që atmosfera ishte e dyshimtë dhe pasi

ata të dy nuk u dukën, e pyeta gruan nëse ajo shtëpi aty ishte shkollë, apo çfarë. M'u përgjigj se ishte shtëpi publike dhe më ftoi brenda. Unë u largova i turpëruar dhe i zemëruar. Atë mbrëmje nuk i pashë as Telin, as Esatin, ma punuan mirë.

Një tjetër episod: disa gra, dhe ishin dhjetëra, me thasë në krahë, ishin mbledhur para prefekturës dhe thërrisnin: "Bukë! Bukë! S'kemi bukë!" - Para "Shëngjergjit" ishte një grumbull me gurë për ngritjen e prefekturës së re. Hipa mbi gurët dhe me kodakun tim bëra disa fotografi në kohën kur xhandarët i shtynin gratë me bajoneta për t'i shpërndarë. Kapiten Kulla u bërtiste djemve që ishin aty pranë, të shpërndaheshin, dhe unë i thashë:

- Ata janë djemtë e këtyre nënave që kërkojnë bukë! Mos i zemëroni, që të bashkohen edhe ata me nënat e tyre! - Ato fotografi ia dhashë në Tiranë Ali Bakiut, një pjesë e të cilave janë botuar: xhandarë me armë në dorë që shtynin gra korçare!

Isha në kinema "Majestik", kur erdhën dy xhandarë dhe më hodhën prangat. Më çuan te prefekti. Ai ma tregoi urdhrin që kishte ardhur telegrafisht: *"Të arrestohet Petro Marko dhe të dërgohet postë më postë në Tiranë!"*

Prefekti, pasi ma lexoi telegramin, më tha:

- Më ke ba nji të mirë, pra edhe unë po të baj nji të mirë. Nuk do të të dërgoj në Tiranë të shoqëruem postë më postë të lidhun, po do të të dërgoj me korrierën, të shoqëruem me një civil! Pranon?

Pranova, pasi s'kisha nga t'ia mbaja.

Në Tiranë, ai civil më shpuri në polici, aty nga Rruga e Dibrës, ku ndenja vetëm katër ditë. Timo Dilo me shokë i kishin vajtur Musa Jukës dhe i ishin lutur për mua. Më liroi. Po Timoja nuk më pranoi më në gazetë. Ato kohë Medin Kamberi po nxirrte gazetën "Shtypi'. Më kërkoi vetë dhe unë pranova me këtë kusht:

1. Të dyja faqet e brendshme të gazetës t'i kisha unë. Të tërhiqja si bashkëpunëtorë shokët e mi.

2. Si në çdo gazetë ku kisha punuar, ai mund të hiqte nga shkrimet e mia ç'të donte, po nuk do të shtonte asnjë presje dhe jo më fjalë.

Ai e pranoi dhe më tha kështu:

- Ti e di ligjin e shtypit; të mos përmendim për keq familjen mbretërore, lartmadhninë e tij dhe politikën me Italinë e Duçes. Shkruani ç'të doni. Thirr për bashkëpunim kë të duash.

Kështu dy faqet e brendshme të "Shtypit" u bënë tonat. Aty shkroi Shevqet Musaraj, Qemal Stafa, Veli Stafa, Aleks Çaçi, Selim Shpuza, Andrea Varfi, Kristaq Tutulani, Nonda Bulka, Selfixhe Ciu (Kolomba), Musine Kokalari (Muza), Zihni Sako e të tjerë. Si bashkëpunëtorë në redaksi kisha Kolë Berishën dhe Zef Malën, i cili kishte punuar në gazetën "Arbnia" të Nebil Çikës. Zefi, Andrea Stefa dhe Spiro Mihali shkruanin me pseudonimin Trinitas.

Pyetje: - A mban mend ndonjë episod tjetër që vlen të përmendet?

Përgjigje: - Po, shumë të tilla. Kur Veli Stafa më njohu me të vëllanë, Qemalin, më tha se edhe Qemali shkruante mirë. Iu luta të më jepte diçka. Ai, pas disa ditësh, më dha disa skica që i botova me pseudonimin "Brutus". Ai e kuptoi, se ato ditë lexonte "Jul Çezarin" e Shekspirit të përkthyer nga Noli. Më buzëqeshi dhe më tha: "Po im atë nuk ka asgjë të përbashkët me Jul Çezarin. Më pëlqeu pseudonimi që më vure."

Dhe më e madhja: Më tha drejtori, Medini, shko e bëj një reportazh për shkollën e vajzave, institutin "Nana Mbretneshë". Shkova në darkë, kur jepej një shfaqje. Ishin aty të gjithë gazetarët të veshur me të zeza, ishte Musa Juka, princeshat, princ Xhelali e të tjerë. Kur nxënëset nisën të këndonin himnin e mbretit, të gjithë u

ngritën në këmbë duke nderuar me dorë në gjoks, allazogistshe. Unë u ngrita, por, meqë nuk nderoja kurrë më ashtu, bëja sikur shkruaja në bllok. Kur u bë pushimi i parë, dolëm në oborr, ku kishin shtruar një tryezë me gjithë të mirat. Më thirri Musa Juka dhe më tha:

- Mor Pjetër, pse nuk nderove kur u këndue himni i mbretit?

- Mbaja shënime! - i thashë.

- Mbaje shënime, ë? Unë e di që ju jeni betue mos me nderue kurrë, po pa më thuej pse nuk ke edhe ti uniformë të zezë si gazetarët e tjerë?

- Nuk kam pare, zoti ministër!

- Ti nuk don pare, more Pjetër. Po ki mendjen!

Kur filluan të hynin në sallë, unë ika. E shkrova reportazhin dhe e shpura në shtypshkronjën "Luarasi", ku shtypej "Shtypi'. Aty nga mesnata më erdhi në dhomë një tipograf me emrin Meti dhe më tha se ma kishin "fëlliqur" reportazhin. Shkova menjëherë në shtypshkronjë dhe pashë se mbi shkrimin tim kishin shtuar fjalë si "djemnia shqiptare duhet të edukohet me frymën e Liktorit, si avanguardistët fashistë"... e të tjera. I prisha ato dhe reportazhin e ktheva ashtu siç e kisha shkruar unë. Prita korrektorin, që të vinte për të parë bocat. Kur më pa dhe kur iu vërsula dhe s'lashë gjë pa i thënë, u trondit dhe iku pa thënë asnjë fjalë. Pas disa ditësh, tipografët u mblodhën aty në një lëndinë të Tiranës së Re për të biseduar se si të ngrinin sindikatën e tyre. Isha dhe unë, Luigj Filipi e të tjerë.

Aty nga ora 11 erdhi në shtëpinë ku banoja, karroca e mbyllur me dy xhandarë. Brankoja u trondit kur më pa të lidhur. Më shpunë drejt e te Musa Juka.

Sapo hyra, ai m'u vërsul si i tërbuar me sharje të rënda, megjithëse shpeshherë më kishte thënë se i paskësha bërë magji Burhanit, djalit të tij, i cili i kishte thënë; "Po më preke Petro Markon, unë nuk do të vij më

në shtëpi." (Burhani më duket se ishte në një klasë me Qemal Stafën dhe ishte përfshirë nga "snobizmi" i ideve të reja). Musa efendiu nisi të më bërtiste dhe, pasi heshti, unë e pyeta se çfarë kisha bërë! Ai m'u kthye:

- Si more, ç'ke ba? Ke sha nanën mbretneshë dhe princeshat... dhe korrektorin që mbronte nderin e nanës mbretneshë dhe të princeshave, e ke fyer!

Atëherë unë i thashë:

- Korrektorin do ta kisha vrarë, po të kisha revole!

Ai më pyeti pse dhe unë i thashë:

- Ai merr artikujt tanë dhe ia shpie Larusso Attomas për t'i kontrolluar dhe për t'i redaktuar sipas frymës fashiste. Po t'jua sillte juve artikullin tim për institutin e vajzave që shkrova, ishte e logjikshme, se fundi jeni ministri i Punëve të Brendshme të Shqipërisë dhe jo fashist si Larusso Attoma! Ai kishte shkruar mbi artikullin fjalë që nuk kishin vend, prandaj dhe unë u acarova e veprova ashtu. - Dhe ia tregova fjalët e shtuara.

Ai më dëgjoi mirë dhe m'u lut që t'ia përsëritja ato që i thashë.

- Ashtu asht?

- Po të doni, hetojeni mirë dhe keni për t'u siguruar se nuk ju gënjej.

E pashë që ndërroi fytyrë. U ul dhe i ra ziles, që të hynte roja e derës, të cilit, sapo hyri, i tha:

- Të më vijë këtu shpejt zoti Sherko!

Më shikonte në sy. Sherkoja, drejtori i shtypit, hyri, ashtu elegant, siç ishte, nderoi allazogistshe dhe tha:

- Ekselencë, më thirrët? - Mua nuk më hodhi asnjë shikim.

- Më thirr këtu sa më parë korrektorin.

Sherkoja doli. Musa Juka më shikonte dhe më thoshte:

- Naltmadhnia më ka folë edhe për ty! Dhe më ka

porositë që të të emnojmë nënprefekt në Himarë. Himara ka burra të ndershëm dhe shqiptarë të mirë. Po nuk kemi atje ndonjë të ri që të na punojë siç duhet. Prandaj edhe unë jam i mendimit që të ju emnojmë nënprefekt në Himarë.

Ai fliste butë dhe më shikonte në sy. Ishte shumë i zgjuar, psikolog dhe i përshtatshëm për misionin që i kishte ngarkuar mbreti. Pas pak hynë në zyrë Sherkoja dhe korrektori. Të dy rrinin si të ngrirë. Unë i vështroja në sy.

Musai u ngrit më këmbë:

- Ti, - iu drejtua korrektorit, - ki mendjen dhe më thuej të vërtetën! Artikullin e Petros kush e redaktoi dhe kush i shtoi ato fraza për rininë tonë? Mos gënje, se të piu e zeza!

Korrektorit i dridheshin leqet e këmbëve.

- Ekselencë, po ju them të vërtetën, nuk e redaktova unë, po Larusso Attoma.

Aty e pashë me sy egërsinë e Musa Jukës. U ngrit si një tigër dhe e kapi nga jaka e xhaketës korrektorin, e pështyu në fytyrë dhe nisi t'i binte me shkelma të shoqëruara me sharje:

- Edepsëz, mut, hale! Kush, more, është ministër këtu, unë apo Larusso Attoma? Jashtë, jashtë!

Pastaj u ul, zuri kokën me të dyja duart dhe më tha:

- More Petro, ju jeni betue mos me shkrue për mbretin. Po s'kemi bre, se kush na shkruen. Po të shkruenit ju, ja ku po të betohem se qysh sot po var në Pazar të Vjetër gjithë ato lavire (dhe përmendi emrat e disa gazetarëve të asaj kohe). Po ju jeni betue mos me shkrue për regjimin dhe për naltmadhninë e tij.

Pastaj me zë të butë përsëriti propozimin:

- Si thue, a pranon të shkosh në Himarë si nënprefekt?

E kuptova që laku po më hidhej në fyt. U mendova pak dhe i thashë:

- Kam për të dhënë dy provime në Athinë. Të bëhem me diplomë...

- Ti nuk ke nevojë për diplomë. Ti ke në kokë qindra diploma.

- Po duhet të vete patjetër në Athinë, se aty kam dhe një vëlla dhe ai ka nevojë të takohet me mua. Prandaj, të lutem, më lejo të vete në Athinë dhe, me t'u kthyer, do të pranoj të vete në Himarë si nënprefekt.

Ai u ngrit më këmbë:

- A ma jep besën e shqiptarit, besën e himarjotit se ti nuk do të shkosh atje ku vajti Asimi dhe profesori yt Skënder Luarasi? - dhe hetonte thellë shikimin dhe shprehjen time.

- Po ta jap fjalën se, me të dhënë provimet, do të kthehem.

Ai heshti, tundi kokën dhe pëshpëriti me zë:

- Të do shumë Burhani im dhe më ka thënë se ti je me karakter, prandaj të lejoj. Por, - dhe u mendua ca, - por, po më gënjeve, unë do t'i jap llogari naltmadhnisë së tij.

Para se të largohesha, iu luta:

- Lajmëro prefektin Qamil Pepa që të më japë pasaportën.

Ai mori telefonin dhe për pak u lidh me prefektin. I tha të më jepte pasaportën për në Greqi. Ai diçka i thoshte duke kundërshtuar, po ky me zë të rreptë e urdhëroi.

- Unë po të jap urdhnin që Petro Markos t'i japësh pasaportën!

U ndava nga ai dhe shkova drejt e në prefekturë. Dy fotografitë i kisha gati. Qamil Pepa më priti keq dhe më foli me romuze:

- Ia hodhe dhe Musa efendisë. Unë e di se ku po shkon ti... Po s'kam se ç'ti bëj atij...

Unë nuk flisja fare. I dhashë dy fotografitë. Nuk më tha të ulesha. Qëndrova më këmbë afro një orë, gjersa pasaportën e futa në xhep. Para se të dilja nga dera, dëgjova zërin e Qamil Pepës:

- Bëji të fala Asimit!

Drejtori dhe pronari i gazetës "Shtypi" më ndihmoi shumë. Më dha dy rroga parapagim dhe u bë garant në rekrutim. Para se të nisesha, u takova me disa shokë, të cilëve u propozova të vinin edhe ata në Spanjë. Njëri prej tyre më tha: "Unë po e rregulloj të marr bursë për në Itali. Sos do të vritemi të gjithë! Disa duhet të jetojnë!"

Ali Bakiu dhe Demir Godelli mblodhën disa të holla dhe m'i dhanë. Në dyqanin e Ali Bakiut erdhi dhe Ferid Vokopola, të cilit Aliu i tha:

- Petroja niset për një udhëtim të gjatë, dhe ne i mblodhëm disa të holla!

Ferid Vokopola, që kishte botuar dhe një vjershë në "Përpjekjen shqiptare" si përgjigje të vjershës sime "Nuk ndihet kënga", nxori kuletën dhe më dha tre napolona (që ishin shumë për atë kohë), duke më thënë:

- Të qoftë udha e mbarë e, kudo shkofsh, e nderofsh emrin e Shqipërisë!

U nisa për në fshat. U takova me të mitë. Mama Millja, gjyshja ime që më ka rritur, më pyeti se ku do të shkoja. I thashë se do të veja shumë larg.

RRUGA PËR NË SPANJË

Pyetje: - Si vendose të shkoje në Spanjë?

Përgjigje: - Ne, në gazetë (atëherë punoja në gazetën "Shtypi"), interesoheshim shumë për zhvillimin e luftës në Spanjë. Ajo nisi më 18 korrik të vitit 1936. (Për këtë është shkruar një libër: "Lufta e Spanjës", botim i Komitetit Qendror. Mua më ngarkuan ta redaktoja dhe ta botoja. Aty i kemi thënë të gjithë shkaqet e Luftës së Spanjës dhe krijimin e brigadave internacionale nga Kominterni, ku morën pjesë dhe shumë shqiptarë.) Pra, në gazetë njoftoheshim me anën e agjencive "Stefani" (italiane) dhe "UDN" (gjermane) agjenci fashiste; por Kolë Berisha, që ishte përgjegjës i lajmeve të jashtme, mendoi kështu: pasi agjencitë fashiste gënjenin dhe thoshin se përditë në frontet e ndryshme të Spanjës vriteshin mijëra "të kuq", që ta bënte të pabesueshme për lexuesit e gazetës frymën fashiste, shtonte nga një zero pas shifrave të të vrarëve të kuq. Pra, kur agjencitë fashiste thoshin se në filan front u vranë 8000 të kuq, Kola shtonte dhe një zero prapa, kështu që bëheshin 80 000. Brenda asaj vere të vitit 1936, po të mblidheshin shifrat e të vrarëve të kuq, do të dilnin me miliona. Kështu që lexuesit

thoshin: "More po Spanja sa milionë banorë ka? Sipas lajmeve të agjencive fashiste, aty janë vrarë më shumë se 100 000 000 spanjollë. Eh, si gënjejnë!"

I pari që hapi fjalën për vajtjen në Spanjë qe Demir Godelli, i cili kishte folur në burg dhe me Mustafa Gjinishin dhe Hasan Reçin, të cilët e kishin porositur Demirin që t'u propozonte shokëve të rinj dhe të shëndetshëm që të shkonin në Frontin e Lirisë në Spanjë; ishte thirrja e Kominternit që popujt duhej ta ndihmonin Spanjën Republikane edhe me njerëz, pasi aty Hitleri dhe Musolini kishin dërguar armatat e tyre për ta mbytur në gjak.

Demiri na mblodhi dhe na foli. Asimi qe i pari që doli vullnetar. U vendos që ai të shkonte i pari. Me shumë mundime, arriti ta siguronte pasaportën gjoja për të shkuar në Itali, në akademi, për të marrë dokumentet. Ai iku pasi i mblodhëm disa të holla. Pas tij u nis dhe Skënder Luarasi. Ai, duke kaluar nga Elbasani për në Korçë, takoi Justina Shkupin, së cilës i tha:

- Ti duhesh më shumë se ne në Spanjë, se je infermiere e mirë. - Justina e dëgjoi dhe u nis edhe ajo bashkë me Bim Kuranin, i cili kishte një librari në Elbasan.

Pas disa muajsh u mor vesh në gjithë rrethet tona, po ashtu edhe në qeveri, se Skënder Luarasi, Asimi, Justina e Bim Kurani kishin arritur në Spanjë. Madje disa herë Skënder Luarasi kishte folur nga Radio-Barcelona. Shumë nga shokët e kishin dëgjuar. Prandaj qeveria mori masa të rrepta për të mos lejuar largimin nga Shqipëria të shokëve tanë.

Nuk më mbante vendi gjersa të ikja edhe unë. Nuk mund ta shpreh dot dëshirën e madhe që kisha për të arritur sa më parë edhe unë në Spanjë. Ditë e natë, në çdo çast mendjen e kisha aty. Sa zili i kisha Asimin dhe shokët e tjerë që ishin në brigadat internacionale. Dhe ja që verën e vitit 1937, ashtu siç thashë më lart, gënjeva Musa Jukën dhe ika edhe unë.

Në rrethet revolucionare që njihja unë, ishte një nder i madh, një privilegj i jashtëzakonshëm, vajtja në Spanjë. Për mua qe një ëndërr.

Pyetje: - Mund të tregosh shkurtimisht itinerarin e udhëtimit për të realizuar ëndrrën tënde?

Përgjigje: - Janë kohë që nuk harrohen kurrë. Po, para se të rrëfej itinerarin e udhëtimit që më çoi në realizimin e ëndrrës sime, dua të shtoj dhe diçka që më mbeti si një imazh i paharruar: fytyra e Migjenit! Aty nga dimri shkova në Shkodër dhe rashë në familjen e Vasil Trimçevit, për t'u takuar me Migjenin. Ndenja disa ditë. Aty ishte dhe Viti Shahini, që e kishim shoqe të mirë. Me Migjenin folëm për poezinë. I thashë se Ismet Toto dëshironte të botonte një vëllim me vargjet e tij dhe me vargjet e mia dhe me një parathënie të gjatë për poezinë e re. I thashë se unë pranova, po Demir Godelli nuk më lejoi duke më thënë se Ismet Toto nuk ishte shok i idealit tonë. Edhe Migjeni nuk e dëshironte një gjë të tillë. Kur po hipja në autobus dhe po përqafohesha me Migjenin, vendosa t'i thosha se po ikja larg. Nuk dihej nëse do të shiheshim më. Ai e kuptoi. Më shtrëngoi dorën, më përqafoi. I pashë sytë t'i lageshin. Dhe më tha:

- Lum ti që ke shëndet të mirë! Po, Petro, lum ti që ke shëndet të mirë. - Më vështroi një copë herë, sikur deshi të më jepte porosi, por shqiptoi këto fjalë të fundit që dëgjova prej tij:

- Ti ke shkruar vargje të mira dhe të dobëta, ke shkruar shumë, po nisja jote për në Spanjë është poema më e bukur që po shkruen.

Mora udhëzime nga shokët e Tiranës (Demiri, Tajari e të tjerë) që, sapo të arrija në Paris, të takohesha me Llazar Fundon dhe t'i bëja një relacion për gjendjen e lëvizjes në Tiranë dhe në Shqipëri. Më dhanë dhe adresën.

Mbaj mend se hasa pengesa në konsullatën greke të Sarandës, që nuk më dha vizën. U ktheva në Vlorë dhe i dhashë një napolon një fshatarit tim, Vangjel Rucit, që

ishte kafaz në konsullatën greke të Vlorës. Ai ma rregulloi vizën.

Në Korfuz u takova me Dr. Omer Nishanin, i cili më dha një relacion për t'ia çuar Llazar Fundos. Takova dhe emigrantë të tjerë antizogistë, si Dhimitër Balën e të tjerë, të cilët më dhanë disa porosi për emigrantët e tjerë që ishin në Paris. Atëherë në Greqi ishte diktatura e Metaksasit dhe më duhej të kisha shumë kujdes. Në Athinë u takova me vëllanë tim, Mimin, me Vasil Konomin, Pavllo Rexhon e të tjerë. Më duhej të merrja vizën nga ambasada jonë në Athinë. Ambasador ishte Rauf Fico. E dija që ishte mik i Branko Merxhanit. Shkova tek ai, i dhashë të fala nga Brankoja dhe iu luta të më jepte vizën për në Francë. "Dua të shikoj "Ekspozitën Ndërkombëtare"" - i thashë. Ai më pa në sy dhe më tha troç:

- E di unë se për ku je nisur. Gjynah! Por patjetër që do të ta jap vizën! - Më dha dhe dorën dhe mbaj mend këto fjalë: "Mjerë rinia jonë".

Për në Pire më shoqëruan vëllai, Mimi, Vasil Konomi, Pavllo Rexho dhe dy komunistë grekë të shkuar nga mosha. Hipa në vaporin francez "Teofil Gotie", vapor i madh, në klasën e katërt, domethënë në kuvertë, se ishte behar dhe bileta ishte më e lirë. Vapori bënte xhiron e limaneve të Mesdheut. Udhëtuam për në Beirut, për në Aleksandri, për në Tripoli, për në Bizertë, Algjer e Marsili. Udhëtimi ishte i gjatë. Unë rrija gjithë ditën duke vështruar brigjet e Mesdheut dhe shkruaja vargje ashtu siç më dilnin, duke pasur mendjen të ndezur. Shkoja drejt luftës dhe së panjohurës. Në kuvertë ishin shumë udhëtarë, shumica të rinj e të reja franceze, turistë, me pantallona të shkurtra, të nxirë nga dielli, se dhe në kuvertë gjithë ditën bënin banjo dielli. Edhe nga Mimi, edhe nga dy shokët grekë që më përcollën gjer në Pire, pata porosi të prerë: "Me asnjë udhëtar miqësi dhe muhabete, as edhe me vajzën më të bukur, po t'u afrua!"

M'u afrua një angleze shumë e bukur, me një trup elegant. Dinte shumë gjuhë. Vinte nga Egjipti. Ishte egjiptologe dhe merrej me kërkime të kulturës së lashtë egjiptiane. Më pyeti se nga isha dhe ku veja. I thashë se isha student dhe shkoja në Paris, që të vizitoja "Ekspozitën Ndërkombëtare". Ky qe refreni i përhershëm. Ajo m'u afrua shumë, më jepte banane dhe ushqime të saj dhe unë e falënderoja. Më jepte cigare, i thosha se nuk e pija. Kur po afroheshim në ujërat e Francës, koha u prish dhe deti u egërsua shumë. Unë u struka nën një tendë druri. Deti ulërinte. Mezi u shqita nga anglezja, e cila më kërkonte. Pastaj e humba. Nata ishte e thellë. As unë nuk e di se si nisa të fishkëlleja "Internacionalen." Kaloi andej një marinar i trashë, me një fener në dorë. Afroi fenerin drejt meje, se dëgjoi fishkëllimën e "Internacionales." Më pa mirë dhe më tha:

- *Mon petit, vien avec moi!*[1)]

Më mori nga dora dhe më shpuri poshtë, në kabinën e tij. Më shikonte në sy dhe më fliste me sy. Hapi sirtarët e nxori proshutë, kaçkavall, banane dhe një shishe verë.

- *Mange mon petit! Mange e repose toi ici!*[2)]

- *Merci!* - i thashë.

Para se të dilte nga kabina e tij, u kthye, mbylli derën dhe më tha me zë të ulët:

- *Mon petit je sais ou tu va! Il faut battre Franco, il faut sauver la Republique Espanjol!*[3)]

Hëngra e piva dhe më zuri gjumi. Ndjeva dorën e marinarit francez në ballë. Hapa sytë dhe e pashë që më buzëqeshte me zemër deti. Më mori nga dora dhe hipëm në kuvertë, ku ishin shumë nga ata që kisha njohur gjatë udhëtimit.

---

1) Vogëlushi im, eja me mua

2) Ha vogëlushi im! Ha dhe pusho këtu.

3) Vogëlushi im, unë e di ku po shkon ti! Duhet mundur Frankoja. Duhet shpëtuar Republika Spanjolle.

- *Voila Marseille*! - më tha. Më shtrëngoi dorën duke më thënë: - *Bonne chanse mon petit!* - dhe iku në punën e tij.

Deti ende ishte i egërsuar. Marseja dukej e gjerë dhe në çdo çast më bëhej më e madhe. Të gjithë ishin në kuvertë dhe bëheshin gati për të zbritur. Pranë meje rrinte anglezja egjiptologe, veshur mirë. Më shikonte. Më fliste, por unë i përgjigjesha në mënyrë lakonike. Ajo më në fund më tha:

- Më vjen shumë keq që nuk munda t'jua lehtësoja dramën që mbartni në shpirtin tuaj! Unë ju uroj që të buzëqeshni së shpejti! - Ku unë e ku ajo! Pastaj m'u afrua më shumë dhe, duke qeshur, më tha: - Më lehtë është për mua që të bisedoj me mumjet e piramidave, sesa me ju! Shikoëni një herë në sy, para se të ndahemi, dhe lexoni dëshirën e zjarrtë që kam për t'ju njohur! - Unë i buzëqesha me mirënjohje për këto fjalë të mira që më tha, pastaj ula sytë dhe tunda kokën.

Vapori i madh, i udhëhequr nga një vapor pilot, arriti në mol. Iu afrua bankinës së caktuar dhe u ulën shkallët. Qindra udhëtarë filluan të zbritnin. Anglezja pas meje. Kur shkela truallin francez, ndjeva diçka të çuditshme. Mendimet m'u ngatërruan dhe më dukej sikur nuk shihja asgjë. Anglezja më kapi, më pushtoi, më puthi në buzë dhe iku pa më thënë asnjë fjalë. Ndjeva që më shtynin. Dola tej turmës dhe qëndrova një copë herë duke kundruar lëvizjen e madhe. Mbaja në dorë valixhen e lidhur me tel. Xhaketën e bardhë e hoqa, se bënte vapë. Më shtynin. Më flisnin të bëja mënjanë. I shastisur, kundroja një botë tjetër. Dëgjova një zë gruaje: *"Sas parakalo..."* Më fliste greqisht. Atë grua dhe vajzën e saj të re, nja shtatëmbëdhjetë vjeçe, i kisha parë shumë herë në kuvertën e vaporit. Mbaj mend se dhe ajo në Pire hipi. "Ju lutem, më bëni një nder të madh. Jemi nisur për në Grënobël, po nuk na dalin të hollat për tren. Sa t'i

telegrafojmë burrit." Ajo kërkonte 200 franga. Unë, pa menduar fare, ia dhashë. Vajza shkroi adresën e babait, pastaj më tha:

- Po të doni, na shkruani se ku t'jua dërgojmë paratë!

- S'ka gjë, - u thashë, - kushedi, mund të takohemi ndonjëherë!

Dhe vërtet, pas tre vjetësh, kur isha në Grenobël, dhe isha shumë ngushtë, m'u kujtua ajo grua. Dhe për çudi, në *"Place gernette"* të Grënoblit pashë vajzën. E ndalova, por ajo bëri sikur nuk më njohu. Të nesërmen u nisa për në Sasenage, se atje punonte babai i saj si fotograf. Vajta. Ai grek kujtoi se unë shkova të fotografohesha. I thashë se isha keq, prandaj me turp ia kërkova ato që u kisha dhënë gruas dhe vajzës së tij në Marsejë, kur ktheheshin nga Greqia.

Ai thirri të shoqen, të cilën e njoha, por ajo nuk më dha të njohur.

- E njeh këtë zotëri? - e pyeti i shoqi.

Ajo ngriti supet dhe tha se nuk më kishte parë kurrë në jetën e saj. Kërkova ndjesë dhe u largova. Po dëgjoja shamatën që u ndez në mes tyre.

Pyetje: - Ishte etapa e parë e itinerarit të udhëtimit tënd për në Spanjë. Dua të të pyes: si e ndjeve veten, ç'mban mend, se kanë kaluar shumë vjet?

Përgjigje: - Jeta njeriut mund t'i duket e gjatë dhe vetëm për një orë. Po, të të them të drejtën, për mua ato ditë kanë qenë të gjata dhe të ngarkuara me aq emocione dhe imazhe, se gjatë gjithë këtyre viteve më janë amplifikuar pambarimisht.

Në Marsejë të Francës e ndieja veten të lirë, të gëzuar. E ndieja veten njeri.

Me valixhen në dorë, me xhaketën hedhur në sup, shëtita ca, pastaj u futa në një restorant të madh modern, aty në afërsi të stacionit hekurudhor. Thashë me

vete: "O Petro. Ti shkon në luftë dhe, s'dihet, edhe mund të vritesh. Para në xhep ke. Pse nuk futesh në këtë restorant modern!" Me valixhen në dorë, me xhaketën hedhur në sup, iu afrova derës. Portieri më nderoi. U futa brenda. Një zotëri më kërkoi valixhen dhe xhaketën. I mori dhe më shpuri në një tryezë, andej nga fundi i sallës së restorantit.

Më tha:

- Ju pëlqen këtu?

- Po! - i thashë.

Vendosi valixhen pranë murit dhe vari xhaketën në varëse. M'u drejtua:

- A jeni mirë këtu?

- Shumë mirë!

- Do të hani?

- Si urdhëron!

U largua. Pas pak erdhi kamerieri. Më nderoi me buzëqeshje:

- Vetëm jeni?

- Po!

- Do të hani?

- Po!

- Çfarë pije dëshironi?

- Birrë! - i thashë.

U largua dhe pas pak erdhi me një shishe të gjatë në dorë. E hapi dhe nisi të mbushte një gotë si hinkë. E shikoja me habi atë pije që mbushte gotën e gjatë. (Ishte një lloj vere.) Ai vuri re habinë time dhe më pyeti:

- *Quelle langue vous parlez?*

- *Parlo italiano, ksero elenika.*

- *Parlate italiano! Che cosa volete bere?*

- *Una birra!*

- *A... Voulez vous de la bierre!* - dhe më kallëzoi duke buzëqeshur markën e verës që mbante shishja "Byrth...", po që shqiptohej *bir.*

Pastaj më pyeti:

- *Voulez vous mangez a la carte ou a la choie?*

Dhe unë iu përgjigja:

- *A la carte!*

Ai erdhi me pjatanca të mëdha, nja tetëmbëdhjetë herë. Unë u ngopa që me pjatancën e parë plot me antipastë të pasur. Vinte me të gjitha gjellët e menusë. (Dhe unë mendoja: Mos vallë ky do të jetë ndonjë komunist? Më lexoi në sy mendimet, e kuptoi se unë po shkoj në Spanjë, dhe kërkon të më ngopë. Apo mos e kuptoi që unë vij nga një vend i varfër, dhe sillet kështu pasi është "shok" - se unë mendoja se të gjithë punëtorët ishin shokë - ashtu siç i mendoja unë shokët: bolshevikë, zemërmirë, që bëheshin copë për shokun.)

Më në fund më solli edhe fruta të ndryshme. Hëngra vetëm një banane. Pasi mbarova, e pyeta se sa duhej të paguaja. Ai më tha dyzet franga, unë i dhashë pesëdhjetë franga.

Këtë episod ia kallëzova edhe Fundos e Ali Kelmendit në Paris. Ata qeshnin me mua dhe më shpjeguan se e kisha bërë kërkesën "a la carte" domethënë për të ngrënë të gjithë menunë.

Pyetje: - Mos ke harruar ndonjë episod tjetër interesant?

Përgjigje: - Çdo hap që bëja, ishte një episod. Po dua të përmend një episod të Athinës, që hyn në fondin e dashur sentimental të çdo të riu: Kur isha në Athinë, pas arratisjes nga Shqipëria, banoja në Falero, te vëllai im Mimi, bashkë me Vasil Konomin. Por, kur shkoja në universitet, shihja hyrjen e një kabareje të madhe me tabelën "Femina". E çfarë nuk tregonin për atë kabare! Pasanikët eglendiseshin me të bukurat e Greqisë dhe të Evropës. Tani që u nisa për në Spanjë dhe kisha me vete ca të holla, vendosa të hyja edhe unë një herë në atë kabare, se mendova: "O Petro, ti për t'u vrarë që për t'u

vrarë ke, pa hyr dhe ti një herë këtu, para se të vdesësh". U err shumë dhe unë vija vërdallë në afërsi të "Feminas". Prisja të kalonte edhe ca kohë e të hyja, kur sallat të ishin plot e unë të shikoja se si zbavitej klasa e pasanikëve. Kur u futa brenda, më pyeti një burrë i gjatë nëse isha vetëm. Ai më shpuri te një tjetër, një burrë i shkurtër dhe tullac. Ky më çoi te një tryezë në një qoshe. Më pyeti nëse prisja njeri. I thashë jo. Pastaj erdhi një i ri simpatik, më përshëndeti dhe më pyeti nëse dëshiroja shoqëri me ndonjë vajzë të bukur. Unë i buzëqesha dhe ai më kuptoi mirë. Më pyeti tërë mirësi:

- Si e doni? Ezmere, bjonde, të hollë, të trashë, - e të tjera.

- Si të doni ju! - i thashë pak si i truar.

Muzika dëgjohej lehtë dhe shumë çifte vallëzonin. Vura re se shumica e femrave ishin gjysmëlakuriq, në mos fare lakuriq. Mendova: "O Petro, e ç't'u desh që hyre në këtë valle?!"

Pas pak erdhi ai djaloshi me një vajzë ezmere, të re, shumë të re, të hollë dhe shumë të bukur. Ajo më përshëndeti duke përkulur këmbën nga pas, dhe më tha:

- A mund të ulem pranë jush? - dhe erdhi u ul pranë meje. Ndreqi pakëz flokët e zinj, që i binin mbi shpatullat lakuriqe, ktheu sytë nga unë dhe më tha:

- Cigare!

- Nuk e pi! - i thashë dhe kisha frikë t'i shihja ata sy të zinj e të mëdhenj, me ato qepalla të gjata...

Erdhi kamerieri.

- Ç'urdhëroni të pini?

- Shampanjë! - thirri vajza.

- Po ju? - më pyeti mua.

- Shabesë!

Vajza ktheu menjëherë sytë nga unë dhe më tha:

- Pse, nuk e pini shampanjën?

Unë nuk fola. Ula kokën. Ajo menjëherë i tha kamerierit:

- Edhe mua sillmë një shabesë!

Unë ngula këmbë që ajo të merrte shampanjë, por nuk pranoi.

Kur u largua kamerieri, më hodhi dorën e saj në timen dhe më pa në sy:

- Ç'punë bëni?

- Jam student, por i varfër!

Ajo u kthye më shumë nga unë, më shtrëngoi dorën dhe më pyeti se si quhesha, pasi ajo më tha se atë e quanin Keti. I thashë se më quanin Demo Ziu.

- Demo Ziu, je shumë i mirë, ashtu siç janë gjithë të varfërit! Po ç'kërkove këtu?

- Po ti ç'kërkove këtu?

Ajo e tërhoqi dorën që më shtrëngonte timen, zuri të dyja faqet me pëllëmbët e saj dhe pastaj tha, sikur po zgjohej nga një gjumë me ëndrra të tmerrshme:

- Demo Ziu, ti je i mirë, shumë i mirë, dhe vetëm ty mund të të hap zemrën time të plagosur. - Më shtrëngoi fort dorën, u afrua më shumë dhe më puthi në buzë, sikur po puthte buzët e ndonjë busti të mermertë. - Demo, mos eja më këtu. Po ti më jep adresën tënde, se unë dua të vij dhe të ta hap zemrën dhe të të them pse gjendem këtu. Ma jep adresën dhe ikë, ikë sa më parë që këtej!

As unë nuk e di se si vendosa t'i jepja adresën e Vasilit. Dhe, pasi e pimë shabesën, që kushtonte 70 dhrahmi gota, u ngritëm, jo për të vallëzuar siç bënin të tjerët në sallat gati të errësuara, po për t'u ndarë përjetë, përjetë. Ajo më përcolli gjer në derë dhe përsëri më puthi në buzë, sikur puthte buzët e një busti prej mermeri. Më hodhi duart rreth qafës dhe më tha:

- Dua të më puthësh me zemër, ashtu siç të putha unë. Po nesër, kur të vij tek ti dhe të dëgjosh arsyet pse jam këtu, ti do të më puthësh me zjarrin e dashurisë. - Ajo fliste dhe mua më vinte mendja rrotull, sikur të kisha pirë një vozë me shampanjë. U ndamë.

Unë të nesërmen isha në det, mbi vaporin "Theofil Gotie". Dhe, të them të drejtën, sytë e saj më ndiqnin dhe thosha me vete: "Do të ketë shkuar te Vasili, do të ketë kërkuar Demo Ziun dhe Vasili do ta ketë kuptuar se cili është *Demo Ziu*".

Para se të më bëni një pyetje tjetër, dua të them se, që kur më shkeli këmba në tokën franceze, e ndieja veten të lirë. Kjo është një etapë me rëndësi e maratonës sime drejt frontit të lirisë, kambana e të cilit ishte aq bubulluese, sa humbiste çdo tingull tjetër të ëndrrave, mendimeve dhe episodeve të tjera...

Pyetje: - Si e kaluat udhëtimin nga Marseja në Paris?

Përgjigje: - Të gjitha i kam harruar, përveç amerikanes. Dua të them se hollësitë e tjera janë të rëndomta. Para se të blija biletën e trenit për në Paris, bleva disa gazeta: *"Humanitee" "Vendredi" "Lu" "Vu"* Hipa në tren. Zura vend në një kabinë ku ishin vetëm dy veta: një burrë dhe një grua. Vendosa valixhen lart dhe zura vend pranë dritares, përballë dy udhëtarëve të tjerë. Vura re se dera u hap dhe pashë kokën e një vajze bjonde shumë tërheqëse. Ajo buzëqeshi dhe hyri brenda e, pasi kërkoi leje të ulej pranë meje, u ul. Edhe ajo rregulloi valixhen e saj, përshëndeti me edukatë udhëtarët kundruall dhe lëshoi një pasthirrmë të lehtë. Treni u nis. Unë lexoja gazetën dhe më vinte çudi se si "Humanite-në" e lexoja pa frikë, dhe jo si në Tiranë e Korçë, ku e lexonim fshehurazi. Vura re se frontet në Spanjë ishin shumë të ndezura. Fashistët bënin kërdinë me bombardime dhe me terror në popullatën e vendeve të pushtuara prej tyre. Pasi palosa gazetën, ndjeva supin e vashës që u ul pranë meje. Nuk lëviza. Ajo u afrua më shumë dhe më tha:

- Besoj se nuk jeni francez! Vini nga Orienti?

I pashë sytë e saj që shprehnin pastërti dhe interesim. I thashë se vija nga Ballkani. Ajo tha se ishte amerikane, kishte studiuar në Firence të Italisë, kthehej në Paris për të marrë disa tesha dhe për të parë

"Ekspozitën Ndërkombëtare". Pasi e fliste mirë italishten, filluam të merreshim vesh më lehtë se në frëngjisht. Burri që ishte pranë gruas karshi nesh, kishte mbyllur sytë, kurse gruaja e trashë na shikonte me zili dhe pyeti:

- Të fejuar apo të martuar?

Vajza që kisha pranë, qeshi dhe nuk u përgjigj. As unë nuk u përgjigja. Ajo vazhdoi:

- Paskeni lindur për njëri-tjetrin! Çift si ju s'kam parë gjer më sot!

Bashkudhëtarja që kisha pranë, qeshi dhe u mbështet më shumë tek unë. Dhe mendoja: "Nga vinte ajo bukuroshe? A më kishte thënë të vërtetën? Nga ta dish." Cila qe porosia e shokëve? "Kujdes nga femrat! Ato janë spiune. Fashizmi dhe kapitalizmi zgjedhin bukuroshet për të prishur mendjet e revolucionarëve dhe për t'u hapur qoshet sekrete të zemrës së tyre.""

- Francez jeni? - pyeti përsëri gruaja e trashë, ndërsa i shoqi vazhdonte të rrinte me sy mbyllur, me kokë të mbështetur pas.

- Jo! - tha vajza që kisha pranë.

Gruaja fliste me amerikanen. Veshi më kapte ndonjë fjalë nga zëri i vajzës që kisha pranë. "Ne amerikanet ëndërrojmë Evropën ku ende ka sentiment, ka ngrohtësi, ka romantizëm!"

Gruaja franceze gjithnjë qeshte me përgjigjet që i jepte amerikania. Dëgjova të thoshte: "Ne francezet jemi plot sentiment dhe dëshirë për t'u pëlqyer nga burrat."

Flisnin për ndjenjat e tyre, për dëshirat e tyre, për planet e tyre. Asnjë fjalë për luftën që gjakoste Spanjën, asnjë fjalë për fashizmin, që kishte ndezur flakën e vdekjes në Spanjë. Më vinte inat. Dhe s'kisha mundësi t'u bërtisja: "Pse nuk dëgjoni kambanën e Spanjës? Nuk dini ju se ç'bëhet në Spanjë?"

Dëgjova francezen: "Stina më e bukur për dashuri është udhëtimi... Edhe ne kemi udhëtuar..."

Ato bisedonin. Burri gërhiste. Unë e ndieja veten si në ëndërr. Mendimet e mia nuk gjenin strehim qetësie gjëkundi. Ndërsa treni ecte në binarë drejt një caku, mendimet e mia pa binar e pa cak turbulloheshin më shumë nga vasha që më ishte mbështetur shumë, aq sa flokët e saj të verdhë ngrohnin faqen time të majtë.

Treni ndalej nëpër stacione të ndryshme, ku zbritnin dhe hipnin udhëtarë, ndërsa mendimet e mia ndaleshin herë pas here nëpër stacione të ndryshme të horizontit tim të shkelur, ku dilnin dhe zhdukeshin fytyra, si ajo e mama-Milles, e motrës, e Mimit, e Demirit, e Omer Nishanit: "Ki mendjen nga cilido, sidomos nga bukuroshet, se kudo udhëtojnë dhe janë agjente të fashizmit dhe të kapitalizmit." Dhe vija në vete, kthehesha aty: "Po edhe kjo agjente të jetë? Ku e dinte ajo se do të hipja në këtë tren? E po, në qoftë agjente..."

Ata dy udhëtarët që *ishin përballë nesh, zbritën* duke na uruar *"bonne chance!"*. Kështu që mbetëm të dy vetëm. Treni u nis dhe nuk na erdhi asnjë udhëtar tjetër. Amerikania u ngrit dhe, duke u gjunjëzuar, më vuri duart në duart e mia. Më pa mirë në sy dhe më tha:

- Ju ka ngjarë ndonjë fatkeqësi e madhe?

- Jo!

- Nuk dua të qëndroni kështu i mërzitur! A mund t'ju dukem e dobishme për ndonjë gjë të mundshme? - dhe më shikonte në sy e në buzë. Mbështeti kokën te gjunjët e mi! Atëherë unë, padashur, i vura dorën në flokët e mëndafshtë dhe ia përkëdhela. Ajo qëndroi kështu shumë çaste, pastaj u ngrit, ndenji në vendin e saj duke u strukur më shumë tek unë. Dhe thoshte:

- Vijmë nga qielli i pafund dhe ja që takohemi sikur të kërkonim njëri-tjetrin në xhunglat e jetës. Ti je i mërzitur, ti je i pikëlluar, ti je i rënduar nga brenga, kushedi; dhe unë dua që të ta lehtësoj, se kushedi a do të udhëtojmë më bashkë. Kushedi! Si thua, a do të

udhëtojmë bashkë? Si tha ajo gruaja? "Stina më e bukur për dashuri është udhëtimi!" Po... ja... Udhëtimi më solli te prehri yt! Pse nuk më shikon?

Foli e foli, pastaj u shtri. Kokën e vendosi tek unë dhe zgjati këmbët. Dhe fliste si në ëndërr. Ndoshta ishte e lodhur. Më kishte kapur një dorë dhe mbi të kishte mbështetur faqen e saj. Unë me dorën tjetër i përkëdhelja flokët e mëndafshtë. Dhe treni ecte drejt Veriut me këngën monotone të tij: "Përfito! Përfito! Përfito!"

Pyetje: - Si shumë e zgjate me këtë episod!

Përgjigje: - Këto episode mbahen mend përherë, se janë aroma e ndjenjave më intime. Aty, për çudi, m'u kujtua dhe Keti e kabaresë "Femina" të Athinës. Dhe, duke përkëdhelur flokët e amerikanes, e cila nuk më kishte thënë as emrin e saj, se as që ia kisha kërkuar, sillja ndër mend sytë e Ketit, kur më thoshte: "Mos eja më këtu, o Demo Ziu. Do të vij unë tek ti." Ajo kushedi se ç'jetë të zezë kishte bërë, gjersa arriti atje për të eglendisur të pasurit, kurse kjo amerikane e lirë udhëtonte, studionte në Firence dhe tipizonte vashën e lirë të shekullit...

Treni arriti vonë në Paris. Amerikania e dinte, se ia kisha thënë drejtimin tim. Duhej të shkoja në *"Place de l'Etoile"*. Treni u ndal. Njerëzit dilnin me radhë. Përpara doli amerikania, pas saj unë. Të dy krah për krah iu drejtuam metrosë. Ajo më tha të shkonim me metro në *"Place de l'Etoile"* dhe jo me taksi. Për herë të parë hyra në metro. Shumë njerëz. Dritë kudo. Dolëm në *"Place de l'Etoile."* Drita të shumta. U drejtuam për te hoteli *"Etoile."* Sportelistja na pyeti nëse donim një dhomë apo dy dhe amerikania i tha një. Dhamë emrat, paguam. Amerikania më kapi për krahu. "Ngjitu se po vij", - i thashë. Dhe ajo po hipte ngadalë shkallëve duke më vështruar. Më buzëqeshte e lumtur. Kur u zhduk, menjëherë dola nga hoteli dhe nisa të ecja rrugëve. Pyeta një njeri se ku binte rruga që kërkoja, dhe më tha të zbritja nga e majta e të

pyesja, se aty pranë ishte. Shëtita ca në atë shesh të ndritur dhe habitesha. Më dukej si në ëndërr. Kisha dëgjuar se Parisi quhej *ville llumiere* dhe ja tani e shikoja me sy se me të vërtetë ishte qytet i ndritur, me gjithë ato drita të pafund. Eca edhe ca dhe herë pas here mendoja: "Ç'do të thotë tani amerikania?"

Nuk më dukej vajzë e keqe. Por gjendja ime, qëllimi im, rruga ime nuk më lejonin. U lodha dhe u futa në një kafe. U ula në tryezë dhe porosita një kafe. Para meje ishte dhe një pjatancë me disa petulla të gjata që quheshin "*croissants*". Piva kafe, hëngra dhe tri nga ato *croissants*, se ishin shumë të mira. Nisa të lexoja "*Venderdi*-në" dhe më vinte gjumë. Prisja të vinte agimi. Shikoja njerëz të qetë që hynin e dilnin, shikoja çifte, vajza të vetme, të veshura mirë dhe me qëndrime provokuese. Uleshin, pinin pije, pinin cigare dhe putheshin sikur të ishin të mbyllura në dhomë. Unë kujtoja se ato ishin të dehura, po jo! Ishin normale dhe puthjet i kishin normale. Aty më kujtohej Keti, më kujtohej amerikania, e cila në ato çaste ndoshta ende po më priste. Më në fund zbardhi dita. U ngrita dhe pyeta kamerierin se ku binte rruga që kërkoja. Doli jashtë dhe ma bëri me dorë se nga duhej të shkoja.

I rashë derës. Dëgjova një zë gruaje. Edhe Demiri, edhe Dr. Nishani adresën e Fundos ma kishin dhënë: *Madamë*... Dhe aty për aty thashë me vete se *mos isha* gabuar. U hap dera dhe më doli përpara një grua e bukur, bjonde, me robëdëshambër. U turpërova, por arrita të thosha me frëngjishten time: "Kërkoj Llazar Fundon!" Dëgjova një zë nga dhoma e hapur:

- Petro, po vij, po vij. - Ishte zëri i Fundos, i cili më doli përpara vetëm me brekët e ngushta të bardha. Një trup atletik, një fytyrë e çelur, një flokëverdhë simpatik. Më buzëqeshi, më dha dorën dhe më puthi: - Të prisja, Petro. Qenke ashtu si të përfytyroja...

LIDHJA E PARË ME KOMINTERNIN

Llazar Fundoja ose Zai i Fundos, siç i thoshin, m'u duk njeri shumë i zgjuar dhe shumë i përgatitur. Ai më priti me përzemërsi, më njohu me një shoqe të tij me të cilën bashkëjetonte (ishte ajo që më hapi derën) e që punonte në redaksinë e revistës komuniste "Regard". Më duket se ishte gjermane. Fundoja më pyeti për gjithçka dhe unë i raportova për sa më kishin porositur shokët e Tiranës: Kishin bërë përpjekje të bënin një mbledhje me shokët e Korçës dhe me shokët e tjerë nga gjithë Shqipëria. Kishin vendosur të takoheshin në Pogradec, në verë, me qëllim që të krijonin njëfarë "komiteti drejtues" për gjithë lëvizjen komuniste shqiptare. Tajari më kishte porositur t'i thosha se mendonin që patjetër duhej krijuar ai "komitet drejtues" dhe do të përpiqeshin ta bënin. I tregova se edhe unë isha dërguar nga Tajari dhe Demiri në Korçë të merresha vesh për këtë punë. I tregova pra gjithçka duhej, sipas porosisë.

Zai i Fundos më shëtiti në Paris, po kurdoherë duke folur për situatën në Shqipëri. Më porositi:

- Tani do të bëjmë një mbledhje me të gjithë emigrantët shqiptarë që janë këtu, si dhe me punëtorët shqiptarë. Ti do të tregosh këto: 1) Në Shqipëri lëvizja komuniste po zgjerohet; në shkolla, në ushtri, tek tregtarët e vegjël, te mësuesit, te punëtorët, vetëm idetë komuniste përhapen. Nuk njihet asnjë organizëm tjetër. 2) Asnjë nuk i njeh fare emigrantët e tjerë politikë përveç Komitetit të Çlirimit Nacional...

Unë i thashë se kisha marrë porosi edhe për Qazim Koculin, se atje kishte shokë të tij, kishte në burgje dhe jashtë njerëz që kishin lidhje me të. Ai më tha të thosha ato që më porositi ai...

Aty ishte dhe Ali Kelmendi e Loro Brahimi, dy anëtarë të tjerë të Komitetit të Çlirimit Nacional, që përbëhej prej

këtyre tre shokëve, me Fundon përgjegjës. Me këta të tre u takova shumë herë.

Fundoja më shpuri në *"Rue Combat"*, nr. 8, ku ishte qendra e komitetit të seksionit të Kominternit për Ballkanin. Më njohu me shokun Robert (ishte pseudonimi i një shoku jugosllav, që më duket se quhej Vukoviç). Ai më pyeti për shumë shokë tanët që atëherë ishin në burg, si Mustafa Gjinishin, Hasan Reçin e të tjerë. Ai më dha një shok që më çoi në një zyrë tjetër. Ai shoku tjetër më pajisi me bonot e restorantit ku do të haja, dhe më shpuri në hotel *"Bellville"*, ku do të flija gjersa të niseshim për në Spanjë.

Në atë atmosferë revolucionare, ku hynin e dilnin shokë e shoqe shumica të klasës punëtore, sidomos ballkanas, e ndieja veten shumë mirë dhe harrova çdo gjë të së kaluarës. Më porositën se si të sillesha, me kë të shoqërohesha, se kudo kishte spiunë, njerëz të Kolonës së Pestë.

Mbledhjen me shqiptarët e bëmë në një sallë të një kafeneje. Fundoja hapi mbledhjen. Aty njoha Qazim Koculin, Rexhep Mitrovicën, Ali Këlcyrën, Kolë Tromarën, Aziz Çamin, Qazim Mulletin, Beqir Valterin, një djalë të Ismail Qemalit, Muharrem Bajraktarin e të tjerë. Fundoja u tha:

"Meqë Petroja shkon në Spanjë, dëshiron të na bëjë një ekspoze të situatës në Shqipëri." Unë thashë pak a shumë ato që më porositi Fundoja. Kur mbarova, u ngrit Qazim Koculi dhe tha se nuk ishin të vërteta ato që thashë unë, se në Shqipëri nuk ishin vetëm komunistët kundër regjimit të Zogut, po ishin shumë nacionalistë që dergjeshin në burgje dhe që punonin kundër regjimit. Ai foli gjatë dhe pastaj iu kthye Fundos:

- Ju bëni shumë keq që dërgoni këta goxha djem të vriten kot së koti në Spanjë. Pse nuk del ndonjë nga këta të vdesë në Shqipëri, duke vrarë një Kros ose një Musa Jukë ose dhe vetë satrapin Zog? Pse këta nuk marrin

shembull nga Avni Rustemi? Po ju i merrni në qafë kot, duke i dërguar të vriten në tokë të huaj, pa asnjë leverdi për Shqipërinë tonë.

Atëherë u ngrit Fundoja. Aty pashë aftësitë e tij, pjekurinë politike, retorikën e tij bindëse. Ai foli gjatë për lëvizjen komuniste në Shqipëri, përmendi shokët e burgjeve dhe të torturave, përmendi Lëvizjen e Fierit, ku shumica ishin komunistë. Pastaj foli për Luftën e Spanjës, ku shkonin bij të shquar nga gjithë bota dhe ku luhej fati i demokracisë.

- Sa për të vrarë Krosin ose Musa Jukën, që të shkoni e t'i zëvendësoni ju, pse nuk ngarkoni shokët tuaj në Shqipëri ta bëjnë këtë punë? Ju e dini që ne jemi kundër terrorit. Ne luftojmë sistemin.

Ia preu Ali Këlcyra:

- More zotni Fundo! Ti je i gojës dhe shumë i zoti. Po pse nuk shkon edhe ti në Spanjë, siç kanë shkuar gjithë krerët e komunizmit të botës?

Fundoja ishte i aftë dhe hazërxhevap:

- Unë nuk marr urdhra nga Roma, as nga Beogradi dhe Athina, siç merrni ju. Ju të gjithë e dini se komunizmi ka një disiplinë dhe nuk pyet reaksionin se kë duhet të dërgojë në Spanjë.

Mbledhja u kthye në një gjurulldi ku rriheshin mendime të kundërta me ato që thashë unë për situatën në Shqipëri dhe për fjalët që lëshoi Ali Këlcyra. As Ali Kelmendi e asnjë nga shokët nuk foli, përveç Fundos, që u përgjigjej të gjithëve me radhë.

Pyetje: - Më fal, po dua të të pyes: Si e kuptove këtë punë të Fundos?

Përgjigje: - Pas disa vjetësh, domethënë kur Fundoja u quajt trockist, e kuptova se ku e kishte pasur qëllimin: U thoshte atyre nacionalistëve se, kur në Shqipëri po përhapej komunizmi, ata ç'bënin aty në Paris? Pse nuk punonin edhe ata për idetë e tyre nacionaliste, po rrinin

gjithë ditën duke luajtur kumar? I porosiste të kishin mendjen, se do të merrnin fund, po qe se triumfonte komunizmi në Shqipëri. (Pas shumë vjetësh mora vesh se ai e paskësh piketuar platformën e Ballit Kombëtar.)

Pyetje: - Po me Halim Xhelon a u takove?

Përgjigje: - Halimin nuk e njihja personalisht, por ai më njihte dhe më shkruante. Letra e fundit e tij ka qenë e verës së vitit 1936. Ma dorëzoi Viti Shahini, një shoqe që studionte në Francë dhe që ishte korriere e Halimit. Me Vitin më dërgoi dhe komunikatat e bashkimit të të gjitha forcave demokratike antizogiste, si dhe një letër të dytë, ku më këshillonte që të mos qëndroja "as në Korçë e as në Tiranë, se aty ka shumë shokë, po ti duhet me çdo kusht të krijosh mundësinë të kthehesh në Himarë, i dashur Arap, se në Himarë, kemi nevojë për ty." Ai më quante Arap...

Një pasdreke erdhi një shok (jo shqiptar) dhe më tha se më kërkonte shoku Robert, në *"Rue Combat"*, nr. 8. Vajta dhe u takova me Robertin. Më pyeti se cilët shokë gëzonin simpati në Shqipëri, nga ata që njihja unë vetë ose që i kisha dëgjuar dhe që nuk i kisha njohur (sidomos ata që ishin jashtë shtetit). Unë i fola dhe ai më tha:

- Shkruaji, - dhe më dha një letër. I shkrova. Nga ata që ishin në Shqipëri: Tajar Zavalani, Demir Godelli, Mustafa Gjinishi, Hasan Reçi (në Tiranë); Stefo Grabocka, Dhimitër Fallo, Miha Lako, Koçi Xoxe (në Korçë); Dr. Omer Nishani, Halim Xhelo, Sejfulla Malëshova, Llazar Fundo... (nga ata që ishin jashtë shtetit). Pastaj shënova dhe Asim Vokshin, Bedri Pejanin, Zef Malën...

Roberti më pyeti se cili ishte më aktiv në Shqipëri, dhe unë i thashë për Tajarin (që shkruante e përkthente literaturë revolucionare).

Pastaj ai më pyeti për shokët që kishin vajtur në Spanjë. Unë i fola mirë për Asim Vokshin, për Emrush Myftarin (që i njihja mirë), për Skënder Luarasin (që

nuk ishte komunist, po patriot demokrat). Të tjerët, që kishin vajtur para meje (dhe që ai i kishte në listë), si Ramiz Varvaricën, Urfi Agollin, Zef Hotin, Justina Shkupin, Ymer Pukën, Zef Prelën, Shaban Bashën, Veli Dedën, Hulusi Spahiun, Bim Kuranin, Dhimitër Kostën, Kostë Kolombon, Teni Konomin, nuk i njihja.

Më pyeti për Ali Kelmendin. I thashë se me të më kishte njohur Bedri Pejani, me të cilin rrinte në kafe "Kursal" në Tiranë. Më pyeti nëse dija diçka për veprimtarinë e Aliut në Shqipëri. I thashë se nuk dija asgjë. Pastaj më dha disa porosi: si të interesohesha për punën e shokëve shqiptarë në Spanjë dhe si të njoftoja partinë për gjithçka dija për ta. Më në fund më dha dhe një zarf të vogël, e hapa dhe gjeta një letër nga Halim Xheloja, i cili pak a shumë më shkruante: *"Nuk të them më i dashuri Arap, i shtrenjti Petro. Të qoftë udha mbarë dhe mos harro se jemi shqiptarë dhe, kudo që të jemi, ta mbajmë lart emrin e Shqipërisë dhe të historisë sonë. Kushedi nëse do të shihemi ndonjëherë. Mbaje lart kokën, se je revolucionar, dhe, në mos u pafshim më, kudo që të jesh, të kesh lidhje me shokun tonë Llano Borshi, i cili është shok me vlera. Është nga krahina jonë..."* Kur e mbarova së lexuari, e pyeta se si ishte Halimi dhe ku ishte. Dhe ai më tha se ishte në Belgjikë e andej mund të shkonte në Moskë për t'u shëruar. Më foli mirë për Halimin, më tha se Halimi kërkonte të shërohej sa më shpejt, që të shkonte edhe ai në Spanjë.

Aty folëm dhe për vrasjen e Riza Cerovës, për luftën dhe rrugën e tij revolucionare. Kartëpostalen që kishte botuar "Ndihma e kuqe Internacionale", ma tregoi, por unë e kisha parë.

Pyetje: - Si i kalove ato pak ditë që ndenje në Paris, duke pritur nisjen për në Spanjë?

Përgjigje: - Me densitet ngjarjesh, njohjesh, shëtitjesh, vizitash. Me Ali Kelmendin vajtëm në "Ekspo-

zitën Ndërkombëtare," vizituam pavionin e varfër të "Mbretërisë Shqiptare" dhe Aliu më fliste për varfërinë e vendit tonë. Shkuam në ekspozitën e Bashkimit Sovjetik. Aty pamë dhe dy filma: "Çapajev" dhe "Bijtë e Maksimit"; kurse me Fundon pashë dy filma të tjerë; "Koracata Kronshtad" dhe "Të trembëdhjetët". Me Fundon hipëm dhe në "*Tours d'Eifel*", nga ku dukej gjithë Parisi. Aliu më porosiste që ne shqiptarët në Spanjë të tregonim shpirtin luftarak dhe revolucionar të popullit tonë. M'u lut që të përktheja shqip disa këngë revolucionare si "Këngën e partizanëve sovjetikë" ("Prej urisë e prej mjerimit"), të cilën e përktheva brenda një nate dhe të nesërmen ia dhashë. Më përqafoi fort.

Pyetje: - Më fal, po a të ndodhi ndonjë aventurë?

Përgjigje: - Jo! Në hotel "*Bellville*", ku flija unë dhe, siç duket, gjithë ata që po grumbulloheshin për t'u nisur për në Spanjë, njoha bijën e pronarit të hotelit, që ishte komunist. Ajo ishte shumë e bukur dhe sillej mirë me të gjithë ne. Po një leshverdhë, që banonte në katin ku banoja unë, kurdoherë më shikonte dhe e shikoja me dëshirën për ta njohur. Vajza e të zotit të hotelit më bënte me shenjë: "E shikon? Ajo ka simpati për ty!" Po atmosfera jonë ishte kundër njohjeve të tilla. Madje edhe Roberti më porositi, qoftë këtu, qoftë në Spanjë, sa më pak intimitet me vajzat.

Ajo leshverdha më përshëndeste sikur të më njihte, unë e përshëndetja i frenuar, i censuruar. Ama një gjë dua të shtoj: të gjithë ata klientë që flinin në hotel "*Bellville*", shiheshin për herë të parë, por silleshin sikur të ishin njohur prej vitesh. Flisnin bullgarisht, serbisht, greqisht, rumanisht, gjermanisht, çekisht, por kurrë nuk hynin lehtë në bisedë.

Pyetje: - Si është e mundur që i mbani mend këto pas tërë atyre viteve që kanë kaluar, dhe pas gjithë atyre ndryshimeve që janë bërë në planet dhe në jetën tuaj?

Përgjigje: - Mbahen mend ato ngjarje, ato emocione, ato vizione, ato fytyra, ata tinguj, ato panorama, ato skena të rrugës së jetës sate që të shoqërojnë në çastet më të vështira, më dramatike, më tragjike. Besoj se ata që janë duke lënguar në çastet e fundit të jetës, ose ata që kanë mbaruar së jetuari, jetojnë me çastet që u buzëqeshin, që u thonë. "Ke jetuar dhe ti, ke parë dhe ti, ke dashuruar dhe ti, ke qenë *Njeri!*"

Pra, a mund të harrohen këto çaste? Ja, na thanë: "Po niseni!". Me valixhet në duar, shikonim njëri-tjetrin në sy, më shikonte me lot ndër sy vajza e pronarit të hotelit dhe më tha: "Shkruamë". Më shikonte e gëzuar leshverdha që më fliste gjermanisht. U nisëm. Arritëm në *"Gare de Lyon"*. Njerëz plot. Më shoqëronin Aliu, Fundoja, Loro Brahimi. Ja dhe Roberti. M'u afrua dhe më tha:

- Jeni 113 veta. Je përgjegjës, gjersa të arrini në Spanjë. Aty do të vijë një shok, të cilit sapo të të tregojë një pe të kuq prapa jakës së xhaketës, do t'i japësh raportin e udhëtimit, si u sollën shokët, si qëndruan, me hollësi. Hap sytë! - dhe më puthi si baba.

Aliu më dha një fletore të re dhe më tha:

- Shkruaj vargje revolucionare! Unë e mora dhe shkrova në faqen e parë: *"Viva la muerte!"*. Aliu u zemërua, e shoi dhe shkroi: *"Viva la vida!* "Më kupton? Ti shkon atje të luftosh që të rrojë *Jeta!*" - I dhashë ato para që më kishin mbetur, i dhashë dhe një qeskë lëkure me duhan dhe një llullë.

- Kur ta ndezësh, më kujto, - i thashë. Ai më puthi me sytë e njomur. Më përqafuan dhe Fundoja dhe Loroja. Hipa në vagon. Ishte plot me ato fytyra që shihja në hotel. Ishte dhe shoqja flokëverdhë që fliste gjermanisht. Ajo u ul pranë meje. Vura re se të gjithë më shikonin. Kur kalonin pranë meje, më thoshin "*camarada*", me një shpre-

hje sikur më njihnin prej kohësh. Treni u nis, ne po linim pas Parisin dhe sytë e Aliut, të Fundos, të Loros dhe të të gjithë atyre të tjerëve që përcollën gjithë këta shokë, që tani rrinin të heshtur e të menduar. Unë nuk guxoja t'i ktheja sytë nga shoqja që kisha pranë. Ajo më foli e para, me një frëngjishte më të keqe se timen. Siç dukej, ajo dëgjoi Aliun e Fundon të më flisnin kur po ndaheshim në *"Gare de Lyon"*, dhe nuk e kuptonte dot se ç'gjuhë kishim folur, prandaj me një edukatë të jashtëzakonshme dhe me një vështrim të jashtëzakonshëm më pyeti se cila ishte gjuha e nënës sime. E pashë në sy, i buzëqesha dhe i thashë se do t'ia thosha të nesërmen ose të pasnesërmen. Ajo qeshi. E kuptoi.

Shënim: Nuk harrohet atmosfera entuziaste e nisjes. Nuk harrohen këngët dhe shprehjet e fytyrës të turmës që na përcolli nga *"Gare de Lyoni"*. Parulla kudo: *Rroftë Fronti popullor! Rroftë Republika Spanjolle! Vdekje Fashizmit! Vdekje Frankos, Musolinit dhe Hitlerit! Rroftë solidariteti ndërkombëtar i punonjësve të botës! Rrofshin bijtë e proletariatit që shkojnë në FRONTIN E LIRISË!* Aty pashë botën e vërtetë që ëndërroja. Dhe fillova të shkruaja vargjet e para: *"Ka në botë njerëz të mirë/Ka në botë njerëz të lirë! /Ka në botë një hapësirë,/ Pa gjerdhe, pa errësirë!"*

Zbritëm në një qytet që quhet Karkasone. Zbritëm dhe pamë aty shumë njerëz që na prisnin. Tani, të gjithë ne që zbritëm, mund të kishim besim te njëri-tjetri, se të gjithë e kishim kuptuar se kishim të njëjtën rrugë. Aty na pritën disa shokë francezë. Njëri prej tyre m'u drejtua mua dhe më tha se, para se të errej, ishte mirë të bënim një vizitë në kalanë e qytetit. Njëri pas tjetrit po i ngjiteshim kodrës mbi të cilën ishte kalaja e vjetër. Shokët

francezë që na shoqëronin, na flisnin për kalanë, për historinë e Francës dhe të Revolucionit. Nga kalaja shtrihej një panoramë e bukur dhe gjithë qyteti i Karkasones. Austriakja nuk më ndahej. Zbritëm dhe hipëm në disa autobusë të rinj. Shumë kalamaj ishin grumbulluar aty dhe këndonin këngët e Komunës së Parisit. Ata bërtitnin: *"Camarades gagnez la guerre!"*, *"Camarades, battez Franco!"*, *"Vive les brigades internacionales!*[1]*"* Ishim shumë të prekur nga këto thirrje dhe nga këngët revolucionare. Autobusët na shpunë në një fshat. Zbritëm dhe aty na pritën shumë shokë. Më thanë se do të ndaheshim nëpër shtëpitë e fshatarëve, ku do të kalonim natën. Fshatarët morën nga një e nga dy shokë. Mua nuk më ndahej ajo austriakja. Të dy ne shkuam në shtëpinë e kryetarit të bashkisë, që ishte edhe sekretari i partisë komuniste në fshat: një burrë i trashë, me një fytyrë të pafajshme fëmije, gjithnjë i qeshte nuri. Për habinë time pashë se pllakat e dyshemesë së sallonit të shtëpisë ku hymë, ishin me drapër e çekan. Edhe shoqja ime u habit. Pasi ndenjëm aty nja dy orë, i thashë të zotit të shtëpisë se më duhej të shkoja e të vizitoja shokët, të shihja se si ishin rregulluar. Më dha një djalë të tij, nja pesëmbëdhjetë vjeç. Shkuam derë më derë dhe pashë se të gjithë shokët ishin të kënaqur. Kishin ngrënë e kishin pirë dhe pushonin ose dëgjonin radion. Në një shtëpi pashë një të ri slloven, që ishte në listë me ne, i cili po vallëzonte me të zonjën e shtëpisë, një grua e shëndoshë. Ishte bërë tapë. Nuk dinte ç'thoshte, nuk dinte ç'bënte. I fola:

- Tani shko e pusho, se je lodhur!

Ai nuk mbahej:

- Do të kërcejmë gjithë natën me këtë damë të bukur!

Kur u ktheva, gjeta tryezën të shtruar. Më prisnin. I zoti i shtëpisë dukej shumë i gëzuar. Dhe më tha:

---

1) Shokë fitoni luftën! Shokë mundni Frankon! Rrofshin brigadat internacionaliste!

- *Mon petit*, do të pish një verë? Vetëm unë dhe Stalini pimë nga kjo.

Thashë me vete: "Edhe ky qenka bërë tapë", - se ajo krahinë e Francës së Pirenejve ishte burimi i verërave më të mira. Pashë pesë shishe në tryezë.

- Shikoji mirë, - më tha i zoti i shtëpisë.

Në etiketë ishte Stalini dhe vetë i zoti i shtëpisë. Çdo 21 dhjetor i dërgonte Stalinit 50 shishe, dhe ai e falënderonte. U ngrit, shkoi dhe më solli dosjen me telegramet e Stalinit.

Çdo hap që bëja, gjëra të reja të botës së lirë zbuloja. Të them të drejtën, mund të kisha zbuluar edhe më shumë, po të mos më ndiqnin në çdo çast sytë e austriakes, që më në fund ma tha emrin e saj të vërtetë: Greta, po kishte dhe emrin e luftës që po niste tani: "Sharlotë". Ata dy shokët e saj austriakë, që ishin në listë me ne, e thërrisnin Lote! Unë ende nuk e kisha thirrur kurrë me emrin e saj.

Pyetje: - Si është e mundur që gjithë fshati pranoi vullnetarë të lirisë? Nuk kishin frikë nga qeveria franceze?

Përgjigje: - Me sa dukej, gjithë populli francez ishte pro luftës që bënte populli spanjoll, se edhe në Francë, edhe në Spanjë ishin në fuqi frontet popullore. Unë e vija re, qysh nga "*Gare de Lyon*" në Paris se dhe policët na ndihmonin të futeshim në tren e në vagon. Dhe në Karkasone edhe policët thërrisnin "Rroftë Republika Spanjolle!"

Udhëtimi për të shkuar në Spanjë ishte organizuar nga Kominterni, i cili kishte ngarkuar Partinë Komuniste Franceze. Kjo kishte dy rrugë: detin dhe Pirenejtë. Po, pasi rruga me det kohët e fundit ishte e vështirë, se aeroplanët dhe nëndetëset fashiste i mbytnin vaporët që transportonin vullnetarë për në Republikën Spanjolle, siç ngjau dhe me vaporin ku udhëtonte Asim Vokshi e Teni Konomi që u mbyt, kishte zgjedhur Pirenejtë dhe kishte mobilizuar të gjitha forcat revolucionare që ta

kryenin këtë detyrë me saktësi dhe siguri. Prandaj tani shumica e vullnetarëve kalonin malet e Pirenejve. Po qeveria e Daladiesë, socialist, kishte mbyllur edhe rrugën e Pirenejve për ndihmat që i shkonin Republikës, sidomos ato që vinin nga Bashkimi Sovjetik me trena. Madje Daladieja bëri dhe një krim të madh kundër Republikës Spanjolle: për një çast tha se rruga e Irunit për në Spanjë ishte e lirë. Dhe një karvan vagonësh plot me armë që vinin nga Bashkimi Sovjetik, u la ta kalonte kufirin francez enkas, se qeveria frënge e dinte që atë ditë Iruni do të binte në duart e fashistëve, kështu që armët për republikën i morën këta. Kjo që ndodhi, ndezi një fushatë kundër politikës së Daladiesë, që sabotonte Luftën e Spanjës në Frontin Popullor...

Shënim: Pas shumë vjetësh, aty nga viti 1960, kur erdhi në Shqipëri Torezi, sekretari i Partisë Franceze, me të cilin u takova në Pogradec, mora vesh se ai vetë ishte ngarkuar nga Kominterni si përgjegjës i transportimit të materialeve luftarake nga Bashkimi Sovjetik për në Spanjë, që niseshin nga Murmansku me një brigadë trimash marinarë francezë që transportonin materialet me aftësitë e tyre të jashtëzakonshme.

Megjithatë vullnetarët nuk shkonin ashtu lirisht, por me kujdes, nëpër fshatra dhe shtigje të sigurta. Ne u nisën drejt jugut po me ata autobusë dhe ndaluam në mes të një fushe të vogël plot me pemë. Na futën në një hangar të madh, që dukej se do të ishte i ndonjë fermeri, se shërbente për të grumbulluar të lashtat dhe gjithë prodhimet e tokës. Në hangar na pritën disa fshatarë dhe na përqafuan me radhë. Na dhanë për të ngrënë, na thanë të pushonim, se natën do të kapërcenim Pirenejtë. Kur u err, na dhanë disa opinga prej konopi, si edhe nga një kilogram çokollatë, dhe u nisëm, njëri pas tjetrit. Në

krye ishte një fshatar nga ato anë, që i njihte mirë shtigjet nga do të kalonim, që të mos na shihnin rojat e kufirit francez. Porosia: të mos bisedonim, të mos ndiznim cigare. Pas meje ishte Lotja. Ecnim në monopate të vështira, diku lëndina moçalore, diku pyje të dendura. Ecnim pa zë, të ngarkuar me mendime. Ku shkonim? Ç'kishim lënë pas? Nganjëherë ndalonte *battistrada* (udhërrëfyesi), ndalej dhe kolona. Hanim nga një copë çokollatë. Natë. Pas nesh, në largësi nate, dukeshin mijëra drita të Francës. Ecnim. Ecnim të shoqëruar nga monologët e heshtur. Agimi po fekste. Nisi të dukej konturi i maleve të Pirenejve. Po zbardhte. Ne vazhdonim të ecnim. Tani mund të këndonim, mund të flisnim, se kishim kaluar kufirin. Rreth nesh: male dhe lëndina si moçale. Shtigje të rrahura ndoshta nga kontrabandistët, nga barinjtë.

Ecnim. Të ndërgjegjshëm për drejtimin që kishim marrë.

Kur dolëm majë një bregu të zhveshur fare dhe dëgjuam udhërrëfyesin: "JA SPANJA!" - shpërtheu një urra e fuqishme dhe pastaj përqafime me njëri-tjetrin. "NO PASARAN!"

HAPËSIRA INTERNACIONALE. LUFTA E SPANJËS

NJOHJA, ATMOSFERA, TAKIMI ME SHOKËT E MI

Pyetje: - A mban mend çastet e para të takimit me spanjollët?

Përgjigje: - Po. Ne kënduam këngë internacionale në shumë gjuhë. Dhe nisëm të zbrisnim anës tjetër të Pirenejve. Arritëm në fshatin Septcases, ku na priste një turmë e madhe fshatarësh që këndonin, sidomos nxënësit e shkollës. Fshati ishte i vogël, plot ujëra të pastra. Aty, pranë shkollës, u mbajtën fjalime. Kishin shtruar për të ngrënë e për të pirë verë me bollëk. Aty pashë se të gjithë pinin me karar, kurse ai studenti sllloven, që ishte bërë tapë në fshatin francez, edhe këtu piu aq shumë, sa mezi mbahej më këmbë.

Hipëm në makina të zbuluara dhe u nisëm drejt jugut. Shikonin fushave dhe arave fshatarë katalanas që punonin tokën. Na përshëndetnin duke tundur shami të kuqe. Ne këndonim gjersa arritëm në Figueras. Na shpunë në një kështjellë që ishte kthyer në kazermë, ku qëndronin ditët e para vullnetarët që zbritnin nga Pirenejtë. Ishim të lodhur dhe shumica ranë për të pushuar. Aty kishte dhe shumë shoqe spanjolle që na

shërbenin. Lajmet e radios përhapeshin me altoparlant; pas lajmeve vazhdonin këngët revolucionare. Me Loten dhe disa shokë dolëm për të shëtitur. Jeta vazhdonte e qetë, sikur të mos ishte luftë. Fluturonin në qiell aeroplanë dhe ne nuk dinim se të kujt ishin. Banorët e Figuerasit na përshëndetnin me dashuri. Dikush na afrohej e na dhuronte mollë; dikush na dhuronte edhe ndonjë shishe me verë. Disa fëmijë na dhanë lule. Ishin mësuar ata dhe e dinin se kush ishim ne: *"Volontarios de la libertad!"*. Disa thërrisnin: *"Viva los Internacionales!"*

Në darkë ramë shpejt për të fjetur. Më ngritën nga gjumi. Ishin dy shokë të sigurimit. Më thanë të shkoja me ta. Hipëm në një makinë të vogël dhe, pasi bëmë një copë rrugë, u ndalëm në një banesë në periferi. Kur hyra në zyrë, pashë shumë milicë dhe oficerë. Më dhanë dorën dhe më thanë t'i ndjeja që më shqetësuan në mes të natës:

- Çështje sigurimi, - më tha njëri, që rrinte pas një tryeze. Më tha të ulesha, pastaj nxori nga një dosje një letër dhe ma dha duke më thënë ta përktheja ja italisht, ja frëngjisht. "Letra të dyshimta", - më tha.

Ma habiti fakti nga e dinin ata që unë flisja greqisht, se letra ishte shkruar greqisht, në një copë letër të vogël, me laps.

Ai e kuptoi dhe më tha:

- Ne shqyrtuam gjithë dokumentet e shokëve që erdhën dje, dhe pamë se ju dini greqisht. (M'u kujtua se në formularin që mbushëm, kishte dhe një rubrikë: sa gjuhë dini!)

Pas pak e përktheva letrën. Dikush i shkruante një tjetri: "Duam kaq kuintalë patate, kaq kuintalë fasule," - e të tjera. Kur i lexoi, ai që fliste me mua, më tha:

- Këto nuk janë as patate e as fasule, por armë. Këtu ka shumë të Kolonës së Pestë që janë lidhur me reaksionin ndërkombëtar. Po ne do t'i shuajmë, do t'i shpartallojmë pa mëshirë.

Më prunë një kafe të nxehtë, pastaj ai shoku që fliste, më përcolli gjer jashtë dhe më tha:

- Mos kujtoni se këtu janë të gjithë me ne. Kini mendjen, se më të rrezikshmit janë të kamufluarit, janë agjentë të të gjitha kallëpeve. Revolucioni ynë ka shumë armiq të fuqishëm, por ne do t'i zhdukim!

Më çuan përsëri në kështjellë. Gjumi nuk më zuri gjersa u gdhi dhe u zgjuan shokët. Ata ishin të gëzuar. Këndonin. Unë mendoja: "Si?! Edhe këtu paska armiq?! Luftë, luftë e fshehtë dhe e hapur."

U nisëm për në Barcelonë.

Nuk përshkruhet dot pritja që na bënë në Barcelonë! Mijëra njerëz ishin grumbulluar me flamuj të kuq, me parulla, me lule. Thërritnin *"Viva los Internacionales! NO PASARAN! VINCEREMOS!"* Shumë vajza të reja u sulën drejt nesh, na përqafonin, na puthnin duke na folur me gjuhën e zemrës së tyre. Për pak çaste u bëmë një me turmën dhe ecnim duke kënduar këngë revolucionare. Arritëm në kazermën e madhe "Karl Marks". Atje na pritën me pije, me ëmbëlsira, me meze dhe këngët nuk kishin të sosur. Jetonim çaste shumë emocionante dhe nuk nxirrnim dot asnjë fjalë nga goja, se gjaku na ishte ndezur dhe sytë nuk shihnin tjetër gjë përveç fytyrave të dashura të katalanëve që shprehnin mirënjohjen dhe dashurinë e tyre për ne internacionalistët.

Pyetje: - A mban mend ndonjë ngjarje të veçantë nga Barcelona?

Përgjigje: - Të them të drejtën asgjë konkrete, përveç vizionit të pritjes së zjarrtë, të turmës në delir dhe të vashave që na rrethuan me dashuri, që na dhuruan lule dhe na kapën për krahu. Lotja kurdoherë ishte pranë meje. Ajo, mbaj mend, shoqërohej nga dy shoqe ezmere, që në çdo çast e puthnin.

Të nesërmen mua më thirri një shok. Më dha dorën. Më foli frëngjisht dhe më tregoi jakën e ngritur. Unë po e

vështroja dhe e mora si çdo njeri nga turma e madhe që na afrohej dhe na pushtonte me dashuri. Ai përsëri ngriti jakën e xhaketës dhe, pasi e pa që unë nuk e vija re, më tha: "Shihe këtë perin e kuq!". E pashë perin e kuq dhe m'u kujtua porosia që më dha Roberti në Paris. Oh, sa larg ishte Roberti dhe Parisi, sa larg ishte hotel "*Belleville*" dhe Tirana, dhe fshati im. S'ishte në gjendje mendja të binte në qetësi dhe të kujtonte... "Po, - i thashë, - do të bisedojmë!"

Më hodhi krahun. Shkuam dhe u ulëm në një tryezë të kafenesë. Më pyeti se si e kaluam udhëtimin dhe a kishim pasur ndonjë pengesë a ndonjë ndodhi. U mendova ca dhe nxora nga xhepi një bllok të vogël ku shënoja me kujdes ditët dhe ndodhitë. Pas një heshtjeje, i thashë se vetëm një shok slloven, student në medicinë, me emrin... ishte dehur tri herë... Ai ndenji ca, pastaj thirri aty atë studentin slloven dhe i foli shumë ashpër. Ai i thoshte se kishte kaluar me vështirësi kufijtë e Austrisë, Zvicrës, Francës, Spanjës, për të ardhur gjer këtu dhe po e kthenin përsëri. Megjithatë, e ktheu, duke i thënë se Spanja nuk kishte nevojë për pijanecë. Ishte i rreptë shoku jugosllav që kontrollonte vullnetarët.

Shënim: Më vonë u diskutua se ai shok mund të kishte qenë vetë Jofif Broz Titoja.

NË ALBACETE, QENDRA E BRIGADAVE INTERNACIONALE

Para se të më pyesni përsëri, dua të kridhem për disa çaste në pjesën e kujtimeve të udhëtimit nga Valencia për në Albacete. Kujtoj atë pritje të ngrohtë, ato vasha që na shërbenin në stacione, në salla të përgatitura, në rrugë. Gra me të zeza, dhe pastaj alarmi! Vinin aeroplanët dhe bombardonin, mitralonin. Dhe trenin tonë e mitraluan pranë Valencias. Nuk pësuam asnjë humbje.

Këndonim edhe ne bashkë me popullin që na priste dhe na përcillte. Një gjë vura re: përreth asnjë i ri për be. Të gjithë ishin në luftë. Dhe, siç mora vesh më vonë, ishte turp dhe fyerje për të gjithë, po të shihej ndonjë i ri në rrugë, në kafe, në kinema, shëtitje. Asnjë vajzë nuk denjonte të shoqëronte ndonjë të ri që mbetej në prapavija.

Dhe, para se të arrija në Albacete, nxora fletoren që më kishte dhuruar Ali Kelmendi aty në *"Gare de Lyon"*, në Paris! Kisha shkruar shumë vjersha, midis tyre një për Loten, e cila qeshi shumë, kur ia lexova, dhe më puthi. Aty në fletore shënova emrat e shokëve shqiptarë që ishin nisur për në Spanjë:

1. Teni Konomi, mbytur para se të arrinte në bregun e Spanjës.
2. Asim Vokshi Ai ishte në vaporin që u mbyt.
3. Ramiz Varvarica
4. Zef Hoti, vrarë në Madrid
5. Urfi Agolli, vrarë në Madrid
6. Dhimitër Kosta
7. Ymer Puka
8. Justina Shkupi
9. Skënder Luarasi
10. Emrush Myftari
11. Shaban Basha
12. Xhemal Kada
13. Ulusi Spahiu
14. Mane Nishova
15. Veli Deda
16. Stefan Duni
17. Bim Kurani
18. Kostë Kolombo
19. Daut Muço
20. Zef Prela
21. Xhafer Miraku
22. Iljaz Pashai
23. Faik Dardha

Më vonë erdhën:
24. Mehmet Shehu
25. Thimo Gogozoto
26. Musa Fratari
27. Zihni Muço

Në Albacete na shpunë drejt e në kazermën e madhe, nga do të shpërndaheshim për në brigadat përkatëse.

Qyteti ishte plot me internacionalistë. Altoparlantët oshëtinin nga këngët revolucionare dhe komunikatat e frontit. Mua bashkë me dhjetë italianë na dërguan në *Kuintanar de la Republica*, një fshat i madh, që ishte caktuar për brigadën "Garibaldi." Loten e caktuan për te brigada "Telman". U ndamë duke u përqafuar pa thënë asnjë fjalë.

Pyetje: Në Kuintanar, a gjete shokë?

Përgjigje: - Asnjë shqiptar. Ishin të gjithë vullnetarë italia-në. Pas dy ditësh erdhën aty Skënder Luarasi, Asim Vokshi dhe Emrush Myftari.

Të them të drejtën, e ndjeva veten të lumtur: erdhën shokët e mi të dashur: Asimi, Emrushi, Skënderi. Ishin të gëzuar, të veshur si milicianë, me yllin me tre cepa, yllin e solidaritetit internacional. Qenë optimistë, të qeshur, të lumtur. Ndenja me ta disa orë. Deshën lajme nga atdheu, pyetën për shokët në Tiranë, për shokët në Paris. U hodh Emrushi dhe tha:

- Tani do ta botojmë shqip "Vullnetarin e lirisë". - Ishte entuziast Emrushi. Asimi do të nisej natën për në frontin e Aragonës. Ai ishte veshur shumë thjeshtë, me disa rroba ushtarake shumë të përdorura, me këpucë të përdorura. Më rrinte pranë dhe nuk fliste shumë, si kurdoherë. Duke ndenjur me Asimin, kujtoja gjithë rrugën e njohjes sonë që nga viti 1932, kur na njohu Demir Godelli dhe Bedri Pejani (në Tiranë). Pastaj në Dropull (1933-1934), kur ai ishte toger i xhandarmërisë... si na porosiste mua, Zenel Hekalin dhe Zylyftar

Veleshnjën (Zeneli, profesor në Gjirokastër; Zylyftari, postëkomandant i xhandarmërisë në Sofratikë), si e kthyem Zylyftarin me ne, si më udhëzoi të arratisesha për në Greqi dhe pastaj si u ktheva, si botuam "ABC-në" si u internuam... Të gjitha më parakalonin sikur t'i jetoja në ato çaste, aty në Kuintanar, ku gjëmonte kënga e garibaldinëve italianë. U ndamë për t'u takuar sa më shpejt, veçse me Asimin nuk u pashë më. Ai iku për në frontin e Aragonës, ku ra në fshatin Fuente del Ebro, më 4 tetor të vitit 1937.

Në Kuintanar zura shumë shokë italianë, antifashistë të vjetër, komunistë të vjetër, punëtorë. Shumica kishin qenë nëpër burgje dhe internime. Disa kishin ardhur nga Amerika dhe nga Argjentina. Stërviteshim. Duhej të stërviteshim, pastaj, po të ishim të aftë fizikisht dhe ushtarakisht, do të inkuadroheshim në front, në brigadën e 12-të "Garibaldi."

Pyetje: - Kë njohe në Albacete?

Përgjigje: Në Albacete shkoja shpesh. Aty takohesha me Skënder Luarasin, Ymer Pukën, Justina Shkupin, Zef Prelën, Emrush Myftarin... Aty njoha dhe Dhimitër Kostën dhe Kostë Kolombon...

Ditët e para takohesha më shpesh me qendrën e brigadës "Garibaldi." Aty njoha Luixhi Longon, komisarin e brigadave internacionale. Ai më priti ngrohtë dhe bashkë me Pavaninin, sekretar partie i brigadës "Garibaldi", më ngarkuan të bëja një relacion për të gjithë vullnetarët shqiptarë dhe për shokët e Komitetit të Çlirimit Nacional në Paris. Unë u ktheva në Kuintanar dhe atje punova disa ditë. U ktheva me relacionin, që ishte pak a shumë ky:

Asim Vokshi, revolucionar që në rini. Një nga shokët më të rëndësishëm nga oficerët. Aktivist i madh për përhapjen e ideve komuniste. Familje patriotësh. Pjesëmarrës në Lëvizjen e Fierit. Një nga shokët kryesorë për botimin e revistës "ABC". Internuar dhe burgosur.

Emrush Myftari, shok i Asim Vokshit. I gjallë, trim, komunist, shok i gjithë grupit komunist të oficerëve. (Ai u bë shkak që botuam "Vullnetarin e lirisë" në gjuhën tonë, se ai shkoi vetë tek Luixhi Longo dhe i propozoi për botimin shqip të revistës, e cila botohej në gjuhët kryesore të botës: rusisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht. Longoja i tha se ishte e pamundur, pasi shumë kombësi të tjera, si grekë, bullgarë, turq, rumunë, që ishin më shumë se shqiptarët, nuk kishin mundësi ta botonin, po Emrushi këmbënguli aq shumë, sa Longoja e përgëzoi dhe na dha lejen ta botonim, duke na e dhënë ai kryeartikullin.)

Skënder Luarasi, patriot, demokrat, antifashit, njeriu më i kulturuar nga të gjithë vullnetarët shqiptarë. Ai u njoh shpejt nga shokët intelektualë të brigadave internacionale. U vu në shërbim të propagandës, në censurë dhe në shpërndarjen e librave në brigada. Në Shqipëri njihej si një nga profesorët (profesori im në Shkollën Tregtare në Vlorë) më aktivë në propagandën kundër shtypjes dhe errësirës. Ishte i persekutuar. Ai nuk erdhi në Spanjë i rekomanduar nga Komiteti i Çlirimit Nacional. Erdhi vetë.

Ramiz Varvarica, patriot dhe antifeudal. Komunist dhe besnik. Kishte marrë pjesë me qeverinë e Fan Nolit, në xhandarmëri. Pas kthimit të mbretit Zog, më 1924, ai emigroi dhe në Francë ishte në Partinë Komuniste qysh më 1926. Ishte nga të parët shqiptarë që erdhi në Spanjë.

Zef Hoti, malësor nga Veriu i Shqipërisë. Rritur jetim dhe shumë i varfër. Emigroi në Francë në fund të vitit 1920 dhe aderoi në Partinë Komuniste Franceze. Njeri me karakter.

Urfi Agolli, një i ri që ishte shumë i gjallë dhe me shu-më peripeci. Qe për ca kohë student në Akademinë e Modenës, si ushtarak. U përjashtua. Në Shqipëri u persekutua. Nga Franca, me rekomandimin e Komitetit të Çlirimit Nacional, erdhi në Spanjë.

Stefan Duni, fshatar nga Himara. Emigroi për në Francë, ku aderoi në Partinë Komuniste Franceze. Qe nga të parët që erdhi në Spanjë bashkë me shokë francezë.

Ymer Puka, njeri me shumë peripeci dhe me shumë veprimtari. Sipas Fundos, ishte i lidhur me Kominternin, kurse sipas Aliut, ishte aventurier. Ymer Puka arriti gradën e majorit. Ishte shumë i dashur me ne. Na tregonte episode nga jeta e tij. Ai shoqërohej shumë me gjeneralin Gëstençiç, një sllloven që kishte shoqëruar Leninin nga Zvicra, me trenin e blinduar, për në Leningrad. Gëstençiçi shkroi dhe një artikull në revistën tonë "Vullnetari i lirisë" (nr. 1) për Ymerin, me pseudonim Demir Kuka. Ai ishte shefi i sigurimit të brigadave internacionale, mik i ngushtë edhe i Skënder Luarasit dhe i Zef Prelës.

Shënim për xha Ymerin: (Ç'kam dëgjuar nga goja e tij.) Sipas fjalëve të Ymerit, ai kishte emigruar qysh i ri për në Turqi. Kur plasi Revolucioni i Tetorit, nga shtetet që intervenuan, ishte edhe Turqia, e cila dërgoi atje një divizion ku ishte dhe Ymer Puka ushtar. Kur shkuan turqit në Rusi si intervencionistë, pësuan disfatë dhe u zunë rob. I shpunë në një vend të Ukrainës, ku u foli vetë Lenini. Pastaj i lanë të ktheheshin në Turqi, të ndihmuar nga Lenini. Kur mbaroi fjalën Lenini, Ymer Puka doli mënjanë dhe i tha se nuk ishte turk, po shqiptar dhe si shqiptar që qe, po i jepte besën se do të ishte gjithë jetën besnik i tij. E morën mënjanë xha Ymerin, e stërvitën dhe e bënë korrier të Kominternit për vendet arabe dhe veriafrikane. Para se Mustafa Qemali të bënte revolucionin në Turqi, Ymeri u dërgua nga Moska për në Turqi, dhe atje arriti të bëhej adjutant i Mustafa Qemalit, me të cilin mori pjesë aktive në revolucionin turk. Pas fitores së

revolucionit, Mustafa Qemali e mbante pranë, por aty nga fillimi i viteve '30 pati mosmarrëveshje me të, sa i tha se po e tradhtonte revolucionin. U zunë keq dhe Mustafa Qemali e përzuri nga Turqia, po me të drejtën që ai ta merrte rrogën në çdo ambasadë turke në mërgim. Shëtiti shumë vende, erdhi edhe në Shqipëri dhe këtu u internua në Gjirokastër nga Musa Juka. Kur dëgjoi se në Spanjë luftonin të kuqtë, ai u arratis. U hodh në Greqi, që andej në Afrikën e Veriut, ku kishte shumë të njohur. Andej erdhi në Spanjë dhe u inkuadrua në brigadën "Dimitrov", dhe jo te "Garibaldi", ku ishin pothuajse gjithë vullnetarët shqiptarë...

Justina Shkupi, e vetmja femër shqiptare që erdhi në Spanjë, e rekomanduar nga Komiteti i Çlirimit Nacional. Antifashiste, e rritur mes mundimesh, pa njeri. Me karakter dhe fisnike. Besnike.

Bim Kurani, njeri i thjeshtë, librar, i lidhur me shokët e Elbasanit, i rekomanduar nga Komiteti i Çlirimit Nacional.

Xhafer Miraku, pasanik, pak mendjemadh, njihej si njeri me dojçkulturë, po me një vëlla përparimtar antifashist, të lidhur me shokët e Korçës dhe të Elbasanit. Çudi pse erdhi ai në Spanjë.

Kostë Kolombo, me një jetë plot me aventura. I njohur nga të gjithë të vjetrit si njeri i qejfit, i shakasë, i zgjuar.

Hulusi Spahiu, Shaban Basha, Veli Deda, oficerë antifashistë, që ishin njohur për idetë e tyre përparimtare.

Xhemal Kada, shok i Asim Vokshit dhe i Emrush Myftarit, dinamik, i vendosur, besnik. I njohur si shok me ide komuniste.

Dhimitër Kosta, punëtor dhe anëtar i Partisë Komuniste Franceze. Besnik dhe i vendosur. Komunist. I njohur mirë nga Komiteti i Çlirimit Nacional.

Daut Muço, emigrant ekonomik. I njohur për idetë komuniste. Njeri i thjeshtë, besnik.

Zef Prela, shok i Partisë i ardhur nga Praga. I njohur me Halim Xhelon si korrier i Partisë (Kominternit). Besnik dhe i përgatitur mirë politikisht.

Iljaz Pashai, fshatar i varfër që pastaj mësoi profesionin e farmacistit qysh i vogël, në Vlorë. Emigroi në Francë, ku bënte pjesë në Partinë Komuniste Franceze. Besnik dhe me karakter.

Faik Dardha, njeri deri atëherë për ne i panjohur. Kishte qenë sekretar komune dhe ardhja e tij në Spanjë qe me pikëpyetje.

Mehmet Shehu, me ide komuniste qysh në Shqipëri. Pjesëmarrës i Lëvizjes së Fierit. Njeri me karakter. Ushtarak i lindur.

Thimio Gogozoto, shok nga Çamëria. Student në Normalen e Elbasanit. Njeri i vendosur, me ide komuniste.

Musa Fratari, oficer, nga familje patriotike. Me ide komuniste. I vendosur dhe me karakter.

Mane Nishova, shok i mirë. E njoh që nga Shqipëria. Komunist i vendosur. Autodidakt, me dëshirë për të mësuar. I thjeshtë dhe i ndershëm.

Pak a shumë këto shënime i dhashë Pavaninit.

Nga gjithë këta, me sa di unë, anëtarë partie u bënë: Mane Nishova, Mehmet Shehu, kurse Dhimitër Kosta, Ramiz Varvarica, Zef Prela, Stefan Dumi, Zef Hoti, ishin. (Për të tjerët nuk kam dijeni të kenë qenë anëtarë partie. Pavanini, si sekretar i partisë së brigadës, e dinte se asnjë tjetër nuk ishte anëtar i partisë spanjolle.)

Pyetje: - Pasi përmende disa karakteristika të vullnetarëve shqiptarë, a mban mend tjetër gjë nga jeta e tyre në Spanjë, nga veprimtaria e tyre në frontet e ndryshme?

Përgjigje: - Shumë gjëra të qena e të paqena kam dëgjuar. Por unë besoj se në arkivat e brigadave gjenden

patjetër karakteristikat e pjesëtarëve të njësiteve të ndryshme. Në arkivat e brigadës "Garibaldi" gjenden dokumentet për çdo pjesëmarrës në atë brigadë, sidomos për kuadrot. Shumica e shqiptarëve ishin kuadro, oficerë të përgatitur: Hulusi Spahiu, Emrush Myftari, artilierë; Shaban Basha, Xhemal Kada, Veli Dedi, xhenjerë; Ramiz Varvarica, Ymer Puka, Musa Fratari, në këmbësori; Skënder Luarasi, Zef Prela, në propagandë; Justina Shkupi, Bim Kurani, Iljaz Pashai, në shëndetësi...

Pyetje: - Ç'episode të kanë lënë mbresa nga veprimtaria e shokëve në Spanjë?

Përgjigje: - Episodet pozitive janë të shumta. Dua të kujtoj disa prej tyre:

Emrush Myftari ishte në vijën e frontit. U godit një aeroplan sovjetik dhe piloti, që u hodh me parashutë, ra midis dy vijave të frontit e nuk dinte se nga të drejtohej, andej apo këndej (se nga njëra anë dilnin tanët me flamur të kuq dhe i bërtisnin "eja këtej", nga ana tjetër i dilnin fashistët dhe i thërrisnin "eja këtej"). Piloti u drejtua për te fashistët, i plagosur siç ishte. Emrushi doli nga transheja dhe në mes plumbave shkoi e mori pilotin sovjetik në krahë dhe e solli nga ana jonë. Për guximin e tij u përmend gjithnjë.

Xha Ymer Puka, që ishte në një kompani sllavësh të batalionit "Dimitrov", kur pa se të gjithë shokët po zmbrapseshin, rrëmbeu një mitraloz "Maksim" dhe ua drejtoi duke u thirrur: *Jebenti boga*! - kush është me Leninin, përpara, se ju vrava të gjithëve! Të gjithë sulmuan dhe fituan. Xha Ymerin e graduan rreshter. Pastaj, në çdo betejë, ky ishte i fundit që tërhiqej, duke marrë me vete edhe dy të plagosur në krahë, gjersa arriti gradën major.

Në një vijë fronti të qendrës, Hulusi Spahiu, që ishte komandant i një baterie të cilën e kishte pagëzuar bateria "Hasan Reçi", e pa që fronti po lëkundej keq nga presioni fashist. U mendua ca dhe tha: "Po nuk e kaluam këtë

luginë e të hidhemi përtej me baterinë, ne humbëm. Prandaj të gjithë mbi makinat, mbi topat!" Disa kundërshtuan, duke i thënë se ishte marrëzi. Ky, me revolen drejtuar atyre, u bërtiti: "Të gjithë mbi makinat dhe marsh!" Përmes zjarrit të mitralozave dhe të armëve të tjera, e kaluan luginën, vendosën mirë bateritë dhe filluan qitjet direkte kundër forcave fashiste, të cilat, duke u goditur rëndë, nisën të tërhiqeshin të shpartalluara.

Xhemal Kada, qe një nga xhenjerët e shquar, që krijoi ura false mbi Ebro dhe pastaj natën ura lëvizëse mbi varka, nga kaloi fuqia e ushtrisë sonë. Për këtë ai u përgëzua nga shtabi i armatës së gjeneral Rojos.

Dhimitër Kosta, ka qenë i Sigurimit. U caktua si gardian në burgun Karabanselit, pastaj u dërgua në disa fronte për të ndjekur agjentët e Kolonës së Pestë. Në Alikantes zbuloi një rrjet spiunësh që lajmëronin fashistët kur vinin vaporët sovjetikë në liman për të shkarkuar armë, që t'i bombardonin.

Justina Shkupi, shquhej për besnikëri dhe ndërgjegje në punë. Kur po evakuohej një spital i brigadave internacionale nga Murcia në Veri, çdo vagon i mbushur me të plagosur kishte dhe nga një përgjegjës sanitar, mjek ose infermier. Në një vagon ishte përgjegjëse Justina. Treni u bombardua. U pa se të gjithë mjekët dhe infermierët dolën nga treni, duke lënë të plagosurit në vagonë. Vetëm Justina nuk kishte lëvizur, ishte në krye të detyrës. E gjetën duke i bërë transfuzion gjaku një të plagosuri që kishte marrë një plumb tjetër në shpatull. Ka punuar dhe në krah të Dr. Betynit. Në fëmijëri ka qenë shoqe me Gonxhe Bojaxhiun, Nënë Terezën.

Pyetje: - Ç'mund të na thuash për rrugën tënde pas Kuintanar de la Republika?

Përgjigje: - U thirra në shtabin e brigadës "Garibaldi", ku Longoja kërkoi të më mbante si sekretar në vend të Zhorzh Komnenit, që ishte plagosur. Ndenja disa ditë,

pastaj iu luta të më lejonte të shkoja në front. Ai dhe Pavanini më thanë se duhej të botohej "Vullnetari i lirisë", prandaj duhej përgatitur lënda. U takova disa herë me Skënder Luarasin, i cili më njohu me Zef Prelën. Zefi ishte i përshtatshëm për redaktimin e revistës, por ai tha se ishte i zënë me shokët çekë, të cilët nuk e lejonin, se kishin nevojë për të. Iu futëm punës të përgatitnim lëndën bashkë me Skënderin. Morëm lajmin se Asimi ishte vrarë në Fuente del Ebro. U pikëlluam. Shkrova "Elegjinë", që e botova në numrin e parë të "Vullnetarit të lirisë", bashkë me një letër që i drejtohej nënës së Asimit. Longoja shkroi kryeartikullin, që e botuam edhe italisht. Lëndën e bëmë gati. Më thanë që duhej të përktheja vetëm titujt e artikujve, për t'i parë qendra e brigadave. Vura re se, kur ma kthyen lëndën, kishin hequr artikullin e Skënderit që e kishte shkruar për vrasjen nga Zogu të Ismet Totos. U habita.

Shkuam në Madrid me Skënderin, dorëzuam lëndën dhe u kthyem në Albacete. Skënderi më lutej që unë të merresha me propagandën, të flisja në radio. Ai kishte folur disa herë nga Radio-Barcelona. Unë nuk pranoja. Atëherë Longoja më dërgoi në Pozo Rubio, ku ishte një kurs politiko-ushtarak tremujor. Ishte një vend i bukur, me pyje pishe, afër Albacetes. Vija shumë herë në Albacete, ku takohesha me shokët shqiptarë, sidomos me Ymer Pukën, me Justinën, me Emrushin, me Skënderin dhe hanim në "Cerlje merkantil", ku hanin kuadrot e brigadave internacionale.

Dua të shënoj këtu se Skënderi ishte më aktivi; ai qendrën e kishte aty në Albacete, bashkë me Gëstençiçin, dhe ishte në korrent të lëvizjes së shokëve shqiptarë, si dhe të gjendjes në Shqipëri. Ja disa nga ato që thoshte Skënderi dhe që i mbaj mend:

Kur erdhën në Albacete shokët Shaban Basha, Xhemal Kada, Veli Dedi, të tre togerë të xhenjos, flinin

në një pension. Komanda mori vesh se ishin tre shqiptarë të xhenios. Kishte nevojë komanda për xhenierë, sidomos për të ndërtuar strehimet për popullin, prandaj i thirri të tre oficerët shqiptarë. Xhemali dhe Shabani pranuan menjëherë, kurse Veliu, jo. Ai vuri një kusht: t'u jepnin gradën kapiten, pastaj të shërbenin. Ata u habitën me këtë kërkesë të tij. Xhemali dhe Shabani, pa asnjë kusht, shkuan menjëherë, kurse Veliu s'u pa më. Thanë se u bashkua dhe qëndroi me një oficer hungarez.

Në Pozo Rubio njoha shumë shokë italianë, francezë, belgjianë, grekë, jugosllavë, që kishin ardhur nga Bashkimi Sovjetik si vullnetarë. Aty u pranova në parti. I deleguar ishte Nikolasi, një shok i vjetër italian, shok i Gramshit. Shokët ma festuan këtë ngjarje të jetës sime.

Doli revista. Edhe për këtë bëmë një festë të vogël. E paketuam dhe e dërguam në shumë drejtime. Nuk e dërguam në Paris, te Komiteti i Çlirimit Nacional, se kishim dëgjuar që atje kishte ndodhur diçka e keqe: tradhti! E dërguam në Lion, në Sent Etien, në Amerikë, në Greqi dhe italianët morën përsipër që me anën e marinarëve italianë ta futnin dhe në Shqipëri.

Përgatitëm numrin e dytë. Në këtë numër kisha shkruar dhe dy elegji: njërën për Riza Cerovën, tjetrën për Halim Xhelon.

Gjatë kësaj kohe më thirrën në qendrën e brigadës. Më kërkonte Longoja. Shkova në orën e caktuar. Aty ishte dhe Pavanini. Pas përshëndetjeve, Longoja i tha Pavavinit të lexonte një shkresë që kishte ardhur nga Komiteti Çlirimit Nacional - Paris. Pak a shumë shkresa kishte këtë përmbajtje: *Ne nuk e kemi dërguar aty Petro Markon të merret me vjersha, po e kemi dërguar për në front.* Nënshkruante Ali Kelmendi.

U habita dhe më erdhi për të qarë. Ç'ishte kjo shkresë kështu? Longoja më kërkoi t'i thosha se kush ishte ky Ali Kelmendi dhe ç'mendoja unë. Unë e mblodha veten dhe thashë:

- Unë kam ardhur këtu me vullnetin tim dhe nuk më ka dërguar Ali Kelmendi. Ali Kelmendi me shokët e tjerë të Parisit më përcollën. Besoj se Aliu do të jetë zemëruar pse nuk e dërguam revistën atje, po gjetkë. Nuk e kuptoj këtë qëndrim. Ç'të them? Kemi marrë vesh se shokët e Komitetit tonë në Paris janë përçarë, janë cilësuar si tradhtarë, prandaj nuk e dërguam atje revistën. Nuk e di ç'të them.

Longoja u ngrit më këmbë dhe i tha Pavaninit:

- Shkruaji përgjigjen!

Pavavini vuri letrën në makinën e shkrimit, Longoja diktonte këtë përmbajtje:

Seksionit Ballkanik të Kominternit, për grupin shqiptar, Paris.

Po Ju përgjigjemi:

Çdo aksion ose punë që bëjnë këtu brigadat internacionale, të krijuara dhe të drejtuara nga Kominterni, jo vetëm që pranohet nga të gjithë komunistët e botës, po propagandohet dhe përkrahet me të gjitha mjetet. Kështu dhe për revistën "Vullnetari i lirisë", që e botojnë vullnetarët.

Ju, që rrini në Paris duke luajtur ditë e natë kumar, pse nuk vini këtu për të takuar shokët shqiptarë? Këtu kanë ardhur shokë të shkuar në moshë dhe të sëmurë.

Shkresa u dërgua dhe unë u lehtësova.

Shtatë nëntori, përvjetori i krijimit të brigadave internacionale, u kremtua në Albacete. Unë isha në krye të parakalimit me flamurin e kuq. (Pasi në Pozo Rubio unë isha i vetmi shqiptar dhe pasi emri i atdheut tonë nis me shkronjën A - Albania) Parakaluam para Pasionarias, Longos, Andre Martisë e të tjerëve, si Ludvig Reni, Lukashi, Valteri...

Pas parakalimit u takova me shumë shokë: Skënderin, Zefin, Ymer Pukën, Justinën, Emrushin, Ramizin, Xhemalin, Iljazin. Drekuam bashkë dhe kënduam këngë shqiptare.

Para se të mbaronim kursin në Pozo Rubio, erdhën shumë personalitete dhe na folën. Mbaj mend kur na erdhën: Hemingueji dhe Ehremburgu. Isha kureshtar për këto dy figura të njohura dhe u shkoja pas. Pas fjalimeve që mbajtën - i pari foli për luftën e bashkimit dhe të çlirimit të Shteteve të Bashkuara, i dyti për luftën e Napoleonit në Rusi - na dhanë cigare. U shkoja pas. I tha Ehremburgu Heminguejit:

- Shumë i rënduar je me këta hekura në sup e në kurriz! (se Hemingueji ishte ngarkuar me aparate kinematografike, me armë, me dylbi, me bomba, xhironte filma nga fronti dhe i shiste për Republikën .)

- Më shumë më rëndojnë mendimet sesa hekurat! - iu përgjigj Hemingueji.

Unë i kisha parë këta dy shkrimtarë në Konferencën e Shkrimtarëve Antifashistë, që u mbajt në Valencia. Emrushi çfarë nuk bëri që të shkoja edhe unë në atë Konferencë, si shkrimtar shqiptar! Unë thashë që të shkonte Skënderi, se Skënderi ishte njeri me kulturë, kishte shkruar një dramë dhe kishte përkthyer vepra me rëndësi. Emrushi dhe Skënderi ngulën këmbë: "Ti përfaqëson të rinjtë që shkruajnë sot në Shqipëri! Ti duhet të shkosh!"

Mbaj mend se nga Bashkimi Sovjetik ishin Aleksej Tolstoj, Ehremburgu e të tjerë. Nga Gjermania - Ana Segers, Ludvig Reni. Ishin aty Pablo Neruda, Nikolas Guilen, Cezare Valejo, Neksoe, Andre Malro e shumë e shumë shkrimtarë e poetë nga Anglia, Amerika Latine, Evropa. Unë isha si i ftuar dhe dëgjoja zërin e kulturës botërore nga goja e njerëzve më të shquar të letërsisë së këtij shekulli.

Pas diskutimeve, ata recitonin vjersha ose pjesë nga shkrimet e tyre. Natën e tretë, një shoqe nga Kolombia, që më rrinte pranë, më tha të recitoja edhe unë një nga poezitë e mia. Nguli këmbë, gjersa bashkë përkthyem spanjisht prologun e një poeme që kisha nisur "Vetëm

gjashtë". Prologu ishte "Fjala dhe era". E përkthyem dhe ajo njoftoi: "Poeti i ri nga Shqipëria do të recitojë një vjershë të tij." Shkrimtarët dhe të ftuarit nuk rrinin si ne, në kinema ose në teatër, por në frona dhe kolltukë, rreth tryezave, ku hanin dhe pinin. Të gjithë drejtuan sy e veshë nga unë. Dhe unë nisa të recitoja: "Fjala i ngjan erës/ Kjo është e vërtetë!/ Del fjala nga goja e Demostenit!/ Dhe era fryn e mbyt gjemitë në Egje," e të tjera e të tjera... E dëgjuan dhe, kur mbarova, asnjë reagim, asnjë duartrokitje. U turpërova... Dikush tha: "Ne prisnim ndonjë vjershë ku të ndihej fryma e Shqipërisë, këto mund t'i bëjë dhe një neozelandez a norvegjez."

U turpërova. U ula dhe përktheva vjershën popullore "Tatëpjetë bregut vije/ Jelekverdha veshuro." Pasi e përktheva, shoqja nga Kolombia u ngrit dhe tha se unë do të recitoja një vjershë tjetër. Të gjithë e dëgjuan dhe pastaj duartrokitën. Dikush tha:

- Vjershë e bukur:

Nuk m'u durua e thashë:

- Kjo është një këngë popullore!

Dikush tha:

- Ashtu të shkruash, si populli poet!

Pasi mbarova kursin në Pozo Rubio, u ktheva në Kuintanar de la Republika. Aty erdhi Mane Nishova, pastaj Mehmet Shehu. Të dy i njihja dhe u gëzova pa masë. Ato ditë unë do të nisesha dhe Mania m'u lut të vinte me mua, kurse Mehmeti më tha që edhe ai dëshironte të bënte kursin në Pozo Rubio. Unë fola me shokët. Ishin dakord. Mehmeti kërkoi të futej në parti, bashkë me Manen. Folëm me shokët e qendrës, duke u dhënë garanci për këta dy shokë. Pas pak kohe, edhe Mania e Mehmeti u pranuan në parti. Më thanë për Manen se, sipas rregullit, ai duhej të stërvitej për disa kohë në Kuintanar, si të tjerët, dhe pastaj, po të dilte i

aftë, do të nisej për në front, se, përveç shëndetit, duhej të kishte edhe përgatitje ushtarake. Mania nguli këmbë. Prandaj komandanti i batalionit, Bolzanoja, e la Manen të vinte me mua. Kurse Mehmeti u nis për në Pozo Rubio veshur ushtarak; dukej si gjeneral.

Pyetje: - Cili qe fronti i parë ku more pjesë edhe ti?

Përgjigje:- Kur ishim në Kuintanar dhe bëheshim gati për t'u nisur (nuk thuhej se për ku do të niseshim), mua dhe nja dhjetë shokë të tjerë italianë, që mbaruam kursin politiko-ushtarak të Pozo Rubios, na morën që pa gdhirë me një kamion dhe na nisën në drejtim të panjohur. Udhëtuam gati gjithë ditën dhe arritëm në disa bregore, rrëzë maleve plot me dëborë.

Po afroheshin Krishtlindjet. Ecëm ca kilometra më këmbë dhe u bashkuam me një divizion të përzier që bëhej gati të sulmonte Teruelin. Këtë na e tha komisari, sapo arritëm. Të tjerët ishin gati. U err dhe filloi marshimi i tri kolonave. Unë isha në kolonën e mesit. Ecëm e ecëm dhe që pa gdhirë mirë dëgjuam bataretë e artilerisë, pastaj mitralozat nga të dy anët e maleve. Siç dukej, dy kolonat e tjera kishin shpërthyer frontin dhe marshonin drejt rrugës së vetme që lidhte Teruelin me pjesën frankiste. Afër drekës rruga ishte prerë. Qyteti ishte rrethuar nga forcat tona, po, sipas planit të parashikuar, sulmi mbi qytet duhej bërë i befasishëm, nga të gjitha drejtimet. Në sektorin ku isha unë, malet ishin me dëborë dhe bënte shumë ftohtë, sidomos natën. Tri ditë e tri netë pa vënë gjë në gojë, qëndruam në pozicione; armiku bëri shumë përpjekje për të dalë nga rrethimi. Lufta vazhdoi e rreptë. Unë isha si i mpirë dhe, të them të drejtën, as që e kisha shkrehur fare. Pas disa ditësh, armiku ngriti flamurin e bardhë. Hymë në qytet, lufta vazhdonte. Shumë armiq ishin mbyllur në kisha si në kështjella dhe rezistonin. Nuk dorëzoheshin. Qëllonin me mitraloza dhe këndonin. Peshkopi u zu rob dhe u dërgua me aeroplan në Albacete.

Shumë murgesha qanin dhe të tmerruara prisnin që t'i vrisnim, po ne u dhamë për të ngrënë dhe për të pirë dhe i nisëm për në Valencia. Ato u habitën. Disa prej tyre kërkuan të qëndronin si infermiere, po komanda jonë nuk pranoi. Ajo betejë më duket si një ëndërr, se si ëndërr kaluan ato dy javë në Teruel, ku, përveç ngricës dhe urisë, nuk kujtoj tjetër gjë. Asnjë nga shokët e mi nuk u vra, as u plagos. Na kthyen përsëri në Kuintanar, ku gjeta Manen, Mehmetin dhe Faik Dardhën, që porsa kishte ardhur. Takova dhe Shaban Bashën, i cili u caktua të vinte me ne në një front të panjohur.

DREJT FRONTIT ME RAMIZIN, SHABANIN, MANEN, FAIKUN.

Në Albacete kishin dalë Skënderi, Ymer Puka, Justina, Emrushi. Na takuan dhe na sollën disa gjëra për të ngrënë. Skënderi më tha se lënda e numrit të dytë të revistës "Vullnetari i lirisë" nuk do të dilte, se shtypshkronja ishte bombarduar e djegur e tëra bashkë me dorëshkrimet. Në stacion kishin dalë dhe Longoja me Pavaninin, për ta përcjellë brigadën për në front. Longoja kaloi nga vagoni në vagon duke u përshëndetur me të gjithë. Kur u err, treni u nis drejt Estremadurës.

Ne, të pesë shqiptarët, ishim bashkë. Bisedonim gjëra të ndryshme, po veçanërisht për shokët tanë shqiptarë. Flisnim për të rënët tanë: për Zef Hotin, të cilin e kishte njohur mirë Ramizi në Paris: trim dhe besnik, me një jetë plot brenga e vetmi; për Urfi Agollin, të cilin e njihte mirë Shabani: shumë i shkathët dhe kokëkrisur, antifashist i betuar dhe i papërkulur; për Asimin, të cilin e njihnim të gjithë, se ai ishte i të gjithëve dhe jeta e kishte prezantuar në shumë raste si trim, besnik, të mençur, revolucionar e internacionalist. Më vinte mirë që për Asimin flisnin aq shumë e aq bukur.

Ramizi më pyeti se si e njihja unë Mehmet Shehun. I thashë se e kisha njohur qysh në Shkollën Tregtare të Vlorës, që në klasën e parë, pastaj si e njoha në Tiranë dhe si më premtoi se do të vinte edhe ai në Spanjë.

Ramizi kishte një logjikë të fortë dhe fliste fare hapur. E pyeti Faik Dardhën, që ishte pispillosur dhe krehur si gagarel:

- Po ti, more trim, pse erdhe këtu? Çudi! - Kjo pyetje e papritur na bëri të gjithëve ta shikonim Faikun në sy. Kjo pyetje e Ramizit qe sikur të dilte nga goja jonë. Pritëm përgjigjen e Faikut:

- Po ju pse erdhët këtu?

Treni ecte. Ishim lajmëruar shumë herë që, në rast alarmi, duhej të dilnim nga vagonët me radhë, pa u shtyrë, duke mos harruar armët. Arritëm në Estremadurë dhe u vendosëm në një fshat të madh që quhet Kampanario. Shumica e batalionit të tretë, ku bënim pjesë të gjithë ne shqiptarët , u shpërnda nëpër familje.

Shënim: Gjatë gjithë udhëtimit, që zgjati dy ditë e dy net (me ndalesa), vura re se dy shokët më të mirë: Ramizi dhe Shabani, më dukeshin si veteranë të shumë betejave, se ishin të qetë dhe flisnin me shumë kompetencë për çdo problem. Faiku vetëm për gra fliste. Mania shkulej së qeshuri kur fliste Faiku, të cilin e kishte pagëzuar Don Zhuan. Ramizi më porositi që ta kisha kujdes, se mos na bënte ndonjë proçkë.

E gjeta një mëngjes, pas një muri, duke folur me dy vajza. Ai nuk më kishte parë. E dëgjoja që u shiste dëngla si: "Unë jam kont dhe kam një transatlantik, emrin e vërtetë e kam Ferdinando Grandioso, po emrin e luftës, si pseudonim, e kam Faik, ashtu më quajnë shokët, Faik" - dhe broçkulla të tjera. Kur u ndanë, unë shpejtova hapin dhe takova dy vajzat, të cilat më buzë-

qeshën, se, si gjithë populli, edhe ato na deshën shumë. I pyeta se çfarë u thoshte ai vullnetari. Më thanë diçka. Pastaj unë shtova: "Ai, ashtu siç ju tha, është shumë pasanik... Emrin e vërtetë e ka Faik Kopuku!". Ato e shënuan me laps emrin. Dhe u ndamë. Pas disa ditësh, brigada u nis për në malet e Siera Morenës; kishte dalë gjithë populli për të na përcjellë dhe cilido përshëndeste shokët që kishte strehuar: "Hasta la vista, Alberto!" "Hasta la vista, Xhiovani!" Kur dëgjuam: "Hasta la vista, Faik Kopuku!" - bërtisnin ato dy vajzat që kishte njohur Faiku! Të gjithë u shkulëm së qeshuri, sidomos Ramizi, që më shikonte dhe më tundte kokën.

Kampanario, një fshat i madh i Estremadurës. Njerëz të fortë. Na deshën. E deshën Republikën, e deshën frontin popullor. Burrat ishin në luftë. Gra, pleq, plaka dhe shumë të reja, na ndihmonin. Jepnin shfaqje për ne duke kënduar këngë të bukura dhe duke kërcyer si jitanat. Aty kam parë shpirtin e vërtetë të fshatarit të prapambetur të Estremadurës. Në familjen ku unë u strehova, flisja me plaka dhe gra, shumë fanatike, shumë të prapambetura. Bisedoja me to duke përdorur edhe fjalët e ungjillit, fjalët e Krishtit, dhe ato habiteshin.

Aty afër, në Badajoz, marokenët (myslimanë) kishin bërë krime të shëmtuara në popullatë, sidomos me femrat, që, pasi i përdhunonin, u qethnin flokët, u shkruanin me brisk mbi kafkë. H.P. (hermanos proletarios), i hidhnin në arenën e torove, ku shqyheshin nga demat, ndërsa këta zbardhnin dhëmbët.

Lidhur me këto ngjarje, u kujtova grave dhe plakave se Frankoja ishte i krishterë, dhe i pyeta nëse e mbronin krishterimin marokenët, që vrisnin dhe prisnin femrat e kalamajtë. A ishin të krishterë ata? Ato u habitën dhe

bënë kryqin. (E kam shkruar te "Hasta la vista" episodin e fshatarit të varfër që punonte si shërbëtor në familjen ku u strehova. Aty ishin dy vajza, babai i të cilave punonte në postën e Kastuerës, përtej kufirit, me fashizmin. Dhe, një mëngjes, ne e pritëm atë fshatar të varfër, se dyshuam shumë tek ai. Kur u nis për në Siera Morena, e ndaluam dhe i gjetëm një letër në tabanin e opingës. Letra shkruhej nga vajzat e atij që punonte në postën e Kastuerës. Shkruanin për brigadën tonë, për përgatitjet që bënim për sulm. Sa punonte spiunazhi! Sa punonte Kolona e Pestë!)

Po ne Kolonën e Pestë e kishim midis nesh, madje në komandën e brigadës; ishte vetë Prietoja, ai që më vonë u bë ministër i Luftës.

Brigada eci e eci, sa arriti rrëzë bregoreve të Siera Morenës.

Për tri ditë e tri net rresht lëvizte nga sektori në sektor. Të lodhur, të mërzitur për këtë "taktikë të çuditshme", prisnim me ankth sulmin. Ishte një plan i studiuar mirë nga shtabi i ushtrisë popullore, që të sulmohej e të arrinim kufirin portugez për të ndarë më dysh forcat frankiste. Po Kolona e Pestë punonte mirë. Mbrëmjen e katërt, komandanti Prieto, dha urdhër për sulm. Batalioni ynë ishte në mes dhe formonte pykën qendrore për të arritur lart në bregoret ku ishte vija e fortifikuar e armikut. Ngjiteshim ngadalë, përmes shkurreve dhe ferrave, dëgjohej vetëm fëshfërima e gjetheve! Ajo natë e shkurtit të vitit 1938 ishte e errët dhe e ftohtë. Ne ngjiteshim. Vështrova prapa dhe pashë tej një dritë elektriku (dore) që jepte sinjale. I thashë komisarit Ramirez, ai ktheu kokën e më tha: "U pa kjo punë! Kudo spiunë. Armiku është lajmëruar dhe po lajmërohet se sulmin e nisëm."

Me të arritur në konturet e bregoreve, ramë mbi llogoret armike. Buçiti "Internacionalja" dhe "*Adelante*

para la Republica!".[1] Batalioni ynë e theu rezistencën armike, vrau dhe zuri robër ata që ishin në llogore, pastaj nisi zbritja për në Kastuera. Ana e majtë dhe ana e djathtë nuk e kishin thyer rezistencën. Ne zbritëm duke kënduar. Po zbardhte. Ramë në ullishtat e Kastuerës dhe marshonim, kurse ana e majtë dhe ana e djathtë luftonin për të thyer rezistencën.

Befas dëgjuam batare të dendura nga tri anët: përpara, majtas e djathtas. Aty pashë lemerinë, binin shokët si me urdhër, dhjetëra e qindra ranë. Dëgjoheshin thirrje, klithma. Nga ullinjtë qëllonin marokenët (kishin hipur mbi pemë). U shtrimë përtokë për t'u mbrojtur. Komisar Ramirezi, një i ri nga Katalonja, qëndronte më këmbë duke dhënë urdhra. Ecnim, ca barkas, ca këmbadoras, gjersa arritëm në vijë të drejtë me komisarin. Disa marokenë ranë nga ullinjtë. Ca të vdekur, ca të plagosur, ca të gjallë. U thamë se ishin të rrethuar dhe duhej të dorëzoheshin, prandaj të vinin drejt nesh me duart lart. Katër prej tyre u nisën drejt nesh me duart lart dhe, me t'u afruar, qëlluan, sidomos komisarin, të cilin e plagosën në ijë. Menjëherë ata të katër u goditën me bajonetë nga shokët. Komisari nuk e bëri veten, qëndroi më këmbë, jepte urdhra.

Ndenjëm aty gjersa u err. Ishim mbërthyer si në darë. Asnjë nuk lëvizte, se vritej menjëherë. Të plagosurit e të vrarët dergjeshin. Ne ishim rreth gjashtëqind (gjithë batalioni i tretë), por nja katërqind ishin vrarë!

Edhe unë bashkë me disa të tjerë u ngarkova të mblidhja dokumentet e të vdekurve. Ishte një punë tronditëse, pikëlluese, më dukej sikur mblidhja ëndrrat e vrara të shokëve të mi: letra, fotografi, tesera. Mbusha trastën, mbusha dhe xainon. Nuk guxoja t'u shihja fytyrën të

1) Përpara për Republikën!

vrarëve të shtrirë në poza të ndryshme. Oh, ç'çaste të tmerrshme! Çaste ndjenjëdërrmuese, sidomos kur shikoja fytyra të njohura, ato që gjer dje kishin shprehur entuziazëm, besim dhe jetë! Dhe ja tani të vdekur, të vdekur përgjithmonë, aty, nën ullishtën e Kastuerës!

Pyetje: - Po ti, a qëllove ndonjë armik?

Përgjigje: - Më zure ngushtë! Dua të ta tregoj! Është e domosdoshme që unë të ta them se si vrava njeriun e parë! E vrava! E vrava! Duke parë gjithë shokët e mi të shtrirë, të vrarë, të vdekur, të ndarë nga ne përgjithmonë, u ndeza, u turbullova, nuk e desha më jetën, kërkoja të përmbysja botën, ta merrja në dorë rruzullin e ta shtrydhja si limon, që t'i dilnin lotët e fundit!

Isha ulur me pushkën drejt ullinjve, nga binin marokenët e vrarë. Dallova një që qëllonte. Ishte me një xhybe bojë hiri, me mjekër dhe me çallmë në kokë. I drejtova tytën. Mora mirë shenjë - kisha dalë mirë në qitje - qëllova dhe e pashë të rrëzohej me xhyben e hapur dhe me një klithmë... Ra! Dhe nuk lëvizi më! Ishte i pari që vrisja. Për një çast më mbështolli një shtëllungë mendimesh të çuditshme: "Kush ishte? I martuar? I pamartuar? Djalë i vetëm? Baba? Ç'ëndërronte? Kë dashuronte? Pse erdhi këtu? Erdhi apo e prunë? Sa shokë të mi kishte vrarë?... Shokët e mi! Më shumë se katërqind! Të shtrirë. Aty, nën ullishtat e Kastuerës! O revolucion! O jetë! O ëndërr e madhe! O botë e ngatërruar? Pse? Pse?..."

Pyetje: - Po nga shokët shqiptarë, a u vra ndonjë?

Përgjigje: - Kur nisi të errej, morëm urdhër të tërhiqeshim. Tërheqja u bë në mbrëmje. Kush e kush t'i ngjitej i pari bregores, andej nga u nisëm në mëngjes. Bataretë ishin rralluar. Ngjitesha ngarkuar me trastat plot me dokumente të të vrarëve. Armë, mitraloza të lënë. Rrëmbeva dhe një mitraloz "Maksim" dhe nisa ta zvarritja. Me mua ishte dhe një poet italian, ai më ndihmonte. Asnjë shok i gjallë prapa nesh! Vetëm të vrarët, TË

VRARËT! Po ngjiteshim. Më tha shoku poet: "Shiko andej!" E ç'të shihja! Kavaleria marokene po na priste udhën nga e djathta. "Ma jep mua mitralozin, - më tha, - dhe ikë ti!" U përpoqa ta bindja të vinte me mua! "Jo! Dua të rri edhe unë këtu përjetë, bashkë me të katërqind shokët e mi! - tha. - Ti ikë dhe, po mbete gjallë, shkruaj vargje për ne!" U puthëm. Ai u ul pranë mitralozit dhe nisi të qëllonte kavalerinë marokene, e cila po mbrapsej. Unë ngjitesha i ngarkuar me emrat e të vrarëve. Ai atje poshtë qëllonte. Ktheva kokën. Ishte më këmbë. Më pa dhe thirri "Rroftë liria!" dhe një lëmsh i zjarrtë mbështolli trupin e tij. I kishin mbaruar fishekët dhe plasi bombën që mbante, të fundit, duke i dhënë fund jetës, që të qëndronte dhe ai atje, bashkë me katërqind shokët tanë.

I këputur, vazhdoja të ngjitesha, i fundit, kur dëgjoj: "Oh, mbeta, mbeta!" Shqip! I tronditur nga ky zë, hedh sytë në një gropë. Aty pashë Manen, i cili nuk ecte dot. E hodha në krah (ishte i lehtë Mania, ishte shumë i dobët fizikisht, po mua më dukej sikur mbartja gjithë të vdekurit). E ngjita gjer në qafë. Atje gjeta shumë shokë të tjerë që rezistonin krahëve, nga qëllonin me automatikë armiqtë. Urdhri: "Shpejtoni, se do të fillojë të qëllojë artileria jonë!" Manes i thashë të qëndronte aty, sa të merrja vesh ç'bëhej. Kur u ktheva, nuk e gjeta. Plumbat fishkëllenin me breshëri. Thirra shumë herë, por asnjë përgjigje. Ika i pikëlluar edhe për Manen. Zbritëm, kaluam përroin dhe arritëm shokët tanë. Na dhanë ujë për të pirë dhe na thanë të shtriheshim e të pushonim. Kur u zgjova në mëngjes, pashë pranë meje Manen, që flinte i qetë! Sa u gëzova! Pastaj pashë dhe Shabanin, Ramizin, Faikun! Asnjë nga shqiptarët nuk ishte vrarë!

U kthyem përsëri në Kampanario, për t'u riorganizuar. Ishim të pikëlluar për katastrofën. U fol shumë për këtë disfatë dhe u tha se tradhtia kishte bërë punën e saj. Armiku ishte lajmëruar dhe na priste ashtu siç na priti.

Ishte shkurti i vitit 1938. Estremadura, krahina e ashpër e Spanjës, kishte një klimë të çuditshme: ditën vapë - laheshim dhe në lumë - natën akull!

Aty njoha mirë karakterin e Ramizit: i qetë, i mençur. Na fliste për betejën e humbur, për agjentët, për armiqtë e shumtë të brendshëm e të jashtëm, për rrugën tonë të vështirë dhe për besimin në fitore. Shabani ishte i qetë dhe i palëkundur, kurse Faiku dridhej dhe pëshpëriste: "Kot luftojmë! Luftën e kemi të humbur! Të gjithë do të vritemi!". Për këto ide të Faikut ne shqetësoheshim dhe i flisnim. Po nuk kishim ç't'i bënim: ai ishte disfatist, i trembur. Kurse Mania, i dobët fizikisht, u pa që nuk ishte më për në vijë të parë. Më tha Shabani ta merrte në kompaninë e xhenierëve, po Mania nuk deshi të ndahej nga unë.

Për çudi, aty më erdhi një letër shumë e vonuar nga Parisi. E hapa: *"Të dashtun bijtë e mi, Petro dhe Asim!* - na shkruante Babushi (Bedri Pejani), - *jam në Paris, pa asnjë pare në xhep. Po nuk më ndihmuat, do të mbytem në lumin Senë!"* (Babushi letrën e kishte nisur prej kohësh. Ndërkohë Asimi ishte vrarë, kurse unë, për çudi jetoja. Ai nga Parisi na kërkonte para! Qesha me vete! Hajde, Babush, hajde! Ku ti dhe ku ne! Qeshëm bashkë me shokët. Qeshte me të madhe Ramizi, qeshnin dhe Shabani e Mania, se e njihnin mirë Babushin që këtë e bënte për humor, ngaqë e dinte se ne ishim në grykën e zjarrit. Ishte dorëlëshuar dhe për këtë ves të tij disa shokë në Tiranë (atëherë kur isha në Tiranë dhe e takonim përditë Babushin) thoshin: Për ta zhdukur sa më shpejt imperializmin amerikan, duhet të dërgojmë atje Babushin, ta emërojmë ministër të Financave, kështu që brenda pak muajsh ai mund ta çojë në faliment Amerikën, pa luftë, vetëm me shkatërrimin e kapitalit... Babushi na donte si djemtë e tij.

DREJT ARAGONËS

Pyetje: - Pas Estremadurës, ku shkuat?

Përgjigje: - Morëm rrugën për në Aragonë.

U dha urdhri të niseshim. Treni gjëmoi nga këngët revolucionare. Udhëtonim drejt lindjes dhe verilindjes. Shikonim peizazhe të bukura, fshatarë që punonin, që na nderonin, që ngrinin lart grushtin. Pamë dhe minierën e merkurit, aty nga e djathta, në Almaden, miniera më e pasur në botë me merkur (zhivë). M'u kujtua Ekspozita Internacionale e Parisit, atëherë kur me Aliun dhe Fundon vizitonim pavijonet e ndryshme, kur vizituam dhe pavijonin e Republikës Spanjolle dhe pashë aty një lëmë të vogël, si ai ku derdhim ullinjtë për t'i bluar në trokoll, ku një burim merkuri derdhej e derdhej. Tani mbi oxhakët e minierës valëvitej flamuri i kuq!

Takonte shpeshherë që mblidheshim të pesë shqiptarët bashkë:

Ramizi, me udhëzimet e tij.

Shabani, me heshtjen e tij.

Mania me pikëpyetjet e tij.

Faiku me qyfyret e tij pa mbarim. Tregonte aventurat në komunën e Voskopojës. Tregonte aventurat në Paris dhe rrugës për në Pirenej... Qeshnim me të. Ramizi i thoshte: "Mblidhe mendjen, se këtu jemi në luftë. Kujto se je shqiptar, dhe ne këtu nuk duam të lëmë përshtypje të këqija. Mblidhe mendjen, more tutkun!"

Arritëm në bregdet. Treni u ndal. Duhej të zbritnim, të hanim në *"Casa del soldado"*. U lamë në det. Hëngrëm e pimë mirë. Na përcollën me këngë. Dita ishte e bukur. Ecnim drejt Valencias apo drejt Albacetes? Këtë vetëm Ramizi e dinte.

Pyetje: - Nuk u takuat më me shokët e tjerë shqiptarë?

Përgjigje: - U takuam në Albacete. Ne udhëtonim natën me tren. Në stacionet e ndryshme qëndronim në

mëngjes. Rrinim aty gjithë ditën dhe natën udhëtonim drejt Albacetes. Në Valencia ndenjëm një ditë dhe aty mësuam se vullnetarë të tjerë po vinin nga bota. Shtypin e merrnim në rregull dhe komunikatat i dëgjonim në radio çdo ditë. Nuk kishte asgjë të bujshme. Unë shkruaja vjersha dhe shënime nga përshtypjet e shumta. Spanjollët na deshën shumë dhe nuk dinin ç'të bënin, që të na kënaqnin. Me gjithë kështillat që i dhamë Faikut, ai po ai: pas fustaneve. Rruhej dhe kruhej, shtrinte dhe flokët si me brilantinë dhe Mania shkulej së qeshuri, kur e dëgjonte të fliste për morenat e Valencias. Mania i ishte lutur Ramizit që të bënim një shaka me Faikun, dhe ai na lejoi:

- Faik, - i thashë unë, - kërkojnë këtu në Valencia disa shokë që dinë frëngjisht, për të shoqëruar disa gazetare të bukura, që kanë ardhur nga e gjithë bota. Ne menduam të shkosh edhe ti.

Ai u hodh përpjetë nga gëzimi:

- Pranoj... me disiplinë... dhe me urdhër!

Shabani e shoqëroi, pasi Faiku u puth me ne, me lot ndër sy: "Kushedi në do të shihemi më." U ndamë. Pas dy orësh u kthye Shabani (serioz) me Faikun buzëvarur! Ç'kishte ngjarë? Faikun e shpuri Shabani në një azil pleqsh të sëmurë.

Kur arritëm në Albacete, kishte gdhirë. Na prisnin Ymer Puka, Justina, Skënder Luarasi, Emrush Myftari, Xhemal Kada, Dhimitër Kosta, Zef Prela, Hulusi Spahiu. E kishin marrë vesh "katastrofën" e batalionit tonë dhe, kur na panë të gjallë, fluturuan nga gëzimi. Ishte aty dhe Luixhi Longo, Pavanini e të tjerë. Na shtruan të gjitha të mirat dhe na thanë se gjer në darkë ishim të lirë. Në orën pesë duhej të gjendeshim në stacion, te vagonët tanë.

Kjo qe një nga ditët më të bukura të jetës sime në Spanjë.

Shëtitëm. Takuam shokët dhe shoqet e vjetra. Erdhi

dhe Mehmeti, që sapo kishte mbaruar kursin politik në Pozo Rubio. Me shaka e me qyfyre, me biseda dy nga dy e me shumë shokë, hëngrëm të gjithë në *"Cercle mencantil"*. Ishte aty dhe gjeneral Gëstençiçi.

Aty mësuam se po i drejtoheshim Aragonës, ku armiku kishte shpërthyer një nga ofensivat më të bujshme për të dalë në Mesdhe dhe për ta ndarë Republikën më dysh...

LAMTUMIRË, O ALBACETE!

Në trenin tonë ishte dhe Luixhi Longo. Kënga ushtonte. Ne shqiptarët ishim të gjithë në një vagon. Shumë gjëra thuheshin: "Fashistët përparojnë me vrik drejt Mesdheut. Franca e ka lënë kufirin të lirë. Nuk është e vërtetë! Leon Blumi është më armik se vetë Daladieja!" Pastaj bisedonim për shokët e tjerë, që ishin në fronte të ndryshme.

Unë isha në dritare dhe kundroja Mesdheun. Sillja ndër mend fshatin tim, fshatarët e mi të mirë, që kishin lundruar në të gjitha detet dhe oqeanet! Sidomos xha Foti, daja im, i cili më kishte folur shpesh për Karaibet, për popujt që flisnin gjuhën spanjolle, për Joze Martinin, për Simeon Bolivaresin, për luftën që kishte bërë ai, për çlirimin e Kubës nga spanjollët, për Kanalin e Panamasë, ku dhe ai kishte marrë pjesë, ndaj në librin "Kanali i Panamasë", në një faqe, ishte fotografia e tij... Befas u dëgjua një krismë e fuqishme, një lëkundje e tmerrshme! Aeroplanët fashistë kishin bombarduar dhe një gjyle kishte goditur lokomotivën. Alarm! Të gjithë vrapuam të dilnim. Nga ne asnjë i plagosur, kurse në vagonët e tjerë, shumë të plagosur dhe të vrarë. Dolëm tek ullinjtë, ndërsa aeroplanët ende mitralonin. Menjëherë skuadrat kundërajrore u kundërpërgjigjën. U rrëzua një aeroplan

dhe ra mbi ullinjtë. Tre pilotë i zumë të gjallë. Shokët kërkonin, t'i pushkatonim, por Longoja na ndaloi: "Janë robër lufte!" - I mori në pyetje. Ishin italianë. Shumica bërtiste: "Në plumb! Vdekje fashistëve!"

Ndenjëm aty nën ullinj gjithë ditën. Në darkë erdhi një tren tjetër. Me të u nisëm drejt Tortozës. Sapo arritëm në atë qytet, në deltën e Ebros, erdhën aeroplanët fashistë dhe shkarkuan me qindra e qindra bomba në stacion! (Agjentët kishin lajmëruar për udhëtimin e brigadës sonë!) Stacioni, tym e flakë. Vagonë të shumtë u goditën, edhe vagonët e intendencës, ku ishin ushqimet dhe armatimet. Ramizi shpëtoi. Asnjë nga ne shqiptarët nuk pësoi gjë. Kaluam me nxitim qytetin gërmadhë: të vdekur, të plagosur, dyqane të shkatërruara, rrugëve ç'nuk shihje! Sikur i kishin hapur barkun Tortozës dhe gjithë të brendshmet i kishin dalë përjashta!

Longoja u plagos pakëz në kokë, të cilën e kishte lidhur me fasho. Ai jepte urdhra dhe u vu në krye të brigadës, për të kapërcyer urën e për të marrë rrugën nga e majta e Ebros, drejt Gandezës, përmes ullinjve të shumtë.

Pyetje: - Po fronti ku ishte?

Përgjigje: - Nuk flitej kurrë asgjë për planet e brigadës, por unë, duke qenë zëvendëskomisar i kompanisë së dytë të batalionit të tretë, mora vesh nga Ramirezi se fronti ishte shpërthyer dhe armiku zbriste drejt Mesdheut duke hasur pak rezistencë nga njësitet e organizuara shpejt e shpejt. Thuhej se armiku kishte grumbulluar forca të shumta dhe të motorizuara. Kurse aeroplanët fashistë gjithë ditën e ditës shkarkonin bomba, mitralonin, qoftë edhe një njeri të vetëm po të shihnin. Aeroplanët fashistë ngarkoheshin te Balnearët, shkarkoheshin në territorin e republikës, shkonin drejt perëndimit, në zonat e fashistëve, ku përsëri ngarkoheshin dhe, duke shkuar te Balnearët, shkarkonin

hekur e zjarr. Atë punë bënin gjithë ditën.

Tani brigada jonë dhe brigada të tjera internacionale ishin ngarkuar që të ndalonin falangën fashiste. Po ku ishte fronti? Disa thoshin në Saragozë, disa thoshin në Kaspe. Nuk dihej. Ne ecnim më këmbë, të ngarkuar me pajisje të rënda. Ecnim nga krahu i majtë i lumit Ebro. Të gjithë e dinim situatën e rëndë, prandaj nuk tregonim më barcoleta dhe anekdota. Vija re Faikun: i kishte ikur fytyra, nuk fliste fare, sytë i ishin zgurdulluar. Kishte parë lemerinë gjatë këtyre ditëve, qysh nga Kastuera e gjer në Tortoza...

Në Gandeza, ku ndaheshin rrugët, brigada u ndal dhe gjithë natën bëri disa ndryshime në batalionet. Ne morëm drejtimin e Kaspes. Ecnim duke kaluar nëpër vende ku nuk dukeshim. Pararoja jonë, e përbërë edhe nga katalanë fshatarë, ecte në krye, për të parë se ku ishte armiku. Më në fund, armiku u diktua: kishte zënë pozicione në këndin ku derdhet lumi Guadalupe në Ebro, afër Kaspes. Batalioni ynë u ndal përballë Kaspes, në një përrua me disa ullinj. Aty Ramizi vendosi intendencën. Aty lashë edhe unë si të tjerët çantat dhe teshat e rënda. U ndamë me Ramizin dhe ne vazhduam ngadalë përparimin për të zënë pozicione të përshtatshme. Me mua ishte vetëm Faiku, i cili më shihte me ca sy ku lexohej paniku. "Kije kujdes, - më tha Ramizi, - se nuk është i keq i ziu, por është i trembur", - dhe më shkeli syrin. Ramizit ai iu lut që ta mbante në intendencë, po me Ramizin ndenjën shokë të sëmurë dhe të plagosur, nja gjashtëdhjetë veta nga gjithë batalioni ynë i tretë, që përbëhej nga më shumë se shtatëqind veta.

Ndaj të gdhirë arritëm në vendin e caktuar, ku do të ngrinim menjëherë istikame dhe pozicione të armëve automatike. Kompania jonë, e dyta, u vendos mu në krye, përballë armikut, nga i cili na ndante një përrua i thellë, nga kalonte lumi Guadalupe. Pak nga e majta,

përkundruall, kishim Kaspen, që digjej në flakë. Nga e majta, Guadalupen, kurse nga e djathta, Ebron. Në vijë të drejtë me armikun mund të ishin nja katërqind metra. Ata qëllonin ditë e natë. Ishim mësuar. Ata kishin municione pa hesap, ne fishekët i kishim të numëruar.

Ditën e katërt na u vra kot komisari. Mua më caktuan komisar të kompanisë së dytë; komandant ishte kapiten Ferrarezi. Kurse komandant i batalionit ishte Bolzanoja; komisar Ramirezi. Erdhi dhe na dha udhëzime. Fronti u stabilizua. Nga ana jonë armiku u ndal.

Dua të përmend edhe këtë: Kur ishim duke pirë verë me komisarin dhe qeshnim për lajmet e mira që merrnim nga fronti tjetër, vura re se ai u rrëzua pa bërë gëk! Kujtova se ra kot. Një plumb qorr e kishte marrë mbi syrin e majtë dhe i kishte dalë prapa kokës. Kishte vdekur në vend! Unë i mora beretën e shpuar dhe e mbajta gjer në fund në kokë si kujtim! Pastaj e lashë në Lion të Francës!

Pyetje: - Pse zgjatesh kaq shumë me mbresa nga ky front?

Përgjigje: - Është fronti i fundit... dhe kam shumë kujtime, prandaj më fal që flas ashtu siç më vijnë valët e asaj atmosfere. Dua të tregoj edhe një episod për të qeshur: Faiku arriti në një pikë që e mbërtheu paniku. Dridhej dhe nuk dilte nga transheja. Dëgjonte artilerinë armike, që nuk pushonte, dhe nuk ngrinte kokën, madje as sytë nuk i hapte fare. Raportet vinin njëri pas tjetrit: "Faiku vazhdon të helmojë atmosferën me disfatizmin e tij: Kot luftojmë! Ne do të vritemi të gjithë! Armiku është i pamposhtshëm! Janë të çmendur komandantët dhe komisarët tanë!" E këshillova disa herë. I thashë se do ta kthenim në prapavijë me rastin më të parë, por e mbushi kupën dhe ne duhej të mblidheshim, të vendosnim ç'duhej të bënim. Kur shikoj se na kishte ardhur Ramizi! U habita!

- Pse erdhe gjer këtu? (Ai qendrën e kishte nja gjashtë kilometra prapa nesh, në një përrua me katër a pesë ullinj...)

- Erdha për Faikun! - më tha. - Dëgjo, Petro, ne pesë shqiptarë jemi dhe nuk duhet të lëmë këtu asnjë njollë të zezë, pra për Faikun kam ardhur.

- Ne do të mblidhemi që të vendosim për të...

- Prit, o Petro! Ai është frikacak, nuk është trim dhe kjo është fatkeqësi, po është shqiptar. Ti mbaje pranë dhe aktivizoje në veprime të parëndësishme.

Kur iku Ramizi, fola me komandantin e kompanisë, edhe ai ishte dakord. E thirra Faikun dhe i thashë të shkonte të mbushte ujë në lumin Ebro, që ishte aty nga e djathta. Ne ujë merrnim natën dhe jo ditën. Faiku u drodh, qeshi dhe nisi:

- Të puthsha këmbët, më ka nëna të vetëm, nuk dua të vritem, të puthsha këmbët! Aman, o Petro! Mendo për nënën time të shkretë! (Foli shumë i llahtarisur.)

- Vendimi është marrë! Mos harxho fjalët kot! Merr mataratë dhe nisu! Është urdhër! - i tha komandanti i kompanisë.

Na pa një herë me sy të zgurdulluar. Mblodhi mataratë, mori dhe një batanije, e hodhi në kokë, duke lënë vetëm një sy përjashta për të parë, dhe, me t'u hedhur jashtë nga llogorja, nisi me zë të madh:

- La-la-ila-allah, Muhamet, Resul allah... - dhe fjalë të tjera të Kuranit, nga ato që dinte përmendsh. Përkundruall ishin marokenët. Kur e dëgjuan, filluan edhe ata të flisnin arabisht. Faiku zbriti në lumë, gjithnjë duke përsëritur suret e Kuranit, dhe mbushi mataratë, erdhi i gëzuar dhe më tha:

- Më hëngrët munë! Nuk më vranë marokenët!

E dërguam në kompaninë e Shabanit.

Armiku bëri shumë përpjekje të na shkulte nga pozicionet që kishim zënë. Nuk la mjet pa përdorur, ditë

e natë. Një mesditë prilli, më thotë mitralieri: "Shiko se po vijnë marokenët! T'i qëlloj?" Ç'të shikoj? Një mizëri marokenësh, të veshur me xhybet bojë guri, zvarriteshin duke iu drejtuar pozicioneve tona. Kur u afruan, i thashë mitralierit të hapte zjarr. Edhe mitralozi tjetër, në këndin e majtë, hapi zjarr. Marokenët nuk zmbrapseshin. Binin njëri pas tjetrit. Sa binin! Sa u vranë dhe ende vazhdonin të ngjiteshin drejt nesh! U bërtita shumë herë: "Mos, se do t'ju vrasim të gjithëve! Për kë do të vdisni? Për Frankon apo për Hitlerin? Kthehuni prapa!" Ata nuk dëgjonin. Ishin fanatikë dhe trima. I njoha mirë në Kastuera, po ja që ne qëllonim, dhe ata binin. Sa? Kushedi. Asnjë për be nuk mbeti i gjallë. Dergjeshin. Ca ulërinin. Pasdreke, disa që vinin nga lumi, ngritën flamurin e bardhë dhe bërtitën: "Na lejoni të marrim të plagosurit!" Bëmë mbledhjen shpejt e shpejt dhe vendosëm t'i linim të merrnin të plagosurit. Rrinim në gatishmëri, se mos e pësonim si me ata në Kastuera, që erdhën me duart lart dhe, sapo u afruan, hapën zjarr e qëlluan komisar Ramirezin.

Në ato çaste erdhi një shok nga intendenca. Mezi arriti. Më dorëzoi një letër nga Ramizi: E lexova: "Po rrethohet batalioni. Ne rezistojmë gjersa të vini. Mos vononi!"

Dërguam të njoftonin menjëherë komandant Bolzanon, i cili bashkë me Ramirezin vendosën që gjysma e kompanisë së dytë dhe kompania e të tretë të niseshin menjëherë. Vetë Ramirezi do të shkonte me ta. Iu luta të shkoja edhe unë. Më lejuan. Kur arritëm ne atje, nuk dëgjoheshin më krisma. Gjetëm shokët të vrarë dhe Ramizin të plagosur rëndë, mbi mitraloz. Iu afrova. U gjunjëzova ta ndihmoja. Ai nuk fliste dot, por sytë e tij më shikonin dhe më flisnin. Dora e tij e pafuqishme nuk ma shtrëngoi dot timen. Më shikonte dhe nxirrte ca gurgullima të shoqëruara me gulfa gjaku. I ndenja pranë,

jersa dha shpirt. I varrosëm shokët shpejt e shpejt. apëm gropa, dhe Ramizin e vumë në një gropë të cekët. ava për vëllanë e madh, për babanë, për shokun, për hqiptarin e mirë që mori pjesë në Luftën e Spanjës. Dhe 'bëra? Aty për aty vendosa: Mora çantën time, aty pranë nitralozit - siç dukej Ramizi e mbante pranë, - dhe thashë ne vete: "Vargjet e mia do të bien në duart e armikut, do 'i djegin dhe do t'i bëjnë hi, prandaj më mirë të m'i ruajë Ramizi!" Mora çantën plot fletore me vargje, letra dhe otografi dhe i vura për jastëk nën kokën e Ramizit. E mbuluam... e mbuluam aty tek ata katër ullinj, përkundruall Kaspes, që ishte në flakë. Ajo ditë nuk më shlyhet nga kujtesa: e bukur, me një diell që hapej më shumë drejt luginës së Ebros, por pa zogj, se shpendët i kishte trembur dhe larguar bubullima e përhershme e aeroplanëve dhe e gjyleve.

Të them të drejtën, qe hera e dytë që e lëshova veten dhe nuk ruhesha më nga plumbat e nga predhat. Ecja drejt, pa u përkulur dhe pa kërkuar shtigje të sigurta. (Hera e parë ishte tërheqja nga ullishtat e Kastuerës, aty në Sierra Morena, ku lamë katërqind shokë të vrarë.) Vetëm një gjë kërkoja: plumbi të më merrte mirë dhe jo në ndonjë gjymtyrë që të lëngoja ose të bija në duart e armikut!

Pyetje: - Pastaj ç'bëtë? A u kthyet përsëri në llogoret që latë?

Përgjigje: - U kthyem. Të këputur. Unë më shumë se të tjerët, veçse nuk duhej ta bëja veten, se isha komisar! Qëndruam ditë pa ngrënë. Një mbrëmje, komisar Ramirezi dhe komandant Bolzanoja na thirrën aty në shtabin e batalionit, ku vendosëm të tëhiqeshim, se kishim humbur lidhjet me shtabin e brigadës. Thuhej se ne kishim mbetur nja tridhjet kilometra larg forcave të ushtrisë sonë. Ishim në prapavija, por pa shumë municione dhe pa ushqime. Duhej të largoheshim pa u

diktuar dhe pa i dhënë të kuptonte armikut se i kishim lënë pozicionet.

Na erdhi shumë keq, u trishtuam që i lamë pozicionet ashtu, u pikëlluam dhe për Ramizin. Më vinte për të qarë, lotët më dilnin vetë pa u përmbajtur dot, por ishte natë dhe nuk më shihte njeri, nuk turpërohesha.

Lamë aty pesë veta, që të qëllonin herë pas here. Ata do të qëndronin aty gjithë natën dhe gjithë ditën, kurse të nesërmen në darkë do të merrnin monopatet anës Ebros, ashtu siç i udhëzoi Ramirezi. Natën ecëm e ecëm dhe në agim u ndalëm pranë një korijeje me ullinj të dendur. Kishte ca livadhe dhe disa shtëpi pa asnjë banor. Hanim rrënjë lakrash dhe ullinj të rrëzuar, të bërë stafidhe. Kur ja, një aeroplan u ul në livadhin ngjitur me ullishtat. Shkova unë dhe katër veta për të parë se ç'po ndodhte. Aeroplani ishte yni! Ne nuk dolëm menjëherë, po, pasi pamë që zbritën tre veta, ndër ta dhe Andre Martia, vrapuam drejt tyre. Unë nderova me grusht dhe thashë:

- *Camaradë Marti, nous sommes du batallon...*[1]

- *Habla castellano mi hijo!*[2] - më tha Martia.

U habita. Martia aty! Ç'ishte kjo? Na tha që menjëherë të mblidheshin aty komandantët dhe komisarët. Vrapuam të lajmëronim. Pas pak u mblodhëm rreth Andre Martisë, i cili dukej i lodhur, por i fortë, ashtu siç e njihnim ne. Ai na tha pak a shumë këto: "Tradhtia e qeverisë së Francës dhe Kolona e Pestë, që është aktivizuar shumë, na shkaktuan këtë disfatë të madhe. Por populli spanjoll, populli francez dhe popujt e botës nuk do të na lënë në baltë, sidomos Stalini. Ne duhet të luftojmë gjer në fitore! Cili është misioni juaj? Ne ju kishim qarë. Thamë se batalioni i tretë është asgjësuar

1) - Shoku Marti, ne jemi të batalionit...

2) - Fol spanjisht, biri im!

fare dhe nuk kishte mbetur njeri i gjallë. Po ja që batalioni i tretë është më këmbë dhe i fortë. Ju jeni në prapavija. Dhe keni për të mbetur këtu. Por, para se të vriteni, vrisni dhe nga një fashist secili prej jush!" - Sikur fliste me një lëmsh në fyt! Ngriti grushtin dhe u kthye për të mos ia parë lotët! Iku. U fut në aeroplan me dy shokët që e shoqëronin, dhe fluturoi. Ne e shikonim duke kujtuar fjalët e tij të fundit: "Vrisni nga një fashist para se të vriteni!" Ne ishim shuar nga efektivi i gjallë. Batalioni i tretë ishte sakrifikuar...

Po Ramirezi na mblodhi përsëri dhe na këshilloi të mbanim lart optimizmin. Ne ishim gjallë dhe do ta vazhdonim luftën gjer në fitore.

DREJT SË PANJOHURËS

U endëm disa ditë ullishtave duke ngrënë gomarë të pjekur. Disa fshatarë u bashkuan me hallet tona dhe u bënë korrierë. Ata shkonin nga një vend në tjetrin dhe na sillnin lajme. Radio nuk kishim. Gazeta nuk vinin. Fshatarët na thoshin ato që dëgjonin: "Fashistët dolën në Tortoza!", "Katalonja u nda nga qendra." "Një puç fashist në Barcelonë!"

Ditët na dukeshin shumë të gjata. Luftë nuk bënim dot. Nuk kishim shumë municione. Shikonim në qiell valët e aeroplanëve fashistë që kalonin drejt veriut dhe pastaj dëgjoheshin bubullimat. Netëve ecnim të drejtuar nga fshatarët që mbetën besnikë të republikës. Ishim të mbaruar fare. Kishim harruar edhe kohën: e dinim që ishte muaji maj, po se ç'ditë ose ç'datë, s'dinim gjë. Shumë nga ne grisnin dokumentet e shkresat që mbanin. Unë i lashë te varri i Ramizit! Dhe bëra mirë, se aty ishin të sigurta vargjet e mia. Nuk e di pse mbaja në xhep ende vendimin që u mor ditët e fundit, aty në pozicionet e

para, kur u dënuan me pushkatim një katalan dhe një italian si trockistë; kishte prova që ata ishin vërtet agjentë dhe kishin vendosur të hidheshin matanë për të lajmëruar armikun se si ishte gjendja jonë morale dhe materiale. E pranuan se ishin kundër nesh. Filluan të na shanin, të na quanin kasapë dhe gomarë të revolucionit. "Zjarr!" - urdhëroi komandanti dhe të dy ranë aty në shtabin tonë të vogël, prapa bregores së vijës së parë. Pse i mbaja në xhep ato vendime dhe thëniet e tyre të fundit? I mbaja për t'ua treguar atyre që nuk besonin se trockistët u bënë më të rrezikshëm se vetë fashistët. Me ata që nuk e besonin këtë, s'kishte nevojë të bënim debate teorike për trockizmin në Spanjë. Për rrezikshmërinë e tyre mund të flisje me shembuj konkretë.

Pas tri javësh peripecish, komanda e batalionit vendosi që ne të mblidheshim të gjithë së bashku sa kishim mbetur gjallë nga të katër kompanitë, dhe aty në Gandezë të bënim një sulm për të çarë rrugën drejt jugut ose lindjes. U mblodhëm. Shokët ishin shumë të dëshpëruar, të lodhur. U vendos që kompania jonë të ecte e para dhe të fillonte sulmin. Filluam të përparonim ngadalë, në formacion luftimi, nën ullinjtë, aty ku bashkohej rruga që vjen nga Alcanizi.

KATASTROFA E PËRGJAKUR

Vizioni i asaj katastrofe nuk do të më shlyhet kurrë nga kujtesa tërë jetën. Ne zbritëm në rrugë në formacion luftimi. Sapo arritëm, ndërsa dukej se po agonte një ditë e qetë, dëgjuam mbi xhade bataretë e mitralozave të një skuadre tankesh italiane. Na qëlluan me breshëri. Shumë shokë ranë. Nisën krismat edhe nga pas, nga shtëpitë e Gandezës. Na qëllonin nga të katër anët. U

dëgjua kënga e brigadës sonë aty mbi bregore. Filloi sulmi i kompanive të tjera. Përleshje trup me trup. Binin nga të katër anët me dhjetëra e me qindra. Një potere vdekjeprurëse! Një gjurulldi, sikur shembej planeti. Bomba, mitraloza, tanke, automatikë, ulërima, thirrje. Aty nga pasdrekja sikur u rralluan bataretë. Ne nuk dinim se ku ishin shokët e tjerë, nuk guxonim të lëviznim. Kur u err, nisëm të lëviznim dhe, duke ecur mbi kufoma, mbi shokë të plagosur, mbi armë të hedhura, kërkonim të lidheshim me ndonjë njësit tonin, po kudo heshtje varri, kufoma, të plagosur dhe armë pa zot ishte mbushur ai vend i ullishtes nën Gandezë, ku na qëlluan nga shpina. Thellë vinte jehonë beteje. Sa ishim? Pesë apo shtatë? Shtatë. Njëri pas tjetrit. Me pushkët pa fishekë. Vetëm me bajonetën dhe me një bombë. Pa fjalë. Ecnim drejt perëndimit, andej nga dëgjoheshin krisma lufte. Arritëm buzë një gremine. Nuk dukej gjë. Pus! Aty u ndalëm për të parë se ku ishim dhe ç'drejtim kishim. Sipas Yllit Polar ne po drejtoheshim nga perëndimi ose veriperëndimi, andej nga zbriste lumi Ebro. Na zuri gjumi. Ishim si të vdekur.

Dikush më zgjoi. Sa ishim? Shtatë veta! Po të tjerët? Eh, ç'Vaterlo! Pamë poshtë! Greminë nga nuk kalonte as dhija e as djalli vetë! Ç'të bënim? Dikush pa aty në fund disa njerëz që lëviznin. Dukeshin si miza. Ushtarë apo civilë? Kush e dinte! Fashistë apo shokët tanë? Kush e dinte! Nga t'ia mbanim? Të ktheheshim nga erdhëm: vdekja! Të zbrisnim në atë greminë: vdekja! Vendosëm të zbrisnim. Zvarriteshim me thonj e me dhëmbë. Njëri ra, ra! Dhe ulërima e tij therëse u përpi nga oshëtima e klithmës. Zbrisnim, zbrisnim. Dhe gjer në drekë ne zbritëm... gjashtë veta. As që kishim nge të shiheshim në sy. Vumë re se të tjerë zbrisnin nga jugu, të tjerë nga veriu. Ishin tanët! Ndoshta ata kishin mbetur nga batalioni dhe nga brigada.

U takuam me shumë të tjerë të shpartalluar të brigadave të tjera internacionale, që vinin nga jugu i Gandezës. Njëri prej tyre, francez, na tha që të bashkoheshim e të bënim një njësi me një komandë. U hodh një tjetër francez e tha: "Për ku do të na udhëheqë komanda: për në skëterrë apo për në parajsë? Ku do të na çoni më me ato aftësitë tuaja ushtarake? Na morët më qafë, na morët! Ç'oficerë jeni ju?!" Një tjetër tha: "Ne duhet të jemi të bashkuar për t'u mbrojtur! Sa të takohemi me shokët tanë!"

U bëmë nja pesëdhjetë veta, të gjithë të rraskapitur, prej të cilëve vetëm nja dhjetë i kishin mbajtur armët. Ecnim mbi një trase, rrëzë një lumi të vogël që derdhej në Ebro. Para nesh mal dhe një trase; para malit, një grumbull teneqesh, brenda të cilave dëgjohej blegërima e deleve. Hoqëm teneqetë. Ishte tunel, tunel plot me dhen që blegërinin. Një çoban na pa dhe e kuptoi se cilët ishim! "Mbaroi Republika! Mbaroi Republika!" - përsëriste. Disa nga shokët u shtrinë dhe nisën të pinin qumësht nga sisët e deleve. "Merrini ju! Nuk dua të m'i marrin fashistët! Prandaj i kam fshehur, nuk dua që edhe dhentë e mia të bëhen fashiste!" Ishte një bari i moshuar që gati po qante.

Ai na tha: "Fashistët i janë afruar Tortozës. Ju s'keni se nga shkoni andej poshtë. E mira është të hidheni në Katalonjë... Kapërceni Ebron dhe hidhuni matanë."

Si ta kalonim Ebron e gjerë e të rrëmbyer? Ai na tregoi se pak më poshtë ishte një va, nga mund të kalonim edhe me not, edhe më këmbë... Pritëm aty sa u err. Ai çoban i mirë kishte shkuar në fshatin e shkretë, kishte gjetur disa burra, të cilët na ndihmuan të hidhnim lumin dhe të arrinim në zonën e Feliksit. Kudo rrëmujë e panik: "Po vijnë fashistët! Mbaruam! Na tradhtoi Franca, na tradhtoi Blumi!" Nuk dëgjonim as radio. Nuk lexonim as shtypin. Disa nga fshatarët na njohën nga shenja e brigadave internacionale që mbanim, dhe shfrynin: "Ju

na morët në qafë!" Por disa të tjerë: "Ju hiqni të zitë e ullirit bashkë me ne! Ju jeni heronjtë e shekullit!" Pra: sharje dhe mburrje! Mallkime dhe urime! Ne heshtnim. Na jepnin dhe diçka për të ngrënë. Ata qëndronin grupe-grupe rrëzë ullinjve ose në korije, brinjave. Ne ecnim drejt veriut, drejt Pirenejve! Aeroplanët shkonin e vinin! Dëgjohej bubullima! Vazhdonin të bombardonin! Ende kishte zona të lira! Ende kishte gjymtyrë të gjalla të Republikës!

Ditë e natë në ecje mes rrëmujës dhe katastrofës, mes panikut dhe alarmit të përhershëm: "Mbaroi Republika! Vijnë fashistët! Mjerë ne!" E vërteta është se edhe ne ishim bërë një me këtë atmosferë dhe nuk mund të bënim asgjë. Objektivi ynë ishte të arrinim Pirenejtë dhe të hidheshim në Francë. Kishim vendosur të flisnim vetëm spanjisht. Dhe, duke ecur bashkoheshin me ne dhe ushtarë të tjerë të Republikës. Kishim caktuar një komandant nga Katalonja, që e njihte vendin. Ai ishte anarkist i tërbuar dhe kurdoherë përmendte emrin e Durutit. Thoshte se gjithë familjen e tij e kishte shfarosur fashizmi. Kërkonte hakmarrje. Po ja që edhe ky tani kërkonte të shpëtonte kokën bashkë me ne që endeshim monopateve, vetëm natën, se ditën na diktonte aviacioni fashist, që fluturonte në çdo minutë duke mitraluar shtëpi, makina, kafshë, njerëz...

Katalani anarkist hiqej i zoti dhe na thoshte se dëshironte të hidhej me ne në Francë për të vrarë Leon Blumin, që na tradhtoi.

Ne ishim njëqind e tetë veta: të parruar, të pangrënë, të zbathur. Dhe bënim shaka. Unë kërkoja të dija sa kombësi ishim. Pas shumë ditësh arrita të dija përbërjen e kompanisë sonë të dërrmuar nga lodhja: pesëdhjetë spanjollë, tridhjetë e pesë italianë, katër anglezë, një belg, dy jugosllavë, një grek, tre austriakë, dy amerikanë, tre polakë, dy argjentinas, tre skandinavë, një hungarez dhe unë, shqiptar.

Katalani anarkist ishte shumë i shkathët. Na gjente diçka për të ngrënë. Ne, të gjithë ato pesetas që kishim në xhep, ia dhamë atij, se ai dinte të blinte. Ecnim dhe nga ato që dëgjonim, mësonim se dhe Barcelona paskësh rënë. Pas dy javësh arritëm rrëzë Pirenejve. Duhej të ecnim natën, se thoshin që fashistët e kishin shtrënguar shumë kalimin. Ngjiteshim përmes pyjeve dhe shkurreve, andej nga nuk kalonte njeri. Dhe ja ku dolëm majë Pirenejve. Ishte muaji maj i vitit 1938. Aty ne kundronim botën e qetë! Dhe të gjithëve na hipi gjaku në kokë! Këtej kasaphanë, këtej fashizmi gjakoste Spanjën, andej Franca e qetë merrej me debate. Po ja që... U mblodhëm dhe të gjithë me sy të lagur kthyem fytyrën drejt atdheut tonë të ëndrrave dhe të luftës, drejt Spanjës. Tym e flakë!

Pyetje: - Kur ishit mbi Pirenej dhe shikonit botën e qetë që bënte debate dhe vallëzonte, ç'mendonit në ato çaste?

Përgjigje: - Të them të drejtën, m'u duk sikur kisha rënë nga retë e ndezura, ku jetova për rreth dy muaj, të fundit, me një ankth që rritej me progresion gjeometrik, për jetën e shokëve, që binin njëri pas tjetrit, sidomos në Kastuera dhe në Gandeza. Nuk e ndieja veten të gjallë e as normal. Me të parë nga veriu Francën e qetë, mendja më fluturoi te shokët: "Ç'bën Justina, a rron? Po Skënderi? Po Mania? Po Emrushi? Po Shabani? Po Ymeri, Dhimitër Kosta, Musa Fratari, Mehmet Shehu, Thimio Gogozoto, Faiku, Iljazi, Hulusiu, Veliu, Bimi? A rrojnë? Ku mbetën? - dhe më bëhej një lëmsh në fyt. - Vetëm unë shpëtova? Vetëm unë mbeta gjallë?"

Të tjerët këndonin. Sidomos italianët dhe amerikanët. Spanjollët qanin. Mbaj mend se komandanti anarkist tha: "Të kem një armë shfarosëse të tmerrshme dhe t'ia vërvit Evropës, që ta shuaj fare nga harta gjeografike! Lanë fashizmin të na zhdukë! Lanë Hitlerin,

Musolinin, Frankon, zotër të botës! Krimi më i madh i shekujve!"

Ndenjëm aty disa orë. Ishim ulur. Rrinim të heshtur. Dhe as që i kthenim sytë të shihnim njëri-tjetrin. Ç'ishim ne? Nga vinim ne? Ku shkonim ne? Pse mbetëm gjallë ne? Qetësia e Pirenejve prishej nga një erë maji që këndonte majave të pishave. "O burra, - tha një italian, - të këndojmë "Internacionalen", se revolucioni vazhdon! Venceremos!" Dhe nisi të këndonte. E pasuan dy a tre e pastaj të gjithë më këmbë këndonim "Internacionalen", me fytyrë drejt Spanjës e me lot në sy.

PAS SPANJËS ; ODISEJA VAZHDON

Pyetje: - Kur zbritët nga Pirenejtë, ku shkuat?

Përgjigje: - Dielli kishte rënë. Ne vështruam në sy njëri-tjetrin dhe aty u duk se nuk njiheshim më se kush ishim. Dukej sikur kishim dalë nga varri i Spanjës. Mbaj mend se ishte dita e trembëdhjetë që vetëm ujë pinim dhe hanim gjethe. Mua më caktuan të rrija pranë komandantit katalan, si komisar. Dhe aty për aty vendosëm që të mos mbanim me vete asnjë shkresë, përveç dokumenteve me identitetin tonë kombëtar. Unë grisa ato që mbaja ende në xhep. Dhe u vendos:

1. Të ecnim me disiplinë ushtarake!
2. Të mos tregonim asgjë nga betejat tona!
3. Të kërkonim shokët tanë që kishim në Paris, ata që kishin të drejtën, si amerikanë, belgjianë, skandinavë, të kërkonin përfaqësuesit e tyre në ambasada.

Dhe, njëshkolonë, nisëm zbritjen. Ecëm disa orë dhe ramë në disa vreshta. Një qen lehu! Pastaj u duk një vreshtar. Na thirri. U dukën vreshtarë të tjerë. Na thirrën. Erdhën dhe na përqafuan duke mallkuar fashizmin. Na rrethuan me fjalë të ngrohta dhe na ftuan të uleshim, që

të na gostitnin me ato që kishin: verë, bukë, kaçkavall. "Pini nga pak! Pini nga pak, more vëllezër!" Ata na thanë se lufta vazhdonte. Madridi luftonte! Barcelona gjithashtu. U habitëm. Pamë njëri-tjetrin në sy dhe sikur thoshim: a kthehemi përsëri? Po ku të shkonim ashtu siç ishim katandisur?

Pas pak na erdhën *gardes mobiles* (xhandarët) dhe na vunë përpara. Na shpunë në Lushon. Ne ecnim njëshkolonë, me kokën lart, me armët në sup, sikur parakalonim! Republika rronte! Lufta vazhdonte!

Na morën në pyetje një e nga një në zyrën e komisarit të policisë.

- Pse nderon me grusht? Ku je këtu? - më kërcënoi komisari.

- Këtu jam në Francë! Dhe nderoj me grusht! - i thashë.

Pastaj më pyeti për gjeneralitetet e mia. Ai më shikonte dhe më tha:

- Gazetar shqiptar në Spanjën e kuqe? - dhe diç tha nëpër dhëmbë.

Pastaj na shpunë në një si vathë, na mbyllën brenda pa na thënë asnjë fjalë. Pasdreke na erdhi përfaqësuesi i Republikës Spanjolle. Na shtrëngoi dorën të gjithëve dhe na tha se lufta vazhdonte me sukses. Ne iu lutëm që të bënte çmos që ne të ktheheshim përsëri në front. Ai na tha se ishte e pamundur të bëhej kjo. Na tha se ishin edhe qindra e mijëra të tjerë dhe i dërgonin në kampin e Gursit a të Vernes. Atje do të na dërgonin edhe ne. Pas disa ditësh erdhi komisioni i përbërë nga përfaqësuesi i Republikës, nga përfaqësuesi i Frankos, nga përfaqësuesi i Mosndërhyrjes, i autoriteteve franceze dhe të tjerë. Na vunë në rresht dhe i pari foli përfaqësuesi i Francës:

- Ata që janë për në zonën e Frankos, të dalin përpara!

Asnjë nuk doli. Ai përsëri tha:

- Ai që dëshiron të kthehet në Spanjën frankiste, le të bëjë disa hapa përpara!

Doli një spanjoll. Ai doli kokulur e pastaj u kthye nga ne:

- S'kam ç'të bëj! Kam lënë shtatë kalamaj dhe gruan pa njeri dhe nuk di në rrojnë apo jo! - Dhe nisi të qante.

- Ata që janë nga vendet me demokraci, si SHBA, Belgjikë, Angli, vendet skandinave, BRSS, le të bëjnë një hap përpara. Ata do t'i dorëzohen Komisionit të Mosndërhyrjes për ambasadat përkatëse. Ata mund të kthehen në vendet e tyre. Të tjerët...

Midis pjesëmarrësve të komisionit filloi një debat i zjarrtë. Ne qëndronim si të mpirë.

- Pse ju lejoni të kthehen nga ana e Frankos dhe nuk lejoni të kthehemi në atdheun tonë, në Republikën Spanjolle? - bërtiti një spanjoll. - Ç'janë këto padrejtësi që bëhen këtu në Francën e Frontit Populllor?

Pastaj thirrje nga të gjithë: "Rroftë Republika!"

Kjo skenë dramatike i tronditi anëtarët e Komisionit, që na shikonin sikur të kishim rënë nga një planet tjetër. Filloi edhe në mes tyre një debat i zjarrtë. Ishin mbledhur aty dhe burra e gra nga vendi. Dhe ata nisën të bërtisnin: *"Vive la Republique!* Janë njerëz, janë luftëtarë të lirisë; ata kanë luftuar për ne e për gjithë njerëzimin! Silluni mirë me ta!"

Ndërhynë xhandarët dhe e shpërndanë turmën që ulërinte.

Pasdreke na shpunë përsëri në vathë, përveç atij që kërkoi të kthehej në Spanjën frankiste. Pas pak edhe ai u kthye duke qarë:

- Nuk ndahem nga shokët! Nuk dua të ndahem nga shokët!

E kaluam natën aty, pa asnjë mbulesë.

Kënduam këngët tona. Shumë fshatarë vinin e na sillnin bukë e verë fshehurazi. Kishte edhe xhandarë që mbyllnin sytë e na ndihmonin. Aty ndenjëm disa ditë. Pastaj na ndanë. Ne, që nuk mund të ktheheshim në

atdheun tonë, se ishin qeveri fashiste dhe reaksionare, na ndanë mënjanë. Të tjerët do të niseshin për në ambasadat e vendeve të tyre.

Mua dhe shokët e tjerë na vizitoi përfaqësuesi i Republikës dhe na tha:

- Kush ka ndonjë mik a shok të vendit të tij, le t'i drejtohet atij. Ose le të drejtohet nga qendra që ju nisi për në Spanjë. Unë ju siguroj secilit nga një leje qëndrimi për 48 orë në Francë. Ju, (dhe na shkeli syrin duke na dhënë të kuptonim, se duhej ikur këtej me çdo kusht), nisuni për te shokët që ju përcollën kur u nisët për në luftë. Po ju jap edhe nga një mijë franga. Si mendoni?

Unë qeshë nga të parët që pranova. Pranuan edhe disa të tjerë. Mora lejen për 48 orë dhe një mijë franga, u përqafova me shokët dhe ika nga vatha ku ishim mbyllur si bagëtia.

Eca pak më këmbë, pastaj u ktheva në drejtim të një fshati. Aty më zuri nata. Ku të shkoja? Para kisha. Pyeta për hotel. Nuk kishte hotel. Gabova kur pyeta se ku e kishte qendrën Partia Komuniste. Një burrë më dëgjoi, i thashë hallin tim dhe ai më mori në shtëpi. Të gjithë më shikonin me keqardhje. Shanin qeverinë e Blumit, shanin socialistët dhe lëvdonin shumë brigadat internacionale. Më dhanë për të ngrënë e për të pirë. Një vajzë e re më shikonte me lot në sy. Nuk pranova të flija atje. (Isha i mbushur me morra.) Mora leje dhe u largova natën. Pashë aty në një arë një karro. Shkova drejt saj dhe u shtriva nën të ashtu siç isha, i këputur më shumë nga mendimet sesa nga vuajtjet fizike. Dhe kushedi se kur do të isha zgjuar, por një zë, një "*camarade*!" më zgjoi. Pashë pranë meje atë vashë që në darkë më shikonte me ata sy të mëdhenj, aty në shtëpinë e saj, kur haja dhe pija si... si ai që sapo kishte dalë nga varri! E pashë dhe u habita. Kaluan çaste, gjersa u përmenda. Ku e kisha parë unë atë vashë, ata sy? Po! Atje... atje... larg...

larg... në kontinentin e Atlanditës... shumë shekuj më parë... në Albacete, në *Kuintanar de la Republica*... Po, e quanin Anita Gonzales Seto!

- Si të quajnë, Anita?

- Jo, më quajnë Denizë! Po ty si të quajnë?

- Mua më quanin njëherë e një kohë Pedro, kurse tani nuk kam as emër as kombësi e as...

- Jo! - thirri ajo. - Ju jeni luftëtar i brigadave internacionale dhe keni një emër, emrin më të bukur të shekullit "Vullnetar i lirisë"!

Nuk e kisha vënë re batanijen që më mbulonte.

- Këtu të kam ndenjur, pranë, qysh kur ike nga shtëpia jonë. Dhe kam kënduar këngë të bukura për ty, që të shikoje ëndrra të këndshme!... *Pedro! Mon cheri!*

- Denizë!

- *Pedro, mon cheri!*

Dhe m'u afrua e më puthi. E pastaj qau.

U ngrita. Ajo më shoqëroi gjer në stacion të trenit. Kur u ndamë, më dha një zarf të vogël.

- Mos e hap tani, - më tha, - hape kur të jesh larg meje! - dhe më pushtoi fort. Treni u nis. Unë jetoja si në ëndërr!

Denizë, Denizë! Me ata sy të mëdhenj e me atë trup të brishtë! E hapa zarfin. Një letërz dhe katërqind franga. *"Janë kursimet e mia personale. Kujtoje Denizën kudo që të jesh! Do të jetojë me shikimin e syve të tu të trishtuar, por të dashur, plot ndjenja fisnike..."*

Pyetje: - Vetëm u nise, apo edhe me shokë të tjerë internacionalistë?

Përgjigje: - Nuk isha vetëm. Si shqiptar, isha vetëm, por kishte dhe disa të tjerë që shkonin në ambasadat e tyre në Paris. Unë nuk do të shkoja drejt e në Paris, nga u nisa. Më duhej të dija se si qëndronte puna me shokët shqiptarë që më përcollën për në Spanjë. Fjalën e kam për Llazar Fundon dhe Ali Kelmendin, pasi kishim dë-

gjuar sikur ata kishin tradhtuar, kështu që unë do të qëndroja një natë në Lion, për të marrë vesh nga shokët e atjeshëm se si qëndronte e vërteta dhe ku duhej të shkoja.

Qëndrova në Lion dhe u drejtova për te *"Rue Montebello"* nr. 8, aty ku dërguam dhe revistën "Vullnetari i lirisë". Aty gjeta Gaqo Dishnicën, Dhori Samsurin, Ilo Shahinin, të cilët më pritën me ngrohtësi. Gaqoja më dha një kostum të tij. Teshat e mia gjithë morra, të bëra zhele, në mëngjes i hodha me shumë keqardhje në lumin Ronë. U rrova, u lava dhe zura vend në një hotel. Erdhën edhe shokë të tjerë. Pastaj shkova në shtëpinë e Sokrat Nushit, ku më pritën me dashuri. Valideja (Athinaja), e shoqja, më puthte sikur të më kishte djalin e saj. Më bëri për të ngrënë si në fshat: fasule me vaj, ullinj, kulaç të ngrohtë, sallatë. Aty ishin dhe djemtë e vashat: Sanoja, Liloja, Kozmai, Gogoja dhe Ksenofoni. Aty hynin e dilnin si në shtëpinë e tyre Halim Xhelo, Qamil Çela e të tjerë. Erdhën dhe shumë shokë të tjerë shqiptarë (sidomos studentë) e më pyesnin për vullnetarët shqiptarë e për situatën atje. Unë nuk u thashë të vërtetën për situatën, ndonëse ata e dinin fare mirë. U thashë se do të veja në Paris dhe përsëri do të kthehesha në Barcelonë. Aty mësova se Fundoja paskësh tradhtuar, kurse Ali Kelmendi ishte tashmë përgjegjësi i grupit shqiptar.

Pyetje: - A të kujtohet ndonjë ndodhi me rëndësi nga qëndrimi në Lion?

Përgjigje: - Ndodhia më e rëndësishme ka qenë hedhja e teshave të mia në lumin Ronë. Ishte uniforma e vullnetarit të lirisë, teshat që mbanin vulën e tragjedisë sime dhe të popullit spanjoll. I mbështolla mirë, i mbulova me një gazetë dhe, kur i hodha në lumin e gjerë, i ndoqa me sy, ndërsa fundoseshin, dhe pastaj, kur dilnin mbi ujë dhe rrokulliseshin si në dërstil për t'u larë nga mundimet. Ato ikën e ikën, gjersa u zhdukën nga sytë e mi dhe unë rrija aty e i vështroja...

Një ndodhi tjetër: Kur ndërrova teshat dhe u rrova, shokët më shpunë në një hotel të vogël - nuk mbaj mend se si quhej - që ndodhej në sheshin kryesor, ku ishte dhe kafeneja *"La Cycogne"*, ku mblidheshin shqiptarët. Bëra një dush, pastaj rashë për të fjetur. Gjumi më zuri menjëherë në atë shtrat të butë, me pupla dhe me çarçafë të bardhë dëborë. Ëndërroja sikur isha në Madrid. Bëhej luftë. Ne ishim në një ndërtesë të Qytetit Universitar, në katin e tretë dhe qëllonim me mitraloz, vërshonin dallgët e sulmeve marokene, kur u dëgjua një zë i fuqishëm: "Dilni, se ndërtesa është minuar, tani pëlcasin minat!" U dëgjua një shpërthim i madh dhe ndërtesa po vaisej e po vaisej e tëra. Unë brofa nga shtrati i butë dhe u gjenda pranë dritares. Theva me kokë xhamat, u preva në faqe dhe gjaku buisi. Shikoj përjashta: dritë, dritë e fuqishme, trame, vetura, njerëz që shëtitnin, dhe muzikë e muzikë që përhapej e përhapej. U çmenda! Ku jam këtu? Kur dëgjoj pas meje:"*Camarade, voulez vous quelque chose?*"[1] Ktheva sytë dhe pashë kamerierin. Kaluan shumë çaste sa të vija në vete. Në mëngjes erdhën shokët e mi dhe më panë. Më pyetën se çfarë dëshiroja, por unë nuk u thashë atë që më erdhi në majë të gjuhës t'u thosha: "Spanja digjet, kurse ju këtu vallëzoni dhe e hiqni veten si komunistë! E si mund t'ju quaj..."

Para se të nisesha për në Paris, u ktheva dhe një herë te Sokrat Nushi. Ai nuk fliste. Më shikonte dhe tundte kokën, kurse Valideja më shtroi për të ngrënë. Biseduam rreth situatës dhe ata kërkonin të më qetësonin e të më merrnin me të mirë. U ndava nga ata dhe nga disa shokë që më përcollën për në stacion të trenit. Këtu unë u revoltova shumë, pa e treguar me fjalë, me disa shokë shqiptarë që hiqeshin si komunistë të flaktë. Pse nuk erdhën dhe ata në Spanjë? Kush i nda-

1) Shok, dëshironi ndonjë gjë?

lonte? Apo kufizoheshin me "teori" dhe me "lëmosha"? Nejse! M'u kujtuan fjalët e Luixhi Longos, aty në Albacete, kur i tha Pavaninit t'i përgjigjej shkresës që kishte ardhur nga shokët e Parisit për mua.

Pyetje: - Kur shkuat në Paris, me kë u takuat?

Përgjigje: - Unë shkova drejt e në hotel "*Belville*", nga u nisa. Aty pashë shumë shokë të tjerë të kombësive të ndryshme që kishin dalë nga Spanja si unë, të shpartalluar, nga Pirenejtë. Njoha disa prej tyre. Dhe qanim hallet tona. Ç'do të bënim tani? Ata më thanë të shkoja drejt e te Roberti, *"Rue Combat"*, nr. 8. Por unë duhej të takohesha sa më parë me Ali Kelmendin. E kërkova në lokalet ku mblidhe-shin shqiptarët, të cilët, sapo më shihnin, më përqafonin, më përqafonin me zemër dhe më pyesnin për shqiptarët e tjerë: kush ishte vrarë e kush ishte gjallë. Bedri Pejani më shoqëroi për te lokali ku do të takoja Aliun. Sapo hymë brenda, Bedriu u tha: "Puna mbarë, o luftëtarë të lirisë!" Aty, në një tryezë, ishin Aliu, Ymer Dishnica, djali i Ismail Qemalit dhe Muharrem Bajraktari. Ata, me të më parë, lanë letrat dhe u ngritën për të më përqafuar. Vetëm Aliu nuk i la letrat dhe as që e kthente fytyrën për të më parë, (sigurisht përgjigjja që i kishte kthyer Luixhi Longo, mendova.) Unë u ndeza më shumë dhe i bërtita: "Të kërkoj, prandaj ngrihu dhe eja shpejt me mua! Lëri letrat dhe eja me mua.."! Ai u ngrit dhe më buzëqeshi me ironi. Ata m'u lutën të rrija të pija diçka, por unë i falënderova. Me ne erdhi edhe Babushi (Bedri Pejani), i cili e qortoi shumë Aliun për qëndrimin që mbajti ndaj meje.

Shkëmbyem fjalë plot zemërim, sidomos unë, që u revoltova shumë me atë qëndrim të tij. Ai pothuaj nuk fliste fare. I kërkova llogari për paratë që merrte për ne nga Ndihma e Kuqe Internacionale, e cila ndihmonte ata vullnetarë që kishin lënë familjet keq e mos më keq. Paratë i merrte Aliu për shumë familje të shokëve tanë

ne duhej t'i dërgonte patjetër në Shqipëri, te familjet ɔna. Ai m'u përgjigj se paratë i dërgonte në Shqipëri, te Mustafa Gjinishi. Unë i thashë se me ato para luante umar në Paris. Duke u grindur kështu, arritëm te zyrat Robertit, pasi unë për atje isha nisur dhe doja të shkoim bashkë. Roberti (përgjegjësi i seksionit ballkanik të Kominternit), sapo më pa, më përqafoi dhe më qortoi që isha tri ditë në Paris dhe nuk isha dukur fare nga ɛndra. I thashë se kisha kërkuar Aliun, të cilin mezi e jeta, dhe se ai (Aliu) nuk deshi të më shoqëronte fare. E ɪuptoi që isha nxehur shumë. Aliu filloi të fliste serbisht ne të. Po Roberti i tha të flisnin frëngjisht, pasi unë nuk ɛ dija gjuhën serbe. Më tha se ishte shumë i shqetësuar lhe shtoi:

- Tani për tani do të rrish në hotel "*Belville.*" Po të ap dhe ca të holla dhe një valixhe me ndërresa dhe me ɜende të tjera që të duhen (valixhja kishte një kostum gri, një palë këpucë, dy këmishë dhe deri te makina e rrojës). Më tha se duhet të pajtohesha me Aliun, se ai ishte tani përgjegjës i grupit shqiptar. Më porositi gjithashtu t'i bëja një relacion të hollësishëm për veprimtarinë time në Spanjë, si dhe për shokët e për ngjarjet e luftës.

Ishte problem i madh çështja e vullnetarëve që kishin mbetur gjallë e që ishin nga vendet ku nuk mund të ktheheshin, si p.sh. ne, jugosllavët, grekët, bullgarët, rumunët, hungarezët, polakët e të tjerë. Por ata kishin partitë e tyre, që interesoheshin për ta, kurse ne nuk kishim parti. Asnjë nuk interesohej për ne. Shkoja shpesh te Roberti dhe i isha lutur të shkoja në Bashkimin Sovjetik. Ai pas disa ditësh më tha se në Bashkimin Sovjetik mund të shkonin vetëm udhëheqësit..

U mendova dhe u mendova: "Ne pesë shqiptarë jemi! Cili do të dalë i gjallë nga shokët që ende luftojnë?" Isha lidhur shumë me ta dhe desha të kisha edhe unë fatin e

tyre. Ndarja prej tyre për mua ishte si vdekja. Mendova: "Duhet të jem pranë shokëve. Do t'i pres këtu ata që kanë mbetur gjallë." Atëherë Roberti më tha të shkoja përkohësisht në universitet. Ata më përgatitën dokumentet e duhura dhe unë shkova në *"Cite Universitaire"*, në dhomën e Ptoleme Xhuvanit, të cilin e njoha ato ditë në Paris. Ai banonte në ndërtesën e bukur të *"Fondation anglo-americaine."* Jetë studentore shumë komode, në dhomën e tij me dy shtretër, në katin e parë. Aty flija. Haja në mensën e studentëve. Me Ptolemeun u bëmë shumë shpejt shokë të mirë. Ishte një tip i kristaltë, që ndillte besim. Atij i vinte keq për mua dhe bënte ç'ishte e mundur të më qetësonte dhe të më mbante pranë si shok të ngushtë. Ai shoqërohej dhe me Fundon, të cilin prej kohësh nuk e kisha parë, por një pasdreke, në kafenenë *"La source"*, ku mblidheshin shumë emigrantë politikë shqiptarë, Fundoja m'u afrua. E pa që i ndenja ftohtë dhe më tha: "Unë nuk bëra asgjë. Tani mbetet puna te ju. Unë nuk do të jem kurrë kundërshtari juaj." Me dëshirën e Ptolemeut, ai na shpuri të shihnim një film. Dhe ç'pamë? Filmin "Apres", një vepër e Erih Maria Remarkut: Ktheheshin nga lufta shokët e një shkolle që ishin bashkë në front. Njëri prej tyre shkonte me nxitim tek e fejuara. Nuk e gjeti në shtëpi. I thanë se ku mund ta gjente, në një lokal dëfrimesh të shfrenuara. E gjeti në prehrin e një tregtari verërash. Nxori revolverin dhe e vrau tregtarin. E gjykuan. Ai tha: "Unë vrava njerëz që nuk më kishin bërë asgjë të keqe. Ju më mësuat të vras. Pse të mos vrisja një krimb, një shushunjë, një njeri që më kishte marrë të fejuarën time?!", - e të tjera e të tjera. U habita! Pse Fundoja më shpuri të shihja atë film, në gjendjen shpirtërore në të cilën isha unë?! Kishte një qëllim: "Ja se si mbarojnë luftërat! Ja se si mbarove edhe ti!"

E vërteta është se unë quhesha student, po nuk

frekuentoja asnjë kurs. Kursi im ishte shqetësimi për shokët që ende luftonin, për situatën e vështirë, për rrugën time. Haja dhe flija në "*Cite Universitaire*", po gjithë ditën takohesha me shokë shqiptarë dhe të huaj. Të gjithë kishin njëfarë respekti dhe dashurie për vullnetarët e Spanjës.

Në Port Sent Antuan kishte shumë punëtorë shqiptarë. Aty ishte dhe Shamet Brataj, njëfarë Rakip ose Meleq nga Kanina, shokë të ngushtë të Halim Xhelos. Ata më mbanin aty. Aty njoha dhe Thanas Çamin, dajën e Thimio Gogozotos, i cili më shoqëronte kudo. Më shpuri dhe te disa kushërinj të mi: Vasil Spiro dhe Andrea Kuçuli, vëllezër, që jetonin në Paris. I dyti ishte komunist. I pari socialist. Ata banonin aty me familjet e tyre. Njoha aty në Paris njerëz që ua kisha dëgjuar emrin: Beqir Valterin, Ali Këlcyrën, Qazim Koculin, Rexhep Mitrovicën, Kolë Tromarën, Angjelin Sumën e të tjerë. Të gjithë silleshin mirë me mua. Me Babushin takohesha më shpesh. Ky me të gjithë grindej dhe të gjithë i shante. Më shumë grindej me Aliun, të cilin e quante xhandar.

Pyetje: - A mund të na japësh një ide për jetën dhe veprimtarinë e shqiptarëve që banonin në Paris, sidomos të politikanëve të dëgjuar?

Përgjigje: - Është mirë të kemi një ide për jetën dhe veprimtarinë e emigrantëve shqiptarë në Paris. Unë nuk do të zgjatem shumë. Në Paris jetonte pjesa më e rëndësishme e kundërshtarëve të Zogut: Qazim Koculi, Ali Këlcyra, Aziz Çami, Kolë Tromara, Rexhep Mitrovica, Angjelin Suma, Beqir Valteri. Flitej se këta subvencionoheshin nga Beogradi, kurse Qazim Mulleti e disa të tjerë thuhej se subvencionoheshin nga Roma. Mustafa Kruja, që ishte i grupit të Zarës, domethënë që varej nga Roma, jetonte në Zvicër, por vinte shpesh në Paris.

Që nga vitet 1935 e 1936 të gjitha rrymat antizogiste kishin krijuar një front të përbashkët kundër regjimit të Zogut. Halimi na kishte njoftuar në Shqipëri dhe na

kishte dërguar shumë materiale, ku flitej edhe për krijimin e këtij fronti. Këta emigrantë e kalonin kohën në lokalet: *"La source"*, *"La coupole"*, duke bërë politikë. Në Gjenevë të Zvicrës botohej "Liria kombëtare", që e drejtonte Dr. Omer Nishani, po në të vërtetë nga Kominterni ishte caktuar Halim Xheloja ta drejtonte. Kjo gazetë ka bërë një punë të madhe. Kur isha unë në Paris, kjo gazetë nuk dilte më, sidomos që nga vdekja e Halimit. Nga ana jonë ishin Ali Kelmendi dhe Loro Brahimi. Babushi (Bedri Pejani) ishte me grupin tonë, por i paorganizuar.

Këta përditë rrinin bashkë dhe bënin një jetë sedentare, madje nuk lexonin as shtypin, përveç disave, si Ali Këlcyra, Beqir Valteri, Rexhep Mitrovica. Me mua silleshin mirë të gjithë dhe të gjithë më kishin marrë për drekë ose për darkë. I vetmi që tallej me të gjithë ishte Llazar Fundoja, i cili shquhej për zgjuarsi dhe kulturë. Studentët shqiptarë takoheshin shpesh me të gjithë në lokalet që përmenda më lart. Këta politikanë ëndërronin që Zogun ta hiqnin Fuqitë e Mëdha, ashtu siç e sollën në fuqi, dhe pastaj këta të ktheheshin në Shqipëri e të ishin në krye të qeverisë, të pushtetit (në dispozicion të Fuqive të Mëdha që kishin interesa në Shqipëri).

Kishin afro pesëmbëdhjetë vjet kafeneve, duke u atrofizuar e ndryshkur; mbanin disa lidhje me miqtë e tyre në Shqipëri, me të cilët merreshin vesh. Beogradi kishte agjentët e vet, Roma gjithashtu, po kështu edhe Athina e me radhë.

Mirëpo ngjarjet morën tjetër drejtim, sidomos pas Munihut. Kur shkoi Konti Çiano në Beograd, në vjeshtën e 1938-s, dhe u takua me Stojadinoviçin, midis marrëveshjeve të shumta që bënë, ishte dhe kjo: Jugosllavia t'ua priste subvencionin emigrantëve shqiptarë! Dhe Jugosllavia nuk i ndihmoi më emigrantët shqiptarë që ajo mbante qysh nga viti 1924. Kështu që këta shkonin

në Paris të merrnin rrogat, por nuk ua jepnin. Kaluan muaj e ata mbetën pa një lek në xhep. U shqetësuan. Si do të jetonin tani e tutje? Aty nga shkurti i 1939-s dikush erdhi nga Roma me miliona lireta me vete dhe u tha krerëve që paguheshin dikur nga Beogradi: "Para kemi boll. Na dha Roma miliona. Roma do të na ndihmojë për të rrëzuar Zogun nga fuqia dhe për t'u kthyer në atdhe në krye të qeverisë, po me ndihmën ushtarake të Musolinit. Me të përzënë Zogun, ne do të jemi në krye të pushtetit të ri. Pranoni?" Dhe sigurisht që pranuan. Ndanë milionat dhe u bënë më të gjallë se më parë. Tani sytë dhe shpresat i kthyen nga Roma. Kështu qarkulloi fjala mes shqiptarëve.

Pyetje: - Sa qëndrove në Paris? Po pastaj ku shkove?

Përgjigje: - Shkoja shpesh te Roberti dhe aty informohesha mirë për situatën. Në Spanjë ende bëhej luftë e madhe. Shokë të tjerë vinin dhe shpërndaheshin sipas drejtimeve që u jepte Roberti. Shtypi francez informonte përditë rreth zhvillimit të ngjarjeve në Spanjë dhe në botë. Pritej me ditë rënia e Madridit, po ja që *nuk binte*. Aty luftohej me ashpërsi nga të dyja anët. Gjermanët gjatë Luftës së Spanjës morën Renaninë, Austrinë, pjesë të Çekosllovakisë (sudetët). Tension i madh në Evropë. Fashizmi ishte në ofensivë.

Një ditë Roberti më tha:

- E mira është të shkosh në Grënobël, se aty ka shumë studentë shqiptarë. - Menjëherë pranova.

Pyetje: - S'të ndodhi ndonjë gjë e veçantë në Parisin e famshëm?

Përgjigje: - Një mëngjes, kur isha duke dalë nga *Cite Universitaire*, sapo u afrova në shëtitore, u ndal një veturë e madhe e kuqe, e zbuluar. Në timon ishte një deli vajzë. Ma bëri me shenjë të hipja. Ajo e hapi vetë derën dhe unë, i hutuar, i thashë se mos e kishte gabim. "Jo, - tha ajo,- do të zbrisni në Paris, urdhëroni brenda". Hipa.

Ajo mbylli derën dhe më hodhi një shikim pakëz të dyshimtë, duke më thënë: "Ku do të shkoni?" Në "*La coupolle*," në Montparnas!" - i thashë...

Makina shkiste ngadalë. Unë hera-herës ktheja sytë dhe shihja profilin e saj. Isha i bindur se ajo do të ishte ndonjë studente e pasur që dilte nga *Cite Universitaire* dhe shkonte për në Paris. Po, duke i vërejtur profilin, nuk m'u duk e sinqertë. Kishte diçka të frikshme në shprehjen e syve. E pashë që ajo nuk shkonte nga Montparnasi, por drejtohej jashtë Parisit. Atëherë unë futa dorën në xhepin e pantallonave, nxora një monedhë njëzetfrangëshe (të vetmen monedhë që kisha) dhe ia tregova duke i thënë: "Unë vetëm këto kam, ju më shpini ku të doni!" Ajo më buzëqeshi me ironi. E pashë që u vrenjt dhe pastaj e ktheu makinën në rrugën drejt Montparnasit. Kur u afrua makina te "*La Coupolle*", ajo hapi derën dhe më tha: "Shkoni brenda, sa të rregulloj makinën, pastaj vij edhe unë!" Unë hyra në "*La Coupolle*", një kafe shumë luksoze, gjithë drita e pasqyra të mëdha. Gjeta një tryezë të lirë dhe u ula. Vështrova nga vendi i zakonshëm ku uleshin shqiptarët, dhe aty dallova Ali Kelmendin me disa të tjerë të njohur. Ata më panë dhe ma bënë me dorë të shkoja tek ata, por unë ua bëra me shenjë të prisnin edhe pak. Pas pak erdhi kamerieri me tabakanë në dorë, mbi të cilën ishte një zarf i vogël pa asnjë shkrim. "Është për ju", - më tha tërë delikatesë. I habitur, e mora zarfin e vogël, e hapa dhe lexova: "*Puisque vous etez sincere, vous etes sauvé*!"[1] U habita. Dhe me atë kartëvizitë pa emër në dorë shkova te shokët. U thashë se ç'më kishte ngjarë, dhe u tregova edhe kartëvizitën. Ata qeshën dhe më thanë se paskësha shpëtuar mirë. Më treguan se kishte banda që rrëmbenin njerëz, i shpinin në qendrat e tyre, aty i zhvishnin, i rrihnin, u merrnin ç'kishin e ç'nuk kishin, pastaj edhe i vrisnin e i

1) Meqenëse jeni i sinqertë, keni shpëtuar.

hidhnin në lumin e Senës. Më thanë se mund të më kishte marrë për ndonjë maharaxha, se dola dhe nga Fondacioni i anglo-amerikanëve, ku rrinin djemtë e pasanikëve kolonialistë.

Qeshte Aliu, e më shumë Beqir Valteri, të cilit ato ditë i kishte ngjarë gjithashtu diçka tragjikomike! Po e them me dy fjalë: Beqiri ishte simpatik. Me mjekër të zezë, të prerë sipas modës, ezmer, i veshur elegant, gjithnjë me një defter ku shënonte planet e bashkimit të Ballkanit; kishte bërë edhe flamurin e Ballkanit të bashkuar. Më kishte ftuar për drekë. Banonte në hotel "*Monsieur le Prince*" me të shoqen dhe dy vajzat. Aty banonte dhe Alfred Ashiku. Aty, kur një femër të shihte disa herë, të jepte të kuptoje se dëshironte të të njihte. Edhe Beqirin e pa disa herë një femër e bukur. Ky e vuri re që ajo u ngrit dhe zbriti në tualet. Edhe Beqiri u ngrit e zbriti aty. Shokët shqiptarë thanë: "E kapi Beqoja!" Po Beqiri u kthye shumë i mërzitur. E panë shokët shqiptarë dhe e ngacmuan: "E rregullove me të?" Beqiri u skuq dhe tha: "Jo!" Dhe tregoi skenën: Ajo i kishte dhënë dorën, ia kishte shtrënguar duke i thënë dhe emrin e saj (siç e kërkonte mirësjellja). Edhe Beqiri ia kishte shtrënguar fort dorën dhe kishte dashur t'i thoshte emrin e tij. Por i merrej shumë goja dhe kishte filluar: BBBBB... BBBBB...BBB për disa çaste. Ajo ia kishte lëshuar dorën dhe, e mërzitur, i kishte thënë: "Ma thoni nesër emrin tuaj", - dhe kishte ikur. Ky episod u përhap në rrethet shqiptare dhe disa madje edhe e stërzmadhonin.

NË GRËNOBËL

Ku ndodhën shumë ngjarje historike

Pyetje: - Me ç'gjendje shpirtërore u largove nga Parisi?

Përgjigje: - Të them të drejtën, gjithë qenia ime, mendimet dhe shqetësimet e mia përmblidheshin në një: fati i shokëve të Spanjës dhe i jetës sime. Me shokët e mirë që pata në Paris, sidomos me Ptoleme Xhuvanin, me të cilin kalova ditë të mira, u ndava me mall.

Roberti më dha lidhjen e partisë me seksionin e Izerës dhe më dha shumë porosi. Kur erdhi aty edhe Aliu, i thashë Robertit se në Grënobël, pasi kishte shumë studentë shqiptarë, mund të botonim ndonjë gazetë shqip. Aliu u hodh e tha: "Do të mendojmë ne për atë" - dhe, nga frika se mos e bënim ne këtë, ai shpejtoi dhe urdhëroi Qamil Çelën, i cili ishte në Lion, që të botonin aty ndonjë gazetë në gjuhën shqipe, pasi ishte mbyllur "Liria kombëtare". Dhe Qamili, duke u marrë vesh aty në Lion me shokët tanë dhe sidomos me Gogo dhe Kozma Nushin, nxorën "Sazanin".

Pyetje: - Kur shkove në Grënobël, me kë u takove?

Përgjigje: - I pari me të cilin u takova, qe Dhimitër Shuteriqi, i cili më kishte shkruar disa letra, që të veja aty. Më priti mirë dhe si dy vëllezër të mirë banonim bashkë, në dhomën e tij, ku më parë më duket se kishte banuar dhe Gebelsi ose Von Ribentropi. Dhimitri nuk më linte të paguaja për asgjë. Unë merrja 400 franga në muaj nga Ndihma e Kuqe Internacionale. U paraqita në seksionin e partisë, ku më pritën menjëherë dhe më pyetën nëse kisha nevojë për ndonjë gjë. Më lidhën me celulën *"Tres cloittre"*, pasi ishte në lagjen ku do të punoja si kamerier në "*Cope*" (një restorant i studentëve laikë, përkrahur dhe udhëhequr nga partia). Ata më regjistruan në universitet, në degën histori arti, që të isha në rregull

me policinë, dhe më ngarkuan të merresha me studentët. Aty, në fakultetin e Grënoblës më shumë ishin të huaj se studentë francezë. Kishte djem e vajza nga të gjitha anët e botës, shumica e të cilëve studionin në këto degë: inxhinieri hidroelektrike, letërsi, drejtësi.

Pyetje: - A i mban mend shokët shqiptarë që studionin aty në Grënobël?

Përgjigje: - Dhimitër Shuteriqi, Mahir Domi, Petrit Dishnica, Bilbil Klosi, Petrit Dakli, Petrit Merlika, Ilo Shahini, Ferdinand Pici, Manush Haliti, Alqi Nushi (nga Berati) Dario Arditi (çifut nga Shkodra ose nga Durrësi), Druga (nga Durrësi), Petraq Qafoku.

Nga punëtorët, ishte familja e Miltiadh Kasnecit (Koka) nga Vunoi, që banonte në një shtëpi të vogël, bashkë me të shoqen, Katerinën. Të gjithë këta më deshën dhe i desha, sidomos Katerina dhe Milto Koka, që më trajtuan si djalin e tyre.

Fillova nga puna në restorantin e studentëve laikë, aty në *"Rue Bayard"*, 10. Herën e parë më vunë të laja ten-xheret dhe tepsitë, pastaj të laja gota, pjata, pirunë e thika, pastaj më vunë të ndaja gjellën e më në fund jashtë në sallë, si kamerier.

Pyetje: - Si thua, nuk është më mirë që jetën tënde në Grënobël ta ndash në tri pjesë: politike, shoqërore, intime, të na tregosh ç'ishte kooperativa e studentëve dhe veprimtarinë e çdo studenti shqiptar?

Përgjigje: - Shumë mirë. Pra fillojmë me radhë...

Ç'ishte kooperativa e studentëve laikë?

Partia kishte krijuar një restorant, në formë kooperative, për të mbledhur studentët laikë, sidomos të huajt, se aty kishte shumë të tillë: studentë të pasur, që vinin nga Amerika, Anglia, shtetet nordike, Holanda, Turqia e të tjera, por shumica ishin studentë të varfër, sidomos çifutë nga Polonia, Çekosllovakia, Austria, vendet baltike.

Për këta të fundit, që ishin shumica antifashistë, u krijua kooperativa, e cila, përveç restorantit që frekuentohej edhe nga cilido që dëshironte të hante aty, pasi çmimet e gjellëve ishin shumë të ulëta: të haje një drekë pa mish, paguaje tri franga, me mish, pesë franga; ishin pesë gjellë, dhe buka gratis, kishte dhe veprimtari të shumta, shoqërore e politike. Shumica e studentëve anonte nga komunizmi; kishte aty pa parti, kishte filotrockistë, socialistë, të gjithë antifashistë. Pjesa më aktive e anëtarëve të "*Cope*"-së ishin nga Polonia, të gjithë çifutë dhe të zotë, shumica prej të cilëve studionin inxhinieri hidroelektrike, se në Alpet kishte shumë barazhe dhe Grënobli kishte një fakultet të dëgjuar për këtë degë.

Grënobli ishte një qytet shumë i pastër. Kishte një industri të zhvilluar dhe shumë punëtorë, sidomos të huaj. Biçikletat ishin të shumta. Alpet ishin afër dhe shumë qendra për ski mblidhnin rininë e botës. "*Cole de Porte*" ishte qendra për skiatorë e kooperativës sonë. Aty ne kishin dhe një "*Auberge de la jeunesse*"[1], të cilat ishin hotele të vogla laike të drejtuara nga partia. Në këto "*Auberges de la jeunesse*", të rinjtë që vinin nga gjithë anët e Evropës, gjenin strehim dhe ne bënim punën tonë propagandistike revolucionare. Edhe mua më caktuan një herë "*pere*" (baba) në një nga këto "*auberges*". Nga ajo periudhë kam shumë kujtime të pastra si bora, si rinia e pastër që vinte aty, djem e vajza, me edukatë dhe me karakter. Do të përmend disa episode të paharruara.

Komiteti drejtues i kooperativës kishte dhe një aparat për filma pa zë. Disa shokë xhironin ngjarje të jetës sonë dhe çdo të shtunë në darkë i shfaqnin në një nga sallat e restorantit. Po përmend një:

Në "*auberge*", aty në "*Cole de Porte*", nuk kishte tualet dhe u ndërtua një pranë ndërtesës. Më thanë që ta përu-

1) Hoteli i rinisë.

roja unë, si *pere oberzhist*, dhe unë vajta duke qeshur... Dera ishte gjysmë e hapur. Zbërtheva pantallonat, pastaj dola, këputa një degë pishe dhe me dëborë spërkata duke bekuar derën e nevojtores. Atë skenë e kishin filmuar dhe e shfaqën në restorant.

Në "*Cope*" organizohej dy herë në javë ballo. Zgjidheshin vajzat më simpatike, që të kërcenin me meshkujt e shëmtuar ose të mjerë. Zgjidheshin djemtë më simpatikë, që të kërcenin me vajzat ose gratë jo të bukura, me qëllim që zbavitja të ishte kolektive, të gjithë të gëzoheshin. Aty mësonim të këndonim këngët e rinisë, sidomos ato të Kuturiesë, i cili kishte krijuar shumë këngë për rininë. Atmosfera duhej të ishte kurdoherë rinore, e gëzuar, optimiste. Pol Vajan Kuturie ishte më i parapëlqyeri. Aty ishte dhe një poet i ri francez, që banonte afër Grënoblit. Më dukej i mirë dhe quhej Zhak Loran. (Ai u vra nga gjermanët.)

Unë te "*Cope*"-ja shikoja frymën e rinisë antifashiste, shokë e shoqe me karakter dhe me dashuri për njëri-tjetrin. Aty hanin bukë dhe shumë shokë italianë, nga ata që kishin ikur nga Italia dhe punonin në Izerë. Njëri prej tyre ishte nga Firencja dhe, kur erdhi në Grënobël S.C., që kishte simpati për mua (ajo studionte në Firence, ku ishte dhe Qemal Stafa), ai shok italian i dha një letër, që Qemali të lidhej me shokët italianë në Firence. I dha dhe shumë materiale propagandistike, të futura në një kukull të madhe.

Ne shqiptarët fituam simpatinë e të gjithëve, sidomos pas 7 prillit 1939. Aty në kooperativë nisën të punonin edhe Dhimitër Shuteriqi, Bilbil Klosi, Petrit Dishnica, si kamerierë, pasi nuk merrnin më para nga familjet e tyre.

Si gjithë vullnetarët e Spanjës, që nderoheshin dhe ndihmoheshin nga i gjithë populli francez, ashtu më nderonin edhe mua. Aty, me disa shokë që kishin qenë në Spanjë (italianë, bullgarë, jugosllavë, polakë, hunga-

rezë, baltikë), krijuam dhe "*Amical*"-lin, shoqatën e ish-vullnetarëve të Spanjës. Unë dhe një shok bullgar, më duket me emrin Filipov, ishim në drejtim të "*Amical*"-it.

Kur hynte në mes tonë ndonjë provokator, menjëherë e përzinim me kërcënime; nuk lejonim të na përçanin. Për këtë punë, polakët ishin më ekspertë, i zbulonin shpejt provokatorët.

Mua më kishin ngarkuar dhe redaktimin e gazetës së murit. Kolektivi ynë, rini antifashiste, lexonte shumë, sidomos shkrimtarët përparimtarë të kohës. Nuk e di pse mua nuk më tërhiqte letërsia frënge, madje as Aragoni, përveç Pol Vajan Kuturiesë, Gionos, mbesën e të cilit e kisha shoqe të ngushtë dhe m'i jepte të gjitha shkrimet e tij. Ajo u miqësua me mua dhe më ftoi të shkonim në *Santa Monica* - Kaliforni, te motra e saj. Më kishte tërhequr gjithnjë poezia spanjolle me në krye Lorkën dhe Maçadon, nuk më pëlqente shumë as Alberti e të tjerët. Patjetër që na tërhiqnin shumë Majakovski, Neruda, Vallejo e të tjerë. Aty, në "*Cope*", bënim dhe mbrëmje letrare, mbrëmje tematike dhe ngandonjëherë organizonim biseda për atdheun tonë.

Zhak Lorani na recitonte vjershat e tij dhe ngandonjëherë recitoja dhe unë vargjet e mia (që kanë humbur). Mbaj mend se një vjershë që bëra për *Sasenagen* (një fshat turistik ku shkonim shpesh), ku trajtoja disa probleme, sidomos të dashurisë, u pëlqye shumë dhe shokët e kishin mësuar përmendsh (*Sassenage - voyage -mariage -esclevage*!).[1)]

Jeta kalonte me mësime, me ëndërrime, me shqetësime, duke qenë të ndërgjegjshëm se një furtunë e madhe po i kanosej jetës sonë, planetit! Përgatiteshim për furtunën!

---

1) Sassenage - udhëtim - martesë - skllavëri.

Jeta ime politike në Grënobël

Unë isha në parti, e cila më kishte ngarkuar me agjitacionin te rinia universitare. Të gjithë e dinin se unë isha interbrigadist (vullnetar në brigadat internacionale). Vetëm emri interbrigadist bënte që të gjithë të më donin dhe të më respektonin. Në Francë ishte krijuar një atmosferë adhurimi për pjesëtarët e brigadave internacionale. Me sa di unë, nga shqiptarët e Grënoblit asnjë nuk ishte në parti. Ata që ishin simpatizantë, si Manush Haliti, Ilo Shahini, Dhimitër Shuteriqi, Petrit Dishnica, mbronin tezat komuniste. Petrit Merlika, Petrit Dakli, Mahir Domi, Ferdinand Pici, Alqi Nushi, Dario Arditi, Petraq Qafoku, Bilbil Klosi ende nuk preknin libër me përmbajtje komuniste. Ata nuk ishin antikomunistë, por nuk u pëlqente komunizmi. Pastaj kishin dhe frikë, se ata çdo verë ktheheshin në Shqipëri dhe nuk guxonin të shiheshin me libra komunistë në dorë, nga frika se mos e merrte vesh Tirana. Aty erdhi dhe Xhemal Broja, i cili ishte simpatizant.

Dërgohesha nga partia nëpër qendrat e punës për t'u folur punëtorëve për Luftën e Spanjës. Aty kishte shumë italianë. Ata, pasi e dinin që unë isha garibaldin, më thërrisnin shpeshherë në mbrëmjet për të folur për brigadën "Garibaldi".

Lufta në Spanjë po merrte fund. Para se të binte Barcelona, u tërhoqën vullnetarët që mbetën gjallë. Sapo arritën në Gurs, ose në Vernet, i shkrova letër urgjente komandës. Për pak ditë mora përgjigje:

Mbetën gjallë: Skënder Luarasi, Ymer Puka, Justina Shkupi, Mane Nishova, Mehmet Shehu, Zef Prela, Hulusi Spahiu, Veli Deda, Iljaz Pashai, Emrush Myftari, Daut Muço.

Kishin rënë në luftë: Xhemal Kada, Musa Fratari, Thimio Gogozoto, përveç atyre që u vranë që kur isha dhe unë aty: Asim Vokshi, Teni Konomi, Zef Hoti, Urfi Agolli, Ramiz Varvarica.

Sapo mora letrën, në "*Cope*" u bë festë e madhe: pimë shumë verë dhe kënduam këngë revolucionare. Tani unë nuk isha më vetëm: kisha shokët e mi. Ishte sihariqi më i madh i jetës sime, se tani nuk do të luftoja vetëm kundër atyre që na shanin si aventurierë, si sifilitikë etj.

Më ishin qepur shqiptarë reaksionarë, madje dhe nga ata që hiqeshin si komunistë, që nuk lanë gjë pa thënë kundër nesh. Një student mjekësie në Tuluzë, për t'i bërë qejfin profesorit të tij, që ishte fashist (ose për të kaluar më lehtë), si tezë kishte këtë: "Vullnetarët që venë në Spanjë, janë sifilitikë!"

Disa në Paris, midis të cilëve dhe Ali Kelmendi, thoshin se Ymer Puka, Skënder Luarasi dhe Petro Markoja janë aventurierë. Nuk e di pse e bënin këtë. Besoj se e bënin nga zilia, sepse të gjithë ata që shkuan të luftojnë në Spanjë, ishin djem të drejtë, të zotë, antifashistë, internacionalistë, që shkuan të derdhnin gjakun e tyre për diçka të madhërishme, kurse ata fshiheshin si krimba, pasi kishin frikë se mos humbisnin pozitat.

Menjëherë fillova korrespondencën me shokët e mi bashkëluftëtarë. Fillova të mblidhja ndihma në para, ushqime, veshmbathje. Një ndihmë të madhe në këtë drejtim më ka dhënë punëtori i ndershëm patriot Milto Kasneci. Ai punonte si veteran në fabrikën e madhe të biskotave "*Le Brun*". Më jepte me shumicë biskota të thyera dhe ua dërgoja shokëve. Mblidhte dhe veshmbathje, ushqime e të tjera. Dy herë në javë bëja pako të mëdha dhjetëkilëshe dhe i dërgoja.

Tani do të përmend një fakt të hidhur historik për shqiptarët që luftuan në Spanjë. Ata nuk kishin asnjë ndihmë nga qendra e Parisit, siç kishin gjithë të tjerët: grekët, italianët, gjermanët, jugosllavët, bullgarët, çekët e të tjerë, sidomos polakët. Partitë e tyre, me qendër në Paris, kishin organizuar ndihma të shumta dhe vizita të

udhëheqësve të tyre. Tregonin një interesim të madh për fatin e shokëve që dolën gjallë nga zjarri i Spanjës dhe tani vuanin në kampe përqendrimi në vende të llahtarshme, ku lanë kockat me mijëra robër lufte gjatë Luftës së Parë Botërore. Tanët, që rrinin në Paris, jo vetëm që nuk tregonin asnjë interesim, por përkundrazi, na shihnin si armiq! Dua të shënoj këtu dramën e shokëve Shaban Basha, Emrush Myftari, Justina Shkupi, Ymer Puka e të tjerë, të cilët, me ndihmën e shokëve evadonin nga kampi dhe shkonin në Paris. Vetëm nacionalistët si Rexhep Mitrovica, Qazim Koculi, Aziz Çami e të tjerë u dhanë dorën, kurse shokët tanë u dhanë këmbët. Asnjë për be, asnjë nga ata që quheshin komunistë në Francë, nuk denjoi jo të shkonte në kamp përqendrimi për të takuar vullnetarët e lirisë, po të paktën të dërgonte një letër, pale ndonjë ndihmë. As Ali Kelmendi, as Loro Brahimi, as të tjerë nuk treguan asnjë pikë interesimi. Ishte kjo një provë e madhe për të parë se kush ishte me të vërtetë antifashist, kush ishte shqiptar. E vërteta është se shumica e nacionalistëve dhanë ndihma dhe u interesuan për shokët që evaduan nga kampi dhe mbetën rrugëve pa asnjë përkrahje. Këtej nisi dhe drama e Shaban Bashës, Emrush Myftarit, Justina Shkupit e të tjerë, që u përkrahën vetëm nga nacionalistët dhe u ndihmuan të ktheheshin në atdhe të zhgënjyer. Ata nuk ishin anëtarë partie, po antifashistë që e mbrojtën me sakrifica në luftë idealin e tyre.

Vetëm Zeqirja Rexha, që studionte në Tuluzë, dërgoi disa herë ushqime dhe të holla. Asnjë tjetër.

Letrat që më dërgonin shokët komunistë Mane Nishova e Mehmet Shehu, ishin plot indinjatë kundër atyre shokëve që na hiqeshin si komunistë. Pyesnin me habi: "Pse, ç'kanë me ne? Nuk kanë turp të turpërohen, kur gjithë bota përparimtare bën ç'është e mundur që të na vijë në ndihmë në këto kohë shumë të vështira për

jetën tonë? Edhe mbreti satrap Zog u kujtua dhe mendoi të na dërgonte ndihma, kurse ata që na hiqeshin si udhëheqës, na luftojnë! Shumë herë pyesim, të gjejmë shkaqet e këtij qëndrimi armiqësor kundër nesh, po nuk i gjejmë dot. Çuditemi dhe revoltohemi!"

Me anën e Miltiadh Kasnecit dhe të shokëve të Grënoblit, mblidheshin shumë materiale: tesha, ushqime, pará, dhe çdo javë dërgonim pako të rënda.

Mua nuk më harroheshin fjalët e Bedri Pejanit, që i kishte thënë Aliut kur isha në Paris: "Çështja është te paratë që janë dhënë për familjet e vullnetarëve nga Ndihma e Kuqe Internacionale. Kjo është çështja themelore. Ato para janë luajtur në kumar!" Ndoshta ishte edhe kjo arsyeja që shokët e Parisit nuk deshën asnjë kontakt, asnjë afrim me vullnetarët që mbetën gjallë. Sidoqoftë, trajtimi armiqësor që na bënë neve, duke përhapur edhe shpifje, e vërtetoi më së miri qëndrimin e tyre të turpshëm.

Të gjithë shokët ishin larguar nga kampet e përqendrimit, përveç Mane Nishovës, Skënder Luarasit, Zef Prelës dhe Mehmet Shehut (për këtë do të flas hollësisht më poshtë.)

Fati i vullnetarëve shqiptarë që mbetën gjallë, ka qenë tragjik.

Në Grënobël na erdhi dhe Thanas Zikoja, me një letër nga Aliu. Për Thanas Zikon kishim dëgjuar që kishte qenë sekretar prokurie në Berat. Nga Jugosllavia kishte shkuar në Paris, ku ishte njohur me Aliun. Shfaqej si komunist. Ne e përkrahëm dhe e futëm në një spital dilte dhe takohej me ne. Kur u nënshkrua pakti i mossulmimit midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë, ai tha midis të tjerash: "Edhe Stalini njësoj si Hitleri është. Pasi vrau e preu gjithë shokët e Leninit dhe të Trockit, tani na u bë me Hitlerin." Kanë qenë të pranishëm dhe Manush Bektash Haliti, Bilbil Klosi, Dario Arditi e të tjerë.

Aty nga shkurti i vitit 1939, kur isha duke shërbyer

në sallën e restorantit, hyri brenda një burrë trupmadh, me një pallto të madhe dhe me një valixhe të vogël në duar. Nuk e njoha, por ai më pushtoi duke më thënë: "Ku je, o bir!" Ishte Ymer Puka. Më erdhi shumë mirë që e pashë. I shërbeva për të ngrënë e, kur mbarova punë, më tha se për mua kishte ardhur. Shkuam në dhomën time, që e kisha aty pranë. E gdhimë duke biseduar.

Pas ikjes së Ymerit, na erdhën në Grënobël eksponentët e kundërshtarëve të Zogut, ata që kaluan afro pesëmbëdhjetë vjet në kafenetë e bukura *"La coupolle"*, "La source", *"La palette"* të Parisit: Qazim Koculi, Aziz Çami, Ali Këlcyra, Rexhep Mitrovica e të tjerë. Kishin me se të rronin dhe qepnin kostume zyrtare. U habitëm pse erdhën në Grënobël. Vinte shpesh aty dhe Mustafa Kruja nga Gjeneva, që ishte afër.

Ardhja e tyre në Grënobël u kuptua qartë në ditët e para të prillit të vitit 1939. Madridi kishte rënë. Lufta e Spanjës kishte marrë fund dhe tani bota priste se ç'do të bëhej. Shtypi përparimtar kishte demaskuar Munihun, kishte demaskuar tradhtinë e madhe të borgjezisë perëndimore ndaj Republikës Spanjolle. Me tradhti fitoi fashizmi në Spanjë, ose më mirë me ndihmën e gjithanshme të qeverive të Evropës Perëndimore. Atmosfera luftënxitëse e Fuqive të Mëdha, sidomos ajo e boshtit Romë-Berlin-Tokio, paralajmëronte nisjen e Luftës së Dytë Botërore. Fashizmi gjermano-italian e kishte zgjeshur shpatën.

Pra, krerët e nacionalistëve që ishin mbledhur në Grënobël, përgatiteshin e mbushnin valixhet me kostume hierarkësh. U përhap lajmi se Italia bëhej gati të sulmonte Shqipërinë. Shtypi botëror e sidomos ai francez informonte opinionin publik se Musolini, pas Spanjës, do të sulmonte Shqipërinë. Dhe me të vërtetë, kur ende po dilte tym nga gërmadhat e Spanjës, që u gjunjëzua aty nga 28 marsi i vitit 1939, pas një jave, domethënë më 9 prill

të atij viti, lajmi i sulmit të Italisë kundër Shqipërisë u trumbetua me të madhe nga radiot dhe shtypi francez e botëror. Ne, shqiptarët e Grënoblit, menjëherë organizuam mbledhje urgjente, ku morën pjesë të gjithë, edhe krerët nacionalistë.

Dua të shënoj edhe këtë episod të rëndësishëm. Në Grënobël erdhën nga Parisi të dërguar të posaçëm, të agjencisë *"Havas"*, të gazetave *"Le temps"*, *"Figaro"*, *"Paris soir"*, *"Le patin"*, *"Humanite"*, *"Le populaire"* e të tjera. Këta korrespondentë i shoqërova edhe unë. I shpumë te hoteli i madh ku rrinin krerët shqiptarë, ku i pritën në një sallë luksoze. Qazim Koculi nuk e dinte mirë frëngjishten. Ali Këlcyra përgjigjej vetë. Unë përktheja ato që thoshte Qazim Koculi, të cilin e pyeste korrespondenti i *"Havas"*. Unë e prezantova: lideri antiitalian, ai që kishte qenë një nga udhëheqësit e Luftës së Vlorës më 1920 dhe fjalë të tjera, për ta bërë Koculin armik të Italisë e të Zogut.

Pyetja e parë që ai i bëri Koculit, ishte kjo: "Tani që edhe Zogu është kundër Italisë, ju do të bashkëpunoni me Zogun?" - Ia përktheva pyetjen Koculit dhe ai më tha: "Sos do pyes unë këtë zotni se ç'do të bëj!" Por unë nuk ia thashë korrespondentit këto fjalë. Përktheva kështu: "Me Zogun a pa Zogun, unë do të qëndroj përjetë armik i Italisë fashiste." Këtë lajm e dhanë të nesërmen gazetat në tetë kolona: *"Me Zogun a pa Zogun, unë do të qëndroj përjetë armik i Italisë fashiste."* Kur erdhi shtypi në Grënobël dhe e lexuan krerët nacionalistë, u ra pika. Koculi më kërcënoi pse e kisha përkthyer ndryshe thënien e tij, dhe unë i thashë: "Unë shpreha mendimin e zemrës sate..." Sidoqoftë, kjo intervistë u prishi shumë punë krerëve nacionalistë, siç do të shohim më poshtë.

Vetëm Aziz Çami më puthi dhe më tha mënjanë: "Të keqen, more Petro, që fole kështu! Më vonë do ta marrësh vesh se sa vlen ajo thënia jote..."

Kuvendin e parë e bëmë në një sallë kafeneje, të gjetur nga partia, e cila ishte mobilizuar për të na ndihmuar. Ishim të gjithë: krerët, studentët dhe punëtori Milto Kasneci. Mua më ngarkuan të mbaja procesverbalin e Kuvendit. Në një defter të madh shënova me shkronja të mëdha në faqen e parë: *Kuvendi i shqiptarëve të mërguar për të vendosur format e luftës kundër pushtuesit fashist.*

I pari e mori fjalën Qazim Koculi, i cili foli me mallëngjim për Shqipërinë e mjerë, të sfilitur nga mbreti halldup. Pastaj, me perifraza dhe aludime jepte të kuptonim se ne duhej të ktheheshim të gjithë në atdhe për të shpëtuar atë që mund të shpëtonim, kombësinë, gjuhën e të tjera. Të gjithë e dëgjuam me habi, kokulur. Pastaj e mori fjalën Mustafa Kruja, i cili foli më hapur; ai pak a shumë tha se ne duhej të ktheheshim në atdhe, se krimineli Zog kishte ikur dhe se Shqipëria paskëtaj do të lulëzonte.

I pari fishkëlleu Milto Kasneci, duke vënë gishtërinjtë në gojë, dhe bërtiti: "Nuk e kuptoni, more djema, se këta paskan tradhtuar?! Këta duhen vrarë!" U bë një gjullurdi e madhe. Unë hodha tutje defterin dhe bashkë me shokët dolëm përjashta. Disa shfaqën mendimin t'i vrisnin menjëherë, por partia tha: "Në asnjë mënyrë. Ata do t'i vrasë vetë populli shqiptar." Më kërkuan me urgjencë të përkthyera ato që shënova në procesverbal, që t'ia dërgonin Gabriel Perisë (kishte qenë komplot i përgatitur nga Munihu). Iu drejtova Mahir Domit, i cili pranoi menjëherë, dhe, pasi e përkthyem, e dorëzova.

Partia Komuniste Franceze, anëtar i së cilës isha edhe unë, ishte e para që na erdhi në ndihmë për të gjitha: për sallën e mbledhjes, për hedhjen e traktit, për organizimin e demonstratës përpara konsullatës italiane etj. Ata u treguan të gatshëm t'i armatosnin shqiptarët dhe shumë shokë francezë, që të vinin vullnetarë në Shqipëri për të luftuar fashizmin.

Demonstrata para konsullatës italiane qe e madhe.

Krerët kishin ikur. Kishte mbetur vetëm Aziz Çami, i cili hezitonte të kthehej.

Unë ato ditë shkrova poemën "Kushtrimi çlirimtar", të cilën ia dhashë Selfixhe Ciut e ajo e solli në Shqipëri, e shumëfishoi dhe poema qarkulloi dorë më dorë ilegalisht.

Ato ditë na erdhi një telegram nga Noli, i cili kishte lexuar deklaratën e Koculit dhe i gëzuar, thoshte: *"Qëndroni të bashkuar. Po mbledhim ndihma për ju."* Erdhi dhe një telegram nga një shqiptar, që në kohën e Nolit kishte qenë nënprefekt në Bilisht dhe që tani banonte në Tunizi: *"Lexova deklaratën. Qëndroni! Të bashkuar, të luftojmë për mëmëdhenë!"*

Shtypi francez dhe botëror informonte për këtë invadim të pabesë të fashizmit italian. Madje një korrespondent kishte shkuar të takonte Çamberlenin, kryeministrin anglez. Ai peshkonte dhe, kur korrespondenti e pyeti: "Pse Anglia e bën sehir këtë krim të ri të fashizmit?", - ai u përgjigj: "Mos fol shumë, se më tremb peshqit"...

Me anën e partisë organizuam konferenca të shumta, ku folën personalitete antifashiste franceze dhe italiane. U organizua dhe një konferencë e madhe e studentëve antifashistë, me parullën e madhe: "Rini e gjithë botës, bashkohu kundër fashizmit, që është lufta!"

Shokët shqiptarë më ngarkuan mua të flisja në emrin e tyre, pasi ata edhe mund të ktheheshin në atdhe, ndaj të mos kishin telashe me qeverinë e re të Tiranës. Fjalimin ma përktheu mirë Mahir Domi. Fillonte kështu: "Gjersa të ketë popuj të shtypur, kurrë nuk do të ketë paqe në botë..." Një fotografi nga ajo mbledhje më duket se e kam. Ne fituam simpatinë e gjithë studentëve që studionin në Grënobël, të cilët nuk dinin ç'të bënin për ne, që të na shprehnin solidaritetin e tyre.

Pastaj, pasi të gjithë ishin të ndërgjegjshëm se Lufta e Dytë Botërore ishte në prag - disa thoshin (dhe kishin

të drejtë), se ajo kishte filluar në Spanjë e në Shqipëri...
- u mblodhëm në një mbrëmje të madhe tematike (djem e vajza nga Skandinavia, nga Austria, nga Baltiku, nga Evropa Qendrore, nga Ballkani, nga Franca, Spanja, Portugalia dhe disa turq, algjerianë, tunizianë, anglezë, amerikanë, kubanë, argjentinas e brazilianë), ku dhamë këtë premtim: Pas luftës, kush të dalë i gjallë nga pjesëmarrësit, më pesëmbëdhjetë gusht të vitit kur do të bëhet paqja, të takohemi në sheshin e San Markos, në Venecie.

Nuk di nëse e mbajti kush këtë premtim, nëse shkoi apo nuk shkoi ndonjë nga ata të rinj e të reja. Jam i sigurt se patjetër do të kenë shkuar disa. Dhe kushedi se ç'kanë thënë për ata që mungonin: "Do të jenë vrarë, sidomos çifutët e gjorë!" Ku ta dinin ata se ne shqiptarëve një rrugë e tillë nuk do të na lejohej pas çlirimit që do të vinte.

Shokët shqiptarë u kthyen në atdhe për pushime.

Zogu, me familjen dhe suitën e tij, erdhi në Francë, ku bleu një kështjellë. Me të ishte dhe Tajar Zavalani, prej të cilit mora një letër të gjatë. Ndërkohë Aliu kishte vdekur dhe ishte varrosur me nderime nga shokët e Kominternit. Letrën e tij të gjatë e humba. Ai më bënte apologjinë e tij për sa kishte vepruar, më kërkonte ndjesë duke thënë pak a shumë: *Ti je një revolucionar dhe unë u gabova nga shumë anë. Kam marrë vesh se je një veprimtar i mirë. Të punosh ti dhe gjithë shokët e rinj për të vazhduar rrugën që lamë ne përgjysmë. Vetëm një gjë të këshilloj: mos u nda nga hallet e popullit tonë, mos u nda nga rruga që ke zënë, mos ia fal kurrë Zai Fundos tradhtinë, mos u shkëput nga shokët që janë në Shqipëri.*
- Letrën mund ta ketë Dhimitër Shuteriqi ose Qamil Çela.

Tajar Zavalani më vinte në dijeni se shokëve që vazhdonin të ishin në Pirenej u kishte dërguar një ndihmë materiale. Më ftonte të bëja pjesë në frontin e përbashkët kundër Italisë, me në krye Zogun. Unë nuk iu përgjigja,

po, të them të drejtën, letra e tij në ato çaste m'u neverit. E përktheva dhe ua lexova shokëve të partisë. Edhe ata më porositën që të mos i përgjigjesha...

Tani në Paris, në "*La coupole*", në "*La source*", në "*La palette*", atje ku më parë eglendiseshin "nacionalistët" që tani u bashkuan me Italinë dhe shkuan në Tiranë për të qenë në krye të pushtetit fashist, shihje ata të suitës së Zogut. Ç'ironi historike! Një tragjikomedi e faqeve të historisë sonë! M'u kujtuan fjalët e Branko Merxhanit: "Ne jemi vagabondët e historisë!" Vagabondë të historisë mbetën tradhtarët, politikanët imoralë dhe antishqiptarë, që Shqipërinë e kishin bërë plaçkë tregu dhe që ndërronin padronët.

Çfarë mund të shtoj më? Po! Pasi ishte përhapur një atmosferë e ngrohtë simpatie për ish-vullnetarët e Spanjës, tani populli francez kishte simpati për Shqipërinë dhe për shqiptarët që ishin në Francë. Ne këtë e shfrytëzonim duke folur e shkruar për Shqipërinë. Më kujtohet një ditë, në bibliotekën e universitetit, ku vinte dhe "Përpjekja shqiptare" (revista që botonte Branko Merxhani), një vajzë që shfletonte "*La revue de deux mondes*" (ose "*Le monde*"), më ftoi të shikoja diçka që po lexonte. Pashë në atë revistë të vjetër një artikull të gjatë të Elena Gjikës, e cila shkruante për Shqipërinë në shekullin e kaluar. M'u bë zemra mal! Ajo vajzë gërmonte se ku kishte literaturë për Shqipërinë, e nxitur nga ngjarjet e kohës, sidomos nga shtypi që propagandonte rezistencën e popullit shqiptar.

Më 1 shtator të atij viti (1939 - viti që u pushtua Shqipëria), nisi Lufta e Dytë Botërore. Gjermania naziste sulmoi Poloninë. Franca ishte në gjendje lufte me Gjermaninë naziste. Luftë!

Pas pak ditësh u mor vesh se Gjermania e Bashkimi Sovjetik e ndanë Poloninë në mes tyre. Luftë e ashpër me anëtarët e partisë, të cilët hidhnin teserat duke mall-

kuar partinë dhe Stalinin: "Herën e parë Stalini na bëri një traktat të mossulmimit me Hitlerin. Von Ribentropi me kurorë në dorë dhe me dorën tjetër duke nderuar si nazist, ishte te mauzoleu i Leninit, në Sheshin e Kuq! Tani ushtarët sovjetikë po përshëndeten dhe vëllazërohen me ushtarët hitlerianë në Poloni! Ku vemi?! Ç'është kjo tradhti ndaj kauzës së Leninit!" Këto dhe të tjera ishin refrenet e përditshme. Partia doli në ilegalitet. Torezi, sipas thënieve, kishte dezertuar nga ushtria franceze dhe kishte shkuar në Moskë. Shtypi reaksionar francez sulmonte Partinë Komuniste si agjente të Moskës e tani të Berlinit! Një mishmash politik. Shumica e popullit francez bërtiste: "Tani që Hitleri sulmoi Poloninë, tani është koha t'i biem, dhe jo të qëndrojmë sehirxhinj, si në kohën kur ushtritë gjermane hynë në Çekosllovaki. Po nuk i ramë tani, ai do të na sulmojë dhe do të na përpijë!"

Pra ishim në ilegalitet, por partia punonte gjallërisht. Ne ishim aktivizuar më shumë, përhapnim botimet ilegale, sidomos fjalimet e Zhak Guklosë dhe të Kashenit. Një ditë mua më ngarkuan me një valixhe plot me broshura të fjalimit që kishte mbajtur Andre Martia në parlament, ku ishte futur ilegal dhe kishte demaskuar politikën e qeverisë së Lavalit. Më thanë të shkoja në "*Viscose*" (një fabrikë qelqi, pranë Vizilës), ku do të shpërndaja në darkë, kur dilnin punëtorët, broshurën. Më thanë të qëndroja jashtë portës së madhe të oborrit dhe, kur të dilnin punëtorët, t'ua jepja. Shkova me tram. Ndenja jashtë derës dhe veprova sipas porosisë. Pasi pata shpërndarë disa broshura, m'u vërsul një punëtor, por disa të tjerë e ndaluan. Më thanë: "Na e jep neve valixhen dhe ti ikë menjëherë!" Ashtu bëra. Që larg, prapa një peme ku isha fshehur, shikoja përleshjen e punëtorëve. Kur vajta të nesërmen te sekretari i partisë, i thashë: "Nuk kam frikë, se e keqja më e madhe është që të më shpien përsëri në kampin e përqendrimit, në Pirene, por

puna është se armiku trumbeton se këtu në Francë janë të huajt, janë komunistët e huaj ata që shkatërruan unitetin e popullit francez. Ne na akuzojnë si agjentë, prandaj më mirë këto punë t'i bëjnë shokët francezë." Qe dakord me mendimin tim.

Na u dha një urdhër nga partia: "Ju që keni qenë vullnetarë në Spanjë, duhet të kërkoni të veni vullnetarë dhe të inkuadroheni me ushtrinë franceze!" Ne të "*Amicalit*" (shoqata e ish-vullnetarëve të Spanjës), bëmë një mbledhje dhe vendosëm të kërkonim që të shkonim vullnetarë. Unë u pranova. Më dërguan në *"Catrieme genie"*, aty pranë stadiumit, në një kazermë të madhe, ku shumica e ushtarëve ishin nga Pirenejtë. U vesha si ushtar francez. Haja e pija si asnjëherë në jetën time. Për fat, shumica e ushtarëve ishin të majtë. Këndonin këngë revolucionare dhe, kur morën vesh se unë isha shqiptar dhe vullnetar i brigadave internacionale, më respektuan më shumë. Dilja bashkë me ta, shkonim në kinema dhe lexonim "*Humanitenë*" (ilegale). Aty ndenja dyzet ditë. Pastaj më thirri komandanti në zyrën e tij. Ishte një major i shkurtër, me monokël dhe me fytyrë të vrerosur. Sapo iu paraqita se kush isha, ai brofi më këmbë dhe nisi të shante komunizmin, Moris Torezin, që kishte dezertuar:

- Ju jeni shkaku i luftës! Ju jeni kasapët e Spanjës dhe tani po bëheni kasapët e Evropës me dy kriminelë në krye: Hitlerin dhe Stalinin!

Ai foli e foli e unë rrija gatitu! Pastaj i thashë:

- Jam larg atdheut. Jam kundër Hitlerit dhe Musolinit. Dua të luftoj me ju për atdheun tim, nën urdhrat tuaj!

Ai më bërtiti:

- Nuk ka nevojë Franca për kriminelë si ju! Shporru këtej! Dil jashtë menjëherë!

Shkova dhe dorëzova pajisjet dhe u vesha me teshat

e mia civile. Kur isha në mes të oborrit të madh të kazermës, i menduar dhe i trishtuar, dëgjova nga pas një zë: *"Camarade albanais...* prit! Prit!" - M'u afrua një ushtar francez, më dha dorën duke më thënë: "Mos u mërzit, se fitorja është jona! Këtë e ke nga kompania jonë. Është për ty. - E pashë atë copë kartëmonedhë që më dha: ishin 1000 franga. - I mblodhëm për ty! Mos u mërzit! Do ta paguajnë kriminelët!" - dhe më puthi e u ndamë. Isha duke ecur drejt derës së vogël të oborrit të madh të kazermës, i trishtuar, i humbur, i mallëngjyer nga fjalët e ushtarit francez, dhe, kur u ndodha jashtë derës, dy *gardes mobiles* (xhandarë) më rrëmbyen, njëri nga njëra këmbë e tjetri nga këmba tjetër, dhe më vërvitën në një kamion, si një thes me plehra. U vrava dhe pashë derën e kamionit-burg të mbyllej me hekura, makina ecte dhe unë rrokullisesha i dërrmuar në dyshemenë boshe të kamionit të madh.

Më shpunë në komisariat. Komisari më njihte (do ta përmend më poshtë këtë komisar). Më tha: "Dy rrugë ke: ose kthimin në kampin e përqendrimit, ose largimin nga Franca." U mendova ca dhe i thashë: "Dua të kthe-hem në atdheun tim." Më tha se do të më pajiste me një leje dhjetëditore qëndrimi në Francë, që të kisha kohë të mendohesha, madje më dha edhe shkresën për këtë. (Këtë mirësi ma bëri për një ngjarje që më kishte ndodhur pak kohë më parë me një agjente të *"Deusieme Buro"*-së, të cilën do t'jua tregoj.)

Ato ditë ishin mbledhur ilegalisht disa shokë internacionalistë. Kishte ardhur një shok nga Parisi, që na foli për situatën e partisë. Pastaj na tha se vendimi i Kominternit ishte që shokët e huaj të bënin ç'ishte e mundur të ktheheshin legalisht ose ilegalisht patjetër në atdheun e tyre. Pra unë duhej të kthehesha patjetër në Shqipëri. Atë ditë u shkrova shokëve që ishin në kampin e Pirenejve: *"Vendosa të kthehem në Shqipëri.*

Është urdhri i Kominternit që gjithë komunistët të kthehen, legalisht ose ilegalisht, në atdheun e tyre." Pas pak ditësh mora letër nga shokët, nënshkruar nga Mehmet Shehu, ku thuhej: *"Po u ktheve në Shqipëri, dy gjëra të presin: ose litari, ose tradhtia!"* Dhe unë të nesërmen u përgjigja: *"Nuk është dëgjuar gjer më sot që të dalë ndonjë komisar politik i Spanjës tradhtar, që të dal unë i pari! Çuditem si ju shkon në mendje një gjë e tillë! Sa për tjetrën, që më pret litari, parapëlqej më mirë të varem në Shqipëri sesa në vend të huaj."* Ishte kjo letra e fundit që u dërgova shokëve të Spanjës.

Fola me Petrit Daklin, që babanë e kishte kryeministër në Tiranë. I thashë se dëshiroja të kthehesha në atdhe, dhe iu luta që të merrte pëlqimin e babait të tij. Ai i telegrafoi të atit. Dhe ai u përgjigj telegrafisht: *"E mira është të kthehet patjetër. Kam dhënë urdhrat përkatës për lejimin e tij nga Roma."*

Pas dy ditësh shkova në konsullatën italiane të Grënoblit. Ata, kur më panë, u habitën. Kur u thashë se dëshiroja të kthehesha në atdhe, u habitën edhe më shumë. Më thanë se duhej të pyesnin Romën; të prisja disa ditë. Po bëhesha gati për t'u kthyer; me shokët francezë u ndava, se nuk dihej dita e nisjes.

Një episod i vogël për karakterin e italianëve: Shkova të dielën, si gjithnjë, me shokët për ski, në *"Cole de Porte."* Kur isha në restorant, duke ngrënë, një zotëri me zonjën e tij më kërkuan leje të uleshin në tryezën time. U ulën. Ai zotëri më tha: "Nuk më njihni? Jam konsulli italian, erdhët tek unë për të kërkuar pasaportën! - U habita! - Ju këshilloj të mos ktheheni në Shqipëri, se Roma dhe Tirana e njohin gjithë veprimtarinë tuaj revolucionare antifashiste dhe antiitaliane. Prandaj atje vdekja ju pret!" Nuk i fola. E falënderova për paralajmërimin. Dhe më duhet tani të kapërcej pak në kohë: Pas tre vjetësh, kur isha në Romë, zbritur nga malet e Ternit me mision, aty

në "*Piazza fiume*", ndërsa prisja një shok, një zotëri m'u drejtua: "Si jeni, *albanese*?" Kujtova se ishte ndonjë dedektiv, një nga ata që kurdoherë më kanë ndjekur këmba-këmbës. "Nuk më njihni? Kam qenë konsulli i Italisë në Grënobël. Edhe mua më zunë gjermanët që erdhën në Francë, dhe më internuan në Belgjikë. Tani sapo jam kthyer. Ç'kam vuajtur! Po ti si je? Ku je tani?" Nuk i fola shumë, i shtrëngova dorën dhe e falënderova. Çudi! Thotë mirë populli ynë që mali me mal nuk piqet, po njeriu me njeriun piqet! Në gjithë atë rrëmujë që kishte qenë Evropa, ku asnjë gur nuk kishte mbetur pa u rrokullisur, unë u takova me një njeri që dikur kishte qenë konsull dhe që tani ishte në pasiguri...

U miratua leja: unë mund të kthehesha në atdhe. U shkrova një letër shokëve në kampin e përqendrimit, me të cilën i lajmëroja se po nisesha për në Shqipëri, dhe u bëja thirrje që edhe ata të mundoheshin të ktheheshin sipas udhëzimeve të Kominternit. U ndava me shokët francezë dhe shqiptarë. Qamil Çela më dha disa porosi për Nako Spirun, që ishte në Torino. Bektash Haliti, babai i Manushit, më dha 60 lireta për udhëtim. Ishte kapitali i vetëm që kisha në xhep. Kur isha në Modanë, doganierët francezë më bërtitën: "Mos u kthe te kasapët!" Unë i përshëndeta dhe, me të dalë te doganierët italianë, që ishin pak metra larg, menjëherë më hodhën prangat. Dëgjova francezët të shanin dhe të bërtitnin kundër fashizmit.

Jeta intime në Grënobël

Të them të drejtën, në Grenobël njoha një rini të pastër, një rini të edukuar. Pasi dhe puna ime ishte të merresha me rininë universitare, njoha të rinj e të reja nga shumë vende të Evropës dhe të botës. Në "*Cope*" njoha djem me karakter dhe vajza të emancipuara. Njëra nga vajzat që njoha më nga afër, ishte një napolitane,

Jola Taliakoco, e cila studionte literaturë franceze. Kishte mbaruar në Napoli për letërsi e për gjuhë të huaja: gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht. Me të isha shumë i afërt, më kishte si vëlla dhe unë e kisha si motër. Kishte një karakter napolitan impulsiv. Më tregonte se e dashuronte dhe kërkonte të martohej me të profesori i njohur Franko Lombardi, nga një familje e dëgjuar në Napoli. Ky e kishte nxënëse Jolën, e dashuroi dhe me të donte të martohej, po të vendoste ajo. Bashkë shëtitnim, ziheshim, pajtoheshim. Këndonim bashkë këngë revolucionare dhe, ndonëse aty në "*Cope*" shumica ishin çifutë si Jola, nga Austria dhe Evropa Qendrore, sidomos nga Polonia, Jola nuk shoqërohej shumë me ta. Aty vura re se hebrenjtë ndryshonin sipas vendit nga ishin: ndryshe ata nga Polonia, që ishin më egocentrikë dhe më aktivë; ndryshe ata nga Austria, që ishin tërë finesë dhe edukatë; ndryshe ata nga Italia, që ishin tamam italianë të Mesdheut, gjaknxehtë dhe impulsivë. Jola shqetësohej shumë për jetën time dhe më këshillonte se si të veproja në raste të vështira. Ajo ishte filokomuniste, por shumë e pasur; urrente Musolinin dhe Hitlerin. Kishte mjaft kulturë; unë përfitoja shumë prej saj, sidomos për kulturën italiane. Aty kishte dhe shoqe të tjera çifute nga shumë vende dhe ajo më njohu me të gjitha. Kur u nis për në Itali, qau shumë dhe më premtoi se nuk do të më harronte kurrë.

Të vazhdojmë me Jolën: Kur unë kalova kufirin në Modanë dhe më hodhën prangat, më shpunë në një qeli e pastaj më nisën të shoqëruar drejt Brindizit (me një tren mallrash që ndalonte në çdo fshat; 17 ditë e bëra këtë udhëtim, pa katër ditët që ndenja në Napoli).

Unë udhëtoja me tren "*acelerato*". Paratë më kishin mbaruar, ndaj më ushqente kuestura e vendit ku ndalesha. Flija në *"camera di sicurezza"* me vagabondët që arrestonin përditë. Në Torino, një kuestor i mirë më

la të shkoja të takoja disa shokë shqiptarë, Nako Spirun dhe Mihal Durin. Në Napoli më lanë të shkoja te Jola, e cila më priti me dashuri të madhe, më njohu me nënën dhe babanë e saj. Jola mori leje nga kuestura, që të qëndroja disa ditë në Napoli, duke u bërë ajo garante. Ndenja në Napoli si mysafir i familjes së Jolës dhe këto qenë ditët e fundit në Evropë. Jola nuk dinte ç'të bënte që të më kënaqte. U ndamë. Dhe kur isha në Ustikë, i internuar, ajo dhe familja e saj më dërgonin çdo javë një pako me ushqime dhe veshmbathje për grupin tonë shqiptar.

Pra Jola ishte njëra nga shoqet e mia më të afërta.

Kur unë isha duke mbledhur ndihma për shokët e Spanjës dhe për mijëra refugjatë spanjollë që lanë Spanjën, dy motra studente amerikane: Meri dhe Seli, më thanë: "A ka mundësi që të bëjmë një pulovër për një refugjat spanjoll?" Ato shkuan në një dyqan, blenë lesh dhe shtiza dhe më ftuan të shkoja me to në kinema. Edhe në kinema, kur ndërroheshin aktet, ato me shpejtësi punonin me shtiza për ta thurur pulovrin sa më parë. Njëra prej tyre, Seli, m'u afrua shumë. Nuk më ndahej. Seli ishte pianiste, kurse Meri piktore. Babanë e kishin profesor të historisë në Buffallo, SH.B.A. Ishin dy motra bjonde, që i ngjanin njëra-tjetrës si dy pika uji, por kishin një ndryshim karakteri: Seli ishte më romantike, kurse Meri ishte më praktike në jetë. Pulovrin e mbaruan shumë shpejt dhe unë e dërgova në kampet e Pirenejve, me emrat e të dyja motrave.

Një episod i ngatërruar: Kur shkoja të merrja Selin, aty në oborrin e konviktit *"Tres cloittre"*, ku banonin studentet e huaja, unë e dija se nën cilën pemë ishte shezlongu i Selit. Ajo atje, nën atë pemë, në degët e së cilës kishte dy llamba elektriku, shtrihej në shezlong dhe më priste të shkoja ta merrja që të shëtitnim gjatë lumit Izer. Një herë shkova, e mora në krahë, ajo vari kokën

pas shpinës sime dhe unë e përkëdhelja lehtë. Por, kur dolëm në dritë dhe e ula, që dhe ajo të ecte krahas meje, pashë se... nuk ishte Seli, po Meri. Ajo u shkul së qeshuri. Qesha edhe unë. Më tha se Seli ishte pak e sëmurë, prandaj kishte dërguar atë që të më shoqëronte atë mbrëmje. Shëtitëm me Merin gjatë bregut të lumit Izer gjer në orët e para të agimit. Flisnim shumë dhe ajo kishte dëshirë të më dëgjonte.

Meri kishte dëshirë të kompozonte një tablo me një aviator spanjoll dhe mua të më merrte si model fytyrën. Pranova. Ajo, si amerikane që ishte, më tregonte për djemtë që kishte njohur, dhe se vdiste për pak dashuri sentimentale si në Evropë, po ja që nuk kishte gjetur ende ndonjë djalë që t'i pëlqente. "Po të mos kishe njohur më parë Selin, unë do të të dashuroja më shumë se motra!" Fliste dhe qeshte. Unë, si shqiptar, ndonëse njeri me shumë halle dhe si gur në rrokullimë, nuk çuditesha me moralin, edukatën dhe karakterin e këtyre vajzave, që ishin shumë shekuj para jetës sonë. Ajo luante me mua sikur të më kishte të dashurin e saj të parë, sikur të ishte shoqja e jetës sime. Dhe më fliste për modelet e saj, për djemtë e Amerikës, që ishin shumë praktikë, cinikë, egoistë dhe tepër liberalë. "Vdesin vashat amerikane për pakëz romantizëm erotik."

Nuk u habita kur të nesërmen Seli më tregonte se si Meri ishte çmendur pas meje dhe se si e kishim kaluar gjithë natën. Me Selin shëtitja edhe jashtë qytetit. Ajo hiqte këpucët dhe bridhte zbathur lëndinave si e marrë. Shtrihej në tokë duke shikuar majat e Alpeve dhe më thoshte se s'ka si natyra, s'ka si liria në natyrë, s'ka si dashuria në natyrë: "Zhurma amerikane e metropoleve vret sentimentet, kurse natyra është burimi dhe shërimi i dashurisë së vërtetë! Qetësia e natyrës flet shumë dhe gjuhën e saj vetëm të dashuruarit e kuptojnë."

Këtyre dy motrave u vinin rrotull dy studentë: njëri

rumun dhe tjetri neozelandez. Ata kishin bërë dhe unaza me emrat e tyre dhe të të dyja motrave. Rumuni i kishte vënë syrin Merit, kurse neozelandezi Selit. U dhanë unazat me shkronjat e tyre dhe përpiqeshin t'i bindnin që të martoheshin e të shkonin bashkë në Amerikë me to. Por ja që babai u bëri telegram vajzave të ktheheshin, se kishte filluar lufta. Dhe ato vendosën të ktheheshin në Amerikë. Mbrëmjen e fundit, ato shtruan në hotel--restorantin më të madh një darkë. Thirrën rumunin, neozelandezin dhe mua. Kishin bërë vetë porositë e të ngrënave. Të pestë hanim e pinim shampanjë. Të dyja çiftet kërcenin, ndërsa mua më dukej vetja si i tepërt, prandaj shumë herë u përpoqa të largohesha. Ato më thoshin se, po të ikja unë, do të iknin edhe ato. Aty nga ora dy darka mbaroi. Meri u tha të dyve: "Ju shkoni. Natën e mirë! Nesër në mëngjes takohemi. Petroja do të flejë në dhomën tonë!" Ata ikën dhe ne u ngjitëm lart për të fjetur. Ishin dy dhoma me një banjë në mes. Të dyja dhomat nuk kishin derë të mbyllur. Ato u zhveshën dhe u lanë, pastaj u parfumosën. Të tilla ishin Meri dhe Seli, dy motra, dy vajza shumë të bukura, të dyja bjonde me sy të kaltër dhe trup elegant. Unë nuk mund të krahasoj asnjë vajzë evropiane - pale ballkanase - me moralin dhe edukatën e këtyre dy motrave amerikane. Mendoj se ato shprehnin mirë lirinë e femrës dhe karakterin e vajzës moderne amerikane: praktike, transparente, të pavarura.

Në mëngjes, edhe rumuni, edhe neozelandezi rrinin në sallonin para derës së dhomës ku fjetëm ne. Para se të dilnim nga dhoma, Meri më tha se Seli ishte gati të martohej me mua dhe, sapo të arrinte në Buffallo, do të bënte dokumentet që të shkoja edhe unë atje. Më foli shumë me mend dhe logjikë Meri, duke më premtuar se atje në Amerikë do të isha i lirë të shkruaja vargje dhe të ndihmohesha nga babai i tyre, që ishte një personalitet. Pasi e kuptuan se unë as që e mendoja një gjë të tillë,

pashë sytë e Selit të njomeshin. Pastaj më pushtoi fort, duke më thënë se ajo do të priste gjer në mbarim të luftës. Pastaj Meri nxori dy mijë franga dhe m'i dha për shokët e kampit të përqendrimit. "Paratë që kishim, nuk do t'i marrim me vete në Amerikë. Dje prishëm mjaft. A vjen me ne gjer në Cherbourg të na përcjellësh?" I thashë se ishte e pamundur, pasi unë kisha të tjera shqetësime me policinë franceze. Zbritëm poshtë. Hëngrëm mëngjesin. Pastaj dolëm. I priste makina. Ato u përshëndetën me mirësi me rumunin dhe neozelandezin. Mua më puthën dhe më mbajtën shumë çaste të përqafuar. Ato ikën... ikën duke marrë me vete një nga kujtimet më të ëmbla të jetës sime.

Uendi Fleçër... Kjo ishte ndeshja më e fortë e ndenjave të mia. Nuk është as fantazi dhe as ëndërr, po një ngjarje e vërtetë:

Isha në pishinë, ku shkoja përditë: zhvishesha, lahesha, pastaj shtrihesha në diell duke lexuar ose duke shkruar. Drekën e merrja me vete: kaçkavall, zhambon, banane, bukë... Kur isha duke u ngrohur në diell, dikush më spërkati në shpinë. U hodha përpjetë! Ktheva kokën dhe pashë dy vajza, njëra më e bukur se tjetra, që qeshnin. U thashë të mos e përsëritnin, se unë isha i egër dhe mund t'i haja. Dhe u shtriva. Përsëri më spërkatën me ujë. U ngrita, rrëmbeva njërën prej tyre dhe bashkë me të u zhyta në pishinën e ftohtë. Ajo qeshte, kurse unë e zhytja dhe e zhytja në ujë, gjersa u lodha. Ajo kishte pirë shumë ujë. Kur dolëm nga pishina, tjetra, që ishte më e bukur, më tha: "Isha unë ajo që ju hodha ujë". E rrëmbeva edhe atë dhe e zhyta në ujë. E mbajta shumë minuta. Ajo shkulej së qeshuri.

Pastaj të dyja ndenjën me mua. Ishin dy angleze që studionin në Lozanë të Zvicrës, në shkollën e vajzave më të pasura të botës. Kur erdhi koha për të ngrënë drekë, u thashë se unë do të haja në bufe. M'u lutën të pranoja

ɜ hanim bashkë. Uendi, më e mira, ajo që më shikonte ıe dashuri, ishte shumë e zgjuar dhe shumë e bukur. ɜhte nja 18 vjeç. Hëngrëm bashkë të tre. Kjo ishte njohja ıe Uendin, e cila bëri ç'ishte e mundur që kjo njohje të ërfundonte në martesë. Unë i thosha: "Jetoj në një asolle bashkë me dhitë!" Ajo qeshte: "Oh, sa bukur!" I ıosha: "Ne në familjen tonë flemë përdhe, shtruar me jethe!" Ajo shkrihej: "Oh sa mirë!" I thosha: "Ne hamë ɔukë thatë ose me qepë!" Ajo: "Oh, sa mirë!" I thosha: Ne jemi shumë të këputur dhe vuajmë." Ajo: "Edhe unë i ju do të jetoj". Shëtitja me të. Kishte lexuar shumë. I ıëlqente Bajroni. I pëlqente Sheli dhe Shekspiri. Ajo ishte ıga Londra, nga një familje nga më të pasurat e Anglisë. ʒjyshja e saj nga nëna ishte një grua mjaft e pasur dhe Jendi ishte trashëgimtarja e saj, me një kusht: Uendi do ë martohej me kë të dëshironte, por do të jetonte me gjyshen, gjersa ajo të rronte. Po të mos jetonte me gjyshen, lo të humbiste trashëgiminë. Mua më dukej sikur po etoja një roman kalorsiak. E vërteta është se Uendi ishte ɜhumë e pastër nga të gjitha anët. Gjëja më e guximshme ɟë bënte, ishte që më kapte nga dora. Asgjë tjetër! Më ɜhikonte në sy, më thoshte se ishte më e lumtura në ɔotë, kur qe pranë meje.

Vinte në "*Cope*", ku unë shërbeja si kamerier. Ajo ɔriste gjersa mbaroja, dhe pastaj dilnim bashkë shëtitje. Shkonim në kinema dhe në *Sasenage.*

Një ditë erdhi në restorant një i ri simpatik, hëngri ɔukë dhe priti gjersa të mbaroja unë. Më tha se ishte i vëllai i Uendit. Dolëm jashtë të dy. Shkuam në kafenë '*Glacier*", atje ku e pinin kafen edhe shokët shqiptarë. Më tregoi se kishte ardhur nga Londra, me aeroplan personal, familjar. Më tha se Uendi më dashuronte, prandaj kishte ardhur. I thashë se me Uendin kisha vetëm një simpati dhe se nuk kisha ndër mend ta dashuroja e të martohesha me të. Ai u habit. I fola troç

dhe me sinqeritet. I tregova gjendjen time, madje ia bëra më katran. Ai më tha se kishte ardhur dje dhe kishte paguar për të marrë informacione të sakta për jetën time. I dinte të gjitha. Dinte se kush isha dhe ç'rrugë vazhdoja. Ai më tha: "Ju mund të vini në Londër, të mësoni gjuhën tonë dhe të botoni vargje e romane. Aty mund të keni mundësi më të mëdha për të realizuar ëndrrën tuaj të bukur. Gjersa të vdesë gjyshja, pastaj me Uendin mund të shkoni kudo, mund të shëtitni botën. I keni të gjitha mundësitë." Ai po mbaronte Fakultetin e Drejtësisë dhe do të ndiqte karrierën diplomatike. Megjithatë, menduam se si të vepronim për t'u ndarë nga Uendi. Vendosëm kështu: Ajo të nisej me të për në Londër, duke i thënë se, pasi të rregulloja punët e mia dhe të merrja pasaportën, do të nisesha edhe unë për në Londër. Ajo besoi dhe kështu u nis me aeroplan bashkë me të vëllanë. Nuk kaluan shumë ditë dhe nisi korrespondenca: dërgonte letra të gjata dhe albume me fotografi nga familja e saj, nga vilat në *Susex*, në *Wimbëlldon*, vila të bukura ku ishin shënuar me x dritaret e dhomave "të mia" pastaj të dhomës "sonë". Kishte bërë dhe fotografi me dy dhi të bardha, ku shënonte: "Edhe këtu kemi dhi të bukura!" Një fotografi të bukur të saj e mbaja kurdoherë me vete.

Dhe ja historia e asaj fotografie: Kur isha në burgun e Tiranës, më 1940-1942, në birucë, drejtori më solli një gazetar anglez. Ishte korrespondenti i "*Dail telegraf*" -it në Beograd. Kur u prish Jugosllavia, ky u hodh në Mal të Zi me luftëtarët. Aty e zunë italianët. Kishte dhjetë vjet korrespondent i *"Dail telegraf"*-it. Ishte martuar me një çifute me banim në Shkup. Njeri i çuditshëm. Anglez flegmatik.

I tregova fotografinë e Uendit. Ai kishte dëgjuar për familjen e saj në Londër. Kur iku, fotografinë ma mori me vete pa më thënë gjë. Pas Çlirimit, kur ishim duke bërë zgjedhjet e para, shumë gazetarë të huaj kërkuan

të vinin në Tiranë. Më thirri Koçi Xoxja dhe më tha se një gazetar anglez me emrin Eduard më kishte njohur në burg dhe kërkonte të vinte edhe ai në Shqipëri. Unë, kureshtar për fatin e fotografisë së Uendit, i thashë Koçit se e njihja dhe se ishte njeri i mirë. Erdhi Eduardi. E prita në hotel "Dajti", bashkë me shumë gazetarë të huaj. Isha kryeredaktor i gazetës "Bashkimi" dhe qeshë ngarkuar të prisja gazetarët e huaj. Folëm gjatë me Eduardin, i cili vazhdonte të ishte korrespondent i "*Dail Telegraf*"-it. Më tha se porsa ishte larguar nga burgu i Tiranës, në Itali e kishin këmbyer me një kolonel italian të zënë rob në El Alamein, në luftën e Tripolit. Pastaj ishte bërë gazetar korrespondent i luftës. E pyeta për fotografinë! Dhe ai nuk kishte se si të ma fshihte: "E mora dhe më shërbeu shumë. Me atë fotografi u këmbeva me kolonelin italian, me atë fotografi pata shumë lehtësi. E takova në Londër... dhe i thashë se të kishin vrarë italianët, që ajo të mblidhte mendjen, se vuante shumë..."

Pra: Jola, Seli dhe Uendi ishin tri vajza me të cilat kalova çaste nga më të pastrat dhe ëndrra nga më të bukurat, në kohën kur jeta ime ishte në furtunë. Dhe, po të vendosja të martohesha jashtë, me njërën nga këto mund të martohesha pa u menduar shumë.

Shumë të rinj e të reja njoha. Shokët shqiptarë të Grënoblit, më luteshin t'i njihja me ndonjërën nga ato shoqe të huaja që shoqëroja. Dua të them këtë: vajzat e huaja shoqëroheshin me një djalë, po të ishte shumë korrekt. Mjerisht kishte shokë shqiptarë që nuk qenë shumë korrektë.

Për këtë periudhë do të përmend dhe një episod të paharrueshëm:

Më thanë se në fakultet kishte ardhur një vajzë, nga më të bukurat që kishin parë gjer atëherë. Dhe kishin vënë bast me 1000 franga shokët shqiptarë se atë perri vetëm unë mund ta afroja dhe ta zija shoqe... Ma thanë

kur shkova në kafe. Ma tha Bilbil Klosi. Unë qesha dhe mendova: "Do ta pranoj bastin, se, po të fitojmë 1000 franga, ua dërgoj shokëve në kampin e përqendrimit" Pranova. Shkova në fakultet dhe, kur ra zilja për pushim dhe dolën të gjithë, doli dhe ajo. Ma tregoi Petrit Dishnica. Ishte me të vërtetë vajzë e rrallë. Vishte pantallona skiatorësh blu, xhaketë meshini bojë kafe, pulovër me shumë motive të bukura, këpucë skiatorësh; kishte flokë të gjatë. Nuk fliste me asnjë. Të gjithë e shikonin. Ra zilja për t'u futur në mësim. Unë vazhdoja kursin e historisë së artit (letërsi). Kur mbaroi mësimi, dola shpejt jashtë. Doli dhe ajo. I shkova pas nga krahu i majtë. Më hodhi një shikim të ëmbël. Shkoi në trotuarin tjetër. Shkova dhe unë në trotuarin tjetër. Më pa dhe më tha: "Mos jeni gabuar?" Nuk i fola fare. U fut në një permanent. U futa dhe unë dhe ndenja në sallon. E shiko-ja tek po e krihte një grua e gjatë. Kur mbaroi, pyeta sa bënte dhe pagova dy franga. Ajo nuk foli, po, kur dolëm jashtë, më zgjati dorën me dy franga. Nuk ia mora. Ajo vazhdoi rrugën. Unë në krah të saj. U fut në një pemëshitës. Bleu një kile portokalle dhe një kile mandarina. Pagova unë. Ajo u zemërua dhe diçka tha. Gruaja që shiste fruta, mori paratë nga unë dhe qeshi duke thënë: "S'kam parë çift të tillë! Që të dy jeni të prerë për njëritjetrin." Dolëm. Kërkoi taksi. U ndal një dhe shoferi hapi derën. U fut ajo, u futa dhe unë me frutat në duar. Shoferi pyeti për ku. Ajo i tregoi drejtimin. Më shikonte e heshtur, e habitur, e trembur. Më pyeti se kush isha. I thashë. "I ngarkuar nga Erosi për të mbrojtur ëndrrën tuaj!" Ajo qeshi. Taksia u ndal. Doli e para. Dola dhe unë. Më tha t'ia jepja frutat. "Jam i ngarkuar t'ju shpie deri brenda!" I ra ziles. Doli një zonjë e bukur, e veshur me robëdëshambër gjithë lule. "Mama, një kolegu im.", - i tha. Ajo më kërkoi ndjesë dhe më tha të ulesha në sallon gjersa të visheshin! Unë, sapo u futën ato në dhomat e tyre, ika. Ika.

Të nesërmen e pashë në oborrin e fakultetit që më vështronte. Unë bisedoja me disa vajza të tjera dhe nuk i dhashë rëndësi shikimit kureshtar të saj. Pastaj, kur u ndava nga ato shoqet, erdhi vetë tek unë dhe m'u ankua: "Pse ikët? Mamaja deshi t'ju njihte." I thashë: "A i telefonon mamasë që në drekë do të hamë bashkë, pastaj do të vemi në kinema dhe në orën gjashtë të shpie unë në shtëpi?"

Ajo shkoi i telefonoi dhe e ëma e lejoi.

Hëngrëm bashkë në "*Cope*", pastaj shkuam në kafenenë "*Glacial*", ku mblidheshin shokët shqiptarë. Kur më panë për krahu me të, u habitën. E shpura tek ata, e njoha me ta, pastaj u ulëm në një tryezë tjetër. Dëgjova shokët të thoshin: "I fitoi të 1000 frangat! Nxirri, Bilbil, dhe jepja!"

Shkuam në kinema. Më tha se ishte nga Parisi, më duket e bija e guvernatorit të Indokinës franceze. Kishte ardhur në Grënobël për shkak të luftës, se këtu ishte më e sigurt. Kur u afruam në shtëpinë e saj, i thashë të vërtetën: "Ishte një bast. Dhe unë e bëra për shokët e mi që janë në kamp përqendrimi" Ajo qau. I thashë se nuk do të shiheshim më. Ajo vazhdonte të qante, pa thënë asnjë fjalë. I thashë të ndaheshim. Ajo nuk fliste. Vetëm qante. As dorën nuk ma zgjati. Atëherë unë iu afrova dhe i përkëdhela flokët, e putha në sy e në buzë dhe vura re se ajo vazhdonte të qante. E mora për krahu, e futa në oborrin e shtëpisë së saj, i thashë mijëra fjalë të ëmbla, e putha përsëri dhe ika. Dhe nuk e pashë më. E quanin Paulina!

Një tjetër episod interesant:

Kur u ktheva nga Spanja në Paris, dilja nganjëherë edhe me Aliun. Një ditë, në kafenenë "*La Paulette*", na u afrua një vajzë e bukur dhe ndenji pranë meje. Unë në xhep kisha gazeta spanjolle. Ajo më tha nëse kisha pulla poste spanjolle. E pashë në sy. E bukur shumë. Aliu më

tha me zë të ulët që të mos ia zgjatja. Ajo më luste për pulla të Republikës Spanjolle: "Im atë ka qenë konsull në Barcelonë. Ju lutem më falni disa pulla dhe do t'ju jem mirënjohëse." I premtova se të nesërmen mund t'ia sillja. Ajo më tha: "Ja, atje përballë është stacioni i autobusëve që kalojnë nga shtëpia ime. Ejani atje, ju pres, vemi në shtëpinë time, t'ju njoh dhe me babanë. Në orën pesë ju pres!" - dhe iku. Të nesërmen, me gjithë porositë e Aliut që të mos shkoja në takim, vajta dhe ndenja fshehur aty në kopshtin "Luksemburg", ku luanin fëmijët. Ajo kishte ardhur në orën pesë. Priste. Priti më shumë se gjysmë ore, pastaj iku...

Pas një viti në Grënobël: Në restorantin tonë "*Cope*" vinin për të ngrënë edhe ata që nuk ishin studentë, të panjohur. I shërbeva një vajze shumë të bukur, e cila, sapo erdhi, m'i nguli sytë dhe s'mi shqiste. Hëngri, pagoi dhe nuk ikte. "Po ju pres! Dua të pi një kafe me ju", - më tha. Dolëm bashkë. Shkuam në kafe. Pastaj në kinema e më tej ajo më bindi që të shkonim në mbrëmje në *Sasenage*. Shkuam. Zumë një dhomë me qira. Unë nuk i kisha thënë emrin tim të vërtetë, i kisha thënë se isha sirian, me emrin Abdullah. Po ç'ndodhi? Unë flija, kurse ajo më thoshte: "Ngrihu, zoti Marko, dhe më jep pullat që më premtove! Pse nuk erdhe në orën pesë siç e kishim lënë?" E dëgjova të më fliste dhe i këputa një të shtyrë duke e vërvitur në dysheme dhe duke e sharë: "Spiune". Ajo buzëqeshi dhe tha: "Jam franceze dhe për të mirën tuaj e kam, jam ngarkuar t'ju shpëtoj. Jam e "*Deusieme byro*"-së. Pastaj e mblodha veten dhe desha të dija se ç'kërkonte nga unë.

Kisha dëgjuar se kishte jo pak spiune të bukura që u afroheshin shumë vullnetarëve të lirisë, i çonin në kufi dhe i dorëzonin ja në Itali, ja në Gjermani. Ishin agjente të Romës dhe të Berlinit. Unë duhej të manovroja se mos zbuloja gjë. Më tha: "Është e mira jote dhe e atdheut

tuaj që ti të njihesh me një shokun tim, i cili do t'ju ngarkojë me një mision shumë patriotik." Pranova. E lamë takimin të nesërmen, në një adresë që më dha ajo. Shkova te shokët e partisë, u thashë se ç'më kishte ndodhur. Ata u mblodhën dhe vendosën që të shkoja atje, në takim, dhe të qëndroja brenda jo më shumë se gjysmë ore. Po të vonohesha më shumë, do të vinin brenda dy shokë të fuqishëm të më shoqëronin, që të mos pësoja gjë. Unë nuk kisha orë. Më dhanë një orë dhe e futa në xhep. Shkova në orën tetë në adresën e caktuar. Jashtë prisnin shokët e mi.

Kur hyra në atë shtëpi, më priti një zonjë. Pastaj u dëgjua zëri i një burri, i cili erdhi, më dha dorën dhe më shpuri në një dhomë që ishte si zyrë. Ai u ul në vendin e tij, si zyrtar, më tha të ulesha edhe unë. Mbante syze të zeza dhe republikë. Më tha: "Ju jeni shqiptar i mirë. Ne kemi nevojë për ju, ashtu siç keni edhe ju nevojë për ne. Së shpejti do të jemi në luftë me Musolinin, kështu që armikun e kemi të përbashkët. Në Torino ka shumë oficerë shqiptarë, djem të mirë dhe patriotë... Ne duhet të lidhemi me ta. Ti i njeh dhe ata të njohin. Ne mund të të japim pasaportë franceze për të shkuar në Panairin e Milanos; takohu me disa nga ata, sa të krijojmë lidhje." - Pa orën. I thashë se duhet të mendohesha dhe se të nesërmen do t'i sillja përgjigje. "Ikë, - tha ai, se ke gati gjysmë ore që je këtu, dhe, po u vonove, mund të hyjnë këtu *les camarades*," - dhe buzëqeshi me ironi.

U raportova shokëve të partisë për takimin dhe sidomos se ai e dinte që unë duhej të qëndroja vetëm gjysmë ore brenda! Porosia e tyre ishte që të përgjigjesha: "Unë pranoj, vetëm me një kusht: ju të vini me mua në komisariat për t'u siguruar që jeni në shërbim të Francës!" Shkova të nesërmen. Ai menjëherë u ngrit dhe dolëm poshtë. Nxori makinën, u futa dhe unë brenda dhe u nisëm për në komisariat. Pas vinte makina e

shokëve. Dhe ai duke qeshur më thoshte "*Les camarades*! Nuk të lënë, ë? Të ndjekin pas, ë?"

Kur shkuam në komisariat, aty pashë dhe një profesor që e njihja. Ishte komunist. Më përqafoi dhe më tha se do të hynim bashkë te komisari. Më parë hyri ai i panjohuri e pastaj na thirrën edhe mua me profesorin. I pari foli ai i panjohuri: "Ky shqiptar dëshiron të sigurohet nëse jam francez dhe i shërbej Francës." Komisari qeshi dhe tha se ai ishte i shërbimit sekret të Francës. Atëherë profesori tha: "Ne e ngarkuam shokun shqiptar të vepronte kështu nga dyshimi se mos kishte rënë në ndonjë rrjet të agjenturave nazifashiste që i marrin shokët dhe i vrasin. Misioni i shokut tonë shqiptar këtu merr fund! Ai është poet dhe nuk merret dot me detyra të nëndheshme..."

Komisari u ngrit, më shtrëngoi dorën dhe më falënderoi në emër të Francës. Ishte po ky komisar që më dha dhjetë ditë leje qëndrimi në Francë, kur më përzunë nga shërbimi ushtarak dhe më hodhën si thes në një makinëburg. Nuk më kishte harruar.

Pyetje: - Ç'ndodhi me ty pas 1939-s?

Përgjigje: - Para se të tregoj se ç'më ndodhi dhe ç'bëra sapo hyra në Shqipëri, po rrëfej shkurtimisht...

PËRMES ITALISË, I LIDHUR ME PRANGA

Porsa shkela në tokën italiane, më hodhën prangat. Duhej të shoqërohesha i lidhur gjer në Shqipëri, ku do t'u dorëzohesha autoriteteve të Tiranës.

Kishte kuestorë të njerëzishëm, kishte dhe të rreptë. Njërit prej tyre, që m'u soll mirë, i kërkova leje të dilja në Torino e të takohesha me shqiptarët, se aty kishte shumë dhe unë do të bëja sikur u kërkoja ndihmë materiale. Qëllimi im ishte të takohesha me Nako Spirun e të kryeja

detyrën që më kishte ngarkuar Qamil Çela. U takova me të dhe i dhashë porositë. Aty banonte dhe Mihal Duri dhe Dragoti (inxhinieri). Mihali u gëzua shumë, kur më pa, dhe më tha se së shpejti do të kthehej dhe ai në Shqipëri e do të takoheshin patjetër në Tiranë.

Unë udhëtoja me trenin "*acelerato*", që ndalej në çdo fshat e në çdo lagje. Në Romë më futën në dhomën e sigurimit, se ato ditë kishte ardhur aty Von Ribentropi ose ndonjë tjetër hierark i Hitlerit. Lexoja shtypin fashist dhe mendoja se ku ishte Italia e ku Franca. Në Napoli, kuestori i mirë më pyeti nëse njihja ndonjë shqiptar (se edhe në Napoli kishte shumë shqiptarë), për të më ndihmuar, ngaqë atij i erdhi keq që unë të flija në dhomën e sigurimit me kusarët dhe vagabondët. I thashë se njihja Arturo Taliakocon, babanë e Jolës. Ai u habit dhe menjëherë më tha ta merrja në telefon. Më hapi numëratorin e telefonave, e gjetëm familjen Taliakoco dhe menjëherë telefonova. Doli një shërbyese. I thashë se isha Petroja. Dhe ajo pyeti e habitur: "Petroja i Francës?" "Po", - i thashë. Më tha ta merrja pakëz më vonë Jolën. Pas një ore, kur telefonova, Jola doli në telefon. U gëzua dhe u habit pa masë. Më shoqëroi një kuestor gjer te rruga "Xhuzepe Fioreli", te pallati ku banonte Jola. Portieri telefonoi dhe unë hipa në ashensor. Kur dola nga ashensori, më priste në korridor gjithë familja e Jolës: babai, nëna dhe katër shërbyeset. "Mos më puth, - më tha Jola, - se janë prindërit."

Shkuam me Jolën në kuesturë dhe ata i thanë se ajo mund të më mbante si mysafir sa të donte, edhe një javë, po të bëhej garante. Në familjen e Jolës u ndjeva mirë. Aty dëgjonim dhe Radio-Londrën, ku spiker në gjuhën italiane ishte vëllai i Jolës.

Pas tri ditësh erdhi nga Roma Franko Lombardi, ai që dashuronte Jolën. Ishte njeri i mirë, tepër i kulturuar, njëri nga më të kulturuarit që unë kisha njohur deri

atëherë, profesor filozofie dhe konferencier për shumë probleme shoqërore, nxënës i Benedeto Kroçes. Pse erdhi Frankoja? Kush e lajmëroi që unë isha në Napoli? Patjetër motra e tij Vera, e cila me siguri do t'i kishte thënë se Jolës i erdhi i fejuari. Ai erdhi me aeroplan dhe nuk na u nda: as në kinema, as në teatër dhe as në shëtitje. Unë i flisja sinqerisht shumë mirë për Frankon Jolës dhe i thashë: "Të këshilloj që të martohesh me të, se është një burrë i përshtatshëm për ty!" Frankoja hezitonte të martohej me të, siç kuptova unë, sepse ai jepte mësime edhe në Berlin dhe, meqë Jola ishte çifute, ai ngurronte të vendoste, se mund të kishte probleme me gjermanët. Frankoja nxitoi të shpallte fejesën zyrtare duke u trembur se mos Jola vendoste të lidhej me mua. (Më vonë do të tregoj më gjatë për Frankon, Jolën dhe familjen e saj.)

Kur arrita në Brindizi, ishte natë. Më futën në dhomën e sigurimit me kusarët dhe vagabondët. Të nesërmen duhej të nisesha për në Vlorë, po vaporët ende po ngarkoheshin. Sa do të vononin, nuk dihej. Më pyetën nëse njihja ndonjë shqiptar në Brindizi. M'u kujtua një mik i babait tim. Nga letrat që lexoja në komonë e madhe, ku babai mbante korrespondencën dhe dokumente të tjera tregtare, kudo shihja një emër: *Nicola Boci - Brindisi*; ai ishte komisioner. Ndaj pyeta kuestorin nëse rronte Nikola Boçi, që ishte një mik i babait tim. Më tha se ai ishte gjallë dhe gëzonte besimin dhe simpatinë e banorëve të Brindizit, ishte tregtar grosist. Një nga të kueturës më shoqëroi gjer te zyrat e dyqaneve të tij. Ishte një burrë i shkurtër, i shëndoshë, i veshur me të zeza. Edhe e shoqja e tij ishte e trashë, e veshur edhe ajo me të zeza si himarjote e pasur. I thashë: "Jam djali i Marko Janit nga Dhërmiu dhe vij nga Franca, ku studioja në Universitet." Ai u ngrit dhe përmendi disa herë emrin e babait tim. Më shpuri në një hotel të madh. Aty do të haja dhe do të flija për llogari të tij.

NË SHQIPËRI

Pas një mijë e ca ditësh kthehesha përsëri në atdhe. Një mijë me ca ditë e një qerthull ngjarjesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Kthehesha me pranga në atdheun tim të prangosur. Udhëtimi me vapor nga Brindizi për në Vlorë tetë orë zgjat, po për mua tetë orët m'u dukën tetë shekuj, se, duke qenë i lidhur me pranga në një vapor italian të ngarkuar me armë e me pranga..., më kalonin para syve si në një film të xhiruar ngadalë gjithë ëndrrat e mia...

Pas një mijë e ca ditësh, që qenë ngarkuar me një mijë e ca ngjarje, një mijë e ca episode, një mijë e ca persona që njoha, një mijë e ca dallgë të ashpra të jetës dhe të idealit, një mijë e ca tinguj revolucioni dhe nota sentimenti, ishte kompozuar në ndërgjegjen time një himn jete në furtunë dhe, si përfundim: e ëmbël është jeta plot ëndrra të ëmbla në furtunë! Hapat që hidhja, aksionet që kryeja, dhe vargjet që krijoja, nuk m'i impononte njeri, por ishin jeta ime, ëndrra ime, lufta ime, gëzimi im.

Kthehesha në atdheun e robëruar. Në poemën "Kushtrimi çlirimtar"shkruar më 7 prill 1939, një vit më parë, në Grënobël, shprehej shpirti im i revoltuar. Në veshët e mi gjëmonin këngët e brigadave internacionale, tingujt e revoltës dhe të shpresës për gjithë popujt e botës.

Kthehesha në atdhe me një pikëpyetje të madhe! (Më kujtoheshin fjalët që më shkruante Mehmet Shehu nga kampi i përqendrimit: *Të pret ja vdekja, ja tradhtia!* More Mehmet, parapëlqej të vdes i varur në atdhe, sesa të ngordh në burgjet e Evropës! Po, sidoqoftë, do të shihja vendin tim! Do të më qanin gratë e fshatit, sidomos motra ime, me ligjërime himarjote që shprehnin dufin e derteve dhe të kalvareve! Po kthehesha në atdhe! Ishte dhe urdhri i Kominternit: "Të *gjithë komunistët, legalisht ose ilegalisht, të kthehen në vendet e tyre!*"

Vapori u ndal dhe hodhi spirancën në Skelë të Vlorës. Ai që më shoqëronte, ishte njeri i mirë, si shumica e italianëve. Më tha se duhej të më hidhte prangat. Valixhja që mbaja, ishte e madhe dhe e rëndë: nuk mbahej kollaj me duar të lidhura. Sapo dolëm në tokën shqiptare, unë u hutova. Diçka e çuditshme, e pakuptueshme, e pashpjegueshme më mjegulloi mendjen. Dikush nga ata të doganës shqiptare, sapo më pa, më njohu. Ai që më shoqëronte, dorëzoi një zarf të mbyllur, të cilin e çeli një toger shqiptar. Ky më pa një herë mirë, pastaj tha me zë të lartë: "Urdhri është që ti t'u dorëzohesh autoriteteve shqiptare. Ja, u dorëzove. Tani ne të pamë që erdhe, prandaj je i lirë të shkosh në fshatin tënd!" - dhe m'i hoqën prangat. Italiani që më shoqëronte, më përshëndeti dhe më tha "*buona fortuna*!" Me valixhen në dorë, dola nga zyrat e portit dhe u drejtova për në shesh, aty ku rrinin karrocat. Doja të merrja një karrocë dhe të shkoja në hotel "Himara", pastaj të nesërmen drejt e në fshat. Kisha ende nja dyqind lireta nga ato që më kishte dhënë Nikola Boçi, miku i tim eti, dhe vjehrri i Stavri Vinjaut. Kur isha duke ecur, një ish-oficer, kushëriri i Mehmet Shehut, më njohu, m'u afrua,më përshëndeti dhe më tha: "Pse erdhe? Ne jemi të gjithë në hava dhe s'dimë ku të shkojmë." Dhe unë: "E mira është që qëndrojmë të gjithë këtu, se këtu është jeta jonë, varri ynë!" Më pyeti për Mehmetin dhe i thashë se ishte në kampin e përqendrimit, bashkë me Mane Nishovën, Zef Prelën dhe Skënder Luarasin.

Kaloi andej një miku im i vjetër, Ibrahim Shyti. Më përqafoi fort me dashuri dhe më mori me zor në shtëpinë e tij, ku më priti me ngrohtësi gjithë familja, e shoqja, djemtë dhe vajza. Aty ndenja gjithë ditën. Pasdreke iu luta të më lejonte të shkoja në hotel "Himara". Kishim folur shumë për situatën. Unë u tregova ato që dija, dhe, sipas bindjes sime, u thashë se Italia nuk do të qëndronte për shumë kohë te ne. Ata më dëgjonin.

Ibrahim Shyti më mbajti edhe natën. Nuk më linte të shkoja. Në mëngjes, kur po hyja në hotel "Himara", nga e djathta e hyrjes, në sallën e restorantit, bëhej një mbledhje e madhe. Kureshtar, hyra brenda dhe ndenja më këmbë, pranë derës. U habita me gjuhën që përdorte nëpunësi i komunës; ai fliste dhe nja pesëdhjetë fshatarë me takije të bardha në kokë dëgjonin të heshtur se si Duçja kishte dërguar misër pa para për të uriturit e Shqipërisë dhe se misri ndahej "pesë okë për kokë" falas.

Në këtë mbledhje dhe me këto që thoshte folësi, unë menjëherë sintetizova gjithë politikën agresive dhe kriminale të fashizmit italian. Që kur kisha qenë në Tiranë, propaganda fashiste punonte me plan për pushtimin e Shqipërisë. E para: e la popullin në mjerim; e dyta: propagandonte se Zogu, ndihmat që merrte nga Musolini, i përdorte për qejfet e tij dhe të njerëzve të tij, kurse popullin e kishte zhytur në uri e në mjerim. Dhe kasnecët përhapnin: "More Zogu të na ikë nga Shqipëria, pa le të vijë këtu edhe tartari." Musolini përzuri Zogun dhe erdhi vetë këtu për t'u bërë zot i këtij vendi. Dhe tani, me "lëmosha dhe kujdes të veçantë për të uriturit ndante misër pa para, pesë okë për kokë". Fliste nëpunësi i komunës:

- More derra, thoni rrnoftë Duçja, shpëtimtari i Shqipnisë! - Asnjë s'bënte gëk! - Bërtitni, more derra, rrnoftë Musolini, rrnoftë Italia fashiste, se ja, po na qan hallin e na dërgon misër pa para! - Asnjë s'bënte gëk. Heshtje. Atëherë ai bërtiti: - Shpërndahuni, derra!

U dëgjua një zë i mekët:

- Unë kam dhjetë kuintalë eksiq.

Vazhduan të tjerët me radhë:

- Edhe unë, kam tetë kuintalë eksiq!
- Edhe unë kam nëntë kuintalë eksiq.
- Edhe unë kam shtatë kuintalë mangut!
- Edhe unë...

Të gjithë kishin disa kuintalë mangut. Atëherë folësi i ra tryezës me grusht dhe bërtiti me zë të lartë:

- Dëgjoni, more derra! - dhe hapi çantën e nxori andej kodin civil, që e përdorte për martesa dhe lindje. Hapi një faqe dhe bërtiti: - Artikulli 555 i kodit penal: ai që kundërshton dhe intervenon dhe asfikson dhe deponon dhe denoncon dhe agjiton, ka njëzet vjet burgim! - Ai fliste dhe të gjithë kryetarët e fshatrave, ose më mirë kryepleqtë e fshatrave të Topalltisë, iknin një e nga një të shoqëruar nga tingëllimi i neneve dhe paragrafëve që citonte kot folësi, për t'i trembur e për të mos zënë fare në gojë "kuintalët eksiq." Mbeta vetëm unë pranë derës. Kur hoqi syzet e më pa, thirri:

- *E vostra sinjoria cosa...*

- Jam unë, - i thashë dhe iu afrova.

- Kush jeni ju, zotëri? Nuk ju njoh!

- Jam unë, - dhe i tregova se kush isha.

Ai më përqafoi dhe më tha:

- More po gjallë je!? Kur erdhe? Pse erdhe?

Biseduam ca, pastaj e pyeta se ç'ishin ata kuintalë "eksiq" dhe ai, duke më rrahur shpatullat, më tha:

- Pse, gomar jam unë të mos marr nja njëqind kuintalë badihava?

Deshi të më qeraste, por unë e falënderova dhe u ndava nga ai qejfprishur dhe i revoltuar për aq sa pashë e dëgjova nga rendi i ri fashist në Shqipëri! Po thashë me vete: "Ky ashtu ka qenë! Ndërsa njerëz si Ibrahim Shyti me gjithë djemtë e tij, shqiptarë të mirë ishin dhe shqiptarë më të mirë u bënë tani; karrieristët, nën çdo flamur, atë profesion kanë! Kurse populli, bij të të cilit janë, mbetet gjigant dhe i pamposhtur!"

Shumë fshatarë të mi që takoja në Vlorë, gëzoheshin që më shihnin gjallë, dhe më uronin.

Kur u nisa për në fshat, i hodha një vështrim Shkollës Tregtare, ku u rrita. Aty mbinë gonxhet e para

të ëndrrës sime për një botë të lirë dhe më të mirë. Aty shkrova vargjet e para. Andej dërgova të parën vjershë që m'u botua me pseudonimin "Vlonjati" te "Shqipëria e re", në Konstancë (Rumani) më 1929, kushtuar Ismail Qemalit. Shekuj larg më dukej ajo jetë e ëmbël, plot ëndrra dhe shpresa... Dhe gjatë gjithë asaj rruge, Vlorë--Dhërmi, më fanitej gjithë rinia ime. Sapo arritëm në Dukat, m'u kujtua armiqësia e familjes sime me disa familje nga Dukati, për vrasjen e xhaxhait tim, Andreas, më 1914, në kohën e andartëve grekë. Dhe më lindi një ide: pajtimi! Duhej të pajtoheshim, se të huajt na bënë armiq dhe tani të huajt na kishin zënë derën. Duhej të pajtoheshim! Ishte kjo ideja që më lindi, të cilën mendova ta realizoja.

Kur arritëm në Qafë të Llogarasë, mendimet dhe kujtimet qenë shumë të hidhura: im vëlla, Fotoja, u kthye nga Franca i veremosur dhe kaloi disa kohë aty për të shtuar ditët e jetës. Xhaxhai im, Andrea, u vra... Poshtë shtrihej panorama më e mahnitshme e botës, ajo panoramë që për një çast i zbuti edhe esesët gjermanë gjatë luftës.

Rruga që bashkon Dhërmiun me Vlorën, për mua është rruga e parë e mërgimit, dhe në çdo pëllëmbë të saj për mua ka edhe një kujtim. E njihja! E njihja si hapat e ëndrrave të mia, si hapat e derteve dhe të gëzimeve të mia!

NË DHËRMI, NË LLOGOREN E ËNDRRAVE TË MIA, NË DJEPIN E FANTAZISË DHE TË FLUTURIMEVE TË MIA...

Prilli i vitit 1940. Italia mbushte vitin që kishte pushtuar vendin. Në fshat e dinin që unë isha kthyer, dhe më prisnin.

Sapo pashë shtëpinë time, të cilën e kisha imagjinuar si një pallat të madh, m'u duk mikroskopike. Të gjithë kishin dalë të më prisnin, përveç mama Milles. Ajo kishte vdekur! Liloja qante siç qanin të gjithë me radhë: gruaja e Andonit, gruaja e Agjisillës (kur ika unë Agjisilla ishte beqar), Jani dhe gjithë familja e tij. Erdhën atje të gjithë kushërinjtë, farefisi dhe fqinjët. Shtëpia u mbush dhe të gjithë më përqafonin, se më dinin të vdekur në luftëra dhe burgje! Daja, xha Foti, fliste për Karaibet, për Spanjën, për Mesdheun, për Adriatikun, për Jonin. Dreka, darka, vazhduan për shumë ditë. Jani bëri një darkë të madhe, si dasmë.

Shtëpia ime, familja ime, guri im, djepi im, Llogorja ime! Tani shtëpia kishte marrë madhështinë e parë dhe çdo qoshe dhe centimetër i mureve, orendive kishte për mua dhe një legjendë. Qava për mama Millen. I shkova te varri dhe me mend bëra me të një bisedë prekëse:

Unë: - Mama, erdha.

Mama Millja: - Erdhe, a të keqen!

Unë: - Erdha, mama, erdha dhe ja ku jam, këtu, pranë teje!

Mama Millja: - Pranë meje kam prindërit e tu, kam Andrean, kam Foton. Ti duhet të jetosh për të vazhduar atë që ata nuk plotësuan. Por pa më thuaj: I mbajte porositë që të dhashë?

Unë: - I mbajta.

Mama Millja: - Paç uratën! Po konjakun a ma solle?

Unë: - Ta kam sjellë. Ja ku e ke!

E kisha zakon që, kur kthehesha në shtëpi, kudo të kisha qenë, blija dy shishe konjak. Njërën për mama Millen e tjetrën për mama Tullën. Ato i mbanin në karsellë, si ilaç, dhe pinin nga një gllënjkë para se të flinin. Vendosa shishen e konjakut "Metaksa" në gurin e varrit të saj.

Më vonë mora vesh se atë shishe e kishte marrë Leli, (ashtu i thoshim Vangjel Bixhilit, një kushëririt tim, që

ishte shumë shakaxhi dhe kishte një mori aventurash në fshat).

Pyetje: - Si ishte situata politiko-shoqërore në fshatin tënd, kur u ktheve dhe e gjete të pushtuar?

Përgjigje: - Shumë e mirë.

Dhërmiu, fshati im i dashur, është një nga fshatrat e Himarës për të cilën poeti dhe patrioti Nase Beni ka kënduar:

Shtatë fshatra që janë/ aman, trima kapedanë!/ Të penës e të dyfekut,/ Ç'i tregojnë gjoksin dovletit,/ Si zogjtë në tramundanë!/

Himara ka një histori të dëgjuar. Gjatë shekujve luftoi me Turqinë dhe jetonte e pavarur! Atë kohë në Ballkan Suli dhe Himara ishin dy krahina që nuk u përkulën kurrë. Qysh pas vdekjes së Skënderbeut, këto dy krahina ishin kthyer në vatra të lira. Dhe, duke kaluar koha, banorët e tyre thoshin: Jam himarjot (nuk thoshin jam shqiptar ose grek), ashtu siç thoshin dhe suljotët: jam suljot (nuk thoshin jam grek a shqiptar). Kjo vazhdoi për shekuj dhe himarjoti thoshte dhe thotë: jam himarjot, po ashtu si dhe suljotët, me të cilët kishte krushqi dhe lidhje. Motra e Marko Boçarit ishte martuar në Dhërmi dhe kishte lindur kapedan Jani Kocanin.

Himarjotët mbijetuan, se ishin shumë solidarë në mes tyre. Banorët kishin kanunet e tyre (dhe ato të Lekë Dukagjinit.) Çdo problem krahinor zgjidhej nga pleqësia e krahinës. Edhe problemet e vështira të fshatit a të familjeve të veçanta i zgjidhte pleqësia. Nuk kishte gjykata. Gjyqtarë ishin pleqtë e caktuar për këtë punë. Dhe pleqësia nuk përbëhej nga ata që mund të ishin më mirë nga gjendja ekonomike, po nga burrat e ndershëm dhe të urtë. Kjo vazhdoi gjer vonë. Mund të sjell një shembull:

Kur isha mësues në Dhuvjan të Dropullit, më erdhi atje vëllai im Andoni. Më tha se e kishte dënuar pleqësia

e fshatit gjashtë muaj largim nga fshati, pse i kishte kënduar publikisht një këngë një vajze të pamartuar.

Për të përcaktuar mirë dhe drejt karakterin e himarjotit, duhet lexuar dhe njohur e kaluara e tij. Deti, mërgimi, lufta, e kanë lidhur me Venedikun, me Napolin, me papën, me Spanjën, me Rusinë; tregje kishte Janinën, Korfuzin, Venedikun, Triesten, Barin, Brindizin, Pirenë, Patrasin. Filloi dhe emigracioni ekonomik, në Vllahi, në Rusi, në Llavrio të Greqisë, në Korint, për të hapur istmin. (Andej, një nga familja Vreto solli në krahë të parën vare në fshat, që të nxirrte bukën e gojës duke thyer gurë. Ai, që nga Korinti e gjer në fshat erdhi më këmbë, me varenë në krah.) Pastaj u hap emigracioni për në minierat e Francës, pastaj për në Amerikë, në Meksikë, në Argjentinë, në Australi e gjetkë. E ku nuk shkuan himarjotët për të fituar bukën e gojës, se Himara është një vend i varfër dhe nuk i mbante dot me bukë.

Himara u shtua shumë pas vdekjes së Skënderbeut, se aty erdhën shumë familje nga Veriu. Ja, bie fjala, një lagje e Dhërmiut, Gjinleku, është nga Kruja. Edhe sot e kësaj dite, ashtu thonë banorët e Gjinlekut ose të Gjilolit - siç thoshin plakat: ne jemi nga Kruja.

Përmenda me pak fjalë disa nga karakteristikat e banorëve të Himarës. Lindën dhe jetuan me shpirt pavarësie, prandaj edhe sot e kësaj dite shumica e djemve nuk synojnë zyra që të ulen e të bëhen zyrtarë, po punëra që të lëvizin, si shoferë, mekanikë e teknikë. Fshati im sot ka më shumë se 1500 shoferë.

Nuk dua të zgjatem më. Këtë punë le ta bëjnë historianët, por unë do të tregoj disa veçori të fshatit tim. Siç e kam thënë në fillim, gjatë kohës së Zogut fshatarët u ndanë në dy parti: pendëkuqtë dhe pendëbardhët. Të parët ishin me Tiranën, të dytët me Athinën. Të parët kishin shkolla shqipe; të dytët, shkolla greke. (Dhe çudia ishte se një vëlla ishte pendëkuq dhe tjetri pendëbardhë.) Familja Markaj ishte e tëra pendëkuqe, me Tiranën;

mbanin në ballkonet dhe në dhoma flamurin e Shqipërisë.

Për propagandën greke mund të flitet shumë, po këtë le ta bëjnë historianët. Himara nuk është greke.

Pyetje: - Po nga ana ekonomike, si ka jetuar Dhërmiu?

Përgjigje: - Dhërmiu ka jetuar më mirë se të gjitha fshatrat e Himarës. Sidomos duke filluar nga fundi i shekullit XIX, se dolën qitrot. Më parë jetonin keq e mos më keq. Mblidhnin valanidhe e i shisnin në Itali. Fshati ka shumë ujëra. Dhe ujërat, që janë jeta e fshatit, ishin burimi i bahçeve të bukura me portokalle, limonë, me vreshta, me ullinj, po që me to nuk sigurohej as buka e gojës. Po, me kultivimin e qitrove, siç e kam treguar në fillim, fshati u pasurua shumë. Kultura e qitrove nuk e di se si nisi. Çdo vit hynin në fshat rreth 300 000 dollarë.

Gjithë vajin që prodhonin, e hanin vetë. Nuk kishte familje që të mos konsumonte të paktën një litër vaj në ditë, se vaji ishte ushqimi: me lakra, me ullinj, me limon, me peshk, vaji mbushte pjatat. Edhe verën e rakinë nuk i shisnin, i pinin vetë. Me qitro bakalle dhe agrume ushqenin lopët dhe bagëtinë manare. Fshati kishte disa karave, kaike dhe varka me një velë, që lundronin në Adriatik dhe në Jon. Kishte dhe dy makina që bënin linjën Vlorë-Sarandë. Dyqane kishte shumë. Kishte dhe 16 mullinj, ku bluante gjithë krahina e Himarës; trokoj shumë, ku shtrydheshin ullinjtë, dhe shumë dyqane bakalli, ku fshatarët blinin me defter (veresie). Kishte dhe shumë kisha (nja njëzet e gjashtë) dhe tetë priftërinj; dy manastire të mëdha: Stavridhin dhe shën Theodhorin, ku fshatarët familjarisht shkonin si në piknik. Kishte një shkollë shumë të vjetër, të cilën e pati ndërtuar me paratë e tij Gjikë Bixhili, që i dërgoi të hollat nga Rusia. Pano Bixhili, babai i tij, ishte konsulli i parë i Himarës te cari, në Peterburg.

Një nga shkaqet kryesore që dhërmiasit u bënë kundër Hitlerit, qe zhdukja e çifutëve prej tij, domethënë zhdukja e burimit të jetesës së tyre.

Kur erdhi Italia, kur vendi u bë shesh i ushtrive të mëdha dhe i lëvizjes së madhe të mallrave, dhërmijasit nisën të lëviznin, të fitonin, si kudo ku kishte para. Blenë automobila, filluan tregtinë e madhe me Italinë. Lëvizje e madhe!

Më kujtohet se, kur u ktheva unë në fshat, qitrot kishin çelur lulet e tyre të bardha dhe aroma e veçantë përhapej kudo. Fshatarët shpresonin se Hitleri do të mundej nga Fuqitë e Mëdha dhe kështu do të shpëtonin çifutët, burimi i pasurisë së fshatit. Po në atë kohë, pas shtatë muajsh të pushtimit të Polonisë, çifutët shfaroseshin tërësisht në pogrome. Fshatarët nuk i prishën qitrot, i mbanin edhe kur në fshat erdhën hitlerianët. Edhe pas Luftës vazhduan t'i mbanin, me shpresë se ishin rrënjët përrallore të burimit të jetës me bollëk. Më kujtohet se më 1945 mora një letër nga një kushëriri im nga Amerika, Kiço Bua, ku më shkruante se kryerabini i çifutëve pyeste nëse kishte ende qitro në Dhërmi; nëse kishte, ai i blinte me 10 dollarë kokrrën.

Pyeta në fshat dhe më thanë se në vjeshtë, në kohën e eksportit të qitrove, mund të bëheshin nja 20 mijë kokrra. U interesova, vajta dhe fola me Nako Spirun, që ishte ministri i Ekonomisë, dhe ai më tha se si qeveri nuk kishin asnjë mjet transporti dhe se UNRRA, që ishte krijuar për të ndihmuar vendet e dëmtuara nga lufta, nuk do ta pranonte një gjë të tillë. Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi: Ata të UNRRAS, që kishin mjetet e transportit, nuk e pranuan në asnjë mënyrë këtë punë.

Pyetje: - Ç'bëre kur shkove në fshat, me se u more?

Përgjigje: - E para e punës unë realizova idenë e pajtimit me Dukatin. Fola me kushëririn tim, Janin. E binda. Nuk bindej e ëma, nuk bindeshin motrat e tij, që

nisën të ulërinin, duke thënë se, po të mos merrej gjaku i Andreas, do të mbeteshim pa dinjtet e pa nder. Më kujtonin amanetin e babait tim.

Më në fund Jani u bind që ne duhej të pajtoheshim, se të huajt na gjakosën dhe na armiqësuan dhe të huajt tani donin të na gjakosnin e të na përçanin përsëri.

Dërguam fjalë në Dukat me Neço Spiron, që ishte njeriu ynë, pasi ishte martuar me Amalinë, vajzën e madhe të Andreas, motrën e Janit. Neçoja ishte njeri me logjikë. Edhe ai në fillim nuk e pranoi, pastaj, si burrë i pjekur, me një tufë kalamaj, e pranoi. Shkoi në Dukat dhe, kur u kthye, tha se ata ishin të gatshëm e të gëzuar të bënin një akt vëllazërimi me ne. U caktua dita që do të vinin. Dhe erdhën 25 burra, paria e krahinës së Dukatit, si Mehmet Alemi, Ymer Muçoja, Tahir Hoxha e të tjerë.

Darka u shtrua në dhomën e madhe të shtëpisë sonë. Gratë qanin, po Jani ishte shumë autoritar dhe u imponoi qetësi e dinjitet: "T'i presim sipas zakonit shqiptar, me dinjitet dhe bujari."

U caktua që javën e ardhshme të shkonim ne në Dukat. Vajtëm dhe ne 25 burra, si pari e Himarës. Isha dhe unë. Shkuam te shtëpitë e Hamit Selmanit, që i kishte aty në një krah të fushës, nga e djathta, kur shkon për në Vlorë. Na pritën shumë larg shtëpisë, që nga xhadeja. Shkuam dhe aty pamë se ishte mbledhur një turmë e madhe burrash nga gjithë krahina e Dukatit. Dreka u shtrua në dhomat e mëdha të sarajeve të Hamit Selmanit.

Me kërkesën e plakut Hamit u vendos që unë të qëndroja përballë tij, në krye, "pasi, - siç thanë ata, - ti je më plaku nga ne, se ti mendove për këtë pajtim pas njëzet e pesë e kusur vjetësh." Kur ishim duke biseduar për situatën e re në Shqipëri, një mik i familjes sonë, që ishte thirrur dhe ai, xha Sefer Vangjeli, rapsod me nam, kërkoi leje t'ia merrte një herë. Iu dha leja dhe filloi me sy të mbyllur e të përlotur:

"Ç'është kështu, që dëgjojmë/ qaj, medet, o Vlora jonë!/ Italianët po zbarkojnë/ qaj, medet, o Vlora jonë!/ Me pampor' e me ballonë,/ qaj, medet, o Vlora jonë.../ Jo, nuk e harroj atë ditë, kur burrat e krahinës së Dukatit këndonin këtë këngë me lot ndër sy (sytë i kishin mbyllur) si një vajtim, si një kushtrim, si një kushtrim kundër Italisë. Aty pashë me sy burra të vërtetë patriotë, pashë ata që e hodhën në det Italinë më 1920 dhe, të them të drejtën, aty m'u ndez gjaku dhe shpresa dhe thashë me zë të fuqishëm:

- Përsëri do ta hedhim në det, si më 1920! - Më puthën me radhë. Ai pajtim u kthye në një manifestim antiitalian. Nuk e harroj kurrë atë ditë. Ne u pajtuam dhe rinisëm miqësinë që kishin prindërit tanë para ardhjes së andartëve në Himarë më 1914.

Nga shumë pyetje që më bënin për situatën në Evropë e në botë, nuk harronin të më pyesnin për Halim Xhelon nga Tërbaçi, me të cilin kishte të bënte Mehmet Alemi. Flisnin për të si për njeriun më të dashur e më të shquar të Vlorës. Vura re, për çudi, se Skënder Muços nuk i vinte mirë që mburrej kaq shumë Halimi. Atëherë unë, me lejen e të zotit të shtëpisë, kërkova të merrja një këngë:

Të ka rritur Labëria, / djalë i popullit, Halim,/ Të ka pritur Shqipëria, Halim Xhelo, trim, o trim/ Të prit' që të dilje në Vlorë/ me flamur të kuq në dorë/ Halim Xhelo, trim, o trim/ (Këtë këngë e kisha shkruar në Spanjë dhe do të botohej në numrin e dytë të "Vullnetarit të lirisë", bashkë me një këngë për Riza Cerovën.) Kur po këndonim këngën, buçiti dufi patriotik, burrat u ngritën në këmbë dhe më puthnin me fytyra të lagura nga lotët.

Nuk e mbaj mend se cili thirri (ja Tahir Hoxha, ja Gaqe Kaporra):

- T'i lëmë mënjanë armiqësitë me njëri-tjetrin; sot armik kemi vetëm një : Italinë!

Pyetje: - Me kë u takove dhe ç'bëre kur shkove në Tiranë?

Përgjigje: - Më duket se ka qenë fundi i prillit të vitit 1940. Tirana ziente nga lëvizja. Edhe gjatë udhëtimit Vlorë-Tiranë rruga ziente nga makinat ushtarake. Vajta drejt e te kushëriri im Vangjeli, që punonte në shoqërinë automobilistike "Sakt". Ai më shpuri në shtëpinë e Shevqet Musarajit, që punonte në Bankë. Në atë dhomë kishte banuar Branko Merxhani, i cili i kishte lënë aty gjithë librat dhe katandinë e tij, sidomos doreshkrimet e revistës "Përpjekja shqiptare". Shevqetit iu luta të më ndihmonte të takohesha me shokët. Më pruri aty shumë shokë, si Vasil Shanton, Zef Malën etj.

Puna e parë dhe më kryesore që bëra te dhoma e Shevqetit, qe kjo:

Shevqeti, Aleks Çaçi, Andrea Varfi e të tjerë botonin revistën "Antologjia". Tek "Antologjia" kishin botuar dhe disa vargje të mia me pseudonimin Petrit Kurbeti. Ua kishte dhënë Dhimitër Shuteriqi, se ai mbante shumë nga vjershat e mia. Kishin botuar dhe vargje të Migjenit dhe të shumë të tjerëve. Unë u thashë se nuk duhej të pranohej subvencion nga Italia fashiste për të botuar një revistë letrare e cila kurrë nuk do të pasqyronte frymën patriotike dhe idealin tonë. Ne duhet ta sabotonim këtë propagandë dhe, nëse donim të shkruanim, le të shkruanim dhe krijimet tona t'i përhapnim ilegalisht, siç përhapi Selfixhe Ciu "Kushtrimin çlirimtar" për 7 prillin, që shkrova në Grënobël.

U bindën dhe "Antologjia" nuk doli më.

Në përgjithësi isha i irituar nga sa shikoja dhe nga sa dëgjoja. Më dukej sikur të gjithë ishin bërë fashistë dhe shikonin punët e tyre, të jetonin mirë, të pasuroheshin, pra sikur deti u bë kos dhe o burra kush të hajë më shumë. Duke ecur andej nga Rruga e Dibrës, kaloi një jerark me uniformë të madhe, kapardisur, me spaleta gjithë ar. Më vështroi dhe më foli:

- Si je, o Petro? Bëre mirë që u ktheve edhe ti!

Mezi e njoha: ishte Q.K., një shok i Shkollës Tregtare,

që e la shkollën qysh atëherë për grada ushtarake. Shpreha habi se si ishte bërë ashtu, dhe ai m'u përgjigj.

- Unë nuk kam kokën tënde!

Po me këtë gjuhë ia ktheva edhe unë.

- As unë kokën tënde!

Që kur qeshë në Francë, vrisnim mendjen me shokët se kush i shkruante artikujt për fashizmin që botoheshin në gazetën "Tomori" dhe që ishin nënshkruar nga Dr. Omer Nishani. Ishin vërtet të doktorit apo të ndonjë tjetri?! Se doktori kishte qenë përgjegjës i "Lirisë kombëtare", organ i Konaresë. U interesova dhe e gjeta se ku banonte doktori, megjithatë u mendova gjatë dhe vendosa të mos e takoja.

Kërkova takim me Mustafa Krujën, i cili më pranoi menjëherë. Më foli "përzemërsisht"

- Bëre mirë që u ktheve, se tani ne, si fashistë, dhe ju, si komunistë, kemi lidhje dhe afrim të madh, si Stalini me Hitlerin, që u bashkuan kundër plutokracisë perëndimore. - Shante borgjezinë franceze dhe angleze. Pastaj: - Tani ç'keni ndër mend të bëni? Unë mendoj se për ju është mirë të punoni si zëvendësministër i Kulturës. Ai fliste dhe unë e dëgjoja. E pa që unë nuk po përgjigjesha.

Mustafai më premtoi një ndihmë modeste në të holla dhe më tha:

- Të futëm në listën e emigrantëve politikë! Cilido që është kthyer si emigrant politik, ka marrë një ndihmë në të holla. Merri dhe ndihmo familjen tënde, që është e varfër.

- Ju e dini që unë jam kundër parasë! Po të kem nevojë ndonjëherë, do t'ju drejtohem ...

Ai këmbënguli:

- More budalla, merri! Ti nuk lëshon asnjë firmë gjëkundi! Po nuk i pëlqeve ti, jepua vëllezërve, kushërinjve, fshatarëve. Kush nuk e do paranë, përveç hajva-

nëve! - dhe u ngrit më këmbë e më thoshte se ai më kishte respektuar dhe çmuar shumë, se kishte lexuar vjershat dhe shkrimet e mia dhe qysh atëherë kur na dërgonte te "Përpjekja shqiptare" shkrime albanologjike me pseudonimin Shpend Bardhi, për mua dhe për Brankon kishte një simpati të veçantë... - Po Brankoja u tregua mendjelehtë. Iku dhe tani po vuan për bukë rrugëve të mërgimit. Kurse ti bëre mirë që u ktheve. - Fliste për perspektivën e Shqipërisë, që do të lulëzonte nën suazën e Italisë së madhe dhe do të bëhej një shtet evropian. E pa që unë nuk përgjigjesha. U ngrita dhe ika. Ai nuk më dha as dorën. (Pas Çlirimit, në oborrin e Gjykatës Ushtarake italiane u gjendën stiva me dosje dhe dokumente të hedhura. Midis tyre, një shok, Andon Kuqali, kishte gjetur dosjen e procesit tonë të Vlorës për traktin, ku flitej shumë për mua. Kishte gjetur dhe disa poezi, si "Nase Labin" e të tjera e m'i dha. Lexova procesverbalet e vitit 1940, në Vlorë, ku midis të tjerave ishte dhe deponimi i Mustafa Krujës, i cili ishte pyetur për mua dhe kishte thënë: "Sapo doli nga zyra ime, dhashë urdhër të survejohet". - Për këtë do të flas më gjatë, kur të tregoj për traktin e Vlorës).

Takova dhe disa të tjerë, si Qazim Koculin, Azis Çamin.

U largova nga Tirana, i vrerosur për atmosferën fashiste, për ato që pashë dhe dëgjova, sidomos për qëndrimin e shokëve ndaj situatës dhe për pikëpamjet e tyre të moderuara ndaj pushtuesit fashist. Dhe Radio-Tirana ishte kasnec i fashizmit, me gazetarë e artistë që, për të ngrënë bukë, u duhej të bënin politikën e okupatorit.

Gjatë rrugës për në Vlorë vija re një lëvizje të madhe automjetesh ushtarake, rrugët po zgjeroheshin me shpejtësi nga ushtarët dhe punëtorët italianë. Një atmosferë tensioni lufte. Në Vlorë e kudo bëhej propagandë për të rekrutuar milicë kundër Greqisë.

Me gjithë këtë situatë të tensionuar, si mund të rrija duarkryq unë që isha kthyer nga lufta e Spanjës në atdheun tim të robëruar nga fashizmi?!

Me të arritur në Vlorë, në shtëpinë e Ibrahim Shytit, fola me Luterin, djalin e tij të madh. Edhe ai ishte dakord që të bëhej një trakt shqip dhe një italisht për të sqaruar masën rreth rekrutimit të milicëve kundër Greqisë. Në librarinë e tij, në një zyrë, pas sallës, ishte makina e shkrimit. Aty u hartuan dy traktet: shqip dhe italisht. Shqip ishte pak a shumë me këtë përmbajtje: *Vëlla shqiptar, mos u gënje të luftosh kundër të tjerëve, ku të shtyn pushtuesi e të gënjen, se armiku yt është Italia fashiste, që të ka zënë derën. Të bashkohemi e të organizohemi e ta hedhim në det si më 1920!* Kurse italisht: *Vëlla ushtar italian! Ti pse je këtu? Pse të kanë gënjyer e të dërguan të pushtosh një atdhe që nuk është yti? Ky atdhe është i shqiptarëve, të cilët do ta çlirojnë patjetër. Mos u gënje nga fashizmi, që është gjakatar, që, si në Abisini e në Spanjë, bëri krime çnjerëzore dhe tani, këtu në Shqipëri, kërkon të zhdukë një popull që jeton në vendin e tij. Bashkohu me popullin shqiptar ose mos e përdor kurrë armën kundër vëllezërve të tu shqiptarë!*

Traktet u shumëfishuan dhe u shpërndanë nga studentët e Shkollës Tregtare Hajro Çakërri, Filat Muço e shumë të tjerë. Kur u shpërnda trakti, unë isha në fshat. Trakti italisht do të vihej në xhepin e xhaketave të ushtarëve italianë. Mirëpo ç'ngjau: Siç dëgjova më vonë, dikush paskësh lajmëruar kuesturën për traktin, kishte thënë dhe emrat e grupit që e hartuan dhe që e shpërndanë. Filluan arrestimet. Në fshat, kur isha duke fjetur në dhomën e madhe, lart, kur hapa sytë, pashë tytat e dyfekëve fashistë drejtuar në kokën time. U ngrita, më lidhën dhe, duke kaluar përmes një turme njerëzish që u mblodh në xhade, më futën në makinën e madhe, mes tetë karabinierëve.

Nisi tortura fizike fashiste. Kërkonin nga unë që të dinin me kë u takova në Tiranë! Kërkonin të dinin kush kishte urdhëruar të hartoheshin traktet. Kërkonin emra, sidomos në Tiranë e në Vlorë... Unë isha i sigurt se do të më varnin. Dhe mendoja shumë, që të mos më shpëtonte ndonjë fjalë ose ndonjë emër. Përdorën shumë lloj torturash, por më e reja ishte kjo: në një qeli të mbytur në ujë, më hodhën brenda. Uji më vinte gjer në gjoks. Errësirë. Asgjë nuk shikohej. S'merrej vesh në ishte natë apo ditë. Kur më hodhën, ishte mbrëmje. Aty nga mesnata, dera u hap dhe pashë një xhandar shqiptar që më tha:

- Ma jep dorën të dalësh, o vëlla. - Dola dhe fillova të dridhesha. Më kishte blerë konjak dhe kaçkavall. - Unë jam tri orë rojë, - më tha. - Ha kaçkavallin, pi dhe konjak e rri aty nja dy orë.

Kur u futa prapë brenda, e pyeta se nga ishte.

- Jam nga Skrapari dhe më quajnë Muharrem, - më tha.

Eh, populli i gjorë, sa zemër të madhe ka dhe ç'guxim tregon!

I dërgova fjalë kolonelit se kisha vendosur të flisja. Erdhën më morën dhe më shpunë në Vlorë. Si interpret ishte njëfarë Sezai, i cili deshi të dinte se ç'kisha folur me Abdyl Agalliun. I thashë se Abdylin e kisha parë dy minuta në një kafe dhe ishim përshëndetur. Këtë kisha arritur t'ia thosha që më parë vëllait tim Agjisilla, i cili duhej të shkonte menjëherë tek Abdyli, që ishte noter, dhe ta porosite të thoshte "se me Petron u takova dy minuta në filan kafe dhe vetëm u përshëndetëm!"

Kështu shpëtoi Abdyli, të cilin e urrente shumë Sezaiu dhe kërkonte ta burgoste.

Koloneli më la të flisja. I thashë se traktin e kisha hartuar vetë, nga urrejtja që kisha kundër fashizmit pushtues. Në Tiranë isha takuar me Mustafa Krujën dhe Qazim Koculin, të cilët më kishin thënë: "Ti puno me

shokët e tu, se ne na ke pranë." - dhe se më kishin ofruar një sasi të hollash, të cilat unë nuk i pranova. Edhe Mustafa Kruja, edhe Qazim Koculi u proceduan dhe urrejtja e tyre kundër meje u shumëfishua. Kërkonin me çdo kusht të merrja një dënim të rëndë.

Proceset mbaruan dhe na shpunë në burgun e Vlorës, ku takova shumë studentë të Shkollës Tregtare, prindërit e tyre dhe gjithë familjen e Ibrahim Shytit: djalin, Luterin, gruan dhe vetë Ibrahimin, i cili, duke qeshur (ishte shumë ironik), më thoshte: "E mbushe koburen në Spanjë dhe e zbraze në shtëpinë time." E vërteta ashtu ishte. Familja e Ibrahimit u shpartallua. Ishte e para familje shqiptare në Vlorë që hoqi të zezat e ullirit nga fashizmi.

Në burgun e Vlorës ishim shumë: nja tridhjetë veta për çështjen e traktit. Prindërit e djemve ishin të matur dhe nuk u vinte keq; ata kishin luftuar më 1920 kundër Italisë dhe e urrenin fashizmin. Pas një muaji prindërit i liruan dhe ne, nja dhjetë veta, na dërguan në burgun e Tiranës. Ishim të parët të burgosur për çështje politike antiitaliane. Burgu ishte plot me ordinerë. Mua më izoluan në një birucë të veçantë. Në atë burg ishte Ibrahim Shyti me djalin e madh, Luterin, ishte Hajro Çakërri, Filat Muço, Azbi..., një djalë nga Poliçani, kurrizo, Zako Mezini, Ethem Shehu. Mora vesh se i vetmi për çështje politike ishte Ramazan Stërmasi, një elektricist, që akuzohej se, kur po instalonte dritat në *Luogotenencë*, kërkonte të vinte një bombë për të vrarë Jakomonin. E mbajtën pakëz dhe e liruan. Duke qenë i izoluar, dëgjoja nga kamarja e dritës (se dy biruca bashkë kishin një kamare si dritare për llambën elektrike që ndriçonte të dyja birucat): "Mos u mërzit, bre burrë!" Dhe më hidhnin paketa me cigare. Për pak ditë u mbusha me paketa. Duhanin nuk e pija. Ata që më flisnin fjalë inkurajuese dhe që më jepnin guxim, nuk i shihja. Tregonin emrat e

tyre. Disa ishin të dënuar e disa të padënuar ende (për rrahje, për borxhe, për vjedhje, për krime ordinere).

Filluan hetuesit italianë të më pyesnin. Ishin njerëz me kulturë dhe të sjellshëm. Dukej se nuk ishin fashistë. Kishte edhe ndonjë fanatik këmishëzi që më provokonte dhe kjo mua më ndihmonte për tezën që mbroja: "Nëse ka një shtet shqiptar, duhet të ketë dhe një qeveri shqiptare, e cila duhet të ketë dhe Ministri Drejtësie dhe gjykata shqiptare. Unë jam shqiptar dhe jam kundër Italisë fashiste. Kush më dënon? Më dënojnë gjykatësit italianë! Ku është qeveria shqiptare, ku janë gjykatat shqiptare? Pra, nuk ekziston as qeveri shqiptare, as gjykata shqiptare, por vetëm pushtet italian." Dhe, kur ai gjykatës këmishëzi më tha: "Shqipëria është një provincë e Italisë", - unë e falënderova se mbrojti tezën time!

Në hetuesi vinin shumë. Kishin dëshirë të mësonin gjëra që nuk i dinin. Më pyesnin dhe u përgjigjesha gjatë. Vija re se atyre u pëlqente kur thosha të vërtetën për Italinë, për rreziqet që i kanoseshin Italisë nga fashizmi, që ishte bërë lake i Hitlerit. U vinte mirë kur flisja për garibaldinët, që kishin bërë emër në Spanjë, dhe për ajkën e antifashistëve italianë, që njiheshin nga e gjithë bota.

Pyetje: - Mund të na flasësh pak më shumë për burgun e Tiranës, se aty ndenje mjaft dhe njohe shumë?

Përgjigje: - Po, duhet të flas më shumë për burgun e Tiranës, se aty ndodhën shumë ngjarje interesante gjatë kohës kur unë isha i burgosur.

Shokët e mi të Vlorës u liruan (më duket se ndërhyri Meloni, një personalitet i rëndësishëm italian, që kishte bërë në Vlorë shumë vjet si konsull dhe e njihte mirë parinë e Vlorës, e cila i ishte lutur që t'i lironin vlonjatët, se i kisha mashtruar unë, që vija nga Spanja). Mua më merrnin shpesh në pyetje. Kisha zënë miqësi me disa nga hetuesit, si me Çekantonin, që ishte një burrë i

ndershëm antifashist nga Orvietoja dhe që na bëri shumë favore... Isha vetëm, po shpejt më sollën në birucë Shyqyri Pezën, të cilin e kisha njohur në Korfuz. E kishin arrestuar për Myslimin, vëllanë e tij, që ishte në mal. Ai kërkoi vetë nga drejtori, Man Kopliku, që të vinte në birucën time. Shyqyri Peza shokët i kishte me pozitë, ai kishte mik dhe Maliq Bushatin, që ishte ministër i Punëve të Brendshme. Me Shyqyriun bisedonim shumë: ai ishte me anglo-amerikanët dhe jo me Rusinë. Kishte pikëpamjet politike të shokëve të tij antizogistë që bënë kokrrën e qejfit në mërgim me rroga të majme dhe tani që ishin kthyer, secili kishte marrë një shpërblim në të holla. Dhe rrogat tani i kishin të mëdha, se i kishin caktuar në Këshillin e Shtetit, që atëherë i thoshin *"Refugium pecatorum"* (strehimi i gjynahqarëve). Shyqyriun e ndihmonte në burg njëfarë Dem Xhepa, që i dërgonte përditë pula të pjekura dhe pilaf me tepsi. Hante shumë Shyqyriu, sa mezi ulej e ngrihej. Ishte trupmadh.

Me të kalova vetëm disa javë, se u lirua në këtë mënyrë:

Një ditë Shyqyriun e thirrën në drejtori. Shkoi dhe u kthye pas një ore. Isha i sigurt se do të lirohej menjëherë, por ja që zbriti përsëri në birucë. Më vështroi mirë dhe më tha:

- Me ty do të këshillohem, se vetëm ti je këtu me mua. Do të të them një gjë dhe përgjigjen e dua nesër. Duhet ta mendosh mirë, ta peshosh shumë mendimin dhe të gjykosh. Pra, mua më thirri lart Jak Koçi, njeri i Luogotenencës dhe i Mustafa Krujës. Më bënë këtë propozim: të takohet Myslymi, vëllai, me Mustafa Krujën ose me Qazim Mulletin e të mos jetë më kaçak, të jetë i lirë dhe të na japin të dyve 10 000 napolona.

Ky ishte kushti për lirimin e tij dhe për pasurimin e tij. Unë nuk e zgjata:

- Dëgjo, Shyqyri, ai që merr para nga Roma, është

radhtar. S'ka nevojë të mendoj gjer nesër që të të përgjigjem. Po more para nga Luogotenenca, je skllav i saj.

Ai u nxeh shumë, u ngrit më këmbë dhe nisi të shprehte mendimet e tij me zemërim.

- Unë nuk bëhem kurrë skllav i Luogotenencës, si ju që jeni bërë skllevër të të kuqve të botës! - Fliste me pasion dhe unë e dëgjoja: - Kush të vjen sot pas, po nuk pate para?! Asnjë s'të dëgjon se ç'ka thënë Marksi ose Lenini. Shqiptari, sidomos fshatari, do para, do ndihmë, do bukë, do këpucë e gomarë. Me se t'i blejë, me thëniet e Marksit dhe të Leninit? Jo! Unë do t'i marr paratë dhe me ato para do të nis luftën kundër tyre. Ke për ta parë. Me paratë e tyre unë do të bëhem i fuqishëm, do të më dëgjojnë dhe do të më besojnë fshatarët e do të vijnë pas meje.

Të nesërmen u ngjit lart në drejtori dhe u kthye pas pesë ditësh. Më kërkuan edhe mua në drejtori, ku gjeta Shyqyriun, të kapardisur si gjel. Më përqafoi, më solli të falat e shokëve dhe më tha se drejtori kishte marrë urdhër nga lart që të silleshin mirë me mua. Kur iku, la në tryezë disa napolona. "Merri, për shokët dhe për të gjithë të burgosurit, për kolektivin, siç i thoni ju", - më tha. La paratë dhe iku. Drejtori më shpjegoi se ato para ishin të miat, prandaj do t'i mbante në zyrë ai e, kur të kisha nevojë, do të tërhiqja sa të më duheshin. Kështu u ndamë me Shyqyri Pezën, i cili shkoi në Pezë dhe atje, siç dihet, me vëllanë e tij, me ndihmën e shokëve, krijuan bazën e parë luftarake të armatosur kundër pushtuesit.

Në një ditë qershori të atij viti (1940) më sollën në birucë një italian. Ishte pronari dhe kapiteni i vaporit "Paganini", që u mbyt nga të çarat në hambar, pranë Durrësit. Vapori ishte i ngarkuar me municione. Kapiteni dhe pronari i "Paganinit" rrinte si i hutuar dhe kishte frikë se do ta pushkatonin. Vinin përditë hetues dhe njerëz të Ovras dhe e pyesnin. Kërkonin nga ai të dësh-

monte se vaporin e mbytën oficerët shqiptarë që ktheheshin për pushime nga akademia e Torinos dhe e Modenës. Por italiani i mirë nuk pranonte të bënte një deklaratë të tillë. Thoshte se në vaporin e tij ishin nja dyzet oficerë shqiptarë, po kishte më shumë oficerë dhe ushtarë italianë. Duke folur me mua, më dha të kuptoja se ishte i bindur që këtë sabotim e kishin bërë shqiptarët. Dhe më tregonte disa detaje për të vërtetuar atë që thoshte. Atë e morën dhe e dërguan në Itali. Nuk e mora vesh fundin e tij. Lidhur me këtë unë shkrova një roman të vogël "Vajza e kapitenit", ku tregoja sikur i ati, kapiteni i vaporit, që do të pushkatohej, i dha unazën një bashkëvuajtësi shqiptar dhe i tha se, nëse ky shpëtonte dhe arrinte të shkonte në Napoli, ku banonte familja e tij: gruaja dhe vajza, t'i thosha vajzës së tij të mos martohej me fashistin aviator që e dashuronte. Linja ishte kjo: Shqiptari dërgohet për në Ventontene, në internim. Pranë Napolit, hidhet nga treni dhe pas shumë peripecish arrin te familja e kapitenit e i tregon unazën. Nënë e bijë e strehojnë dhe dashurohen pas tij, sidomos vajza, së cilës i premton se, po të mbarojë lufta dhe po të jetë gjallë, do të kthehet të martohet me të. Romani humbi; ishte nja 300 faqe dorëshkrim.

Pyetje: - Qëndrove për shumë kohë në birucë? Cilët shokë erdhën pastaj?

Përgjigje: - Kur isha vetëm në birucë, nuk lejohej asnjë libër e asnjë gazetë. Por të burgosurit ordinerë më hidhnin nga kamarja e dritës gazetën dhe ndonjë libër. Për shtresë kisha vetëm një rrogoz dhe si ushqim, bukë e ujë.

Një ditë erdhën në birucë prokurori Mustafaraj, doktor Kokona, një infermiere si dhe drejtori Man Kopliku. Isha mbështetur në qoshe.

- Pse nuk ngrihesh në këmbë?! - thirri drejtori i burgut. Bëra sikur nuk e dëgjova.

- Pse të kanë arrestuar? - pyeti prokurori.

- Pyet padronët e tu, - i thashë. Nuk folën. Dolën njëri pas tjetrit dhe më lanë aty ku isha, në çimento, me bukë e ujë.

Një drekë, kur bëhej shumë zhurmë përjashta, veshi më zuri të përmendej nga një zë i dashur emri im! Përmblodha gjithë forcat dhe dëgjova: "Kam ardhur për Petro Markon, e kam vëlla!" - Ishte zëri i Lilos së gjorë, i motrës-nënë, e cila më rriti, si nënë e si motër. Dëgjoja këtë bisedë:

Liloja: - Kam ardhur nga fshati. Dua një të mirë nga ju (dikush e përkthente italisht, se, siç dukej, motra fliste me ndonjë oficer italian).

Oficeri: - Nuk është e mundur të takoheni me të, se ende nuk është gjykuar!

Liloja: - Jo, nuk kam ardhur ta takoj, po t'ju lutem juve që ta varni sa më parë, që të mbledhim mendjen, se s'kemi as këmbë, as zemër e as para që ta ndjekim në burgje dhe internime!

E zeza Lilo! Dhe m'u kujtua gjithë drama e familjes sonë.

Atë mbrëmje, i mërzitur në kulm, hipa në dritare dhe vështroja oborrin e burgut. Bosh. Vetëm një ushtar italian bënte rojë (se natën vinin në oborr roja italiane), shëtiste i menduar. Më pa dhe m'u afrua. Më foli:

- Pse je në burg? Ç'ke vjedhur?

- Nuk kam vjedhur gjë!

- Unë, - tha ushtari italian, - kam bërë pesë vjet burg në Napoli për vjedhje, dhe tani jam rojë këtu... - dhe qeshte.

I thashë se vuaja në burg, pasi isha kundër Musolinit. Ai nuk foli, eci paksa dhe u kthye përsëri:

- A do bukë?

Nuk e kundërshtova, kështu që ai shkoi pranë dritares së shkallës dhe thirri:

- Mario, hap një kuti mishi, merr një panine dhe një shishe verë dhe m'i sill këtu!

Pas pak, Marioja ia dha nga dritarja ato që kërkoi. E pashë që vinte ngadalë drejt meje dhe m'i dha duke më thënë:

- Kujdes se mos të të shohin këta shqiptarë të ligj (për rojat)! *(Attenzione che ti vedono questi vigliacchi albanesi!)*

Sa rëndë më erdhi! Sikur më qëlloi me plumb dhe jo sikur më dha bukë... Ai kishte të drejtë, se i shihte rojat shqiptare të burgut sa keq silleshin me mua dhe me të tjerët; ishin më fashistë se vetë Musolini! Nuk e harroj kurrë atë mbrëmje.

Një ditë më erdhën për takim Aziz Çami, Hysni Lepenica dhe Shyqyri Peza. Pas atij takimi mua më hoqën nga izolimi. U vendosa në birucën nr.8.

Në birucën nr. 8 vinin shumë të burgosur, më donin, më ndihmonin, bisedonim. Nga të parët shokë që erdhën, qe Pandi Kristoja (jo Pandi Kristoja që njihet, po një tjetër, shok i mirë nga Korça. Pas tij erdhi Delo Balili, Veis Pipa nga Vlora, Niko Laçi, Foto Veshi, Dhimokrat Noti, Gaqo Naste nga Korça). Filluam të hidhnim themelet e kolektivit të parë në burg, që më vonë u bë familja e të burgosurve. Bashkë me këta shokë krijuam si të thuash një bërthamë rezistence.

Po burgu u mbush në fund të tetorit të vitit 1940, kur Italia sulmoi Greqinë.

Para se të sulmohej Greqia, më erdhën për takim në burg Aziz Çami, Skënder Muçoja e të tjerë. Aty u zumë me Azizin, se ai ishte caktuar si komandant i milicëve shqiptarë që do të sulmonin Greqinë për të çliruar Çamërinë. Folëm ashpër të dy dhe u ndamë keq!

Pak muaj më vonë, kur italianët hëngrën dru nga populli grek, më erdhi përsëri Azizi në burg e më tha:

- E hëngra atë mut! Vajta. Ti kishe të drejtë. Ne menduam dhe besuam ndryshe. - Azizin e njihja që në Francë dhe e kisha dashur; që kur e njoha, më dukej më

i ndershëm se të tjerët. Më kujtohet kjo ngjarje në Grënobël:

Ishim në kinema dhe, kur dolëm, policia franceze nisi të kontrollonte të gjithë ata që dilnin nga kinemaja. Pra, isha me Azizin. Unë kisha në xhep teserën e partisë, që kishte dalë në ilegalitet. Po të ma gjenin, do të më dërgonin në kamp përqendrimi, se isha edhe i huaj. Azizi e vuri re që unë isha i shqetësuar. I thashë arsyen. Nuk dija se ku ta futja teserën, por ai më tha që ta nxirrja e t'ia futja në xhepin e pantallonave. Ishim të gjithë me duart lart. Me marifet shkova pas tij. Ishte i gjatë. E nxora me shpejtësi teserën nga xhepi dhe ia futa në xhepin e pasmë të pantallonave. Kur policia nisi të më kontrollonte mua, Azizi tha se kishte pasaportë diplomatike. Dhe me të vërtetë ai nxori pasaportën diplomatike me të cilën ato ditë do të kthehej në Shqipëri, pas të tjerëve që kishin ikur.

LUFTA ITALO-GREKE DHE BURGU...

Disa hetues italianë antifashistë dhe njerëz që m'u sollën mirë, më kishin thënë një ditë, para marsit të vitit 1942, kur më dërguan në burgjet dhe nisitë e Italisë: "Afro 30 mijë procese janë bërë kundër shqiptarëve me akuzën: Ndihmë Greqisë në luftën e saj kundër Italisë!"

Lufta Italo-greke qe një ngjarje e madhe për ne. Në fillim shumica besoi se Italia do të shkonte në Athinë për pak ditë. Por u gabuan: populli grek e mundi Italinë, e vuri përpara. Dhe kjo disfatë e Italisë qe fitore e madhe për popullin tonë, se tani u bind se Italia nuk do të ngulej përjetë këtu, siç propagandonin agjentët e saj.

Me qindra e qindra arrestoheshin. Burgu u mbush, sa dhe në korridoret s'kishe ku të hidhje këmbë. Nga biruca nr. 8 kalonin të gjithë, dhe ne i ndanim sipas

njerëzve dhe pikëpamjeve të tyre. Me të gjithë silleshim mirë, i prisnim mirë, u shërbenim, u flisnim, i mbanim me kurajë dhe i bënim që ta ndienin veten të sigurt, të qetë, si mes vëllezërve. Kolektivi ynë ishte pasuruar me ndihmat që merrnim, dhe kushdo e hante një pjatë gjellë.

Nga burgu i Tiranës shkonin për në Itali, internim ose largim nga Shqipëria: ish-zogistë, nëpunës dhe ish--ministra ose deputetë, që Italia i largonte duke i dërguar në Romë, Firence a Napoli, me rroga të majme. Kur pashë Nebil Çikën në burg, u habita. Dhe ai u habit dhe më thoshte duke qeshur se kishte bërë gati frakun dhe uniformën, se ishte caktuar si federal i fashizmit në Janinë! Ndërkohë shokët tanë të mirë, si Mina Uçi, Stefo Grabocka e të tjerë internoheshin në ishuj si në Ventontene, në Ponza e të tjerë, ku jeta ishte tepër e vështirë.

Shpërngulën dhe gjithë ordinerët për në burgjet e rënda të Kapodistrias e s'di se ku. Kishin frikë nga ndonjë revoltë. Megjithatë, burgu u mbush me shokë nga gjithë Shqipëria, sidomos nga Jugu, si armiq të Italisë që ndihmonin ushtrinë greke: tregtarë nga Saranda, Delvina, Përmeti, Gjirokastra, Korça; fshatarë nga Vurgu, nga Himara, nga Dropulli. Kishte të arrestuar që qëndronin pak ditë në burg; kishte nga ata që kalonin nga gjyqi ushtarak. Dënime të vogla.

Erdhën me radhë: Ismail Golemi, Shemsi Totozani, Kastriot Muço, Fejzo Gjomemo; (grupi i Shkodrës) Qamil Gllavoçi, Xhovalin Luka, Bushati, Nuri Llazani; nga Berati, nga Fieri, nga Myzeqeja, nga Durrësi, nga Tirana, me qindra e qindra. Kolektivi ishte zmadhuar dhe ne e drejtonim me shokë të mirë.

Kur hyri Gjermania në Greqi e pastaj u fut dhe Italia, nga pranvera e vitit 1941 erdhi në Tiranë mbreti i Italisë, të cilin e qëlloi Vasil Laçi, që kishte të bënte me Niko Laçin. Për ne ishte një emër i panjohur. Por e prunë në burg dhe e mbanin të izoluar e të shoqëruar me njerëz të

OVRAS. Nuk lejonin as drejtorin e burgut, as gardianët e burgut, as dhe oficerët e gjykatës ushtarake italiane, nuk lejonin njeri të fliste me të. Nuk kaluan shumë ditë dhe ne dëgjuam në oborr që po ngrinin një trekëmbësh. U habitëm. U grumbulluan te dritaret e burgut dhe pamë të nxirrnin Vasilin, të cilin e mbanin dy veta nga krahët. I thanë se do ta shpinin në Gjirokastër. Kur ai pa trekëmbëshin, u habit. Ishin mbledhur shumë oficerë italianë. Sekretari i prefekturës, M. Hurshiti, lexoi vendimin me vdekje. Ne filluam të këndonim këngë revolucionare. Vasili hodhi sytë nga ne dhe hipi në fronin e vdekjes. Para se t'i hidhej litari në fyt, bërtiti; "Poshtë fashizmi, rroftë Stalini, rroftë Shqipëria e lirë!" Ne vazhdonim të këndonim "Internacionalen".

Ishte i pari shok që varej nga italianët.

Varja e Vasil Laçit na ndezi gjakun, u bëmë më luftëtarë dhe e shtuam shumë punën për të propaganduar idetë tona antifashiste në gjithë atë masë të burgosurish.

Drejtori i burgut dhe sekretari Mark Berisha na ndihmonin. Na tregonin se cili ishte provokator.

Pyetje: - Meqë ndenje në burgun e Tiranës për shumë kohë, a mund të na flasësh diçka më gjerë për këtë front të rezistencës?

Përgjigje: - Që nga maji i vitit 1940 e gjer në marsin e vitit 1942, kur ndodhesha në burg, kam qenë dëshmitar i një atmosfere luftarake dhe patriotike të përgjithshme, edhe nga ordinerët e gjorë, të cilët për një faj të vogël, për një batanije ushtarake ose për një zënkë, dënoheshin e pastaj, në kontakt me kolektivin tonë, bëheshin me ne dhe shumica e tyre morën anën e luftës sonë. Në burgun e Tiranës zotëronte dhe kishte pushtet krahu ynë revolucionar dhe asnjë parti tjetër. Aty u përhapën këngët e para të luftës sonë, si: "Prej urisë e prej mjerimit" (kënga e partizanëve sovjetikë), "Pararoja" (ne jemi pararoja, ne

jemi shpresa e njerëzisë), Flamuri i kuq (bota e mbushur plot me lot e jeta plot me varfëri), "Para jetës", "Kënga e shoqes" (O shoqe, eja të shkojmë, në punë më parë se n'agim), "Fusha, ju fusha" (kënga e kavalerisë sovjetike), "Tovarish Timoshenko, eja"; këngët italisht: O general Guzzoni,/ un figlio di putana... ose të tjera si këto: *E, guinti in Albania,/ non pianterem la giostra,/ Diremmo agli albanesi/ che non e casa nostra.*[1] Shumë nga këto këngë italisht i mësuan edhe rojat italiane. Pas burgut, këto këngë antifashiste u kënduan në Pezë e pastaj morën dhenë. Kur erdhi një ditë në burg Demir Godelli (pas shpëtimit të Mihal Durit, që shkoi në Pezë), më tha se këngët po këndoheshin në Pezë. Në Spanjë e në Francë kisha punuar për përhapjen e këtyre këngëve në rininë e atjeshme, prandaj më takonte mua që këto këngë t'i sillja edhe në Shqipëri. Dhe buçitën në burgun e Tiranës e pastaj në gjithë Shqipërinë.

Siç e përmenda më lart, gjersa Italia u thye nga Greqia, rojat e burgut, përveç disave si Hysni Lushnja nga Përmeti dhe Islam Bullica nga Kolesjani i Kukësit që na përkrahnin dhe mbaronin porositë tona, të tjerët ishin shumë të këqij dhe na persekutonin. Pastaj, edhe ata u bënë me ne. Do të tregoj se si u bë dhe Ali Minxha me ne, që ka qenë më i rrepti dhe pa shpirt.

Ja se si u bë Ali Minxha me ne: Ai vinte me çelësa në dorë, birucë më birucë, dhe kontrollonte se mos kishim ndonjë biçak a thikë, ose dhe qelq. Para se të vinte në birucën time nr. 8, i thashë një shoku nga Kuçi, që quhej Xhevahir: "Kur të futet roja tek unë, mbylle me lloz nga jashtë derën". Ali Minxha u fut në birucën time dhe dëgjoi llozin të mbyllte derën. U kthye nga dera dhe i binte që t'ia hapnin dhe, kur u kthye pastaj nga unë, pa se i ishte

---

1) E, kur të arrijmë në Shqipëri,/ nuk do të mbjellim luftë,/Do t'u themi shqiptarëve/ se nuk është shtëpia jonë.

drejtuar një nagant drejt e në fytyrë (nagantin ma kishte dhënë Islam Bullica, që ishte gardian burgu: "Merre, se të duhet", - më tha).

- Duart lart, Ali Minxha! - I ranë çelësat nga dora dhe nisi të dridhej. - Ulu këtu, në shtratin tim! - Ai u ul. Unë, me revolen në dorë, i flisja. - Po ti, me kë je? Ishe me Zogun? Po edhe Zogu kundër Italisë është. Pse nuk po e kupton se ku të shpie mushka? Gjithë gardianët, drejtori, sekretari, janë me ne, na ndihmojnë, na duan, kurse ti ende tek ura! Ali Minxha, eja në vete! Je apo nuk je shqiptar edhe ti si ne?!

- Aman, hiqe atë, pastaj flasim. - U ul. I dhashë një duhan dhe e pyeta nëse donte kafe. Ai, pasi ndezi cigaren, më tha "bereqaversen" dhe deshi ta kthente situatën duke bërë pak humor. (Pas Çlirimit, kur isha në gazetën "Bashkimi", më thanë se më kërkonte një plak. U thashë ta futnin në zyrë! Ç'të shoh?! Ali Minxha! Me mjekër dhe i kërrusur. "Eh, eh, - më tha! - Unë jam babë dëshmori. Im bir, që ishte xhandar, u bashkua me partizanët dhe u vra!" - Tani isha me një baba dëshmori dhe jo me atë gardian burgu të tmerrshëm që e urrenin të gjithë.)

Kur Gjermania naziste sulmoi Bashkimin Sovjetik, ne ishim pak shokë në burg. Filluam të këndonim, se ishim të sigurt që po i vinte fundi Hitlerit. Vinin përditë oficerët italianë që njihja, dhe më pyesnin ç'mendim kisha, si do të shkonte lufta. Ata tmerroheshin se ushtritë gjermane përparonin shumë dhe oficerët italianë pyesnin ç'bënte Stalini, pse nuk ia thyente kokën Hitlerit! "Pritni", - u thosha, po hitlerianët përparonin shumë.

Filluan të na vinin në burg shumë shokë. Tani që luftonte Bashkimi Sovjetik, fashizmi ishte tërbuar. Na sollën në burg edhe Mihal Durin. Mihali flinte në birucën time dhe bisedonim. Vinte e ëma dhe motra, na sillnin për të ngrënë, na lanin teshat. Mihali ishte arrestuar për një aksion që kishte bërë me Misto Mamen në një zyrë të

fashios, ku kishin marrë dhe një shaptilograf. Aty dëgjova për herë të parë emrin e Enver Hoxhës. Fliste Mihali për të.

I thashë Çekantonit: "Kam një shok shumë të varfër. Djalë i vetëm. Nëna dhe motra vetëm atë kanë. Të lutem, përpiqu ta lirosh!" - Të nesërmen e thirrën Mihalin në drejtori dhe e liruan... Pas pak erdhi në drejtori Palandri, kuestori, dhe kërkoi të merrte në pyetje Mihalin. Po Mihali ishte liruar. U bë kiameti. Kuestori u tërbua dhe kërkoi të dinte se kush e kishte liruar. Hapi dosjen dhe lexoi: *"Është arrestuar, se nuk ka lejen e radios, prandaj lirohet, se me këto merret Gjykata Civile e Tiranës dhe jo Gjykata Ushtarake."* Palandri u tërbua. Çekantoni kishte ndërruar akuzën. Nga atentat kundër shtetit, një akuzë për një radio pa leje. Mihali iku drejt e në Pezë.

Natë për natë dilja nëpër biruca për të parë se kush kishte ardhur. Në birucën përballë simes, kur hyra, pashë një njeri të shtrirë, që kishte vënë këpucët për nënkresë. Kur më pa, më tha italisht:

- Më dukesh si Robespieri!

Folëm me të. Ishte oficer italian i xhenios. I dhamë për të ngrënë dhe i bëmë një kafe. Fola me të gjersa u gdhi. Ai kishte bërë disa trakte të vogla me slogane: *"Italianë, kjo nuk është lufta jonë!", "Italianë, ne nuk kemi vend këtu, Shqipëria është e shqiptarëve!", "Italianë, fashizmi po e shpie në greminë popullin italian!"* e të tjera. Këto ia kishte besuar një orëndreqësi shqiptar në Rrugën e Dibrës. Ai orëndreqës kishte dhe djalin e tij në dyqanin e vogël. Pra, italiani i la aty traktet dhe disa orë. Ata shkuan e denoncuan dhe atë e arrestuan. E torturonin për të nxjerrë dhe shokë të tjerë, po Sisto Venturi (ashtu quhej ai oficer i xhenios nga Bolonja) nuk nxori asnjë emër. Ishte i bindur se do ta pushkatonin. E mbajtëm ne disa ditë dhe bisedonim se si duhej të mbrohej. Erdhi dita dhe e shpunë në Gjykatën Ushtarake për ta dënuar.

Prisnim me ankth dënimin e tij, megjithëse unë kisha folur shumë me hetuesit, me të cilët në njëfarë mënyre isha i miqësuar. Kur ç'të shohim? Na vjen pasdreke duke kënduar *"Avanti Popolo - a la riscossa..."*

E kishin dënuar 12 vjet! Edhe ne kënduam e kremtuam shpëtimin e tij. Na tregoi se si ishte zhvilluar gjyqi:

Sisto Venturi pranoi se i kishte bërë me ndërgjegje ato slogane antifashiste dhe kundër luftës. Dhe, kur kryetari e pyeti pse, ai u zhvesh dhe tregoi plagën që kishte marrë në Luftën e Parë, nga austriakët, në Brenero. Dhe nisi të tregonte të vërtetën për situatën në Itali e në botë (ashtu siç e kishim planifikuar dhe biseduar shumë herë bashkë). E lanë të fliste shumë. I thanë të vishej, dhe u tërhoqën brenda në sallë. Pastaj, kur dolën, pyetën dhe avokatin nëse kishte gjë për të thënë. Avokati ushtarak caktohej nga Gjykata Ushtarake; kishin caktuar një toger simpatik, nipin e Maskanjit. Ai kishte thënë:

- Kur më dhatë dosjen dhe e lexova, nuk desha të mbroja një tradhtar, sidomos ushtarak tradhtar. Po, kur e dëgjova të pandehurin të fliste, m'u hapën sytë dhe me ndërgjegje deklaroj solemnisht para kësaj gjykate të ndershme se unë solidarizohem plotësisht me të pandehurin Sisto Venturi, - dhe doli nga salla.

Ora që mbaj ende në dorë, është kujtim nga Sisto Venturi. (Pas Çlirimit shkova në seksionin e sigurimit, ku ishte përgjegjës Stefo Grabocka. I thashë ato që më kishte treguar Sisto Venturi për ata dy orëndreqës, atë e bir, që e denoncuan atë në SIM. Stefoja u interesua dhe pas disa ditësh më tha se atë e bir më vonë kishin ndihmuar Lëvizjen.)

... Vazhdoja të vizitoja natën të arrestuarit e rinj. Një natë, nën shkallë, gjeta një malësor të shkurtër. Nuk flinte. Rrinte këmbëkryq. E pyeta si ishte dhe nëse dëshironte duhan. Më pyeti dhe ai se cili isha, dhe, pasi

i thashë se isha dhe unë i burgosur, pranoi duhan dhe ushqime. E mora në birucën time. Ishte nga Kthella dhe quhej Frrok Gjeta, një bajraktar i vogël. E kishin arrestuar, se "djemtë e mi janë budallenj, i morën paratë nga njerëzit e legatës jugosllave në sallën e kinemasë, ku i panë spiunët". Ai merrte çdo vit nga Beogradi 1000 napolona. Më tregonte tragjedinë e banorëve të Kthellës. Ky me banda të armatosura nisej për plaçkitje e vjedhje bagëtish e bereqeti gjer në Maqedoni e Greqi e luftonte me rojat dhe ushtarët në kufi duke lënë dhe të vdekur. Plaçkat ua ndante ky malësorëve që merrte me vete. Cuba të organizuar për bukë, se Kthella është shumë e varfër. Pas pak ditësh u bë siç tha ai: "Do të më lirojë princi, se e kam mik, kam shumë miq në qeveri." Me të vërtetë, e thirrën lart dhe e liruan. Kërkoi të takohej me mua. Më falënderoi shumë dhe më tha: "Kur të kesh nevojë, thirrmë, se vij edhe natën!"

Pas nja dhjetë ditësh më thirrën në drejtori. Kur shkova aty, pashë Frokun. Më përqafoi. I tha sekretarit të burgut, Mark Berishës, të na linte vetëm nja dy dekika. Marku doli. Froku më tha se kishte ardhur të më merrte me vete.

"Ti duhet të vish në Kthellë. Aty do të jesh i lirë si zogu. Nuk ban që ti të dergjesh këtu brenda."

E pyeta se si do të më merrte me vete. Më tha se e kishte bërë planin. Kishte sjellë dhe nja pesë djem me vete dhe do ta shpërthente burgun. E falënderova dhe i thashë që të mendohesha një herë dhe se të nesërmen do t'i ktheja përgjigje. Mendova e mendova dhe nuk vendosa, se nuk kisha as shokë, as brenda dhe as jashtë me kë të këshillohesha. E rraha nga të katër anët këtë propozim dhe të nesërmen, kur erdhi, i thashë se nuk kisha vendosur. Ai la në tryezë një torbë me ushqime dhe duhan dhe më tha: "Të ruejtë zoti, o Pjetër! Kur të kesh nevojë për mue, më thirr, dhe erdha!" - dhe iku.

(Pas Çlirimit, kur isha në Berat duke ngrënë bukë me shokët e Shtabit, i tha Tuk Jakova Hysni Kapos: "Thuaja, thuaja Petros çështjen e Frrok Gjetës." Dëgjova nga ata se Frroku kishte dhënë urdhër në Kthellë që fshatarët të mos shtinin kurrë kundër partizanëve, "se i kam dhanë besën Pjetrit!", megjithëse ai ishte mik i ngushtë i Gjon Markagjonit dhe i Bazit të Canës. Kur isha në gazetën "Bashkimi", më erdhi një malësor nga Kthella me një letër nga Frroku. Ishte djali i tij që më solli letrën. Kërkonin t'i ndihmoja se mos merrnin dhe këta ndonjë copë tokë në Bregun e Matës nga reforma agrare, pasi shumë malësorëve u jepnin tokë. U interesova, po nuk e di se ç'u bë, sepse u arrestova edhe vetë më 1947. Pas disa vjetësh, mora vesh se Frroku kishte vdekur në burg, se kishte strehuar diversantë.)

Një paradite, kur isha në zyrën e sekretarit Mark Berisha, erdhën dy karabinierë me dy shqiptarë të lidhur. Unë i njoha dhe u trondita. Njëri prej tyre më shkeli syrin, që të mos flisja. Të dy shqiptarët e lidhur ishin Hasan Reçi dhe Hamit Shijaku, po thanë emra të tjerë. I mori në dorëzim Marku dhe i dërgoi poshtë; pas tyre vajta edhe unë. I mora në birucën nr. 8. Ata ishin zemëruar shumë me njëri-tjetrin. Pasi i qerasa dhe u çmallëm, më thanë se si kishte ndodhur arrestimi i tyre.

Për Hasan Reçin dhe Hamit Shijakun, e vërteta ishte kjo: Të dy kishin vendosur të shkonin në Pezë, po më parë duhej të kalonin nga aerodromi për të parë se ku ishin depot e municioneve me të cilat ngarkoheshin aeroplanët fashistë dhe bombardonin Malin e Zi kryengritës. Duhet patjetër t'i vinin në ndihmë Malit të Zi, që kishte ngritur krye, thoshin. Prandaj ndihma e parë që duhet t'i jepnin ishte të hidhnin në erë depot e gjyleve që përditë shkarkonin aty aeroplanët fashistë. Nuk e panë tabelën "Zonë ushtarake. Ndalohet kalimi!", hynë brenda në fushë dhe, sapo panë një depo, dëgjuan

zërin e rojave: "Alto la! - duart lart!" - Atëherë nisi grindja midis tyre. Hasani thoshte që armët që kishin, t'i hidhnin në hendek e, kur t'i zinin, t'u thoshin se kishin kaluar pa ditur se ç'ishte aty. Kurse Hamiti thoshte:

"Jo, do të na zënë, do të na njohin, prandaj më mirë është të luftojmë dhe të largohemi duke luftuar. Kemi revole dhe bomba."

Hasani thoshte se në atë fushë të hapur s'kishin se si të shpëtonin. Mënyra e shpëtimit ishte të hidhnin armët në hendek dhe të hiqeshin si fshatarë që kishin humbur rrugën.

Kështu kishin vendosur: kishin hedhur armët. Rojat i kishin zënë, i kishin kontrolluar, nuk u kishin gjetur gjë, po në atë kohë karabinierët kishin hyrë në fushë, i kishin lidhur të dy dhe i kishin sjellë në burg. Prandaj ata nuk treguan emrat e tyre të vërtetë. Megjithatë ata i kishin njohur, prandaj erdhi menjëherë Palandri, kuestori i tmerrshëm, dhe i mori në kuesturë, ku i shtroi në torturat nga më çnjerëzore.

Pas një jave e sollën te ne Hamitin të dërrmuar aq shumë, sa as ujin nuk mund ta kapërdinte. Ra në shtratin tim dhe ne bëmë ç'ishte e mundur që ta sillnim në vete. Fjetëm bashkë dhe, kur vinte në vete, mallkonte Hasanin. Përsëritte: "Më mirë të ishim vrarë me nder, sesa të vritemi të dërrmuar dhe të poshtëruar nga fashistët." Ndenji me ne një javë. Nuk fliste shumë. Shokët e donin dhe bënin ç'mos që ta qetësonin. Erdhën dhe e morën, se do ta çonin në Gjykatën Ushtarake. Hasani ishte në burgun ushtarak, nga e majta e burgut. Ne prisnim me ankth vendimin e gjyqit. Kishim një avokat që na përkrahte shumë, Suat Asllanin. Ai erdhi dhe na dha mandatën: të dy me vdekje. Hamitin e prunë te ne në birucën nr. 8. Ai nuk fliste fare. Në mëngjes erdhën, e morën dhe e çuan në burgun ushtarak. Hasani na lajmëronte që të njoftonim Myslym Pezën, se mos vinte

dhe shpërthente burgun për t'i shpëtuar. Kaluan 48 orë dhe nuk u ekzekutuan; shpresonim të faleshin. Hasani i dërgoi një letër Hamdi Kërçikut, që të bisedonte me Mustafa Krujën. Rojat na mbanin në lidhje të vazhdueshme me ta, që ishin në biruca, të ndarë. U dërgonim lajme dhe për të ngrënë. U dërguam dhe një mangall me qymyr.

Duke gdhirë 2 marsi i vitit 1942 dëgjuam lëvizje në oborr të burgut. Prapa burgut ushtarak po ngrihej një trekëmbësh. Të gjithë ne të burgosurit u mblodhëm nëpër dritare për të parë trekëmbëshin që ngrihej. Thamë: Hasanin dhe Hamitin, po i varin. Që pa gdhirë, oborri u mbush me oficerë. Nxorën të parin Hamitin. Ishte i qetë, i përgatitur; ato ditë i ishin dukur shekuj, priste fundin! I lexuan vendimin. Ai nuk foli. Hipi vetë në fron dhe, para se ta vinte vetë litarin në qafë, thirri me zë të fuqishëm: "Rroftë Stalini! Rroftë komunizmi! Rroftë Shqipëria e lirë!" Ai thoshte fjalët e fundit dhe ne këndonim "Internacionalen". Burgu buçiti. Tani prisnim të nxirrnin Hasanin, por nuk e nxorën. Erdhën shumë karabinierë e policë dhe rrethuan burgun. Erdhën dhe makina. Pas pak thirrën për t'i internuar në Itali disa shokë, midis të cilëve Zenel Hekalin, Seit Bushatin e të tjerë. Me ta ishte dhe Hasan Reçi, i lidhur këmbë e duar. Rojat na thanë se, kur kishin shkuar të merrnin Hasanin, kishin parë të mur të shkruar me qymyr, këto fjalë: *"Sot, më 2 mars 1942, fashistët varën Hamit Shijakun dhe Hasan Reçin! Shokë, na merrni hakun!"*

Do të tregoj më tej për Hasanin, kur ishim në burgun e Barit. Ai kishte këtë mendim: kanë frikë të më varin në Shqipëri, por do të më varin në Itali. Ai në burg ishte ditë e natë lidhur këmbë e duar dhe në derën e birucës me hekura rrinte natë e ditë një rojë.

Hamit Shijaku qe i pari komunist shqiptar që varej.

Pyetje: - Po ti, pse nuk u gjykove? Si të mbajtën në burg për rreth dy vjet pa të gjykuar?

Përgjigje: - Akuza ishte përcaktuar qartë: Akuzohesha për veprimtari kundër unitetit të shtetit, domethënë dënim me vdekje! Por hetuesit italianë përpiqeshin me çdo kusht që të më shpëtonin jetën. Ata e shtynin gjyqin, gjersa më në fund Çekantoni dhe dy të tjerë më thirrën në drejtori dhe më folën:

"Ne menduam dhe menduam se si të të shpëtojmë, se nga Luogotenenca marrim shpesh sugjerimin: dënojeni me vdekje. E dimë se kush i bën këto nxitje: Mustafa Kruja dhe Qazim Koculi. Po ne e gjetëm rrugën e shpëtimit. Është caktuar gjykimi për në 10 nëntor 1941, po me këtë kusht: nuk do të zhvillohet gjyqi, po nuk u paraqitën në sallën e gjyqit personalisht Mustafa Kruja dhe Qazim Koculi si bashkëpunëtorë të të akuzuarit."

Nuk e kuptova tamam, po më erdhi mirë që në sallën e gjyqit të ishin dhe ata të dy, të cilët i kisha takuar që në Francë dhe i takova edhe kur erdha në Shqipëri. Dhe ja tani këta italianë të mençur kërkuan me këmbëngulje që ata të dy të rrinin në bankën e të akuzuarve, pasi ishin proceduar. Pas një jave, përsëri Çekantoni më tha se punët shkonin mirë. Gjykata Ushtarake nuk pranonte asnjë përfaqësues të tyre, as avokat, po duhej që ata të ishin në bankën e të akuzuarve me gjithë ata vlonjatë që ishin liruar nga Meloni dhe që ishin pjesëmarrës në hartimin dhe shpërndarjen e trakteve në Vlorë, në maj të vitit 1940.

Ne ishim të gëzuar, se ishte krijuar Partia Komuniste dhe e festuam me këngë revolucionare. Ishim shumë komunistë në burg, më duket më shumë se 20 veta. Ishim në lidhje të rregullta me shokët dhe mua më kërkonin të shkruaja se si punonte organizata e partisë në Francë, ç'ishte komisari politik dhe ç'punë bënte në ushtri ose në çetat ilegale. Aty nga mesi i dhjetorit të vitit 1941 erdhi Çekantoni me katër të tjerë dhe më përqafuan. Më

treguan urdhrin nga Luogotenenca: *"Sospeso il procedimento për oportunita politicha..."* - Të ndërpritet gjyqi për oportunitet politik dhe i akuzuari të lirohet!" Nuk më besohej. Po ja që do të dilja nga dera e burgut.

Jashtë më priste kushëriri im Vangjeli dhe dy shokë të dërguar nga Partia. Më shpunë drejt e te shtëpia ku është themeluar Partia, dhe aty takova katër shokë, dy prej të cilëve i njihja: Koço Tashkon dhe Koçi Xoxen. Andon Deçka me një tjetër më shpunë në një shtëpi të mirë aty pranë. Nuk dilja fare në Tiranë. Këta shokë duke menduar se isha njeri i përshtatshëm për të bërë një bisedë me personalitete nacionaliste, pasi isha i njohur si gazetar, si luftëtar në Spanjë dhe si anëtar i Partisë Komuniste Franceze, më ngarkuan me detyrë që të takohesha me ta. Direktiva ishte që të bashkoheshim të gjithë në një front të përbashkët kundër fashizmit, për çlirimin e atdheut. Pranova. Shkova në shtëpinë e Turkeshit, i shoqëruar nga Andon Deçka dhe një tjetër. Aty ishin: Mithat Frashëri, Bahri Omari, Kolë Tromara, Hasan Dosti, Fuat Dibra, i zoti i shtëpisë, Turkeshi. Rrinin rreth oxhakut modern të ndezur me dru. Shtëpi e pasur. Më ftuan të ulesha. Pasi u përshëndetëm, i pari foli Mithat Frashëri, i cili pak a shumë u shpreh mirë për mua, se më njihte. Më tha ta merrja unë i pari fjalën. Fola shkurt, sipas udhëzimeve që më kishin dhënë:

- Duhet të bashkohemi të gjithë kundër pushtuesit, si më 1920. Partia Komuniste Shqiptare u ka bërë thirrje gjithë patriotëve dhe popullit që të bashkohen në një front të përbashkët për të luftuar armikun që na ka robëruar. Jam i sigurt se ky është dhe ideali juaj. Ta luftojmë bashkë shkelësin dhe ta hedhim në det si më 1920-n!

Foli pastaj Mithat Frashëri alias Lumo Skëndo, i cili shpesh ndërhynte duke përsëritur: Pse ai trakt të nënshkruhej Partia Komuniste dhe të mos nënshkruhej

patriotët shqiptarë? I thashë se ai ishte trakti i Partisë, ishte thirrja dhe kushtrimi për të gjithë, edhe për nacionalistët, prandaj më kishin dërguar mua t'u bëja thirrje në emër të popullit që të bashkoheshim të gjithë në një front për ta dëbuar armikun nga vatani. Mithat beu kërkonte të dinte se cilët ishim ne: samarxhinj, teneqexhinj, muratorë, argatë të zbathur apo çfarë? Më pyesnin se cilët ishin në krye, cili ishte kryetari ose sekretari. Unë u thashë se nuk e dija kush ishte, ngaqë partia është ilegale dhe se partia në ilegalitet ka konspiracion. Kur të dalë legale partia, do ta mësojmë të gjithë se cili është në krye të saj...

Ai nisi t'i vinte në lojë komunistët, por të tjerët, si Fuat Dibra, Bahri Omari, Kolë Tromara flisnin ndryshe. Ata ishin dakord që të merreshim vesh me të gjithë patriotët e çdo partie përparimtare dhe atdhetare. Atë natë nuk u vendos asgjë. Natën tjetër - e lamë të takoheshim përsëri të nesërmen - përsëri Mithat beu ishte më i ashpër kundër Partisë dhe nuk donte të dinte dhe të besonte se "na paskëshin krijuar një parti. Po kush? Delenxhinjtë!" Atëherë jo vetëm unë, por edhe të tjerët i thanë që t'i maste mirë fjalët, se me atë që thoshte, shpinte ujë në mulli të armikut. Ai brofi më këmbë dhe bërtiti: "Mithat Frashëri është shqiptar e bir shqiptari dhe..."

Më në fund, Mithat Frashëri e nxori atë që deshi të thoshte:

- Partinë e themeloi Dushani dhe Miladini. Por Partia Komuniste ekzistonte. E dimë: Fundoja, Halim Xheloja e të tjerë e kanë formuar Partinë në Paris me sektorin ballkanik të Kominternit. Tani Miladini dhe Dushani na krijuan një degë të Partisë Jugosllave. Dua të të pyes: Partia juaj e përfshin Kosovën? Nëse e përfshin Kosovën, eja të bisedojmë nesër. Nëse kjo parti e Miladinit dhe e Dushanit Kosovën ia kanë lënë Partisë Komuniste Jugosllave...

- Këtë unë nuk e di! Unë nuk njoh as Miladin e as Dushan - i thashë.

- Pyet, - më tha ai. - Nëse Kosovën e përfshin Partia Jugosllave, mos eja më të vazhdojmë bisedimet, se Kosovën e shitët.

- Të pyes, - thashë unë.

- Pyet Miladinin! - më tha ai.

- Unë s'njoh Miladin. Sinqerisht.

Ika shumë i tronditur.

Pyeta shokët që më dërguan, dhe ata më thanë të mos shkoja më, por m'u betua se nuk ekzistonte as Dushan dhe as Miladin në partinë e tyre.

Shokët më dërguan të bisedoja për bashkim edhe me ata të "Zjarrit". U mblodhëm te Kryqi i Kuq. Ishin aty Demir Godelli, Vasil Konomi, Niko Xoxe, Uan Filipi dhe të tjerë. Ata e dinin qëllimin e mbledhjes dhe filluan të thoshin se ata partinë e kishin themeluar me kohë dhe se ishte njohur nga Kominterni; madje kishin edhe vulën e tyre. Duhej që ne të bashkoheshim me ta dhe ata të na pranonin në partinë e tyre që quhej "Zjarri". Folën të gjithë, pastaj më lanë të flisja edhe unë. U tregova se Partia ishte themeluar me shokë të njohur e me përvojë të madhe revolucionare. Në themelimin e saj kishte dhe delegatë të një partie tjetër, të ngarkuar nga Kominterni. Demir Godelli mori fjalën, dhe fjala e tij peshonte: "Ne shokun që kemi këtu, e njohim shumë mirë se cili është. Prandaj unë mendoj të bashkohemi me Partinë dhe të bëhemi një trup i vetëm." (Foli shumë Demiri.) Pra, Demiri u shkëput nga ata... Uani hezitonte, kurse Niko Xoxja ngulte këmbë që ne të bashkoheshim në partinë e tyre. U përmendën dhe emra të njohur si Vasil Shanto, Qemal Stafa, Mihal Duri e të tjerë, që Demiri i kishte njohur në Pezë. "Nëse sot Peza është në luftë revolucionare, - tha Demiri, - kjo u dedikohet shokëve që themeluan Partinë e vërtetë Komuniste Shqiptare."

U raportova shokëve për mbledhjen me zjarristët, pastaj u kërkova të shkoja në Pezë. "Jo në Pezë, - më thanë, - se aty kemi caktuar Kriston (Shulin). Ti je caktuar të shkosh në Vlorë." Të nesërmen më dhanë udhëzimet dhe lidhjet me shokët e Vlorës. Pas një dite, më njohën me Njazi Islamin e me një shok tjetër, që do të më shpinin në Vlorë. Njaziu kishte një veturë të tij, ku mund t'i fshihte mirë edhe traktet. Kur arritëm në Vlorë, ishte vonë. Në hotel "Tirana" gjeta vëllanë të sëmurë. Ishte rasti i mirë për të thënë se unë kisha shkuar atje për të parë vëllanë e sëmurë. Me anë të vëllait dhe të disa fshatarëve të mi lajmërova Mynir Xhindin, Sinan Gjonin e të tjerë, të cilët erdhën, por jo të gjithë së bashku. Lamë takim më 10 janar, tek Uji i Ftohtë. Po takimi nuk u bë për këto arsye: Mora vesh nga fshatarët e mi se qeveria paskësh mbyllur makinat e vajit në Himarë, pra ulliri të shitej në Itali e aty të bëhej vaji. Unë, si himarjot, e njoh mirë se ku i dhemb himarjotit: në prodhimet e tij, që kurrë nuk ka lejuar t'ia merrte askush. Mendova dhe vendosa të hidhesha disa ditë në Himarë, të organizonim aty një demonstratë të madhe dhe, po të ishte e mundur, edhe përleshje, se Himara ishte plot me armë, të mbetura që nga Lufta Italo-greke. Mendoja që Himara të hidhej në luftë si Peza, t'ia bënim bam, të rezistonim disa ditë duke zënë Llogaranë dhe Palermon. Në fshat thirra disa djem si Petro Dhimo Zahon, Vangjel Neçon, Llukë Gjikopullin, Mimi Lolin dhe kushëririn tim Janin, që ishte kryeplak. Ishin dakord. Ata do të vdisnin dhe ullirin nuk do t'ia jepnin Italisë. Ata shokë i dërgova në Vuno te Thoma Varfi dhe Kozma Pipa (Andoni), në Himarë te Simo Zotoja dhe Thanas Bollanoja, në Pilur te Polo Prifti, që e kisha njohur në burg dhe mbante anën tonë. Ata ishin dakord që ditën e 7 janarit të zbrisnim të gjithë në Spile me parullën: "Ulliri është yni. Nuk lejojmë të na e marrë askush! Hapni makinat e vajit, se do t'i hapim vetë!" - e të tjera.

Kështu që më 7 janar të vitit 1942 Spileja u mbush me më shumë se tetëqind burra nga e gjithë krahina e Himarës. Duke marshuar drejt nënprefekturës thërrisnim: "Hapni sa më parë makinat e vajit! Ulliri është yni. Vdesim dhe nuk e lëmë të na e marrin!"

U grumbulluam të gjithë para ndërtesës së nënprefekturës. Kishin ardhur të gjithë nga paria e fshatrave. Nga Vunoi kaluam me shumë makina plot e përplot, duke kënduar këngë patriotike. U ndalëm dhe u thamë të hipnin në makina. Ata rrinin aty në pjacë, duke na shikuar e duke mos lëvizur. Thoma Varfi erdhi bashkë me Zaho Kokën, Manol Andonin (vëllanë e Paskalit), Kiço Kokën (që e kisha njohur në burgun e Tiranës), Kozma Pipën (Andoni). Erdhi paria e Palasës, e Dhërmiut, e Qeparoit, e Kudhësit, e Pilurit. Dolën nënprefekti, Hysni Lepenica, që e kishim mik, toger Moreti dhe një major i milicisë fashiste. Tenente Moreti bërtiti me zemërim: "Ç'është ky rebelim? Ç'kërkoni këtu?" (U erdhi e papritur kjo demonstratë e madhe e Bregut.) U bërtitëm: "Ejani poshtë të bisedojmë!'

Zbriti i pari Hysni Lepenica, pastaj dhe tenente Moreti. U fola. Dhe ata na thanë: "Zgjidhni nga një delegat për çdo fshat dhe, si komision, ejani lart të bisedojmë në zyrë dhe jo këtu!" Kështu bëmë. Zgjodhëm me të shpejtë shtatë veta, një nga çdo fshat, dhe shkuam lart në zyrë.

- Si u mblodhët kështu? Si e lajmëruat njëri-tjetrin? - pyeti tenente Moreti.

- Kur bubullojnë Malet e Vetëtimës, është sinjali i mbledhjeve! - thamë.

Hysni Lepenica nxori urdhrin që kishte ardhur nga Tirana: *"Të mbyllen makinat e vajit!"* - dhe tha:

- Është urdhri i qeverisë!

I thamë t'i telegrafonte urgjentisht qeverisë, që të anulohej ai urdhër, se ndryshe makinat do t'i hapnim vetë, se ishin pronat tona, siç ishin dhe ullinjtë prona jonë dhe me ta mund të bënim ç'të donim.

Hysni Lepenica gjer atëherë anonte nga e majta, domethënë nga ana jonë. Dhe telegramin e bëri. (Gabova shumë që nuk fola me të para se të bënte telegramin.) Ai pak a shumë telegrafoi kështu në Tiranë: *"Po nuk u çelën makinat e vajit brenda ditës, në Himarë plasi kryengritja!"*

Ne dolëm jashtë, disa hidhnin valle, disa hynin e dilnin nga kafenetë; pashë se aty kishin sjellë damixhana me raki dhe të gjithëve u jepnin për të pirë. Oshëtinte vendi nga këngët... Aty nga ora tre na thirrën në zyrë dhe shkuam. Hysniu më përqafoi dhe tha: "Qeveria dha urdhër të hapen makinat e vajit!" Mua nuk më erdhi mirë dhe ai u habit:

- Pse? - më tha.

- Deshëm të mos hapeshin, që të nisnim luftën! Të gjithë ishim gati ta çlironim, të paktën për disa ditë, Himarën e pastaj të dilnim maleve.

Sapo u përhap lajmi, buçiti kënga dhe thirrjet : "Rroftë Himara e bashkuar!" "Rroftë historia jonë!" "Rroftë Shqipëria!" U bë një gjullurdi e paparë. Njerëzit përqafoheshin e hidhnin valle.

Kur arritëm në Vuno me makinat që gjëmonin nga këngët himarjote, dolën burra dhe gra në pjacë, aty ku janë dyqanet. Makinat u ndalën. Kur dëgjuan njerëzit se makinat e vajit do të hapeshin, ushtoi një thirrje e fuqishme nga të gjithë: "Rroftë Himara dhe bashkimi i saj shekullor!" U ndamë dhe, kur arritëm në Dhërmi (ishte vonë), shumë djem e vajza prisnin në xhade, aty ku ishin dyqanet dhe postëkomanda. Sapo zbritëm, pashë shumë karabinierë që më vinin pas. Jani, kushëriri im, që ishte kryeplaku i fshatit dhe që kishte ardhur edhe ai në demonstratë atë ditë, ishte më pas dhe fliste me postëkomandantin. Ndërkohë dy karabinierë të fuqishëm m'u hodhën, më kapën nga krahët dhe me forcë më vunë prangat. Të gjithë filluan të bërtitnin. Mua më shpunë në postëkomandë, aty pranë, dhe më futën në një birucë të vogël, shumë të vogël, pa dritë. Jashtë

dëgjoja thirrje dhe ulërima grash. Gjithë gëzimi i asaj dite u kthye në pikëllim dhe ulërima. Tërë natën e natës nuk më zuri gjumi. Asnjë nga karabinierët ose nga oficerët nuk erdhi të më shihte në isha gjallë apo jo. Atë natë të gjatë mendoja shumë gjëra. Isha shumë i gëzuar që fshatrat e Himarës, si në shekujt e vështirë të luftërave, ishin të bashkuara.

Në Himarë kishte ardhur dhe paria e Dhërmiut, dhe dy priftërinj. Më kujtohej rasti i arrestimit tim të parë, në maj të vitit 1940.

U gdhi. Erdhi postëkomandanti dhe hapi birucën. Jani, kushëriri im, aty ishte. "Nuk kam fjetur gjithë natën. Rrija këtu jashtë, po të betohem se postëkomandanti nuk dinte gjë, as Hysni Lepenica; urdhrin e pruri dje një oficer nga Vlora dhe tha se duhet të arrestohesh e të dërgohesh në Tiranë." I thashë Janit të hiqte dorë nga kryepleqësia, dhe ai m'u betua se do ta vazhdonte punën time me besnikëri. Përjashta ishin grumbulluar shumë njerëz, sidomos të afërmit e mi, motra, kushërirat. Qanin me të madhe kur më panë të lidhur dhe kur më futën në një veturë. Shumë prej tyre i dolën përpara veturës dhe thërrisnin: "Ku po e shpini vëllanë tonë? Lirojeni! Ai është i mirë!" Kurse Amalia, kushërira më e madhe, bërtiti: "Edhe Petroja si Markoja, për fshatin dhe krahinën po bëhet kurban! Qëndro, o vëlla si yt atë!" Makina mezi çante turmën që ulërinte.

Dolëm nga fshati dhe po ngjiteshim në Llogara. Unë isha prapa, midis dy nënoficerëve të karabinierisë i lidhur, me duart prapa. Me shoferin ishte një toger i karabinierisë. Vura re shoferin: E njihja. Ishte Vasil Liza. E kam dashur dhe më ka dashur. Nga pasqyra që kishte përpara, më hidhte nga një shikim. Kur ishim lart në kthesën e fundit të rrezikshme, ai më shikonte dhe murmurinte greqisht: "Ta hedh, ta hedh." Më bënte shenjë që t'i thosha po ose jo, pra a ta hidhte makinën në

greminë e të vdisnim të gjithë apo jo. "Thuamë ta hedh, se nuk duroj më!" I bëra shenjë: "Jo!" Nuk e harroj atë vendim të Vasil Lizës, të këtij bashkëfshatarit tim të varfër po të ndershëm, që vendosi të vdiste me mua dhe me të tre italianët!

Më çuan në burgun e Vlorës, ku gjeta dhe Minella Kolekën dhe të tjerë. Dhe pastaj, nga burgu në burg: në Fier një natë, në Durrës një natë, më shpunë në kuesturën e Tiranës, në Rrugën e Kavajës, pranë kinema "Glorias." Ishte natë. Më futën në një dhomë, por hekurat nuk m'i hoqën. Kaluan disa orë ankthi, kur ja, dëgjova në korridor zërin e Aziz Çamit, që kërkonte të takonte kuestorin, Shyqyri Borshin. I thanë të shkonte në zyrën e kuestorit, por ai nguli këmbë;

- Thuaji të dalë jashtë! - Fliste me zë të lartë.

Pas pak u dëgjua:

- O, Aziz! Eja! Ç'paske ardhur gjer këtu?!

- Dua të të pyes nëse e keni këtu Petron...

- Këtu e kemi!

- Dëgjo, Shyqyri Borshi, po i vutë dorë Petros, ti ke mbaruar! Dhe ky nuk është mendimi im. Më dëgjon? Natën e mirë! - dhe u largua.

Atë natë, vonë, erdhën në birucën time shumë veta. Më thanë të qëndroja në këmbë. Një nga të kuesturës më shikonte dhe me sy e me trup më maste gjatësinë e trupit."Mendojnë të më varin" -, thosha me vete. Pastaj më çuan në një dhomë tjetër, ku pashë përtokë një kufomë të përgjakur. Ishte Njazi Islami!

- E njeh? - më tha majori.

- Siç e keni bërë ju, nuk e njeh as e ëma, dhe jo unë!

- Dëgjo! Atë fytyrë simpatike prej artisti që më ke, do të ta bëjmë ne sonte më keq se të atij.

Njaziu ishte gjallë. Lëvizi dhe më hodhi një vështrim me të cilin më la të kuptoja se nuk kishte treguar asgjë. Më shpunë përsëri në dhomën ku qeshë. Prita të fillonin

orturat, por nuk më vunë dorë. Që aty më çuan në burg.

Pse nuk vunë dorë mbi mua? Këtë e mora vesh pas ly vjetësh, në Berat, kur u ktheva nga burgimet dhe nternimet në Itali. Aty mësova nga miku im Tuk Jakova se ai, më 6 a 7 janar të vitit 1942 bënte rojë në shtëpinë ku ishte mbledhur komiteti provizor. Ishte radha e tij. Natën, në ato rrugica, kaloi një milic i kuesturës dhe i tha Tukut: "Duart lart!" Tuku i ngriti duart. Milici i kërkoi dokumentet. Tuku nxori letërnjoftimin: Pjetër Marku (ashtu e kishte emrin Tuk Jakova, i biri i Markut). "Po në xhep, çfarë ke?", - e pyeti milici. "Portokalle", - tha Tuku dhe nxori një bombë, i hoqi siguresën dhe i tha milicit: "Duart lart, se të vrava!" Milici ia mbathi me të katra dhe u zhduk. Ai raportoi për Pjetër Markun, ndaj u dha urdhri që Pjetër Marku të arrestohej, kudo që të ishte. Vlora e mori këtë urdhër dhe menjëherë dërgoi njerëz të më arrestonin. Tani e besova se Himara nuk dinte gjë, as Jani, as Hysni Lepenica, që patjetër do të kishte lajmëruar. Pra ja pse s'më vunë dorë: Se ai milici i kuesturës, që maste trupin tim duke e krahasuar me supet e tij, ishte ai që qe ndeshur me Tukun, të cilin e kishte parë që ishte më i gjatë se ai. Pra, duke u nisur nga gjatësia e trupit tim u tha se nuk isha unë. Kur më pyesnin se ku kisha qenë më 7 janar, unë u thosha: në Himarë. Pra, më 7 janar nuk pata qenë në Tiranë, nuk isha i gjatë sa Tuku, nuk isha unë ai që kërkonin...

Po të mos kalonte atë natë andej ai milici dhe të mos takonte Tukun që quhej Pjetër Marku, ç'drejtim do të kishte marrë rruga e luftës sime? Ku ta dish!

Në burg gjeta shokët që lashë, dhe, përveç atyre, Koçi Xoxen, Ilo dhe Gaqo Çomon e shumë të tjerë. Jashtë hekurave për lidhjet ishte caktuar Isuf Kamba.

Që kur plasi kryengritja në Mal të Zi, sillnin përditë në oborr të burgut familje malazeze. Ne i ndihmonim me ushqime, veshmbathje dhe barna; kishim lidhje të mira

me ta. Në oborr të burgut vinin natën makina, i ngarkonin dhe i shpinin në kampe të ndryshme; disa i çonin në Itali. Prunë dhe shokë malazezë e kosovarë, si Aesen dhe Miladin Milatoviçin nga Peja, Boron dhe disa të tjerë nga Tetova, Hatibin dhe dy të tjerë nga Dibra e Madhe e të tjerë. Të gjithë mbaheshin nga kolektivi ynë, që furnizohej rregullisht nga ana materiale, se e mbante dyqani "Flora". Përditë vinte në burg një karro me ushqime (fasule, oriz, makarona, gjalpë, djathë, kafe, sheqer, cigare e të tjera), që i sillte vëllai i Esat Dishnicës, Haloja i gjorë. Burgu ishte kthyer në shkollë antifashiste. Përsëri unë shkova në birucën nr. 8. Koçi më qortoi që lashë misionin që më ngarkoi Partia, dhe shkova në Himarë. I fola gjatë, duke i shpjeguar arsyet, pra ishte rasti kur një revolucionar ndërron objektivin, meqë tjetri është më i rëndësishëm se i pari. Flisnim për organizimin, për të ardhmen. Mua më vunë të shkruaja dhe të flisja për Kominternin, për disa udhëzime të reja që morëm para se të shpërndaheshim, para se të largoheshim nga Franca (Shënim: Është mirë të dihet se, kur partia doli në ilegalitet në Francë, ne, disa të huaj të "*Amical*"-it, na mblidhte një shok me rëndësi dhe na jepte udhëzimet e reja të Kominternit: 1. Komunistët e çdo vendi duhet të kthehen legalisht ose ilegalisht në atdheun e tyre. 2. Kur partia është ilegale dhe ndonjë shok që nga masa nuk njihet si komunist, ka ndonjë post në administratë ose në mbrojtje a në ushtri të shtetit borgjez, me t'u bërë partia legale, ai shok nuk duhet të jetë figurë ose shok me përgjegjësi, se masat e kanë njohur ndryshe; ai duhet të nderohet nga partia, se në kohë të vështira i ka sjellë shërbime të mëdha, po në asnjë mënyrë nuk duhet të ngarkohet me funksione të ndryshme. 3. Në rast revolte të armatosur, shokët me përgjegjësi duhet të ruhen mirë e të mos dalin në vijë të parë. Shtabet duhet të jenë të sigurta dhe të siguruara nga besnikët e partisë.)

Koçi me shokët i shkruanin këto. Sa për këngët, ato shtoheshin. Para se të më largonin për në Itali, isha duke u mësuar këngën e fundit: "Flamuri i Kuq" (Bota e mbushur plot me lot). Isha sëmurë me paratifo dhe më shtruan në dhomën që përdorej si ambulancë. Më ushqenin me lëng portokalli. Doktor ishte Petraq Leka, një burrë i mirë, që ishte me ne.

Një mbrëmje erdhi sekretari i burgut, Pjetër Berisha, dhe më tha se kishte ardhur një listë tjetër me dhjetë emra që do të niseshin nesër për t'u internuar në Itali. Në listë isha edhe unë. Lajmërova Koçin, i cili erdhi, dhe i dhashë emrat e atyre që do të internoheshin bashkë me mua. Nga shokët tanë ishin: Ilo Çomo, Bedri Çeliku, Gaqo Çomo, simpatizantë; Vançi Vithkuqi, tipograf; Koço Gjika, Emxhet Skëndo, punëtorë dhe ish-shoqja e Hulusi Spahiut, Makbule Dibra. Me ne ishte dhe oficeri Emil Mistura...

Gjovalin Luka m'u ngjit e s'më ndahej që ta mbaroja strofën e fundit të këngës "Flamuri i kuq!" Me zor e këndoja. Disa shokë e dëgjonin dhe e përsëritnin, gjersa e mësuan deri nga mesnata. Me infermierin Ibrahim Anadolli lajmëruam shokët që ishin jashtë, për internimin tonë. Që në mëngjes erdhi Haloja i shkretë, me një karro me ushqime, me 200 napolona dhe me 100 pako "Flora" njëqindcigarëshe. Më caktuan mua si përgjegjës të grupit. Udhëzimi ishte ky: me të gjithë të burgosurit politikë ose edhe ordinerë duhej sjellë mirë dhe njësoj, pa marrë parasysh se ç'kishin bërë para se të arrestoheshin. (Për ato do të përgjigjeshin kur të liroheshin.) Duheshin afruar të gjithë me kujdes dhe me durim. Në raste të rënda dhe të jashtëzakonshme duheshin përjashtuar nga kolektivi.

Ishte ditë prilli kur na nxorën nga burgu të lidhur me pranga dhe me një zinxhir të gjatë, që kalonte nga i pari deri tek i fundit, kështu që, në rast se binte njëri, të tjerët nuk lëviznin dot. Burgu buçiti nga thirrjet. Këngët

oshëtinin. Përjashta burgut shumë gra, vajza dhe kalamaj thërrisnin: "Ku po i shpini djemtë tanë?" Pashë në ballë të tyre Meli Dishnicën, motrën e Esatit, që me duart lart u vërsul dhe i doli autobusit përpara, duke thirrur: "Mos na i largoni vëllezërit! Ku i shpini shokët tanë? Ndaluni!" E shtynë karabinierët. Makina ecte ngadalë, ndërsa burgu gjëmonte e rruga gëlonte nga njerëzit.

U lashë amanet shokëve të njoftonin motrën time, Lilon, që po më internonin.

Autobusi-burg ecte dhe ne ishim të gjithë si të mpirë. Ishim të veshur shumë, se shokët na dhanë shumë tesha, shumicën e të cilave i kishim në trup. Kishim disa valixhe me ushqimet që na dërgoi "Flora". Ishim dhjetë veta dhe asnjë karabinier aty brenda me ne, se nuk qe e nevojshme: autobusi burg ishte mbyllur hermetikisht nga jashtë. Nga disa të çara shikonim se rruga që bënim për në Durrës, ishte rruga e re, ajo që kalonte nga Peza. "Peza!", - tha dikush. Mendoja:

"Po sikur ta ketë marrë vesh Çeta e Pezës dhe të ketë dalë në pritë të na shpëtojë e të bashkohemi me të maleve, të lirë?" - Edhe në çastet më të vështira të jetës kam ëndërruar lirinë, të jem i lirë si zogjtë nëpër pyje.

Pasi arritëm në molin e Durrësit, na mbajtën brenda në autobusin-burg gjersa u err, pastaj na nxorën si një copë zinxhir e na hodhën në hambarin e një vapori. Edhe pasi na flakën në hambarin e vaporit, nuk na i hoqën prangat, as zinxhirin. Shumë vaporë shpesh torpilohesin nga nëndetëset. Por e keqja më e madhe qe se mbi ne, në kuvertë, punonte zhurmshëm një motor, a kushedi se ç'qe, që bënte një zhurmë të tmerrshme. Me shpirtin ndër dhëmbë e me llahtarën se nga një çast në tjetrin mund të zhyteshim në fund të detit ashtu siç ishim, të gjithë të lidhur, dëgjuam spirancën të hidhej dhe motorin të heshtte. Kishim arritur në molin e Brindizit.

NË BURGJET DHE ISHUJT E ITALISË

Pasi qeshë arrestuar në Dhërmi dhe isha kthyer në burgun e Tiranës, e kisha gjetur celulën të ngritur. Dhe atë natë të prillit, kur po përgatiteshim për t'u degdisur në burgjet dhe nisitë e Italisë, u mblodh celula dhe vendosi: përgjegjës dhe sekretar i grupit u caktova unë; Iloja zëvendës; të zbatonim vijën e përcaktuar nga celula, të kishim shumë kujdes për shoqen Makbule, se ishte e sëmurë.

U hap bukaporta e hambarit dhe nisi të zbriste një si govatë e madhe. Brenda në atë govatë ishin dy karabinierë. Pasi govata arriti në dyshemene e hambarit, na urdhëruan të futeshim të gjithë aty brenda. U futëm dhe u grumbulluam lëmsh njëri mbi tjetrin. Dëgjuam "vira-virra": vinçi po ngjiste lart govatën si varkë me ne brenda. Me të dalë në dritë, pamë përjashta në mol shumë njerëz, shumica këmishëzinj, që thërrisnin *"A morte le spie!* - Vdekje spiunëve!" - se ne na kishin trumbetuar si spiunë, si shkaktarë të humbjes së luftës me Greqinë. Prandaj ulërinin: "*Morte a la brutte spie albanesi!*", ndërkohë që vinçi po ngrihej lart dhe ne mbi atë govatë ishim në hava. Govata po lartësohej dhe kthehej drejt molit, mbi kokat e atyre që thërrisnin: *"Morte a la spie albanesi!*". Atëherë dëgjova zërin e fortë të Misturës: "Këndoni, shokë!" Dhe ne filluam: *"Të gjithë ne, o djema, të japim besënë!*"... Ne këndonim ata thërrisnin, gjersa ai që drejtonte vinçin, hapi govatën dhe ne, si, zhavorr, ramë grumbull njëri mbi tjetrin, mbi bankinë. U vramë sa nuk mund të lëviznim më. Turma e tërbuar thërriste "*Amazateli gli sporchi albanesi!* - Vritini shqiptarët e fëlliqur!"

Na morën në një makinë burgu dhe na shpunë në burgun e Brindizit. Ishim të dërrmuar nga nata që ka-

luam të lidhur në hambar të vaporit. Në burgun e Brindizit ishim shumë mirë. Ishte një burg i ri, komod, me nevojtore në kaush dhe me ujë. Hapëm ushqimet dhe ndamë racionet. Si në burgun e Tiranës, që i ndaja mirë racionet, edhe këtu mua më ngarkuan t'i ndaja: nga pak kaçkavall, zhambon...

Isha ende i sëmurë. Përbri birucës sonë ishin shokët tanë: Zenel Hekali, Seid Bushati e të tjerë. Poshtë ishte Hasan Reçi, i izoluar, i cili na thërriste kur zbritnim shkallëve për në oborr. Merrnim 15 minuta ajër në oborrin-birucë, pa tavan. Çdo birucë kishte oborrin--birucë të saj, kështu që nuk mund të takoheshim me të tjerët.

Pas disa ditësh shokët e birucës pranë i hoqën dhe i nisën për në Ponza, kurse Hasanin e transferuan në burgun e Sant Andresë, aty ku qenë të dënuarit me burgim të përjetshëm. I kishin komunikuar faljen e jetës dhe kthimin e dënimit në burgim të përjetshëm. Aty në birucë njohëm dhe karakteret e shokëve:

Mistura, shumë i zoti, ish-oficer i Zogut, praktik, i gjallë, bëhej një me ne dhe na tregonte aventurat e tij. Thoshte që rridhte nga një familje fisnike dhe se i ati ishte podgoriçan, kurse nëna kishte një farmaci në Shkodër dhe dy motra të martuara me njerëz të pasur në Itali, nga të cilat njëra ishte gazetare. Ishte shumë i hedhur dhe me ne sillej korrekt, i shtruar, respektonte normat e kolektivit tonë. Nga ana tjetër, ne, sipas udhëzimeve, duhej të silleshim mirë me të burgosurit. Çështja ishte që ne të mundoheshim t'i mbanim të gjithë pranë dhe t'u bënim të ditur rrugën e qëllimin tonë. Mistura merrej vesh me rojat, me drejtorin e burgut. Një natë ishte duke thirrur si i çmendur në dritaren me hekura. Një tjetër i burgosur, i panjohur, nga kati i poshtëm, e pyeti se cili qe. Dhe Mistura i bërtiti: "Jam i biri i Çan Kai Shekut!" "Po ç'ke bërë që të kanë arrestuar?" Dhe Mistura me zë të lartë tha një sharje banale për

italianët. E porositëm të mos bënte marrëzira të tilla, se do të na rëndonin, por ai nuk dëgjonte.

Tjetër tip ishte Koço Gjika. Ne ushqimet i ndanim që në mëngjes për gjithë ditën. Ai, sapo merrte racionin e ditës, e hante menjëherë, pastaj kishte përsëri uri. Koçoja ishte shumë i shëndoshë në trup dhe ishte gjithnjë i uritur.

Biruca ishte shumë e vogël dhe ne, dhjetë veta, të shtrirë në çimento, pa asnjë shtrojë, nuk lëviznim dot. (Sa çimka kishte ajo birucë!Kishim vendosur të bënin rojë me radhë, ditë e natë, për të vrarë çimkat, që zbrisnin si milingonat nga muret.)

Lajme nuk merrnim dhe nuk dinin se ç'bëhej. Aty ndenjëm afro dy muaj. Më duket se në muajin maj na morën dhe na shpunë me tren në drejtim të Palermos, në Sicili. E mora me mend se do të na dërgonin në ndonjë ishull. Megjithëse të lidhur, ne këndonim këngë patriotike. Në kanal treni do të hipte në ferrabot dhe do të kalonte në Sicili. Përballë nesh ishin ushtarë gjermanë që shkonin në Afrikë, në luftë.

Mistura fliste gjermanisht, thoshte se ne ishim patriotë shqiptarë të arrestuar nga italianët. Pamë se katër ushtarë gjermanë morën dy kosha kuintalësh me portokalle, erdhën tek treni ynë dhe na i dhanë neve, duke urdhëruar karabinierët që të na zgjidhnin duart e t'i hanim portokallet me duar të lira. Ata flisnin me ton urdhërues dhe thoshin se fashizmi italian ishte portokalle. Gjithë rrugës këndonim dhe ushtarët na shihnin me keqardhje e dashamirësi, se e dinin ku na shpinin, pasi na shihnin të lidhur.

Arritëm në burgun e Palermos. Makbulen e shpunë në burgun e grave. Na futën në një dhomë të madhe, me dysheme dërrasash që lëviznin dhe hiqeshin. Sidoqoftë dërrasa dhe jo çimento. Dhoma ishte e madhe, me dy dritare. Ai burg më parë kishte qenë kuvend fetar dhe në

kohën e burbonëve ishte bërë burg. Aty na binin dhe qumësht, se burgu kishte lopët e veta. Para kishim, prandaj filluam të blinim edhe fruta e verë. Në atë burg kishte qenë edhe im atë, më 1916. Tani mendoja e thosha me vete se ku do të na shpinin: në Faviana, në ndonjë ishull tjetër apo në Ustikë! Edhe doja, edhe nuk doja të na çonin në Ustikë, se kisha krijuar një ide të tmerrshme për atë nisi të shkretë. Lexoja letrat e babait që na dërgonte nga Ustika (doemos i lexoja pasi ai kishte vdekur, kur isha në shkollën fillore të fshatit dhe dija të lexoja). Mbaj mend diçka nga letra e fundit: *"Ndoshta unë nuk do të kthehem nga ky kafaz ku më kanë mbyllur në një kala gërmadhë të errët. Shiko fëmijët!"* - Kisha shkruar edhe një vjershë për Ustikën.

... Ja, na nxorën për të na dërguar në... Para se të iknim nga dhoma e sigurimit, ku na dhanë plaçkat që na kishin mbajtur në drejtorinë e burgut, si dhe paratë, ndërsa isha duke numëruar paratë, u dëgjua një zë i humbur, sikur vinte nga varri: *"Per baco, quanti soldi!"*[1] - U habita dhe pyeta se cili ishte. Kishte njëzet vjet aty në atë burg. Dhe tregonte se si në vitin e parë diçka i dërgonte e motra, sidomos çdo Krishtlindje nga 25 lireta. Po motra kishte vdekur dhe një mbesë e tij çoku e kujtonte me ndonjë kartolinë për Vit të Ri. I dhashë dyqind lireta. U habit dhe nuk dinte se si të na falënderonte.

Na morën ashtu siç ishim, na drejtuan drejt limanit të madh, plot vaporë, kaike e varka. Ishim të ngarkuar dhe me plaçkat që mbanim. Arritëm në liman, na çuan drejt një bankine dhe aty na hipën në një vapor të vogël. Të gjithë, zinxhir, u ulëm në kuvertë. Karabinierët që na shoqëronin, nuk na flisnin. Vapori u nis. Guxova dhe pyeta një karabinier se për ku shkonim. Ai më tha: "Për

1) Për perëndi, sa shumë para!

në Ustikë!" Unë shtanga dhe shokët e kuptuan që diçka pata. Mistura, që ishte shejtan i madh, pyeti: "Po ku bie kjo Ustika!?" Dhe ata, duke qeshur, i thoshin se pasdreke do të ishim banorë të nderuar të saj. Pastaj më pyetën mua se ç'pata, dhe unë u thashë se atë nisi e njihja. U tregova tragjedinë e babait tim. U erdhi keq të gjithëve. Filluam të këndonim në det të hapur. Vapori rrëshqiste drejt veriperëndimit. Deti ishte i qetë. Duke u larguar, kthenim kokën pas për të parë Palermon e madhe, që shtrihej e shtrihej midis gjelbërimeve, dhe duke pasur mbi kokë disa gërxhe, ku kishin vilat anglezët.

Të gjithë ne sytë i mbanim drejt veriperëndimit, drejt detit të hapur të Mesdheut, se mos na fanitej Ustika. Mua më kalonte para syve jeta e babait tim, letrat e tij... Ustika skëterrë, ku të dënuarit kishin vetëm një litër ujë për të pirë. Ustika.

- Ustika! - thirri një marinar dhe ne të gjithë shikonim një pikë të zezë larg, larg në horizont, drejt së cilës drejtoheshim dhe e cila pak nga pak zmadhohej, si ankthi ynë.

Pyetje: - Ç'ndjeve kur shkele në Ustikë?

Përgjigje: - Ustika është një kapitull i rëndësishëm i jetës sime, prandaj do të flas pakëz më gjatë (kam shkruar një roman me titullin "Një natë dhe dy agime", ku flas shumë për atë ishull.) Me këtë rast është mirë të përmend se çfarë shkrova dy vjetët që ndenja në burgun e Tiranës: 1940-1942:

1. Poemën "Nase Labi", që e kam.
2. Romanin "Kodoshi", që nuk e kam. U dogj.
3. Romanin "Rrugëve të luftës", që nuk e kam. E mori Hajro Çakërri për ta shpëtuar dhe e kishte varrosur në tokë. Kur shkuan ta zhvarrosnin, ishte bërë pluhur.
4. Poemën "Horizonti në kuletë", që e kam. Ma ruajti Shevqet Musaraji.
5. Poemën "Parada e të uriturve", që e kam, e kishte ruajtur Demir Godelli.

6. "Nisje pa mbarim", vargje të ndryshme, nuk i kam. I mori Gjykata Ushtarake.

7. "Bija e kapitenit", për të cilën kam folur më lart. Nuk e kam.

Të kthehemi te kapitulli i ri: Ustika.

Vapori çante ujërat drejt saj dhe ai ishull i izoluar çdo çast na bëhej më i madh, gjersa arritëm në portin e vogël dhe hodhën spirancën.

Pamje dramatike: Në shkëmbinjtë ngjyrë guri të djegur lëviznin si krimba të internuarit, uniformisht, me lëvizje të ngadalta. Nuk mund të bindeshe kurrë se ata ishin njerëz! Një marinar na tha: *"Eco i confinati*! - Ja të internuarit." Ata prisnin shokë të rinj. Dhe ne morëm urdhër të bëheshim gati. Erdhën dhe na hoqën zinxhirin dhe prangat, të cilat i hodhën në një hambar; siç dukej, me ato pranga dhe me atë zinxhir ai vapor bënte prej shumë vjetësh atë linjë: Palermo - Ustikë. Vapori u afrua shumë dhe ne nisëm të zbritnim. Dëgjova Vançin të thoshte:

- Hidhni këmbën e djathtë:

Dikush tha:

- Të këndojmë! - por askujt nuk i këndohej në ato çaste... Hidhnim këmbët në një njësi të zezë, ku dhe mund të mbeteshim përjetë...

Na vunë në radhë dhe, duke iu ngjitur një monopati të shkurtër, arritëm në shtëpitë e para. Shumë të internuar apatikë na shikonin sikur të shihnin një skenë të zakonshme. Dëgjova dikë: "*E arrivata la catena*! - Arriti zinxhiri!" - Nuk thoshin arriti vapori, por arriti zinxhiri, se zinxhiri ishte simbol i atij vapori. Ndërsa po ecnim të qetë, dëgjuam të bërtisnin: "Druzhe albanski!". Aty kishte dhe jugosllavë. Ishim ne të parët shqiptarë që shkelnim atë ishull në Luftën e Dytë Botërore...

Kaluam nëpër një shesh të pjerrët të shtruar me pllaka guri. Sheshi "Longo". Në qendër kishte nja katër

pemë të mëdha dhe në mes të tyre, një monument të njëfarë Longoje. Shumë të internuar: zhele, skelete, na shikonin pa hapur gojë. Kaluam nga zyrat dhe nga një rrugicë me kalldrëm. Nga e djathta e zyrave na çuan në disa baraka të gjata dhe na thanë të uleshim aty. Pas pak erdhi një i internuar trashaluq dhe na tha:

- Arbëreshë jeni?

- Po arbëreshë jemi!

Na tha të prisnim dhe pas pak u kthye me një tenxhere e me dy lugë.

- Hani, hani, o arbëreshë, lentike, - na tha dhe na vuri përpara një tenxhere plot me thjerrëza.

Hëngrëm. Ishin të mira, me vaj ulliri. I hëngrëm pa bukë. Ai ishte arbëresh nga Piana, pranë Palermos. Kishte qenë kryetar bashkie. Kur Musolini bënte vizita nëpër Sicili, kishte shkuar në Piana dhe kishte filluar t'i fliste popullit arbëresh të Pianës nga ballkoni, siç e kishte zakon. Çuçoja, ashtu quhej arbëreshi, i kishte vënë dorën në gjoks dhe e kishte shtyrë: "Er duçe der pais! - Këtu jam unë dhe ky thi i zi!" Populli kishte nisur të thërriste "Çuço-Çuço!" dhe ia kishin shpjeguar Musolinit se ç'kishte thënë i ziu Çuço. Ai kishte urdhëruar menjëherë, e kishin lidhur dhe e kishin dërguar në Ustikë, ku ishte qysh nga viti 1925.

Makbulen e shpunë me disa gra, në një barakë më të vogël. Aty kishte dy lloje grash: prostituta nga më të përdalat dhe antifashiste, që nuk rrinin bashkë. Siç kishte dhe dy lloj të internuarish: për faje politike, si antifashistë, dhe për faje ordinere. Shumica ishin për faje ordinere. Atë ishull e kishte krijuar si vend internimi Krispi, për delikuentët. Dhe ashtu mbeti. Banorët e lirë të ishullit, që nuk i kalonin të pesëqind vetat, shumica rridhnin nga ish-të internuar, që kishin mbetur aty. Musolini kishte internuar aty për pak kohë edhe vëllezërit Roseli, të cilët ikën me varkë për në Tunizi e andej në

Francë. Pak shokë antifashistë internoheshin në Ustikë. Shumica e antifashistëve internoheshin në Ventontene e Ponza dhe pak në ishujt e tjerë. Ata që ishin shumë të rrezikshëm, i internonin në ishuj të vegjël dhe të këqij, si në Ustikë. Kur vajtëm ne aty, gjetëm pak komunistë dhe antifashistë italianë: njëri nga Foxhia, që nuk ia mbaj mend emrin, dhe njëri nga Brindizi, Antonio Xhigandi. Ai, nga Foxhia kishte shumë vjet aty dhe rronte shumë keq.

U vendosëm në barakë dhe Mistura, që ishte shumë i shkathët, nisi të miqësohej me autoritetet e me priftin.

Unë ende isha i sëmurë dhe dilja aty pranë e shtrihesha në diell, por kaluan dy civilë të kuesturës dhe më thanë të ngrihesha, se nuk duhej të qëndroja aty. E vërteta është se unë i mora për dy të internuar dhe nuk lëviza nga vendi. Pas pak erdhën përsëri ata, me dy karabinierë, të cilët më ngritën dhe, duke më mbajtur për krahu, më shpunë në drejtori e së andejmi në gratagabia (birucë ku futeshin nga lart; bukaporta ishte derë në dysheme e së andejmi të hidhnin brenda.) Më hodhën brenda të lidhur me duar pas. Mendova se ishte urdhri nga Tirana që ky të ishte fundi im. Më grinë çimkat dhe nuk mund të kruhesha. E ndieja se dita mbaronte dhe vinte nata në natën e kësaj biruce nën dhe. Ajo natë ka qenë shumë e gjatë për mua, një natë nga më të gjatat e jetës sime. Erdhën dhe hapën kapakun e varrit tim dhe më nxorën. Ishte ditë. Jashtë ishulli ndriste nga dielli i Mesdheut. Ende nuk kishte rënë boria që të hapeshin banesat-burg e të dilnin të internuarit. Më çuan fill e në drejtori. Në sallë m'i hoqën prangat. U futa brenda. Në krye të tryezës rrinte drejtori, një burrë me moshë mesatare dhe i pashëm, por tullac, i bardhë në fytyrë, tip zyrtari. Nga e djathta e tij, një burrë i shkurtër, me *pic*,[1] veshur me të zeza, me bastun të zi dhe me çizme të

1) Mjekër me majë.

zeza, më vështronte. Tip pirandelian m'u duk. Më tha drejtori:

- *E tu perche non saluti romanamente*?! - Pse nuk nderon si fashistët?

- Po të nderoja me dorën përpjetë si fashistët, nuk do të isha këtu, po do të kisha edhe unë ndonjë post, si zotëria juaj, - i thashë. Aq shumë u zemërua, sa brofi më këmbë sikur shkeli sustën, u bë flakë i kuq në fytyrë dhe nisi të më bërtiste e të më shante:

- Do të të ngordh këtu! Këtu, këtu do t'i lësh kockat, atje ku kalove natën. Ku je, ku je këtu, more beduin i ndyrë? E di se ku je këtu?! - e të tjera e të tjera. Kur mbaroi, i thashë pak a shumë se aty kishte vdekur edhe babai im në Luftën e Parë Botërore, po në Shqipëri kishin vdekur mijëra herë më shumë italianë, që i kishin varrezat në Vlorë dhe tani Shqipëria do të bëhej varri i qindra e mijërave italianëve si ai.

Ai i ra tryezës me forcë dhe më shau rëndë, madje bëri të afrohej dhe të më godiste, por burri i shkurtër me të zeza u ngrit, i doli përpara dhe me zë të qetë nisi ta zbuste e t'i thoshte se kishte të bënte me një poet, me një njeri të kulturuar. Shokët e mi, kur kishin parë që unë nuk u isha kthyer në darkë, kishin dhënë alarmin, sidomos Mistura, i cili nuk kishte lënë zyrë pa u futur, duke thënë se do të telegrafonin në Tiranë, se ishte zhdukur poeti i dashur e të tjera... Siç duket, qe ai shkaku që më nxorën që në mëngjes nga ajo birucë e nën-dheshme.

- Drejtor, - fliste me zë të ulët njeriu pirandelian, - kemi të bëjmë me një poet. Nuk është delikuent, është njeri, - dhe m'u kthye mua: - Është e vërtetë që babai juaj ka qenë këtu në Luftën e Parë Botërore?

I thashë se aty kishte qenë dhe se, meqë ishte sëmurë, për vdekje nga veremi, e kishin nisur për në Shqipëri, pranë familjes, ku vdiq!

Mjeku - se ai ishte mjeku i kampit - më hodhi dorën në sup dhe më tha të dilja e ta prisja në sallon. Ai ndenji ca brenda dhe foli me drejtorin. Doli, më dha dorën, më mori me vete dhe më shpuri në ambulancë, që ishte pranë ndërtesës së ulët me birucat e nëndheshme.

Pasi u futëm në zyrën e tij, ai, duke më vështruar me lot ndër sy, më pyeti: "Vërtet këtu ka qenë babai yt?" Pasi i thashë dhe emrin dhe kohën: 1916-1920, u ngrit dhe shkoi e nxori disa regjistra të mëdhenj sa dera. Shfletoi e shfletoi dhe e gjeti faqen e babait tim, fotografinë, shenjat e gishtërinjve, gjeneralitetet. I pashë dhe unë dhe qava. Ai u ngrit dhe thirri: "Tu non morirai! - Ti nuk do të vdesësh". Më mori nga dora dhe më tha të shkoja me të. Dolëm nga ambulanca dhe morëm të përpjetën e Rrugës së Kalvarit - ashtu quhej rruga që ngjitej për në bregoren ku ishte kështjella e vjetër. Duke ecur, më fliste si një baba. Hymë në kështjellën e vjetër të rrënuar. M'u kujtua Kalaja e Gjirokastrës, kur e vizitova për herë të parë më 1933. I ngjante asaj: shpendra, hithra, gërmadha e bodrume të errëta. Duke ecur drejt një si korridori të errët, duke pasur nga e djathta dhe nga e majta hekura të rrëzuar dhe të ndryshkur, arritëm në një vend ku mjeku u ndal: "Këtu ka qenë qelia nr. 14. Këtu ka qenë yt atë!" Ndenji gatitu, kokulur, me lot në sy. Mua m'u ngjeth mishi dhe m'u kujtuan disa tregime të Egdar Poesë. Pastaj më mori nga krahu dhe dolëm në dritë. Oh, sa dritë kishte Ustika, sikur kishte mbledhur gjithë dritën e Mesdheut. Më shpuri në shtëpinë e tij. Aty ishte e shoqja, një grua e shëndoshë, dhe një djalë nja pesëmbëdhjetë vjeç, që quhej Çicio. Porositi qumësht me kafe dhe i tha së shoqes: "Këtë e kemi si djalin tonë! Do të vijë çdo darkë këtu dhe ti do t'i japësh një gotë të madhe me verë të bardhë, duke i hedhur brenda dy vezë të freskëta. Dhe bukë sa të dojë. Duam që ky djali ynë të jetojë."

I prekur, u ktheva në barakë, ku më prisnin shokët e mi të shqetësuar. Më përqafuan dhe pastaj filluan të këndonin. Vançi kishte kitarë. Kur u tregova se ç'më kishte ngjarë, ata rrinin gojëhapur, sikur dëgjonin ndonjë roman.

Mjeku menjëherë na gjeti një dhomë, aty pranë shtëpisë së tij. Kishte dhoma që i lëshonin me qira. Për të pasur një ide të dhomave që jepeshin me qira, duhet të shpjegohem. Dhomat-burg ishin burgje: me dritare me hekura dhe me dyer me hekura. Ata të internuar që zinin dhoma me qira - dhe ishin shumë - mbylleshin në dhomë në orën gjashtë ose shtatë të darkës dhe, kur binte boria e hapjes së dhomave-burg, aty nga ora tetë e mëngjesit, disa nëpunës, me qindra çelësa në duar, si zinxhirë, shkonin dhe hapnin dyert. Pra, shkuam në dhomën e re, pranë shtëpisë së mjekut. Dhoma kishte një pus që mblidhte ujërat e shirave, kishte një nevojtore të vogël, një kuzhinë dhe një dhomë fjetjeje, kishte një derë dhe dy dritare. Aty shkuam. Makbulja kishte zënë një dhomë me tri shoqe sllovene, në Rrugën e Kalvarit, shtëpia e fundit, lart.

Si jetonim: Paguheshim pesë lireta ditën. Dy lireta e gjysmë i mbante drejtoria për supën që hanim një herë në ditë dhe për barakën. Sipërmarrëse ishte e motra e princ Garganos. Ajo ishte padronia e ishullit. E kishte shtëpinë pranë zyrave, aty te sheshi "Longo", të cilin shesh të internuarit e kishin pagëzuar "*Piazza delle concienze vendute!* - Sheshi i ndërgjegjeve të shitura."

Pyetje: - Si e rregulluat jetën në Ustikë?

Përgjigje: - Do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje kështu: Jeta jonë e përditshme - jeta jonë politike - jeta në ishull.

Ende kishim pak të holla nga ato që na dhanë në Tiranë, para se të niseshim. Merrnim dy lireta e gjysmë ditën secili. Me ato blinim bukën, nga dyzet gramë secili, dhe nuk e hanim një ditë, që ta hanim ditën tjetër, se ishte shumë pak e nuk na mbetej gjë në dhëmbë. Blinim bathë dhe me bathët e thata bënim polentë të mirë dhe ngopeshim disi. Kishim dhe supën e përditshme. Nuk e hanim aty në mensën e madhe, por e merrnim në dhomë, ku e ngrohnim dhe i hidhnim pakëz vaj.

Në mensë, që ishte afër molit, shkonim ditët e para, sa ishim në barakë. Pasi morëm dhomë dhe pamë se ç'bënin ata që ishin më të vjetër në ishull, sidomos arbëreshin Çuço, filluam të hanim në dhomë. Iloja dhe Vançi ishin të aftë për të na gatuar. Gjenim nganjëherë edhe peshk, edhe mish, sigurisht në tregun e zi të banorëve të ishullit, që ishte shumë i përhapur. Mjafton të kishe para dhe çdo gjë gjeje. Na jepnin gjysmë kilogram sheqer në muaj dhe një paketë cigare "*Nacionale*" (me dhjetë cigare) në javë. Një pjesë të cigareve i shisnim, se nuk e pinim duhanin të gjithë. Mistura ishte i vetmi për të gjetur çdo gjë. Pastaj paratë na u mbaruan dhe ne prisnim të na dërgonin. Kurse Bedri Çelikut i dërgonte i ati, ashtu siç i dërgonin edhe Misturës motrat e tij.

Kishte ditë që shisnim bonot e supës. (Supa ishte kjo: çiçerkia, ca fasule qorre si qiqra të krimbura, me ca barishte. Servirej nga kazani, me dy qepshe, si në të gjitha burgjet: Qepshja e parë ishte me vrima; futej në kazan dhe ai që e ndante, e kullonte dhe e hidhte në tas. Pastaj ishte qepshja e dytë, pa vrima, për lëngun.) Shumë të internuar të vjetër italianë i shisnin bonot për gjysmë lirete, që të blinin verë, dhe hanin gjethe fiku deti. Në ishull nuk kishte as mace e as qen.

Porsa binte boria, vinte ai që çelte dyert, na hapte

lerën dhe dilnim. Ne e kishin organizuar jetën me ndë-resa, secili e dinte punën e vet të ditës. Shkonim, nerrnim bonot, blinim bukën. Në drekë bëhej apeli. Mblidheshin të gjithë te një shesh afër ambulancës dhe rinim aty të paktën një orë.

Shëtitnim. Mua mjeku më kishte dhënë leje të dilja ashtë caqeve ku shkruhej: *"Limite confinati"*. Dilja në drejtim të varrezave, rrija në një si tyrbe e shikoja detin e paanë; lexoja ndonjë libër ose shkruaja vargje. Shumë herë merrja edhe Makbulen, se ajo ishte e sëmurë dhe shumë e dobët. Aty takoheshim me të tjerë, që ishin të sëmurë dhe që rrinin duke shikuar detin. Në atë rrugë ishte dhe "Lazareti", spitali i vogël, ku shtroheshin dhe vdisnin të internuarit. Shumë herë vizitoja dhe *Campo Santon*, varrezat që ishin aty pranë tyrbes ku rrija dhe meditoja. Për varrezat e të dënuarve do të flas pakëz më gjatë. Kishte dy varreza: për të lirët mënjanë dhe për të dënuarit, që ishte më e madhe dhe më me shumë epitafe, në anën tjetër.

Nga mjeku kisha leje të rrija jashtë edhe kur binte boria për t'u mbyllur. Aty nga ora gjashtë ose shtatë e pasdrekes shkoja te familja e mjekut për të ngrënë e për të pirë çka më kishin ndarë, racionin e përditshëm, pastaj rrija e dëgjoja radion: komunikatën e Moskës, pastaj Radio-Tbilisin, komunikatën e Kajros dhe të Londrës. Kur kthehesha, shokët më prisnin me ankth. Do të flas më gjatë për komunikatën që nxirrnim në kamp. Kishim pranë dy grupe malazezësh dhe një grup kosovarësh, ish-oficerë të Jugosllavisë nga Tetova, Gjilani, Podgorica... Përballë nesh ishin ca italianë të mjerë. Njëri ishte me një këmbë, tjetrën e kishte katranosur vetë me dru dhe, kur ecte, kërciste në kalldrëm. Ai pinte dhe na shante shumë herë *"Beduini... bruti albanesi..."*. Dhe bërtiste: "E vrafshin atë derr, Musolinin, që krijoi një perandori të madhe dhe në vend që të na sjellë bukë na

bie shqiptarë të uritur!" Unë u lutesha shokëve të mos e ngacmonin, po një drekë, kur ishim duke ngrënë, ai hyri brenda dhe me një çekiç në dorë bërtiste: "Beduini! Beduini!" U ngrita, e kapa nga të dy krahët dhe i dhashë një shkelm prapa, sa u rrokullis në kalldrëm. Kërciste këmba e drurit. U pendova: pandeha se e vrava. Por ai u ngrit, më pa duke qeshur dhe tha: *"Per baco! Sei forte*! E pse të mos jesh i fortë! Ha bukën tonë, pi verën tonë!" - Shkova dhe i dhashë dorën. U bëmë miq dhe ngandonjëherë diçka i jepnim për të ngrënë. Kishte pesëmbëdhjetë vjet aty, kishte bërë dhjetë vjet burg.

Teshat i lanim me ujë deti. Uji që pinim, vinte nga Palermoja me një vapor çisternë.

Na erdhi aty dhe një shqiptar tjetër: një Hysen, nga Kruja, njeri i dyshimtë, njeri i Bazit të Canës, që nuk ndillte besim. E pranuam në kolektivin tonë, po ndenji pak me ne, se nuk i pëlqente. Nuk deshi që paratë t'i bashkonte me të kolektivit. Blinte bukë dhe e hante fshehurazi... U largua vetë prej nesh.

Na prunë aty dhe Kasem Radovickën, të cilin e njihja. Ai kishte shumë pará, prandaj m'u lut që të rrinte vetëm. I gjetëm një dhomë, aty pranë "*Campo Santos*", në një familje që kishte vend dhe pranonte të pasur. Ai paguante dhe hante e pinte në atë familje vendase. Blinte paketa shumë të shtrenjta dhe pinte shumë duhan: ndiz e shuaj e ndiz. Thuhej se i vinin para nga Roma, nga një shoqëri minierash, pasi ishte aksionist i madh i një miniere. Nuk ndenji shumë. Pas katër muajsh e liruan.

Me ndihmën e mjekut u transferua dhe Bedri Çeliku në një fshat të Bergamos, se ishte i sëmurë. Mjeku kishte kërkuar që ai të dërgohej në një vend malor.

U liruan dhe Emxhet Skëndoja e Mehmet Radheshi. Pastaj u lirua dhe Tasim Goxhi. Mbetëm: unë, Iloja, Gaqoja, Vançi, Makbulja, Koçoja. U lidha me shoqen time të mrekullueshme në Napoli, Jola Taliakocon (Lombardi),

e cila, me vëllanë e saj, na dërgonte çdo javë nga një pako me ushqime dhe me tesha. Nuk shkonim keq në krahasim me të tjerët që vdisnin nga uria.

Çështja e ndarjes së bukës ishte bërë problem. Unë vendosa dhe bëmë një peshore me karton dhe racionet i peshonim duke u kujdesur që asnjë thërrime të mos ndahej padrejtësisht. Problem për këtë gjë kishim pasur vetëm Koçon, që nuk ngopej kurrë dhe pretendonte që racionet të ndaheshin sipas trupit dhe oreksit dhe jo të barabarta. "Pse, Gaqoja trupvogël sa unë do të hajë, që kam trupin të madh dhe oreksin të madh?"

Para se të lirohej, Kasem Radovicka për pak e pësoi: E kishin thirrur në drejtori, me akuzën se natën u bënte sinjale vaporëve dhe nëndetëseve armike që vinin vërdallë në kanalin e Sicilisë. U thamë se Kasemi ditë e natë pinte cigare dhe, duke qenë se rrinte edhe natën në dritare, duke kundruar detin, ndizte shkrepëse për cigare dhe ato merreshin për sinjale.

Pasi na mbaruan paratë, filluam edhe ne të shisnim. Vançi i shkretë shiti unazën për një copë bukë. Shisnim teshat e tepërta për një copë bukë. Unë kisha një palë këpucë skish, nga Franca, të cilave një milic i kuesturës ua kishte vënë syrin. Një mbrëmje, kur isha duke dëgjuar Radio-Tbilisin, ai erdhi lart, në dhomën ku ishte radioja, dhe më tha: "Të kapa! Dëgjon komunikatat armike! Tani, në drejtori!" - dhe më shikonte këpucët! E pyeta nëse i pëlqenin, dhe ai thirri: "*Per baco*!"

I hoqa nga këmbët dhe ia dhashë. Që atëherë, e dëgjoja radion pa frikë.

Kisha vendosur të bëja një poemë për ato këpucë që i mbaja në Grënobël, sidomos kur shkoja dhe bëja ski. M'i kishte falur një rrobaqepës grek. Ku s'kishin shkelur ato këpucë të shkreta, dhe tani ishin në këmbët e një milici të kuesturës!

Për veshmbathje nuk kishim nevojë për asgjë, na dërgonte Jola, ato që i kërkonim. Nga Shqipëria nuk na

vinin më as edhe letra. Më vonë mora vesh se na dërgonin pako me ushqime si dhe pará, po nuk na i jepnin. Ishte krijuar një situatë e pasigurt, kështu që edhe ata të kuesturës gjenin rastin për të përvetësuar çdo gjë.

Dimrin 1942/43 Ustika ishte në krizë të madhe. Ra një sëmundje dhe shumë të internuar italianë vdiqën. Herën e parë u fryheshin këmbët, pastaj koka dhe pas pak ditësh vdisnin. Kur shkonin në mëngjes për të hapur barakat, nuk thoshin më "Gati të sëmurët, t'i shpiem në Lazaret", - por, - "Jashtë të vdekurit!" I nxirrnin me shumicë dhe i varrosnin pa asnjë ceremoni. Ne bëmë një ceremoni, se na vdiq një shok jugosllav. Volli shumë gjak dhe dha shpirt shpejt. Ishte i ri i Skoit, nga ata që shkonin mjaft mirë me ne.

JETA JONË POLITIKE

Kur u nisëm nga Tirana, ne ishim tre shokë të organizuar: unë, Iloja dhe Bedriu. Simpatizantë ishin Gaqoja, Emxheti dhe Vançi. Ishte dhe Makbulja, e cila nuk merrte pjesë në asnjë mbledhje.

Pasi mbërritëm në Ustikë, çështja e parë ishte që ne të lidheshim me shokët e atjeshëm, dhe ashtu bëmë. Më parë u njoha mirë me shokun Foxha, që ishte i vjetër. Ai, gjatë bisedave, më tha se aty ishin nja dhjetë komunistë italianë, që kishin celulën e tyre dhe ishin lidhur me partinë ilegale, në Palermo dhe në kontinent. Nuk vepronin fare dhe asnjë ndihmë e asnjë material nuk merrnin. Kur erdhi Antonio Xhigandi, me të cilin bisedova gjatë për shokët italianë që kisha njohur në Spanjë dhe në Francë, më foli dhe ai për situatën e mjerë të shokëve italianë. "Vetëm në Ventontene dhe në Ponza ka shokë që janë të gjallë!"

Me shokët jugosllavë u lidhëm më lehtë. Kishte shumë shokë sllovenë, kroatë dhe malazezë. Çdo grup

kishte celulën e vet, por komiteti ishte një, me përfaqësi nga çdo kombësi. Arritëm që edhe ne të lidheshim dhe thamë që përfaqësuesit e çdo grupi të mblidheshim në dhomën tonë dhe të punonim. Krijuam një komitet të përbërë nga dy shokë për çdo kombësi. U bënë zgjedhjet: mua më zgjodhën si komandant ushtarak dhe shokun Alois, sllloven, si komisar... Dushan Kermauneri, sllloven, që ishte si sekretar i partisë sllovene, shok i Titos, me të cilin kishin qenë bashkë edhe në burg, nuk u zgjodh, pasi kishte disa hesape me partinë e vet. (Akuzohej pse e kishte lënë veten të arrestohej! Ishte një dobësi dhe faj i madh.).

Gjithsej në Ustikë bëheshim nja pesëqind komunistë dhe kandidatë. Çdo kombësi kishte kolektivin e vet, kishte dhe organizimin e vet. Nga shoqet ishin vetëm pesë: shoqja e Dushanit, një austriake, çifute, me emrin Ruth (e dënuar si prostitutë, e bukur, por e çalë) dhe tri kroate. Kishim krijuar formacione ushtarake ilegale, që kishin komandantët dhe komisarët e tyre. Ne, pasi ishim pak, ishim në një formacion me italianët, se edhe ata ishin pak. Kur erdhi në ishull Nikolasi, një nga udhëheqësit e brigadës "Garibaldi" (ai mori pjesë në Poco Rubio, kur u pranova në parti, në tetor të vitit 1937), u fut edhe ai në komitet.

Ai u gëzua shumë kur na gjeti të organizuar shumë mirë. Nikolasi më njoftoi se shokët shqiptarë që kishin mbetur në kampet e përqendrimit në Gurs dhe Vernet: Mehmet Shehu, Mane Nishova dhe Zef Prela, ishin kthyer të shoqëruar në Shqipëri. Ai i njihte mirë të tre.

Puna më e madhe që bëmë, ishte komunikata që dilte çdo mëngjes. Unë merrja lajmet e luftës dhe të tjera nga Radio-Tbilisi, Radio-Londra, Radio-Kajroja çdo mbrëmje në shtëpinë e mjekut. Në mëngjes vinin shokët e caktuar, të çdo grupi , i merrnin dhe gjer në drekë gjithë kampi ishte në dijeni për gjithçka. Dua të shënoj

se me anë të këtij mjeti propagandistik bëmë që shumë ish-oficerë çetnikë të ktheheshin me ne. Më kujtohet njëri prej tyre: kolonel Millosh Duçiçi nga Podgorica, i cili u bë me ne dhe ndikoi që dhe shumë oficerë të tjerë të ndiqnin shembullin e tij. Duke lexuar komunikatat, ata kuptonin mirë se fitorja ishte jona. Për njëfarë kohe dëgjoja edhe një stacion nga Ballkani, që transmetonte greqisht dhe thoshte *"I foni tis alithias* - Zëri i së vërtetës". Një herë nga ky stacion dëgjova se partizanët shqiptarë kishin çliruar Skraparin. Ç'gëzim i madh për ne! Ishte një kambanë shqiptare që tingëllonte aq fort, sa na ngriti moralin shumë. Pastaj nuk u dëgjua më ai stacion. Herën e fundit dëgjova këto (greqisht): "Kujdes... kujdes... kujdes... se vijnë... erdhën!..." - dhe një zhurmë sikur përmbysej bota. Më erdhi keq! E mora me mend se ai stacion do të ishte zbuluar nga armiku dhe shokët që flisnin aty, do të ishin kapur ose vrarë, kështu që më mbeti një pikëpyetje e hidhur. Kisha vendosur t'u shkruaja letra spikerve të Radio-Tbilisit, të Radio-Moskës, po sa gjëra premton njeriu në kushte të caktuara dhe sa shpejt i harron! Sidoqoftë, komunikata që nxirrte grupi shqiptar në Ustikë, ishte një fitore e madhe, se në rrethana të tilla, në kushte dhe mjedise të tilla, një lajm i vogël është një injeksion shprese dhe guximi për atë që lëngon i izoluar, kur planeti është në furtunë. Për këtë nuk harroj kurrë mjekun Facio dhe familjen e tij, që na ndihmuan në ato kohë shumë të vështira dhe të pasigurta për jetën tonë.

Kur komunikata sovjetike njoftonte për fitore të mëdha, unë hapja dritaren e dhomës, ngrija shumë dhe zërin e radios, që jepte këngë revolucionare, të cilat dilnin nga dhoma dhe përhapeshin në Ustikë, në netët e qeta; të gjithë shokët në baraka dëgjonin dhe këndonin edhe ata... Ishte edhe kjo një fitore në atë skëterrë të fashizmit, kur netëve përhapeshin dhe oshëtinin këngët e revolucionit.

Kur hitlerianët ishin në Stalingrad, si në tërë botën, shtu edhe në Ustikë ankthi dhe dëshpërimi errësonin hpresat e jetës. "Stalingradi ra! Stalingradi po bie!" - rumbetonte shtypi dhe radioja fashiste. Dhe të nternuarit e Ustikës, të dëshpëruar, mendonin për jetën tyre, që do të mbaronte në atë nisi të shkretë. Po një natë, më duket se aty nga shkurti i vitit 1943, dëgjova komunikatën e fitores në Stalingrad! E ngrita shumë zërin radios dhe oshëtinë atë natë në Ustikë këngët e evolucionit, sa zemrat na rrihnin me forcë, sikur po na dilnin nga kraharori.

Kur dola nga shtëpia e mjekut, shkova drejt e te roja. Ai na donte. Edhe ne e deshëm, shpesh e qerasnim me diçka, sidomos me cigare. Më pyeti se si ishte gjendja dhe ç'lajme kishte dhe unë iu përgjigja se diçka e mirë po lëvizte, se Hitleri kishte mbaruar.

Sapo hyra brenda, u thashë të këndonin me zë të lartë. Buçitën këngët. Pas pak këngët u dëgjuan në dhomën pranë te kroatët, pastaj dhomë më dhomë e barakë më barakë. Nuk besoj të jetë pritur gjëkundi në botë lajmi i fitores në Stalingrad, ashtu siç u prit në Ustikë! Shokët e barakave të tjera e merrnin me mend, po jo aq sa kur lexuan të nesërmen komunikatën! Edhe gjatë ditës oshëtinë këngët. Shumë shokë sllovenë e malazezë u dehën, pinin për shëndetin e Ushtrisë së Kuqe, për shëndetin e Stalinit! Edhe të gjorët ordinerë këndonin, se tani po e besonin që Musolinit po i vinte fundi e se së shpejti do të jetonin në liri! Në liri të sigurt.

Ishim të bindur se tashmë lufta do të mbaronte shpejt dhe ne do të ktheheshim në vendet tona të lira. Çdo ditë, dëgjonim lajme të reja. Ushtria e Kuqe i kishte vënë përpara hordhitë naziste. Përditë komunikata fliste për fitore. Kishim bërë hartën e frontit dhe vinim përditë flamurin në qytetet e çliruara.

Letra nuk vinin më. Na sollën dhe disa të internuar

të tjerë, midis të cilëve edhe Alfredo Çekin me gruan, djalin dhe vajzën. Këta kishin qenë në Francë; nga Franca, kur u kthyen, menjëherë i internuan në Avelino, pastaj i prunë te ne. Zura miqësi me atë familje punëtorësh. Alfredoja ishte komunist. Me vajzën e tij, Dorën, zumë miqësi dhe bashkë me të vëllanë, Mikelen, dilnim shëtitje në Kampo Santo. U bëja edhe mësim, siç jepja dhe në shumë kurse të internuarish, si dhe djalit të mjekut, që ndiqte liceun e Palermos.

Një ditë morëm një letër nga profesor Gaetano Petrota, që ishte, më duket, rektor në Universitetin e Palermos. Letra ishte shkruar shqip: *"Të dashtun arbreshë. Kam marrë vesh se jeni aty disa arbreshë. Unë du me ju ndihmue; nëse keni nevojë, të më shkruani se ç'ka ju nevojitet..."* Diskutuam për këtë në mbledhjen e komitetit tonë të përbashkët. Italianët na thanë se Petrota ishte fashist, prandaj nuk iu përgjigjëm.

Një ditë më thirri për vizitë mësuesja e Ustikës. Ishte bashkë me nënën e saj. Më pritën me ngrohtësi. Më gostitën dhe më thanë nëse kishim nevojë të lidheshim me shokët e Palermos ose të kontinentit. Ato ishin gati të shpinin e të binin letra. Mësuesja ishte shumë e sinqertë dhe u binda se këtu nuk mund të kishte ndonjë qëllim të keq. I falënderova. Në komitet vendosëm t'i provonim. I dhashë nënës së saj një letër për një shok në Palermo. Kur u kthye nga Palermoja, më solli një letër, ku, midis të tjerash, na thuhej që mëmën e mësueses mund ta përdornim si ndërlidhëse.

Një nga kujtimet e mia sentimentale është dhe ky:

Unë, shumë herë, rrija aty në sheshin e të internuarve dhe dëgjoja pianon; i binte një vajzë leshverdhë, aty pranë, në shtëpinë e padrones së Ustikës, nga familja princore Gargano. Ajo i binte pianos kur më shikonte mua që rrija duke vështruar detin, i mbështetur te trungu i njërës nga të katër pemët e sheshit. Pasi i

binte disa pjesëve romantike, dilte dhe më shikonte. Një herë, një nga milicët e kuesturës, nga Katania, që quhej Karmelo, që më afrohej shpesh e më thoshte se babai e kishte futur në kuesturë aty në Ustikë për ta shpëtuar nga fronti rus, më kallëzoi se mbesa e padrones, ajo bjondina që luante në piano, i binte për mua. Kishte pyetur mësuesen se cili isha, dhe i vinte keq. Një ditë mësuesja e mirë më dha këtë letër nga ajo: *"Mos kujtoni se ne jemi skllevër të Musolinit dhe të fashistëve! Edhe ne i urrejmë. Jemi me ju! Kurdoherë mendoj për ju dhe pianos i bie për ju!"* Në një letër tjetër më shkruante: *"I jemi lutur doktor Facios që t'ju ketë kujdes dhe ai na ka thënë se ka shumë kujdes për ju. Dëgjoni pianon, që shpreh ndjenjat e mia për ju."* Mësuesja më tha: "Ajo kërkon të takohet me ju. Unë e sjell këtu në dhomën tonë, dhe ju, po të doni, e takoni!" Më pëlqente ta takoja e të flisja me të, po për mua ishte një rrezik i madh. Po të mësonte drejtori, kuestura, karabinieria ose spiunët që unë takohesha me mbesën e konteshës, patjetër që do të dënohesha të paktën me tre muaj izolim, ku dhe mund të vdisja. Në Ustikë kishte shumë gra publike, nga më të përdalat e Italisë, kishte dhe homoseksualë, nga më të përdalët e Italisë. Aq të degjeneruar ishin, sa dhe fashizmi nuk i kishte lënë të lirë, por i kishte sjellë aty, në atë nisi. Ishin shumë të ligj. Homoseksualët edhe emrat i kishin femërorë: në vend që të quhej Piero, quhej Pierinë; në vend që të quhej Anxhelo, quhej Anxhelinë. Edhe gjestet, edhe zërin e kishin femëror. Ata në përgjithësi bënin punët e femrës, si p.sh. rrobaqepëse e të tjera. Kur ziheshin në mes tyre për çështje xhelozie, thereshin e gjakoseshin me thika. Ne u ruheshim këtyre sherreve dhe skenave ordinere e çnjerëzore, ashtu si dhe gjithë ballkanasit, sidomos malazeztë e gjorë, që thoshin: më mirë është të internohemi në ferr se në këtë mjedis të degjeneruar...

JETA NË ISHULL

(Do të flas dhe për qenin Fido.)

Të internuarit italianë bënin një jetë nga më të mjerat. Ishin katandisur keq e mos më keq, nga uria e nga të gjitha. Nuk lanë qen ose mace të ishullit pa ngrënë. Jetonte vetëm Fidoja, qeni *maskot* i tyre, dhe konia e shoqes së drejtorit të kampit, një *foxterrier* i vogël, i majmë, i bukur, me kordele në qafë. Një ditë, edhe konen e saj e hëngrën të internuarit. E shoqja e drejtorit qante, se fëmijë nuk kishte dhe atë kone e kishte rritur dhe e mbante si foshnjë. Drejtori ç'nuk bëri për të gjetur se kush e kishte ngrënë. Përdori të gjitha mjetet e zbulimit, po kones nuk iu gjet asnjë qime. Dhe ai u hakmor kështu:

E dinte që të internuarit e deshën shumë qenin e tyre Fido, e ushqenin me thërrime dhe e kishin si të shenjtë. Nga lehjet e Fidos ata profetizonin ngjarje të çuditshme. Po sjell një shembull: Një mëngjes ra boria për hapjen e barakave-burg. Fidoja e kishte zakon që, sapo dëgjonte borinë, vraponte drejt e te borizani dhe lehte me të madhe, gjersa pushonte boria. Një mëngjes, kur ra boria, nuk u dëgjuan të lehurat e Fidos. Ai që kishim përballë, nxori kokën nga hekurat e dritares dhe na tha: "Do të kemi ndonjë krim sot në kamp!" (Ai që fliste, ishte njeriu me këmbë druri.) Pas pak u hapën barakat dhe ata që kishin për të dalë, dolën. Dola edhe unë dhe u nisa për në sheshin "Longo", ku zakonisht mbështetesha te trungu i një peme dhe prisja të dilte leshverdha e të fillonte t'i binte pianos. Dhe ja u çel pazari! Ç'pazar! Njerëz skelete, me diçka në dorë, uleshin aty dhe mezi thoshin: *"Me la vendo!* - E shes!" Po çfarë shiste? Ndonjë palë nallane të vjetra, ndonjë këmishë të arnuar, ndonjë palë pantallona të arnuara, ndonjë kopsë, ndonjë pasqyrë sa gishti. Njëri kishte një furçë dhëmbësh me tri a katër fije dhe thoshte: *"Me la vendo!"* E sa? Sa për një

thithur cigareje, për një gotë verë. Doli ai që shiste thi. Ai ishte antifashist dhe kishte gjithë jetën në burgje ıe internime. Nxirrte ndonjë liretë ditën me ato pesë |thi që shiste. "10 lajthi njëzet qindarka. 50 lajthi një ë" - mezi i dëgjohej zëri. Njëri nga ata që numëroheshin e gisht në Ustikë, laxarone dhe kusar me famë lërkombëtare, që kishte ngrënë dhe shokun e tij, kur 'aduan nga Kajena e Guinesë franceze në Amerikën e ıgut se aty i dërgonte Franca ata që dënoheshin me urgim të përjetshëm (dhe kjo kishte ndodhur kështu: ëta kishin vrarë një rojë, kishin marrë një varkë dhe ıhin hedhur në Paludat e Guinesë së egër; aty moçale, gërsira, vdekje; ec e ec dhe ky, duke mos pasur asgjë ër të ngrënë, e kishte vrarë shokun, e kishte bërë thela hela dhe ishte ushqyer me to, gjersa kishte arritur deri ıë një vend ku kishte gjetur njerëz), ky, pra, i tha atij hokut antifashist që shiste lajthi: "Më jep një liretë!". 'asi ia mori, i tha se nuk ia kishte dhënë tamam, por nangut. U zunë keq! Ky kriminel i këputi një shkelm rastës me lajthi. Trasta u përmbys dhe lajthitë u shpërndanë nëpër kalldrëm dhe të internuarit që ishin aty duke shitur diçka, u sulën për t'i mbledhur e për t'i ngrënë. Krimineli i këputi të ziut antifashist një nallane në kokë dhe e la në vend pa frymë. Ai dergjej aty, ndërsa të tjerët ziheshin për kokrrat e lajthive që mblidhnin, ndërsa krimineli, pa asnjë shqetësim ose turp, zbërtheu pantallonat dhe nisi të bënte nevojën nën monumentin e Longos duke kënduar një këngë pornografike. Skenë makabre kjo në një kamp makabër, ku fashizmi kishte hapur ekspozitën e ideologjisë së tij dhe të moralit të tij.

Kur u ktheva në dhomë, më tha njeriu me këmbë druri:

"Fidoja është profet! Ai e paralajmëroi atë krim!"

Dhe drejtori, për të marrë hakun e kones, ç'bëri?

Një mëngjes, kur ra boria, u dëgjuan ulërimat e

Fidos. Ulërima therëse për zemrat e atyre që e deshën për kaq vjet. Klithmat vazhduan shumë, pastaj nuk u dëgjuan më... Të gjithë kujtuan se e kishin rrahur Fidon e gjorë. Kur u hapën barakat, u dha urdhër të mblidheshim në shesh... Kur vajtëm atje, ç'të shihnim? Fidon e kishin varur si njeri. Qëndronte Fidoja i gjorë, me gjuhën përjashta. Të gjithë filluan të qanin dhe të mendonin se erdhi fundi i kampit! U dha urdhër që Fidon ta hiqnin nga trekëmbëshi dhe ta hidhnin në det. Asnjë nuk lëvizi! Asnjë nuk pranoi të zbatonte atë urdhër të drejtorit. Qanin me dënesa! Pastaj karabinierët e hoqën nga trekëmbëshi dhe, duke e hequr zvarrë, e çuan pas, aty ku rrija unë, dhe e vërvitën në greminë për në det!

Thoshin se ai nuk ishte mbytur, po dallgët e sillnin vërdallë Ustikës. Disa thoshin se dëgjonin të lehurat e tij, sidomos netëve kur frynte erë.

Pas varjes së Fidos, aty nga prilli i vitit 1943, na erdhi një njësit zbulimi gjerman. Ata u vendosën në zyrat e kryetarit të bashkisë dhe në çast zbuan andej të gjithë ata që banonin pranë asaj ndërtese. Sapo erdhën zbuluesit hitlerianë me aparatet dhe me mjetet moderne të zbulimit, Ruthi, prostituta çifute vjeneze, e internuar aty qysh nga viti 1939, kur nisi Lufta e Dytë Botërore, si prostitutë nga Milanoja, menjëherë u vesh si togere e Gestapos dhe u largua. E kishim anëtare të partisë, na kishte dhënë shumë informata nga zyrtarët e Ustikës, se kishte lidhje me ta, me kuesturën, me të gjithë. Ne e besonim si komuniste militante që "sakrifikonte trupin e saj" për të mbledhur të dhëna që na interesonin. Ishte kjo një ngjarje e padëgjuar dhe e paparë; për më tepër ne u tronditëm, se ajo dinte shumë gjëra nga organizimi ilegal që kishim. Atë e kishim ngarkuar shumë herë me misione delikate, të cilat i kishte kryer. Na kishte informuar dhe për lidhjet që kishin prostitutat ose femrat e tjera të internuara me ata që flinin me to. Pas ikjes së

saj, ne vumë në pikëpyetje gjithë raportet dhe të dhënat që na jepte. Bëmë një mbledhje urgjente dhe morëm masat e duhura. Ç'organizim që kishte zbulimi gjerman! Edhe në Ustikë kishte dërguar një agjente me përvojë.

Kur po bëhej apeli, si zakonisht, në drekë, erdhi një mareshal gjerman. Ai thirri me të madhe: "Petjo Mako, Petgo Mako!..." Asnjë nuk kuptoi asgjë. Pastaj oficeri italian thirri "Petro Marko!" U habita dhe ngrita dorën duke u përgjigjur si kurdoherë: "*Presente*!" Më mori mareshali gjerman dhe më shpuri në komandën e tyre të porsangritur. Aty ishin dy oficerë të rinj që luanin me letra. Më thanë të ulesha, ndërsa ata vazhdonin lojën. Njëri më zgjati një paketë cigare greke "Papastratos." "Nuk e pi", - i thashë. Më zgjati një çokollatë "Nestle", zvicerane. Me druajtje e mora dhe e mbajta në dorë. Më mbushi një gotë me konjak "Metaksa" dhe nuk m'i hidhte fare sytë as ai e as shoku i tij. Luanin, qeshnin, flisnin në mes tyre. Unë prisja. Pasi mbaruan lojën dhe qeshnin me të madhe, njëri nga ata, togeri simpatik, më foli frëngjisht: "Unë jam oficer hitlerian. Ju lutem, më dëgjoni me kujdes! Edhe unë jam artist, kam mbaruar liceun artistik, jam austriak. Po tani jam ushtar i Hitlerit. Pra, ju këtu jeni të organizuar mirë. Por... Me ne nuk ka shumë fjalë. Me ne të silleni mirë, pa na penguar në misionin tonë. Nuk ju trazojmë fare. Me italianët bëni ç'të doni, edhe mund t'i vrisni të gjithë, po të doni. Ne nuk trazohemi. Po me ne, kujdes se mos bëni ndonjë shaka të keqe, se për një orë ju shuajmë të gjithë! Po të keni ndonjë nevojë, na thoni, se do t'ju ndihmojmë". - Fliste duke më vështruar në sy. I thashë se ne aty ishim pak shqiptarë dhe ato që më tha, do t'ua komunikoja shokëve të mi shqiptarë. Për të tjerët s'mbaja asnjë përgjegjësi.

Ai u ngrit më këmbë dhe më tha se ishte në dijeni të organizimit tonë dhe se e dinin që unë isha komandanti ilegal i kampit. Më përsëriti fjalët: "Mos na ngatërroni,

mos na pengoni në misionin tonë, që të jeni rehat. Po bëtë ndonjë marrëzi, ne do t'ju shuajmë brenda një ore."

U ktheva në dhomën tonë. Shokët i gjeta të shqetësuar. Kur më panë, u gëzuan. U thashë pse më kishin thirrur gjermanët. Ramë në mendime, në mendime shumë shqetësuese. Pas një ore erdhi një gjerman dhe më tha se më kërkonte komandanti i tyre, po ai me të cilin bisedova pak më parë. Shkova. Më tha: "Na duhen nja njëzet veta të fuqishëm, që të transportojnë materialet tona që nga moli e gjer te semafori. 10 lireta ditën dhe një kilogram bukë secili. Për një orë të paraqiten këtu!" - dhe më bëri shenjë se kaq kishte për të më thënë. U ktheva te shokët. Dërgova fjalë të vinte Aloisi. Erdhi dhe ia komunikova të gjitha. Tha se menjëherë do të zgjidhte nja njëzet shokë të fortë që të transportonin materialet, pasi 10 lireta dhe një kilogram bukë në ditë nuk ishin pak. Shkuan shokët dhe punuan një javë, sa i transportuan të gjitha, por as lireta u dhanë, as bukë u dhanë. Shkova te komandanti gjerman dhe i thashë se punën e kishin mbaruar, prandaj t'i paguante siç kishte premtuar.

Ai u ngrit e më tha ta ndiqja. Shkuam para drejtorisë. Para derës ishte togeri i karabinierëve. Togeri gjerman e urdhëroi togerin italian që të njoftonte të dilte pak jashtë drejtori. Togerit italian nuk i pëlqeu mënyra urdhëruese, e egër e gjermanit, por u fut brenda dhe doli bashkë me drejtorin, i cili qëndroi gatitu para oficerit gjerman. Ky i fundit i tha prerë: "Brenda ditës do t'u japësh atyre që transportuan materialet tona nga moli në semafor, nga një kilogram bukë dhe nga dhjetë lireta ditën. Brenda ditës!" - përsëriti dhe iku. Unë e ndoqa prapa. Ai ktheu kokën dhe më tha se brenda ditës do të rregullohej gjithçka. Dhe vërtet ashtu u bë.

U duk se midis italianëve dhe gjermanëve ishte hapur një hendek urrejtjeje. Një ditë po ai toger gjerman e ndaloi togerin italian mu në mes të sheshit dhe i bërtiti të rrinte

;atitu kur i fliste: "Një ushtar gjerman që vjen nga Fronti Lindjes ka të drejtë edhe ai të kalojë një orë me një emër. Pse e ndalove?" Italiani i tha se ajo femër (njëra nga prostitutat e internuara) ishte e dashura e tij. Dhe oficeri gjerman i bërtiti: "Kur ne përgjakemi në Frontin e Lindjes, ju këtu zini të dashura prostitutat tuaja! Ta hashë copë: mos e nga ushtarin tim, i cili ka të drejtë edhe ai të zbavitet, se të piu e zeza!"

Ndërsa në ishull ishte ndezur një atmosferë paniku dhe tmerri, kontesha Maria, e shoqja e një profesori të universitetit të Romës, e degjeneruar, prandaj dhe ishte internuar, blinte qumësht, lante me të fytyrën e fishkur dhe përsëriste: "Fashizmi i poshtër, që më prishi fytyrën time!"

Ne mblidheshim më shpesh dhe mendonim si të zotëronim situatën në ishull, pasi fronti ishte përballë nesh, në Tunizi. Një ditë, një aeroplan gjerman me robër lufte (anglezë) u ul në vreshtat e Ustikës. Ne kujtuam se zbarkuan aleatët, por ja që ata ishin robër lufte... Aty u bë dhe një betejë e madhe aeronavale: *gjëmonte vendi*, oshëtinte qielli dhe deti. Shumë aeroplanë binin e disa anije merrnin zjarr. Ishte e rreptë lufta dhe ne me ankth prisnim se ç'do të bëhej. Lufta aeronavale mori fund dhe ne shihnim se si në brigjet e Ustikës deti nxirrte materiale të shumta, madje dhe një nëndetëse të vogël gjermane të përmbysur. Orët dhe ditët ishin të ngarkuara me ankth e pasiguri. Gjendeshim në frontin midis dy ndërluftuesve. Prandaj menduam ta merrnim ishullin. U mblodhëm dhe biseduam; bëmë planin. Pushtimi nuk ishte i zorshëm. Do të asgjësonim më parë garnizonin italian, të dobët; pastaj, me armët që do të merrnim, do të sulmonim garnizonin gjerman të zbulimit. Ne ishim shumë dhe të vendosur. Plani u përpunua mirë dhe u pranua nga të gjithë. Antonio Xhigandi dhe Nikolasi thanë: "Po sikur të pyesim dhe Dushan Kermaunerin? Është shok i vjetër

dhe me përvojë të madhe, është dhe gjakftohtë!" E thirrëm dhe i njoftuam vendimin që kishim marrë. Ai na kërkoi njëzet e katër orë afat, që ta studionte planin. Të nesërmen erdhi dhe na tha se nuk duhej në asnjë mënyrë ta bënim këtë krim! E quajti krim! Dhe filloi ta argumentonte:

"E para, ju planin e keni bërë mirë për ta marrë ishullin në dorë. Kjo bëhet.

E dyta, e morëm ishullin. Po pastaj? Ju thoni se do të dërgojmë dy shokë, me një motoskaf që do të marrim, në Tunizi. Ja u arrit edhe ky qëllim: shkuan dy shokët tanë me motoskaf në Tunizi. Kush është atje? Atje janë anglezët dhe amerikanët. Do ta çajnë kokën ata për ne? Do të vijnë të na shpëtojnë? Kurrë! Ja erdhën këtu. Do të na marrin? E ku do të na shpien? Në ndonjë kënd të Afrikës për të vdekur atje. Ja nuk na shpien në ndonjë shkretëtirë për të vdekur atje, po na marrin dhe na inkuadrojnë në ndonjë taborr mercenarësh. Po pastaj, kur të kthehemi gjallë në vendin tonë, ç'do të na thonë? Do të na akuzojnë si agjentë të imperializmit anglo-amerikan. E të tjera, e të tjera.

Po kryesorja është kjo: kur ne do të jemi duke luftuar me garnizonin gjerman, a thua se ndonjëri prej tyre nuk do të lajmërojë me anë të radios qendrën e tyre për kryengritjen e këtushme dhe për rrezikun e jetës dhe të misionit të tyre? Besoj se këtë ata do ta bëjnë menjëherë. S.O.S. do të lëshojnë menjëherë. E pastaj, ç'do të bëjnë gjermanët? Do të na lënë më të gjallë këtu? Jo! Ata do të vijnë të tërheqin njerëzit e tyre, e pastaj do të na përvëlojnë me bomba me napalm të gjithëve e s'do të mbetet njeri i gjallë."

Dushani foli më gjatë. Na bindi. Prandaj e anuluam vendimin.

Nga komunikatat që nxirrnim përditë, u përmend dhe lufta aeronavale e kanalit të Sicilisë, që e pamë me

ytë tanë. Ushtria e Kuqe përparonte shumë. Por ishulli në i izoluar tani me zor lidhej me Palermon, prandaj dhe ushqimet pakësoheshin, edhe uji pakësohej. Ishim ë nervozuar e gjithë ankth. Ishim plot pikëpyetje për etën tonë.

Aty nga muaji maj, pamë se gjermanët po iknin. Për ıe ishte një shenjë e mirë, se frikën ua kishim. Mendonim ;e ata do të na shfarosnin para se të largoheshin. Me njekun bisedonim shumë. Atij i lashë një deklaratë,[1] ɔër shërbimet e shumta që na kishte sjellë. Edhe ai ishte ıë ankth, si gjithë banorët e ishullit. Një mëngjes erdhën dy vaporë për të na marrë. Me shpejtësi u dha urdhri që të zbrisnim në mol. Morëm ato tesha që na duheshin, dhe në rrëmujë, si një ushtri e dërrmuar në tërheqje, na zbritnin grupe-grupe dhe të palidhur na futnin në vapor. Unë kërkoja shokët: Ilon, Gaqon, Makbulen. Vançi ishte me mua. Në vapor isha me Nikolasin, me Xhigandin, me familjen Çeki e me të tjerë. Arritëm në Palermo e të gjithë u grumbulluam në një shesh. Kërkoja shokët e mi. Thërrisja. Na lidhën e na nisën për në Monreal më këmbë, të lidhur. Arritëm në mbrëmje dhe fjetëm në një fushë plot me limonë, limonë të mëdhenj, lëkurëtrashë, si qitrot. Shikonim valët e aeroplanëve aleatë që fluturonin dhe bombardonin qytete. Aty ndenjëm një javë. Vizituam edhe kishën e vjetër të Monrealit, të ndërtuar në kohën e Frederikut II. Edhe banorët ishin në ankth, por, megjithatë, na jepnin bukë.

Na hipën në tren dhe u nisëm për në kontinent. Nuk gjente shoku-shokun. Aty më thanë se i kishin parë shokët e mi të hipnin në trenin e parë (Ilon, Gaqon, Makbulen). Duke udhëtuar drejt Mesinës, shikonim popullatën në rrëmujë, në panik. Kishim frikë se mos na mitralonin ose na bombardonin aeroplanët aleatë. Ka-

1) Kjo deklaratë i shërbeu pas çlirimit të Italisë dhe ai u dekorua.

përcyem kanalin e Mesinës mbi ferrabot dhe treni drejtohej tani për në veri. Për ku? Asnjë nuk dinte se ku na shpinin. Trena të tjerë plot me të burgosur dhe të internuar ishin nisur para trenit tonë. Shikonim qytete, kalonim tunele të shumta. Drejt veriut: Për ku? Pse nuk na lironin? Disa u hodhën nga dritaret dhe ikën. Mendova të hidhesha dhe unë. Po shokët? Pas disa ditësh arritëm në një kamp, në Alatri, Frozinone. Kampi quhej Frasketi. Ishte plot me të reja sllovene dhe kroate, motrat dhe të fejuarat e partizanëve. Ishin shumë.

NË KAMPIN "FRASKETI" - ALATRI-FROZINONE...

Pyetje: - Ç'ishte ky kampi "Frasketi"?

Përgjigje: - Ishte krijuar për shtetasit britanikë të zënë robër në Tripoli e gjetkë. Po në të vërtetë aty nuk kishte asnjë britanik autentik. Ishin grekë nga Kreta e Qiproja dhe shqiptarë nga arbëreshët që punonin në Tripoli, Libi e Maltë, por që kishin nënshtetësinë britanike. Kampi ishte modern: me vila të vogla, me banja, me mensa, me kuzhinë, sheshe e rrugë të drejta. Aty ishin pak shtetas britanikë (gjiritllinj, maltezë, qipriotë, sicilianë) e, meqë kampi ishte i madh, e kishin mbushur me të reja sllovene dhe kroate. Shtetasit britanikë ishin të paktë aty e me familjet e tyre. Merrnin nga Kryqi i Kuq Internacional, me anë të Zvicrës, çdo javë nga 400 lireta e 18 kg ushqime të mira. U vinin pako nga Kanadaja me gjithë të mirat brenda: kafe, sheqer, sallam, zhambon, kaçkavall, oriz, kuti me mish nga Argjentina e Australia.

Qindra e qindra të reja sllovene e kroate na pritën me dashuri. Aty gjeta dhe Arso Milatoviçin, të cilin e kisha njohur në Tiranë dhe kolektivi ynë e kishte mbajtur mirë, bashkë me të vëllanë dhe familjen, siç kishim mbajtur gjithë malazeztë e arrestuar, që i sillnin familjarisht

në burgun e Tiranës. Arsoja u gëzua pa masë, kur më pa, dhe nëpërmjet tij u lidhëm me partinë aty. Unë me Vançin u caktuam në një dhomë pranë familjes së Çekit. Ishin vila të vogla, me banjo e me dritë, të ndërtuara si kamp-model për ata që deshën të vinin në Itali për të parë se si trajtoheshin robërit e luftës. Isha bërë shumë merak për Ilon, Gaqon e Makbulen, por Arsoja më tha se ata bashkë me të internuarit e tjerë të Ustikës kishin shkuar në një kamp afër Arezos. Pastaj më tha se një pjesë e tyre kishin dashur të shkonin në Sllloveni, po gjermanët i kishin kapur dhe i kishin dërguar në kampet e Austrisë. Bashkë me ta kishte qenë dhe Aloisi, komisari politik i Ustikës.

Ditët e para hëngrëm mirë, se na ndihmuan shtetasit britanikë, që në të vërtetë ishin grekë, hamej, dhe arbëreshë që i kishin zënë familjarisht në qytetet e Libisë, ku punonin si sfungarenj ose si hamej të porteve Bengasi, Tripoli. Një familje arbëreshe nga *Piana degli albanesi*, kur mori vesh se në kamp kishin ardhur dhe shqiptarë, erdhën na ftuan dhe shkuam bashkë me Vançin. Na pritën, na dhanë gjithë ato ushqime. M'u lutën t'u mësoja shqip dy djemve që kishin me vete. Fillova t'u mësoja atyre shkrim e këndim shqip. Unë e Vançi hanim bashkë me familjen e Çekit, megjithëse Arsoja më tha të bashkoheshim në kolektivin e tyre. Edhe aty supa ishte e keqe. Thuajse përditë supë me kungull e me pak domate e lakra. Po mbaheshim me ndihmat që na jepnin shtetasit britanikë. Ata gjithë ditën pinin. Sidomos pleqtë e lodhur nga puna e rëndë e sfungarait dhe e hamallit, aty kishin gjetur parajsën. Ku i kishin parë ato të mira në jetën e tyre! Gjithë bota, si dhe ne, priste me padurim mbarimin e luftës, fundin e fashizmit, që të ktheheshim në jetën tonë të lirë, kurse ata pleq dhe burra, rrëzë barakave, me fiaskot e verës përpara, pinin dhe luteshin që lufta të mos mbaronte kurrë.

Tensioni psikologjik në rrethet e ushtarakëve dhe të rojave të kampit përditë shtohej. Me ne silleshin mirë. Nuk ndërhynin kurrë në veprimtaritë që zhvillonim. Nuk thoshin asgjë, kur gjëmonte kampi nga këngët revolucionare. Vinin fshatarë çoçarë (ai vend quhej Çoçaria), burra dhe gra, dhe na shisnin fruta, vezë, djathë e mish pastërma. I këmbenin edhe me veshmbathjet tona, sidomos të vajzave sllovene dhe kroate.

Në kamp krijuam një komitet provizor. Përsëri mua më caktuan komandant dhe Arso Milatoviçin, komisar. Lajmet i merrnim nga shtypi. U përpoqëm të lidheshim me ndonjë fshatar, pranë kampit, që kishte radio. Por ata fshatarë ishin shumë të varfër dhe radion pak familje e njihnin. U përpoqëm, me anën e vajzave sllovene ose kroate, se mos afronim ndonjë ushtarak, por nuk qe e mundur. Ditët na dukeshin shumë të gjata. Kishim krijuar disa forma edukimi. Njëri nga problemet që rrihej më shumë, ishte: a është i sinqertë koalicioni antifashist midis Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës, apo jo? Ne, me sa mundeshim, i sqaronim shokët dhe sidomos vajzat sllovene (shumica katolike), duke u bazuar në ato që dinim nga Radio-Moska për këtë koalicion kundër Boshtit Romë-Berlin- Tokio.

Më 25 korrik u përhap lajmi i arrestimit të Musolinit! Gazi dhe hareja oshëtiu në kamp: *Musolini u arrestua! Fashizmi ra! Fashizmi u mund*! Këngë e valle. Vajzat sllovene dhe kroate nuk mbaheshin dot. Këndonin, kërcenin. Na përqafonin me lot në sy: "Fituam! Do të kthehemi në atdheun tonë".

Ne organizuam një mbledhje të madhe. Ngarkuam të fliste Çeki. Ligjëratën e hartuam shpejt e shpejt së bashku (se Çeki ishte punëtor pa shkollë). Ai e lexoi me zë të lartë: *"Fashizmi mbaroi! Rroftë liria..."*

Tani prisnim ç'do të bëhej. Badolioja kishte thënë se lufta vazhdonte. Dëgjonim se në Romë luftonin ita-

lianët me gjermanët. Musolinin e shpunë në Ponza e pastaj e morën dhe e çuan në malet e Abrucit, ku e rrëmbyen gjermanët dhe e shpunë te Hitleri, i cili e priti dhe e ngarkoi të kthehej përsëri në Italinë e Veriut e atje të krijonte Republikën e Salosë. Italia ishte në rrëmujë. Ne prisnim se ç'do të vendosej për jetën tonë. Mësuam se një pjesë e antifashistëve të internuar në Ventontene e në Ponza ishin liruar, si: Skoçimaro, Teraçini e të tjerë. U lirua dhe Nikolasi, që ishte me ne, dhe familja e Çekit, po vetë Alfredoja jo! Unë dhe Vançi bëmë një lutje ku thoshim se, meqë ishim arrestuar dhe internuar si qytetarë të perandorisë, pse të mos liroheshim dhe ne si shokët italianë. Asnjë përgjigje. Prisnim me ankth. Shumë thashetheme qarkullonin: "Do të vijnë gjermanët të na marrin! Do të na shpien në kampet e Gjermanisë." Folëm me shokët. Bëmë një mbledhje. Unë kërkova që të largoheshim nga kampi e të mos prisnim të na merrnin gjermanët. "Të presim, se ku do t'i lëmë gjithë këto shoqe", - thoshte Arsoja, komisari i jugosllavëve. Ishim në tension. Gjumi nuk na zinte. Një ditë dëgjuam zhurmën e tankeve gjermane që vinin drejt kampit. Unë isha me një shok malazias që quhej Bozho, dhe me Alfredon. U thashë të iknim. Ata pranuan. Shkuam drejt murit. I pari hipa unë, me ndihmën e tyre. U hodha jashtë. Pashë të hidhej dhe Alfredoja, ndërkohë u dëgjuan fishkëllimat e plumbave në krye të murit. Qëllonin tanket gjermane. Kujtuam se Bozhon e vranë, po Bozhoja, i shkathët, u hodh edhe ai dhe të tre vrapuam që të largoheshim sa më parë nga afërsitë e kampit. U ngjitëm në të përpjetën për në Fumone, një fshat përmbi bregoret. Dëgjoheshin krismat e mitralozave dhe thirrje. Vraponim. U err. Arritëm në fshatin Fumone. Shkuam në një shtëpi. Na hapën dyert. Na dhanë për të ngrënë. Dëgjuam radion dhe mësuam se lufta bëhej në Italinë e Jugut. Kurse në Lindje Ushtria e Kuqe përparonte... U thamë fshatarëve

të mos mbanin aty drithëra dhe kafshë, se ishte rrugë automobilistike dhe do të vinin gjermanët e nuk do t'u linin asgjë. U thamë të fshihnin të gjitha prodhimet bujqësore, se Italia kishte kapitulluar pa kushte. Rrëmujë kudo. Badolioja thoshte se lufta vazhdonte, po kundër kujt? Në familjen ku u strehuam atë mbrëmje, erdhën shumë fshatarë dhe një pronar i një mulliri të madh mielli. "Fshiheni bereqetin! Fshihini prodhimet, se gjermanët nuk lënë gjë. .. Presim me orë anglo-amerikanët! Ata do të na shpëtojnë!"

Hëngrëm e pimë verë dhe ikëm. Nata ishte e qetë, me hënë. Natë shtatori. Kudo aromë rrushi. Ecnim mespërmes vreshtave. Hanim rrush. Nuk flisnim. Kur pamë që në drejtimin tonë vinte një togë e zezë, si djajtë e "Per Gyntit" të Ibsenit. "Gjermanët! Po tani!?" Të kthehemshim prapa, do të na qëllonin. Vendosëm të ecnim të qetë, të qetë, në krahun e djathtë të rrugës që ndante më dysh vreshtat, që s'kishin të sosur. Ata afroheshin. Dhe ne me gjak të ngrirë prisnim të afroheshin edhe më. Kaluan nga e majta jonë. Ishin nja dhjetë, veshur njësoj, më dukeshin të fryrë, të rrumbullt. Kur dëgjojmë një zë: *"Professore! Professore! Sei vivo!"* U afruan. Folën për Ustikën. Ishin nga ata të Ustikës. Na thanë se i kishin shpënë në burgun e Gaetës. Andej kishin ikur dhe kishin plaçkitur shumë dyqane. Ishin ngarkuar me orë, me tesha, me bylyzykë... "Doni para? Para sa të doni! Doni tesha, doni nga një orë? Koha punon për ne! Ne jemi zotët e kohës! Rroftë kapitullimi! Rroftë anarkia! Rrofshin laxaronet! Poshtë kuesturinët dhe karabinierët, që na e morën të keqen, nuk dinë se ku të futen! Poshtë shteti i senjorëve! Bota është jona!" Ata flisnin si të dehur. Njërin nga ata e mbaja mend. Dhe vetë ai më tha: "Nuk ta harroj kurrë, jo! Ti më ke dhënë cigare e bukë dhe dhjetë lireta! Po mos u merr më me politikë, se do të mbarosh përsëri në Ustikë! Dhe ata që do të vijnë, do të kenë karabinierë

e kuesterinë e pranga. Ikë, dil kaçak. Vidh sa të sigurosh jetën, dhe shko e martohu. Kështu do të bëj unë tani. Do të shkoj në Sora dhe do të martohem..."

Njëri zgjati një pako me bankënota: "Merrini, se pa këto as Shën Pjetri s'të flet me gojë!" E falënderuam. Tjetri nxori një shishe me triplësek. E kishte hapur dhe na dha për të pirë. Pimë. "Dhe mos gaboni më t'i kundërviheni shtetit, se do të ktheheni në Ustikë. Vidhni si të tjerët dhe mos këndoni *"avanti popolo, a la riscossa, bandiera rossa triumfera"*, se amerikanët dhe anglezët që na vijnë plot me para dhe dollarë, nuk e duan bolshevizmin. Rroftë rrëmuja! Rroftë Alkapone, rroftë mafia!" U ndamë: ata në drejtim të kundërt, për në Sora e Subiako, ne për në Fiuxhi.

Vendosëm të ndaleshim pranë disa mullarëve. U dendëm duke ngrënë rrush dhe rrushi natën hahet me shije. Triplëseku kishte qenë pije e fortë, na ra në kokë të treve. Bozhoja nuk fliste fare, Alfredoja përsëriste: *"Povera Italia!"*, kurse unë mendoja: "E zeza Shqipëri! Çfarë po ndodh tani atje?"

U shtrimë në mullar dhe aty na zuri gjumi. Në agim kishte ardhur i zoti i vreshtave, na zgjoi dhe e kuptoi se vinim nga kampi i Frasketit. Na ftoi në konak të na bënte nga një kafe elbi "orzo". Ndoshta ishte kureshtar të dinte se cilët ishim ne. Po në ato ditë nuk ishim vetëm ne që endeshim kuturu: kishte me qindra e mijëra të tjerë që endeshin monopateve, larg udhëve automobilistike, nga kalonin makinat gjermane. Për ne fillonte një jetë e re: jeta e lirë!

Pyetje: - Domethënë nisi jeta e lirë, pa pranga, pa karabinierë, po ç'drejtim more bashkë me shokët e tu?

Përgjigje: - Aty nga njëmbëdhjetë-dymbëdhjetë shtatori i vitit 1943, kur kapitulloi pa kushte Italia fashiste, unë isha i lirë. Me dy shokë, Alfredon dhe Bozhon, ecnim të lirë. Shikonim turma njerëzish si refugjatë që

merrnin drejtime të kundërta: ca për në veri e ca për në jug. Ecnim monopateve, pastaj morëm rrugën automobilistike. Në një vilë, u ndalëm dhe kërkuam bukë. Doli një zonjë - dukej e pasur - dhe Alfredoja i tha se ishim ushtarë dezertorë dhe se ishim pa ngrënë. Kur Alfredoja fliste me atë grua, para vilës u ndal një veturë, nga e cila doli një burrë i gjatë dhe i thatë. Zonja thirri: *"O, signor marescialo, venite, venite!"* - dhe ai u afrua. Ndërkohë, nga një tjetër makinë dolën katër gjermanë. Dy prej tyre u futën në veturën e zotërisë dhe ndezën motorin. Zotëria vrapoi duke thirrur: *"Sono il marescíallo Graciani!*... - Jam mareshal Graciani! Ju lutem, dilni nga makina!" Kur u afrua në dritaren e veturës, një gjerman i këputi një grusht në fytyrë, mareshali ra dhe të dyja veturat u zhdukën. Alfredoja i tha: "Tani, zoti mareshal i Italisë, hip në gomar!" Kjo skenë e tronditi zonjën dhe të gjithë ata që kishin dalë nga vila e bukur dhe e madhe. Ata ishin romanë dhe kishin ardhur këtu për të qenë më të sigurt, se, siç dukej, këtej kishin dhe pasuri, siç kishte dhe Graciani në Fiuxhi, aty pranë. Dëgjoja bisedën e tyre:

- Si s'të vranë!

- Na mori në qafë Badolioja. Ai u shit tek anglo-amerikanët!

Kisha dëgjuar shumë për Gracianin, që e quanin mareshalin më të madh të Italisë, sidomos në luftërat kolonialiste në Afrikë. Thuhej se e kishin kapur beduinët dhe e kishin tredhur. Dhe tani, siç dukej, ishte i zemëruar me Badolion, se nuk e thirri edhe atë në qeverinë e re pas rënies së Musolinit.

Ne morëm nga e djathta dhe dolëm në një stacion treni të vogël, ku prisnin shumë njerëz. Pyetëm dhe na thanë se treni shkonte për në Romë. Hipëm edhe ne midis turmës në panik dhe udhëtuam për në Romë. Arritëm vonë. Ishte errur. Kur zbritëm nga treni, ç'të shihnim! Mijëra ushtarë italianë në brekë, pa këpucë, vinin vërdallë

dhe në çdo njëqind metra një gjerman me automatik në dorë, gati për zjarr. Tmerr! Dyert e stacionit të trenit ishin mbyllur dhe disa kalamaj që ishin përjashta hekurave dhe hidhnin copëra buke, kërcënoheshin nga gjermanët. Që të tre, pranë e pranë, për të mos humbur njëri-tjetrin, mezi lëviznim nga dendësia e ushtarëve e civilëve. U err! Njerëzit, nga paniku që shtohej orë e çast, nuk bënin zë. Një heshtje varri. Pështpëritje dhe dënesa grash e fëmijësh. "Ç'do të na bëjnë gjermanët?! Do të na vrasin të gjithë!" U dëgjua një fishkëllimë treni. Të gjithë vrapuan drejt tij. U dyndën brenda mijëra e mijëra duke shtyrë njëri-tjetrin. Dhe ne të tre u futëm në një vagon kafshësh. Lart, mbi çati të vagonëve, me mijëra ushtarë në brekë. Treni u vu në lëvizje. Ata që ishin lart, thoshin: "Për në veri, se ja Ylli Polar. Për në veri, për në veri..." Treni pas pak e shtoi shpejtësinë. Kishim dalë jashtë Romës. Disa këndonin këngë pornografike. Disa qanin. Treni vazhdonte të ecte dhe ne nuk dinim se ç'fat na priste. Ishim penduar që kishim rënë në grackë. Asgjë nuk merrej vesh, s'dihej ç'do të bëhej.

Aty nga mesnata, u dëgjuan vagonët të përplaseshin njëri me tjetrin. Diku, afër Grosetos, ishin prishur shinat dhe treni u ndal duke shkaktuar terror dhe plagosje. Pamë të dilnin nga treni të gjithë duke shtyrë njëri-tjetrin: nga dyert, nga dritaret, nga çatia. Nuk e harroj kurrë atë skenë, kur hodha sytë dhe pashë mijëra ushtarakë në brekë të bardha, si pata, të vraponin jashtë. Ata fluturonin të shkonin larg trenit, larg gjermanëve. Edhe ne fluturuam dhe u gjendëm jashtë trenit. Kur agoi, arritëm në një fshat. Pyetëm se ku ishim. Alfredoja tha se, po të ecnim gjithë ditën, në mbrëmje do të arrinim në Skarlino, afër Piombinos, ku ai kishte farefisin e tij. Duke ecur monopateve, duke ngrënë vetëm rrush, në mbrëmje arritëm në periferitë e Skarlinos. Alfredoja tha se aty kishte një vëlla, por ai ishte bërë fashist. I thamë të shkonim e

ta gjenim. Shtëpinë e gjeti. Ishte një vilë me një kat, pranë xhadesë, e rrethuar me mure dhe brenda plot me pemë. Vendosëm të flinim jashtë dhe të shkonim në mëngjes tek i vëllai i Alfredos. Ashtu bëmë. Fjetëm pranë disa mullarëve. Koha ishte e mirë. Na zuri gjumi dhe, kur u zgjuam, kishte gdhirë. Shkuam tek i vëllai i Alfredos, i cili nuk e njohu, se kishte shumë vjet pa e parë. Doli një e re simpatike. Alfredoja na tha se ishte e mbesa, e cila kishte mbaruar për fizkulturë, në Orvieto. Dukej se ishte sportiste. Alfredoja i foli në emër, por ajo u habit dhe qeshi duke ngritur supet. "Jam xhaxhai yt, Alfredoja", - i tha. Ajo e pushtoi dhe qau. Kurse vëllai i tij, që kishte dëgjuar, qëndroi serioz dhe tha: "Ç'kërkon këtu? Të na marrësh në qafë edhe ne? Të lutem, largohu sa më parë, se nuk dua të vuaj si ti. Mezi krijova familje dhe pak katandi." Vajza nisi të qante dhe t'i lutej atij që të mos sillej ashtu me xhaxhanë. Ne u larguam, pa pranuar dhe bukën që na nxori një grua, e cila nuk fliste fare, se, siç dukej, kishte frikë nga i shoqi. Rrugës Alfredoja na tregonte se si qysh në moshë të re të dy ziheshin: i madhi ishte me Musolinin, kurse Alfredoja ishte me komunistët. U habitëm edhe ne (unë e Bozhoja) se si një vëlla që ka aq shumë vjet pa parë vëllanë e tij (se Alfredoja emigroi në Francë qysh më 1924), që e sheh vëllanë në gjendje të mjerë, nuk e pranon si vëlla, ndërkohë që ato ditë në Itali, ngado që të veje, në çdo familje që të shkoje, do të gjeje një pritje të ngrohtë e vëllazërore, sidomos për ata që endeshin si ne, të uritur e të persekutuar.

Ecnim pas Alfredos, se i dinte mirë ato monopate. Ai, në çastet e para, nuk tha asgjë, po, pasi ishim larguar nga i vëllai, nisi ta shante shumë: "Si e ka katandisur fashizmi dhe karrierizmi. Po ashtu ka qenë ai. Dëshironte të rronte mirë, pa kokëçarje. Dhe thoshte atëherë: "Që të jem i qetë, duhet të jem me këdo që është në pushtet."" Kur arritëm në një kthesë, u ndalëm, se Alfredoja pa një

karrocë të vjetër. *"Per bacco!* Ende qenka korriera!" U afruam. Alfredoja e njohu karrocierin plak. I foli në emër. Ai e pa dhe bëri shenjë t'i tregonte se cili ishte, se nuk po e njihte. Kur Alfredoja i tha se cili ishte, plaku mjekër-bardhë, i shkurtër dhe i veshur si me uniformë postieri, zbriti nga karroca dhe e pushtoi fort Alfredon: "Biri im! Biri im! Si je, more bir? - dhe lotonte. Nuk e lëshonte. - Si, more, qenke gjallë! Mua më kishin thënë se të kishte vrarë Musolini! Po ti qenke gjallë!" Ai na mori në karrocën që shërbente si korrierë gjer lart në fshatin Skarlino, ku kishte lindur Alfredoja. Gjithë rrugës Alfredoja e pyeste për çdo familje, emër për emër dhe, kur arritëm lart, në fshat, karrocieri, pasi dorëzoi ç'kishte për të dorëzuar, erdhi me ne duke mbajtur nga dora Alfredon. Kur arritëm në një ndërtesë të vjetër, karrocieri thirri me zë të lartë: "Dil, o Maria, të shikosh se kush të ka ardhur!" Maria, një grua e trashë dhe e kaluar nga mosha, nuk kuptoi gjë, nuk e njohu vëllanë e saj Alfredo. Pastaj e njohu dhe iu hodh në qafë e përlotur, duke e puthur në faqe, në duar e në trup. Të dy qanin. Nuk ndaheshin. Hymë brenda, ku gjetëm dhe disa gra të tjera dhe një vajzë; e mbaj mend atë vajzë simpatike që qante me dënesa. Mbaj mend se në një këmbë, që nga gjuri e gjer poshtë kishte një vizë të zezë, sikur e kishte lyer me zift.

Aty Alfredoja mësoi se e shoqja, vajza dhe djali ishin në Papinjo, në një fshat të Ternit, se e shoqja e Alfredos, me të cilën u martua në Francë, ishte nga Papinoja. Ajo kishte shkuar te prindërit e saj.

Aty dëgjonim radion dhe mësonim se si ishte situata në frontin e Lindjes dhe në atë të Italisë së Jugut. Po vetë Italia ishte në një rrëmujë që kurrë s'e kishte njohur në gjithë historinë e saj. Ndenjëm aty disa ditë. Ramë në kontakt me shokë komunistë, sidomos me ata të Piombinos, që kishin tradita antifashiste. Na thanë se në Terni ishte më i favorshëm vendi për të krijuar çeta

partizane. U nisëm për në Terni. Monopateve dhe rrugëve automobilistike, rrëmujë: turma njerëzish të lodhur, të tmerruar, në drejtime të ndryshme, disa pa gjë, disa me plaçka në krahë. Herë me tren dhe herë me tram, arritëm në Terni e që andej me tram në Papinjo. E gjetëm familjen Çeki. E shoqja e Alfredos kishte shkuar te familja e motrës së saj. Ndenjëm aty dy ditë dhe, pasi erdhëm në kontakt me partinë, dolëm në një vend të veçuar, pranë Piedilukos. Atje takoheshim me shokët e fshatrave të tjera. Dhe vendosëm të krijonim njësitin partizan me emrin "Roka Rosa", se kështu quhej Papinjoja, pasi kishte shumë komunistë.

Pyetje: - Si filloi jeta partizane?

Përgjigje: - Aty, në Piediluko, një fshat pranë liqenit artificial nga derdhen kaskadat e Marmores, vinin shokë nga i gjithë rrethi i Ternit, po shumica ishin nga Papinjoja. Erdhi një shok i vjetër i partisë, Filiponi. Me shokët komunistë, pas disa mbledhjeve, u vendos që komandant i njësitit "Roka Rosa" të isha unë dhe komisar Filiponi. Puna e parë që nisëm, qe krijimi i komiteteve të çlirimit nacional në fshatra. Atëherë qeveria italiane ishte në Bari dhe ishte krijuar nga të gjitha partitë antifashiste: komuniste, socialiste, demokristiane, liberale, demokratike, social-demokratike, republikane, prandaj dhe komitetet e çlirimit nacional do të formoheshin nga të gjitha këto parti. Partitë më të dëgjuara ishin Partia Komuniste dhe ajo Socialiste, të tjerat ishin të papërfillshme. Shumica e atyre shokëve që na vinin si partizanë, ishin ushtarë që kishin dezertuar dhe prisnin nga çasti në çast fundin e luftës, domethënë ardhjen e anglo-amerikanëve, që priteshin me padurim. Pasi u bëmë më shumë se treqind veta, u spostuam në bregoret me pyje midis Polinos dhe Akuarorës. Aty krijuam bazat e para, me qendër te një bari i mirë që quhej Façio.

Vjeshta po vinte, të ftohtët po shtohej dhe anglo-

amerikanët nuk tundeshin nga vendi. Gjermanët zhvatin ç'të gjenin: Trena plot me mallra drejtoheshin drejt Breneros. Nuk linin asgjë: as kafshë, as drithëra, as prodhime industriale. Thoshin se në Milano ishte gjetur një depo me tetë milionë palë këpucë ushtarake, kurse ushtarët e gjorë italianë ishin zbathur.

Organizuam furnizimin e ushqimeve nga fshatrat, që mblidhnin me radhë bukë, kaçkavall, zhambon e të tjera dhe na i dërgonin përditë. Erdhën shumë sllovenë e kroatë, ish-të burgosur dhe ish-të internuar. U bëmë afro pesëqind veta. Armë gjetëm në depot e Ternit, kështu që të gjithë ishim të armatosur.

Ishte shumë vështirë në fillim të agjitonim drejtpërdrejt për revolucionin. U pranua të kishim të gjithë shallin e kuq në qafë, si garibaldinë. Ata që donin, mund të vinin dhe yllin e kuq në majë të bustinës.

Pasi bëmë organizimin, të ndarë në katër kompani dhe në çdo kompani një komandant e një komisar (ky duhej të ishte komunist), tani duhej të fillonim nga aksionet. Urdhri nga komanda e përgjithshme partizane ishte që të mos nisnim shpejt përpjekjet me gjermanët. Herën e parë bëmë disa aksione, si bie fjala në depon e federalit të Ternit, ku morëm shumë ushqime dhe veshmbathje. Pastaj një aksion në bagëtinë e princit Torlonia, që e kishte bazën afër Leonesas. Shkova edhe vetë me tridhjetë partizanë. U takova me përgjegjësin e bagëtisë, i cili na tha se më parë duhej të merreshim vesh me qehajanë e princit, që banonte në Leonesa. I dërgova një letër me një bari. Pas dy ditësh erdhi përgjigjja: "Merrni sa të doni, më mirë është t'i hanë ushtarët italianë, se gjermanët. Po me një kusht: do të lini një dëftesë të nënshkruar nga komandanti juaj dhe numrin e shelegëve që do të merrni." Vetë barinjtë na zgjodhën nja njëqind shelegë të majmë. Ne i vumë përpara, po kemi vuajtur shumë sa i shpumë në bazën tonë. Nuk ecnin, pastaj dhe koha ishte e keqe.

Arritëm në bazën tonë, te konakët e stanarit Façio, ku gjetëm Filiponin dhe një të deleguar të partisë që kishte ardhur nga veriu i Italisë.

Atij shoku i bëmë një relacion të punës sonë dhe nuk pati asnjë vërejtje ose kundërshtim. Parashtrova nevojën për t'u hedhur në aksion në përpjekje me ushtarët gjermanë. Ai e pranoi këtë mendim, vetëm se aksionet duheshin bërë larg fshatrave, në pyje dhe male, nga kalonin makinat me gjermanë...

Organizuam një aksion. Shkova vetë më parë për të parë vendin. Larg Poxhio Reatinos, në rrugën malore që shkonte për në Leonesa e në Market. U ktheva dhe bëra skicën e operacionit. Kërkova tridhjetë vullnetarë, përveç pesë malazezve, bashkë me Bozhon, që i mbaja kurdoherë pranë. Pas shumë hezitimeve dolën shokët vullnetarë. Atyre u bëra skicën e terrenit dhe vendet nga do të ecnim. Në të përpjetën e rrugës për në Market ishte një si përrua i thellë dhe rruga formonte gjysmë rrethi, mes pyjeve të dendura. Morëm tri armë automatike mitraloza të lehtë. I ndava në tri grupe, nga dhjetë veta; çdo grup kishte dhe një mitraloz të lehtë. Një grup do të rrinte në këndin e gjysmërrethit, poshtë, i cili, po të vinte ndonjë autokolonë gjermane, do ta linte të hynte. Dhe, ndërsa ne do të luftonim me të për ta asgjësuar, ai grup nuk do të lejonte më asnjë makinë gjermane të ngjitej, po të luftonte me të. Kështu do të vepronte dhe grupi në këndin e gjysmërrethit lart. Ne, që ishim në mes, do të ndizmin luftën...

U dëgjua zhurma e makinave. Gryka ushtonte nga uturima e tyre. Ngjiteshin. U dha urdhër "gati për zjarr!". Përpara ishte një veturë e zbuluar. Pranë shoferit, një femër gjermane oficere; pas, tre oficerë. I thashë Encos, mitralierit, që të qëllonte një batare të tërë, të njëzet fishekët mu në xhamat e veturës, me qëllim që plumbat t'i goditnin të gjithë. Vetura u afrua. "Zjarr, o Enco!" Encoja ngriti të prapmen, uli kokën, ngriti dhe tytën e mitra-

lozit dhe i zbrazi të njëzet fishekët në hava! Oshëtiu gryka. Gjermanët e veturës dhe dy gjermanë të kamionit që vinte pas, menjëherë u hodhën dhe zunë pozicion. Ne edhe me gurë mund t'i vrisnim, se kishim zënë pozicione të mira. I pari qëlloi Bozhoja dhe vrau një oficer që qëndronte më këmbë. Pas dhjetë minutash të pesë gjermanët e veturës dhe të dy gjermanët e kamionit ishin vrarë. Na u duk se njëri ishte hedhur poshtë dhe nuk dinim nëse ishte ende gjallë. Shkuam menjëherë në xhade. Të vrarëve u morëm dokumentet, armët, çizmet, kapotat dhe sahatët. I futëm në makinë, gati lakuriq dhe, pasi i vumë zjarrin dy makinave, i rrokullisëm në humnerë. Vendi u bë flakë. Premë dhe telat e telefonave dhe shpejtuam për te vendi ku kishim lënë takim pas operacionit, i cili na shkoi mirë, pa asnjë të plagosur.

Pas tri të shtënave me revole, të gjithë i lanë pozicionet dhe u drejtuan për te vendi i caktuar. Kapërcyem me shpejtësi thellësitë e përroit, hipëm lart, kapërcyem një bregore të pyllëzuar dhe arritëm te burimi. Aty gjetëm shumë nga shokët. Pas pak u mblodhëm të gjithë dhe nisëm të analizonim aksionin. E pyetëm mitralierin: "Pse ti, Enco, i zbraze të njëzet fishekët në hava?" Ky faj i rëndë Encos mund t'i kushtonte jetën. Po Encoja u ngrit dhe me lot në sy, duke na shikuar në fytyrë, tha: "Nuk vras kurrë femra! Ajo ishte femër! Nuk vras kurrë femra! Më dënoni, më dënoni!...", - dhe qante. Qe një mbledhje e çuditshme. Italianët e tjerë, siç vija re, ishin të gjithë dakord me Encon, pra që nuk duhej të shtinte kundër një femre. Fola unë dhe Bozhoja dhe thamë se ajo ishte gjermane, SS-e, kriminele dhe, sikur të mos ishim më të shpejtë se ata që ishin në makina dhe që dolën menjëherë duke na qëlluar, do të na kishin vrarë ata ne.

Encoja qante, italianët e tjerë e përkrahën dhe njëzëri kërkuan që ta falnim. E falëm. U kthyem në bazë dhe të nesërmen aeroplanët gjermanë bombardonin pyjet, dy

anëve të përroit ku ne kryem aksionin. Në hyrjet e rrugëve që ngjiteshin për në pyje kishin ngjitur disa tabela prej druri ku shkruhej gjermanisht: *"Kujdes, zonë me banditë!"*

Dimri erdhi i egër. Anglo-amerikanët nuk vinin. Mësuam se në një fshat, në veri, më tutje nga Leonesa, në Gravë ose Glavë, ishte një batalion italian, me një gjeneral dhe me shumë oficerë. Ai batalion nuk ishte shpërndarë dhe nuk u dorëzohej gjermanëve. Vendosëm të shkonim e të merreshim vesh për të bashkërenduar aksionet. Me Filiponin dhe me katër shokë, duke kapërcyer male, përmbi Polinon, arritëm në një grykë. Aty gjetëm rojat e batalionit. Na ndaluan dhe pyetën se kush ishim. U thamë se kërkonim të takoheshim me shtabin e batalionit. U dhamë dhe emrat tanë. Rojat telefonuan në shtab të tyre. (U habitëm. Paskëshin dhe lidhje telefonike!) Na lejuan të kalonim dhe njëri na shoqëroi gjer në hyrje të fshatit. Aty gjetëm pesë ushtarë italianë të lidhur me duar pas dhe të varur, për dënim. U habitëm. Na thanë se kishin pirë shumë dhe kishin sulmuar disa vajza të fshatit. Na shpunë në shtab. Hipëm lart. Gjetëm gjeneralin, një kolonel dhe një britanik. Na pritën mirë. Më duket se koloneli ishte socialisti De Martino. Foli Filiponi dhe tha se cili isha unë; tregoi dhe qëllimin e ardhjes sonë. Ata na panë me shall të kuq dhe me yll të kuq në majën e kasketës. Pyetjet e tyre të para, sidomos të gjeneralit dhe të një oficeri tjetër, qenë: "Ç'janë partizanët? Pse vënë yll të kuq? Mos jeni bolshevikë? Kush ju drejton? Mos keni misione sovjetike ose jugosllave?" - e të tjera. Ne nuk flisnim. Përgjigjej kolonel De Martinoja, i cili ishte më objektiv dhe mbante anën tonë. Nga pyetjet e shumta dhe provokuese që bënin, më në fund De Martinoja u nxeh dhe tha: "Ç'janë, ç'janë?! Edhe putana të jenë, mjafton që luftojnë kundër gjermanëve! Doni apo nuk doni të bashkërendojmë aksionet kundër gjerma-

ëve?" Anglezi, që nuk fliste fare, na bëri këtë pyetje: "Sa eni dhe nga kush i merrni udhëzimet?" Ne i thamë se udhë-zimet i merrnim nga komanda e përgjithshme partiane, e cila ishte lidhur me qeverinë e Barit." Po kush ju mban?" - pyeti anglezi. "Na mban populli, - tha Filiponi, populli për të cilin luftojmë."

U shtrua dreka. Ç'drekë! Si në Grand Hotel të Romës. Me të gjitha të mirat: antipasta, pije, gjellë të shumta. U habitëm. Pastaj morëm vesh se ata merrnin shumë sterlina dhe blinin ç'të donin. Ramë dakord në disa pika, njëra prej të cilave ishte edhe kjo: Pas tri ditësh duheshin prerë telat e telefonave në gjithë atë zonë: Terni, Rieti, Peruxhia, Spoleto. Ne morëm përsipër zonat më të gjata dhe më të rrezikshme. U kthyem në bazën tonë, po gjatë kthimit na ndodhi diçka e papritur: Kur po zbritnim nga El Sardoja, pranë Leonesas, për në monopatet mbi Polino, vendi ishte shumë i zbuluar, pa asnjë pemë, dhe një togë gjermane na shikonte, nja tetëqind metra larg. Të ktheheshim, ata do të na vrisnin shumë lehtë. Duke ecur, fola: "Pesë metra larg njëri-tjetrit. Pushkët mos i lëvizni nga supet! Bëni sikur nuk dini gjë! Po qëlluan, edhe ne do t'i qëllojmë." Ecnim pesë metra larg njëri-tjetrit. Përpara unë. U afruam nja dyqind metra larg tyre. Ne morëm monopatin nga e majta dhe jo atë që shkonte për në Polino. Kalova unë, Filiponi dhe pesë të tjerët dhe u futëm prapa bregores, nga nuk dukeshin më gjermanët. Pse nuk qëlluan gjermanët? Ata nuk qëllonin pa i ngacmuar. Italia ishte në rrëmujë. Malet qenë plot me ushtarë dhe ish-të burgosur a të internuar të çdo kombësie.

Organizuam prerjen e telave në zonat e gjera që morëm përsipër, por morëm vesh nga disa ushtarë që na erdhën, se batalioni italian ishte shpartalluar pa shtënë asnjë pushkë. Gjermanët kishin qëlluar disa predha me artileri nga xhadeja dhe menjëherë të gjithë ushtarët kishin ikur në drejtime të ndryshme. Nuk e dimë ç'na u

bënë zotërinjtë oficerë që hanin e pinin sikur të ishin në dasmë. Na treguan shumë ngjarje të shëmtuara, që nuk i duronin dot ushtarët. Prandaj gjetën rastin: me dy-tri gjyle që hodhën gjermanët me artileri, të gjithë ua mbathën këmbëve në drejtime të ndryshme.

Këtë ne e kishim parashikuar.

Na erdhi nga qendra e Umbrias një listë me emra njerëzish të rrezikshëm, bashkëpunëtorë të gjermanëve, që duheshin eliminuar. Vura re se midis këtyre emrave ishin dhe dy shqiptarë! Q. dhe B. dy emra të njohur prej meje. Vendosëm kështu: para se të veprohej, duhej vetë ne të bindeshim që këta ishin spiunë.

Filluam nga Polinoja, te avokat Orsini, i cili shoqërohej nga një ushtar gjerman që e sillte në Polino nga Terni. I shkuam natën. U hap dera dhe doli zonja e tij. U tremb, se na pa me mjekër dhe të armatosur. E qetësuam. Brenda u futëm tre veta. Pesë të tjerë ndenjën përjashta. Folëm me avokatin, i thamë: "Nëse ti nuk je në gjendje të bësh ndonjë të mirë për atdheun tënd, Italinë, mos e dëmto, se vdekja të pret!" I thamë se ishte i dënuar me vdekje. Ai na premtoi se nuk do të përzihej më. E lamë dhe morëm drejtime të tjera. Shqiptarin B. e gjeta dhe e lajmërova. Ai më njihte. Kishte mbaruar për agronom. Pasi nuk mund të kthehej në Shqipëri, nxirrte bukën duke punuar në treg të zi me gjermanët. I thashë të vërtetën. Ai m'u betua se kurrë nuk kishte menduar të bashkëpunonte me gjermanët. Më dha fjalën se as që do t'u afrohej më atyre. Më pyeti nëse kishim nevojë për ndihma në ushqime. U ndamë. U qetësova.

Kur takova Q. të cilin e njihja, ai u habit që më pa atje. E kisha njohur në Tiranë dhe, ç'është e vërteta, pasi ai ishte shumë i pasur, çoku na ndihmonte duke na bërë pajtime për revistën "ABC" e të tjera, sidomos kishte miqësi me Branko Merxhanin. Më tha se ishte larguar nga Shqipëria se e kishin përzier me italianët

ıe kërkonin ta vrisnin. M'u betua: "As që kam folur ırrë me ndonjë gjerman. Këtu është një hotel luksoz, ı ha e pi, gjersa të mbarojë lufta, para kam boll. A ke ti evojë për ndonjë ndihmë?" Ndenja me të disa orë, pastaj porosita që të mos rrinte më atje dhe në asnjë mënyrë : mos përzihej me gjermanët, se do ta vrisnin. Më lënderoi.

Pyetje: - Si shkonte puna e organizimit? Shtoheshin nokët apo pakësoheshin?

Përgjigje: - Siç e thashë, shumica e atyre që u bashuan me ne, kujtuan se për pak ditë do të vinin anglomerikanët, prandaj mirë ishte që të siguronin kokën uke u bashkuar me ne. Por anglo-amerikanët nuk po inin. Dimri po bëhej shumë më i ashpër në ato male. ıeroplanët amerikanë *fortece volanti* kalonin dhe lëshonin ıomba kudo, sidomos në Streto di Spoleto, në Terni e në ıytete të tjera. Nuk lanë vend pa shkatërruar dhe negjithatë asnjë mallkim nga populli, që i priste si ıhpëtimtarë.

Pak nga pak shumë veta iknin dhe nuk ktheheshin në. Menduam disa herë t'i ndanim në grupe nëpër fshatra dhe në rast nevoje t'i thërrisnim, por ata iknin në masë, sa mbetëm vetëm ne ballkanasit dhe pak komunistë talianë.

Një natë na iku dhe një kompani me sllovenë. Ata kishin një profesor si kryetar dhe ne atë profesor e kishim bërë si komandant të asaj kompanie. I armatosëm dhe i vendosëm në një sektor pranë Akuarores, por ata ikën drejt veriut pa na lajmëruar fare. Ai profesor ishte antiserb, antimalazias e antisovjetik, një katolik fanatik. Nuk më kujtohet emri i tij. Ata kishin qenë në burgun e Spoletos.

Një fshatar nga Poxhio Reatinoja erdhi e na tha se një oficer gjerman kërkonte të bashkohej me ne. Kishte marrë me vete një tank dhe municione. Shkuam natën

në fshat, na doli e zonja e shtëpisë me një karbit në dorë (meqë e solli rasti, dua të them se në Papinjo ishte miniera e karbitit). Na ftoi brenda, na bëri nga një "orzo" kafe elbi dhe na tha se gjermani flinte në dhomën e sipërme. Tankun e kishin lënë në oborr, mbuluar me shkarpa. Hipëm lart dhe një shok sllloven, që e dinte mirë gjermanishten, i tha të ngrihej. Kur dëgjoi, oficeri brofi më këmbë me buzë të zbardhura nga frika, se kujtoi mos ishim të Gestapos. Pasi i thamë se kush ishim, ai u ul dhe zuri kokën me të dyja duart. Duke biseduar, na tha se atij i ishin vrarë prindërit nga bombardimet, i ishin vrarë dhe dy vëllezërit në Frontin e Lindjes dhe kërkonte të mbijetonte duke u bashkuar me partizanët italianë, se Fyhreri kishte marrë fund. Na dorëzoi dy revole, një automatik. Dhe ai, me katër shokë dhe me sllovenin që dinte gjermanisht, u nisën me tank për në zonën e Leonesës, ku vepronte një tjetër njësit partizanësh italianë. Dorëzuan atje tankun dhe togerin gjerman. Morëm vesh se në përpjekje me gjermanët togeri kishte luftuar me ashpërsi kundër tyre. Nuk e di nëse jetoi dhe nëse u kthye gjallë në Berlin, se nga Berlini ishte.

Edhe kompania jonë dalëngadalë po shpërbëhej. Një dëshpërim i madh më mbërtheu. Çfarë po ndodhte kështu? E vërteta ishte se unë isha i vetëm si shqiptar me ata njerëz në dhe të huaj. Ishte mesi i dhjetorit dhe ne nuk dinim ç'të bënim. Filiponi kishte shkuar në fshatin e vet. Vendosëm të iknim për në jug, të hidheshim në Italinë e çliruar nga Aleatët. Morëm drejt Kampo Basos, duke ndjekur luginën Reatino. Armët i lamë - ato që kishim rezervë - te një bari besnik. Duke ecur nga baza në bazë, mes malesh me dëborë, arritëm në zonën e Frozinones. Pasi ishim afër kampit të Frasketit, atje ku kisha qenë dhe nga isha larguar, qeshë kureshtar të dija nëse kishte ende atje nga ata që lashë. Kur ishim duke iu afruar kampit, nën Fumone, një batalion gjerman bënte stërvitje dhe po vinte drejt nesh. Kujtuam se

kërkonin të na zinin, por ata bënin manovra. Zbritëm në kamp. Aty ishin ende shumë vajza dhe Arsoja. Fola me Arson dhe ai më tha se në Romë kishte shumë shokë. U mendova dhe vendosa të ikja për në Romë. Aty për fat gjeta shqiptarë: Stefo Grabockën, Ibrahim Shytin, Mina Uçin e të tjerë. Ishte një takim që më ngrohu zemrën. Ishin të tërë miq të mi të dashur. Biseduam gjatë për gjendjen në Shqipëri. Ishte i pari informacion i saktë që merrja nga Shqipëria.

Qendra më dërgoi edhe një herë aty ku kisha qenë, në Terni. Shokët jugosllavë më dhanë këtë porosi (më duket se ishte avokat Vukoviçi), që jugosllavët kudo ku ishin, duhej të bënin ç'ishte e mundur të ktheheshin në Jugosllavi. Me pesë malazeztë, u nisa përsëri andej nga kisha ardhur. Shkova te baza ku kishim qenë, te stani i atij bariu të mirë. Me mua kishte ardhur dhe një shqiptar: Shemso Kasemi nga Turani i Tepelenës, oficer aviacioni. Andej u hodhëm afër Leonesës. Dimri ishte shumë i egër.

Më erdhi një urdhër: të shkoja me pesë shokë në Popi e të merrja nja gjashtëdhjetë grekë të internuar, që kishin mbetur atje. Nuk kishin ikur dhe frika ishte se mos i merrnin gjermanët e i shpinin në kampet e shfarosjes në Gjermani. U nisëm për në Popi. Kudo rrëmujë. Nuk njihte qeni të zotin. Pasiguri kudo. Gjermanët nuk preknin njeri pa i ngacmuar. Ne, si udhëtarë të thjeshtë, udhëtuam herë me tram e herë me tren, gjersa arritëm në Popi më 31 dhjetor të vitit 1943. Porosia ishte kjo: do të veja në Popi, do të kërkoja gjeneral Zanasin, do t'i thosha se isha numri gjashtë dhe do të përgatitja marrjen e gjashtëdhjetë grekëve, që ishin oficerë të Luftës Italo-greke.

Para se të nisesha nga Roma, fola me Stefo Grabockën dhe Mina Uçin, që po ktheheshin për në Shqipëri. U thashë se nuk mund të kthehesha, se isha ngarkuar me një mision. Kur ua thashë, ata më këshilluan të shkoja

e të takoja Eqrem Çabejin, i cili banonte në pensionin "Kalifornia" bashkë me Selaudin Toton. Ishin që të dy miq të mi, shumë të kulturuar e patriotë të ndershëm. Shkova dhe i thashë të mundohej se mos më siguronte një shkresë nga ambasada gjermane në Romë, për të shkuar e për të mbledhur shqiptarët e burgosur dhe të internuar, siç u kishte gjetur dhe dhënë edhe Stefos e Minait. Ai shkoi në ambasadën gjermane dhe arriti të më siguronte një shkresë ku thuhej: *"Petro Marko është i autorizuar nga ambasada gjermane e Romës të udhëtojë nëpër Itali për të mbledhur të burgosurit dhe të internuarit shqiptarë, që t'i sjellë në Romë, se këndej ata do të riatdhesohen. Autoritetet ushtarake të Rajhut janë të lutura të mos e pengojnë për të kryer misionin e tij."*

Me këtë ndihmë që na dha Çabeji, kemi shpëtuar edhe dhjetra malazezë dhe grekë nga gjermanët, duke deklaruar se ishin shqiptarë.

Pra, arritëm në Popi pasdreken e 31 dhjetorit. Unë pyeta se ku ishte vendi i grekëve të internuar. Poshtë ishte një si treg i vogël me disa dyqane. Aty ishte dhe stacioni i tramit. Më treguan vendin: lart, në një kuvend, para hyrjes së fshatit, nga e majta. Të gjithë së bashku hipëm lart dhe aty shokët u ndalën, se pamë disa civilë që ishin mbështetur në një mur dhe flisnin greqisht. U afrova dhe pyeta se ku ishte gjeneral Zanasi. Ata u habitën dhe më pyetën se kush isha. U thashë se isha një nip i tij dhe vija nga Roma. Shkuan dhe pas pak u kthyen me një burrë plak që i dridheshin duart.

Më shikonte i habitur. Kur e përqafova, e pyeta si ishte me shëndet dhe fare me ngadalë i thashë: "Jam numri gjashtë!" - Më dëgjoi. Më pa mirë, më hodhi krahun dhe u larguam pakëz nga të tjerët. I thashë se në orën gjashtë do të vija me disa shokë që t'i merrja, prandaj e porosita: "Mblidhni gjithë dokumentet e të gjithëve në një valixhe dhe mbajini ju. Mos merrni shumë plaçka

ıe vete, se do të ecim ca më këmbë. Në rast se na zënë jermanët, ju të gjithë do të thoni se jeni shqiptarë nga)ropulli." Dhe i shpjegova arsyet. Pasi ramë dakord për ë gjitha, u ndamë. Ai me të tjerët u fut në kuvendin e /jetër, ku ishte vendi i internimit të këtyre grekëve, dhe ınë zbrita më poshtë, ku më prisnin shokët e mi.

E bëmë kështu planin: dy shokët sllovenë do të visheshin me petka gjermane (që i kishim në valixhe). Shemsiu do të hiqej si oficer fashist dhe do të kërkonin të tërhiqnin grekët. Kur shkoi ora pesë e gjysmë, ishte errur mirë. Hipëm lart. Ora ishte gjashtë pa dhjetë. S'po e gjeja vendin ku ishte kuvendi dhe dera e madhe e hyrjes. Shikoja andej-këndej, po nuk po e njihja vendin. Kur dëgjoj një këngë që këndonte një vashë e re - ndoshta nga frika - që po vinte nga rruga e fshatit. Rruga ishte me pemë të zhveshura. Nga e majta, mure të larta. Vajza u afrua. E ndalova dhe nisa t'i thosha fjalë dashurie nga më fantastiket, si: "Tani zbrita nga qielli i dashurisë për ty! Se ja, po vjen Viti i Ri. Dhe Viti i Ri do të jetë viti ynë, i lumturisë sonë. Do të të shpie në Romë e në Napoli, në Kapri e në Sorento dhe..."

Ajo më tha: "Vemi andej, se këtu na dëgjon padre Antonioja". E pyeta se ku ishte dera për të hyrë në kuvend dhe ajo ma tregoi: "Ja, aty". Unë e lashë duke i thënë: "Do të shihemi". Dhe ajo: "Pse ikën, o i lig?! Pse më le kështu?!"

Fishkëlleva vargun e parë të "Pararojës" dhe shokët erdhën. U futën brenda. Disa ndenjëm jashtë. Për pak minuta dolën varg e varg, njëshkolonë, gjithë grekët. Zbritëm shpejt poshtë dhe për fat për pak minuta erdhi trami nga Arecoja. Hipëm të gjithë. Trami ishte plot. Njerëzit udhëtonin. Kushedi se ku do ta kalonin natën e Vitit të Ri. Në Areco u ndalëm. Duhej të merrnim një tren tjetër. Sllovenët ishin veshur përsëri me teshat civile. Rrëmujë kudo. Njerëz që pinin, që ziheshin, që bërtisnin.

Hipëm në trenin drejt jugut. Po në Kiuzi treni u ndal, se dëbora e madhe e kishte bllokuar rrugën hekurudhore. Dolëm. Gjermanët kremtonin Vitin e Ri 1944, kishin stolisur lokalet aty pranë stacionit me flamuj dhe banderola. Këndonin dhe kërcenin! Pa asnjë femër. Po ne ç'të bënim? Morëm drejtimin nga e majta. Ecnim njëshkolonë. Kapërcyem një bregore plot me dëborë të trashë. Ecnim drejt jugut, ku të na shpinin këmbët. Duhej të largoheshim sa më shumë nga ajo zonë. Shumë grekë të kaluar nga mosha mezi ecnin, sidomos Zanasi dhe njëfarë Kalamidhasi, ish-shefi i hotofillaqisë së Selanikut. Agoi. Zbritëm në një lëndinë, pamë tym dhe një grumbull shtëpish si kështjellë. U drejtova drejt një dere të madhe të mbyllur. I rashë fort. Doli një grua. U tremb. E pyeta nëse kishte burrë aty, dhe i thashë të mos frikësohej nga ne, se ishim njerëz të mirë. Erdhi dhe një burrë i trashë, tip fermeri, i fuqishëm dhe me tipare burrërore. I thashë se ne ishim nja gjashtëdhjetë e shtatë ish-robër lufte shqiptarë, para kishim dhe kërkonim ndonjë vend ku të pushonim dhe të futnim ndonjë gjë në gojë. Ai na ftoi të gjithëve brenda. Dua të shënoj se, kur u nisa nga Roma, më dhanë dhe 100 sterlina për shpenzime ose për të korruptuar agjentë. Na futi në një hambar të madh, ku ishin varur zhambone, kaçkavall, lëkurë, hudhra, qepë. Kudo voza, damixhana, dhe të ndara me drithëra e prodhime të tjera. Na tha të uleshim. Pas pak disa femra na sollën nga një tas me kafe elbi. Dhe i zoti i asaj ferme na fliste për katastrofën e madhe që e kishte gjetur Italinë. I thamë se kishte fat që ishte larg rrugëve kryesore, se gjermanët nuk do t'i linin asgjë, të gjitha do t'ia merrnin. I thamë t'i fshihte larg prodhimet, se kushedi mund të qëllonte që të vinin edhe këtu gjermanët. Gratë bënë dy kazanë me taliateli, kishin therur dhe disa gjela deti e i kishin bërë jahni dhe na shtruan për të ngrënë. U shqepëm së ngrëni

taliateli me jahni gjeldeti dhe me kaçkavall e verë sa të donim; pastaj mollë dhe arra me bollëk. U dendëm së ngrëni. E pyeta se sa duhej të paguanim, dhe nxora nga xhepi nja dhjetë sterlina. Ai i pa dhe u zemërua: "Kurrë, nuk pranoj asnjë qindarkë! E kam për nder të vë në vend nderin e Italisë, se nuk është Italia e popullit ajo që ju dënoi dhe ju internoi, por ai derr Musolini me bandën e tij të zezë që na shkatërroi." E falënderuam dhe u larguam; ecëm më këmbë gjer pasdreke, sa arritëm në një fshat ku kishte tram për në Terni. Trami ndalej në shumë vende dhe në Terni arritëm natën vonë. Zbritëm. Ku të shkonim? Qyteti ishte shkatërruar nga bombardimet e aeroplanëve amerikanë. I mbaj mend ato bombardime. Asnjë lokal, asnjë dritë. Pyetëm disa burra dhe na thanë se s'kishte asgjë, as edhe njerëz nuk kishte qyteti. Ku të shkonim me ata burra të lodhur?! Pyeta se ku ishin gjermanët, dhe na thanë se qenë në ndërtesat e Gil-it (Gioventu italiana del Littorio - si ndërtesa e Universitetit tonë në Tiranë, e cila ishte ndërtuar për Gil-in). Mendova se, po të qëndronim ashtu, jashtë, do të na zinin gjermanët. Më mirë ishte t'u kërkonim ndihmë atyre, t'u tregonim shkresën që kisha nga ambasada e tyre në Romë. Kështu veprova. Mora Shemsiun me vete dhe u drejtuam për në ndërtesat e mëdha të Gil-it, që nuk ishin prekur nga bombardimet dhe ku ishte garnizoni e komanda gjermane. I thamë rojës se donim të flisnim me komandantin. Erdhi një nënoficer, na mori dhe na shpuri në zyrat e komandantit, një burrë i thatë, me syze . Major. E nderuam: unë duke ulur kokën, kurse Shemsiu allahitleriançe. U ngrit dhe na pyeti se ç'gjuhë dinim. I thashë se dija frëngjisht, dhe ai me një frëngjishte të keqe i tha Shemsiut, që nderoi allahitleriançe: "Ti... mut shqiptar! Dje thoshe hail Zogu, pastaj hail Musolini! Sot hail Hitleri dhe nesër hail Stalini! Mut shqiptar! Kurse ti, - m'u drejtua mua, - *bon albanais, bon albanais.*" Na pyeti se ç'kërkonim. I thashë se ishim 67 shqiptarë ish-

të dënuar nga Musolini, dhe tani donim të venim në Romë e që andej në Shqipëri. I tregova dhe shkresën. E lexoi. Tundi kokën dhe dha urdhër të na sistemonin mirë. Na shpunë në palestrën e madhe, ku kishte dhe disa gjermanë; disa flinin, disa shkruanin letra, shtruar në kashtë. Na dhanë nga një batanije, na dhanë edhe për të ngrënë. U shtruam edhe ne. Dëgjova Kallamidhan (shefin e policisë së Selanikut) t'u thoshte grekëve të tjerë: "Na tradhtoi ky shqiptar, na dorëzoi te kasapi!" Dëgjova dhe Zanasin t'i përgjigjej: "Kurrë nuk tradhton ky, se e para është shqiptar, dhe e dyta është partizan..."

Në mëngjes kërkuam ndonjë mjet dhe majori na dha një kamion të madh, ku u ngjeshëm të gjithë brenda si sardele. U nisëm dhe pasdreke arritëm në Romë. Kamioni u ndal në Piaca Fiume, aty ku kërkova unë. Dolëm të dërrmuar. Njëri pas tjetrit arritëm në Via Po, te peshkopi, ku kisha marrë urdhër t'i dorëzoja grekët. Peshkopi na ftoi të gjithë brenda. (Ishte koha kur Vatikani bashkëpunonte shumë për të fshehur dhe për të shpëtuar me mijëra robër lufte dhe të persekutuar nga fashizmi.) Atë natë u ndamë të gjithë nëpër baza. Unë me shokët e mi shkuam në Via Kolina, ku ishte Vukoviçi dhe Arsoja. Aty erdhi dhe Ingrao. U raportova se misioni u plotësua: të gjithë grekët u dorëzuan në destinacion.

Të nesërmen, kur dola për të takuar ndonjë shqiptar, më foli një prift katolik. Kishte qenë edhe ai në Via Po, atje ku natën e kaluar vajta me grekët. Më pyeti se nga isha. "Jam polak", - i thashë. Më pyeti se ku banoja. Meqë isha pranë ndërtesës nr. 5, ku banoja, ia tregova pa të keq. Më dha dy paketa me cigare amerikane dhe më pyeti se ku banonin të tjerët, që t'u shpinte edhe atyre ndonjë gjë. Të them të drejtën, dyshova. I thashë se nuk dija gjë se ku banonin ata. Më shoqëroi dhe më tha që të vizitonim Santa Maria Maxhoren. Pranova. Shkuam në kishën e vjetër. Ai e vuri re që unë nuk isha

katolik, ndaj më tha: "Çudi, se polakët janë shumë fanatikë. Mos je çifut?" Bëra sikur nuk e dëgjova. U ndava nga ai. Pasdreke kisha takim me shokët e partisë. Ata erdhën në dhomën time vonë. Ishte Vukoviçi, Kolomboja (një komunist), Pertini dhe një italian që, siç dukej, do të ishte ndonjë oficer madhor. Puna ishte që, para se të nisesha përsëri për në Umbria, të bisedonim bashkë për disa çështje organizative lidhur me luftën në Romë, sidomos për hedhjen në erë të urës së Valetrit. Biseduam gjer vonë. Bënte ftohtë dhe unë isha pak i sëmurë. Ata ikën dhe, sapo u shtriva në shtrat, u shqye dera dhe hynë brenda pesë SS, të tërbuar, me automatikun gati për zjarr. Mbaj mend që më kapi një i fuqishëm nga flokët dhe më hoqi zvarrë duke më bërtitur me ironi: "Her kapitan!" (Kapitan më thoshin shokët edhe në Umbria, edhe në Romë.) Të tjerët nuk lanë gjë pa lëvizur në dhomë, edhe qilimin e ngritën, por nuk gjetën asgjë. Më thanë të vishesha shpejt. U vesha. Më lidhën duart pas, dy veta më kapën nga krahët dhe zbritëm shkallëve.

Pashë shërbyeset të lotonin dhe të dridheshin; edhe i zoti i pensionit lotoi. Kur zbrita poshtë, para se të më futnin në makinë, më lidhën sytë. Në ato pak minuta kujtova gjithë jetën time. Mbarova thashë, dhe mendja më shkonte te shokët e tjerë, të cilët para pak minutash u larguan nga dhoma ime. "Do t'i kenë zënë të gjithë", - mendova. Makina ecte dhe unë një gjë kërkoja: të më vrisnin shpejt e të mos më detyronin të flisja për mbledhjen e fundit. Gjermanët ndryshonin shumë nga italianët: ishin më të shpejtë e më të saktë në procedurën e dënimeve. Pas pak makina u ndal. "Patjetër te lumi, do të më vrasin dhe do të më hedhin në Tevere!" - mendoja dhe mbaja vesh për të dëgjuar fëshfërimën e Teveres, po dy njerëz më morën për krahu dhe më zvarritën gjersa më shpunë në një vend ku më hoqën shiritin nga sytë. Një sallë përrallore! Me kolltukë dhe me mobilie luksoze,

sallë princore m'u duk! Dhe shumë oficerë gjermanë që hynin e dilnin. Më çuan drejt një tryeze në fund, ku rrinin gjenerali dhe disa oficerë të tjerë. Gjenerali u ngrit më këmbë dhe tha: "Brenda dy minutash mendohu mirë dhe na thuaj se kur ke rënë me parashutë, ku është aparati dhënës dhe ku janë shokët. Të na tregosh nëse njeh gjermanë këtu, të fshehur si dezertorë. Dhe me emra. Dy minuta," - dhe shikonte orën. Më fliste përkthyesi, një oficer i gjatë, simpatik, më duket toger ishte. I thashë: "S'ka nevojë të mendoj dy minuta, unë nuk kam rënë me parashutë dhe nuk di as aparate dhe as shokë." Togeri ia përktheu! Gjenerali u ngrit dhe bëri një shenjë gjithë nervozizëm. Dikush më mbërtheu nga qafa. Fola: *"Es que vous parles français?"* Ai më pa dhe m'u përgjigj: "Ju polakët jeni të ndyrë!" I thashë frëngjisht se nuk isha polak, po shqiptar! Atëherë vetëtimthi më doli para syve figura e priftit që m'u ngjit e më pyeti se ku ishin shokët e tjerë. Prandaj u gëzova shumë dhe mora guxim e i thashë gjeneralit: "Luftë është, tani vdes unë, nesër ju. Sa për gjermanë, unë njoh, madje dhe me emra." Ai u ngrit më këmbë, i gëzuar më buzëqeshi dhe më tha: "Cilët janë?" Unë iu përgjigja: "Njoh Gëten dhe Shilerin!" Atij i ndryshoi menjëherë shprehja e fytyrës. Më tha: "Po ti ç'je?" "Jam një poet shqiptar. Po, që të bindeni se unë jam shqiptar dhe informatori juaj ju ka mashtruar, ju lutem i telefononi ministrit tonë Ernest Koliqi, që më njeh, që e di se kush jam e pastaj më vrisni." Gjenerali depërtonte në mendimet e mia duke më vështruar drejt e në sy. Unë rrija i qetë dhe i lumtur, se nuk i paskëshin zënë të tjerët. Ishte prifti që më kishte spiunuar si polak... Togeri që përkthente, quhej tenente Kok.

Gjenerali i foli gjermanisht togerit Kok dhe ky mori në dorë receptorin e telefonit. Unë e dija përmendsh numrin e telefonit të Koliqit, se më parë kisha shkuar

disa herë në zyrat e tij dhe sekretari, njëfarë Shestani, më kishte dhënë shumë pasaporta për malazeztë e për grekët, shokët tanë, ish-të dënuar. (Koliqi më kishte pritur përzemërsisht dhe më kishte uruar që të shpëtoja e të shkruaja vjersha, pasi ai e dinte, që kur e kisha profesor në Ujë të Ftohtë, se bëja vargje). Ia thashë numrin togerit, i cili e mori menjëherë. Unë u shqetësova, se Koliqi, duke dëgjuar zërin e Gestapos, ndoshta do t'u thoshte se cili isha unë: luftëtar në Spanjë e të tjera.

Togeri Kok, që ishte tmerri i Romës (këtë e mora vesh më vonë), pas pak nisi bisedën:

- Na falni për shqetësimin, kemi këtu një... që pretendon se ju njeh.

- .... (Fliste Koliqi.)

- Quhet Petro Marko...

- ... (Fliste Koliqi.)

M'u drejtua mua:

- Ku e keni njohur dhe çfarë ka botuar Koliqi? - Unë i flisja dhe ai përsëriste në telefon: - Në Vlorë, e kishit nxënës, keni botuar "Hija e maleve", "Gjurmët e stinëve"... Ju ka kushtuar dhe një vjershë në "Leka"...

- ... (Fliste Koliqi.)

- Ju falemi nderit shumë e na falni për shqetësimin në këtë orë! - tha togeri Kok... Pastaj foli me gjeneralin, gjermanisht.

Ai bëri tri shenja. Më vështroi në sy dhe tha shkurt:

- Falëndero Gëten dhe Shilerin.

Më morën dhe që andej më shpunë në burgun e madh "Rexhina Çeli", në një birucë me tetë të tjerë. Aty ishte dhe një jugosllav e një grek.

Pas ca ditësh erdhi në burg për takim sekretari i Koliqit. Më tha të rrija i qetë, se do të kujdesej Koliqi. E vërteta është që Koliqi më shpëtoi jetën, se atje ku më shpunë mua: Pensione Xhakarini, rruga "Sicilia", 10, ishte qendër e Gestapos dhe që aty asnjë nuk kishte

dalë i gjallë. Edhe nëse kishte dalë i gjallë ndonjë, kishte dalë invalid përjetë. Këto i mësova në birucë, nga shokët me të cilët flisja, që u thashë se ç'më kishte ndodhur.

Aty mësova se Pensione Xhakarini ditën përdorej si klub i klasit të parë, ku shkonin familje aristokrate dhe pinin ose kërcenin, kurse pas orës 22 kthehej në zyra të Gestapos si në Via Taso. Aty mësova se togeri Kok ishte tmerri i antifashistëve dhe i patriotëve, agjent besnik i Hitlerit, kriminel i regjur. Pra, Koliqi më shpëtoi jetën dhe u interesua për mua duke më dërguar sekretarin e tij.

Pas pak ditësh erdhi për t'u takuar me mua peshkopi i Leros (unit). Më takoi dhe me një zë prej kallogjeri më thoshte: "Të na falësh, o bir, se ai nuk ishte prift, po djalli vetë, ai ishte djalli vetë". Më tha se e kishte dërguar vetë peshkopi i Via Posë të më pyeste se ç'dëshiroja, ç'ndihma donim dhe ta dinim se ai i mallkuar nuk ishte prift, po djall i veshur tani vonë prift nga gjermanët. Siç mora vesh më vonë, atë dhe togerin Kok i vranë partizanët italianë.

Pyetje: - Ç'mund të na tregosh për jetën në Rexhina Çeli?

Përgjigje: - Burgu i Romës, Rexhina Çeli, është buzë lumit Tevere, pranë Kastel Sant Anxhelos, në periferi të Vatikanit. Burg i vjetër, me shumë të burgosur: ish--ushtarakë, patriotë, jugosllavë, grekë, ballkanas, çifutë. Unë isha në të ndarën e gjashtë, në katin e dytë, me dritare përballë Xhianikolos, nga duket dhe monumenti i Garibaldit, me Anitën mbi kalë. Na kishin thënë se kishin shkruar me shkronja të mëdha në piedestal: *"Beppe, scendi, e giunta l'ora!* - Xhuzepe, zbrit, se erdhi ora!" (Të luftojmë kundër gjermanëve!)

Dritaret e burgjeve të Italisë shohin një copë qiell dhe jo tokën. Por, kur kapitulloi Italia, të burgosurit i kishin shkallmuar një pjesë të dritareve; edhe ajo e birucës

onë ishte thyer - jo hekurat, po kanatet prej çimentoje - he ne shihnim përjashta jetën. Përkundruall, jo shumë arg, nja njëqind metra në vijë ajrore, ishte një kuvend ne *suora*. I shihnim përditë se si punonin, si lëviznin pa ë nga dhoma në dhomë, nga ballkoni në ballkon, si mizat dheut, pa fjalë.

Dilnim në oborr një çerek ore ditën (oborr ishin pirucat pa çati, që nuk komunikonin me njëra-tjetrën). Kishte ditë që na nxirrnin në një oborr të madh, ku akoheshim me qindra e qindra të burgosur. Të gjithë shim të shqetësuar. Kishim dëgjuar se burgun e paskëshin minuar gjermanët dhe, para se të iknin, do ta nidhnin në erë bashkë me mijëra të burgosur.

Me anën e një *skopinoje* (ata që fshijnë burgun dhe janë të dënuar), u lidha me inxhinierin e Operas, që ishte komunist. Ai më fliste, por unë bëja sikur nuk dija gjë. Më përmendte emra dhe më thoshte se lidhjen ia kishin dërguar që jashtë shokët Colombo, Ingrao... Po unë përsëri bëja sikur nuk dija gjë, se nuk kisha besim. Ai ngulte këmbë për të organizuar rezistencën në burg, se po afronte ora kur do të vinin shokët nga jashtë, të na hapnin dyert.

Ditët i kalonim shumë të shqetësuar. Aleatët kishin zbarkuar në Ancio e përsëri ishin kthyer; luftohej në Kazino. Lajmet nga jashtë na vinin me shumë vështirësi. E dinim që luftohej afër, por ishim shumë të shqetësuar se mos gjermanët do ta hidhnin në erë burgun. Një ditë më thirrën për takim. Më çuan te vendi i takimit, në hyrjen midis hekurave. Një burrë i gjatë, me një kapelë sa një tepsi, më foli shqip. U habita. Nuk e shihja mirë, se i binte drita në shpinë. Më pyeti si isha e si ia çoja, pastaj e pyeta unë se kush ishte e pse kishte ardhur.
- Jam profesor Kozmoja!

M'u kujtua profesori i pianos, e kisha njohur në Korçë. Habiteshim të gjithë me të.

- Kam ardhur, që të na japësh bukë, - vazhdoi. Iu luta ta përsëriste atë që më tha. - Kemi dëgjuar se këtu keni shumë bukë, ju tepron dhe e hidhni, po ti mblidhe e pastaj vij e marr unë!

Kujtova se do të ishte ndonjë parullë, por ai e kishte me të vërtetë. Roja që rrinte midis nesh , na tha të flisnim italisht dhe më pyeti:

- Ç'të thotë ky zotëria?

I thashë:

- Kërkon bukë nga ne. Thotë se na tepron dhe jashtë nuk ka bukë!

Roja qeshi dhe tha:

- *E mato*! - Është i çmendur!

Kurse unë i thashë Kozmos, italisht:

- Po të duash të ngopesh me bukë, thirr fort poshtë Musolini dhe Hitleri, dhe eja këtu të hash bukë.

Ai, me të dëgjuar këto, iku me vrap.

Roja më tha:

- Ç'ia bëre mirë budallait!

Jeta e burgut rëndohej nga tensioni i madh i luftës që po afrohej. Më 24 mars, jashtë, në Romë, në rrugën "Rasela" (më duket), gueriljet hodhën bomba në disa makina që ishin plot me gjermanë SS. U vranë 32 prej tyre dhe komanda gjermane, si përgjigje, vendosi të vriteshin 320 italianë, të burgosur. Nga burgu ynë erdhën dhe zgjodhën me emër italianët më të mirë (nga biruca jonë morën kolonelin e aviacionit Umberto Grani). I morën dhe i shpunë në Ardeatinë. Atje, pasi i futën në disa galeri, i pushkatuan dhe, ndoshta disa edhe të gjallë, i lanë të mbuloheshin nga shembja e galerive. Vranë më shumë se 330, nja njëzet i sollën të gjallë për të na lemerisur. (Sot Roma dhe Italia përmendoren Fose Ardeatine i ka si simbol të rezistencës.)

Pas dy ditësh vranë përjashta dy gjermanë. Si kundërpërgjigje, erdhën dhe zgjodhën njëzet veta për t'i

pushkatuar (për një gjerman të vrarë, dhjetë të burgosur). Kësaj here më morën edhe mua nga biruca. Shokët më panë me lot ndër sy, se po ndahesha nga ata përgjithnjë. Më shpunë poshtë në një sallë, ku ishin edhe të tjerët: të gjithë të rinj, ushtarakë që kishin dezertuar për të mos vajtur në Frontin e Lindjes. Në krye, pranë një tryeze, ishin tre veta: drejtori i burgut, një oficer këmishëzi italian dhe një mareshal gjerman SS. Na rreshtuan, unë isha i shtatëmbëdhjeti. Në krye pyesnin të burgosurit dhe shënonin emrin në listë; kështu me radhë, gjersa afroi radha ime: kisha përpara tre veta, kur doli nga goja ime: *"Ai jem albanien! Sono albanese! Je suis albanais*! - Jam shqiptar!" Mareshali gjerman ktheu kokën nga unë dhe pyeti "*Vas*?" "*Albanien*!" - thashë. Pyeti drejtorin dhe drejtori pohoi se unë isha shqiptar. Atëherë mareshali gjerman bërtiti: *"No albanien, italien*! - Jo shqiptar, italian!"

Mua më nxorën nga radha dhe pas pak sollën një tjetër që bërtiste: "*Non voglio morire! Non voglio morire!* - Nuk dua të vdes! Nuk dua të vdes!" Mua më shpunë në birucë, kurse të tjerët, për t'i pushkatuar! Shokët, kur më panë, u çuditën! Unë nuk fola për shumë minuta, pastaj u tregova skenën. Më dukej vetja i humbur, i poshtëruar, egoist, pa karakter. Isha i vdekur. Dhe nisi diskutimi: bëra mirë apo bëra keq! Më shumë mbanin anën time, megjithatë unë isha i vrarë... i vrarë... Nuk më hiqej nga sytë ai që thërriste se nuk donte të vdiste. Tërë natën nuk fjetëm. Për këtë flisnim. Dua të shënoj këtu një diçka që është e rrallë në fantazinë e atyre që shkruajnë: kur më thirrën me emër për të më pushkatuar, nuk ndieja më asgjë, sikur ecja në ajër, sikur rruzulli vërtitej me shpejtësi të jashtëzakonshme dhe gjithë planeti sikur më shtypte e më merrte me vete në hapësirën e një vorbulle rrënqethëse dhe në delir.

Të nesërmen më thirrën në takim, në drejtori: ishte

oficeri këmishëzi, kërkonte të takohej me mua. Ai më tha: "Faji është imi! Unë u thashë të të thërrisnin, se kisha një fjalë me ty, kurse ata të morën edhe ty si njërin nga ata që do të pushkatoheshin. Dhe bëre mirë që fole, se për pak shkove edhe ti... Pra, na këtë paketë cigare nga familja Grani. (Ishte një paketë "*Macedonia extra*".) Hape," - më tha. Brenda gjeta një letër ku thuhej: *"Lidhu me inxhinierin e Operës, se është shoku ynë. Mos ki frikë. Punët venë shumë mirë."* Pa firmë. Oficeri më pa dhe më tha: "Ma dhanë shokët. Të lutem, grise dhe digje!" Dhe iku.

U ktheva në birucën time. Shokët më shikonin në sy. U thashë se kush më thirri e ç'më dha. U tregova dhe paketën e cigareve, po letrën e dogja në sy të oficerit.

Nuk e mbaj mend si quhej inxhinieri i Operës së Romës, që ishte komunist dhe që kërkonte lidhje me mua. U lidha dhe biseduam se si të organizonim shpëtimin tonë. Ai më tha se shokët nga jashtë, në çastin e duhur, do të vinin për të hapur derën e burgut, po duhej të ishim të organizuar. Pas pak kohe u bënë me ne shumë gardianë dhe prifti i burgut. U vendos që, kur të jepej sinjali, do të hapeshin të gjitha qelitë dhe të burgosurit do të dilnin nga oborri, se derën e oborrit do ta shpërthenin shokët e jashtëm. Luftimet po afroheshin, luftohej në Veletri. Hyri muaji i qershorit. Prisnim me padurim, se dëgjohej artileria. Roma ishte në panik. U dha lajmi: "Nesër, pa gdhirë mirë, do të hapet dera e oborrit të madh! Në orën gjashtë të hapen të gjitha qelitë!" Ishte agimi i 6 qershorit të vitit 1944, kur u dha sinjali. U hapën të gjitha qelitë dhe të burgosurit u derdhën në oborr. Dera nga brenda u hap, por nuk u hap nga jashtë. Shumë të burgosur vrapuan te dritarja e dhomës ku merreshin pakot nga jashtë. Ajo dritare ishte e ngushtë dhe me një formë të tillë që rrotullohej një gjysmë rrethi, sa merrte pakon nga jashtë, pastaj mbyllej. E shqyen dhe filluan

të dilnin andej, por mund të kalonin vetëm ata që ishin shumë të hollë. U dërrmuan duke shtyrë njëri-tjetrin. Gjermanët vrapuan të vinin mitralozat në çati për të na vrarë të gjithë. Nuk u mor vesh mirë se cila qe, thonë se ishte një malazeze, që iu sul gjermanit dhe, bashkë me të dhe me mitralozin, ra nga çatia në oborr e vdekur. Pas pak u dëgjua një tank, i cili shtynte derën e oborrit nga jashtë. Për pak çaste dera ra dhe aty pashë se si flutu-ronin njerëzit. Shumë veta u shtypën. Të burgosurit merrnin drejtime të ndryshme. Unë mora drejtimin e Xhianikolos, aty ku ishte monumenti i Garibaldit, në Monteverde, se aty banonte prof. Franko Lombardi. Siç isha, ashtu i rraskapitur dhe i mbaruar, trokita në derë. Shërbyesja u tremb, po, kur doli Jola, më njohu, u mahnit dhe u gëzua shumë që isha gjallë. Aty ndenja gjer pasdreke, sa u telefonova disa shokëve, të cilët më ftuan shpejt në Piaca Fiume, Via Piave, ku do të takohesha me komandën ilegale. Arrita pasdreke. Ishte koprifuoko, gjermanët qëllonin dhe vrisnin këdo që nuk ndalej. Aty gjeta disa shokë, të cilët më thanë se isha një nga ata që qeshë ngarkuar të mbronin stacionin e Termini, se mos e hidhnin gjermanët në erë, në tërheqje. Aty nga ora shtatë më shpunë në një rrugë të ngushtë, ku gjeta nja njëqind veta të armatosur. Ishin të gjithë civilë, shumica me republikë. Zotërinj hesapi. Më thanë se ata njëqind veta do të mbronin stacionin Termini. U nisëm. Kur shkuam në stacion, nuk kishte njeri. Me ne ishte edhe inxhinieri i Operës. Vendosëm që të zinim rrugën që vjen nga Veletri, më duket Via Torino. Po errej. U vendosëm të gjithë anës rrugës, nga e majta kur shkon për në Veletri, secili në një nga pemët e trotuarit. Porosia: të mos qëllonte njeri pa urdhër. Qetësi e madhe këtej, kurse andej, ca kilometra më larg ndihej lufta, por e dobët, e lodhur, e shuar. Kur po bisedoja me dy shokë, njëri më tha: "Gjermanët!" - dhe më bëri me dorë nga vinin ata.

Ishin në mes të rrugës. Ecnin shumë ngadalë, nja pesë metra larg njëri-tjetrit. Dukeshin shumë, ndoshta një kompani. Afroheshin pa zë, pa e prishur ritmin e qetë të hapave të ngadaltë. I pari kishte në sup një gjë të madhe dhe mbi të dilte një antenë e gjatë. Vura re se kaskat nuk ishin si të gjermanëve. Kur dëgjoj të thërriste njëri: "Janë anglo-amerikanët!" - dhe u hodh drejt tyre. Pas tij u lëshuan të gjithë. Po përqafoheshin, kur vajta edhe unë dhe i pashë që ishin zbuluesit e armatës anglo-amerikane. Kërkuan përgjegjësin. U thashë se unë isha. lu luta të shkonim bashkë për në rrugën "Sicilia", ku ishte pensioni "Xhakarini", pra zyrat e Gestapos, se mos zinim materialet. Për aty u drejtuam me nxitim dhe, kur arritëm, gjetëm vetëm një rojë italian, i cili, porsa na pa që ishim me aleatët, thirri me të madhe: "Viva gli aleati, viva l'America!" Dolën nga dritaret shumë njerëz që ishin strukur brenda gjithë ditën si e gjithë Roma, dhe për pak minuta rruga u mbush me njerëz që thërrisnin si të shkalluar: *"Sono arrivati! Sono arrivati!* - Erdhën! Erdhën!" Gjermanët në atë lokal nuk kishin lënë asnjë copë letër, as edhe një kuti cigareje. Kishin ikur siç kishin ikur nga Roma, pa zhurmë, duke marrë me vete të gjitha automjetet. Populli kremtonte, kur morëm vesh se në sheshin "Ungeria" ende luftohej. U drejtuam për atje. Ishin dëgjuar disa të shtëna të gjermanëve të fundit, të cilët kishin vrarë disa njerëz që i kishin parë të lëviznin.

Pas nja dy orësh terri, Roma, e tërë Roma kishte dalë në rrugë, qyteti vezullonte nga dritat dhe buçisnin këngët duke pritur qindra e mijëra automjete të Armatës së Tetë Aleate që hynte nga sheshi "Venecia", në rrugën e gjatë që dilte në *Piaca del popolo.* Me qindra mijëra njerëz ishin në eufori: këndonin, kërcenin. Roma nuk kishte parë natë më të gëzuar se natën e 6 qershorit të vitit 1944.

Pyetje: - Tashmë ishe i lirë. Çfarë bëre në Romë?

Përgjigje: - Menjëherë u lidha me shokët italianë dhe jugosllavë, se nuk kisha asnjë shok shqiptar. Kisha shumë të njohur në Romë, ish-oficerë, studentë, ish-ushtarë, politikanë. U lidha më shumë me shokët jugosllavë, të cilët më ndihmuan në të gjitha drejtimet. Pika e parë, e pashë të arsyeshme që të hapja urgjentisht një zyrë të Çlirimit Kombëtar. Zyrën e hapa në Piaca dela Kroçe Rosa. Mora aty në zyrë Kiço Karajanin dhe Hito Sadikun, që ishin të gatshëm të bashkëpunonin me mua. Tani ç'duhej bërë? Në Romë kishte ushtarakë të Armatës së Tetë Aleate nga shumë kombësi, dhe çdo kombësi kishte komandën e vet. Grekët, jugosllavët, polakët.... hapën zyrat e tyre, se kishin shumë ushtarë në Armatën e Mesdheut; kishin komandat e tyre, mensat dhe intendencën e tyre. Ata grekë që solla unë nga Popi në Romë morën menjëherë rroga dyfishe në ar, për gjithë kohën gjatë së cilës ishin të arrestuar. Donin të më jepnin edhe mua, unë u thashë se nuk isha grek; sigurisht, i falënderova.

Shqiptarët, bullgarët, rumunët, hungarezët, trajtoheshin si ish-aleatë të Hitlerit dhe të Musolinit. Puna e parë ishte që ne shqiptarët të trajtoheshim si aleatë. Fola me Arso Milateviçin, që ishte atasheu ushtarak i Misionit Jugosllav në Romë (në Bari e kishin qendrën) dhe me Beblerin, një shok i mirë slloven që më njihte. Ata më krijuan mundësinë që unë të takohesha me komandantin e aleatëve në Romë, që ishte një gjeneral amerikan. Mora me vete dhe Hito Sadikun, që dinte mirë anglisht, si përkthyes. Të dy ishim veshur me uniformën ushtarake që na e kishin dhënë shokët jugosllavë. (Hanim në mensën e tyre.) Në sup, si çdo kombësi, kishim shkruar edhe ne "Albania". Na u caktua ora e takimit me komandantin e Romës, takim që na e organizuan shokët jugosllavë. Shkuam. I thashë se cilët ishim, se si Shqipëria qe i pari vend në Evropë që e priti fashizmin me armë,

se si populli shqiptar po luftonte e po derdhte gjak, se si burra e gra e fëmijë ishin në luftë të pandërprerë.

Një major, i cili kishte të shkruar në sup "*Greece*", diçka i tha komandantit dhe ai qeshi me të madhe. Kurse Hitoja u nxi e më tha me zë të ulët: "Ky grek na shau rëndë, tha se ne jemi kusarë kecërish, pa kombësi." Atëherë edhe unë u nxiva edhe më shumë dhe i thashë gjeneralit. *"Ec que vous parlez français?"* Ai dinte pak frëngjisht. I thashë me zemërim: "Ju lutem, nxirreni jashtë këtë fashist. Ne i kemi ndihmuar grekët me gjak. Në Shqipëri u bë Lufta Italo-greke dhe me dhjetëra mijë shqiptarë janë arrestuar e torturuar, se kanë ndihmuar fqinjët grekë, pasi ajo ishte dhe lufta e tyre. Edhe unë vetë kam shpëtuar 60 nga të Luftës Italo-greke, të cilët i solla në Romë dhe këtu në Romë janë ende. Ata janë burra të mirë, grekë patriotë, antifashistë, ata mund të flasin për ne dhe jo ky provokator." Ai më dëgjoi, u ngrit më këmbë dhe diçka i tha majorit grek, i cili u ngrys dhe doli jashtë. Na ftoi të uleshim. Telefonoi në një komandë - më duket në komandën greke - dhe na tha të prisnim. Pyeste për Shqipërinë dhe për ne. I thamë se ishim me mijëra të internuar dhe të burgosur aty në Itali dhe prisnim të ktheheshim në atdhe, të merrnim edhe ne pjesë në luftë. U dëgjua zilja e telefonit. Ai foli disa minuta, pastaj u kthye nga ne dhe na tha se komanda greke e kishte vërtetuar thënien tonë, prandaj na pyeti se sa shqiptarë ishim në Romë. I thashë se ishim nja 500. I ra ziles dhe erdhi një grua ushtarake, së cilës i foli, ndërsa ajo mbante shënim. Asaj i dhamë adresën e zyrave tona në Piaca Dela Kroçe Rosa dhe ajo siguroi ndihmat. U larguam. Të nesërmen, në zyrat tona erdhën kamionë me 500 pako ushqime dhe me 500 franxholla. Po kaq do të vinin një herë në javë.

Bëmë një lajmërim në gazetat "Unita" dhe "Avanti", që gjithë shqiptarët që ishin në Romë, të vinin në zyrat

tona për të tërhequr ushqimet. Na u dha urdhri: "Mos bëni dallime. Vetëm të jenë shqiptarë, pavarësisht nga prirjet politike, të paraqitin pasaportën dhe të tërheqin ushqimet; më vonë do të japin llogari." Kryesorja tani për tani ishte që gjithë shqiptarët t'i kontrollonim ne dhe të njiheshim prej tyre si përfaqësues pranë aleatëve.

Filluan të vinin: studentë, ish-ushtarë, ish-xhandarë, ish-oficerë, ish-të internuar. Kiço Karajani dhe Hito Sadiku ishin ngarkuar për regjistrimin e tyre; ata ua jepnin edhe ushqimet. Filluan të vinin ish-ekselencat: Xhemil Dino, Dhimitër Berati, Mehmet Konica, Omer Fortuzi.

Një ditë na erdhën dy hanëme, që na folën frëngjisht. Kujtova se ishin të huaja që donin të pyesnin diçka për Shqipërinë ose për ndonjë njeri që kishin në Shqipëri. Ishin të dyja të shëndosha, një e re dhe një e shkuar nga mosha. E reja mbante në prehër një qen të murmë, me lesh të gjatë. I pyeta se çfarë dëshironin (frëngjisht). Ato më thanë se kishin lexuar lajmërimin dhe kishin ardhur për të marrë ushqimet. I pyeta se të ç'kombësie ishin.

- *Nous sommes albanaises, monsieuer Marko!*

- *Vous etes albanaises, mais parlez vous l'albanais?*

- *Mais oui mon chere!*

- Flasim shqip zotni Marko, - tha e reja.

- Jemi zonja dhe zonjusha Libohova! - tha e madhja.

- I keni pasaportat ? Nëse i keni, shkoni në dhomën tjetër. Atje janë shokët që do t'ju regjistrojnë dhe do të merrni ushqimet.

Parfumi mbushi dhomën. Ato shkuan dhe pas pak u kthyen me pakot në duar. Më tha më e reja, që mbante qenin në prehër:

- Monsieur Marko, a ka mundësi të marrim dhe një pako për Fufunë?

- Kush është Fufuja? - e pyeta.

- Ja! - dhe më tregoi qenin që mbante në prehër... - Nuk gjenden ushqime përjashta dhe Fufuja...

As unë nuk e di si më erdhi. E meritonin t'ua merrja dhe ato që u kishim dhënë dhe t'i sikterisja, por ishte udhëzimi, ishte porosia, kështu që nuk veproja dot ndryshe...

- Po a di shqip Fufuja? - e pyeta me zë metalik.

Ajo buzëqeshi si... dhe tha:

- Nuk di shqip Fufuja.

- E po ne kemi urdhër t'u japim atyre që dinë shqip dhe që kanë pasaportë shqiptare. Më vjen keq, zonjë.

- Zonjushë! - ma preu e ëma.

Ikën të indinjuara të dyja.

Në marrëveshje me shokët e partisë, caktuan shumë shokë italianë të vinin e të merrnin pako, si p.sh. familje të partizanëve italianë në Shqipëri, familje të shkatërruara nga fashizmi.

Nga shqiptarët që vinin për të marrë ushqime, shumica ishin studentë. Ata në përgjithësi regjistroheshin si vullnetarë për t'u kthyer në Shqipëri në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Njëri nga ata ishte dhe Nexhmedin Zajmi. Ish-oficerë si Stathi Sallabanda, Asllan Sojli, një Ypi, disa sportistë si Naim Kryeziu, Haki Korça e të tjerë ishin regjistruar si vullnetarë. Një ditë shokët e Misionit Jugosllav më thanë se skuadra partizane jugosllave e futbollit do të luante me skuadrën e futbollit të Armatës së Mesdheut, dhe kërkuan që dhe Naim Kryeziu të merrte pjesë në këtë lojë, pasi Naimi ishte një futbollist i shquar i Romës. I thashë Naimit, dhe ai, si kosovar, si gjakovar më tha: "Unë marr pjesë në lojë me një kusht: që skuadra partizane jugosllave të quhet skuadra partizane shqiptaro-jugosllave, se unë vlej sa gjithë ata lojtarë të "Partizanit" jugosllav." Këtë kusht nuk e pranuan jugosllavët, prandaj Naimi nuk luajti.

Vinin shumë ish-ushtarë, ish-xhandarë, ish-të internuar dhe ish-të burgosur, por, meqë nuk kishim mundësi t'i mbanim, shkuam në komandën aleate dhe i para-

shtruam kërkesën që këta të trajtoheshin si aleatë. Komandanti e pranoi kërkesën tonë dhe na tha që çdo qytetar shqiptar të pajisej me një shkresë e të paraqitej në kampet e Çineçitasë. Dërguan aty dhe dhjetëra ish--ushtarë, ish-të burgosur dhe tri vajza që kishin mësuar për mami, njëra ishte motra e Janaq Paços, tjetra një me mbiemër Lepenica. Aty hanin e pinin dhe ne shkonim shpesh për t'i parë. Të gjithë ishin regjistruar vullnetarë për t'u kthyer në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por ja që ne ende nuk kishim asnjë lidhje me shtabin tonë.

Një ditë na u paraqit në zyrë edhe një poet nga Tirana, me duket se quhej Sotir Vangjeli ose Vangjel Sotiri (motrën e tij e kishte marrë për grua Ernest Koliqi). Na tha se ishte poet dhe dëshironte të kthehej në Atdhe. U regjistrua për ushqimet. Pas pak kohe na vjen në zyrë Omer Fortuzi dhe, i alarmuar, na thotë: "Na rrahin italianët!" I thamë të na e shpjegonte, por ai nxitohej dhe më lutej të shkoja me të, se në kishën Santa Maria deli Anxheli, aty pranë, po martohej poeti nga Tirana me një vajzë të një pasaniku të madh, por ai pasanik i madh kishte dërguar atje shumë trima për ta ndaluar martesën. Ishin përleshur me Dhimitër Beratin, Mehmet Konicën, Zef Sereqin, Xhemil Dinon, zonjën dhe zonjushën Libohova e shumë ish-ekselenca që atëherë ishin në Romë. Desha s'desha, vajta. Kur hymë në kishë, dëgjoheshin zëra dhe britma.

Fortuzi, që hyri i pari, bërtiti: "Erdhi konsulli ynë. Me atë e keni fjalën!" Unë hyra në kishë. Të gjithë ishin më këmbë, si pas betejës. Kërkova priftin. Ai erdhi duke fërkuar duart. E pyeta se ku ishte çifti. Më shpuri në një dhomë. Çifti ishte atje. Porsa më pa, poetit iu mbushën sytë me lot: "Jam i varfër, po më do dhe unë e dua. Nuk dëshiron i ati të bëhet ceremonia e martesës. Të lutem, na ndihmo!" Vajza simpatike më vështronte. E pyeta a e

donte apo jo; "E dua për vdekje! Po nuk u martova me të, do të mbytem në Tevere!" I thashë priftit ta bënte shpejt ceremoninë e duhur. Dhe ai, duke më shikuar si me druajtje (unë isha ushtarak dhe me revole në brez), pranoi. Ceremonia u bë shpejt e shpejt. Unë desha të largohesha, po Fortuzi, që ishte kumbari, m'u lut t'i shoqëroja te lokali ku ishte përgatitur dreka. Vajta me ta dhe më ulën në krye. Gotën e parë e ngriti Fortuzi: "Një i varfër, por poet shqiptar, një arbëresh, stërnip i Skënderbeut, po martohet me njërën nga vajzat më fisnike të Romës", - dhe gati sa nuk qante duke folur me fraza stereotipe zyrtare, që nuk hynin fare në këtë ceremoni. Më vinte për të qeshur, por ja që urdhri ishte që unë t'i mbroja shqiptarët pa marrë parasysh se cilët ishin.

Një ditë Bebleri më tha: "Do të shkojmë në Kazerta, në Shtabin e Mesdheut. Do të jetë me mua dhe gjeneral Sarafisi, i Eamit. A vjen edhe ti?" Pranova. Ata kishin makinë. Unë mora me vete dhe një sasi me ushqime për familjen e Jolës, e cila më kishte ndihmuar shumë gjatë internimit në Ustikë. Më shpunë me makinë gjer te shtëpia e Jolës. Aty do të vinin e të më merrnin pasi të mbaronin mbledhjet në Shtabin e Mesdheut. Kisha marrë me vete edhe ish-oficerin Adnan Ypi. Nëna e Jolës u gëzua pa masë kur më pa. Ishte vetëm me shërbyeset. Jola ishte në Romë dhe djemtë në Londër. Tri ditë shëtita nëpër Napoli dhe dëgjoja e shikoja horrllëqet e aleatëve me bukuroshet napolitane. Shërbyeset nuk dilnin nga shtëpia. Gjatë kohës që u ndodha aty, më lutnin t'i shoqëroja gjer në pazar, se nuk guxonin të dilnin. Pas tri ditësh erdhi Bebleri me Sarafin. Më morën dhe u kthyem në Romë. Bebleri më mbajti për darkë. Më tha: "Shqipëria bie erë vajguri!" Nuk e kuptova. Më shpjegoi se "Shqipërisë ia kishin vënë syrin për vajgurin e saj. Aleatët do të zbarkonin në Greqi, Shqipëri dhe në gjithë bregdetin Adriatik, gjer në Trieste, ku do të takoheshin me Ushtrinë

e Kuqe, që do të vinte nga Rumania, Bullgaria, Serbia. Nuk pashë ndonjë gjë të keqe. Më vonë e kuptova. Do të flas për ardhjen e Çurçillit në Napoli e Romë, ku u takua dhe me Titon.

Nuk e mbaj mend se në ç'muaj erdhi në Itali Çurçilli. Asokohe shtypi perëndimor kishte ngritur dy njerëz të mëdhenj: në Perëndim De Golin dhe në Lindje Titon. Kishin bërë ekspozita për Titon, me Jovankën, në luftë, në marshime, në shtab. U takua Titoja me Çurçillin, i cili djalin e tij e kishte dërguar në shtabin e Titos, gjatë luftës. Pasi ikën Çurçilli dhe Titoja, Bebleri, një mbrëmje më tha:

- Nuk do të zbarkojnë aleatët, as në Shqipëri e as në Jugosllavi, po vetëm në Greqi!

- Po pse? - e pyeta unë.

- Se atje kanë Titon! - më tha Bebleri. Këtë e tha me nëntekst, që unë asokohe nuk kisha se si ta kuptoja. Këtë e kuptova kur Titoja u shkëput nga Informbyroja dhe u bë shkaku i shkatërrimit të kampit socialist! Bebleri, që e pësoi më vonë nga Titoja, nuk ma tha troç në Romë, se... kushedi. Por ai e kuptoi qysh atëherë se si do të rridhnin vitet drejt prishjes së kampit socialist.

Një ditë më thirrën shokët jugosllavë dhe më thanë se duhej t'i bëja një telegram Stalinit, në emrin e gjithë të dënuarve dhe të internuarve shqiptarë. Telegramin e hartova. Stalinin e falënderoja që na shpëtoi nga vdekja, dhe shprehja mirënjohjen ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe, që shpartalloi nazifashizmin, vdekjen e njerëzimit. Më thanë se cilin duhej të kërkoja në ambasadën sovjetike, *Via Piza*. Shkova dhe në sallë, ndërsa prisja, kisha përballë meje një zotëri të gjatë, të thatë, të veshur keq, me pantallona me arna të mëdha te gjunjët. Më vështronte dhe më pyeti mos isha jugosllav (më pa të veshur partizan). I thashë se isha shqiptar dhe pastaj e pyeta se cili ishte, duke besuar se do të ishte ndonjë

shok italian i kthyer nga kampet e përqendrimit. Më thanë se ishte gjeneral Nobile, ai aviatori legjendar që kishte bërë ekspeditën për në Polin e Veriut!

U habita. Kur isha nxënës në Shkollën Tregtare në Vlorë, lexoja me interesim të madh për ekspeditën për në Polin e Veriut, të *dirixhibiles* italiane "Italia", nën komandën e gjeneral Nobiles. Me keqardhje atëherë mësuam disfatën, humbjen katastrofike dhe dënimin që i dha Musolini gjeneral Nobiles. Atë e shpëtuan sovjetikët dhe ai nuk u kthye në Itali, nga frika se mos e dënonte Musolini. Në Bashkimin Sovjetik, sipas thënieve të tij, ishte profesor në një shkollë aeronautike. Kur e pyeta se nga vinte, ai m'u përgjigj: "Vij nga një vend ku njeriu nuk çmohet nga pantallonat, në janë me arna apo pa arna." Qe një takim shumë interesant. Ai ato kohë shkruante artikuj të mirë për Bashkimin Sovjetik në gazetën "Popolo".

Më thirrën lart. Më priste ai që kërkoja (nuk e njihja, shokët jugosllavë më thanë emrin e tij). Ishte një kolonel i shkurtër dhe i shëndoshë. Më pyeti se kush më kishte dërguar tek ai. I thashë të vërtetën. Ai e mori telegramin dhe më tha se qysh tani do t'i dërgohej Stalinit. Më pyeti për Shqipërinë. I thashë se ende nuk kisha informacion të saktë nga atdheu im. Foli fjalë të mira për partizanët shqiptarë, më qerasi me vodka dhe më dha cigare "Papirus". Më pyeti nëse kishim ndonjë nevojë. E falënderova dhe u largova. Ishte hera e dytë që futesha në një ambasadë sovjetike.

Pyetje: - Po ti si jetoje, ç'shoqëri kishe?

Përgjigje: - Jetoja i lirë, me shokë të mirë dhe me preokupacione. Një muaj isha i ftuar në familjen Grani, te vëllai i Umberto Granit, që u pushkatua më 24 mars në *Fose Ardeatine*, që ishte me mua në një birucë te Rexhina Çeli. Ata kujdeseshin për mua si për një njeri të shtëpisë. Vajza e tyre Tina, kur unë kisha kohë të lirë,

më shoqëronte kudo, nuk më ndahej. Ajo më shpinte në *"La Kuirineta"*, një kafene ku mblidheshin tërë artistët e Çineçitasë, të teatrit dhe të operas. U njoha aty me shumë artistë, si Xhino Çervin, Ana Manjanin, Leonardo Kortezën, Elsa Merlinin, Vivi Xhoin e të tjerë. Më nxitën të shkruaja një dramë. E shkrova: *"Erano sette prigionieri"*. E lexuan, dhe Xhino Çervi mendoi ta vinte në skenë në teatrin "*Eliseo*", ku punonte. Kisha shkruar dhe një novelë "*Letere in fiame*", të cilën ma nxori Tina nga "Rexhi-na Çeli" dhe e kishte ruajtur ta botonte në "Il politekniko" dhe që Elio Venturini e kishte pëlqyer shumë. Po të dyja këto vepra i tërhoqa, sipas urdhrit të Bedri Spahiut. Për këtë do të tregoj më tej.

Një muaj punova në gazetën "Unita" dhe një muaj në gazetën "Avanti". Aty ndihesha shumë mirë, se kisha të bëja me shokë të dëgjuar dhe të ngritur: Në "Unita", me Ingraon, Kolombon e të tjerë; në "Avanti", me Pietro Nenin, që e kisha njohur në Spanjë, me Saragatin, me Pertinin, me de Martinon. Më deshën dhe më nderonin shumë. Ndërkohë kisha njohur dhe Maria Denisin, një artiste e madhe, me shpirt dhe zemër të madhe.

Tina, vajza e Granit, që ishte një tregtar i madh, me magazina ku shiteshin konfeksione lëkure "Grani", kishte kënaqësi të më shoqëronte. Ishte një vajzë shumë e këndshme, e sinqertë dhe e dashur. Shoqërohesha me Jolën, me burrin e saj Franko Lombardin, me babanë e Jolës, një burrë i mirë, që kishte qenë kryetar bashkie në Napoli, me një shoqe të Jolës, që quhej Kordelia, e cila më njohu me artistët e "Via Marguta"-s, se dhe ajo në "Via Marguta" banonte, afër *Piaca di Spania*, vendi më i bukur dhe më karakteristik i Romës. Aty pranë ishte dhe shtëpia ku kishte vdekur poeti i madh anglez Keatsi.

Në një mbrëmje, te një arkitekt, në "Via Marguta", ku më shpuri Kordelia, shumë artistë, piktorë, skulptorë e të tjerë bisedonin për lirinë që do të kishin këtej e tutje

krijuesit. Njëri më pyeti se cila vepër e re skulpture ose arkitekture më kishte pëlqyer më shumë në Romë (jo veprat e lashta, po të rejat). Unë, pa u menduar shumë, i thashë se më kishte pëlqyer Palaco dela Giusticia (Gjykata). U hodh njëri dhe si i tërbuar bërtiti: "Është turpi i artit italian, një bllok mermeri!" Fliste duke shfryrë kundër atij pallati, që mua më kishte pëlqyer shumë. Atëherë Kordelia e mençur, me takt, tha: "Ndoshta Petros i ka pëlqyer më tepër si ndërtesë e bukur gjykata, pasi Petros i ka takuar të vizitojë shumë gjykata, në Francë, në Itali dhe në Shqipëri!" Të gjithë qeshën.

Një gafë tjetër bëra dhe me nënën e Kordelias, që ishte një plakë simpatike dhe e mençur. Ishte çifute. Kordelian e kishte me një dijetar gjerman, më duket Woundurf ose... (Sot në Berlinin lindor universiteti ka emrin e babait të Kordelias. Kam lexuar për jetën e tij edhe në një faqe të tërë të enciklopedisë "Trakani".) Pra, nënës së Kordelias i thashë për portretin e saj të madh që kishte në mur:

- Shumë e bukur paskeni qenë!

Ajo u nxeh aq shumë, sa dridhej:

- Pse, tani si jam? Nuk jam po ajo?

Kordelia e gjorë u përpoq ta qetësonte duke i thënë se unë kisha thënë për portretin që ishte punuar shumë bukur. Që atë ditë nuk shkela më në shtëpinë e Kordelias, se mos bëja ndonjë gafë tjetër. E kush isha unë, që frekuentoja ato rrethe: një fshatar shqiptar, që kishte hequr të zitë e ullirit gjithë jetën! Dhe atë pak kulturë që kisha, ia kisha vjedhur copa-copa dhe çika-çika borgjezisë.

Më ftoi në shtëpinë e tij arbëreshi avokat Argondica, i cili më tregonte punën që kishte bërë për mbledhjen e folklorit. Kishte botuar një vëllim, të cilin ma fali. Pastaj kërkoi edhe ai të merrte ushqimet, "pasi jam arbëresh!", - më tha. Kishte gruan dhe një vajzë.

Një ditë Stefan Garuli m'u lut t'i jepnim të hante

bukë sa të deshte, se kurrë nuk ishte ngopur. Kiço Karajani i tha: "Ha sa të duash, bre burrë!" Stefani filloi të hante në orën 10 dhe, kur ne do të mbyllnim zyrat, në orën 12, ai kishte ngrënë katër bukë, franxholla të ngrohta, me kaçkavall. Dhe tha: "Tani le të vdes i ngopur!"

Na thanë se do të vinte i pari delegacion i shtabit tonë. Për këtë na njoftoi Halim Budoja, i pari shok që na erdhi nga Shqipëria. Ai ndenji disa ditë në Romë dhe pastaj u largua. Para se të ikte, na bëri një ekspoze të situatës në Shqipëri: punët venin shumë mirë. Dhe unë i bëra një ekspoze të situatës sonë në Romë. Ai më porositi ta vazhdoja punën ashtu siç e kisha nisur, gjersa të merrte udhëzime të reja nga delegacioni i shtabit tonë, që ato ditë do të vinte në Itali për t'u lidhur me Shtabin e Mesdheut në Kazerta.

Pyetje: - Kur erdhi delegacioni i Shtabit tonë të Përgjithshëm?

Përgjigje: - Erdhi nga fundi i gushtit ose fillimi i shtatorit të vitit 1944. E kryesonte Bedri Spahiu, që kishte si shokë Ramadan Çitakun dhe Frederik Nosin. Ata i pritëm ashtu siç duhej, dhe u bëra një ekspoze të situatës në të cilën ndodheshin shqiptarët në Romë. Bedriu, të cilin e njihja, më foli gjatë për situatën në Shqipëri. Fitorja po afronte! Kur e pyeta për Mehmet Shehun, më tha se ishte bërë Komandant i Brigadës së Parë Sulmuese dhe se luftonte me trimëri. Më erdhi mirë, se ishte edhe ai një luftëtar i Spanjës. Shkova në "Unita", u dhashë emrat e personave të delegacionit dhe ata i botuan në gazetë. Shkova dhe në qendrën e shtypit të Armatës së Mesdheut për të dhënë lajmin, ku më priti shefi i shtypit. I shkrova emrat. Pasi u ktheva në zyrë dhe kur shkuam për të ngrënë, dëgjuam në Radio-Londra lajmin për ardhjen e delegacionit të parë të partizanëve shqiptarë në Shtabin e Mesdheut. "Shumë të shpejtë janë, qerratenjtë!" - më tha Bedriu duke më përgëzuar. I fola për përshtypjet e

mia rreth mënyrës së shpejtë të informimit që kishin organizuar aleatët. Në hotel "Placa" kisha parë me sytë e mi se si korrespondentët, në një sallë të madhe, me aparate të reja, merrnin lajmet nga vija e parë e frontit, në Italinë e Veriut, dhe menjëherë i komunikonin në qendrën e tyre në Zvicër, e ajo qendër menjëherë i shpërndante në gazetat amerikane. Brenda orës merrnin lajmet.

Bedriut, midis të tjerave, i raportova dhe këto:

1. Disa shokë, midis të cilëve dhe jugosllavët, kishin shfaqur mendimin që ne të bllokonim Bankën Shqiptare, që i kishte zyrat në *"Piaca d'Esedra"*, përmbi kafenenë "Italia". Këtë nuk e pranoi Bedriu. Do t'i merrnim paratë e bankës sonë, sidomos floririn, në bazë të marrëveshjes që do të bënim me aleatët. Të mos bënim më asgjë pa urdhër.

2. I propozova të bënte një mbledhje me të gjithë krerët, se ata e dëshironin një gjë të tillë. Ai e pranoi dhe mbledhjen e bëmë. Qenë të pranishëm shumë ish-ekselenca, krerë të të gjitha qeverive të Shqipërisë. Ata i bënin shumë pyetje dhe Bedriu u përgjigjej menjëherë. Pyetjes që bënë disa: "Po të kthehemi, a na bëjnë gjë, kush na e siguron kokën?", - Bedriu iu përgjigj: "Edhe unë nuk e kam të siguruar kokën time. Kush ka bërë faje, do të gjykohet. Po ardhja me vullnet ua lehtëson fajet atyre që kanë bërë. Se duhet ta dini, në bazë të marrëveshjes me aleatët, të gjithë do të kthehen të shoqëruar në vendin e tyre për të dhënë llogari."

3. I thashë se kisha dorëzuar një dramë *"Erano sete prixhionieri"* dhe një novelë të gjatë "*Letere in fiame.*" Ai më tha t'i tërhiqja.

Disa xhandarë, të gënjyer nga propaganda, u futën vullnetarë në ushtrinë aleate. U thanë: "Pse të shkoni në Shqipëri e të luftoni, kur lufta bëhet kudo? Angazhohuni në ushtrinë aleate." Xhandarët ikën dhe pas pak kohe

na shkruan një letër që na shërbeu shumë: *"Amani, na shpëtoni, se na kanë prurë këtu në Oran të Algjerisë dhe na përdorin si hamej për të shkarkuar nga vaporët materialet luftarake. Aman, na shpëtoni, se jemi më keq se skllevërit!"*

Këtë letër ne e afishuam në zyrat tona. Po propaganda bëhej më e theksuar: "Ku do të shkoni? Atje nuk ka siguri! Atje vrasin njëri-tjetrin. Shqipëria është bërë një kasaphanë."

Në zyrat tona vinin lloj-lloj agjentësh, të njohur e të panjohur. Ne i njihnim dhe nuk binim në provokacionet që na bënin. Ishim aleatë.

Edhe në Çineçita, ku ishte kampi i të gjithëve, bëhej propagandë e madhe, që të mos kthehej njeri në Shqipëri. Na u desh të luftonim me takt, gjersa erdhi Misioni ynë Ushtarak në Bari. Kryetar i misionit ushtarak ishte Kadri Hoxha. Erdhi në Romë, ku u takuam, dhe na tha se së shpejti do të ktheheshim në Shqipëri. Vajta edhe unë me të në Bari. Shkova dhe në spitale, ku takova shokët e plagosur. Midis tyre ishte dhe Zylyftar Veleshnja, që e njihja. E mora me vete në Romë. Ishte kapiten i parë, po gradat i kishte vënë shumë të mëdha, saqë, kur shkuam në mensën e oficerëve amerikanë, kujtuan se ishte ndonjë feldmareshal. Na u mblodhën shumë oficerë dhe na pyetën se kush ishim. Pastaj disa u interesuan për luftën tonë. Zylyftari ishte me paterica. Më tha se kishte nevojë për ndërresa, prandaj duhej t'u kërkoja oficerëve që ta ndihmonin. Kur na përcollën, i thashë atij që bënte punën e përkthyesit, se shoku i plagosur kërkonte tesha për t'u ndërruar. Ai shkoi lart dhe u kthye me një shkresë në dorë. Ne nuk kishim makinë, prandaj na dhanë një makinë për të shkuar në magazinë. Vajtëm në magazinë, i treguam shkresën dhe magazinieri na pyeti se ç'kërkonim. Zylyftari me të qeshur më tha: "I thuaj se unë bëhem shtatë veta në shtëpi dhe jemi të gjithë lakuriq. Pra thuaji për shtatë veta: këpucë për dimër e për

verë dhe çizme, tesha për dimër e për verë për shtatë veta, të brendshme për dimër e për verë, për shtatë veta." - dhe ia plasi të qeshurit me dhembje.

Në Romë vija re se shumë shokë që ishin regjistruar si vullnetarë, nuk dukeshin më, si aviatori nga Turani (ose Bënça), Shemsiu, për të cilin thoshin se kishte përfunduar aviator personal i sulltanit të Arabisë Saudite!!!

Kur vajta të përshëndetesha për herë të fundit me shokët që më kishin trajtuar me dashuri si garibaldin, qoftë ata të "Unita"-së qoftë të "Avanti"-t, më bënë një përcjellje të përzemërt. Dua të shënoj qëndrimin e Nenit, që ishte, me sa mbaj mend, kryeredaktori i "Avanti"-t. Sa herë iu luta të bënte një artikull për luftën e popullit tonë, siç më kishte porositur Bedriu, dhe nuk e bëri! Edhe kur po më përcillnin, ai m'u kthye e më tha (duke parë hartën e Ballkanit që ishte e varur në mur): "*Petro, dove vai? Rimani qui!...* - Petro, ku po shkon? Qëndro këtu, si korrespondent i "Avanti"-t, në daç në Evropë, në daç në Amerikë ose në Azi. Mos shko në Ballkan, se Ballkani ka qenë, është dhe do të jetë një bordello ku nuk do të ketë kurrë qetësi! Ideve përparimtare të majta mund t'u shërbesh më mirë ashtu si të them unë. Atje ke për të humbur fare."

E vërteta është se ai më kishte dashur qysh në Spanjë. Dhe unë e nderoja si njërin prej plejadës së madhe të antifashistëve botërorë. Por, kur më tha këto, u mendova para se t'i përgjigjesha. Për fat, u përgjigj për mua Sandro Pertini, i cili e pyeti Nenin: "Po ti, Pietro, pse nuk ndenje vetë në Paris, po erdhe në Romë? Edhe ai vendin e tij e ka atje, në atdheun e tij, për të cilin ka luftuar... Pietro, - mu drejtua mua, - aty të shkosh, aty është llogorja jote!" Edhe De Martinoja, edhe Lombardi, edhe Saragati ishin të një mendimi me Pertinin. Si kujtim më dhanë një stilograf të Mateotit. Unë atë ia fala Kordelias, e cila ma kërkoi me këmbëngulje, se ajo kishte dashuruar shokun e Mateotit, kryeredaktorin e

'Avanti"-t, që e vranë gjermanët pak ditë para se të çlirohej Roma, në sheshin "Ungeria", e vranë duke e ndjekur. Ishte i ngarkuar me gazeta "Avanti" dhe, kur i thanë të ndalej, nuk u ndal. Pas çlirimit të Romës, aty u bë një ceremoni e madhe për ta përkujtuar. Kordelia qante me dënesa. Më 10 qershor, në Tevere do të pagëzohej një urë me emrin Mateoti, se aty ishte vrarë. Isha i ftuar të flisja edhe unë si shqiptar. Folën të gjithë përfaqësuesit e partive antifashiste, foli dhe një shok jugosllav, fola dhe unë. Kordelia qante. Prandaj, kur më kërkoi stilografin, ia dhashë.

Shumë shokë italianë që kisha njohur në Spanjë, në Francë, në internime, në burgje, në male, vinin dhe më takonin. Midis tyre dhe Sisto Venturi, ai që njoha në burgun e Tiranës dhe që më kishte dhënë si kujtim orën, të cilën e mbaja në dorë dhe vazhdoj edhe sot ta mbaj. Ishte emëruar përgjegjës për viktimat e fashizmit. Ishte krijuar një zyrë që u vinte në ndihmë të shpejtë atyre antifashistëve që fashizmi i kishte katandisur për ibret, nga çdo anë. Më shtroi një darkë në Grand Hotel. Kishte me vete dhe disa shokë të tjerë, ish-të burgosur nga fashizmi. Bënte shaka dhe kujtonte burgun e Tiranës, kujtonte dashurinë e madhe që treguan shqiptarët për të dhe më përsëriti: "Po të kthehesh në atdhe, atë spiun dënojeni!" (E kam përmendur më lart.)

Sa për orën, i tregova dramën e saj, qoftë në Ustikë e qoftë në Rexhina Çeli. Kur u çlirua Roma, një shok më tha nëse kisha lënë në burg të Romës ndonjë gjë me vlerë. I thashë se kisha lënë orën e Venturit. Shkuam në burg, në drejtori, dhe ma dhanë orën. (Përmbysje u bë, po rregulli ishte rregull! Asgjë nuk u zhduk në drejtorinë e burgut nga gjërat me vlerë që kishin lënë të burgosurit.)

Ato ditë u bë dhe një linçim. Populli linçoi drejtorin e burgut të Rexhina Çelit. Një grua pa se në gjykatë (Palaco dela Xhiusticia) po hynte si dëshmitar drejtori i burgut. Gjykoheshin ata që kishin qenë agjentë të

gjermanëve. Gruas i kishin vrarë djalin në Fose Ardeaine, më 24 mars (siç kam treguar më lart). Kur e pa gruaja, thirri: "Ja krimineli!" - dhe iu hodh. Pas saj iu hodhën të tjerë e të tjerë, gjithë turma, e morën duke e zvarritur dhe e hodhën në lumë. Ai ishte ende gjallë dhe lumi e nxori në breg. Po zbritën shumë burra dhe gra, e tërhoqën zvarrë gjer te burgu dhe atje, të vdekur, e varën në hekurat e hyrjes. (Atëherë Çurçilli foli nga Londra se duhej gjykuar dhe jo linçuar!)

Shkoja shpesh në Bari në Misionin tonë Ushtarak, ku takohesha me Kadri Hoxhën, Gafur Çomon e të tjerë. Aty më prezantuan edhe me Miladinin (Popoviçin) e dëgjuar, të cilit i kishin folur për mua shokët e tjerë jugosllavë. Në Bari, së bashku me Kadri Hoxhën, shkuam të ftuar për drekë te Hari Fulci, njeriu që kishte themeluar në Tiranë një shkollë teknike të dëgjuar. U bisedua gjerë e gjatë për shumë probleme lidhur me situatën në Shqipëri. Fulci më pyeti për vitet e internimit. Kur dolëm, unë i bëra Kadriut shumë pyetje lidhur me luftën partizane dhe për situatën e përgjithshme në Shqipëri. Ai më informoi imtësisht me entuziazëm për heroizmin partizan dhe popullor, i bindur në fitore. Kadriu ishte një njeri i kulturuar, inteligjent dhe shumë i këndshëm në bisedë.

Midis atyre që kishin ardhur nga Shqipëria të plagosur për t'u kuruar në Itali, njoha një vajzë të re, të pashme, të veshur partizane. Ishte Liri Belishova. Ajo kishte humbur syrin në luftë.

Kudo ku ndodhesha, zakonisht me shqiptarët më shumë se me të huajt, bisedoja për kthimin në atdhe. Për mua, mbas kaq vjetësh peripecish, kthimi në vendin tim ishte ëndrra ime më e madhe. Doja që mundësisht të arrija të inkuadrohesha edhe unë në formacionet partizane, mbas kaq shumë vjet lufte, internimesh, burgimesh e vuajtjesh larg atdheut.

Papritur, një ditë tetori, më lajmëruan në Romë: Nesër në orën tetë të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të kthehen në Shqipëri, të paraqiten në stacionin "Termini". Ky lajmërim na u dha aty nga ora gjashtë e pasdrekes. Kë të lajmëronim më parë? Ku t'i gjenim? Iu lutëm të shtyhej afati të paktën dy ditë, por urdhri ishte i prerë: Nesër në orën tetë!

Bëmë ç'ishte e mundur për t'i njoftuar njerëzit edhe gjatë natës, por të nesërmen në orën tetë në stacionin "Termini", nga të 400 e ca të regjistruarit si vullnetarë, erdhën vetëm rreth 150 veta. Midis tyre, oficerë si Asllan Sojli, Stathi Sallabanda, studenti i Akademisë së Arteve Nexhmedin Zajmi e të tjerë.

Atë natë, përpara nisjes, u telefonova miqve të mi. E para Jola Lombardi u trondit dhe tha; "Sa keq që po ndahemi kaq papritur pa u takuar. Mos na harro! - dhe unë iu përgjigja se isha shumë i lumtur që po kthehesha në atdheun tim, ku do të mund të luftoja edhe unë deri në çlirim. I premtova se pas çlirimit do të kthehesha jo më i internuar në Ustikë po "*libero*" (i lirë). Të njëjtën gjë bëra me familjen Grani. Edhe ata u trondítën dhe thanë se ndoshta nuk do të shiheshim më. U thashë: "Shumë shpejt, pas çlirimit të atdheut tim, do të kthehem në Romë, jo më në Rexhina Çeli, por në "*Via Marguta*" për të pirë një kafe.

As që më shkonte ndër mend se nuk do të takohesha më kurrë me ta.

Nga stacioni "Termini" u nisëm duke këndúar. Arritëm në Ostumi, se atje ishte kampi ku na prisnin. Aty gjetëm dhe shumë shokë të tjerë ish-të burgosur e të internuar, të plagosur. Prisnim të niseshim. Sipas marrëveshjes, ne duhej të ktheheshim të veshur dhe të armatosur. Më në fund, erdhi ora e nisjes. Na hipën në shumë kamionë ushtarakë që morën drejtimin e Tarantos. Dy vaporë shkarkimi (nga ata që përdoreshin për

zbarkime të shpejta të ushtrisë, të cilët hapen nga prapa si dyert e kështjellave mesjetare) ishin caktuar për riatdhesimin tonë. Unë isha i ngarkuar nga misioni ynë ushtarak në Bari si përgjegjës dhe komandanti aleat i të dy vaporëve do të merrej vesh me mua për çdo problem.

Pyetje: - Çfarë ndienit kur po largoheshit nga Italia dhe morët rrugën për në Atdhe?

Përgjigje: - Në Taranto patëm disa shqetësime: erdhën e më thirrën shokët e vaporit tjetër. Një oficer grek dhe një britanik, i cili dinte shqip, u flisnin kështu atyre që po ktheheshin: "Mos u ktheni tani për tani në Shqipëri, se atje ha njeriu njeriun. Ata që janë ortodoksë, janë grekë, prandaj është më mirë të zbarkojnë në Korfuz." Kur hyra, i dëgjova që villnin vrer kundër luftës çlirimtare, prandaj shkova menjëherë te komandanti anglez që ishte përgjegjës, dhe i fola: "Ju lutem, i nxirrni jashtë përpara se të ngjasë ndonjë gjakderdhje, sepse ne jemi edhe të armatosur." Komandanti erdhi menjëherë me ne dhe i dëgjoi ç'flisnin. I thirri dhe, pasi i qortoi ashpër, i nxori përjashta.

Shumica e shokëve që ktheheshin në atdhe, as që ua vinin veshin këtyre provokimeve. Ne që të gjithë një dëshirë kishim: të arrinim sa më parë në atdhe. Gëzimi ishte i papërmbajtur, kur më në fund u dha sinjali i nisjes drejt brigjeve tona.

Pranë meje kisha shumë shokë të mirë, të gatshëm për çdo sakrificë.

... Po kthehesha në Atdhe! Ishte thuajse e pabesueshme që ende isha gjallë. Që nga çasti kur u nisëm nga Taranto dhe deri sa pashë konturet e brigjeve tona në një agim tetori të vitit 1944, më parakaloi para syve gjithë jeta ime, përmes një furtune që s'njihte fashitje. "Kush më pret vallë? Çfarë ka ndodhur me njerëzit e shtëpisë sime, me të afërmit e mi, me fshatin tim?

Po afron dita e çlirimit. Ende luftohet. Ende derdhet

gjak. A do ta jetoj ditën e çlirimit? Mbas gjithë këtij kalvari të popullit tim dhe timin? Dhe në u vrafsha, s'ka gjë: do të shtrihem në tokën time dhe do të më qajnë me ligje njerëzit e mi. Do të mbetem aty, i vdekur ose i gjallë, për të mos u larguar kurrë më."

Dhe ja së fundi konturet e Maleve të Vetëtimës! Qielli ishte i hapur, por frynte një mistral i fortë dhe deti ishte i trazuar. Vaporët kaluan pranë ishullit Othonus, të cilin, kur isha i vogël, e shikoja përditë nga dritaret e shtëpisë sime, si dhe nga të gjitha këndet e fshatit tim. Natën shihja farin e tij. Dhe shumë herë kisha ëndërruar që të ndodhesha atje dhe që andej të shikoja se si dukej fshati im. Kaluam shumë pranë ishullit të shkretë. Fshati i vogël nuk dukej, se ishte nga lindja. Aty banonin shumë pak fshatarë, që ruanin bagëtinë. Kishte shumë lepuj, thoshin, dhe shumë minj.

Andej, peizazhi i maleve të Vetëtimës dhe i gjithë fshatrave të Himarës dukej si ireal: aq i bukur dhe fantastik ishte...

Pjesa e dytë

Petro Marko plak interviston Petro Markon plak

Shkruar në vitin 1991

Pyetje: - Pse e ndërpreve këtë intervistë me vetveten katërmbëdhjetë vjet më parë dhe po e vazhdon përsëri tani, në korrik 1991?

Përgjigje: - Ishte e pamundur ta shkruaja, se, edhe ta mendoja, ishte me rrezik jete...

Më kujtohen vitet tridhjetë: kisha vajtur në Korçë për të bërë një anketë për gazetën "Vatra", ku punoja. Kisha njohur Viti Shahinin (Afërdita), një shoqe shumë e mirë që studionte në Francë, ku pati njohur Halim Xhelon, i cili i jepte materiale për mua. (Ajo më vonë u martua me mikun tim të dashur Zef Mala, njeri shumë i kulturuar, themelues i grupit komunist të Shkodrës që më 1937.) Njoha dhe vëllanë e saj Ilo Shahinin, të cilit i mësova të këndonte "Internacionalen". Plaku Vangjel, i ati i Vitit dhe i Ilos, pyeti se ç'ishte kjo këngë. Ia shpjeguam dhe ai menjëherë thirri: "Aman, mos e mësoni, se, kur të shkoni në Tiranë, në hotel, mund ta këndoni në gjumë e pastaj na merr lumi!" Ja ç'frikë na kishte hyrë në palcë.

Tani do të më kuptoni dhe do të më jepni të drejtë pse unë nuk i shkrova ndërkohë kujtimet që nga ora kur zbrita në Himarë - tetor 1944 - me rreth 200 vullne-tarë të ardhur nga burgjet dhe internimet: sepse mund të më bëhej përsëri një kontroll i befasishëm dhe të m'i gjenin, siç ndodhi me mua më 1947 dhe më vonë me

djalin tim, që u arrestua më 1975. Do të rrezikoja veten dhe gjithë familjen time.

Dhe tani po rikthehem atje ku e lashë.

Nuk e përshkruaj dot çastin kur vaporët iu afruan bregut të Spilesë së Himarës. Shikoja shumë njerëz që na prisnin. Midis tyre një turmë skeletesh, të mbuluara kokë e këmbë me lecka, thërrisnin italisht *"portateci in Italia, vi preghiamo!"*[1] dhe u hodhën në det, por një krismë automatiku i trembi dhe unë dëgjova një zë që bërtiste: "Ose kthehuni, ose ju vrava." Ishte zëri i Minella Kolekës. U trondita dhe dola i pari, iu hodha në qafë, e përqafova dhe i thashë:

- Pse nuk i lë këta italianë të mjerë, të kthehen në Itali?

- Gjer tani, - më tha ai, - ne kemi riatdhesuar me mijëra e mijëra ushtarë italianë, të cilët i kanë mbajtur familjet shqiptare për t'i shpëtuar nga gjermanët. Vinte këtu gjenerali italian Azzo Azzi dhe i ngarkonte në vaporë. Tani kemi marrë urdhër që t'i grumbullojmë dhe pastaj t'i dërgojmë ne, qeveria jonë, në Itali.

Pyetje: - Kush ishte Minella Koleka?

Përgjigje: - Ishte një nga shokët më të mirë të asaj kohe. Patriot e revolucionar, shok i Halim Xhelos dhe i Omer Nishanit, kishte qenë burgosur dhe kishim qenë bashkë në burgun e Tiranës. Pastaj e shpunë në burgun e Vlorës dhe që andej u arratis dhe kaloi në ilegalitet. Me trimin Zaho Koka themeluan Çetën Plakë të Himarës. Ai ishte më i rëndësishëm, prandaj, kur u çlirua Jugu, në Himarë caktuan Minellën si kryetar të komitetit. Merre me mend se sa me mall flisnim me sytë të njomur nga lotët: ai më tregonte për luftën, për shokët e vrarë; unë i tregoja për vuajtjet në burgje dhe në ishujt e Italisë. Minella shtroi një drekë të madhe për ekuipazhin e të dy

1) Na çoni në Itali, ju lutemi.

vaporëve që na sollën, dhe ngritëm dolli për miqësinë e popujve të koalicionit antifashist.

Për ne që ktheheshim të gjallë në Shqipërinë që po çlirohej, po realizohej ëndrra e madhe.

Pyetje: - Po më pas?

Përgjigje: - Qëllimi ynë ishte të arrinim në Berat, ku ishte qeveria jonë demokratike. Dhe u nisëm të ngarkuar me armë e me arka. Arritëm në Dhërmi, ku na pritën me ngrohtësi të madhe.

Nxitoja nëpër gurë, mes ullinjve, në të përpjetën drejt shtëpisë sime. Më kishte marrë malli jo vetëm për motrën e vëllezërit, për tërë farefisin e bashkëfshatarët, por edhe për gurët e për drurët.

Pasi u takuam me lot e përmallim të madh, që u ktheva sërish gjallë, shtëpia filloi të mbushej me njerëz. Erdhi i tërë fshati. Plakat vajtonin tim atë, më puthnin e numëronin vuajtjet e mia e të familjes sime. Kthimi im ishte një gëzim, po gëzim i larë me lot. Pasi hëngrëm një kafshatë bukë, fshatarët i morën të gjithë të ardhurit dhe i shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre.

Kur mbeta vetëm me Lilon (që emrin e vërtetë e kishte Vasiliqi), nuk më la të flisja për vuajtjet e mia, se i dridhej buza, ngaqë më donte shumë, por filloi të më tregonte se çfarë kishte bërë ajo për luftën. Kishte pritur në shtëpinë e madhe e të varfër plot partizane, të cilave u vinte kazanin me ujë të ngrohtë e sapun, që të laheshin e të pastronin veshmbathjet nga morrat. Midis tyre kishte qenë edhe Xhevo Shehu e shoqja e Heroit të Popullit Abaz Shehu. Më tregonte këto, për të më dhënë një kënaqësi, që edhe ajo, me sa mundi, diçka bëri për luftën. Më tha se, kur ndihmonte partizanët, më kujtonte mua dhe e bënte për mua, që më shumë më mendonte të vdekur se të gjallë. Ndërkohë ishin rritur edhe fëmijët e Andonit, kurse vëllai i vogël, Agjisilla, që ishte martuar me një nuse të bukur e të mirë, kishte edhe ai fëmijë më të vegjël.

Në krahun tjetër të shtëpisë, te xhaxhai im Andrea Marko, i vrarë në hasmëri, edhe i biri i tij, Jani Marko, megjithëse kishte qenë kryeplak i fshatit në kohë të gjermanëve, i kishte ndihmuar shumë partizanët. Në maj të vitit 1944 dikush e vrau në pritë Janin, që la gruan me një vajzë e gjashtë djem jetimë. Kur u ndamë, më kishte siguruar se do të ishte në krah tim. Vrasja e tij mbeti një mister që nuk u sqarua kurrë. Të shtatë fëmijët e tij mbetën në skamje dhe i ndoqi tërë jetën si hije vdekja e babait. Mbetën të persekutuar.

U nisëm për në Berat. Ecnim të ngarkuar dhe të lumtur, se ishim në tokën tonë. Natën arritëm në Dukat. Kërkova Koço Kaporën, që e kisha timin, dhe ai, si kryetar këshilli, i ndau shokët nëpër familje. Na kishin thënë në Himarë që të kishim kujdes në Dukat, se aty ende kishte ballistë. Në shtëpinë e Koço Kaporës erdhi edhe paria e Dukatit, disa prej të cilëve i njihja. Folëm shumë dhe ata mallkonin kohën kur u arrestova unë, se nuk do të ishin gënjyer nga disa prijës ballistë, që thonin se gjoja ne ishim me amerikanët. Erdhi edhe trimi Maliq Koshena dhe më tha: "S'ta jap dorën, o Petro vëllai, se e kam me mut... Ç'e do, ike ti dhe ne u gabuam, se na gënjyen... Dukati nuk është tradhtar. Po të tregoj një episod: Partizanët kishin ngelur në qafë të Llogarait, se aty ishin gjermanët në istikam. Unë vajta me çetën time dhe me thika u hodhëm në istikamet gjermane, i asgjësuam dhe u thamë partizanëve: *kaloni tani, se gjermanët i asgjësuam!*" Maliq Koshena dhe patriotët e tjerë nuk i dinin mirë arsyet pse njerëz si Skënder Muçoja, si mik i Mithat Frashërit dhe mik i amerikanëve, ishin kundër Partisë: këta e dinin që Partinë e krijuan jugosllavët me anën e Dushanit dhe të Miladin Popoviçit. Këto i kuptuam më vonë...

Nga Dukati u nisëm për në Vlorë, ku unë takova shokët e vjetër, që u gëzuan pa masë, kur më panë. Ne

mburreshim se në Vlorë ishte shtypur trakti i parë kundër okupatorit, në shtëpinë e Ibrahim Shytit, i cili u burgos me gjithë familjen (një djalë i tij u vra në Prishtinë). Familja e patriotit Ibrahim Shyti është familja e parë që u persekutua dhe u shkatërrua nga okupatori, siç e kam treguar edhe në pjesën e parë.

Pyetje: - Po kur arritët në Berat?

Përgjigje: - Në Berat, duke ecur të shumtën e herës më këmbë, të ngarkuar, arritëm nga fundi i tetorit. E para gjë që duhej të bëja, ishte të paraqitesha në shtab. Kur hyra në zyrë, pashë Koçi Xoxen, me të cilin u përqafuam me lot në sy, se, kur më morën të lidhur për në Itali, Koçin e lashë në burgun e Tiranës. Ai më mëkonte me lugë, se unë isha me paratifo. Koçi ishte veshur me kilota dhe me një xhakavento alpine. Më tha:

- Ja, ky është shoku Enver Hoxha, sekretari i Partisë dhe kryetari i qeverisë demokratike.

Enveri më dha dorën me shumë mirësjellje dhe më tha:

- Koçin e kemi kolonën e Partisë. Ai është sekretari organizativ i Partisë.

Kisha bërë disa karakteristika të një pjese prej atyre 200 vetave që erdhën me ne nga Italia. Ato i mori Teodor Heba, që ishte aty sekretar. Të gjithë i shpërndanë në familje beratase; mua më caktuan në shtëpinë e Sallabandës, afër shtëpisë së Margarita Tutulanit, në Goricë. Kur u largova nga zyrat e qeverisë, që ishin në sarajet e Vrionasve, Koçi doli bashkë me mua dhe rrugës po bisedonim. Më tha: "S'kemi ç'bëjmë, o Petro! Na janë futur kontrabandë në Parti ca vagabondë dhe të poshtër." E pyeta se si ishte e mundur dhe cilët ishin ata. "Ja, p.sh., ai që pe ti, Enver Hoxha, një njeri i dyshimtë, më tepër nga ana politike, që nuk ka qenë më parë komunist. Se si arriti të jetë në krye të këtyre punëve, një zot e di!" Unë i thashë se nuk e njihja, por kisha dëgjuar për të që në Francë, dhe se duhej parë çështja e këtyre lloj njerëzve në parti.

Shkova te zyrat ku ishte Sejfulla Malëshova. U gëzua shumë kur më pa; atë në Grënobël e kisha lënë në dhomën time, një dhomë që në dimër duhej të hapej dritarja për të hyrë ajri dimëror, se në atë qytet të ftohtë alpin brenda bënte më ftohtë se përjashta. Sejfullai më mori për krahu dhe shëtitëm deri tek ura poshtë qytetit. I fola shumë i tronditur për ato që më tregoi Koçi për Enverin. Ai më pa në sy dhe më tha: "Dëgjomë mirë! Ti ke milituar në partinë spanjolle, në partinë franceze, në partinë italiane... Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh. Ndaj më dëgjo mirë: nuk duhet të hapësh gojën të paktën një vit për ato që sheh dhe dëgjon. Përndryshe do ta pësosh..."

Më 17 nëntor krisën bataretë: Erdhi lajmi se Mehmet Shehu me Brigadën e Parë dhe disa të tjera kishin çliruar Tiranën. Gëzim i paparë. Entuziazëm i papërmbajtur. Tirana u çlirua. Shqipëria u çlirua.

Pyetje: - Po ti nuk merrje gjë vesh për prapaskenat që luheshin?

Përgjigje: - Mua më shpëtoi Sejfullai, se Koçi ende vazhdonte avazin kundër Enverit. Më thoshte se shumë herë e këshillonte Miladini që të mos ngriheshin probleme të tilla, se ende nuk kishte ardhur koha e përshtatshme. U nisëm për në Tiranë.

Pyetje: - Si u nisët?

Përgjigje: - Grupe-grupe. Gjersa arritëm në Tiranë dhe u vendosëm në hotel "Dajti".

Hanim e flinim në hotel "Dajti". Unë isha në një dhomë me Petro Kitën. Kërkova Mehmetin dhe e gjeta në shtab, po e rruante një ushtar. U përqafuam të përmalluar dhe më tha spanjisht: "*La Republica a trionfado. Viva la Republica Demokratica Albanes*!" Të nesërmen, më 28 Nëntor 1944, do të parakalonin fitimtarët. U ngrit një tribunë para hotel "Dajtit". Në

tribunë hipa edhe unë, në këndin e majtë, nga do të vinin për të parakaluar fitimtarët. Më tërhoqi vëmendjen një zë diku poshtë tribunës. Hodha sytë dhe ç'të shihja?! Një bashkëfshatari im bënte rojë me armë në dorë, në këndin e tribunës. Ishte veshur partizan dhe tundte pushkën në shenjë fitoreje. Po kush ishte ky? Një kryekusar. E lashë në burgun e Tiranës në marsin e vitit 1942, kur më nisën për në Itali. Në burg ishte shumë i sëmurë dhe u kujdesa për të sa munda aty, bashkë me kolektivin e shokëve. U habita: "Paska qenë partizan dhe i bëka rojë udhëheqjes së qeverisë nën tribunë!" - Filloi parakalimi madhështor, gjithë Tirana ishte shkulur për të parë se kush ishte Enver Hoxha, kryetari i Qeverisë, se asnjëherë nuk ia kishin dëgjuar emrin. Në atë kohë si luftëtar i dëgjuar për çlirimin e atdheut njihej Mehmet Shehu. "Po nga doli ky Enver Hoxha, cili është?" - pyesnin turmat e dehura nga gëzimi që më së fundi u çliruan nga okupatorët dhe tradhtarët. Ishte një parakalim që të ngulitet në kujtesë sa të jetë jeta: parakalonin vajzat dhe djemtë partizanë me flamurin tonë në krye, të grisur, të zbathur, të parruar, por me kokën lart e armët në sup. Fitorja u shkëlqente në ballë. Njerëzit brohoritnin nga gëzimi dhe nuk mbanin dot lotët nga mallëngjimi.

Pyetje: - Si rrodhën ngjarjet?

Përgjigje: - Unë iu luta Koçit dhe Mehmetit që të më lejonin të shkoja me Brigadën e Parë, se desha të merrja pjesë edhe unë në luftën tonë siç pata ëndërruar. Ata e pranuan kërkesën time. Në Tiranë, nga ata që solla nga Italia, mbajtën vetëm Nexhmedin Zajmin, si piktor. Të tjerët u inkuadruan në Brigadën e Gjashtë dhe të Shtatë dhe shumica u vranë në tokat e Jugosllavisë, duke ndjekur gjermanët gjer në Sanxhak.

Mua më mbajtën në Shkodër për të botuar Buletinin e Korparmatës së Tretë. Flija në shtëpinë e Nush Topallit, ku merrja lajmet me radio dhe përgatitja lëndën te "Jeta

e re", ku bashkëpunoi dhe Vehbi Bala e të tjerë. Shkodra ishte në festë të madhe. Nuk ka qytet në Shqipëri që t'i ketë pritur aq mirë partizanët si Shkodra. Çdo familje e kishte për nder të mbante një partizan me gjithë të mirat. Familja e Nush Topallit më ka mbajtur si bir të saj, shumë familje bujare, patriote dhe fisnike. Mirëpo në Shkodër, siç duket me ndikimin e malazezëve, nisi ndjekja kundër katolikëve. Kishin ardhur shumë podgoriçanë dhe ata ishin thuajse shumica. Nisi rrëmbimi i mallrave, zbrazja e dyqaneve nga jugosllavët. Shkodranët ishin tmerruar dhe prisnin se çdo të bënte qeveria shqiptare: a do t'ua ndalonte sllavëve rrëmbimin e mallrave, zbrazjen e dyqaneve?

Pyetje: - Pse jugosllavët i zbraznin dyqanet dhe magazinat e Shkodrës?

Përgjigje: - Do të them të drejtën: gjykimi i çdo veprimi duhet bërë sipas kohës kur është kryer. Ne, si antifashistë dhe internacionalistë, ishim shumë lealë, shumë të sinqertë dhe për veprimet e jugosllavëve, megjithëse na ngacmonin me shumë dyshime dhe pikëpyetje, nuk shpreheshim, se besonim shumë tek ideali i përbashkët. Kurrë nuk na shkonte ndër mend se një parti e majtë mund të vepronte me djallëzi. Mua më thoshin disa shokë e miq shkodranë, katolikë e myslimanë: "Druzhet po na plaçkitin dhe ne i bëjmë sehir." Dua të shënoj këtu dhe një bisedë që pata pas një viti me Nako Spirun, ministër i Ekonomisë: "Ne kemi aq mall dhe materiale të çdo kategorie, sa për dhjetë vjet s'kemi nevojë të importojmë asgjë", - më tha. Edhe Nush Topalli, një njeri me mend dhe i ndershëm, një mbrëmje, duke ngrënë bukë në shtëpinë e tij, më pyeti me druajtje:

- Më falni, zoti Petro. Unë e di që ju jeni një patriot i ndershëm, dhe dua t'ju bëj një pyetje. A më lejoni?

- Unë ha bukën e një vëllai shqiptar, - iu përgjigja, - si të mos kem besim dhe respekt për të? Ç'doni të më thoni?

Ai më pyeti:

- Pse, zoti Petro, sllavët po na zhveshin? Të paktën të marrin një pjesë e një pjesë ta mbajmë dhe ne, se ku t'i gjejmë tërë këto mallra të çdo kategorie: që nga lënda e ndërtimit, te manifaktura, te makineritë, te pijet, madje deri te furçat e nevojtoreve?! Më vjen keq, vërtet miku është mik, po duhet t'i japim ne atë që kërkon, dhe jo t'i hapë ai vetë depot, magazinat, dyqanet... dhe t'i zbrazë pa na thënë as faleminderës! Unë e kuptoj këtë, zoti Petro. I shoh të gjitha dhe hesht, se, po hapa gojën, burgu më pret...

Nuk e kuptoja këtë veprim zhvatës pa skrupull nga ana e druzheve...

Të gjithë katolikët shiheshin me sy të keq, madje nisi dhe arrestimi i tyre.

Pyetje: - Ç'të ka mbetur në kujtesë nga Shkodra?

Përgjigje: - Kujtimet më të mira, por edhe hidhërimet më të thella.

Ato ditë kishte ardhur në Shkodër Hysni Kapoja, shoku dhe miku im qysh në fëmijëri. Ishte komisar i Korparmatës së Tretë. Desha t'i kallëzoja ato që shihja në Shkodër, por m'u kujtuan fjalët e Sejfulla Malëshovës në Berat: "Dëgjo e shiko, por mos hap gojën një vit". Atë natë më kishte thirrur për darkë një dentist kosovar. Pyeta një shok që ishte i sigurimit, dhe ai më tha se mund të shkoja. Kur vajta te familja e mjekut, pashë aty si fantazmë Babushin - Bedri Pejanin; m'u duk sikur m'u fanit në ëndërr. Më përqafoi me lot në sy. U çmallëm, se kishim pa u parë që në Paris, më 1939. Ndenjëm gjithë natën pa fjetur, se ai më tregonte gjëra të pabesueshme: terrorin e madh serb në Kosovë e Metohi, poshtërsitë dhe krimet e stilit hitlerian të bëra nga Rankoviçi e Mihailloviçi. Unë u habita shumë për ato bëma çnjerëzore. Dhe ai më tregoi se si Partia Komuniste Shqiptare ishte krijuar nga agjentët e Titos, Dushani dhe Miladini. Babushit i ishte dashur të organizonte Lidhjen

e Dytë të Prizrenit dhe të pranonte të bëhej prefekt i Pejës, duke u justifikuar me thënien e Hasan Prishtinës: Edhe me djallin do të bëhem aleat e ortak, vetëm Kosova të çlirohet e të bashkohet me nënën Shqipëri...

Në mëngjes do të nisesha për në Tiranë me Hysniun, se ai kishte ardhur që të më merrte për të botuar gazetën "BASHKIMI"... Unë i kundërshtova, po ai, si shok i dashur, më bindi duke më thënë se isha gazetar dhe shokët e kishin ngarkuar të më merrte me vete. I thashë se unë kisha një shok të vjetër, Babushin, për të cilin i fola shumë. Ai më tha që ta merrnim me vete në Tiranë. Dhe gjatë gjithë rrugës Shkodër-Tiranë, Babushi fliste për situatën në Kosovë dhe për tradhtinë tonë ndaj kosovarëve. Kur arritëm në Tiranë, Hysniu i tha Babushit: "Të gjitha këto që na kallëzove, i shkruaj dhe jepja Petros." Dhe u ndamë. Babushin e shpura në shtëpinë e Abdurrahmanit, dhëndrit të tij. E pritën të habitur dhe shumë të emocionuar. Babushi pas një jave më dërgoi me vajzën e tij një "Promemorie" ku shkruante ato që na kishte treguar gjatë udhëtimit Shkodër-Tiranë. Ishin 13 faqe të daktilografuara. I kopjova. Kopjen e mbajta unë, origjinalin ia dërgova Hysniut. Nuk e gjej dot kopjen, se jam bastisur dy herë nga sigurimi: herën e parë kur u arrestova unë, dhe herën e dytë kur u arrestua djali. Nuk më lanë dorëshkrime, poezi, romane, letra, gazeta të vjetra e të tjera pa më marrë. Por do të përpiqem të them thelbin e atyre që na rrëfente Babushi që nga Shkodra e deri në Tiranë, të cilat i përmblodhi në promemorien që unë ia dorëzova Hysni Kapos.

"... Ju keni bërë një krim fatal jo vetëm për Kosovën, por edhe për gjithë Shqipërinë. Ratë në grackën e Titos. Ai me Miladinët, me Vukmanoviç Tempot, dhe veçanërisht me udhëheqjen e Partisë suaj që e drejtojnë serbët, i dhatë fund pavarësisë sonë. Në mos vënçin dorë aleatët e mëdhenj, s'ka Shqipëri më, por një bijë të bindur

të Federatës së Titos. Titoja ia mbushi mendjen Stalinit që të mos pranohej ideja e Dimitrovit për krijimin e një Federate Socialiste Ballkanike ku, aty ku flitej serbishtja, të ishte Republika Serbe, aty ku flitej shqipja, të quhej Republika Shqiptare, aty ku flitej bullgarishtja, Republika Bullgare e kështu me radhë për të gjithë popujt e Ballkanit, se Ballkani jetoi afro pesëqind vjet nën të njëjtin sundim otoman, me të njëjtat kanune e zakone. Popujt e Ballkanit nuk mund t'i ndash prerazi në kufij, se ata kanë lëvizur gjatë pesë shekujve duke e bërë Ballkanin një vend ku nuk mund të gjesh vetëm një popull brenda një kufiri. Por këtë ide nuk e pëlqeu mareshali Tito, madje edhe Stalini, se, po të bëhej Ballkani një federatë socialiste, do ta kalonte shumë Bashkimin Sovjetik të prapambetur, kështu që Stalini nuk donte të ishte despot i një populli të prapambetur. Edhe politikanët anglo--amerikanë nuk e përkrahën këtë mendim të Dimitrovit. Ata gjatë Luftës së Dytë Botërore ngritën dy figura: në perëndim De Golin dhe në lindje mareshalin Tito, i cili pretendonte të bëhej mareshal i gjithë Ballkanit, sipas dëshirës së Çurçillit, djali i të cilit qëndronte gjatë Luftës pranë Titos. Por ja që Titoja nuk u bë dot mareshal i gjithë Ballkanit, por u bë i Shqipërisë. E vërteta është se Stalini i kishte thënë që ta inkuadronte edhe Shqipërinë si republikë të shtatë, por Titoja i zgjuar nuk e pranoi, duke thënë se shqiptarët nuk janë sllavë dhe se... janë xhelozë për pavarësinë e tyre. Këtë e tha, se, po të bashko-hej Shqipëria si republikë e shtatë, do të ishte republika më e madhe, më e pasur, më e fortë, se do të bashkohej edhe Kosova në këtë republikë të shtatë."

Babushi pretendonte se ishte dakord me idenë e Dimitrovit, por, pasi e pa si veproi Titoja me agjentët e tij në Shqipëri, ishte më se i sigurt se Shqipëria tashmë ishte e Titos. Tragjedinë e Kosovës - thoshte Babushi - e shkaktuam ne, se ishim servilë, frikacakë dhe shërbëtorë

besnikë të Titos, i cili kishte këtu agjentët e tij të famshëm, Miladinin dhe Dushanin, të cilët krijuan një parti sipas planeve të tyre. "Sot na vjen turp të themi se një popull me njerëz të zgjuar dhe patriotë i ra në gjunjë një Miladini, i cili e krijoi Partinë ashtu siç deshi vetë Titoja. U përpoqëm dhe krijuam Lidhjen e Dytë të Prizrenit, kryetar më caktuan mua. U bëra dhe prefekti i Pejës. Edhe i shkreti Emrush Myftari, luftëtar trim edhe në Spanjë, krijoi një çetë për të mbrojtur nga serbët dhe çetnikët popullin shqiptar. Madje ai erdhi në Shqipëri, me një thes plot me duar dhe koka të prera fëmijësh të vegjël shqiptarë, i solli në Tiranë dhe, në shtëpinë e Esat Dishnicës, thirri Enver Hoxhën dhe Nako Spirun, zbrazi thesin me koka e duar fëmijësh kosovarë dhe u tha: "Ja se ç'bëjnë druzhet tuaj që i mbani në krahë!" Pastaj Emrushi doli në Tiranë, pa dy kryeçetnikë, i ndoqi dhe i vrau të dy para Bankës Kombëtare."

Mbaj mend se në fund të promemories thoshte: "Hapni sytë e qëroni këlyshët e Titos, përndryshe nuk ka as Shqipëri e as Kosovë!"

Pyetje: - Po pastaj ç'ngjau me Babushin?

Përgjigje: - Pas disa kohësh, Babushin ua dorëzuan jugosllavëve, të cilët e burgosën. Ky shkroi dy letra: njërën për Dimitrovin, tjetrën për Kolarovin. Para se të vinte përgjigjja e tyre, ata të burgut e helmuan. Ky ishte fundi i njërit nga bijtë më të shquar të Kosovës e të Shqipërisë, i shokut të Fan Nolit, të Hasan Prishtinës, të Bajram Currit dhe i të gjithë revolucionarëve dhe patriotëve shqiptarë.

Pyetje: - Thonë se gjatë jetës së tij ka dhe shumë qyfyre! A di ndonjë nga ato?

Përgjigje: - Ishte djalli vetë. Fan Noli e mori në qafë me dy vargje që i thuri në parlament: "Populllorja brigje--brigje/, Digje, o Bedri Peja, digje." Me Nolin puqeshin shumë në humor dhe në çapkënllëqe. Babushi tregonte

se si një ditë, kur shkoi të rruhej në Berlin, hyri në berberanë, që ishte e ndarë në dhoma të vogla dhe ku çdo klient futej në një dhomëz. U fut edhe Babushi në një dhomëz dhe berberi e mbylli derën. Pastaj, sapo Babushi u ul në fron, berberi shkeli me këmbë një sustë dhe froni i Babushit u përmbys, u hap nën të një kamare e madhe, ku do të binte Babushi, po ky menjëherë hapi duar e këmbë, thirri me të madhe shumë herë, gjersa u hap porta dhe erdhën e ngritën. Babushi shpëtoi për mrekulli, se ajo berberanë ishte një kasaphanë, ku klientët i përmbysnin poshtë, u merrnin paratë dhe ç'kishin e nuk kishin dhe ata që ishin të shëndoshë si Babushi, i thernin dhe i bënin mortadel. Kur ia tregonte Nolit këto Babushi, Noli dhe shokët e tjerë që ishin aty, u shkulën së qeshuri, pastaj Noli tha: "Do të të kishim ngrënë si mortadel!"

Pyetje: - Kur erdhe në Tiranë, ku u vendose?

Përgjigje: - Unë shkova në hotel "Dajti", ku gjeta shumë shokë. Aty u vendosa, si gjithë shokët e tjerë; paguante Ministria e Kulturës. Që të nesërmen shkova te shokët e Shtabit, ku gjeta edhe Koçin. Enveri më tha se "duhet botuar sa më parë gazeta "Bashkimi", prandaj dhe të thirrëm të vije."

Pranova me një kusht: Kërkova që shokët Enver, Sejfulla, Omer Nishani, Nako Spiru, Ymer Dishnica të më jepnin nga një kryeartikull secili, një herë në javë. Të tjerat do t'i bëja vetë. Më thanë të merrja kë të doja dhe të kërkoja çdo gjë, vetëm gazeta të dilte sa më parë! "Brenda këtyre ditëve!" - u thashë dhe fillova nga puna. Kërkova Rebi Alikajn dhe shkova në shtypshkronjën "Bashkimi". Aty gjeta cinkografin Nexhdet Kosturi dhe i thashë se duhej të botonim sa më parë gazetën "Bashkimi". Ai, nuk e di se me kë, bëri testatën "Bashkimi", të cilën e miratuam dhe pastaj menjëherë ai e stampoi. Në cinkografinë e tij vendosa një radio që e mora nga Shko-

dra, nga depot që zbraznin jugosllavët. Para Vitit të Ri, nisa botimin e "Bashkimit". Kisha si korrektor Nuçi Priftin e shkretë, që vdiq pas ca kohe. Thirra aty dhe Reshat Again që e njihja që në rini, të më merrte lajmet si stenograf i mirë që ishte; pak nga pak po vinin edhe shokë të tjerë që të bashkëpunonin, si Remzi Xheneti e të tjerë që vinin e shkonin, si Kolë Jakova, Mark Gurakuqi, Vebi Bala, Jusuf Alibali, Enver Fico, por nuk qëndronin. Për fat të mirë, tipografët ishin italianë, faqosësi italian dhe ai i rrotativës italian. Ata punonin shumë, me kujdes e me cilësi, prandaj edhe unë u sigurova nga një litër qumësht çdo mëngjes dhe të shtunave, sapo hidhej gazeta në flan, u kisha caktuar dyqind franga që t'ia shtronin me se të donin.

Kërkoja zyrë. Më thanë të futesha në një ndërtesë aty pranë, por unë shkova dhe zgjodha në bulevard një ndërtesë të mirë ku italianët kishin zyrat e tyre të siderurgjisë. Mora katin e dytë, gjersa ata të iknin, pastaj do të merrja edhe katet e tjera. Më erdhën në gazetë publicistë të rinj, si Astrit Delvina, Mustafa Grebllleshi, Osman Bishqemi, të cilët i aktivizova si reporterë dhe ishin të mirë. Më vonë erdhën dhe Mustafa Xhaxhiu e Raif Hasani.

Pyetje: - A ishe i kënaqur nga gazeta?

Përgjigje: - Ne vazhdonim traditat e shtypit tonë demokratik, traditat e "Bashkimit" të vjetër, të "Lirisë kombëtare", të "Diellit" e të tjera. Unë punoja 20 orë, se duhej parë lënda: pa agjenci telegrafike, pa korrespondentë, pa letër për gazetën, pa naftë për të vënë në lëvizje makinerinë e shtypshkronjës (ishte Sinan Gjoni përgjegjësi i stabilimentit, i cili na prokuronte naftë). Gazeta e mbante në korrent lexuesin me zhvillimet e luftës, e cila po shkonte drejt shkatërrimit të Gjermanisë hitleriane. Një pjesë e njerëzve prisnin zbarkimin e anglo-amerikanëve, prandaj dhe u morën në qafë. Filluan

arrestimet e kuislingëve që kishin mbetur, se shumica, duke pritur anglo-amerikanët, u mblodhën në Shkodër e së andejmi, nga Ulqini, ikën për në Itali.

Pyetje: - Po ti ku banoje?

Përgjigje: - Kur erdha nga Italia me vullnetarët, këtu në Tiranë mbajta Novruz Nivicën, se ishte i zoti i punës. Bedri Spahiu e caktoi si përgjegjës të plaçkave që u sekuestroheshin ish-funksionarëve (orendi, pajisje shtëpie, mobilie e të tjera); shkonin shokët e ardhur nga lufta dhe merrnin me autorizim çfarë u duhej për të pajisur banesat e tyre.

Mua më caktuan vilën e ushtarakut të lartë Aqif Përmeti, në bllokun e autoriteteve të mëparshme. Ishte natë janari, kur shkova bashkë me shoferin. Hyra brenda dhe në kuzhinë ishte e gjithë familja. Aqif Përmeti qe arrestuar. U trembën, e kuptova që më shikonin të tmerruar. Më pyeti e zonja e shtëpisë nëse kisha ngrënë bukë. I thashë po. Atëherë më bëri një kafe. Dhe filluam të bisedonim qetë. E kuptuan se nuk isha i egër. Më pyeti zonja Përmeti nëse desha të flija dhe më tha nëse mund të qëndronin aty edhe disa ditë, gjersa të shkonin në Durrës. Më pyeti dhe nëse kishin të drejtë të merrnin ndonjë plaçkë, apo të iknin me ato që kishin veshur. Të them të drejtën, aty e kuptova gjendjen e tmerrshme dhe të zezën që po na kanosej.

- Zonjë, unë sonte duhet të fle këtu, se shoferi iku. Mund të fle në sallonin e pritjes, me ndonjë mbulesë.

- Ku të dëshironi! Shtëpia dhe të gjitha ç'ka brenda, janë tuajat, kështu na kanë thënë.

- Dëgjo, zonjë! - të gjithë më shikonin pak të çliruar nga tmerri. Vajza, djali, nusja. .. më shikonin tani me sy njeriu. - Dëgjo, zonjë. Ju të vini në derë një shkrim me këto fjalë: "Këtu banon Petro Marko", - se nuk do të qëndroj këtu. (Nuk thashë ato që mendoja: i zoti i shtëpisë ende nuk është gjykuar; shtëpia është juaja, mos kini

frikë.) Në mëngjes zonja më solli një kafe dhe më pyeti nëse do ta haja mëngjesin aty. I përshëndeta dhe ika. Nuk e di se cili e zuri atë vilë.

Koçit, me të cilin kisha lidhje dhe shoqëri, i thashë se këto mënyra veprimi që kishin nisur, do të ndikonin negativisht në besimin e popullit. Ai kishte zënë një vilë përballë vilës që kishte zënë Enveri, dhe vilës ku banonte Mehmeti. Të tre më të fuqishmit u vendosën afër njëri--tjetrit.

Më caktuan banesën e Andon Beçës, karshi bibliotekës së vjetër. Kur shkova aty, gjeta një zonjë të gjatë; ajo ishte franceze dhe qe martuar me djalin e Andonit, Nikon, që kishte studiuar në Francë. Nikoja kishte një magazinë në bulevardin e madh, pranë ndërtesës së "Bashkimit". Zonja e dinte që shtëpia me të gjitha mobiliet ishte caktuar për mua. Erdhi edhe i shoqi, Nikoja. U njohëm. Më bënë një kafe. Flisnin me frikë, sidomos francezja. Unë e kuptova dhe u thashë:

- Dua vetëm një dhomë për të fjetur dhe asgjë tjetër!

- Po, zoti Petro, na thanë që të dalim këtej vetëm me rrobat që kemi veshur, se të gjitha janë tuajat! - Flisnim frëngjisht.

Pimë kafen dhe pastaj nga një liker. Unë ua përsërita:

- Vetëm një dhomë ku të fle, dua. Asgjë tjetër s'është imja, të gjitha janë tuajat.

Ata u habitën. Shkoja natën, shumë vonë, atëherë kur mbaroja punë me gazetën. Një natë, shumë vonë, si zakonisht, kur hyra në korridor, dëgjova zëra. S'po kuptoja ç'po ndodhte aty në këtë orë. "Ndoshta kanë ndonjë davet", - mendova dhe u futa brenda. Ç'të shihja? Gjashtë kumarxhinj luanin kumar. Njoha njërin prej tyre, që ishte i famshëm. Dyshemeja qe plot me shishe të zbrazura. Nuk doja të ulesha, dola dhe u futa në dhomën time. Pas pak dëgjova një trokitje të lehtë. Hyri francezja me lot në sy, më foli frëngjisht dhe më tha se Nikon e zhvatnin

ata profesionistë kumarxhinj. "Ka humbur gjer tani 10 000 napolona flori dhe tani më kërkoi edhe stolitë e fundit dhe xhevahiret që më ka falur vjehrri". I thashë të mos qante. U ktheva përsëri në dhomën e fundit, ku luhej kumar: "Më falni, - u thashë, - unë jam gazetar dhe njeri i këtij pushteti. Nxirrni të dhjetë mijë napolonat dhe ato stolitë dhe xhevahiret, që të mos përfundoni keq. Paratë i lini aty mbi tryezë", - dhe dola. U futa në dhomën time dhe mbaja vesh ç'bëhej. Dëgjoja thirrje dhe sharje, pastaj ndjeva të dilnin me radhë një nga një duke kaluar para derës së dhomës sime, që ishte pranë shkallës. Pas pak trokitën tek unë. Zonja, me lot në sy, më përqafoi dhe mallkonte burrin e saj, të cilin e rropën kumarxhinjtë profesionistë. Pas pak, erdhi dhe Nikoja dhe më tha që të dhjetë mijë napolonat t'ia jepja qeverisë. Stolitë dhe xhevahiret i mbajti e shoqja.

Të nesërmen, para se të shkoja në zyrë, kalova nga Koçi dhe i dorëzova një çantë të rëndë me napolona flori. I shpjegova si kishin rrjedhur ngjarjet dhe ai, duke qeshur, më tha: "Duhet të bëhesh ti ministër i Brendshëm dhe jo unë..." Folëm për matrapazët, për kumarxhinjtë, për vigjilencën. Po ishte fillimi dhe nuk dihej se nga duhej filluar shërimi i plagëve që kishte lënë sistemi shoqëror që e kishte humbur davanë, por që ende shpresonte se ne i kishim ditët e numëruara dhe se do të zbarkonin anglo-amerikanët.

Pyetje: - A mund të na përshkruash situatën e ditëve, muajve, viteve të para të çlirimit?

Përgjigje: - Kanë kaluar afro dyzet e shtatë vjet qysh atëherë, por unë pata mundësinë që, si gazetar që isha, të shkruaja aq sa mundja për atë situatë dhe këto të mbeteshin në shiritin e kohës, që regjistronin shkrimet e gazetës. Unë, darkave, kur gazeta thuajse ishte plotësuar me materiale, aty për aty, shkruaja rubrikën time "Një orë në Tiranë". Kapja një ngjarje të ditës dhe,

duke shkruar aty pranë linotipit, ia jepja pjesë-pjesë linotipistit. E vërteta është se pas çlirimit Tirana kishte bollëk: për të ngrënë, për të pirë, për të veshur ishte si asnjëherë. Tregtia private konkurronte. Shkruante mirë në një artikull të botuar te "Bashkimi" Sejfulla Malëshova: "Ne duhet t'u jemi mirënjohës tregtarëve tanë, të cilët, me rrezik koke, kalonin Adriatikun me vaporë plot me mallra, që e mbushën Shqipërinë. Ata rrezikonin kokën, se nëndetëset aleate ishin kudo dhe, kur shikonin vaporë italianë, i torpilonin dhe i mbytnin. Në vend që t'i falënderojmë, - shkruante Sejfullai, - ne i dënojmë si kapitalistë, kulakë, spekulantë ose i burgosim dhe ua marrim dhe mallin. Merrni për shembull një tregtar nga Durrësi, Vangjel Manushin, i cili edhe me qerre i sjell patatet nga Korça, kurse ne, si qeveri, që kemi gjithë ato automjete, nuk begenisim të furnizojmë popullin." Ai i kritikonte masat që po merreshin, se ai vinte nga Bashkimi Sovjetik, ku kishte parë dhe jetuar mjerimin në të cilin ishte zhytur populli me masat që mori Stalini.

Me sa kam mundur, e kam përshkruar në gazetë jetën e viteve të para gjer më 1947. Sejfullai, që vinte shpesh në redaksi dhe shtrihej në divanin e zyrës sime, më thoshte pak a shumë: "I madhi (Enveri) bën ç'i thonë jugosllavët, të cilët, përveç që na rrjepin, por edhe na diktojnë ligjet e tyre antishqiptare..." Më shikonte me ata sy të zgjuar dhe njerëzorë dhe më thoshte: "Kujdes... se po krijohet një situatë e rrezikshme për ne..." Dhe me të vërtetë ajo situatë erdhi.

Unë i shpreha mendimin që të nxirrnim dhe një fletë satirike, si hor-teks i "Bashkimit", një herë ose dy herë në muaj, se ne, te "Bashkimi" kishim një rubrikë "Qesh e ngjesh" dhe kishte shokë si Nonda Bulka, Zihni Sako, Mark Gurakuqi e të tjerë që e mbanin atë rubrikë të përditshme. Ai pranoi, pranoi që ta quanim "Hosteni", si vazhdim i traditës së shtypit tonë të mëparshëm satirik:

"Purteka", "Dajaku", "Shkopi", "Shufra". Në fillim nuk qe dakord t'ia vinim emrin "Hosteni", "se ne synojmë të bëhemi një shtet industrial, - thoshte, - dhe jo vetëm bujqësor". Por pastaj pranoi, se "Hosteni" vetëm shponte, nxitte për punë. Kështu, filluam të botonim "Hostenin". Testatën dhe karikaturat i bënte shoqja ime Safo, e cila në fillim nuk deshi se "unë dua të pikturoj, - thoshte, - dhe jo të bëj karikatura..." Më vonë morëm karikaturistë të tjerë, si Fadil Pullumbin, gjersa mbajtëm Zef Bumçin, një karikaturist shumë i talentuar.

Besoj se s'ka vend të flas shumë për "Bashkimin", gjersa unë i kam përshkruar pak a shumë hapat e parë të ecjes së republikës sonë në atë gazetë. Kudo populli thërriste Enver-Tito, dhe ne vetë, me Enverin në krye, thoshim dhe shkruanim se pa Titon nuk do të ishim çliruar. Kudo vareshin flamuj të gjatë jugosllavë bashkë me flamurin tonë. Shumë herë flamujt jugosllavë merrnin flakë, digjeshin nga njerëz të panjohur. Nëpër mure shkruheshin parulla kundër Titos. Thoshin se rruga për në Moskë, kalonte nga Beogradi.

Në zyrë më vinin shpeshherë shokë të vjetër, si Zef Mala, që punonte në bibliotekë, bashkë me Minella Kolekën, që edhe ai punonte në bibliotekë. Flisnim ashtu siç mendonim, se ishim shokë të vjetër dhe besnikë ndaj njëri-tjetrit. Vinte aty dhe Hasan Reçi, Koço Boshnjaku e shokë të tjerë që nuk po e duronin dot pushtimin e Shqipërisë nga Titoja.

Pyetje: - Pse, pushtim e quanit ju "vëllazërimin" me popujt e Jugosllavisë?

Përgjigje: - Unë këtë, shumë vjet pas çlirimit, ia shpreha dhe Torezit, sekretarit të partisë franceze, i cili kishte ardhur këtu për pushime.

Ishim në Pogradec, unë dhe familja ime. Unë me vajzën time të vogël Arianita ishim përballë shtëpisë së pushimit të kuadrove. Rrinim buzë liqenit me kallamin

në dorë, kur dikush më zuri sytë dhe unë i fola të më linte, se do të më shpëtonte peshku që kishte rënë në grep. Ktheva kokën dhe njoha Torezin. U habita. U ngrita dhe e përqafova. Unë e njihja atë, se e kisha parë në Francë, ku isha anëtar i partisë, e kisha parë edhe një herë në Albacete të Spanjës. Puthi vajzën time të vogël, e cila i fali peshkun që zumë, dhe shkuam pak më lart, para shtëpisë së pushimit, ku ishin ulur shumë veta, midis të cilëve Zhaneta, një franceze me gjithë të shoqin dhe djalin e tyre, Gogo Nushi, Rita Marko, Behar Shtylla, Javer Malo e shokë të tjerë francezë. (Kam një fotografi të asaj dite.) Filluam të bisedonim dhe aty dëgjova për herë të parë se gjatë luftës antifashiste në Spanjë ai ishte i ngarkuar nga Kominterni që armët sovjetike t'i sillte në Spanjë me një brigadë trimash marinarë francezë, nga Murmansku, në Asturia. Unë i thashë se e kisha dëgjuar disa herë të fliste në Francë, dhe se i mbaja mend ato që kishte thënë. Po fjalimi më i fortë ishte ai që mbajti në Shamberi, pranë kufirit me Italinë, ku midis të tjerash tha: "*E bien, monsieur Mussolini, l'Europe d'aujourd'hui est fasciste! Europe du demain sera comuniste!*[1]" Ai fliste mirë për Stalinin. Pastaj më pyeti:

- Pse e keni prishur me Titon?

Unë i thashë:

- Ja, pyet këta shokët e byrosë, që i dinë të gjitha.

- Jo! - tha ai, - Unë e dua prej teje, prej një vullnetari të lirisë, të më thuash të vërtetën.

Gogoja ma bëri me shenjë që të flisja. Dhe unë fillova:

- Shqipëria është pushtuar disa herë. Italia, për të na hedhur hi syve, e mbushi Shqipërinë me gjithë të mirat. Erdhi Greqia gjatë Luftës Italo-greke dhe ia desh puna që Jugun tonë ta mbushte me të mira. Erdhën gjermanët dhe nuk na morën asgjë, përveç njerëzve tanë

1) Mirë pra, zoti Musolini, Evropa e sotme është fashiste. Evropa e nesërme do të jetë komuniste.

që i shpunë në kampet e shfarosjes në Gjermani dhe Austri. Tani, shoku Torez, të flasim të drejtën: besoëni se pushtimi më i egër ka qenë dhe mbetet pushtimi nga jugosllavët. Ata erdhën këtu dhe na plaçkitën. Shqipëria ishte një depo e madhe e stërmbushur me materiale që solli Italia dhe tregtarët shqiptarë, sa për vite të tëra nuk kishim nevojë të importonim asgjë. Po jugosllavët ditë e natë na plaçkitën dyqanet, depot, magazinat... nuk na lanë asgjë... Unë fajin ua hedh shokëve, - dhe tregova me dorë grupin e shokëve prezentë aty. - Ata pse i lanë?... Pastaj, me politikën e tyre të Rankoviçit, arrestuan dhe vranë shumë intelektualë, specialistë dhe patriotë që shprehnin dëshpërimin se Jugosllavia na kishte katandisur skllevër të saj. Ja, edhe unë isha tre vjet në burg, pse u zura me ambasadorin jugosllav. Dhe, sikur të mos ishte demaskuar Titoja nga Informbyroja, edhe unë sot nuk do të isha gjallë, siç nuk janë gjallë me qindra e mijëra komunistë të ndershëm, luftëtarë që vuajtën në burgjet e Italisë dhe që pastaj i akuzonin si agjentë amerikanë dhe i pushkatonin... Ja ky ka qenë Titoja, shoku Torez!

- Po a janë të vërteta këto? - më pyeti duke u hedhur një sy dhe shokëve të tjerë. Asnjë nuk foli, përveç Gogos, që tha se "Petroja i ekzagjeron pak, se ka qenë në burg..."

Zhaneta tha:

- Gjëra fantastike! Gjëra fantastike!

Pastaj i thashë Torezit:

- A mund t'ju bëj edhe unë një pyetje?

- Posi, me gjithë qejf!

- Pse e përjashtuat Andre Martinë nga partia?

Ai ktheu sytë nga Zhaneta:

- Përgjigju ti! - i tha.

Ajo lëvizi e nervozuar dhe, duke mos më parë në sy, foli:

- Ai ka bërë gabime fatale. Në një mbledhje kishte

thënë se, sikur Ushtria e Kuqe të na sulmonte, ne do të luftonim me të gjitha forcat tona si me një agresor. Pastaj, ai i ndalon shokët spanjollë të kthehen e të punojnë në Spanjë, se ka frikë mos i zë Frankoja. Saboton luftën e partisë spanjolle. - Heshti dhe shikonte liqenin, kurse Torezi më pyeti me zemërim:

- A të bindi shoqja? - E tha këtë me zemërim dhe ironi, se, siç u kuptua, ajo do të ketë qenë shkaku i përjashtimit nga partia të Andre Martisë, figurës më të ndritur të Kominternit, heroit të Detit të Zi dhe komisarit të brigadave internacionale në Spanjë... Kaq për Torezin.

Pyetje: - A bisedonit gjë me Sejfullanë?

Përgjigje: - Ai më vinte shpesh në redaksi dhe unë i shkoja shpesh në shtëpi. Pas atyre që më kishte thënë në fillim, ai heshti. Nuk fliste më për situatën. Nuk zinte njeri në gojë. Më fliste për përkthimet që bënte dhe që do të bënte nga shkrimtarët e mëdhenj rusë. I kishte shkruar Fan Nolit, që të vinte, dhe ai i përgjigjej se mund të vinte nga prilli ose më vonë. Dhe, meqë ra fjala për Fan Nolin:

Kur vajti Mehmet Shehu në Kombet e Bashkuara, i bëri tri letra Nolit:

Letra e parë: Pasi unë nuk mund të largohem nga Nju-Jorku, ju lutem të vini të takohemi.

Asnjë përgjigje.

Letra e dytë: Kam porosi nga populli shqiptar dhe nga pushteti ynë që ju të vini në Shqipëri, se për figurën tuaj ka shumë nevojë populli ynë, për të cilin keni bërë shumë. Ju do të keni të drejtat materiale të një kryeministri, dashurinë dhe respektin e pakufishëm si dhe mirënjohjen e gjithë popullit tonë.

Asnjë përgjigje.

Letra e tretë: Imzot, të gjitha i besoja, po që Noli të ishte frikacak, nuk ma merrte kurrë mendja.

Këto na i ka thënë vetë Mehmeti, kur i shkonim si grup i Spanjës për t'i uruar ditëlindjen çdo 10 janar.

Më 28 Nëntor të vitit 1952, kur kremtonim 40--vjetorin e pavarësisë, e kam dëgjuar vetë Nolin me veshët e mi të fliste në radio nga Amerika, pak a shumë: ".... O ti që je në fuqi me hanxhar në dorë për të prerë kokat e patriotëve, thuamë ç'po bën... Shqipëria pret një Shën Kostandin për të shpëtuar nga kjo kasaphanë..."

Më kujtohet në frontin e Aragonës, kur një gjerman tankist, pasi mori vesh se jam shqiptar, më tha: "Në Hamburg, më 1928 bëhej Internacionalja Fshatare dhe referatin e mbajti shqiptari Fan Noli."

Pyetje: - Me cilin nga udhëheqësit ishe më i afërt e me cilët kishe distancë e përçmim?

Përgjigje: - Unë më shumë afëri dhe mirëkuptim kisha me Sejfulla Malëshovën, nga i cili mësoja shumë gjëra, pasi ishte shumë i kulturuar, i përgatitur dhe i mençur; kisha shok lufte që nga Spanja edhe Mehmet Shehun, i cili kurrë me mua nuk prononcohej për asgjë; kisha shoqëri dhe me Koçi Xoxen, i cili besoj se më shpëtoi nga pushkatimi kur u arrestova në vitin 1947. Ndihej njëfarë shkëputje e vërtetë e udhëheqjes nga populli. Ata u vendosën në atë që u quajt më vonë "bllok", i cili në kohën e okupacionit nga masa e varfër u quajt "Lagjja e hajdutëve".

Me Hysni Kapon përveç që e kisha shok që në kohën e Shkollës Tregtare, na lidhte edhe një miqësi e hershme ndërmjet familjeve tona. Që kur u ktheva në Shqipëri dhe e takova më 1944, ai vazhdimisht u tregua me mua shumë i dashur. Edhe në vitet e mëvonshme, kur unë pata probleme të rënda, atij i jam drejtuar.

Një gjirokastrit, miku im, një ditë më tha se dikush i kishte thënë Enverit se "ata të Spanjës, shëtitin në bulevard sikur të jenë çlirimtarët e botës." Kjo shprehje mua më rëndoi.

Shumë vjet më vonë, një ditë na thirri për drekë Hysni Kapoja, mua, gruan time dhe një mikun tim. Pasi

drekuam, dolëm në kopsht. Hysniu na hodhi krahun të dyve, ai në mes. Ktheu kokën nga unë, më shkeli syrin dhe pastaj na tha: "Ju të dy jeni të mençur e më të mëdhenj se unë. Kur keni ndonjë ide të kundërt me njëri-tjetrin, merruni vesh të dy dhe s'ka nevojë të bëni raporte të shpeshta njëri kundër tjetrit." E kuptova, ishte fare e qartë. Njerëz të tillë kishte kudo dhe jo pak. Edhe Sejfullai shpeshherë më linte të kuptoja se midis bashkëpunëtorëve të tij, kishte nga ata që e raportonin.

Për gazetën tani interesohej Nako Spiru, i cili solli shumë shokë të rinj, djem të luftës, si Luan Omarin, Androkli Kostallarin, Raif Hasanin, Sofokli Lazrin, Myzafer Xhaxhiun, Javer Malon, Stefanaq Pollon e të tjerë. Kështu që gazeta u pasurua, po ç'e do se letra nuk i përshtatej rrotativës. Më vonë na erdhi dhe letra. Për "Hostenin" erdhi si përgjegjës Sotir Papuli. Mora dhe Spiro Çomorën, që ishte një talent i vërtetë, edhe Aleks Çaçin. Kështu që u bëmë një batalion gazetarësh. Një pjesë e tyre, si Raif Hasani, Muzafer Xhaxhiu e shokë morën bursa për në Hungari, Bullgari, Rumani e Bashkimin Sovjetik.

Pyetje: - Me Nako Spirun si ia kalove?

Përgjigje: - Ishte vërtet i zoti i penës, por, meqë ai e dinte, me sa dukej, antipatinë që kishte Enver Hoxha për mua, sillej pak si zyrtar.

Pyetje: - Në përgjithësi si u çmua puna e gazetës?

Përgjigje:- Shumë mirë. Se të gjitha fushatat i popullarizuam, i propaganduam me sinqeritet dhe objektivitet. Fushatat i pasqyruam shumë me vërtetësi, si fushatën kundër analfabetizmit, fushatën e reformës agrare, fushatën kundër atyre që fshihnin pasurinë dhe që nuk dorëzonin floririn. Gjyqin special kundër kuislingëve dhe tradhtarëve e ndoqa dhe e përshkrova me shumë besnikëri. Mora dy stenografë të zotë, Reshat Again dhe Benushin, dhe gjithë zhvillimi i gjyqit është shkruar i saktë pa asnjë presje mangut. Këto janë të gjitha në gazetë

dhe cilido duhet të ketë besim se s'ka asnjë shtrembërim në asnjë fushatë, në asnjë ngjarje me rëndësi.

Pyetje: - Ç'ngjarje me rëndësi të kujtohet nga periudha kur ishe në gazetë?

Përgjigje: - Aty nga viti 1945 erdhën në Shqipëri dy gazetarë amerikanë. Gazetarët e parë të huaj që vizitonin Shqipërinë: Çakalli, përgjegjësi i Unaid Press dhe Li Uait, korrespodent i shumë gazetave, por më shumë i "Çikago tribun". I prita në hotel "Dajti" dhe në zyrat e mia të gazetës. Më pyesnin për shumë gjëra dhe më kryesorja ishte kjo: a jeni ndarë nga Jugosllavia dhe a isha unë anëtar i Partisë. Pastaj më pyetën dhe për Enver Hoxhën, nëse ishte anëtar i Partisë, dhe unë u thashë se nuk e dija, pasi Partia ishte ende ilegale. Ata më pyetën: Nuk e udhëhoqi luftën Partia Komuniste? Pastaj më kërkuan të takoheshin me Enverin. Unë i telefonova Enverit dhe ai, nga zyra e tij që ishte në ndërtesën e parë të pallateve të ministrive, më tha se mund t'i shoqëroja tek ai në orën 12. I thashë se ata më pyetën nëse ai ishte në Parti. "Po ti çfarë u the?" "U thashë se nuk e di, pasi Partia është ilegale!" I shpura në orën 12. Ai i priti shumë mirë. Ishin gazetarët e parë të huaj që vizitonin Shqipërinë. Ata kishin marrë pjesë edhe në mbledhjet e Teheranit dhe të Jaltës dhe më tregonin qyfyre për Stalinin, Çurçillin, Rusveltin. Li Uaiti kishte qenë si gazetar edhe në Spanjë dhe njihte Bim Kuranin dhe Karmenin (të shoqen).

Me Enverin folën pak. Me sa më kujtohet tani, pas shumë vjetësh, biseda ishte pak a shumë kjo: Pyetën nëse ishte e vërtetë që luftën e udhëhoqi Partia Komuniste Shqiptare. Enveri u tha se ishte e vërtetë. U zhvillua ky bashkëbisedim:

Li Uait: - Zoti gjeneral, a bëni pjesë në Partinë Komuniste?

Enveri: - Është nder i madh të jesh anëtar i Partisë Komuniste.

Çakalli: - Po ju, si president i qeverisë, a jeni komunist?

Enveri: - Partia është ilegale dhe nuk tregohet nëse je apo jo komunist.

Li Uait: - Ky është një paradoks. Një parti që udhëheq luftën dhe del fitimtare, nga cili ka frikë të jetë legale? Ajo triumfoi...

Çakalli: - Mos nuk ju ka lejuar Titoja të dilni legalë? Nga kush keni frikë?

Enveri u nxeh pak, por e mbajti veten. Kurse Li Uaiti vazhdoi:

- Vërtet është një paradoks. Siç duket ende nuk ju ka lejuar mareshali Tito...

Enveri: - Me Titon jemi aleatë dhe shokë. Po ne së shpejti do të dalim haptas.

Ata nuk mbetën të kënaqur. I kërkuan leje që unë t'i shoqëroja nëpër Shqipëri. Ai pranoi me gjithë qejf. Pastaj bënë një fotografi me të. Kur i përcolli deri te dera, më tha: "Sillu si në Francë... mos i pengo gjëkundi të venë, të shohin ku të duan..."

Mora një taksi të madhe nga shoqëria "SAKT" dhe, bashkë me të fejuarën time dhe Javer Malon, të cilin ma rekomanduan, shkuam në Elbasan. Li Uaiti kërkonte të takonte Bim Kuranin dhe Karmenin, që ishin në llixhë. Shkuam në llixhë dhe i takuam. Karmeni e njohu Li Uaitin. Hëngrëm drekën aty dhe u nisëm për në Korçë. Gjatë rrugës bënim shaka. Li Uaiti na tregonte se si në mbledhjen e Teheranit të tre të mëdhenjtë u ulën të hanin mëngjes dhe:

Tha Çurçilli: Kam parë një ëndërr sikur u bota u bë një Komunuelth dhe unë u bëra premieri i saj.

Tha Rusvelti: Pashë një ëndërr sikur bota u bë Shtetet e Bashkuara të botës dhe unë u bëra president.

Tha Stalini, duke zbrazur llullën: Ëndërr! Ëndërr! - dhe të tre qeshën.

I shoqërova gjer në Kakavi, ku panë vetë me sytë e tyre një provokacion monarko-fashist grek: kishin hyrë në tokën tonë pesë ushtarë grekë dhe tërhiqnin zvarrë një dropullite që punonte tokën. Çakalli, që dinte greqisht, i pyeti pse e merrnin atë grua. Ata u përgjigjën me inat: "Është toka jonë; edhe Gjirokastra, edhe Korça." Të dy gazetarët, të veshur me uniforma ushtarake, u thërrisnin dhe më kërkuan leje të shkonin e të bisedonin me oficerët grekë të piramidës. U thashë se qeveria jonë ishte përgjegjëse për jetën e tyre, prandaj iu luta të mos e kapërcenin traun, se mund edhe të vriteshin. Shkrova një artikull "Provokacion në flagrancë". Li Uaiti më tha: "Këtu ju keni avaze dhe lufta do të vazhdojë për shumë kohë..."

Ata ikën. Pas disa ditësh erdhi një aeroplan me dy gjeneralë: një anglez, një amerikan. I prita në aerodrom. Kishin sjellë penicilina, se atëherë kishte rënë tifoja e morrit dhe vdekja bënte kërdinë. Ishte dhe Hysniu në aeroport. Na dhanë nga një pako me penicilina - ishin të parat që vinin në Shqipëri - po nuk i pranuam, se duheshin për ushtrinë dhe popullin. Unë, aty te dera e avionit, pashë një revistë "Llajf" dhe e shfletova. Shikoja faqosjen dhe fotografitë... Dhe ç'bëri më vonë kjo revistë? Botoi një foto në faqen e tretë: unë duke shikuar revistën, me këtë diçiturë: kryeredak-tori më i ri i Evropës lexon revistën tonë.

I shpura në Dajti, në tavernë, por ata m'u lutën t'i çoja në ndonjë lokal karakteristik shqiptar. Pyeta Myqeremin, se ashtu quhej shoferi ynë i rrahur me vaj e me uthull, se ku kishte ndonjë lokal ku të kishte edhe këngëtarë shqiptarë. Na shpuri në Rrugën e Durrësit, ku ishte kafene "Valbona". Lokali qe plot tym e me shumë tryeza me tiranas me veshje popullore, që pinin raki. Në krye, si në skenë, këndonte një rome me dimit dhe i binte gërnetës një rom me një vesh. Nuk kishte vend ku të uleshim. Amerikani nxori pallton, e shtroi në qoshe dhe

u ul bashkë me anglezin. Unë i thashë të zotit të kafenesë se këta ishin të huaj dhe të shikonte mos kishte ndonjë mundësi t'u sajonte një tryezë. Ai shkoi te një tryezë me dy veta, diçka u tha dhe ata u ngritën e shkuan në një tryezë tjetër ku ishin dy të tjerë... Cija - ashtu quhej romja që këndonte këngë tiranase - pasi i tha i zoti i kafenesë se ata ishin të huaj, filloi të këndonte disa këngë italiane me shqiptim të keq... *"O campagnola bella - tu sei la reginella"*. Po të huajt iu lutën të vazhdonte me këngë të vendit dhe jo me këngë italiane, të cilat, kur i këndonte, i deformonte fare.

Porositëm tri shishe konjak "Stok" dhe ata filluan të pinin. Unë sa lagia buzët, se do të kthehesha në gazetë. I dhashë gjeneralit amerikan një kartëmonedhë dhe ai shkoi e ia ngjiti në ballë romes që këndonte. Të gjithë u ngritën në këmbë dhe brohoritën: "Rrofshin aleatët anglo--amerikanë!" I shpura në hotel "Dajti". Ishin të gëzuar dhe më thanë se nesër duhej të bënin një mbledhje me qeverinë, se UNRRA kishte caktuar për ne një shifër të madhe në dollarë si ndihmë, ashtu siç kishte bërë UNRRA për të gjitha shtetet aleate të koalicionit anglo-ruso--amerikan.

Fola të nesërmen me Nako Spirun, i cili krijoi një komision, më duket me kryetar Njazi Demin, për të biseduar me ata. Mbledhja u bë dhe sjellja jonë ndaj tyre ka qenë arrogante dhe e ulët, siç më ra në vesh. Me kë flisnim ne kështu? UNRRA ishte krijuar për t'u ardhur në ndihmë popujve që u shkatërruan nga lufta, një prej të cilëve ishim edhe ne. Kur u takova me dy gjeneralët në drekë në hotel "Dajti", e pashë që ishin të zemëruar. Më thanë se komisioni ynë nuk ishte serioz dhe nuk e kishte kuptuar si duhet qëllimin e tyre. Ata u kishin thënë se ndihmat ishin në dollarë; do të sillnin mallrat dhe të gjitha ato që do të kërkonim ne, por duhej të vinte këtu dhe një ekip i UNRRA-s për të parë se si ndaheshin

ushqimet, teshat dhe makineritë, ashtu siç kishin bërë në vendet e tjera. Komisioni ynë nuk pranoi ardhjen e anglo-amerikanëve për të parë se si do të ndaheshin furnizimet, se "ne, - kishte thënë komisioni ynë - kemi krijuar asistencën sociale që ndan ushqimet dhe veshmbathjet." Nga sa kuptova unë, ata kishin ndër mend që të iknin, prandaj shkova te Nakoja dhe i thashë: "Ata po ikin." Ndenjëm me Nakon ca orë, pastaj ai m'u lut t'i mbaja edhe ndonjë ditë, gjersa të bënin një listë të madhe me kërkesat... I mbajta. I shpura dhe gjer në Krujë. Në darkë më erdhi lista dhe unë me sinqeritet u thashë: "Është krim i madh që të mos marrë Shqipëria ato që i takojnë, nga UNRRA. Unë kam sjellë një listë këtu." E morën dhe nuk pranuan vetëm dërgimin e aeroplanëve.Unë u thashë: "Ka krahina të largëta, s'ka ura, s'ka mundësi të ndihmohen dhe të furnizohen, prandaj ata aeroplanë bombardues mund të përdoren për furnizimin e zonave të izoluara, nga qielli me parashuta." Ata nuk e pranuan këtë; të tjerat po. I përcolla gjer në aerodrom duke u shprehur mirënjohjen e një populli të tërë.

Furnizimet filluan të vinin. Midis tyre ishte edhe letra rrotative për gazetën. Të gjitha duhej të jepeshin falas - ushqime, veshmbathje, - po qeveria nisi t'i shiste dhe ata të UNRRA-s vinin tek unë dhe kundërshtonin. Unë u thosha se të gjitha ishin dhënë sipas rregullave të përcaktuara nga UNRRA. Njëri më tha: "Pamë në Sarandë dy vaporë sovjetikë që ngarkoheshin me grurin që UNRRA e ka sjellë për ju"! Njëri prej tyre, një burrë i thyer në moshë, fisnik dhe i thatë si anglezët, u martua me një grua shumë të bukur shqiptare, të cilën e mori me vete në Londër.

Më vonë, kur erdhën të gjitha furnizimet, gjysmat e të cilave me siguri shkuan tek Titoja, dhe delegatët e UNRRA-s u larguan, filloi fushata e arrestimeve për të

gjithë ata që kishin pasur lidhje pune me oficerët e UNRRA-s.

Me shokët e mi të vjetër të paraçlirimit, si p.sh. me Zef Malën, Ilo dhe Viti Shahinin, me Sejfullanë, me Hasan Reçin, me Selaudin Toton, me Shefqet Bejën, me Gjergj Kokoshin, Enver Sazanin, Sinan Gjonin, Uan Filipin, ing. Andrea Xegën, Foto Veshin, Zef Prelën, Irfan Majunin e të tjerë. (një pjesë e tyre ishin deputetë), kur takoheshim, bisedat ishin të përmbajtura dhe gjithmonë silleshin rreth çështjes së udhëheqjes: a kishin dorë vërtet jugosllavët, siç po dukej, dhe kush ishte i lidhur me ta. Sigurisht diskutohej nën zë. Demir Godelli, burrë i mençur, thoshte: "Koha do t'i nxjerrë në pah të gjitha."

Pyetje: - A mund të na tregosh diçka për jetën tënde larg politikës?

Përgjigje: - Çdo njeri ka jetën e tij intime. Mua jeta më ka shkuar mes shumë peripecish. Kam njohur shumë vajza sidomos në Francë. Po me tri prej tyre, për të cilat kam folur, mund edhe të martohesha, po të mos isha martuar me idealin. Më vjen keq që nuk e jetova edhe unë rininë me gëzimet dhe bukurinë e saj. Por rrugën time e zgjodha vetë.

Qysh në vitet e para pas çlirimit, më ishte e pamundur që të bëja dhe përpjekjen më të vogël për të komunikuar me shokët dhe shoqet e mia jashtë Shqipërisë, aq më tepër pas arrestimit tim në 1947 dhe më vonë pas lirimit, kur as që bëhej fjalë për një veprim të tillë. Mund të shtoj se në gazetë më erdhi një letër nga Billi Uoter, amerikani që unë njoha kur isha i internuar në Llogara, në kohën e mbretit Zog, me të cilin u lidha miqësisht, dhe unë kësaj letre nuk mund t'i përgjigjesha, se një veprim i tillë keqinterpretohej.

Nga të tri shoqet e mia të dashura Uendi, Sally dhe Jola, vetëm nga Jola merrja mesazhe në formë kartolinash për çdo Vit të Ri, që vinin në adresën time në Lidhjen e Shkrimtarëve.

Në fund të vitit 1990, kur unë isha shumë i sëmurë pas një operacioni të rëndë, pata fatin të shkoja në Romë, i shoqëruar nga vajza ime, në shtëpinë e Jola Lombardit.

Në aeroport ku ajo po na priste, 46 vjet pas ndarjes me fjalët "do të shihemi shumë shpejt", ne e njohëm njëri-tjetrin në çast, në mes të lumit të njerëzve. Vërtet të dy të plakur, por ishim gjithmonë ne. Franko Lombardi, i cili kishte vdekur, kishte qenë një personalitet, filozof me një veprimtari voluminoze, po ashtu edhe Jola në fushën e saj si pedagoge. Ajo më pa që unë isha katandisur si hije. Biseduam gjatë për vitet e ndarjes. Ajo më shëtiti për të parë të gjitha ato rrugë e vende që lidheshin me kujtimet e mia të luftës. Pamë Koloseun, kaluam në Via Marguta, në Fosse Ardeatine dhe sigurisht dhe te Rexhina Çeli, burgu nga i cili çuditërisht dola i gjallë. Ato mbrëmje në sallonin e saj tentuam të këndonim këngët partizane duke kujtuar me sy të përlotur vitet e rinisë dhe të luftës. Jola, megjithëse në moshë të avancuar, deri natën vonë gjithmonë punonte, dëgjoheshin tastet e makinës së shkrimit ku rrihnin gishtat e saj.

Nga ata që kishin mbetur gjallë, nga miqtë e atyre viteve munda të takoja disa prej tyre. Kur u ndamë me Jolën, më tha: "Të këshilloj të shkruash autobiografinë tënde, e cila vlen sa 100 romane."

Pyetje: - Po si u martove me Safon?

Përgjigje: - Shumë thjesht. Një martesë e papritur. Dhe ja: Kur erdhëm nga Berati, në fund të tetorit, dhe banonim në hotel "Dajti", hynin e dilnin shumë të rinj e të reja. Më tërhoqi vëmendjen një vajzë shumë simpatike, e veshur me pantallona si vajzat e Grënoblit, kur shkonin për ski. Më vonë, kur bëhej gjyqi special, një shoqe, Xhorxhi Haxho, ish-partizane, ma prezantoi atë vajzë që unë e kisha vënë re në hotel "Dajti", dhe m'u duk nga afër më e bukur se atëherë kur e pashë për herë të parë.

Pas disa javësh më merr në telefon Liri Gega, që ishte

presidente e Bashkimit të Grave, dhe më thotë se do të më dërgonte një shoqe që punonte atje, për të marrë eksperiencë në gazetë. Ma dërgoi! Ishte po ajo vajzë që pashë në hotel "Dajti" dhe në sallën e gjyqit special. Ajo u ul kundruall meje, pak e skuqur. E pyeta:

- A je e martuar?

- Jo!

- A dashuron njeri?

Ajo u skuq më tepër dhe më tha "jo".

- Atëherë ti do të bëhesh gruaja ime!

Ajo uli kokën, u ngrit dhe iku pa më thënë asnjë fjalë.

Qesha me vete dhe thashë me zë: "Si shumë u nxitove, o Petro! Nuk e di se këtu je në Shqipëri dhe jo në Francë?!"

Vërtet më erdhi shumë keq dhe turp që u nxitova dhe harrova se ku isha. Kur ç'të shoh! Të nesërmen erdhi përsëri në zyrën time. U gëzova pa masë dhe i kërkova ndjesë për ato që i thashë të djeshmen. Ajo nuk fliste, po më shikonte. Përsëri unë, i trullosur si peshku në stere:

- Ti që sot je gruaja ime!

Ajo qeshi. E mora për dore dhe zbritëm poshtë, në pasticeri. Unë piva një kafe, ajo piu një gazoz. Dhe që atëherë ne dilnim bashkë.

Në ditët e njohjes, midis të tjerave, i recitova këto vargje të miat: *Ti, o mjeshtër, merr një shkëmb,/ Rrihe fort e me ngadalë,/ Jepi trup e kokë e këmbë,/ Vetëm zemër mos i fal.* - Ia kisha kushtuar këtë poezi skulptorit Odise Paskali.

Safoja porsa e dëgjoi tha:

- Po unë i di këto vargje. I mbaj mend shumë mirë.

Ajo më tregoi se këto vargje i dinte përmendsh babai i saj Shefqet Çelo, i cili kishte qenë mik me Branko Merxhanin qysh në Stamboll, ku kishte kryer fakultetin në shkenca politike. Ai ishte i abonuar në shumë organe

të shtypit të asaj kohe, por mbi të gjitha parapëlqente "Përpjekjen shqiptare". Safoja më tregoi se Brankoja i kishte thënë babait të saj se atë poezi e kishte shkruar një djalë i ri shumë i talentuar, të cilin e kishte marrë në punë te "Përpjekja". Çudi!

Para se të tregoj për tragjedinë e familjes sime, dua të them edhe këto:

Shumë nga ata që kishin qenë në Shkollën Teknike të Fulcit, ishin arrestuar si spiunë amerikanë. Shumë nga ata që mund të takoheshin rastësisht ose në tavernën e hotel "Dajtit" me ndonjë nëpunës të UNRRA-s, arrestoheshin si agjentë anglo-amerikanë.

Situata politike kishte ndryshuar.

Erdhi koha që misionet anglo-amerikane s'mund të qëndronin më në Shqipëri, dhe vendosën të largoheshin. Unë dhe gazetarë të tjerë si Shevqet Musaraji, Javer Malo etj., përcollëm në aerodrom misionin amerikan. Zoti Jakobs, shefi i misionit, një burrë i mençur me autoritet, më hodhi krahun dhe më tha: "Zoti Marko! Ne po largohemi, se po marrim në qafë shumë shqiptarë. E shohim se shihemi këtu si armiq. Po dua t'ju them vetëm këtë: Ju mund të shani Rusveltin, Hajzenhauerin e të tjerë, mua dhe gjithë autoritetet amerikane, por jo kurrë flamurin e lavdishëm të Amerikës. Ju atë e keni poshtëruar. Amerika këtë s'ka për ta harruar kurrë, kurrë! - " më tha me zemërim. Këto shkova dhe ia tregova Koçit, dhe ai më tha: "Ne jemi kampi socialist."

Pyetje: - Si nisi tragjedia jote?

Përgjigje: - U kurdis një skenar. Nako Spiru provokoi një mbledhje në redaksi me Frontin, se Fronti ishte ai që përfaqësohej nga "Bashkimi". Ishin: Omer Nishani, Shefqet Beja, Nako Spiru, Behar Shtylla e të tjerë. Ishte i dërguar "gjoja" nga Ministria e Brendshme N. H., por në të vërtetë mendova se ishte i ngarkuar nga Nakoja. Unë nisa të bëja një raport për gjendjen e gazetës, nisa

të flisja për disa kërkesa, për anën materiale, sidomos për letër rrotative e të tjera.

U ngrit N.H. dhe tha midis të tjerash se Petroja na "mburri" këtu "Bashkimin e kombit", që shtypej po në këtë shtypshkronjë dhe dilte më bukur e më i madh. Harrova të them se disa ditë më parë Nakoja më kishte thënë që ta bënim "Bashkimin" si "Borbën" e Beogradit. Unë e kisha kundërshtuar me po ato fjalë që i thashë dhe N.H. në mbledhje, se dhe ai nxori nga xhepi një "Borba" dhe tha se edhe ne duhej ta bënim "Bashkimin" si "Borbën". Unë shkova në dhomën tjetër, mora koleksionin e "Bashkimit" të vjetër dhe thashë se "Bashkimi" sot ndjek gjurmët e "Bashkimit" të vjetër. Pastaj ne kemi shtypin tonë, siç ka çdo shtet shtypin e vet. Çdo shtet ka traditën e shtypit të tij. Ne me "Borbën", - thashë, - ndryshojmë nga forma, por kemi po atë përmbajtje, ashtu si në Itali "Unita", si në Francë "Humanité", si në Greqi "Rizospastis" e të tjera. Cilido mban formën kombëtare, ashtu dhe "Bashkimi" ynë mban formën kombëtare. N.H. nguli këmbë aq sa më bëri të nxehesha e të thosha: "Pse të mos bëhet "Borba", që është më e re, si "Bashkimi", që është shumë i vjetër!"

Pas disa diskutimesh qetësuese nga Omer Nishani, thanë ta mbyllnim mbledhjen.

Pas disa ditësh Jugosllavia kishte një festë dhe ne të kulturës (të Radios, të Agjensisë Telegrafike dhe të shtypit) ishim të ftuar në ambasadë. Dhe shkuam në Ambasadën Jugosllave për të uruar. Unë kisha marrë me vete edhe shoqen time, Safon. Josip Gjergja, ambasadori, më mori pranë dhe flisnim shqip. Ngritëm gotat. Kur e ceku gotën me gotën time, më tha:

- E, në mos u bëftë "Bashkimi" si "Borba", le të bëhet "Borba" si "Bashkimi"...

Gotën as nuk e vura fare në buzë, por e lashë mbi tryezë. Ai buzëqeshi me ironi dhe më tha:

- Pse?

I thashë:

- Ju nuk i njihni mirë zakonet tona. Ne themi se "hallet e shtëpisë nuk dalin në pazar!"

Edhe ai e uli gotën dhe e la mbi tryezë. Më pa me ironi dhe më tha me zë autoritar:

- Unë nuk jam pazar!

Atëherë unë iu përgjigja:

- Në këtë rast për mua po!

Mora shoqen time dhe ika. Asaj nuk i thashë se ç'ngjau, por se më merreshin mendtë nga pagjumësia...

Të nesërmen, ishte kohë e bukur; kisha marrë Safon për krahu dhe shëtitnim në bulevard. Aty përpara hotel "Dajtit", kaloi një veturë. Brenda saj ishte Nakoja. Shikimet tona u ndeshën për pak çaste. Do të ketë thënë me vete: "Kjo është shëtitja e tij e fundit..." Dhe me të vërtetë ajo ishte e fundit, se në mes të natës erdhën njerëzit e sigurimit, më ngritën nga shtrati dhe më lidhën. Safoja qante me dënesa dhe thoshte: "Pse? Ku do ta çoni?" Pastaj iu drejtua atij që më vuri prangat: "A mund t'i bëj një pyetje?" Dhe më pyeti:

- Të lutem, nuk mund të ikësh pa më thënë se çfarë ke bërë! - Dhe unë iu përgjigja:

- Jam i pastër si kristali. - Dëgjoja dënesat e saj edhe jashtë, kur më futën në makinë... Dhe nisi tragjedia. Më 15 maj 1947.

NISI KALVARI

Më vonë mora vesh se më 15 maj u bënë arrestime masive. Mua më shpunë te Burgu i Vjetër.

Aty, në birucën e katit të poshtëm, gjeta tre veta: Asim Abdurahmanin, që e njihja, se ishte dhëndri i Bedri

Pejanit; Gjysh Dedën, një shkodran; Asllan Ypin. Sapo më panë, u habitën: "Edhe ti këtu!"

Asimi më tha:

- I kisha thënë gruas sime të vinte tek ti që të interesoheshe për mua. Më kanë dënuar me vdekje! Nuk e di pse... Unë Babushin (Bedri Pejanin) nuk mund ta mohoja, se e kam vjehërr... Pastaj, pse jam përfaqësues i shoqërisë farmaceutike gjermane "Bajer", nuk është ndonjë krim.

Ishim katër veta në një birucë. Cilido tregonte të tijat. Aty dëgjova Asllan Ypin të na tregonte për jetën e tij dhe të Enverit në Francë...

Pastaj tregonte edhe për në Tiranë:

- Një ditë kalova andej dhe e pashë që pozonte në derën e dyqanit "Flora", ku njoha disa komunistë. I thashë frëngjisht: "Po ti, Enver, ç'kërkon këtu me të kuqtë?" -

Dhe ai po frëngjisht: "Jam këtu, me qëllim që t'u... nënën gjithë komunistëve. Asnjë nuk do të lë më këmbë."

Dhe, siç do të shohim, ai me të vërtetë qysh atëherë nisi të eliminonte komunistët e orëve të para.

- Po ne që nuk jemi komunistë, - tha Gjysh Deda, - pse na arrestoi e na dënoi me vdekje?

Mendoja: "Kam qenë në burgje të tjera me shokë të dënuar me vdekje dhe gjithnjë jam kredhur në një trishtim shumë të thellë... Ç'ka bërë njeriu! Ç'mënyra krimi, mundimi dhe degjenerimi ka gjetur për të dënuar veten! Më kujtohet që thoshin në burgun e Barit se inxhinieri i cili ndërtoi burgun, pasi e mbaroi, vrau veten. Burgjet janë varri i të gjallëve. Njeriu, në disa demokraci, ka gjetur mënyrën e dënimit të fajit ose të krimit: izolimi në vende të largëta; kanë krijuar komunitete fajtorësh që punojnë e jetojnë të izoluar nga bota tjetër, por ama janë në shoqëri, shohin diellin, paçka se bëjnë një jetë pa krahë për të fluturuar..."

Ja një skenë çnjerëzore: Ishim duke ngrënë bukë të katër bashkë; kishim shtruar ato që na kishin sjellë familjet tona në sefertasë. Mua më sillte ushqim rregullisht përditë gruaja ime, Safoja. Atë e ndihmonte e ëma, Shazija, që gatuante shumë mirë. I bashkuam gjellët dhe që të katër, këmbëkryq, filluam të hanim. Nuk kaluan pak minuta dhe dera kërciti e u çel. U futën dy oficerë të sigurimit, Aznedari dhe Stavri, të zellshëm për ofendime dhe tortura nga më çnjerëzoret. Nuk na thanë "ju bëftë mirë dreka," po:

- Ti, Asim Abdurahmani, dhe ti Gjysh Deda, ngrihuni!

Nuk e di si guxova dhe fola:

- Dale të mbarojmë drekën... Tani sapo u shtruam!

- Pusho ti, agjent i fëlliqur! Ju ngrihuni, se drekën e mbaroni në atë botë.

Shtangëm. Gjysh Deda, trim, tha:

- Asim, ngrihu! Të shpëtojmë nga kjo pjellë e keqe që ka lindur ky vend fatkeq i pushtuar nga Titoja, që ka këtu si xhelat Enverin!

Më erdhi të ulërija kur pashë Stavrin ta godiste me këmbë në kokë dhe ta shante.

- Ngrihuni!

Gjysh Deda i tha Asimit:

- Mos u ligështo. Mbaju burrë, se ne bëjmë pjesë te kurbanet, në ato mijëra kurbane që Enver Hoxha i ther për perëndinë e tij Tito.

Përsëri Stavri e goditi rëndë. E hoqi zvarrë. Me Asimin u përqafuam me lot në sy. Dëgjova:

- Në dalçi gjallë këtej, thoni se vdesim të pafajshëm!

Dera u mbyll. Unë dhe Asllani ndenjëm në këmbë me lot në sy, ndërsa radioja shpërndante me zë të lartë me anë të megafonit të vënë në oborr të burgut "Orën gazmore" dhe i bënte të qeshnin ata që e dëgjonin.

Ishte edhe kjo një nga ato mijëra skena makabre që kam parë gjatë gjithë jetës.

Pyetje: - A ndenje shumë te Burgu i Vjetër me Asllan Ypin?

Përgjigje: - Jo. Shpejt na shpunë në Burgun e Ri. Në një sallë të katit të dytë, ku kishte më shumë se njëzet veta, të gjithë të dënuar si agjentë të të huajve. Kishte aty njerëz të karaktereve dhe moshave të ndryshme. Kishte edhe disa rusë të bardhë, nga ata oficerë të carit që shpëtuan nga revolucioni dhe ikën. Ishin nga ata rusë të bardhë që i rekrutoi Ahmet Zogu në Jugosllavi dhe bashkë me bashibozukë të tjerë e bajraktarë hynë në Tiranë më 24 dhjetor të vitit 1924. Ata u bënë instruktorë të ushtrisë dhe Zogu i mbante mirë. Tregonin nga jeta e tyre në Peterburg dhe si kërcenin me balerinat më të bukura. Njëri thoshte se kishte kërcyer edhe me carinën dhe se ajo e kishte pëlqyer shumë, prandaj e thërriste shpesh në mbrëmje në pallat. Shokët e tij i thoshin Rasputin. Të gjitha këto ndoshta ishin fantazi.

Më në fund, më ndanë nga ata dhe më futën në një birucë të katit të parë, më lidhën me duart pas dhe te këmbët. Vetëm kur haja bukë, më zgjidhnin duart dhe kur shkoja në orën e caktuar në tualet. Lidhur këmbë e duar nga pas, pa asnjë shtresë e mbulesë, më bënin presion të përditshëm, të tregoja, të pohoja ato që deshën ata. Vinin grupe-grupe. Në një grup njoha një hetues që kishte qenë në kuesturë në kohën e okupacionit fashist dhe thosha me zë të lartë: "Më vjen mirë që është edhe ai hetues, se më duket sikur jam në kuesturën fashiste."

Hetimet filluan të bëheshin më të ashpra, më brutale. Më thoshin gjëra të çuditshme dhe ndërronin ton duke shtuar: "Fol për të mirën e Partisë!" Dhe unë përgjigjesha: "Të cilës Parti? Unë kam qenë anëtar i partisë spanjolle, franceze, italiane gjer në ditët e para të çlirimit. Tani më thoni: pranon partia komuniste shqiptare të shpif dhe të akuzoj njerëz që s'kanë bërë gjë dhe që nuk i njoh?" Shpesh çekani rrihte këtu: të deklaroja se Mehmet Shehu

ka qenë agjent qysh në Spanjë! Nuk çuditesha, se shumë nga ata që kishin mbaruar shkollën teknike amerikane, ishin arrestuar si spiunë amerikanë. Shumë nga ata që kishin qenë të internuar ose të burgosur në Itali, ishin arrestuar si spiunë. Dhe unë kujtoja atë mbledhje që bëmë në ishullin e Ustikës me grupet komuniste, me synimin që të merrnim ishullin, se përballë nesh, në Tunizi, ishte armata anglo-amerikane. Dhe kishim ndër mend të vrisnim rojat, të rrëmbenim një motoskaf e të shkonim në Bizertë, t'u thoshim amerikanëve të vinin të na shpëtonin. Unë e pranova këtë plan, por një shok nga Sllovenia, Dushan Kermau-neri, insistoi: jo! Dhe na bindi: "Ja erdhën amerikanët e na shpëtuan, ku do të na shpien? Në një kamp të tyre në Afrikë. E, kur të kthehemi në atdhe, në u kthefshim, do të na akuzojnë si spiunë të anglo-amerikanëve!" Na bindi, kishte të drejtë dhe ishte shumë i zgjuar.

Jam i mendimit që llojet e torturave çnjerëzore nuk duhet të shkruhen, se mund t'u shërbejnë diktatorëve ose xhelatëve të tjerë. Por do të tregoj për një shaka që bëra në atë skëterrë. Në derën e birucës sime bënte rojë një nga Myzeqeja, mbiemrin e kishte Prifti. Ai e lexonte gazetën me zë, sikur psallte në kishë, kështu që unë pak a shumë merrja vesh se ç'bëhej. Ishte 10 Korriku, festa e ushtrisë. Dëgjova rojat të bisedonin, në derën e birucës sime: "Si pihet birra, e ngrohtë apo e ftohtë?" U kishin dhënë një vozë të vogël me birrë për festë. Disa thoshin se pihet e ngrohtë, disa thoshin pihet e ftohtë.

Tha ai që lexonte gazetën sikur psallte dhe që më rrinte te dera:

- A e pyesim këtë gazetarin, se ky di shumë gjëra...

U hap dera dhe pashë nja katër roja. Më foli roja i derës sime:

- Si pihet birra: e ftohtë apo e ngrohtë?

U thashë:

- Birra pihet e ngrohtë!

- Po si ta ngrohim? Kemi një vozë të vogël...

- Vëreni në mes të oborrit gjer në drekë. Dielli i korrikut do ta bëjë valë. Pastaj pijeni...

Dhe ashtu bënë. E vunë vozën në mes të oborrit gjer në orën 12. Pastaj e shpunë në sallën e ngrënies. E hapën me një hekur dhe ajo shpërtheu e spërkati tavanin, mezi e mbajtën përgjysmë. Dhe filluan ta pinin të përvëluar. Të gjithë nisën të villnin... Kur e morën vesh oficerët, erdhën tek unë dhe më shqepën në dru, duke më thënë: "Sabotator! Na helmove rojat. Agjent!" Lëre mos e nga ç'avaze më dolën më vonë! Mora vesh se arriti puna gjer në ministri: "Agjenti Petro Marko desh na helmoi rojat e burgut!"

Pastaj, pasi mbyllën derën, duke më lënë të shtrirë në çimento, ata këndonin këngët internacionale që u kënduan gjatë Luftës, që i kisha përshtatur unë në shqip dhe që më parë mësoheshin në burgun e Tiranës, pastaj shkonin në Pezë e pastaj tek të gjithë partizanët, si: "Para-roja", "Fusha, ju fusha", "Kominterni", "Kënga e shoqes", e shumë e shumë të tjera që mobilizuan rininë në luftë. Ato ishin këngët e brigadave internacionale.

Më hoqën nga ajo birucë dhe më çuan te një tjetër.

Presioni vazhdonte. Më varën te hekurat e dritares dhe më vunë në supe një zinxhir nja pesëdhjetë kile, kështu që duart e mia të lidhura me zinxhir mbanin peshën e trupit tim dhe të zinxhirit. Nuk durohej dot kjo lloj torture. Më këputeshin duart, më dukej vetja sikur digjesha në flakë. Aluçinacione fantastike: Më bëhej sikur vinte gruaja ime Safo me një gotë aranxhatë dhe kërkonte të ma afronte te buzët... Hapja sytë: një furtunë e madhe në birucë, sikur kërkonte të shkulte hekurat e dritares. Kjo torturë vazhdonte. Vinte hetuesi me një deklaratë: "Nënshkruaje, të shpëtosh! Je i ri. Ke një nuse të re që të pret te dera..."

Unë nuk para u besoj ëndrrave, por ka raste që më dalin: kur shikoj në ëndërr vezë, do të kem ndonjë mërzi të madhe; kur shikoj në ëndërr dru, do të marr para; kur shikoj në ëndërr sikur lahem në det, do të sëmurem e të tjera. Kur isha i varur dhe më dilnin para sysh hije e skelete njerëzish, pashë bashkëfshatarin tim Petro Kokën, sikur m'u afrua dhe në dorë kishte një paketë me karamele amerikane. Kur hapa sytë, mendova: mërzi të madhe do të kem. Për çudi, pas pak hyri në birucë hetuesi im, me një letër të shkruar në dorë dhe më tha: "Po e nënshkrove këtë, do të t'i heqim zinxhirët..." Dhe e lexoi:

- I nënshkruari Petro Koka deklaroj se Mehmet Shehu ka qenë agjent qysh në Spanjë...

E vështrova mirë dhe i thashë:

- Po! Këtë deklaratë e nënshkruaj...

Hetuesi më hoqi hekurat, më liroi dorën dhe nënshkrova: Petro Koka. Ai, sapo e mori, e tundi në ajër dhe, duke dalë në korridor, thërriste: "E mposhtëm dhe revolucionarin e Spanjës..."

Erdhën me vrap shumë hetues dhe të gëzuar më thoshin:

- Pse të vuaje?! Ta kishe nënshkruar që më parë...

Mirëpo kryehetuesi e mori në dorë deklaratën dhe si i tërbuar thirri:

- Ç'ke nënshkruar këtu Petro Koka! Kë gënjen? Me kë tallesh? - dhe më zhdëpi në dru. Pasi mblodha veten, hapa gojën:

- U bënë gjashtë muaj që më torturoni, dhe ende nuk e dini se cili jam! - Përsëri filluan me shkelma dhe përsëri më varën te dritarja.

Dëgjoja përballë meje një shkodran që e torturonin keq, pastaj, kur iknin hetuesit, ai qeshte me të madhe dhe thoshte: "Po të venë këta në Evropë, do të bëhen milionerë, se unë, kur erdha këtu, isha tullac dhe tani jam me flokë kaçurrelë... Kushedi sa do të paguanin

tullacët e botës, që të torturoheshin këtu si unë e pastaj t'u mbinte floku në kokë!"

Një ditë hetuesit më nxorën nga biruca dhe më çuan në një zyrë. Më vunë përpara një deponim ose më mirë një akuzë shumë të rëndë. E lexova dhe me aq fuqi sa më kishte mbetur nga ata muaj torture, qesha. Bëhej fjalë për një propozim, që më ishte bërë mua, hapur, me zë të lartë, në mes të të gjithëve, në një tryezë, për të pranuar që të bëhesha agjent i amerikanëve. Mua m'u kujtua në çast ky propozim. Ma kishte bërë një gazetar amerikan për t'u bërë agjent shtypi nga Shqipëria, për gazetën ku punonte ai. Atëherë iu thashë hetuesve: "Si mund të besoni ju një absurditet të tillë? Si mund të më propozohet kaq hapur, me zë të lartë, në prezencën e njëzet e ca vetave, që të bëhem spiun i një fuqie të huaj? Ky është kulmi i ligësisë dhe i injorancës!" Kaq thashë dhe më kthyen përsëri në birucë. E gjeta menjëherë se kush ishte ai që e kishte bërë deponimin.

Pyetje: - Cila ka qenë skena më e rëndë që të ka tronditur më shumë në birucë?

Përgjigje: - Në atë birucë, e treta nga e djathta e katit të parë, isha varur te dritarja me zinxhirin e rëndë në qafë, që më bënte si Atlasin që mbante në kurriz globin; veçse unë s'mbaja globin e vërtetë tokësor, por globin e mundimeve, aq sa më dukej vetja në zjarr e furtunë, sikur vija vërdallë një ujëvare gjigante flakësh. Vetëm kur kërciste dera që hapej, hapja dhe unë sytë e përqendrohesha për të parë se cili hetues do të hynte si xhelati me vdekjen në dorë. Një herë, ç'të shikoj? Vërvitën brenda birucës një njeri skelet, si Gandi, të zhveshur pothuaj fare, kockë e lëkurë. E flakën brenda me të shara, pastaj e mbyllën derën. Mblodha të gjitha forcat për të parë më mirë se ç'ishte ajo "leckë-njeri"; pas pak ai ngriti kokën, më pa dhe për çudinë time foli: "Edhe ju këtu, zoti Marko?! Unë kisha shpresë se ju do të ndërhynit për të më shpëtuar..."

Dhe u zhvillua ky dialog ndërmjet dy kufomave të gjalla: njëri varur te hekurat, tjetri përdhe si një leckë e hedhur:

- Po cili jeni ju?

- Nuk më njihni? Jam profesor Zuber...

- Cili?!

- Zuberi. Ju kujtohet kur vajtëm në Shkodër bashkë me Nako Spirun, zonjën tuaj dhe Andrea Xegën dhe hëngrëm një drekë të mirë në ishullin e Bunës? Ne shkonim në Koplik për të parë se mos zbulonim burime uji.

Atëherë m'u kujtua profesor Zuberi. Andrea Xega, edhe ai gjeolog, dhe Nako Spiru, më treguan se cili ishte profesor Zuberi:

Një nga gjeologët më të mëdhenj të botës. Më parë e mori Lenini për të zbuluar puset e Bakusë - ku i kishin ngritur dhe një bust - pastaj, për aftësitë e tij të jashtëzakonshme, e angazhoi Shoqëria Anglo-persiane për të studiuar pellgun e Lindjes së Mesme (Gjirin Persik, Arabinë Saudite, Irakun, Iranin). Ai punoi shumë vjet dhe qe i pari që bëri hartën gjeologjike të asaj zone. Sot në gjithë botën gjeologët i kanë si udhërrëfyese zbulimet dhe traktatet e tij gjeologjike për atë zonë, që doli më e pasura në botë për naftë. Punoi shumë vjet dhe, pasi i kreu të gjitha punët, Shoqëria Anglo-persiane e dërgoi në Shqipëri. Ai erdhi këtu dhe punoi, bëri hartën e parë gjeologjike të Shqipërisë. Shoqëria në fillim nisi punimet në Kuçovë, ku doli nafta e parë, por, pasi ajo naftë përmbante shumë squfur, Shoqëria Anglo-persiane e la dhe ia shiti Italisë së Musolinit, që vuante për karburante. Filluan nga puna italianët; Zuberi zbuloi dhe Patosin. Italianët kishin shtrirë një tubacion nga Kuçova e gjer në Ujë të Ftohtë të Vlorës, ku vinin çisternat e "Axhipit", shoqëri italiane e naftës, dhe e shpinin për ta përpunuar në Itali. Zuberi krijoi dhe muzeun gjeologjik në Kuçovë.

Gjatë Luftës, nga bombardimet e aviacionit anglo-amerikan u godit dhe Kuçova dhe u vranë shumë njerëz, midis të cilëve dhe e shoqja e Zuberit.

Pas Çlirimit, Zuberi u thirr si këshilltar i gjeologjisë pranë Këshillit të Ministrave... Dhe më 1945 e njoha edhe unë në Shkodër. Ai më mbante mend, se e dinte që isha përgjegjës i gazetës "Bashkimi", dhe kishte tentuar të më shkruante që ta shpëtoja e ta liroja, se e akuzonin për një sabotim në Kuçovë.

Dhe tani ja ku·ishim të dy: ai i katandisur një grusht njeri, unë një skelet i gjallë i ngarkuar me hekura.

Pyetje: - Tani që e kishe dhe një shok në birucë, a të lehtësoheshin vuajtjet?

Përgjigje: - I vetmuar, lodhesh së fluturuari në hapësirën e kujtimeve dhe të shpresave, kurse me një shok jeton dhe lehtëson barrën e mundimeve shpirtërore. Kur jeton i rënduar nga hekurat, bëhen më të rënda mendimet dhe pesha e globit që ke mbi kokë.

Me Zuberin shkëmbenim ndonjë fjalë: ai, i shtrirë përdhe; unë, i varur. Ai murmuriste gjithë ditën dhe, pasi e pyesja se ç'murmuriste, thoshte:

- Tani jam duke bërë një leksion për shkaqet pse disa zona janë të pasura me naftë, si ato të Lindjes së Mesme... Tani jam duke u lutur, - ai ishte katolik dhe lutej.

E ngacmova dhe i thashë:

- Si ka mundësi që një intelektual si ju të besojë?

- Unë u besoj ideve që jetojnë dhe do të jetojnë për mijëra vjet. Ti i beson marksizëm-leninizmit... por a do të jetojë qindra ose mijëra vjet kjo ideologji? Feja ka një funksion shumë human dhe universal, ajo ka shumë vlerë për njeriun, se e bën më njerëzor, e bën më guximtar ndaj së ligës dhe i zbut plagët e shpirtit. Ja tani, kur unë i falem Krishtit, i them: edhe unë do të duroj dhe do të qëndroj si ti. Se ti na dhe shembullin për të buzëqeshur

edhe para vdekjes. Pse njerëzimi beson? Se ka nevojë për burim shprese, për këtë burim humanizmi, për këtë ilaç qetësues, sidomos në rastet si ky yni, në të cilin ndodhemi tani.

Hynë në birucë dy hetues: njëri e ngriti Zuberin dhe e nxori jashtë birucës, tjetri ndenji me mua dhe më tha:

- Pa pyete këtë armik a ka flori toka shqiptare. Ai ka bërë hartën gjeologjike, por nuk ka shënuar gjëkundi se ku ka flori...

Unë qesha me vete dhe i thashë hetuesit kallp:

- Po të kishte flori, për kë e ka fshehur? Po të ishte për italianët, do ta kishte shënuar. Po të ishte për gjermanët, do ta kishte shënuar. Për kë e ka fshehur?

- Këta agjentë... janë djallëzorë... Po ti pyete, se nuk ka mundësi që të mos ketë flori gjithë kjo tokë.

Përsëri unë qesha hidhur me vete dhe i premtova se do ta kryeja këtë "detyrë patriotike", se kështu më tha ai: "është detyrë patriotike kjo që po të ngarkojmë!"

Kur u kthye përsëri në birucë Zuberi, u shtri dhe qeshte.

- Pse qesh? - i thashë.

- Më shtrëngojnë të them pse nuk kam shënuar zonat ku ka flori toka shqiptare. Dhe unë u thashë se nuk ka. Ata më shkelmuan dhe më shanë "agjent i shitur".

- Me të vërtetë, a ka flori Shqipëria?

- Po të kishte, unë patjetër që do ta kisha shënuar, si të gjitha mineralet e rralla. Në të vërtetë, ka në disa zona, por duhet njëzet herë më shumë flori për ta nxjerrë atë sasi. Këta janë injorantë. Unë, kur kam bërë hartën gjeologjike, e kam bërë si gjeolog dhe jo si agjent ose spiun. Ç'janë këto që po dëgjojmë?!

Dhe përsëri mendimet dhe fantazia jonë morën drejtime të ndryshme. Burgu gjëmonte nga ulërimat. Përnatë merrnin e pushkatonin intelektualë të shquar, specialistë. "A e di? - më tha një ditë Zuberi. - Këtu, ja

Enveri, ja Koçi janë agjentë të huaj, besoj të Jugosllavisë. Se nuk lanë intelektual të gjallë, me qëllim që ata të sjellin të tyret."

U hap dera. Hyri brenda një polic trupmadh dhe i bërtiti Zuberit:

- Ç'punë bën ti?

- Gjeolog! - u përgjigja unë.

- Mbylle gojën ti, se s'të pyeti njeri!

- Gjeologu zbulon pasuritë e nëntokës! - u përgjigj i frikësuar Zuberi, se e vuri re shprehjen e kriminelit.

Roja i këputi me sa fuqi që pati, një shkelm prapa veshit duke i thënë:

- Tani shko e zbulo pasuritë e nëntokës. - Mbylli derën dhe u largua.

Kisha mbyllur sytë dhe çudi se si nuk më pushoi zemra. Me frikë, hapa sytë dhe pashë Zuberin të shtrirë, me duar e me këmbë të hapura dhe me një curril gjaku që i buronte nga goja. Bëra të lëvizja, t'i vija në ndihmë, por isha i varur në dritare. M'u errën sytë. M'u err mendja. Desha të bërtisja, që të më dëgjonte gjithë bota: Krim! Krim universal! Zuberin e vranë! Vranë kulturën, vranë shkencën, vranë jetën.

U hap përsëri dera. Hyri ai polici që e goditi, bashkë me dy të tjerë. E panë.

- Ngordhi qeni! - tha ai që e goditi. E kapën nga këmbët, e hoqën zvarrë, e nxorën jashtë dhe mbyllën derën, duke më lënë mua në birucë fantazmën gjakatare të kohës që vuloste turpin e këtij shekulli.

Si është jeta! Unë isha kredhur në hapësirën e llahtarës, kur dëgjova përballë birucës sime këtë bisedë:

- Ti je bej nga Vlora, ë?

- *C'est vrai* - është e vërtetë, unë bej jam...

- Gjakpirës!

- *Parole d'honeur* - fjalë nderi, unë gjak s'kam pirë kurrë, po shampanjë kam pirë gjithnjë... shampanjë *kordon-rouge*...

Dëgjova thirrje. Rojat e morën, e zvarritën gjer te kazani me ujëra të ndyra, e krodhën brenda kokëposhtë e talleshin:

- Pi, pi shampanjë kordon-shurrë!

(Parantezë e finales së tragjedisë: "Ha në atë botë!")

Te porta e oborrit të burgut çdo drekë bëhej një radhë e gjatë e grave, e nuseve, e bijave të të burgosurve: mbanin sefertasët në dorë, sillnin drekën. Sefertasët i radhitnin aty dhe disa oficerë, sikur parakalonin, lexonin emrin e te burgosurit. Kur panë një sefertas me emrin Uan Filipi, i ranë me shkelm, gjella u derdh dhe sefertasi rrokullisej bosh. Oficeri iu tha: "Qërohuni dhe të mos vini më, se ai e mori plumbin që meritonte!" E ëma dhe e motra e Uanit, pa bërë gëk, shtrënguan njëra-tjetrën dhe nisën rrugën e kthimit për në shtëpi duke ecur rrugës që merrte të përpjetën... Po t'i shikoje ato të dyja, dukej sikur vaiseshin si varka në furtunë duke bërë zigzaget e terrorit, pikëllimit dhe vdekjes! Një skenë që besoj se në asnjë ekran të botës nuk është shfaqur.

Pyetje: - Po ti nga e pe këtë skenë?

Përgjigje: - Kur u lirova, Safoja ime më tregonte... më tregonte me pikëllim kalvarin e saj dhe të familjeve të tjera të të burgosurve... (Të zezat nëna, të mjerat gra... ç'u kanë parë sytë dhe si kanë mbijetuar nga helmi që kanë pirë.)

Gjatë burgimit tim trevjeçar në izolim të thellë, vetëm Safoja kishte të drejtë të më sillte te dera e burgut sefertasin me pak gjellë, pa më takuar kurrë. Tre vjet.

Pyetje: A të ka ndodhur të humbësh shpresën për të jetuar?

Përgjigje: - Një pasdreke erdhi drejtori i burgut me hetuesin tim kryesor dhe më hoqën zinxhirët. Dallgët e mundimeve janë aq të furishme, sa nuk kuptohet se nga i shtyn era: ndaj jetës apo ndaj vdekjes. Më shpunë te biruca e fundit përballë nevojtoreve. E dija që ajo birucë

ishte për ata që do të pushkatoheshin. Më futën brenda, më lidhën përsëri këmbë e duar dhe dolën. Aty ishin tre të tjerë, të cilëve nuk ua dalloja dot fytyrat. Ata ishin të sigurt se do të pushkatoheshin. Nuk folën për disa minuta, pastaj dëgjova një zë:

- Pse je dënuar me vdekje!

- Si agjent i amerikanëve! Po ju?

- Ne? - heshti ca. - Unë...

Dhe tregoi se si ai kishte folur me një mik të tij për Enver Hoxhën, por në gjyq nuk i nxorën këtë akuzë, i thanë "agjent i shitur!"

- Unë e di mirë se jam dënuar për ato që fola për Enver Hoxhën. - Dhe vazhdoi: - Me sa di unë, gjer tani janë pushkatuar dymbëdhjetë veta... Kushedi sa të tjerë do të pushkatohen. Këta të dy janë dënuar me vdekje, se kanë djegur flamurin e Jugosllavisë që varej nga e djathta e flamurit tonë në Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare. E kishin pranuar fajin e tyre dhe thanë në sallë të gjyqit se nuk ishin penduar fare për aktin që kishin bërë, pasi Jugosllavia sundon këtu dhe jo qeveria e Tiranës.

Dëgjoja fjalë e psherëtima të njerëzve që prisnin me çaste të pushkatoheshin. Shumë më theri thënia e njërit (fytyrat nuk shiheshin, ishin në errësirë):

- Nuk u vrava në luftë nga fashistët dhe nga nazistët dy vjet në mal, po vritem nga plumbi i shokëve të mi!

U dëgjua një fështërimë në dritaren e vogël. Ishin krahët e një shpendi, ndoshta një lakuriq nate...

- Do të na vrasin, erdhi lajmi! - tha njëri.

Unë pyeta se nga erdhi lajmi. Në atë birucë të të dënuarve me vdekje kishte mbetur një profetizim: kur vjen ai zogu i natës dhe rreh krahët në hekurat e dritares sa një faqe libri, vijnë xhelatët dhe marrin viktimat për te bregu i lumit, për te vendi i ekzekutimeve...

Dhe me të vërtetë, aty nga ora dhjetë e mëngjesit, u hap dera e birucës dhe thirrën atë që kishte folur keq

për Enverin dhe ata të dy që kishin djegur flamurin e Jugosllavisë.

- Takohemi në atë botë, në mos pastë edhe atje ndonjë Enver tjetër që të na përvëlojë në kazanët e skëterrës...

KTHESA E ÇUDITSHME

Në darkë më thirrën lart në drejtori. Aty ishte Nesti Kerenxhi, zëvendësministër i Punëve të Brendshme. Më foli butë. Më pyeti dhe iu përgjigja:

- Unë flas vetëm me Koçi Xoxen!
- Koçi Xoxe nuk mund të vijë këtu!
- Më shpini mua tek ai. Vetëm me atë do të flas.
- Kërkon gjëra që nuk bëhen.
- Po një letër a mund t'i shkruaj?

Unë e njihja Nestin. E njihja mirë dhe ai më njihte mirë. U mendua dhe më tha:

- Shkruaje letrën.

Më dhanë një copë letër dhe një stilograf dhe shkrova:

"Koçi! Nëse të ka mbetur ndonjë fije shoqërie nga e kaluara jonë, të lutem për dy gjëra:

1. Jep urdhër të më pushkatojnë sa më parë, se nuk i duroj dot fyerjet e rënda dhe torturat çnjerëzore.
2. "Pse?"

E lexoi Nesti dhe më tha:

- Pse, nuk e dije ti organizatën e fshehtë të deputetëve? - Atëherë unë i thashë se me të vërtetë as që e kisha dëgjuar kurrë këtë organizatë. E mori letrën.

Mua më shpunë në një birucë tjetër, përballë me atë të Hasan Reçit. Në atë krah ishin me radhë dhe biruca me shokët: Spiro Ruço, Spiro Dhima, Uan Filipi, Islam Radovicka, Sinan Gjoni, Kolë Berisha...

Më lidhën këmbët dhe duart pas dhe u shtriva në

dysheme i trullosur dhe i handakosur. Mendoja e thosha: Sa i fortë është njeriu! Besoja se kafsha më e fortë e universit ishte njeriu normal.

Siç dukej, lart ishte ende Nesti Kerenxhi, prandaj me radhë i merrnin këta shokë dhe i shpinin në drejtori. Kjo punë vazhdoi dhe të nesërmen: shokët merreshin në pyetje nga Nesti. Të pasnesërmen, më thirrën lart përsëri. Në drejtori ishte vetëm drejtori dhe Nesti Kerenxhi.

- Letrën ia dorëzova Koçit..., - më pa me sy njeriu, - dhe më tha: "i thuaj Petros të flerë rehat..." Më kuptove?

Kur dola, më dha dorën. Dhe, kur u mbyll dera, ndërsa mua m'u këputën gjunjët nga një ndiesi e papri-tur, dëgjova zërin e Nestit t'i thoshte drejtorit:

- Në birucën e Petro Markos të mos futet asnjë oficer ose hetues pa lejen e Koçit. Ushqimet që i bien nga shtëpia, t'ia dorëzoni të paprekura, edhe cigaret... Më urdhëroi Koçi...

Zbrita shkallët me nge. Dëgjova zërin e Hasan Reçit, që ishte në birucën kundruall birucës sime:

- Petro, në dalsh i gjallë, kujdesohu për vajzën time. Shtatë muajsh është...

Dhe, atë agim, mandata erdhi... Hasan Reçi, Uan Filipi, Spiro Ruço, Sinan Gjoni, Islam Radovicka, Kolë Berisha - më duket tetë veta - i morën dhe i drejtuan për te bregu i lumit, ku i pushkatuan...

Jam plotësisht i bindur se jetën e kam nga Koçi Xoxe.

Unë komunikoja me Safon me anën e një shkrimi të hollë gati të padukshëm të bërë me majën e gjilpërës në rrethin e kapakut të sefertasit prej alumini. Me pak fjalë ne kishim zbuluar një komunikim sekret origjinal. Shkurt, bëja të ditur gjendjen time. Ajo pyeste. Kur shokët e mi u pushkatuan, i shkrova: "Shpëtova!" Kurse para dy ditësh, kur erdhi Kerenxhi dhe më tha se Koçi e kishte porositur "të flija rehat, të më jepnin ushqimet pa i prekur dhe të mos hynte njeri në birucën time pa

urdhrin e Koçit...", i kisha shkruar Safos në rrethin e kapakut të sefertasit: "Më duket se shpëtova!" Tani që me të vërtetë nuk u pushkatova si të tjerët, përsëri i shkrova: "Shpëtova për ty... që je munduar më shumë se unë!"

Pyetje: - Pastaj ç'ndodhi?

Përgjigje: - Erdhën në birucë, më hoqën hekurat e këmbëve dhe më nxorën në korridor, ku ishin edhe shumë të burgosur të tjerë. Na lidhën dy e nga dy. Mua më lidhën me Tika Tezhën, i cili, duke buzëqeshur hidhur, më tha: "Edhe ti këtu? - Pastaj, kur na shtrënguan fort duart, shtoi me të qeshur: - Aq je bërë i pandjeshëm, sa nuk lëshove asnjë psherëtimë. Mua m'u thye kocka nga shtrëngimi i zinxhirit!"

Ishim shumë: Të gjithë si skelete. Na nxorën përjashta. Ku po na shpinin? Nuk flisnim dot, se na dhanë urdhër të prerë: "Po hapi gojën njeri, do t'ia presim gjuhën!" Tika më shikonte dhe ngrinte supet. Tika ishte një shok që e njihja mirë: pasanik i madh që kishte ndihmuar shumë luftën me të holla dhe duke transportuar të plagosur partizanë dhe armë, se kishte makinën e tij. E kuptuam. Po na çonin te Burgu i Vjetër. Dhe me të vërtetë në Burgun e Vjetër na shpunë, në katin e sipërm. Na futën në një kaush të madh, ku ishin edhe të tjerë...

JETA NË BURGUN E VJETËR

Dy gëzime të mëdha:

1. Ardhja në burgun e vjetër, pa zinxhirë, me shokë, me libra.

2. Gëzimi tjetër i madh: U ndalën ekzekutimet me një vendim të Plenumit... Kështu që shumë shokë që prisnin ekzekutimin, si ing. Andrea Xega e të tjerë, shpëtuan nga vdekja.

Na vunë në një kaush, pranë ish-spitalit, që tani ishte bërë si zyrë e përkthimeve. Aty u takova me shokët e mi të vjetër, si me Demir Godellin, Koço Boshnjakun, Hito Sadikun, Nexhmi Ballkën e shumë e shumë të tjerë që kishin shpëtuar nga vdekja. Këtu pashë pas shumë kohe njerëz që mund të qeshnin, që bënin shaka, që lexonin libra, që përkthenin nga letërsia botërore për institucionet letrare qeveritare. Për mua dhe për të gjithë ata që erdhën nga ferri i Burgut të Ri, ky ishte gjysmëlirim.

Erdhi Stefo Grabocka nga Ministria e Brendshme dhe më takoi. Më tha: "Kur u kthye Koçi Xoxja nga Korça, u habit se si ti ishe arrestuar, mblodhi nënministrat dhe i pyeti: "Kush dha urdhër të arrestohet Petro Marko?" Dhe njëri nga ata i tha: "Urdhër nga lart!..."

Për të burgosurit kishte dy opinione:

Njëri opinion: Si është e mundur që Petro Marko të jetë këtu?! (Kështu u shpreh dhe ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku, kur erdhi për të vizituar burgun. Kur më pa mua, tha: "Shikoni bre se cilin kanë arrestuar! Luftëtarin e Spanjës...")

Opinioni tjetër: Ata që e dinin mirë çështjen, thoshin: "Si ka shpëtuar ky nga pushkatimi?!"

Në këtë mjedis të ri mes njerëzve, mora vesh se ishte bërë edhe gjyqi i deputetëve dhe ishin arrestuar e pushkatuar tërë miqtë e mi, me të cilët isha shoqëruar e kisha shkëmbyer mendime para arrestimit tim. Deputeti Shefqet Beja ishte varur në fushën e druve. Selaudin Toto, Enver Sazani, Gjergj Kokoshi e plot të tjerë ishin pushkatuar. Ata shpresonin që në Shqipëri të vendosej demokracia. Për mua ishte një goditje shumë e rëndë.

Unë u mblodha me Demir Godellin dhe Koço Boshnjakun; me ata rrija pranë e pranë dhe me ata haja bukën që na e sillnin nga shtëpia. Koço Boshnjaku kishte qenë

në Konare, pastaj shkoi në Bashkimin Sovjetik, ku më duket ishte edhe si konsull i Shqipërisë. Më duket se ishte përpjekur të dërgonte në Durrës dhe disa anije sovjetike me grurë, kishte bashkëpunuar dhe me Kostë Kolombon, që kishte një furrë në Odesë. Ky Kostë Kolomboja kishte ardhur edhe në Spanjë. Thonë se, kur gjermanët pushtuan Odesën, i shkruante një miku në Shqipëri, nga Parisi, ku jetonte: "Do të shkoj në Odesë, se ndoshta gjej furrën time, tani që s'ka më bolshevikë!" I ziu Kostë! Shpresonte se pas kaq kohe dhe ndryshimesh në Rusi do të gjente furrën e tij në Odesë... Për këtë Kostë, Koço Boshnjaku na tregonte shumë qyfyre dhe habitej se si kishte ardhur edhe ai vullnetar në Spanjë. Demirin e kisha njohur qysh nga viti 1932 dhe mund të them se ai ishte mësuesi i parë i komunizmit në Shqipëri. Tregonte edhe shumë anekdota për Fan Nolin në Berlin dhe për mënyrën si e bënte propagandën komunizmi, me Stalinin në krye. Po tregoj diçka për të qeshur:

Në Hamburg festohej 1 Maji, punëtorët kremtonin festën e tyre; ishin mbledhur në një teatër dhe flisnin me radhë shokë nga shumë kombësi. Dy gjermanë shkuan në një vapor kinez. I thanë një marinari kinez: "Eja me ne dhe për një orë do të të japim pesë dollarë!" Marinari kinez u tha se për një orë do të nisej vapori i tij. Ata i thanë: "Për gjysmë ore të duam". E çuan në teatër, ku bëhej mbledhja e punëtorëve, dhe ata që drejtonin mbledhjen, thanë se ky ishte përfaqësuesi i klasës punëtore kineze. Kinezi qeshte dhe thoshte: "Aman, se mos më ikë vapori!" - në gjuhën e tij dhe ata që ishin në tribunë, "përkthenin": "Thotë se sjell përshëndetjet e klasës punëtore shumëmilionëshe." Duartokitje, dhe, në mes të duartrokitjeve, kinezi iku me vrap se mos e linte vapori, që për pak do të nisej...

Demiri na tregoi përsëri atë historinë në Moskë për ditën e 1 Majit, kur e morën për të folur në një tribunë

para punëtorëve të një uzine dhe përkthyesi, i cili nuk dinte as edhe një fjalë shqip, bënte sikur i përkthente ato që thoshte Demiri, dhe masa duartrokiste stuhishëm.

Pas fjalimit, mes duartrokitjeve dhe shtrëngimeve të duarve, atij i ishte afruar një zonjë, e cila dukej që nuk bënte pjesë në atë turmë punëtorësh, dhe i ishte drejtuar frëngjisht: "Hapni sytë dhe shikoni si na ka katandisur ky sistem çnjerëzor! Pse bën sehir Evropa? Apo, dhe ajo pret këtë "parajsë të kuqe e të përgjakur?". Demiri ishte tronditur. Por ata që kishte pranë, e tërhoqën dhe i thanë se ajo ishte një agjente borgjeze.

- Ne ishim qorra! Nuk shihnim ç'bëhej! - tha Koçoja.

Dhe bisedonim shtruar. Koçoja ishte më elokuent dhe më me përvojë:

- Që nga Adriatiku e gjer tek oqeani Paqësor më shumë se një miliard njerëz besuan te komunizmi dhe tani, nën regjimin e kuq, sa miliona vuajnë e vdesin si ne! Katastrofë! Vetëm Stalini, siç thonë, ka zhdukur me miliona. Këtu te ne, në krahasim me popullatën, janë zhdukur e persekutuar edhe më shumë. Pse? Ka arsyet e veta. Ky sistem këtu nuk ka asgjë të përbashkët në themel me idealin tonë. Ky sistem po zbatohet sipas direktivave të agjentëve serbë, armiq shekullorë të Shqipërisë, Rankoviç, Miladin, Dushan e të tjerë, të cilëve kështu u intereson ta shohin këtë vend. U mbush bregu i lumit me kufomat e intelektualëve. Qarkullojnë fjalë se listat për arrestime dhe asgjësime vijnë nga Beogradi."

Përditë bënim biseda me zë të ulët në qoshen e korridorit të gjerë të katit të dytë të burgut, përballë zyrës së përkthimeve. Edhe Koçoja përkthente nga rusishtja. Tekstet vinin nga Ministria e Arsimit. Aty përkthente dhe Mirash Ivanaj nga latinishtja ose greqishtja e vjetër, aty përkthenin dhe Dhimitër Pasko, Gjergj Bubani e shumë të tjerë.

Unë nuk dua që këto shënime t'i shkruaj si Silvio

Peliko: "Le mie prixhioni - Burgjet e mia;" ose si Antonio Gramshi: "Letere ali intelektuali italiani"; ose si "Il milione" të Marko Polos... Dua të bredh me kujtimet e mia në ato "llogore" ku fantazia ishte arma e vetme e jetës dhe nata ishte motra e lirisë. Unë e njihja këtë burg që nga koha e Zogut, po atëherë ishin më pak politikanë, shumica qenë ordinerë. E vërteta ishte se në atë kohë të burgosurve politikë, siç ka shkruar disa pjesë dhe në romanin e tij "Burgu" Haki Stërmilli, mund t'u vinte në birucë nëna ose gruaja, ose motra dhe të shërbente ngandonjëherë. Në kohën e okupacionit italian burgu u bë shkollë revolucionare. Aty kishim kolektivin, hanim bashkë, mësonim bashkë dhe bënim kurse politike.

Kam qenë në burgun e Dhërmiut vetëm një natë, pastaj në burgun e Vlorës, se kisha bërë një trakt (traktin e parë antiitalian)... Pastaj në burgun e Fierit, në burgun e Tiranës, në burgun e Brindizit, në burgun e Barit, në burgun e Palermos, në burgun "Rexhina Çeli" të Romës... Isha njeri i rritur me ëndrrat që shohin të burgosurit, kur janë të rinj, dhe me çdo kusht nuk duan t'u vriten ëndrrat, po i mbajnë të gjalla, se ëndrrat e bukura, të lirisë, të dashurisë, të udhëtimeve në botën e çudirave, janë forca që i mban të gjallë ata që kanë një ideal, ata që besojnë dhe shpresojnë se bota ka si timon humanizmin, demokracinë, lirinë, vëllazërimin...

Pyetje: - Po a pati në atë jetë burgu ndonjë shkëndijë sado të vogël të realizimit të ëndrrave?

Përgjigje: - Më kujtohet një çast i paharruar. Oficeri Maqo Pecani, njeri i mirë (se kishte dhe oficerë me zemër njeriu) lejoi që Safoja ime të më shikonte përmes dy palë hekurave të katit të dytë. Më thanë të shkoja te hekurat. Përtej pashë ëndrrën time, Safon time, me të cilën jetoja aty ditë e natë, edhe në torturat më çnjerëzore. Çudi, duket se dashuria e saj, shpirti i saj i dëlirë kanë ndikuar shumë në qëndrimin tim të pathyeshëm...

Ajo kishte dritën nga prapa, unë dritën përpara... Kur më pa, ia shkrepi të qarit me të madhe dhe shqiptoi me dënesa: "Si e keni katandisur kështu...!" Vetëm dhëmbët më dukeshin! Qau. Unë e qetësova duke i thënë se shpejt do të mbaronte edhe ky kalvar yni... Vajza e re, e bukur, që kushedi se sa njerëz me pushtet i kishin thënë: "Braktise, se do të humbasësh edhe ti", - heshtte dhe duronte, më priste... Ajo ditë ishte për mua një apokalips! Nuk do ta harroj kurrë. Ishte një dritë shprese, pas gjithë atyre muajve, atyre tre vjetëve izolimi të thellë, atij terri të përgjakur.

Asnjeri nuk lejonin të takohej me familjen e tij.

Një ditë, Koço Boshnjaku më thirri në zyrën e përkthimeve dhe më lexoi dy vjersha të poetit Zoshenko, që u dënua rëndë nga Zhdanovi. E para kishte këtë përmbajtje: "Majmunët vendosën të bënin një shtet origjinal. Ndërtuan një kafaz shumë të madh, ku u futën të gjithë brenda, përveç udhëheqjes, që duhej të rrinte jashtë kafazit." Për këtë dhe për "Eugjen Onjegini në Peterburg", tema e së cilës ishte kjo: " Eugjen Onjegini, personazh i Pushkinit, u ringjall dhe shkoi në Peterburg, që tani quhej Leningrad. Hipi në tram duke mbajtur çantën në dorë. E shtynin, sidomos gratë e trasha, që binin erë hudhre dhe pordhe dhe që talleshin me të... Ky e humbi, se kujtoi gratë e dikurshme të Peterburgut, elegante dhe fisnike, dhe harroi të zbriste në stacionin ku duhej të zbriste. Zbriti në një stacion më tutje, ndërsa e shtynin dhe e shanin si borgjez të rrezikshëm... Kur zbriti, Onjegini nuk e kishte më çantën në dorë. Ia kishin marrë. Shkoi te zyra e policisë së stacionit dhe u ankua se i kishin marrë çantën. Dhe, ndërsa fliste, kishte marrë lapsin nga tryeza dhe e tundte. Oficeri i tha" "Ti e kishe në dorë çantën dhe ta morën. Ku ta gjejmë ne atë që ta mori ?" Onjegini i tha: "Është mirë që të bëhet një ligj që t'u pritet dora atyre që vjedhin!" Dhe oficeri, duke qeshur,

i tha: "Ma jep lapsin që more, se e kam në inventar... E, ç'thua ti, more i çmendur! Po t'u presim dorën atyre që vjedhin, sot populli rus do të ishte i tëri pa duar... Por ma jep lapsin, se edhe ty duhet të të pritet dora"."

Zhdanovi këtë Zoshenko dhe poeteshën Ahmanova i përjashtoi nga Lidhja e Shkrimtarëve.

Kishim krijuar një rreth të mirë me shokë si Mirash Ivanaji, Mitrush Kuteli, Arshi Pipa... Duhet të hap një parantezë, se përmenda Arshi Pipën. Kam dëgjuar shumë vjet më parë nga Radio Vatikani (shqip) poemën e Arshiut "Vloçishti". Se Arshiu kishte qenë në Vloçisht (të Maliqit) bashkë me Nexhmi Ballkën e të tjerë për të tharë kënetën e Maliqit... Skëterrë! Skëterrë e vërtetë! Të burgosurit mbyteshin në baltë dhe rojat i shtynin më thellë, që të mos dilnin më! Ka pasur kampe në Rusi e gjetkë, po si Vloçishti s'do të ketë pasur në asnjë vend! Cilido që rron ende dhe ka qenë në tharjen e kënetës së Maliqit, besoj se kurrë nuk mund t'i harrojë ato skena makabre... Të burgosurit politikë kanë punuar për ndërtimin e shumë veprave, si Rafineria e Ballshit, minierat famëkeqe të Spaçit, të Bulqizës e gjetkë... Kurse të burgosurit ordinerë kanë punuar në tarracat e famshme të Lukovës, të Ksamilit dhe të shumë fermave të tjera! Kanë punuar dhe për ndërtimin e banesave edhe në Tiranë, edhe në rrethe. Këto punime të sforcuara kanë munduar mijëra e mijëra djem e burra, të cilët në pikë të vapës dhe në shi e dëborë punonin përjashta si skllevër të antikitetit. Në prapaskenën e "Shqipërisë së lulëzuar dhe të lumtur" ishte e vërteta e hidhur: mijëra e mijëra djem e vajza që punonin angari në miniera, në çeljen e tarracave, në hapjen e rrugëve, në ngritjen e urave dhe të ndërtesave. Këtë përjetoi thuajse gjysma e popullit shqiptar.

BISEDA, EPISODE, PERSONAZHE...

Bëheshin këto pyetje, këto biseda:

1. Pse të dënuarit politikë të jenë së bashku me të dënuarit ordinerë?

2. Pse të dënuarit që dikur ishin me Partinë, kurse tani janë të dënuar për agjitacion e propagandë, të jenë bashkë me armiqtë e tyre gjatë Luftës, si ballistët, ata të "Legalitetit" e të tjerë?

3. Kishte nga ata që shuanin nga kalendari njëzet vjet - që nga 1924-a e gjer në vitin 1944. Se gjer më 1924 ishin me Fan Nolin, me "Bashkimin", pastaj pas 1924-ës u bënë me Zogun, me Italinë fashiste, me Gjermaninë naziste. Këta mburreshin se kishin qenë me Fan Nolin e me "Bashkimin", po kurrë nuk zinin në gojë as Zogun e as okupatorët. Ata me marifete varnin në gjoks dekoratat e demokracisë që u zhduk nga Zogu më 1924, dhe nuk zinin në gojë fare përfitimet që kishin pasur nga Musolini ose Hitleri. Këta tipa Branko Merxhani i quante "Vagabondë të historisë". Mirëpo ata përfituan shumë edhe nga ky regjim, se ishin të stërvitur në profesionin e dallkaukut, servilit, shërbëtorit të të madhit. Dhe pushteti këta i ndihmonte, se e dinte që nuk mund të hapnin gojën për padrejtësitë që bëheshin, se ishin vetë pjella e padrejtësisë, e imoralitetit.

- Siç duket, - na thoshte Koço Boshnjaku me zë të ulët aty në një qoshe të korridorit të burgut, - të gjithë pushtetarët të njëjtën rrugë ndjekin në vlerësimin dhe përkrahjen e njerëzve...

Episode: Në katin e poshtëm, te birucat, vazhdonin hetimet për ata që shtonin radhët e të burgosurve. Ndodhte nganjëherë që ndonjë i arrestuar, ndërsa e pyesnin hetuesit, përmendte ndonjë emër shoku të dënuar që ishte lart në katin tonë. Natën vinin policët, e merrnin të dënuarin dhe e çonin poshtë, në dhomën e

hetuesisë. Cilitdo që i dilte emri që të thirrej përsëri në hetuesi, tmerrohej se kushedi ç'ngatërresa të tjera do të kishte, kushedi ç'torturave do t'u shtrohej dhe mund të dënohej më shumë, ndoshta edhe me vdekje - gjëra që kishin ndodhur.

Aty, në dhomën e përkthyesve, ishte edhe profesor Filip Fishta, një si jezuit i rrumbullakët, i veshur me një këmishë të bardhë, të gjatë si raso, që nga koka gjer te këmbët. Po të vinte nga jashtë ndonjë komision ndërkombëtar për të parë gjendjen e të burgosurve dhe po të tregonin Filipin, do të thoshin se në Shqipëri të burgosurit ushqeheshin aq shumë, sa bëheshin si Çurçilli. Kur e thirrën Filipin natën të shkonte poshtë në hetuesi, iu pre gjaku, mezi ecte. Dy policët e mbanin nga krahu, se mos u hidhej nga shkallët, gjëra që kishin ngjarë edhe këta disa herë. Filipit iu zbardhën buzët dhe filloi të dridhej, kur hyri në dhomën e hetuesisë, ku dy oficerë, njëri i gjatë dhe tjetri i shkurtër, mbanin një hu në dorë. Në shesh ishte shtrirë ai që pyetej dhe akuzohej.

- Nuk na thua, zoti profesor (ky ton disi e zbuti Filipin), ju që merreni me letërsi dhe gjuhësi...

- Po... po... po... - përsëriste Filip ziu.

- Pra, ne këtu me këtë shok po zihemi për një fjalë. (Filipit iu çelën sytë dhe ngriti më shumë veshët.) Zihemi, se ky shok këtu thotë se fjala *njëmendësi* do të thotë *mentalitet*... Si qëndron puna?

- A për këtë më keni thirrur këtu?

- Po! - i tha ai hetuesi i gjatë që mbante një hu në dorë...

Filipi gëlltiti pështymën, humbi ndjenjat dhe u palos në tokë.

Hetuesit qeshën dhe pritën sa erdhi në vete. Ai me zë të mekur shqiptoi:

- Më falni sa të marr pakëz frymë... - dhe u tha se afrohej kuptimi i tyre.

- Mirë, profesor, tani shko! - i tha ai më i gjati. Dhe Filipi doli i kërrusur dhe i dërrmuar. Kurse hetuesi i shkurtër tha:

- Ama ç'armiq të popullit që kemi! U alivanos për një pyetje të thjeshtë... Këta do ta rrëzojnë pushtetin?!

Informacione: Ne mësonim çdo gjë që bëhej përjashta. Kishte të burgosur që informoheshin për çdo gjë, se i burgosuri i mban veshët si lepuri duke dëgjuar dhe fëshfërimën e gjethit.

"Nako Spiru vrau veten!"

Këtë ma njoftoi Safoja me anën e kapakut të famshëm.

Koço Boshnjaku qeshi me vete, se ai e njihte mirë Nakon, jo vetëm se e kishte nga Durrësi, po kishin bashkëpunuar: Koçoja si drejtor i përgjithshëm i Bankës së Shtetit dhe Nakoja si ekonomist (kishte mbaruar studimet e mesme tregtare në fillim në Korfuz, pastaj në universitet për ekonomi në Torino). Pas Çirimit, bashkë-punonin për çështjet ekonomike. Koçoja u mendua paksa, fërkoi fytyrën... ndoshta edhe sytë e njomur... dhe tha me një ton të egër: "Nakoja nuk e vret kurrë veten... e kanë vrarë!"

Ai arsyetonte kështu: Kur kishte vajtur Nakoja në Jugosllavi, për unifikimin e monedhës, siç duket nuk kishte rënë dakord me ta... Ata do të ishin zemëruar shumë dhe do t'i kishin thënë të madhit tonë: "Pse e mban atë... që kërkon të prishë unitetin tonë?!"

Ngjarje të papritura dhe të habitshme: Thanë se Titoja ishte zënë me Stalinin dhe do të arrestohej në Moskë, ashtu siç ishin arrestuar dhe zhdukur shumë sekretarë partie, po Dimitrovi e ndihmoi Titon dhe ai iku. Shpëtoi. Me të arritur në Beograd, thanë se Jugosllavinë e përjashtuan nga Informbyroja dhe nga Traktati i Varshavës. Këtu te ne, Koçi Xoxe dhe bashkëpunëtorët e tij të afërm të Ministrisë u arrestuan. Koçi u dënua me

vdekje. Thonë se, kur dëgjoi pretencën dhe vendimin e kryetarit të gjyqit Bedri Spahiu, tha pak a shumë këto: "A, maçok i zi, maçok i zi! Siç të vuri ty tani të më dënosh mua, ashtu do të vërë një tjetër të të dënojë ty!" E çfarë nuk thuhej. Na prunë në burg disa bashkëpunëtorë të Koçit, të cilëve nuk u afrohej asnjeri. Koço Boshnjaku na tha:

- E ç'faj kanë ata? Atë faj që kemi edhe ne! Prandaj vemi e takohemi me ta...

Të burgosurit e tjerë, me qëndrimin e tyre e shfaqnin hapur urrejtjen dhe nuk deshën t'u afroheshin atyre që kishin qenë në krye të Ministrisë së Brendshme, e cila i kishte arrestuar dhe dënuar...

M'u kujtua një pasazh i romanit të Aleksandër Manxonit "Të fejuarit". Encoja, protagonisti, shkonte në pazar. Kishte varur pulat tufë, kokëposhtë, dhe ato i nxirrnin sytë njëra-tjetrës: secila kujtonte se njëra e kishte lidhur tjetrën, prandaj e çukiste. Ato - thotë autori - nuk e dinin se cila dorë i kishte lidhur. Dhe shumica e të dënuarve nuk e dinin se cila dorë i vrau dhe i burgosi. Ishte po ajo. Dhe akuza ishte e njëjta: agjitacion e propagandë ose agjentë të anglo-amerikanëve.

Më thoshte një shok i Koçit, i dënuar me tridhjetë vjet, se asnjë arrestim ose ekzekutim nuk bëhej kurrë pa urdhrin e Enverit.

Do të bëhej Kongresi i Parë i Partisë dhe të gjithë shpresonin të liroheshin. Të gjithë bënin leckat gati për të dalë, se flitej që do të bëhej një anmisti e përgjithshme. Osman Gazepi, një njeri i njohur për thëniet e rënda, si të marra, po me kuptim, duke ndenjur te shkallët e duke parë të gjithë që bëheshin gati për të dalë (se po insistohej që Kongresi do ta bënte këtë falje të madhe, duke e ngarkuar Koçin si kasapin e gjithë kësaj situate dënimesh dhe ekzekutimesh) thoshte: "O ju mbylltë dera, ju mbylltë! - Këta mezi na mblodhën koqe-koqe këtu, dhe tani të na lëshojnë!..."

U bë një anmisti nominale. Unë dhe disa shokë të mi të vjetër, si Demiri, Koçoja e të tjerë, nuk u falëm, megjithëse kishim kaluar tre vjet në izolim.

Në atmosferë ndihej prishja e marrëdhënieve me Titon. Flitej se tashti po kërkonin të forconin lidhjet me Stalinin.

Shumë jugosllavë antititistë u hodhën këtej. U burgosën, po nuk deshën të bisedonin me asnjë oficer shqiptar. Ata kërkonin një përfaqësues të ambasadës sovjetike në Tiranë.

Kështu që tani u hoqën nga zyrat dhe shtëpitë portretet e Titos dhe u vendosën ato të Stalinit, krahas asaj të Enver Hoxhës.

Personazhe të rralla: Një nga këto personazhe ishte dhe Mirash Ivanaj, të cilin, kur erdhi nga Turqia, e prita unë dhe e vendosa në hotel "Vollga". Pastaj qeveria e emëroi në bibliotekë. Ai nuk fliste me asnjeri në burg. Unë i afrohesha dhe ai pranonte nga unë çdo gjë që i jepja. Nga të tjerët nuk pranonte as edhe një cigare. Kishte *ardhur nga Turqia* (se kishte ikur me Zogun, pasi kishte qenë ministër i Arsimit.) Në Turqi jetonte keq. Vendosi të kthehej, se kishte punuar gjithë jetën si një nga eruditët më të shquar të kulturës sonë. Kishte lënë këtu shumë artikuj studimorë, për të cilët kishte punuar gjithë jetën. Për ato u kthye, por nuk i gjeti më. Plaka që ruante shtëpinë, i tha se në kontrollin që iu bë, ata të sigurimit nuk lanë asnjë libër. Kishte studime për origjinën e gjuhës shqipe; studime për origjinën e kombit tonë; studime për ndikimin helen në gjuhën dhe qytetërimin tonë; studime për ndikimin e Romës dhe të latinishtes në gjuhën tonë; për ndikimin e gjuhës turke, të gjuhës sllave në gjuhën dhe në kulturën tonë. Dhjetë studime të plota - punë e një jete me *vullnetin e hekurt të Mirash Ivanajit*, për mua njëri nga më të kulturuarit midis më të kulturuarve gjatë gjithë historisë sonë kombëtare. Meqë

ai s'donte të pranonte nga askush asgjë. i shkrova Safos sime që mundësisht t'i dërgonte një pako të vogël në javë, pa emrin e saj. Ai çuditej dhe thoshte: "Kush më kujton mua?".

Unë ngandonjëherë bëja dhe vjersha. Kisha bërë një të bukur kushtuar Safos sime. Ia lexova dhe ai qeshi duke më thënë: "Duket se je poet, mbasi krijon dhe me pranga në tru!"

Mirash Ivanaji vdiq në burg. Kam një brerje ndërgjegjeje dhe për se do ta shpjegoj më poshtë.

Unë u dënova me një akuzë të rëndë, pa fakte reale! Pse pije cigare amerikane? Pse visheshe me uniforma ushtarake amerikane? Këto qenë faktet! Dhe unë, duke qeshur, përgjigjesha: "Ne kishim marrëveshje me aleatët amerikanë që të na dërgonin armë, veshmbathje e të tjera. Shumica u veshën me teshat amerikane, si ato që vishja unë. Madje ne ankoheshim dhe thoshim pse s'na dërgojnë më shumë (se ata i hidhnin me parashuta). Shumica e kuadrove tanë kishin po ato veshje ameri-kane." U akuzova pse botoja lajme në faqen e parë të gazetës "Bashkimi" për ndihmat e UNRRA-s për popullin dhe qeverinë tonë. Nga këto elemente rezultoi akuza e tyre: Agjent i anglo-amerikanëve dhe i Fulcit. Një akuzë absurde, qesharake e pa bazë, shkatërruese, ndonëse s'kisha bërë asnjë faj.

Tani të them fajin tim për Mirash Ivanajin: Kur dola, unë duhej të kisha shkuar te ministri i Punëve të Brendshme, që atëherë ishte Mehmet Shehu, dhe t'i kisha thënë se Mirash Ivanaji, një nga intelektualët më të shquar të Shqipërisë, po vuante. Unë, kur do të dilja nga burgu, i premtova se do të përpiqesha të takohesha me Mehmet Shehun e t'i lutesha: "Lirojeni Mirash Ivanajin. Ai vetëm një gjë kërkon: një vend në Bibliotekën Kombëtare për të punuar. Po të doni, lidheni dhe në tryezë... Ai vetëm të punojë kërkon." - Ja, këtë faj timin

e njoh si faj të rëndë, se ai në Bibliotekë do të kishte punuar dhe do t'i kishte dhënë kulturës sonë, sigurisht, po ta kishin liruar.

Pra, erdhi koha dhe më 15 maj të vitit 1950 u lirova pas një gjyqi ushtarak krejt formal, që më dënoi me tre vjetët e paraburgimit si armik të popullit.(?!) Tani fillonte një odise edhe më e ndërlikuar.

NËN DIELLIN E MJEGULLUAR TË LIRIMIT TIM NGA BURGU

Pyetje: - Si e ndjeve veten, kur dole nga pragu i portës së burgut?

Përgjigje: - Të them të drejtën, shumë herë kisha dalë nga burgu vite të shkuara, por, që të dilja i gjallë nga ky lloj burgu, nuk e besoja kurrë. U përqafova me shokët që lashë brenda, sidomos me ata me të cilët rrija më shpesh, dhe ja, u çel dera e hekurt. Përjashta më priste Safoja, që kishte pesë orë që qëndronte kundruall portës së madhe të Burgut të Vjetër. Çudi! Sytë m'i vrau drita e lirisë... por, kur pashë të më afrohej Safoja ime, m'u bë sikur ndriti gjithë planeti dhe për një sekondë gjithë errësira që jetova, m'u zhduk brenda një çasti.

Në një shtëpi të vogël dhe të vjetër (Rruga e Veriut ose "Bardhok Biba") një familje fisnike kosovare me mbiemrin Rizvanolli i kishte lëshuar një dhomë e kuzhinë të vogël në oborr familjes sime; ishte aty dhe vjehrra ime dhe biri i saj. Zija, Shefqet dhe Ali Rizvanolli, vëllezërit kosovarë të shpallur të deklasuar, të tatuar rëndë, pranuan në shtëpinë e tyre familjen e Safos. Ata u sollën si të ishin të afërt: nuk pranuan kurrë pagesë qiraje dhe i ndihmonin me se të mundnin. Nuk hanin gjë të mirë pa i bërë pjesëtarë, si të ishin një familje. Edhe kur dola unë nga burgu, vazhdoi e njëjta miqësi dhe zemërbardhësi. Ishin një familje e ndershme e me tradita, sidomos gratë e tyre fisnike, ashtu siç dinë të jenë motrat kosovare.

Vjehrra ishte nga familja Qafëzezi e Kolonjës dhe si burrëreshë e kishte ndihmuar shumë Safon të më priste e të punonte, për të më mbajtur mua dhe familjen. Ajo ishte një grua e rrallë, me edukatën e familjeve të mëdha, me parimet e një morali të shëndoshë shqiptar dhe me një objektivitet të pabesueshëm për një grua, me qëndrimin që mbante ndaj ngjarjeve të hidhura në Luftën e Parë Botërore, për të cilat fliste dhe gjykonte siç gjykonim Skënder Luarasi dhe unë.

Skënderi u çudit kur e dëgjoi të fliste, duke goditur kastën e saj, për qëndrime të gabuara dhe duke dhënë hollësi për vdekjen e P.N. Luarasit: si e kishte shpëtuar nga djegia kufomën e tij Dajlan beu, xhaxhai i saj, duke dërguar të armatosur trimin e tij Dake Luarasin, si ndërhyri për t'i bërë një varrim normal. Pas një bisede për rreth dy orë me vjehrrën time, Skënderi doli bashkë me mua i mahnitur se si ajo fliste për të vërtetën objektive pa iu trembur syri dhe tha: "Është fat i madh për mua që njoha një grua të tillë nga fisi i bejlerëve të Qafëzezit".

Gjatë gjithë jetës, me gjithë problemet e rënda që kaloi familja ime, ajo mbeti një grua që me logjikën e saj ndihmoi që jeta te ne të ecte normalisht. Pranoi burgun tim, pa u trembur. Punoi për mua dhe Safos, që ishte aq e re, i thoshte: "Të mos të shkojë mendja se mund të të lejoj ta ndash e të dyshosh për të se është spiun! Ai, është poet, është i ndershëm, i pashëm, për mua është si një shebender (që do të thotë ambasador). Do ta presim dhe do fati del i gjallë, se është rritur jetim rrugëve të luftës!"

... Isha si në hava. Ç'të bëja? Njeri nuk më afrohej. Ishte koha kur buka jepej me triska dhe triskë kishin vetëm ata që ishin në punë. Unë nuk isha në punë, gruaja nuk ishte në punë... ishim pa triskën e bukës. Shkova në Ministrinë e Arsimit dhe mezi arrita të flisja me një shok që punonte atje, me Sterjo Spassen, si dhe me Spiro

Xhain, që ishte dhe sekretari i partisë. Ata pas shumë muajsh mezi më gjetën një punë më 1952: korrektor letrar në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", që i kishte zyrat në bulevardin e madh dhe ku punonin shumë përkthyes pa marrë parasysh se në cilën parti kishin bërë pjesë. Drejtor ishte një Miço, i çalë; sekretare partie një grua: A.S. Punoja në një zyrë me mikun tim "X". i cili përkthente. Këtë "X". unë e tërhoqa nga qyteti ku kishte qenë mësues dhe e mora kur isha në gazetën "Bashkimi", se e njihja si poet dhe desha që në gazetë të kisha njerëz me talent e të kulturuar. Tani ai përkthente dhe përkthente shumë mirë nga frëngjishtja. Bisedonim hera-herës dhe ai çuditej pse më kishin burgosur...

Një ditë më thirri në zyrë A.S. atje ishin edhe dy shokë të tjerë të sigurimit. Më thanë të ulesha. Pastaj A.S. më pyeti se çfarë kisha folur me "X"-in. Unë i thashë se me atë flasim për çdo gjë, pasi jemi në një zyrë dhe shkëmbejmë ndonjë fjalë.

- Fol! - tha ai i sigurimit. - Çfarë i ke thënë shokut "X"?

Mblodha veten dhe thashë:

- Unë nuk mbaj mend se çfarë i kam thënë sot gruas sime dhe jo të mbaj mend se ç'muhabete bëj me "X"-in.

- I ke folur kundër pushtetit! - përsëriti ai i sigurimit.

U habita shumë. Mendova shumë. Thashë ta përmbaja veten, se kujtova gruan time të gjorë...

- Unë nuk flas me asnjeri kundër pushtetit, se për këtë pushtet kam dhënë edhe unë rininë time... Prandaj, thirreni këtu shokun "X" dhe le të thotë para meje se çfarë i kam thënë unë kundër pushtetit.

E thirrën. Ai erdhi dyllë i verdhë, se ishte shumë frikacak.

E pyetën:

- Fol! Çfarë të ka thënë ky armik i pushtetit?

Ai nuk i kthente sytë nga unë:

- Po të jetë burrë, siç thotë se është burrë, le ta thotë vetë ai... - tha dhe shikonte nga dritarja.

Kur ai tha kështu, me të vërtetë u nxeha shumë, se në jetën time rrallëherë jam nxehur:

- Shoku "X"! Ka dy lloj burrërie: një si imja dhe një si jotja. Ti, me burrërinë tënde, që e kam dhjerë, jetoje i lumtur në kohë të Zogut, kurse unë vuaja internimeve dhe burgjeve. Burrërinë tënde e kam dhjerë, se ka dy lloj burrërie: një si jotja dhe një si imja. Me burrërinë tënde jetoje bukur si pasha në kohën e Duçes. Atë burrërinë tënde e kam dhjerë. Kurse unë në atë kohë me burrërinë time torturohesha, burgosesha dhe internohesha. Edhe sot me atë burrërinë tënde, që përsëri e dhjes, ti jeton si pasha në këtë pushtet që ti e urren...

- Mjaft! - thirri njeriu i sigurimit. - Ti, shoku "X", shko!

Prisja të më hidhnin hekurat. Po ngjau kjo:

- Tani që do të bëhen shkurtime në zyra, këtë pushojeni...

Ata ikën dhe unë shkova në zyrën time, ku "X", sikur të mos kishte ndodhur asgjë,.vazhdonte të përkthente. S'ia hodha sytë. Më dukej si një hiç, një kërmë, një imoral.

U ktheva në shtëpi pa shfaqur asnjë shenjë shqetësimi. Gruaja punonte në oborr për një pllakat të madh, nga ata që i vendosnin në sheshin "Skënderbej". Mendoja shumë dhe parashikoja furtunë... Dhe furtuna erdhi. Pas disa ditësh më thirri shoqja e kuadrit, A.S., dhe më komunikoi pushimin tim për shkurtim kuadri.

Mendohesha ditë e natë se ç'duhej të bëja. Mbeta pa bukë. Më kështilloi shoku im Mane Nishova, që më tha t'i bëja një letër Mehmet Shehut, që ishte ministër i Punëve të Brendshme. E gjeta me vend mendimin e Manes, të cilit i vinte keq për mua, por që ai vetë nuk kishte asgjë në dorë që të më ndihmonte. Vendosa dhe i shkrova këtë letër Mehmet Shehut:

"Shkëlqesisë së tij Mehmet Shehu, ministër i Punëve të Brendshme.

Unë që po ju shkruaj këtë letër, quhem Petro Marko dhe të paktën veten time e quaj patriot të ndershëm. Nëse nuk është kështu, se ju i njihni ata që janë armiq, mos m'u përgjigjni... Kam qenë korrektor letrar në "Naim Frashëri", ku punojnë njerëz të të gjitha ngjyrave, madje dhe nga ata që bashkëpunuan me gjermanët dhe u pasuruan kur ne luftonim dhe vuanim. Erdhi një urdhër për shkurtim personeli dhe më gjetën mua të më shkurtonin... Tani dua t'ju pyes: Kush e ka fuqinë në dorë, ata armiq që bashkëpunuan me okupatorët apo ne?! Nëse e kanë fuqinë në dorë ata, na thoni të dalim përsëri në mal për të çliruar popullin nga këto shushunja..."

Letrën e bëra pa e pyetur gruan, se ajo nuk do të më lejonte kurrë. E shkrova dhe vajta në ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Nuk e dija që nuk hyhej nga dera e madhe, karshi ministrisë tjetër, por hyhej nga një derë prapa ndërtesës. Ndenja ca duke pritur, kur për fat po hynte andej zëvendësministri i Mehmetit, Mihallaq Ziçishti, i cili më buzëqeshi me mirësi dhe më pyeti se ç'kërkoja.

- Kam një letër për ekselencën e tij Mehmet Shehu dhe nuk e di se si mund t'ia dorëzoj...

Ai më buzëqeshi:

- Pse i thua ekselencë?! Ti e ke shok! - tha duke më rënë në sup. - Ma jep mua letrën dhe do t'ia jap që tani. Mos u bëj merak. - E mori letrën dhe u fut brenda.

Ishte ditë e premte, kur ia dhashë letrën. Të shtunën në drekë, erdhi një civil në shtëpi, ose më mirë në konakun tim të mjerë, dhe pyeti:

- Këtu banon Petro Marko?

Edhe vjehrra, edhe gruaja u trembën. I thanë se aty banoja. Unë dëgjoja dialogun:

- Ku është tani?

- Këtu! - iu përgjigj vjehrra ime, se e pa që nuk kishte ndonjë fytyrë të zymtë.

Dola në oborr, ai më dha dorën dhe më tha se më kërkonte shoku Mehmet Shehu në zyrën e tij.

Gruaja u tremb pa masë dhe m'u drejtua me lot në sy:

- Ç'ke bërë?

- Mos u mërzit, - i tha ai dhe u nisa bashkë me të për te Mehmet Shehu.

Kur hyra në zyrën e Mehmetit, ai u ngrit më këmbë, më përqafoi me sy të njomur.

- Ku je, more i uruar! - Më pa që nga koka e gjer te këmbët, me ato këpucë të vjetra, me këmishë të vjetër... dhe më tha:

- Besomë: unë kam një djalë që quhet Vladimir! U bë gati tetëmuajsh dhe unë nuk e kam parë... Po ti, me të dalë nga burgu, duhej të vije tek unë... Nga bridhje?

U ula dhe ai më pyeste për shumë gjëra. E pashë që ishte shumë nervoz, nuk e zinte vendi.

- Eh, ta dish... - i shpëtoi kjo frazë, pastaj ndërroi bisedë. Dhe, që të më qetësonte, nisi të më tregonte episode të paharruara nga Spanja. Ndenja aty gati një orë. Pastaj më tha:

- Do ta shtroj lart çështjen tënde dhe do të ngarkojmë shokun Bedri Spahiu të merret me punën tënde. (Bedriu ishte në atë kohë ministër i Arsimit.)

U përqafuam gati me lot në sy dhe u ndamë, sikur ta dinim se ç'po gatuhej në krye të Partisë...

Nuk ishte më ai Mehmet që njihja unë dhe shokët e tij, por një Mehmet tjetër. Ai armikun deshi ta kishte përballë dhe jo si tani, që e kishin ngarkuar me atë detyrë delikate, të zbulonte ata të Kolonës së Pestë. Më parë ishin jugosllavët ata që zbulonin dhe zhduknin mijëra e

mijëra të Kolonës së Pestë, me urdhër nga lart. Koçi zbatonte urdhrat. Mehmeti, me të cilin ndenja afro një orë, e dinte që biseda jonë regjistrohej, prandaj pati guximin dhe tha: "Unë jam nga ata që armikun e kam luftuar ballë për ballë... Kjo punë nuk më përshtatet, e kam të vështirë."

Kur u ndamë, përsëri u përqafuam dhe aty më pyeti për shokët e tjerë të Spanjës, sidomos për Skënder Luarasin, të cilin e nderonte shumë.

- Të gjithëve jepu të fala nga unë!

Dhe u ndamë pasi më përcolli deri te dera e zyrës së tij.

Ne në burg, me Koço Boshnjakun, me Demir Godellin e disa të tjerë kishim folur dhe për Mehmetin dhe çuditeshim se si i duronte dhe i pranonte ky këto persekutime dhe ekzekutime që s'kishin të sosur. Kishte këtë karakter: i bindej verbërisht superiorit të tij, por edhe kërkonte t'i bindeshin verbërisht vartësit e tij.

Pas disa ditësh më thirri Bedri Spahiu, ministër i Arsimit. Më priti krahëhapur dhe më tha:

- Bëre mirë që u drejtove më lart se ata... vendosin. (Bënte aluzion për të madhin fare.) U mblodhëm dje në byro dhe u shtrua çështja jote. Të gjithë kishin mendim unanim që ti të sistemoheshe, por tani për tani jo si gazetar. Folën të gjithë mirë për ty duke të cilësuar si një nga revolucionarët më të devotshëm e të ndershëm dhe më porositën të të sistemoja. Meqë ti tani për tani nuk mund të ushtrosh profesionin tënd në gazetari, unë mendova të bëhesh profesor... U vendos që burgu i vuajtur nga '47-'50 të mos të përmendet më.

Që atë ditë unë u emërova profesor në shkollën pedagogjike me bazë fillore. Fillova nga puna dhe nisa të shkruaja në atë kasolle ku banoja. Nisa "Hasta la vistën". Shkruaja natën me një llambë vajguri në një si kotec...

ROMANI I PARË: "HASTA LA VISTA"

Pyetje: - "Hasta la vista" qe romani yt i parë pas burgut?

Përgjigje: - Po. Ishte vepër e vëllimshme. Pasi e mbarova, ua dhashë ta lexonin tre shokëve nga të Spanjës për të më bërë ndonjë vërejtje: e lexuan Skënder Luarasi, Mehmet Shehu dhe Zef Prela, që të tre nga shokët më të mirë të Spanjës, që do të më ndihmonin me vërejtjet e tyre. E lexuan dhe cilido më bëri dhe ndonjë vërejtje, por që të tre e kishin pëlqyer shumë. Mehmeti më tha se me këtë vepër do të bëja armiq shumë shkrimtarë dhe se, duke kaluar koha, ajo do të çmohej më shumë, se ishte monumenti i shqiptarëve në Spanjë. Më bëri këtë propozim: "Shto pak më shumë për Pasionaren..." - dhe unë i tregova këtë: "Nazim Hikmetit, kur ishte në burg, i thanë të bënte një poezi për Mustafa Qemalin, që ta lironin... Ai u përgjigj: "Kur të vdesë Mustafai, atëherë po... se nuk e dimë ç'fund do të ketë". I thashë se nuk bën që shkrimtari të ketë personazhe personalitete të gjalla. Më tha: "Ti e di vetë punën tënde. Po romanin e ke qarë..."

E çova në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve. Ma mbajtën ca kohë dhe më lajmëruan ta tërhiqja, se nuk do të botohej. Ishte një goditje. I telefonova Mehmetit (ishte kryeministër në atë kohë) se romanin nuk ma botonin. Atëherë ai i telefonoi kryetarit të Lidhjes, mikut tim të vjetër Dhimitër Shuteriqit, dhe i tha: "Të më bëni një relacion me shkrim pse nuk botohet romani "Hasta la Vista!"

Dhimitri më thirri të pinim një kafe, në kafe "Tirana", dhe më lexoi relacionin që i bënte Mehmetit. Por më tha me zë të ulët: "Ta dije ti se kush e ndalon botimin e romanit!" E pata të qartë se për kë e kishte fjalën, se ai ngriti dorën lart dhe zëri i dridhej.

Mjerisht, ata të revistës "Nëntori", ca njerëz skema-

tikë, nga frika për emrin tim, hoqën pjesë shumë të mira nga romani, sidomos pjesët luftarake, duke i quajtur natyraliste... Megjithatë romani u botua, veçse i cunguar. (Dorëshkrimin e plotë e kam në shtëpi. Shyqyr që s'ma morën gjatë persekutimit që më bëri sigurimi i shtetit: kur arrestuan djalin më 1975, shumë dorëshkrime, fotografi e të tjera m'i morën.) Romani u botua dhe u nderua me çmimin e Republikës. Ia di për nder Mehmet Shehut, që më hapi rrugën e shkrimit, se do të kisha mbaruar keq.

Pyetje: - Po romani "Qyteti i fundit"?

Përgjigje: - Edhe romani i dytë "Qyteti i fundit" pati peripecitë e veta. E mbarova së shkruari dhe ia dhashë ta lexonin përsëri: Mehmetit, Skënder Luarasit dhe Zef Prelës. Mehmeti më tha:

- Hiqi ato fjalë e fjali banale dhe pornografike, se, po i le, djemtë e mi nuk do t'i lë që ta lexojnë.

- Po atë gjuhë kanë prostitutat, kontrabandistët, gjithë ata italianë matrapazë dhe feministë... nuk e kanë gjuhën të zgjedhur si këtu në kryeministri...

Mehmeti qeshi dhe më tha:

- E di vetë ti. Po romani ka një kuptim të thellë universal: ai që kërkon t'i zërë derën tjetrit, ikën pa brekë... si italianët që erdhën të bëheshin zot të këtij vendi, dhe u katandisën të iknin pa brekë.

E shpura në Ndërmarrjen e Botimit. U bënë recensat dhe më thirri drejtori, miku im Spiro Xhai. Më tha:

- Duhet të heqësh faqet me fjalë banale dhe me natyralizëm të theksuar. Ne jemi të realizmit socialist.

E tërhoqa romanin duke i thënë:

- Unë kështu shkruaj dhe nuk shkruaj gjëra donkishoteske!

Pas ca kohësh, kryeministri Mehmet Shehu, siç e kishte zakon ai që u bënte nga një vizitë ndërmarrjeve, i bëri një vizitë dhe Ndërmarrjes së Botimeve. E priti drejtori Spiro Xhai dhe u përgjigjej pyetjeve që i bënte

Mehmeti. Pastaj Mehmeti e pyeti nëse kishin ndonjë kërkesë. Spiroja, pasi foli për punët e ndërmarrjes, i tha:

- Petro Marko na ka dërguar këtu një roman me një natyralizëm që nuk i shkon realizmit socialist. Erdhi dhe e tërhoqi romanin, se nuk i pranoi vërejtjet që i bëmë për të mirën e tij!

Mehmeti, pasi e dëgjoi, qeshi dhe i tha:

- Ai nuk më dëgjoi mua dhe jo të të dëgjojë ty... Merrja romanin dhe botoja ashtu siç e ka shkruar ai vetë.

Kështu që romani "Qyteti i fundit" u botua pa hequr asnjë presje, prandaj dhe është romani më i arritur ndër romanet e mia. Për këtë roman kritiku dhe miku im Dalan Shapllo, me guxim, mbrojti mendimin se ky ishte romani i parë modern shqiptar.

Romani pati sukses, më përgëzuan njerëzit e kulturës, po jehona e tij në shtyp vdiq. Ai nuk u ribotua më.

Çuditërisht, në vitin 1969 Inasuke Hazama, një piktor i dëgjuar japonez, i cili kishte qenë për vizitë në Shqipëri dhe unë i kisha falur si dhuratë romanin tim (sigurisht shqip), më dërgoi një pako në Lidhje. Në atë pako ishte romani "Qyteti i fundit", i ndarë në dy vëllime, i botuar japonisht. Gjithashtu, ishte edhe një gazetë japoneze në të cilën vlerësohej romani dhe unë, si autor i tij. Më erdhi një letër nga përkthyesi japonez, që çuditërisht e zotëronte shumë mirë shqipen, i cili më ftonte në Japoni për t'u njohur dhe për të marrë shpër-blimin për romanin. U drejtova në institucionet përkatëse dhe sigurisht mora atë që prisja: përgjigje negative. Kështu, as japonezit të largët, i cili me vlerësoi kaq lart punën, nuk iu përgjigja dot.

Sigurisht, një shkrimtar kurrë nuk arrin të shkruajë më shumë se pesëdhjetë për qind të atyre veprave që ka ëndërruar ose planifikuar. Unë ende nuk kam shkruar as pesë për qind të atyre që kam planifikuar... Shumë tema... po shumica me karakter internacional.

Pyetje: - Si e ndieje veten si krijues brenda kornizave të kërkesave të kohës?

Përgjigje: - Nën diktaturë, pas burgut tim me një izolim të rëndë trevjeçar, në vitet që pasuan, ëndrra për të realizuar vepra letrare ishte thuajse e paarritshme. Atëherë e gjeta çelësin dhe zgjodha temat e dashura për mua: luftërat e trimave, të popullit tim për liri, pavarësi e çlirim.

Kështu që më vonë shkrova romanin "Halimi", romanin "Stina e armëve", për të cilin më ka ndihmuar me shumë materiale Safoja, që kishte shoqet e saj partizane si Liri Arapi etj., romanin "Ultimatum", romanin "Ara në mal", romanin "Një emër në katër rrugë", që u bë kar-ton, por që besoj se tani do të botohet (siç u bë karton dhe përmbledhja e vjershave të mia të zgjedhura), romanin "Një natë dhe dy agime", që nuk u lejua të botohej, qëndroi për shumë vjet në dorëshkrimet e mia. (Në vitin 1988, kur isha përsëri shumë i sëmurë, në prag të vdekjes, Xhevahir Spahiu, pasi u përpoq në instanca të larta, nuk e di se ku, që mua të më jepej përsëri e drejta e botimit, e mori këtë roman, e redaktoi dhe e reduktoi ai vetë, në mënyrë që të mund të shihte dritën e botimit. Origjinalin e kam të pabotuar. Botimit të reduktuar iu përshtat titulli "Nata e Ustikës". Ky roman u quajt romani më i mirë i vitit dhe unë, në gjendjen time të rëndë shëndetësore, pata një gëzim të madh.)

Në vitin 1963 miku im më i mirë, poeti Drago Siliqi, në atë kohë drejtor i shtëpisë botuese "Naim Frashëri", u nis për një vizitë në Kinë dhe mori me vete dorëshkrimin e romanit "Një natë dhe dy agime", që ta lexonte në orët e lira, për të dhënë sa më shpejt përgjigjen lart. Pas disa ditësh më mori Spiro Çomora në telefon dhe më dha një lajm të papritur, tepër të hidhur: "Petro! Avioni ku gjendej Dragoja, duke u kthyer nga Kina, u rrëzua në Irkutsk në zbritje e sipër, mbi aerodrom." Dhe Spiroja, i helmuar,

më tha se Dragoja kishte ndërruar jetë. Mbylla telefonin, i thashë Safos lajmin e hidhur, se edhe ajo e deshi shumë, mora një stol dhe dola në ballkon. Më rridhnin lotët sikur të isha fëmijë. Humba përsëri një shok e mik të dashur. Më vonë, Drita, gruaja e tij, më tregoi se në çantën e Dragos u gjetën dy palë këpucë të vogla, që ishin për vajzat e tij të mitura, dhe, midis sendeve të tjera, ishin shpërndarë nëpër aerodrom dhe faqet e romanit tim, të cilat i mblodhën të pranishmit dhe ia sollën familjes.

Unë shkrova si poet, si gazetar e si shkrimtar, duke iu nënshtruar mundësisht sa më pak kërkesave dhe rregullave të krijimtarisë së kohës, por u kritikova ashpër, u dënova me heqjen e së drejtës së botimit dhe disa nga veprat m'u bënë karton, pa dalë në qarkullim, duke më mohuar kështu gëzimin e krijimit. Për një artist kjo është e barabartë me vdekjen. Ky ishte një lloj tjetër burgimi dhe izolimi: heshtja. Emri im u hoq nga të gjitha antologjitë, tekstet shkollore, në plenumet e Lidhjes nuk përmendesha kurrë më dhe asnjë organ shtypi nuk mund të fliste për mua, pra më keq se të kisha vdekur; unë vërtet isha gjallë, merrja frymë, shikoja, mendoja, dëgjoja, gjykoja, por në këtë lloj heshtjeje e ndjeva se isha eliminuar si krijues.

Më 1974 u bë një mbledhje në Ministrinë e Arsimit, për të më përjashtuar nga Lidhja. U kritikova për një vjershë, që gabimisht faqosësi e kishte vënë si të kohëve të fundit, kurse ajo vjershë ishte e serisë së "Lotëve të mërgimtarit": *"Seç u mbyll dera e mërgimit/ dhe tanithi do të vuaj/. Vendi im sot prej mjerimit/ do të më duket i huaj/"* e të tjera... (vjershë nga cikli "Lotë mërgimtari" shkruar në Zhapion të Athinës dhe që m'i ruante Dhimitër Shuteriqi, i cili mund t'i ketë edhe sot). Kryeministri u skandalizua për këtë vjershë (se thuhej aty: nga vjershat e fundit të autorit), prandaj mori në telefon Ndërmarrjen e Botimeve dhe u kërkoi një sqarim: "Kjo vjershë e fundit

e Petro Markos kur është shkruar?" U mblodh me të shpejtë organizata-bazë e Partisë dhe nisi diskutimi. Folën e folën pastaj një "shoku" im i vjetër tha: "Petroja e ka shkruar tani atë poezi." Kështu i raportuan Mehmetit, i cili u zemërua pa masë, duke më quajtur të çmendur, dhe propozoi ai vetë që të merreshin masa kundër meje.

Mbledhja u bë në Ministrinë e Arsimit. E kryesonte miku im Mantho Bala. Më pyetën për atë vjershë dhe unë e nxora nga xhepi të botuar më 1935: "Gabimi është i faqosësit. Gjëra që ndodhin në shtypshkronja..."

Pastaj filluan të kritikonin personazhet e romanit që u bë karton: "Një emër në katër rrugë". Bënin pyetje si kjo:

- Pse tetar Rizon, komandant xhandarmërie në fshat, që e vë në lojë, e ke bërë nga Kuçi?

U thashë:

- Po Zogu nuk merrte xhandarë dhe tetarë nga Danimarka, po nga trevat tona.

Folën e folën sikur të kisha bërë ndonjë vepër kriminale, pastaj ma dhanë fjalën mua, pasi vendosën që unë të hiqesha nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe të paguaja shpenzimet e botimit voluminoz të romanit "Një emër në katër rrugë".

- Unë nuk kam para për të paguar dhe asgjë të kushtueshme, por gruaja ime ka një makinë qepëse. Merreni dhe shiteni... Pastaj dua të them dhe këtë: Pse e bëtë këtë mbledhje pikërisht sot që është Shtatë Prilli, dhe nuk e bëtë dje më gjashtë prill ose nesër më tetë prill. Pra kjo mbledhje e Shtatë Prillit ka një kuptim politik. Ndoshta do të akuzohem se e kam përgatitur unë 7 prillin e vitit 1939. - Dhe ika pa përshëndetur njeri. Të gjithë më dukeshin si inkuizitorë. Po dhe ata nuk kishin faj. U përjashtova nga Lidhja, më hoqën të drejtën për të qenë shkrimtar në profesion të lirë dhe të

drejtën e botimit për një afat të pacaktuar. M'u hoq edhe triska e veteranit. Fyerje pas fyerjeje. (Njëkohësisht u mor masë edhe kundër redaktorit të romanit, mikut tim të mirë, poetit Llazar Siliqi. Me sa mbaj mend, e shkarkuan nga funksioni i sekretarit të partisë të Lidhjes së Shkrim-tarëve) Në romanin "Një emër në katër rrugë", për të bërë analogji me kohën që jetoja, m'u duk e volitshme që të vendosja ngjarjet në kohën e mbretërisë. Dhe kështu bëra. Dua të them lidhur me këtë se e kam nxirë më tepër nga sa ishte atë kohë, për këtë qëllim. Por kjo u kuptua dhe romani u bë karton. Për një ribotim të mund-shëm kam lënë shënimet përkatëse.

Një shënim që harrova ta shkruaja më parë: Më 1959, pasi botova "Hasta la vistën", që u prit shumë mirë nga lexuesit (vite me radhë të gjithë më përshëndetnin në rrugë: "Hasta la vista"), po kremtohej njëzetvjetori i Revolucionit për Mbrojtjen e Republikës Spanjolle nga agresorët fashistë të brendshëm dhe të jashtëm. Atëherë Kominterni i pati bërë thirrje proletariatit botëror që të ndihmonte me vullnetarë Republikën Spanjolle. Të gjitha vendet që patën dërguar vullnetarë në Spanjë, duhej të botonin një vëllim për Luftën e Spanjës. Këtë urdhër mori Komiteti Qendror. Ata më thirrën mua dhe më dhanë të gjitha mundësitë që të botonim edhe ne një libër të tillë. Pra ma ngarkuan mua këtë detyrë. Kisha kujtimet për Luixhi Longon, për brigadën "Garibaldi", kisha një botim francez dhe "Vullnetarin e lirisë" që botuam në Madrid.

Fillova nga puna dhe ngarkova të gjithë shokët të shkruanin nga një kujtim për luftën e Spanjës. Skënder Luarasi, Zef Prela, Mane Nishova, Mehmet Shehu i shkruan. Ato të Justina Shkupit dhe të Iljaz Pashait i përgatita unë, duke biseduar me ta. Mehmeti bëri parathënien dhe botoi aty një poemë të tijën *"Adelante, camaradas!"*

Pak ditë pas botimit, Mehmeti na ftoi për një piknik në bregdet, te pishat tej Shkëmbit të Kavajës. Na porositi të mos merrnim asgjë me vete, se shpenzimet do t'i bënte

ai. Shkuam në kodrën me pisha dhe gjetëm një vend të mirë. Ishte një takim i ngrohtë, bëmë fotografi dhe nënshkruam kopjen e librit "Lufta e Spanjës", secili për të tjerët, kështu që çdo kopje që mori secili, kishte nënshkrimin e të gjithëve. Propozimin për t'u dhënë titullin "Hero i Popullit" të rënëve në luftën e Spanjës e kam bërë unë bashkë me shokët e mi Skënderin, Manen, Zefin, Iliazin, Justinën, duke e motivuar kështu: "Krahas 28 mijë dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare le të qëndrojnë me krenari edhe këta pesë djem shqiptarë që dhanë jetën në Luftën Antifashiste në Spanjë." Propozimi u bë që të shpallen "Heronj të Popullit", dhe ashtu u bë.

Me keqardhje them: Termi "aventurier" për luftëtarët e Spanjës qarkulloi në disa rrethe të larta shoqërore. Ky ishte epiteti denigrues me të cilin jo vetëm në Atdheun tim, por edhe në shumë vende të botës, u cilësuan luftëtarët e lirisë, antifashistët e shquar, të cilët morën pjesë në atë luftë. E dëgjuam atë që në Francë e vazhdoi të përshpëritej edhe kur u kthyem në atdhe. Kur diktatura më padiste mua me epitete të tjera, midis tyre radhitej edhe termi "aventurier". Kjo ishte një gjë që na rëndonte në shpirt që të gjithëve. Ndihej që bëhej qëllimisht.

SKENARI PËR FILMIN E PARË SHQIPTARO-SOVJETIK

Do të bëhej, në bashkëpunim me Kinostudion e Moskës, një film për luftën tonë partizane dhe skenaristi do të ishte shqiptar. U ndamë në tri grupe: Mbaruam skenarët, i mori Kinostudioja, i përktheu rusisht dhe, kur erdhi në Tiranë regjisori i dëgjuar Çuhrai me grupin e tij, i lexuan të tre skenarët. Na thirrën në hotel "Dajti", ku ishte Çuhrai. Unë mora me vete edhe Zef Prelën, shokun tim të Spanjës, që dinte rusisht.

Porsa u mblodhëm, Çuhrai tha: "Na ka pëlqyer shumë skenari i shkrimtarit Petro Marko, me titullin "Bora e kuqe"... Do të bëjmë një film artistik që të ketë jehonë, se është një temë shqiptare dhe e shkruar me art..."

Ndërkohë që Çuhrait po i flisnin disa nga të pranishmit, ai më shikonte në sy. Dhe unë e vështroja pa kuptuar se ç'thuhej. U ngritëm. Çuhrai i tha drejtorit të Kinostudios: "Ne po ikim! Nuk kemi mundësi të bashkëpunojmë!" - dhe dolën. Këto m'i tha Zefi. Të nesërmen Çuhrai me ekipin e tij iku i zemëruar dhe Kinostudioja e Moskës na dërgoi një ekip me një regjisor tjetër. Për skenarin tim, çuditërisht, nuk u fol më fare. Dikush më tha se Çuhrait i kishin thënë "shkrimtari Petro Marko nuk shikohet me sy të mirë nga Partia, prandaj mos insistoni për skenarin e tij".

I revoltuar bëra një letër drejtuar kryeministrit, duke i shprehur indinjatën për luftën që po i bëhet artit: "Nuk do të thoshin ky është filmi i Petro Markos, por do të thoshin: film shqiptar!"

Skenari "Bora e kuqe" është ende në Kinostudio, po nuk doli ndonjë regjisor që ta realizonte. Është pak a shumë lufta jonë me personazh kryesor heroinën Zonja Çurre, nga Tragjasi, së cilës i kam kushtuar edhe një vjershë të dashur "Vajza e Labërisë". Me një fjalë, e ndieja se krijimtaria ime hap pas hapi ndeshte në barrikada njerëzish që nuk shfaqeshin. Kjo gjë më lëndonte shumë, sepse unë secilën vepër e mendoja dhe e hidhja në letër me gjithë sinqeritetin e shpirtit tim.

DRAMA E NJË DRAME

Do të përkujtohej 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut. Duhej bërë një spektakël. Unë kisha botuar në

revistën "Drita", një tregim "Male, male të bardha..." Më thirri Ramiz Alia në aparatin e Komitetit Qendror dhe më tha: "Atë tregim që ke botuar në "Drita" për Skënderbeun, a mund ta përpunosh në formën e një drame për t'u shfaqur me këtë rast?"

I thashë se do të mundohesha. Në këtë kohë kishim marrë urdhër të shkonim në terren për t'u njohur me realitetin. (Kjo ishte një formë kineze.) Unë shkova në fshatin tim dhe vendosa që atë tregim ta ktheja në dramë. Fillova nga puna. Por ndërkohë shkoja dhe poshtë te bahçet, ku punoja me fshatarët e mi të mirë, që atë kohë krasitnin agrumet, pasi kishin lëshuar lule, dhe më mësuan se si të shikoja sa lule kishte një degë, të hiqja të dobëtat dhe të lija ato që ishin më të shëndosha.

Erdhi një djalë nga fshati dhe më lajmëroi se në shtëpi kishin ardhur disa kinezë. Shkova në shtëpi. Motra ime Lilo i kishte pritur shumë mirë, mbetën të kënaqur edhe se ata vërtetuan që unë isha në punë me fshatarët. Për këtë punë kishin ardhur: Punonin shkrimtarët apo flinin? Ambasadori kinez, sekretari i tij, një i dërguar i "Hsinuasë" dhe një shok shqiptar përkthyes konstatuan se unë po e realizoja edukimin tim në gjirin e masave.(!) Motra i kishte qerasur, por ishte koha e drekës dhe ata s'kishin se ku të drekonin: kampi nuk ishte hapur ende, restorant nuk kishte. Të shkonin në Vlorë, duheshin tri orë... Prandaj i thashë përkthyesit: "Le të rrinë të marrin një kafshatë bukë e kripë... se nuk është koha për të ikur". Ata pranuan. Shkova poshtë dhe e pyeta motrën se ç'kishte për drekë. Ajo më tha se kishte një tenxhere me fasule... "Po shko lart ti, se i rregulloj unë!" - tha ajo dhe thirri një mbesë, që ta ndihmonte...

Për pak dreka u shtrua: motra dhe mbesa u vunë përpara nga një pjatë fasule të ziera me një gisht vaj ulliri përsipër dhe me limon. Në mes vunë një pjatë me vezë të ziera, të bëra sallatë, dhe djathë... Buka ishte e

vakët, e bërë në shtëpi. Nxorën dhe dy shishe me verë shtëpie. Dhe filluam të hanim. U kërkova ndjesë për këtë drekë të varfër; motra e ndiente veten të turpëruar: pse nuk e lajmërova më parë, që të therte kecin? Pashë që pjatat i fshinë. I thashë përkthyesit t'i pyeste se mos donin prapë fasule. Që të tre: "ho-ho-ho". Erdhi motra me tenxheren, ua mbushi prapë, u hodhi vaj boll dhe limon, solli dhe bukë tjetër.

Pasi mbaruan së ngrëni, tha ambasadori: "Është dreka më e mirë që kam ngrënë në Shqipëri!" Ai ndoshta e tha këtë si diplomat, po unë e shikoja që pjatat i përlanin sikur të ishin ëmbëlsira nga më të mirat. Ata ikën dhe motra, e cila me gjithë fatkeqësitë dhe traumat nuk e linte humorin, më tha:

- Këta kinezë sa janë?

- Janë me miliona.

- Bobo! Ku i gjejnë tërë ato fasule... duhen vaporë dhe vaporë me fasule për t'i ushqyer.

Dilja tek Të Tre Gurët, ku rrija gjithnjë, se aty është një vend me horizontin dhe panoramën më të bukur të Mesdheut. Aty rrija mendoja. Kujtoja dramaturgët e vjetër e të rinj. Më ra ndër mend drama e Sartrit "Djalli dhe Perëndia e mirë" dhe vendosa të përdorja atë formë.

Punova gjithë muajin dhe e mbarova dramën. Titullin ia vura "Niku i Martin Gjinit".

U nisa për në Tiranë dhe ia shpura Ramiz Alisë, i cili më kishte dhënë këtë ide.

Pas dhjetë ditësh, ai më thirri dhe më përqafoi: "I ke rënë në të! Ke bërë një vepër të arrirë..."

Patjetër që unë u gëzova, por iu luta që për ta vënë në skenë këtë dramë duhej të vinte regjisori Piro Mani nga Korça. Pirro Mani erdhi. Bashkë me Pjetër Gjokën, si ndihmësregjisor, u mblodhëm për të ndarë rolet sipas aktorëve. Aktori i madh i teatrit, Naim Frashëri, kërkonte me insistim të merrte rolin e Nikut...

E kisha paraqitur dhe në konkursin e Ushtrisë, ku fitoi çmimin e parë. Me paratë që mora, shtrova një darkë në shtëpi me shumë shokë krijues. U dha për botim dhe në revistën "Nëntori" dhe u botua.

Të gjithë aktorët i kishin marrë me shumë dëshirë rolet, aq sa Naim Frashëri thoshte se me këtë dramë teatri ynë mund të nderohej edhe në Evropë... Por në kohën kur po ndaheshin rolet dhe kur filloi punën për dekorin edhe piktori Agim Zajmi, erdhi urdhri nga komiteti i partisë i Tiranës që drama të mos vihej në skenë, se ishte liberale... Duhej të pezulloheshin të gjitha përgatitjet. Qarkullonte në rrethet tona letrare mendimi se nuk mund të vihej në skenë një dramë e cila vinte theksin te njëfarë degjenerimi të fëmijëve të udhëheqjes (bëhej fjalë për kohën e Skënderbeut), sepse do të tingëllonte si një analogji me bijtë e udhëheqësve aktualë. Në fakt, urdhri kishte ardhur nga lart. Ky ishte një helm tjetër që m'u dha ta pija në heshtje, pa zhurmë.

PAS LETRËS SË HAPUR TË PARTISË

Letra e Hapur e Partisë nxiti shumë mbledhje dhe diskutime. Edhe në Dhërmi u mblodh fshati për të diskutuar "lirisht". Duheshin vënë në dukje të metat dhe duheshin demaskuar dallaveraxhinjtë që në emër të Partisë spekulonin dhe shfrytëzonin, si dhe reaksionarët. Në mbledhjen e madhe që u bë, shkova dhe unë dhe më vunë në presidium.

I pari që e mori fjalën, ishte Thimio Milo, djali i doktorit. Ai tha: "Nëse Shqipëria u çlirua më 29 nëntor 1944, Dhërmiu u çlirua tani..."

Filluan të kritikonin shumë sidomos drejtorin e kampit të pushimit, që prodhimet e kooperativës së fshatit i dërgonte me shoferin e tij në Vlorë e në Tiranë tek të

gjithë kuadrot e Partisë që gjatë verës pushonin në vilat e kampit. Këtë e vërtetoi edhe shoferi. E vërtetuan edhe shumë gra e burra, që gjithë ditën zgjidhnin portokallet më të mira, limonët më të mirë, mjaltin, gjalpin, arrat, verën, rakinë. Të gjitha llojet e prodhimeve të kooperativës shkonin pa para tek ata me të cilët ai kishte lidhur fije të forta, të padukshme për interesat e tij.

Tani erdhi ora dhe fshatarët e shkretë nisën të flisnin. U fol për shpërdorime, për veprime të pamoralshme, edhe për përdhunimin e një vajze të mitur, nga një njeri me triskën e partisë në xhep. Këto gjëra, sidomos kjo e fundit, e tronditën gjithë fshatin. Më tepër nga të tjerët u trondita sidomos unë, që i dëgjova të gjitha këto. Mbledhjet vazhduan disa ditë dhe unë mbaja kontakt të përhershëm me sekretarin e partisë të fshatit, duke u munduar të gjenim rrugën për të dalë nga kjo gjendje. Por njerëzit e përlyer në fshat, të cilët ishin anëtarë partie, i kishin marrë masat. Kishin njoftuar Partinë në Vlorë, e cila nga ana e saj njoftoi Tiranën, duke kërkuar ndihmë, pra duke pyetur se çfarë duhej bërë për t'i mbyllur këto gjoja "thashetheme".

U provokua një tjetër mbledhje në fshat, nën ullinjtë e Dunit, ku e detyruan tërë fshatin, burra e gra, që të mblidheshin me urgjencë. U vendos tryeza me bezen e kuqe, kishte ardhur edhe vetë anëtari i Komitetit Qendror Peti Shambli, kishte dhe të deleguar të Partisë nga Vlora.

Unë isha aty me gjithë familjen dhe bashkë me një prokuror nga Tirana. E ndjeva se diçka jo e mirë do të ndodhte, kurse tërë njerëzit e fshatit ishin të bindur për të kundërtën. Dhe ndodhi pikërisht ajo që mendova unë: Partia po u vinte kapak të gjitha fëlliqësirave që kishin dalë në shesh pas Letrës së Hapur. U kritikua i tërë fshati, si një fshat i predispozuar për të rënë në prehrin e reaksionit. Nuk u mor në mbrojtje vajza e mitur dhe familja e saj, barinj me bërruc, por u mbrojt njeriu i partisë me

kasketë, që rrinte krenar në rrëzë të ullirit, anëtari i partisë. Asnjë nga fshatarët nuk e hapi më gojën. Heshtje varri. U tha se të gjitha "thashethemet" që qarkullonin, ishin shpifje të reaksionit, i cili "gëlonte" në fshat, për të denigruar Partinë nëpërmjet njerëzve të saj. Anëtari i Komitetit Qendror më kritikoi edhe mua, duke thënë se "ne dërguam këtu Petro Markon për të punuar në frymën e Letrës së Hapur, kurse ai u bë pre e reaksionit të egër në fshat. Shkrimtari i dëgjuar Petro Marko doli mbi Partinë. Dhe tani ja se cilët janë armiqtë që e çoroditën fshatin". Dhe atëherë u panë disa djem të ardhur, të cilët nxorën litarët. U thirrën tre emra: Thimio Milo, Llambro Dede dhe Karavella. (Llambro Dede, peshkatar, i persekutuar, pasi i vëllai ishte arratisur, ishte njeriu më i dashur për djalin tim, i cili e adhuronte si peshkatar, pasi ai e mësoi të peshkonte, të njihte llojet e peshqve. Për djalin tim të mitur kjo ishte një ngjarje e tmerrshme.) Ua lidhën duart me litar, njëri pas tjetrit me një metër distancë. Asgjë nuk pipëtinte. Dukej sikur gjithçka shtangu. Unë nuk e hapa gojën, sepse dy ditë më parë kishte ardhur nga Tirana një xhips me një shok apostafat për mua, i cili më tha: "Më ka dërguar shoku Mehmet, i cili më porositi që, po të bëhet ndonjë mbledhje e hapur në fshat, ti nuk duhet të flasësh fare edhe sikur të të akuzojnë..."

Po atë pasdite gjetëm një makinë dhe u nisa me familjen për në Tiranë.

VAZHDOJNË PERSEKUTIMET

Siç duket, kërkonin me çdo kusht që unë të mos shkruaja më. Dhe e gjetën mënyrën. Sa mënyra dhe forma ka inkuizicioni! Pas ngjarjes në Dhërmi, isha në kafe "Tirana", me Shevqet Musarajin, kryetarin e Lidhjes së

Shkrimtarëve, shokun tim të vjetër. Ai rrinte pak i zymtë. Pasi pimë kafen, u ndamë. Pas një ore më mori në telefon Luigji, sekretari i Lidhjes, dhe më tha se më kërkonte kryetari për një njoftim.

- Po unë me kryetarin isha! Ç'njoftim të ri do të më komunikojë? - I habitur, shkova dhe e gjeta në zyrë. Nxinte. Më dha një shkresë. E lexova:

"Shoku Petro Marko bashkë me familjen e tij të paraqitet sa më parë në Komitetin Ekzekutiv të Elbasanit..." - Lexoj: zyra sekrete e Komitetit Qendror, zyra sekrete e Kryeministrisë, zyra sekrete e Ministrisë së Arsimit... (Atë shkresë, për çudi, ende e kam.) U habita dhe i thashë Shevqetit:

- Po pse nuk ma the në kafe?

- Këto janë shkresa rezervate... Prandaj sa më parë merr familjen dhe nisu për në Elbasan. Mos e bëj të gjatë, o Petro!...

- Unë nuk e di nëse do të nisem për në Elbasan... Ti detyrën tënde e bëre, shkresën ma dhe. Më urdhërove... dhe mbeç me shëndet, Shevqet, - ... dhe dola.

Edhe kjo më duhej. Internimi. Po pse? Me gruan, qamë hallin tonë të zi. Menduam e menduam çfarë mund të bënim, dhe vendosa që t'i bëja një letër Hysni Kapos. Ia shkrova. Me sinqeritet i tregova se si rrodhën ngjarjet në fshat, si dhe përfundimin. Letrën ia dhashë Mafuz Lazes, një shokut tim të vjetër, që të mundohej t'ia jepte në dorë Hysniut... Dilja përjashta në rrugë dhe shokët e Lidhjes më shmangeshin.

Pas një jave Hysniu i telefonoi kryesisë së Lidhjes dhe pikërisht Shevqetit, duke i thënë: "Lëreni rehat Petron të shkruajë e të krijojë, e mos i bini në qafë!"

Pak ditë më vonë, duke ngrënë, ishim në tryezë bashkë me fëmijët, trokitën në derë. E hapi Safoja dhe hyri brenda Pipi Mitrojorgji me një zarf të bardhë në dorë, me tri viza të kuqe dhe me fytyrë që i shndrinte nga gëzimi:

"Petro! Shpëtove!" - dhe më përqafoi,

Hapa zarfin dhe lexova: "Anulohet vendimi i Komitetit Qendror nr. kaq e aq, data kaq, ndaj jush. Duhet të niseni urgjentisht në rrethin e Tiranës për të bërë një roman me temë kolektivizimin". U çmendëm nga gëzimi. U përqafuam. Shpëtuam!

Gjeta një valixhe të vogël prej dërrase, futa makinën e shkrimit, letër daktilografimi, një këmishë e ca ndërresa dhe të nesërmen u nisa për në zonën e Shëngjergjit. Romanin "Ara në mal" e shkrova me shumë vështirësi, sepse isha së bashku me një ekip, i cili mundohej të bindte fshatarët të krijonin kooperativën. Po nuk besonte njeri dhe asnjeri nuk "vinte gishtin" në deklaratë vullnetarisht që të futej në kooperativë. Unë gjeta një temë interesante: Arën e Gjaqeve, të Zan Erzenit, dhe në këtë bosht shtjellova skena reale dhe ireale, se e vërteta është që asnjë nuk u fut vullnetarisht në kooperativë. Unë mora fshatin e fundit të Shëpalit, që u kandis me shumë presion të bëhej kooperativa e fundit e Shqipërisë.

Me romanin "Ara në mal" mora përsëri çmimin e Republikës.

VËSHTIRËSITË E BOTIMEVE TË MIA

Pyetje: - Pse nuk u botua romani "Beteja për foletë e bardha?

Përgjigje: - Kur ra tërmeti në Dibër, Librazhd, Maqellarë, vajta edhe unë nga rruga e Librazhdit. Shëtita të gjitha vendet e goditura nga tërmeti dhe vura re një gjë: gjithë populli shqiptar kishte marrë pjesë në këtë fatkeqësi të asaj krahine. Me mijëra e mijëra vullnetarë ngrinin shtëpitë e rrëzuara, me qindra makina vinin me ushqime... shumë rini, shumë mjeshtër ndërtues. Unë kalova shumë herë nga Golloborda, nga fshatrat të cilat vetëm

një vijë e vogël uji i ndan si kufi me Jugosllavinë. Asnjë i ri, asnjë punëtor nuk u hodh përtej, megjithëse kufiri ishte fare pranë. Kjo fatkeqësi e rëndë i bashkoi të gjithë njerëzit e ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si në një betejë me një armik që u shembi foletë vëllezërve të tyre dibranë. Kjo luftë mbizotëroi në mendjen dhe në zemrën e të gjithëve.

U ktheva në Lunik dhe aty me arsimtarët bisedoja dhe bashkëjetoja, duke grumbulluar lëndë për një roman. Gjetëm shoferët të bllokuar në makinat që sillnin mate-riale ndërtimi, të mbuluara nga dëbora në mal, dhe mezi i nxorëm të gjallë. Tërmeti ishte një katastrofë e vërtetë, por që kaloi me ndihmën e të gjithë atyre që morën pjesë vullnetarisht. I frymëzuar nga ky solidaritet i paparë popullor, vendosa të shkruaja një roman. Mendova se kështu do të kontribuoja edhe unë si krijues, duke u munduar të hidhja në letrat e bardha atë gjendje të jashtëzakonshme njerëzore të cilën e pashë dhe e jetova. Ata njerëz ndërtuan në një kohë rekord, në kushtet e rënda të dimrit të egër, shtëpitë - fole i quajta unë - për vëllezërit e tyre të rënë në fatkeqësi. Pati edhe drama dhe heronj midis tyre. I vura titullin "Beteja për foletë e bardha". (Shumë miq të mi shkrimtarë e poetë, kur mbarojnë veprën e tyre, vijnë dhe më kërkojnë si kumbar (nun) për të caktuar titullin e veprës.)

Kur e shkrova romanin, të cilin dëshiroja ta shihja të botuar sa më parë, që ata që fituan betejën, të gjenin aty heroizmin e tyre, e çova në Ndërmarrjen e Botimeve. Ata, si zakonisht, ua dhanë dy recensentëve, të cilët bënë vërejtje skematike, ashtu siç ishte kritika: shumë skematike. Pra, pas disa ditësh më thirrën në redaksinë e romanit dhe redaktorja, që ishte e ngarkuar për të dhënë një mendim, më thoshte:

- Këto faqe shkurtoi... Këto faqe hiqi. Ky kapitull duhet të shkurtohet, se merret shumë me dialogë ndër-

mjet të rinjve... Ky kapitull duhet të hiqet fare... Pastaj titulli i romanit nuk shkon fare... Nuk janë zogj ata, që të ngrenë foletë, por janë ustallarë që ndërtojnë banesa... Dhe kryesorja: ju e keni zbehur krejtësisht rolin e Partisë në këtë "betejë".

- Nuk ju kuptoj... Ju e keni lexuar romanin? - e pyeta.

- Nuk ka nevojë që ta lexoj unë, por e kanë recensionuar dy kritikë kompetentë.

Atëherë unë u preka; nuk e kisha menduar se do të më prisnin përsëri kështu. Gabova, u nxitova që e çova, por entuziazmi im për atë që pashë dhe jetova, më bëri që të harroja censurën. Mora romanin nën sqetull, shumë i trishtuar, dhe thashë me vete: "Ah! O Petro! Si nuk vure mend! Gjithmonë shpreson dhe harron se krijimet e tua nuk mund të kalojnë kufirin e vendosur rreptësisht për të gjithë artistët. Prandaj edhe kjo vepër e shkruar me ndjenjë do të mbetet e burgosur pranë dorëshkrimeve të tjera."

Këtë trishtim në ato çaste nuk e mbaja dot vetëm, ndaj këmbët më shpunë drejt Klubit të Gazetarëve, ku pija kafen. Po aty çdo të bëja? Do të pija një kafe dhe do të qepja gojën me këdo që do të më afrohej. Atëherë u ktheva në shtëpinë time me gjithë roman. Si gjithmonë, edhe kjo disfatë vetëm aty mund të diskutohej. Kështu ndodhi. Dhe kjo vepër zuri vend krahas dorëshkrimeve të tjera.

Pyetje: - Çfarë shkrove pas kësaj?

Përgjigje: - Botova romanin "Halimi" për jetën revolucionare të njërit prej djemve të Labërisë, politikanit demokrat dhe patriotit të shquar Halim Xhelo nga Tërbaçi. Unë trajtova vetëm një pjesë të jetës së tij: ardhjen ilegale në Shqipëri...

Botova romanin "Ultimatum", për luftën e 1920-ës në Vlorë. Me shkurtimet dhe redaktimet që iu bënë vend

e pa vend, patjetër që romani, ashtu si romanet e tjera përveç "Qytetit të fundit", ka humbur shumë vlera. Edhe kjo gjë më hidhëroi.

Nga "Ultimatumi" mora një kënaqësi në një ditë plot trishtim, kur udhëtoja me tren nga Tirana për në Fier, për të shkuar pastaj drejt Ballshit me autobus, në burgun e Ballshit, ku kryente dënimin djali im Jamarbër, mbas burgut të Spaçit. Në vagon, ulur në sedilje ishim unë, Safoja dhe vajza jonë Arianita. Poshtë sediljeve kishim futur çantat dhe trastat me ushqime e ndërresa për djalin. Këtë rrugë e bënim një herë në muaj. Treni ecte dhe asnjeri nga ne nuk fliste. Mundoheshim të dukeshim si udhëtarë të zakonshëm, që mundësisht të mos e kuptonte njeri se ku po shkonim. Gjatë gjithë muajit përpiqeshim të siguronim mundësinë për t'i mbushur ato çanta me ushqime, duke ia kursyer vetes.

Ishte një ditë e bukur me diell. Të mbjellat gjelbëronin. Në tren bisedohej. Befas pranë nesh u afrua një vajzë e re flokëverdhë dhe me druajtje e shumë respekt iu drejtua Safos:

- Më falni që guxoj t'ju pyes, shoku është shkrimtari Petro Marko, në mos gaboj?

Safoja iu përgjigj:

- Po, - shkurt. Vajza jonë mundohej që t'i fshihte me këmbë çantat edhe më shumë poshtë sediljeve. Unë e dëgjova që pyeti për mua, dhe ula kokën. Dëgjova përsëri vajzën flokëverdhë që e pyeti Safon:

- A mund t'i jap dorën, se kam shumë respekt për të si shkrimtar?

Atëherë Safoja sikur shkriu dhe i tha:

- Posi jo! - U kthye nga unë: - Petro, shoqja dëshiron të të takojë. - Ngrita sytë, e vështrova dhe ajo më dha dorën me shumë emocion. Pak a shumë tha:

- Shoku Petro, jam shumë e lumtur që po ju takoj, se kam një porosi nga gjyshja ime shumë e vjetër, së

cilës i kemi lexuar me zë romanin tuaj "Ultimatum", ku keni përshkruar me shumë vërtetësi dhe art heroizmin e burrit të saj Zigurit, deri në vrasjen e tij. Ajo ëndërron që t'ju takojë dhe thotë: "Ku ta gjej e t'i puth dorën për atë penë të florinjtë, që ka shkruar historinë e Luftës së Vlorës". Ja ku e solli fati që unë t'ju takoj dhe t'ju komunikoj dëshirën e saj. Unë vetë jam arsimtare. Ai atje, - dhe tregoi me dorë një burrë të gjatë që rrinte më këmbë, - është vëllai im. Nëna dhe babai ynë kanë qenë të dy partizanë dhe im vëlla ka lindur në mal. E ka emrin Partizan. A pranoni që edhe ai t'ju takojë, se ka shumë dëshirë?

Ktheva kokën, pashë njeriun që rrinte më këmbë dhe thashë:

- Pse jo?- Atëherë ai u afrua dhe më përqafoi si të ishim të njohur. Biseduam për veprat e mia; ata më ngritën në qiell dhe vërtet ishin të lumtur që po më takonin. Ishte një gjë e jashtëzakonshme për ne, që po shkonim për në burgun e Ballshit. Nuk na pyetën fare se ku po shkonim. Kur po i afroheshim stacionit të Fierit, u përshëndetëm dhe u ndamë. Ata zbritën të parët nga vagoni. Ne pritëm që të largoheshin, dhe, kur u siguruam për këtë, nxorëm me të shpejtë trastat dhe çantat, ngaqë na duhej të nxitonim për të arritur autobusin e Ballshit. Thamë që të tre njëherësh: "Shyqyr që shpëtuam, nuk dinin gjë të shkretët se ku po vemi!" Mirëpo në ato çaste u shfaq mësuesja bashkë me të vëllanë, m'i morën nga duart të dy çantat e rënda e thanë:

- Shpejt! Se mos ju ikën autobusi i Ballshit! - Ne nuk folëm asnjë fjalë. Na përcollën deri te dera e autobusit dhe mësuesja tha: - Ne e dimë. Na vjen shumë keq që e keni djalin në burg, shoku Petro, po ju lutem mos u mërzitni. Këto gjëra ndodhin.

Nuk mund të rrija pa e shkruar këtë episod, kur shumë miq e shokë, madje edhe banorët e pallatit ku

jetonim, as që na përshëndetnin. Pra, po e shkruaj këtë ngjarje në biografinë time të shtrirë në shumë vjet, duke e zgjedhur midis shumë episodesh të tjera të këtij lloji, Njerëzit e duan letërsinë. E duan edhe shkrimtarin.

Punova gjatë për romanin "Vatër e blinduar", kushtuar Shqipërisë, por me recensentët, me redaktorët hoqa shumë, ai u shkatërrua; mbajta vetëm skicë-idenë e romanit, i cili u botua me titullin "Të thjeshtët". Në këtë roman të botuar nuk është as një e katërta e idesë dhe e shtrirjes së ngjarjeve e të personazheve. Forma është masakruar. E kam në shtëpi me titullin "Vatër e blinduar". Kështu që për mua mbetet thuajse i pabotuar. Pas daljes nga shtypi, kur e lexova, buzëqeshja hidhur. U pendova që këtë vepër e dhashë për botim.

ROMANI TJETËR "ÇUKA E SHTEGTARIT"

Në vitin 1980 disa zyrtarë më sugjeruan që të shkruaja një roman në formë autokritike për qëndrimin tim ndaj edukimit moralo-politik të rinisë dhe pastaj atë ta paraqitja në Komitetin e Partisë. Kjo do të ishte forma që do të mund të më rehabilitonte si shkrimtar dhe si prind, mbas lirimit me kusht të djalit nga burgu.

U ula, krijova personazhet, situatat në të cilat do të kalonin ato; personazh kryesor vura veten, si shkrimtar. U mundova që nga faqja e parë deri tek e fundit të isha në pozita siç kërkohej. Por më lindi ideja që krahas këtij krijimi të porositur, të vija po ato personazhe si dhe veten time, jo në mënyrë fare të hapur, por afërsisht ashtu siç mendoja unë, në një variant tjetër. Romanin e parë e dorëzova, kurse të dytin e futa në depo me dorëshkrimet e mia. S'prita shumë dhe mora përgjigjen negative: romani është i pabotueshëm. E para herë që nuk u hidhërova. Përkundrazi. Dhe tani që kohët me sa duket po

ndryshojnë dhe sistemi diktatorial do të përmbyset, shpresoj të shërohem përsëri e të jetoj - kur them të jetoj, nënkuptoj të punoj - dhe midis planeve që më mbeten për të realizuar, është që edhe këtij romani t'i hyj përsëri, kësaj radhe të shkruaj pa gjerdhe. Tani jam pak më i qetë, se në kopjen e dytë kam arritur të bëj ato ndryshime të domosdoshme të cilat i bluaja në kokë, duke ia diktuar Arianitës.

"RETË DHE GURËT"

Ëndrra ime si krijues. Deri më sot e parealizuar. Të them se nga e mora këtë titull për veprën time ende të pashkruar: nga rrëfimet e gjyshes sime të mirë, mama Milles, e cila më rriti. Rrëfente ajo:

"Thonë se gurët e mëdhenj atje poshtë
në Shënmëri, janë burrat që janë kthyer
dhe kanë vdekur në vend. Po të jesh trim
zemërbardhë e po të shkosh andej natën,
i dëgjon të dëftejnë historitë e tyre.
Po të jesh frikacak e zemërlig, nuk i dëgjon dot.
Kurse ata burra që kanë ikur dhe kanë vdekur
në kurbet, janë bërë re... Vijnë qajnë dhe ikin
(Edhe im shoq, që iku e s'u kthye më, por humbi në
mërgim, është bërë re: vjen qan dhe përsëri ikën.)
Dhe mbi spitharët më poshtë, afër bregut,
mblidhen lotët e tyre siç mblidhet uji i shiut..."

Kam vite të tëra që e kam të ndërtuar në kokë këtë roman. Ky është romani më i dashur për mua. I kam hedhur në letër faqet e para, por pena nuk po më bindet. Jam i lodhur, shumë i sëmurë nga emfizema e të tjera të moshës. Me sa shoh, nuk do të arrij dot që ta shkruaj.

Ka ditë kur nuk mund të ulem as para makinës së shkrimit. Edhe për këto pak faqe për 45 vjet të gjatë e të mundimshëm, që po i shkruaj për biografinë time, nxitëse është Safoja, e cila me siguri e ndien që mua po më lënë forcat. Ajo mendon se është e domosdoshme që unë t'i hedh në letër shkurt kujtimet që nga viti 1945. Thotë se jeta ime dhe krijimtaria ime janë zhvilluar në mote me furtunë, luftëra, burgje, internime, punë, krijimtari të shumëllojtë, me aq shumë episode, ngjarje, vite, data, njerëz, sa askush tjetër nuk mund t'i renditë e t'i kujtojë, ashtu siç mund të bëj unë vetë. Ka të drejtë. Unë kaq mund të shkruaj, tani në këtë gjendje që jam. Aq i sëmurë e i pafuqishëm ndihem, sa nuk e di se kur do të më ndalet dora. Në këto çaste pështjellimi, nuk e di pse më kujtohen vargjet e mia:

Rrëmbem', o dallgë e bukur, si pirati,
dhe më bashko me kapedanë trima,
zemër-delfina të shpejtë vetëtima.
Te kull' e jetës, ku na shkruhet fati,
Të derdhemi, o dallgë, e ta hedhim në erë!
Të shoh edhe unë - edhe ne - parëverë!

Pyetje: Si e përjetuat ngjarjen e rëndë të arrestimit të djalit?

Përgjigje: - Djalit tim ia kam vënë emrin Jamarbër. Është shumë i talentuar. Është poet, por nuk boton. Shumë i mbyllur është, shumë i ndjeshëm. Gjatë viteve të gjimnazit, me klasën e tij, shkuan në një aksion në rrethin e Tiranës. Kur u kthye nga aksioni, ai kishte pësuar një zhgënjim. Kur biseduam në mbrëmje, m'u drejtua me fjalë akuzuese. Më tha: "Pse gënjeni dhe flisni për lumturinë dhe begatinë e fshatarësisë, kur unë vetë bashkë me shokët e mi i pamë se sa të varfër janë?!" Ai ishte tronditur nga varfëria e tyre. U kishin vënë për të

ngrënë bukë e dhallë dhe u kishin shtruar për të fjetur në rrogoz, mbi truall. Asnjë nga djemtë nuk kishte fjetur dot, jo nga të ftohtët, se stina ishte e ngrohtë, por nga fjalët e të zotit të shtëpisë. Plaku kishte treguar për mjerimin në të cilin jetonin: mezi siguronin bukën për familjen; se ditë të tilla kaq të këqija nuk kishte parë ndonjëherë (ai ishte 70 vjeç) dhe pothuajse tërë fshati kujtonte me mall kohën e Zogut, si kohën e bollëkut.

Unë i thashë djalit se ai duhet të kishte qenë ndonjë zogist dhe mund të ishte armik i pushtetit, meqë fliste me këtë gjuhë. Kurse unë vetë u dëshpërova shumë për këtë zhgënjim të tij, pasi nuk duhej që fëmijët të konstatonin me sytë e tyre këtë realitet të pamohueshëm.

Pas kësaj, në fund të vitit, në maturë, ndodhi një ngjarje e shëmtuar. U hap zarfi me pyetjet, përpara provimit. Kjo gjë u bë problem në komitetin e rinisë. Në mbledhje u thirrën gjithë djemtë e klasës, u akuzuan rëndë dhe u mor vendim që të gjithë të dënoheshin me punë të detyruar. Në Laç, në Fabrikën e Superfosfatit, bashkë me shokun e tij Fatos Lubonjën, në gjirin e klasës punëtore, për djalin erdhi përsëri një zhgënjim i ri. Ai u afrua me familjet e punëtorëve dhe pa përsëri varfërinë që i kujtonte atë të fshatit të Tiranës. Shpesh më tregonte për bisedat që bënte me punëtorët, për pakënaqësitë e tyre. Ky për të ishte zhgënjimi i dytë, kësaj here edhe më i madh.

Pakënaqësitë e të rinjve, të shokëve të djalit, ishin dhe të tijat: Dëshironin të visheshin sipas modës perëndimore, pavarësisht se mund t'u vinin fletë-rrufe, sipas modelit kinez. Dëshironin të dëgjonin muzikë të huaj, të kohës, muzikë të ndaluar. Dëshironin të lexonin letërsi të huaj, moderne. Dëshironin të vallëzonin dhe këtë e bënin pa pyetur as prindërit. Dëshironin të mbanin flokë të gjatë. Por të gjitha këto Partia i quante degjenerim dhe ishin të dënueshme. Një gjendje e tillë stimuloi dhe

shfaqjen e mendimeve. Ata akuzonin Partinë. Ata e njihnin shumë mirë ligjin, që të dënonte për agjitacion e propagandë. Kishte edhe arratisje, kapërcim të kufirit, por kishte dhe qendra për vuajtje të dënimit, të cilat ishin në zë, si Spaçi, Burreli etj. Por ata nuk kishin frikë, ishin të rinj.

Më vonë i doli e drejta e studimit, në Fakultetin Juridik, dega gazetari. Stazhin pas fakultetit e bëri në gazetën "Zëri i Vlorës" në Vlorë. Atje punoi mirë, por e shtoi pijen. Pas stazhit, pritëm emërimin, i cili nuk po vinte. Ai erdhi në Tiranë shumë i revoltuar. Unë bëra përpjekje për ta sistemuar në ndonjë gazetë, por asnjë rezultat. Ndërkohë ishte arrestuar shoku i tij i gjimnazit Fatos Lubonja, i cili u dënua me shumë vjet. Shqetësimi i djalit kishte filluar që me masat e marra kundër meje. Me situatën e krijuar, me arrestimet që pasuan, ai kaloi në një gjendje shumë të stresuar. Në atë kohë u internua dhe miku im Vangjush Gambeta dhe, kur ai po ngrinte plaçkat e i ngarkonte në makinën që do ta çonte në internim në Derjan të Burrelit, im bir iu afrua ta ndihmonte. E kishte pasur pedagog në fakultet. Vangjushi i kishte thënë "Ikë, Jamarbër! E di që më do e më respekton. Ikë, se mos të sheh njeri!" Unë e humba përsëri një mik inteligjent e të këndshëm.

Më 7 gusht 1975, në orën 12 të natës, djali u arrestua në shtëpi. Njerëzit e sigurimit e kryen detyrën duke qenë shumë të sjellshëm. Pasi i vunë prangat djalit dhe e morën, nuk lanë gjë pa kontrolluar. Arrestimi i djalit qe gjëja më e rëndë e jetës sime.

U gdhimë, unë, Safoja dhe vajza, duke diskutuar se çfarë do të na priste. Flisnim me gjysmë zëri. Kur zbardhi mëngjesi, ne ishim ende të tre kokë më kokë, duke menduar se çfarë do të ndodhte më tej. Për vajzën studente në Institutin e Arteve dhe për ne si krijues ishte vdekje. Unë isha i dënuar, i shembur, Safoja mund të humbiste

punën si piktore në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", vajza do të humbiste Institutin dhe të ardhmen.

Mbi të gjitha, nuk dinim se çdo të ndodhte me djalin.

Safoja i drejtoi një letër Hysni Kapos. Unë shkova në Ministrinë e Brendshme, por nuk më pritën, megjithëse aty kisha shumë miq që nga koha e rinisë sime.

Që nga ajo ditë filluam ta ndienim ftohtësinë e njerëzve që na rrethonin, dhe largimin e shumë miqve. Ishin vite shumë të rënda dhe i justifikuam të gjithë. Çdo makinë e madhe që ndalonte përballë pallatit tonë, bënte që, përveç nesh, të dilnin në dritare edhe ata që na kishin dashur, duke menduar se kishin ardhur për internimin.

Mora kontakt me hetuesin, një djalë i ri shumë i sjellshëm. Ai më tha: "Vetëm një emër të më thotë, dhe unë e nxjerr që tani, ta marrësh me vete". Mbas pesë muajsh në hetuesi, më 31 dhjetor 1975, u dha vendimi i gjyqit: gjashtë vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë. Në takimin e parë me djalin, përpara se të nisej për në Spaç, takim me dy palë hekura mes nesh, ai ishte jashtë mase i tronditur, i verdhë, i ënjtur, i deformuar. Ne e pyesnim dhe ai heshtte. Shqiptoi vetëm disa fjalë të pakuptimta për ne:"Jam këtu për të dytin". Kishte menduar se ne ishim të internuar, pasi gjatë gjithë kohës i tregonin urdhrin e internimit. Ishim të gjithë jashtëzakonisht të tronditur, por për mua ishte më e rënda. Se e pashë tim bir prapa hekurave, njëlloj si veten time.

Ato vite ishin shumë të rënda. Safoja punonte ditë e natë për të mbajtur familjen dhe burgun e dytë. Unë nuk mund të punoja, pasi nuk kisha më të drejtën e botimit. Asnjeri nuk më afrohej, por edhe unë nuk i afrohesha askujt. Edhe shumë shokë të ngushtë, që më parë e frekuentonin shpesh shtëpinë time, nuk u panë më. Vetëm shokët e Spanjës nuk m'u ndanë kurrë. I miri dhe i guximshmi Skënder Luarasi, që i dridhej shpirti

për arrestimin e djalit tim, disa herë më dha për të cigare dhe çokollata. Por unë nuk i kam mbajtur mëri askujt. E tillë ishte koha. (Dua të kujtoj diçka që lidhet me guximin e Skënderit. Sa herë që kishim ndonjë mbledhje të rëndësishme në rrethet tona letrare, vinte e na gjente Alfredi (Alfred Uçi) djali i Minait dhe i Shegës, motrës së Skënderit, dhe na porosiste mua dhe Manen, që, kur të uleshim në mbledhje, ta futnim Skënderin në mes e ta detyronim me forcë që të mos reagonte e të mos fliste kur revoltohej nga diskutimet e të tjerëve. Ne qeshnim dhe i premtonim.) Alfred Uçi, Sofo Lazri dhe miku im i vjetër Dr. Shefqet Ndroqi u përpoqën me të gjitha mënyrat në organet e pushtetit dhe të partisë që unë të mund të shkoja e të operohesha në një shtet tjetër evropian, më 1989, kur këtu po më rrezikohej seriozisht jeta. Dhe mbetën të pikëlluar kur morën përgjigje negative.

Midis gjithë këtyre të këqijave, patëm një gëzim: vajzën nuk e hoqën nga Instituti, megjithëse u bënë tentativa për këtë. Safon nuk e lëvizën nga shtëpia botuese. Në shtëpi me gjysmë zëri diskutonim: "Të ketë ndërhyrë Hysni Kapo për të gjitha këto?"

Kishte edhe njerëz me zemër.

Çdo muaj shkonim në Spaç dhe më vonë në Ballsh, kur djali u transferua atje. Nuk mund t'i harroj udhëtimet për në Spaç hipur mbi karroceritë e kamionëve në mes të dimrit, në ato male të ashpra ku të grinte veriu, unë me një pardesy fësh-fëshe. Në këto rrugë mora shumë herë bronkopneumoni, që më shkaktoi këtë emfizemë pulmonare, e cila po më merr jetën tani.

Në Ballsh, ngaqë përvëlonte dielli në verë, vinim në kokë lecka të lagura, në rrugën e gjatë pa mbarim drejt barakave të kampit të riedukimit. Majtas rrezatonte rafineria e naftës me vezullime marramendëse, si një qytet jashtëtokësor. Një ditë, teksa ecnim ngarkuar me trastat e rënda drejt kampit, një grup kinezësh të rinj, që po

vinin nga rafineria, kapërcyen rrugën dhe, duke buzëqeshur, na përshëndetën me kokë, ndërsa njëri prej tyre tha: "Tungjatjeta, Petro Marko!" U çudita!

Arianita, vajza ime e vogël, e talentuar, për të cilën ëndërroja se do të bëhej një piktore e madhe, përfundoi si "punëtore e kualifikuar" në Fabrikën e Qelqit në Kavajë. Dikur, kur ishte vetëm 12 vjeç, miku im Abdurrahim Buza, kur pa punët e saj, tha: "Me këtë portret Arianita mbron diplomën në Akademi".

Neve, si prindër, na u shembën ëndrrat. Megjithatë të gjithë ishim gjallë, kishim jetën.

Unë mendoja se nuk duhej të udhëtonim të tre bashkë me makinë për në Spaç, se kisha frikë mos makina rrokullisej nëpër ato rrëpira dhe vdisnim që të tre. Atëherë çdo të bëhej me djalin?

Po tregoj tri raste:

1. Isha duke shëtitur në bulevard, kur dëgjova dikë të më thërriste. Ktheva kokën dhe pashë në ballkonin e tij Dhimitër Shuteriqin, i cili ma bëri me dorë që ta prisja. Erdhi më dha dorën (për çudi) dhe më tha:

- Të shoh përditë që shëtit kokulur. Ngrije kokën. Kush je ti? Çfarë i ke dhënë kulturës sonë ti... Ai djalë është... bëri gabime... dhe do të dalë... Po ti, Petro, ec kokëlart!

2. Një ditë, aty nga fundi i bulevardit, pashë mikun tim Koço Kosta, që ikte poshtë. Pastaj e pashë të kthehej dhe të më drejtohej. M'u afrua dhe më tha:

- Do të të përqafoj një herë, pa le të më varin... - dhe m'u hodh në qafë.

3. Një ditë tjetër, ndesha ballë për ballë me mikun tim të dashur Dritëro Agolli. Ai më foli dhe më ftoi të futeshim në kafe "Tirana" për të pirë një kafe. U ulëm dhe ai kushedi se nga vinte, se ishte data 5 maj, dita e dëshmorëve dhe kushedi se në cilën familje dëshmori kishte qenë. Kur nisi të pinte kafen, më tha:

- Sot kam nderin të pi kafe me një dëshmor të gjallë!

As njerëzit e mi nuk mund të vinin në shtëpi. Por vëllai im Agjisilla, që qante për fatin e djalit tim, dhe motra Lilo erdhën me ne dhe e takuan djalin në burgun e Ballshit. Liloja e ngarkuar si në fshat. Kurse nipi im Lluka, djali i Jani Markos, i persekutuar, më siguronte një automjet për të vajtur deri në burg në Spaç ose në Ballsh, se shoferët, po të ishe i ngarkuar me ushqime për në burg, rrallëherë të merrnin, se kishin urdhër. Lluka çdo të diel vinte e më takonte në shtëpi. Agjisilla ishte larg, në Vlorë. Vetëm Dunajt, kushërinjtë e mi të persekutuar, djemtë e Jerasimos, kur kishin ndonjë hall, vinin e konsultoheshin me mua vazhdimisht. E vetmja familje që nuk na u nda asnjë ditë, ishte familja e Ali Çelos, vëllait të Safos, i cili jetonte me Shazijen, vjehrrën time. Aliu dhe gruaja e tij Drita ishin që të dy inxhinierë kimistë. Aliu ishte inxhinier shumë i zoti, shpikës, por e tërë puna krijuese që bëri në fushën e tij, asnjëherë nuk u evidentua me emrin e tij. E ndoqi tërë jetën një lloj persekutimi, për arsye se fare fëmijë kishte qenë ballist. Në moshën 15-vjeçare, me shokë pak më të rritur se vetja, u nis për në Kosovë. Ai së bashku me gruan e vizituan djalin tim edhe në burgun e Spaçit, edhe në atë të Ballshit, pa marrë parasysh konsekuencat.

Ishte një kohë e tmerrshme. Ishim izoluar nga jeta.

Dhe mendoja për luftën time, për idealin tim, për vuajtjet që hoqëm, gjersa të fitonim lirinë...

Vrasja e jetës! Vrasja e ëndrrave! Vrasja e shpresave!

"LEJANIA"

Pyetje: - Si të lindi ideja për të zhvarrosur vargjet e tua te varri i Ramiz Varvaricës në brigjet e lumit Ebro...?

Përgjigje: - Nuk rrija i qetë. Punoja. Bëja edhe punët

e shtëpisë, se Safoja punonte pa pushim edhe jashtë orarit, edhe natën, për të nxjerrë shpenzimet e burgut, pasi kishim një njeri të familjes në burg të rëndë, dhe ai duhej ndihmuar me sa më shumë ushqime, se ishte astmatik dhe punonte brenda në minierat e Spaçit... Nuk mund ta përshkruaj Spaçin. Poshtë rridhte një përrua si qelbi i historisë.... Vende të nxira nga varfëria e mjerimi. Zonë e prapambetur, si e harruar nga bota. E tërë ajo luginë ishte si një hon pa frymëmarrje. Përshtypje të paharruar më bëri kënga e një malësori, e cila nga maja e gurtë, një gur i zi, m'u dëgjua si një rënkim proteste ose si një mallkim.

Po mendja nuk më hiqej nga krijimi. Krijimi është jeta ime, gëzimi im, dashuria ime. Atëherë m'u kujtuan vjershat që shkruaja në llogoret e Spanjës, kur luftohej kundër barbarisë fashiste. Atëherë unë isha i ri, plot energji dhe shpresë. Poezitë e mia, që i kisha shkruar që nga Figueras e deri në Badajoz, i pata vënë si nënkresë në varrin e Ramiz Varvaricës, atje përkundruall Kaspës, në Ebro, ku janë katër ullinj.

Nuk mund t'i lija më të varrosura ato vargje. Një shtytje imperative më nxiste që t'i nxirrja përsëri në jetë. Të merrnin frymë. Atëherë nisa të shkruaja poemën "Lejania" (Largësi e pafund), poemën time të dashur, me entuziazmin e rinisë sime idealiste dhe me urtësinë e një plaku tashmë me një përvojë jetësore shumë të hidhur. Nuk e kam dhënë për botim.

Kam shkruar dhe përsëri, sa të kem frymë, do të shkruaj, po me atë entuziazëm të Petros idealist të pathyeshëm, të viteve të rinisë e të luftës: dhe qëndrimi im do të jetë gjithmonë kundër çdo lloj padrejtësie, kundër shkeljes së çdo lloj të drejte njerëzore, kundër çdo pushteti diktatorial që të pengon frymëmarrjen, që vret ëndrrat e fëmijëve dhe idealin e idealistëve, që u vë kufij me tela me gjemba horizonteve të lira.

Më kujtohen vargjet e mia të thjeshta, që i shkrova

të parat në bllokun që më fali Ali Kelmendi në stacionin e trenit, kur u nisa për në Spanjë: *Ka në botë njerëz të mirë, / Ka në botë njerëz të lirë, / Ka në botë një hapësirë / Pa gjerdhe, pa errësirë...*

FISNIKËT DHE GUXIMTARËT, VËLLEZËRIT E MI KOSOVARË...

Pyetje: - Pse i ke dashur aq shumë kosovarët?

Përgjigje: - Kjo dashuri për kosovarët më lindi në fillim të viteve tridhjetë. Njoha më parë Asim Vokshin, që ishte nëntoger i xhandarmërisë në rrethin e Gjirokastrës, kur unë isha mësues në Dhuvjan të Dropullit, më 1932. Më vonë, nëpërmjet Asimit, në Tiranë, njoha Bedri Pejanin, Ali Kelmendin. Dhe në Spanjë njoha shokët e paharruar Emrush Myftari, Xhemal Kada, Justina Shkupi, Shaban Basha e të tjerë, për të cilët kam folur në shënimet për Spanjën.

Në Tiranë, pas Çlirimit, njoha Xhaferr Vokshin, vëllanë e Asimit, ardhur nga Kosova, partizan gazetar. U lidhëm me miqësi, por lidhjet me të u ndërprenë kur ai u internua familjarisht. Nuk i zinin këmbët dhe. Ka vuajtur shumë, me gjithë familjen me shumë fëmijë. E kam mik dhe shpesh vjen më takon. Djalit të tij të madh ia kam vënë unë emrin Ebro, për kujtim të betejave në Spanjë.

Po gjatë viteve '70 më erdhën në shtëpi Esat Mekuli, Hasan Mekuli, pastaj Ali Aliu, me të cilin shkova edhe në fshat, Rexhep Qosja e të tjerë. Kur ishte këtu Esat Mekuli dhe të tjerët, flisnim për kulturën tonë dhe ata më pyetën nëse unë kisha ndonjë mendim për zhvillimin e kulturës në Kosovë. Folëm e folëm, pastaj unë shfaqa mendimin se edhe gjuha letrare e Kosovës duhet të unifikohet me gjuhën tonë letrare.

Më vonë erdhi këtu Ali Aliu dhe vendosi që të bënte

një biografi për mua. E shpura në fshat, te shtëpia ime; ai u mahnit me bukuritë e natyrës bregdetare dhe më tha: "Tani e kuptoj pse shkruan në mënyrë çapkëne poetike plot ngjyra dhe me një horizont të gjerë." Ai shkroi librin "Krijuesi dhe koha", për jetën dhe veprimtarinë time letrare dhe me atë punë mbrojti doktoratën.

Në Kosovë, nën redaktimin e Ali Aliut, u botuan 9 vepra të miat, në një kohë kur këtu në Shqipëri as që përmendej gjëkundi emri im si krijues. Në Kosovë jam më i njohur se këtu, falë punës së madhe që ka bërë shtypi dhe kritika. Edhe "La Rousse" i Francës (më 1969) më kishte vënë si shkrimtar shqiptar që kam shkruar "Hasta la vista" e vepra të tjera, kurse këtu as që guxonin të vinin emrin tim në ndonjë botim shkollor. Urdhri që të mos përmendej emri im si shkrimtar në asnjë gazetë, revistë ose mbledhje të Lidhjes së Shkrimtarëve, kishte ardhur nga lart. Unë isha një shkrimtar i mallkuar në vendin tim, ku, me sa munda, luftova, punova dhe shkrova si gazetar, si poet, si shkrimtar, si përkthyes i një pjese të mirë të poetëve latino-amerikanë. Kurse në Kosovë janë ribotuar vepra si "Hasta la vista" (botimi i katërt, që ka një parathënie të mrekullueshme të Rexhep Qoses) "Shpella e piratëve", për lexime letrare në shkollë.

Për mua në Kosovë krijimtaria artistike është shumë më përpara se krijimtaria jonë e realizmit socialist. Me gjithë shtypjen serbe dhe masat e rrepta që janë marrë dhe merren kundër njerëzve të artit në Kosovë, aty arti i çdo gjinie, mund ta them me plot gojën, është më i pasur se arti ynë i persekutuar dhe i kanalizuar. Nuk më harrohet një episod:

Ishte muaji i letërsisë, që bëhej në çdo tetor (se në tetor ka lindur Enver Hoxha), dhe unë u caktova me dy shokë të shkonim në Berat. Aty, në mbrëmjen letrare që u bë në kombinatin e tekstileve, bënin shumë pyetje, midis të cilave dhe këtë: "Cili është shkrimtari më i mirë

i Shqipërisë?" Dhe një shok nga të kryesisë së Lidhjes që ishte me ne, u përgjigj: "Shkrimtari më i madh i Shqipërisë është shoku Enver Hoxha!"

Unë mendoja dikur se veprat më të mira të letërsisë shqiptare janë shkruar në të gjitha kohët jashtë Shqipërisë: Noli, Faiku, Çajupi, Naimi, Asdreni, Lasgushi, si dhe gjithë kosovarët e shquar krijimet e tyre më të mira i kanë bërë larg Atdheut! Është e vërtetë se Fishta, Mjeda, Ali Asllani, Migjeni e të tjerë... kanë krijuar këtu... po kishin qenë shumë herë jashtë atdheut nëpër Evropë ose për studime, ose për të punuar... Kjo ishte një dukuri që shumë herë diskutohej nga Branko Merxhani me Odise Paskalin, me Tajar Zavalanin e letrarë të tjerë. Shumica e veprave që janë themeli i kulturës sonë, janë shkruar jashtë Shqipërisë.

Po të kishin lindur e jetuar këtu Rexhep Qosja, Ali Podrima, Bekim Fehmiu e të tjerë, talenti i tyre do të ishte vrarë, ashtu siç u vra talenti dhe jeta e shumë e shumë bijve të talentuar të kësaj Shqipërie që mbijetoi në këto vite në dallgët e historisë...

(Shikoj Safon time, artiste, për mua jashtëzakonisht e talentuar, e cila ka punuar e punon, e punon akoma për të mbajtur shtëpinë. Dhe kujtoj ëndrrat e saj për udhëtime, për tablotë, për ngjyrat, për idetë, për ekspozitat. Nuk u realizua kurrë ëndrra e saj për të vizituar Luvrin, galerinë e famshme të artit në Firence, që ishin aq afër dhe që ia kisha premtuar kur u njohëm! Shikoj të dy fëmijët e mi, të dy artistë. Dhe mendoj: Si iku kjo jetë kështu?!)

Kam marrë shumë letra nga lexues të thjeshtë, nga studentë, nga njerëz të artit e të kulturës dhe nga familjarët e heronjve dhe luftëtarëve të Spanjës. Tek unë në Shqipëri erdhën të më takonin Mahiri, i vëllai i Xhemal Kadës; Luljeta, e bija e Emrush Myftarit, një djalë i mrekullueshëm kosovar, i cili u kthye gjallë nga Lufta e

Spanjës dhe e gjeti vdekjen në Kosovë, nga dora e serbit Miladin. Mahir Kada më telefonoi e më njoftoi se kishte dalë në treg seria e plotë e veprave të mia në Kosovë dhe se duhet të shkoja atje për të marrë shpërblimin që më takonte si shkrimtar, kurse unë në telefon iu përgjigja: "Asnjë shpërblim nuk pranoj, por ato që më takojnë, do t'i vini në shërbim të ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës me emrin e Asim Vokshit që po ndërtoni". Kjo dashuri vëllazërore e lindur ngaqë ne ishim shqiptarë, megjithëse na ndante një kufi i egër, ishte lidhja e gjakut tonë të hershëm dhe e atij që u derdh në Luftën Antifashiste të Spanjës. Ëndrra ime për të vajtur qoftë edhe një herë të vetme në Kosovë, ku më respektonin si shkrimtar dhe luftëtar dhe më quanin vëlla, nuk u realizua kurrë deri më sot. Mbeti një ëndërr. Këtë dëshirë e kam shfaqur me të gjithë kosovarët. Për çudi, për mua kufiri ishte i pakapërcyeshëm. Edhe kjo është një nga dhembjet e mia.

E dua Kosovën gjer në dhembje, se është Shqipëri!

NJË ÇAST MEDITIMI

Kam shkruar kaq shumë, tërë këto faqe, duke rendur nëpër vitet e mia, mbushur me kujtime, me pësime, me zhgënjime, me luftë, burgje, hekura dhe poshtërime zyrtare, dhe i kalova pa përmendur dy gëzime të mëdha të jetës sime të rëndë: lindjen e djalit, që e quajtëm Jamarbër, dhe të vajzës, Arianita, të cilën fillimisht e quajtëm Joniana. U bë një diskutim pa fund midis meje dhe Safos për emrin e saj. E pra, në familje jemi katër veta. Të katër artistë. Gjë më të bukur nuk paska!

Po përsëri do të flas për një ngjarje të hidhur: Në qershor të këtij viti djali u aksidentua rëndë dhe qëndroi në gjendje kome në spital për një kohë të gjatë, pa shpresë. Unë dergjesha në shtrat i sëmurë. Për fat, djali

u kthye në jetë dhe në shtëpinë tonë u bëmë dy që dergjeshim në shtrat në gjendje të rëndë. Nga dita e aksidentimit të djalit dhe deri tani, katër muaj më vonë, ai dalëngadalë po rimëkëmbet fizikisht. Dalëngadalë po i kthehet edhe kujtesa. Ndërkohë, unë ngrihem nga shtrati që të vazhdoj të shkruaj kujtimet. Mundohem mëngjeseve, kur dielli ka ngrohur qytetin, të bëj atë copë rrugë të shkurtër që më shpie te Klubi i Gazetarëve, ku më rrethojnë poetë, shkrimtarë, gazetarë të rinj, miq të dashur, të cilët duan të dinë shumë gjëra nga unë. Ata janë gjithmonë kërkues dhe kureshtarë. Madje ndonjë prej tyre mban edhe shënime, si Moikomi, për shembull; e ndiej që ai më do dhe më respekton; është djalë shumë interesant dhe me shumë talent. Pastaj, Xhevahiri, që nuk më ndahet, sikur të ishte biri im. E kam si djalë, por edhe si shok; kemi ngjashmëri në portret, por edhe një të përbashkët në ndjeshmëri e luftë për të vërtetën. Kemi edhe poezinë që na lidh. Edhe vlonjati me shpirt artisti Bardhosh Gaçe vjen shpesh e më viziton të sëmurë, që nga Vlora. Më bën pyetje dhe mban shënime. Me sa duket, e shikon që unë dalëngadalë po shuhem.

Edhe kritiku im Adriatik Kallulli, që e kam edhe nipin e Mane Nishovës, asnjëherë nuk më është ndarë. Me Fatos Arapin, edhe ky vlonjat, poezinë e të cilit e kam çmuar gjithmonë shumë, kemi bërë biseda interesante.

Miqësi të përhershme kam pasur edhe me Sazanin, të birin e Halim Xhelos, që nuk më është ndarë kurrë as në të mirë e as në të keq. Më ishte shumë mirënjohës për veprën e vogël "Halimi", të cilën ia kisha dedikuar jetës dhe veprës së atij patrioti të ndershëm. Kohët e fundit më është afruar një djalë nga fshati "Tre Vëllazën" i Vlorës, Faruk Myrtaj, një djalë shumë i talentuar e shumë i mençur. Vite më parë, pata fatin të njihja një djalë të zbehtë, fare të ri, që quhej Bilal Xhaferri. Kur lexova librin e tij të parë me tregime, u mallëngjeva, kaq

i talentuar ishte ai djalë. Shkrimet e tij të befasonin. Punonte nëpër kantiere ndërtimi, bënte punë të rënda. Më në fund ai u arratis dhe përfundoi në SHBA, ku dhe vdiq, siç thonë, aksidentalisht. Ka shumë të rinj që i njoh, të cilët premtojnë shumë; ata më gjallërojnë, ndaj rri në shoqërinë e tyre. Unë iu uroj atyre liri krijimi! Pa pranga, pa censurë! Dhe gjithmonë përpjekje për të mirën e atdheut, të Shqipërisë!

Gjatë këtyre viteve kam humbur familjarë të mi të afërt: Mimin (Dhimitrin), që vdiq në Greqi, u kalb në burgje, kur u shkatërrua EAMI; ai u largua 12 vjeç dhe nuk u kthye kurrë më; Mimi që më shkroi dy letra e që nuk guxova t'i ktheja asnjë përgjigje. Kërkonte të vinte e të na shihte. Po ku të vinte? Liloja, motra-nënë vdiq edhe ajo, e hidhëruar dhe e vetmuar. Kur mbetëm jetimë, na rriti ne e nuk u martua kurrë, megjithëse ishte një vajzë e hijshme... Më kujtohet tani një episod i vogël:

Kur flinim, pas vdekjes së nënës, të pesë vëllezërit, të shtrirë njëri pas tjetrit mbi stromën e bardhë me motive, Liloja shtrihej e fundit në radhë, pasi bënte lutjen para ikonës. Një natë ajo ndjeu se Mimi po i shtrëngonte gërshetin dhe qante me ngashërim, pa zë. Ajo u zgjua dhe i tha:

- Ç'ke more, pse nuk më lë të fle, se jam e lodhur? Hiqma dorën nga gërsheti! - Atëherë Mimi iu përgjigj nëpër lot:

- Unë të mbaj nga gërsheti, se kam dëgjuar që ka ardhur një burrë nga Amerika e ti do të martohesh e do të ikësh me të. Po ne ku do të na lësh? - Dhe motra-nënë, atëherë vajzë 14-vjeçare na tregonte më pas, tërë jetën - u betua që të mos martohej kurrë, por të bëhej nënë për ne të pesë jetimët. Dhe, siç tha, ashtu bëri.

Vdiq dhe Agjisilla, dy vjet më i vogël se unë. Tërë jetën shofer. I ndershëm, i dashur, familjar i mirë. Në

fund ai humbi dritën e syve. Kjo ishte edhe për mua një ngjarje shumë e rëndë. Por gruaja e tij, djemtë dhe vajza ia lehtësuan ditët e errëta dhe vdiq i rrethuar nga dashuria dhe kujdesi i tyre.

Në vitin 1987, kur unë isha përsëri shumë i sëmurë nga emfizema, humba edhe vjehrrën time, Shazijen, të cilën e thërrisja Zonjë. Ishte zonjë e vërtetë jo vetëm nga prejardhja, por edhe nga karakteri dhe mençuria. E respektova dhe më respektoi tërë jetën. Gjithmonë kisha menduar për të se, po të kishte bërë në Stamboll, ku u rrit, edhe studimet e larta, ajo kishte të dhëna të tilla që më bënin të besoja se do të kishte qenë një gazetare e shquar.

Ndër vite, humba miq e shokë të dashur: Demir Godellin, Minella Kolekën, Mane Nishovën, Justina Shkupin, Iljaz Pashain, Mina Uçin, njeri dhe patriot i ndershëm, Esat Dishnicën, me të cilin bisedoja me orë të tëra për luftën. Pas Çlirimit erdhi në Shqipëri Hito Sadiku, të cilin e kisha njohur në Romë, kishte qenë sekretar i Faik Konicës, ishte dhe poet. U arrestua në një kohë me mua në 1947 dhe u dënua 4 vjet. Kur doli, banonte në një xhami në Tiranë. Vendosi të kthehej në Bënçë, në fshatin e tij ku nuk kishte më asnjeri të afërt, se mbeti pa punë e pa shtëpi, i braktisur. Pas nja dy vjetësh mora lajmin e hidhur e të papritur nga një mjek, i cili më tha se Hitos i plasi tëmthi dhe vdiq, gjë që ndodh edhe nga hidhërimi.

Së fundi, dhe një vdekje shumë e hidhur, ajo e Skënder Luarasit. Dhe shumë të tjerë, siç ndodh në jetë, si dhe "vetëvrasja" e Mehmet Shehut, të cilën nuk mund ta pranoj kurrë si të tillë, ngaqë e njihja atë njeri. Akuzat ndaj tij ishin qesharake: poliagjent!

Nga shokët e Spanjës më ka mbetur vetëm Zef Prela.

DY PROPOZIME NË DISTANCË KOHE

Propozimi i parë: Para burgimit tim, siç kam treguar më parë, shoqërova dy gazetarët Li Uajt dhe Çakall në jug të Shqipërisë. Në Vlorë, në një restorant, kur po hanim mëngjesin pranë detit, unë u largova për pak dhe e lashë Safon vetëm me Li Uajtin, njeri shumë i sjellshëm dhe i kulturuar. Kur po ktheheshim në Tiranë, diku pranë Fierit zuri një shi i madh dhe unë me Çakallin e Javer Malon zbritëm nga vetura dhe nxituam për t'u futur nën strehën e një magazine. Pas pak minutash zbriti dhe Li Uajti dhe vrapoi drejt nesh i pasuar nga Safoja, që kishte mbuluar kokën me pardësy. Kur mbërritëm në Tiranë dhe u ndamë me ta, unë dhe Safoja shkuam në zyrat e "Bashkimit". E ndjeva se diçka deshi të më thoshte. Dhe vërtet, ajo më tregoi se, kur kishte mbetur vetëm në Vlorë me Li Uajtin, i cili po pinte kafen, ai i kishte thënë Safos: "Do të të bëj një propozim. Nuk guxoj t'ia them Petros këto që po të them ty. Ne për dy ditë nisemi me avion dhe mendoj se ti dhe Petroja shumë shpejt nuk do ta ndieni më veten mirë këtu. Ai është një gazetar shumë i mirë, kurse ti ëndërron që të bëhesh piktore. Ju ofroj këtë zgjidhje: Në aeroport, kur të bëhet përcjellja jonë, ju mund të hipni në avion. Ju shoqëroj unë. Avioni është zonë amerikane dhe askush nuk do të guxojë të hipë atje e t'ju zbresë. Kështu që ju siguroj ty studimet dhe Petros një vend të sigurt si gazetar." Unë e dëgjova Safon, e cila dukej se në njëfarë mënyre ishte joshur nga një zgjidhje e tillë, dhe i thashë: "Unë kam hequr të zitë e ullirit për këtë vend dhe rruga ime nëpër Evropë nuk ka qenë fushë me lule. Një propozim të tillë ma bënë edhe në Romë, për në gazetën "Unita". Por unë kam ardhur këtu në vendin tim dhe këtu do të vdes." Por edhe Safoja kishte familjen e saj, nënën dhe vëllanë, të cilët nuk mund t'i braktiste, se do të kishin pasoja të rënda. Kaq.

Propozimi i dytë: Pak vjet përpara 90-s, në nëntor, për çështjen e pasurive të patundshme të Safos që ndodhen në Greqi, ajo u lejua të bënte rrugën për në Athinë e Selanik e shoqëruar nga unë. Unë rashë në kontakt me nipin tim, Thomanë, birin e Jerasimo Dunit dhe të kushërirës sime të parë, Kateros. Ai u gëzua pa masë dhe u tregua i gatshëm të na priste në shtëpinë e tij. Sigurisht, për të gjitha këto unë mora leje, duke thënë se atje kisha shumë farefis e të njohur bashkëfshatarë (që kishin qenë arratisur). Takimi ishte i dhembshëm, tërë lot e përqafime. Thomai ishte arratisur nga fshati me të atin, kur ishte vetëm 15-vjeçar, kurse tani ishte bërë një burrë i pjekur me familje, me pasuri, të cilën e kishte vënë me punë e mund, duke e nisur si mekanik e duke fjetur nën ura. Një takim i pabesueshëm. Në ditët që pasuan, më erdhën të gjithë dhërmiotët e arratisur dhe, me një mallëngjim të parrëfyer, putheshin me mua e qanin si fëmijë. Malli për familjet, për atdheun, për Dhërmiun u kishte gërryer shpirtin. Qanim edhe ne. Kishin jetuar, kishin punuar e ishin plakur jashtë. Larg. Megjithatë, ata ishin të informuar për të gjitha, për burgun tim dhe të djalit. Për sa kohë qëndruam atje, nuk pati asnjë nuancë për ndonjë propozim si ai i natës së fundit. Nipi im, Thomai, vetëm tri ditë qëndroi me ne. Ai më deshi, më nderoi e më priti me dashuri të madhe, pastaj iku në Evropë përsëri. Natën e fundit, në vizitën e ndarjes në një familje himarjote, Safoja vajti atje përpara meje. Pak më vonë arrita edhe unë. Shkova të ndahesha me shokun e fëmijërisë, komshiun tim Koço, të vëllanë e Llambro Dedes, me të cilin shkonim këmbëzbathur në shkollë dhe ndanim kafshatën e bukës. Sigurisht, unë nuk kisha, se isha jetim, por nëna e tij nuk më ndante nga djemtë e saj. Vasili më tha:

- Petro, vëlla! Kam një propozim për ty, të cilin ia thashë edhe Safos përpara se të vije ti. Kam menduar që

ti të qëndrosh këtu bashkë me gruan. Të mos kthehesh më në Tiranë. Do të kesh një shtëpi të pajisur me të gjitha ato që duhen, dhe ti do të bësh një libër ku të shkruash të gjitha paudhësitë e pushtetit të Enver Hoxhës, i cili e groposi Shqipërinë. Ty të futi në burg, që je edhe luftëtar i Spanjës. Djalin ta burgosi. Erdhe këtu i varfër si mos më keq. I pe këtu të tërë të arratisurit se si janë sistemuar dhe si rrojnë. Librin që do të shkruash, ne do ta botojmë në disa gjuhë të huaja dhe të gjitha të ardhurat do t'i marrësh ti. Prandaj të propozoj: mendohu mirë sonte dhe nesër mos u nis për në Tiranë.

Unë iu përgjigja:

- Të kam pasur dhe do të të kem vëlla, se nuk e harroj të kaluarën. Ti e di rrugën time, që ndahet nga rruga jote. Unë rrugën time nuk e tradhtoj dot, atë e kam nisur që i ri me shkrimet e mia, me Luftën e Spanjës, me burgje e internime gjatë okupacionit fashist dhe me burg gjatë kohës për të cilën unë luftova. Këto ti i di. Ti e di edhe burgun e djalit, të cilin e kam vuajtur edhe unë. Rruga jote është tjetër. Dhe ti atë rrugë nuk e tradhton. Dhe mbi të gjitha, unë atje kam dy sytë e mi: vajzën dhe djalin. Po të rri unë me Safon këtu, atyre u kemi siguruar internimin ose burgimin. Unë do të kthehem siç kam ardhur. Të kam vëlla. Kemi ndarë kafshatën bashkë. - dhe u puthëm e u ndamë me lot që të dy.

Nota më tragjike e vizitës sime në Athinë:

Mbasditen e fundit, në shtëpinë e nipit tim Thoma, u ulëm unë, Safoja dhe Jerasimo, babai i Thomait, shumë plak dhe shumë i sëmurë, por trupmadh e akoma i drejtë si një lis. Atë drekë s'vuri gjë në gojë njeri. Vetëm u lotua. Jerasimo vajtoi me ligje shqip, si burrat e fshatit. Qau të vrarët e të vdekurit, midis të cilëve vëllanë e tij dhe vëllanë e gruas, Jani Markon, të cilin e quante edhe atë vëlla. Qau fatin e tij e të familjes së tij, si në një rrëfim mitologjik.

Filloi që me të qenët kryetar i këshillit të fshatit pas çlirimit, tregoi atë moment natën kur zgjodhi një nga djemtë e tij, Thomanë, ende të mitur, të cilin e mori me vete në rrugën e arratisë me nëndetëse drejt brigjeve të Korfuzit. Midis vajit, ai thoshte se familjen e tij me gruan e re dhe me tetë fëmijë nuk do ta kishte braktisur kurrë, por u gënjye se e kishin siguruar që e shumta dy vjet do të ishte arratia, se Shqipëria do të çlirohej nga forcat anglo-amerikane. Po kjo nuk ndodhi dhe ai po vdiste tani larg familjes, larg atdheut, nëntëdhjetëca vjeçar, vërtet midis të mirave që i kishte krijuar i biri, por pa e pasur më kurrë mundësinë që t'i shihte përsëri njerëzit që la atje larg. Ky vajtim ishte apologjia e Jerasimo Dunit. që më quante edhe mua vëlla. Nusja e Thomait, Aliqi, serviri drekë, por asnjërit nga të tre nuk na hahej. Ajo i tha:

- Baba! Këta njerëz nesër në mëngjes nisen. Pse u jep kaq trishtim?! - Dhe plaku ngriti kokën me sytë plot lot e iu përgjigj:

- Vetëm Safoja më kupton, asnjë njeri tjetër! Safoja, që nesër do të kthehet atje ku janë të mitë.

Kjo ishte tragjedia e njërit nga të ikurit.

Thoma Duni, me dashurinë, me respektin dhe zemërgjerësinë e tij, më krijoi një familje mirëqenieje. U ndamë të përlotur me të gjithë bashkëfshatarët dhe u ktheva në Tiranë në shtëpinë time, te fëmijët e mi.

Pra këto ishin dy propozime që m'u bënë për të braktisur atdheun e për të rregulluar mirëqenien. Zgjodha të kthehesha këtu, ku po shkruaj kujtimet, ku po vdes.

Tani, pas 47 vjetësh, kur unë jam në prag të fundit të jetës, i sëmurë, përjetoj një situatë kombëtare fare të turbullt, të errët, të pasigurt, me një psikozë kombëtare evadimi me çdo kusht nga e kaluara dhe e sotmja... Ja, këto ditë shihja nga dritarja ime një lumë njerëzish: shumica të rinj e të reja, madje dhe minorenë, edhe burra,

edhe gra që vraponin, disa pa këpucë në këmbë, drejt trenit, për në Durrës... Bulevardi u bë lumë njerëzish, më tepër se në demonstrata ose parakalime... Derdheshin si lumë drejt trenit, për në Durrës, se kishin ardhur disa tragete dhe këta mijëra e mijëra njerëz vraponin t'i arrinin, të hipnin në to dhe të largoheshin nga vatra, nga nëna, nga babai, nga foleja e ëndrrave të tyre duke shpresuar se vraponin drejt lirisë diku përtej detit. Një situatë e vështirë e tensionuar, kaotike... Thonë e ç'nuk thonë... Mijëra e mijëra janë grumbulluar... (I pamë dhe në ekran të televizorit: një grua, me fëmijën në njërën dorë, kurse me dorën tjetër mbahej në litar dhe përpiqej të hipte në vapor. Një pamje tragjike shumë domethënëse për Shqipërinë e mjerë. Ajo grua rrezikonte jetën e saj e të fëmijës për të hipur në vapor... dhe gati sa nuk i binte fëmija në det...)

Thonë se edhe në Vlorë po ndodh po kjo tragjedi, po ky eksod dramatik... Ku vemi? Të shohim.

Më duket se këtu diçka po lëvrin. Po shpartallohet diktatura! Rinia është në krye. Më tingëllojnë në vesh thirrjet entuziaste të pasçlirimit: "Rroftë Shqipëria demokratike!" Pas kësaj përvoje të hidhur shumëvjeçare, nuk do të ketë kurrë më kthim prapa. Nuk do të ketë më mure që të na ndajnë nga bota. Demokracia, të cilën e ëndërruam , për të cilën luftuam e për të cilën u vranë me qindra shokë të mi, më duket se më në fund po vjen.

Nuk do ta harroj kurrë atë ditë të ftohtë, kur sindikalistët demonstruan si lumë - masë rinie e populli - në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe ndaluan përpara shtëpisë sime, ku buçiti thirrja: "Petro Marko! Petro Marko!" "Rroftë kujtimi i Sejfulla Malëshovës! Rroftë Petro Marko" - dhe duartrokitjet e brohoritjet nuk pushuan. U ngrita nga shtrati, ku lëngoja, dhe dola në dritare, mbështeta ballin te xhami e i përshëndeta me dorë. Atëherë ata duartrokitën stuhishëm e më përshën-

detnin me dashuri. Më mbyti mallëngjimi. Ishte një ditë e madhe për mua, një ditë që nuk harrohet.

Dua të përmend dy fjalët që tha Gorbaçovi në varrimin e dy të rinjve që kishin mbrojtur parlamentin nga forcat regresive dhe u shpallën Heronj të Popullit...: "Ne sot nuk po varrosim vetëm këta dy Heronj të Popullit, por po varrosim komunizmin!"

Të them të drejtën, unë çdo gjë të rinisë dhe të jetës sime ia kam kushtuar idealeve të komunizmit, ndaj dhe u bëra anëtar i partisë spanjolle, franceze dhe italiane. Po pse nuk u bëra këtu anëtar i partisë? Këtë e kam thënë: se në Berat, në tetor të vitit 1944, kur u ktheva me dyqind vullnetarë shqiptarë, Sejfulla Malëshova më porositi: Kjo parti është një parti terroriste e krijuar nga serbët, prandaj ti mos e hap gojën për asgjë që shikon, të paktën për një vit. Fjalët e Sejfulla Malëshovës, njërit nga njerëzit më të shquar të demokracisë sonë, që vuajti gjithë jetën dhe që u varros me karron e plehrave në Fier, qenë për mua shpëtimi.

Pyetje: - Po tani a pendohesh që ke pasur ideale komuniste?

Përgjigje: - Nuk pendohem aspak. Se edhe përpara Çlirimit, edhe gjatë Luftës komunistët ishin idealistët më të vendosur për demokraci, për barazi, për mirëqenie popullore, kundër shtypësve të çdo lloji. Në Evropë intelektualët më të shquar ishin të majtë.

Po te ne çfarë ndodhi?

Grupet e vjetra komuniste u shpartalluan. Shumë nga komunistët e parë u vranë në luftë. Nga ata që mbetën, disa u vranë si tradhtarë; shumë komandantë, komisarë dhe kuadro të brigadave u vranë, u internuan në vite të ndryshme duke u quajtur tradhtarë. Kur bisedonim me shokët, thoshim: "Atëherë kush e udhëhoqi Luftën? E paskan udhëhequr tradhtarët!" E vërteta ishte ndryshe. Ata luftuan trimërisht dhe e udhëhoqën Luftën

me mençuri, si strategë të vërtetë në krye të batalioneve, brigadave dhe më vonë të divizioneve. Si shpërblim morën vulën e tradhtarit. Kohë pas kohe "zbuloheshin grupe armiqësore antiparti" dhe ekzekutoheshin specialistë të shquar, komunistë të devotshëm, të cilët merrnin damkën e tradhtarit dhe plumbin. Dhe kështu pakëna-qësia e popullit rritej. U mboll era dhe u korr furtuna!

Qysh në fillim duhej vlerësuar nënshtrimi i Partisë Komuniste si vasale e serbëve. Cili e kundërshtoi këtë, përveç ballistëve, që trumbetuan: "Këta komunistë u bënë skllevër të jugosllavëve"! Prandaj dhe shumica e tyre, që u bënë kundër nesh, kishin të drejtë të na quanin vasalë të serbëve, se e lamë Kosovën nën shtypjen e tyre dhe gjithë Shqipërinë nën kontrollin e tyre. Unë mendoj - meqë i kam jetuar ato kohë - se shumica e popullit kishte besim te djemtë e tij partizanë patriotë, idealistë e komunistë, se e dinin që këta djem luftonin për lirinë dhe pavarësinë e tij. Edhe komunistët kishin besim tek ajo politikë, se edhe ne bënim pjesë në familjen e madhe të kampit socialist, dhe kurrë nuk u shkonte ndër mend se kishte në botë parti komuniste që gënjente ose nuk ishte leale dhe e sinqertë...

Më kujtohen bisedat që bëmë në dhjetor të vitit 1941, në shtëpinë e Turkeshit, kur ne shkuam të merreshim vesh me patriotët e Ballit për të bashkëpunuar me ta kundër okupatorit... dhe ata më thanë: Nëse Kosovën nuk e përfshin partia juaj, atëherë Kosovën e shitët, prandaj me ju nuk shtrohemi në bisedë... Shumë patriotë, shumë intelektualë u dëshpëruan për shitjen e Kosovës, prandaj dhe nuk e deshën Partinë Komuniste Shqiptare. Midis tyre kishte patriotë të ndershëm: kam pasur miq midis tyre. Hysni Lepenica ishte shqiptar patriot e trim.

Unë nuk mund të bëhem avokat i qëndrimit të Ballit Kombëtar gjatë Luftës, se ka pasur dhe banda që luftuan

edhe kundër partizanëve bashkë me gjermanët, por duhet nisur nga arsyeja kryesore: Kush u bë shkak i përçarjes së popullit tonë? Historia do të bëhet gjykatësi i drejtë i përçarjes së popullit shqiptar dhe i shkëputjes së Kosovës.

Aty nga gushti i vitit 1946, mora një letër nga Kostë Çekrezi nga Amerika (Kostë Çekrezi, si drejtor dhe pronar i gazetës "ORA", më kishte botuar tregimet e para më 1932 dhe më kishte pranuar të punoja aty duke më bërë qejfin me fjalët e bukura që më tha: "Do të bëhesh një shkrimtar i mirë"). Ai më shkruante nga Amerika një letër ku më kërkonte 100 shkrime "Një orë në Tiranë", me pseudonimin Demo Koti, duke më thënë se UNESKO-ja botonte nga një shkrimtar modern për çdo kombësi, prandaj 100 copë "Një orë në Tiranë" do t'i botonte UNESKO-ja... Unë i mblodha 100 copë të mira për t'ia dërguar, po nuk më la aparati i Partisë duke më thënë se nuk duhej të kisha asnjë lidhje me Kostë Çekrezin.

Mund të them për atë kohë me ndershmëri: një gjëmë e madhe e kishte pllakosur Shqipërinë - frika, pasiguria, padrejtësia, shtypja dhe mosbesimi tek asnjë njeri, as te njerëzit e familjes sate, ndarja e njerëzve me privilegje, lufta e klasave (padrejtësi çnjerëzore), izolimi, që ishte vdekja, regresi.

Pyetje: - Ç'mund të na tregosh për rrjedhën e ngjarjeve sipas ndryshimeve që bëheshin?

Përgjigje: - Si konkluzion:

1. Koha e parë, gjersa u prishëm me Jugosllavinë më 1948.

2. Koha kur u lidhëm menjëherë me Bashkimin Sovjetik, paçka se më parë thoshim se rruga për në Moskë, kalonte nga Begradi.

3. Koha kur u ndamë nga Bashkimi Sovjetik, se u kritikua Stalini dhe kulti i individit.

4. Lidhja dhe prishja edhe me Kinën.

(Një parantezë: Nuk e di nëse e kam përmendur këtë

episod kuptimplotë: Pas Çlirimit, kur isha drejtor i "Bashkimit", bëra një vizitë në burg dhe u takova me të burgosurit politikë që ende nuk u ishte bërë gjyqi special. Fola me disa që njihja, dhe disave u thashë: "Pse nuk e dorëzoni floririn?" "Do ta bëjmë plumb për ballin tuaj, që e shitët Shqipërinë te serbi!" - më tha Bilal Nivica, kurse një tjetër më tha: "Lumthi Shqipëria! Këtu do të lulëzojë begatia dhe lumturia se paskeni bërë aleancë me Korenë! Koreja do të na lumturojë të gjithëve... Ju jeni gjeni të vërtetë!... Po... presim...")

VETIZOLIMI

U prishëm edhe me Kinën dhe shpallëm vetizolimin. U tha se edhe bar do të hanim, po nuk do ta ndryshonim vijën tonë: Me forcat tona!

Me rastin e 50-vjetorit të pavarësisë më 1962 Branko Merxhani shkroi në Turqi, në gazetën "TAN", për Shqipërinë dhe përparimet që kishte bërë, sidomos në përhapjen e kulturës: "Po udhëheqja, nëse nuk ndryshon rrugë, ecën drejt greminës, drejt vdekjes. Asnjë shtet në botë nuk mund të vetizolohet dhe të rrojë në autarki: as vetë Amerika e fuqishme, as vetë Bashkimi Sovjetik... dhe jo Shqipëria e vogël dhe e prapambetur, më e varfra në Evropë... Nëse qeveria shqiptare nuk i hap kufijtë, nuk bashkohet me botën, por do të vazhdojë vetizolimin, ajo shkon drejt vdekjes... Nuk ka mundësi, siç thotë udhëheqja, "që edhe bar do të hamë, po nuk do të ndryshojmë rrugën tonë!"."

Bota do të na ketë zili, - thoshte Enver Hoxha. - Edhe vetë Amerika na ka zili dhe lufton që të na arrijë në jetën e lumtur që bëjmë ne... Po, kur të na arrijë, ne do të jemi 100 vjet përpara tyre...(!)

Gjatë gjithë këtyre viteve, kontakti i pandërprerë me

botën kanë qenë stacionet radiofonike, të cilat i merrte radioja ime e vogël (dhuratë nga Shevqet Musaraj, i cili ma solli nga Bashkimi Sovjetik), prej së cilës nuk jam shkëputur kurrë. Isha i etur të dëgjoja se çfarë ndodhte në botë dhe si e komentonte bota shtetrrethimin tonë të egër.

Si gazetar i vjetër, i dëshiruar për të thënë një fjalë të lirë, pata mundësinë ta them këtë fjalë në gazetën "Republika". Po vjen koha e ndryshimeve të mëdha. Ndihet në atmosferë, nuk më gabon nuhatja e gazetarit. Veçse për mua është tepër vonë. Megjithatë, më mirë vonë se kurrë, thotë populli. Ndaj dhe nxitova të përmendja shokë e njerëz të dashur që humbën tragjikisht. Këto shkrime, në pamundësi që t'i shkruaja vetë, ia kam diktuar Safos. I merrte miku i shtëpisë sime Vangjush Gambeta dhe i botonte në gazetën e tij. Vetëm kaq mund të bëj. Nëse me të vërtetë më në fund do të triumfojë demokracia e ëndërruar, gjeneratat që vijnë, do të kenë mundësi të analizojnë këtë kalvarin tonë të çuditshëm 45-vjeçar, që edhe duke u shtypur, edhe duke vuajtur, duke na u mohuar frymëmarrja, të ndarë nga bota, ne prapë kemi punuar. Ndërtuesit ndërtonin, bujqit punonin, këngëtarët këndonin, piktorët pikturonin, jeta vazhdonte, por nën diktaturë. Ata që do të jetojnë, që janë në moshë të re, do të kenë fatin të punojnë e të krijojnë lirisht, si njerëz të LIRË.

EPILOGU

Megjithëse unë linda i krishterë, në një fshat shumë besimtar, nuk i jam rrëfyer kurrë priftit përpara se të kungohesha... Por tani dëshiroj të rrëfehem para historisë, përpara se të vdes.

Shënim. *Në makinën e shkrimit ne gjetëm një fletë të bardhë vetëm me këto fjalë:*

"Gjoksi im i sëmurë nuk më lejon që të përkulem mbi makinën e shkrimit."

Tetor 1991

Përmbajtja

Faqe

Parathënie.....3

Pjesa e parë
(shkruar në vitin 1977)

Petro Marko plak
interviston Petro Markon e ri.....9
Le ta çelim rubrikën e kujtesës.....13
Dita e parë e shkollës.....32
Përsëri me djajtë dhe priftërinjtë.....35
Bustiana.....40

Kalvari (1931-1937)
Në Tiranë.....69

Jashtë Shqipërisë
Në Greqi.....117
Një ngjarje që nuk do ta harroj kurrë.....128
Një ngjarje tjetër.....130

Viti 1935 - Në Tiranë
Kryengritja e Fierit.....132

Përsëri në Tiranë (1935-1936-1937)
Vite me densitet ngjarjesh.....142

Rruga për në Spanjë.....181
Lidhja e parë me Kominternin.....*197*

Hapësira internacionaliste
Lufta e Spanjës
Njohja, atmosfera, takimi me shokët e mi....*209*
Në Albacete, qendra e brigadave internacionale.....*212*
Drejt frontit me Ramizin, Shabanin, Manen, Faikun.....*228*
Drejt Aragonës.....*236*
Lamtumirë, o Albacete!.....*238*
Drejt së panjohurës.....*246*
Katastrofa e përgjakur.....*247*

Pas Spanjës: odiseja vazhdon.....252
Në Grënobël.....*267*
Përmes Italisë, i lidhur me pranga.....*299*
Në Dhërmi, në llogoren e ëndrrave të mia...*306*
Lufta Italo-greke dhe burgu.....*326*
Në burgjet dhe ishujt e Italisë.....*350*
Jeta jonë e përditshme.....*361*
Jeta jonë politike.....*365*
Jeta në ishull.....*371*
Në kampin "Frasketi".....*379*
Në Itali.....*389*

Pjesa e dytë
(shkruar në vitin 1991)

Petro Marko plak
interviston Petro Markon plak.....*433*
Nisi kalvari.....*469*

Kthesa e çuditshme.....483
Jeta në Burgun e Vjetër.....485
Biseda, episode, personazhe.....492
Nën diellin e mjegulluar të lirimit tim nga burgu.....498
Romani i parë: "Hasta la vista" (pas burgut)..505
Skenari për filmin e parë shqiptaro-sovjetik.512
Drama e një drame.....513
Pas letrës së hapur të partisë.....516
Vazhdojnë persekutimet.....518
Vështirësitë e botimeve të mia.....520
Romani tjetër "Çuka e shtegtarit".....525
"Retë dhe gurët".....526
"Lejania".....533
Fisnikët dhe guximtarët, vëllezërit e mi kosovarë.....535
Një çast meditimi.....538
Dy propozime në distancë kohe.....542
Vetizolimi.....550
Epilogu.....552